

VLERËSIMI I SISTEMIT TË INTEGRITETIT KOMBËTAR KOSOVË





Instituti Demokratik i Kosovës është degë e
Transparency International për Kosovë

Misioni i KDI-së është mbështetja e
zhvillimit të demokracisë pjesëmarrëse
dhe luftës kundër korrupsion përmes
promovimit të transparencës,
llogaridhënies dhe integritetit në të
gjitha nivelet dhe sektorët e shoqërisë

Instituti Demokratik i Kosovës – Transparency International Kosova

Autori kryesor: **Eugen Cakolli**

Autorë të tjerë: **Vullnet Bugaqku, Tringa Dreshaj, Diana Metushi – Krasniqi**

Recenzentët: **Isabelle Büchner, Jon Vrushi, Jorge Valladares, Andrew McDevitt**

Dizajn: **envinion**

Të gjitha informacionet besohet se ishin të sakta deri më: 01.09.2023

Instituti Demokratik i Kosovës është OJQ e themeluar në vitin 2005. Vetë-iniciativa e stafit lokal për të kontribuar në demokracinë e re të vendit, e kombinuar me përvojën e tyre në pjesëmarrjen qytetare, avokimin, monitorimin e zgjedhjeve dhe parlamentit, ishte parësore në nxitjen e organizatës për t'u bërë ajo që është sot – **një nga OJQ-të më të besueshme, të guximshme dhe me ndikim në Kosovë.**

Puna e KDI-së ka si synim një mjedis pa korrupsion ku institucionet, biznesi dhe qytetarët ushtrojnë të drejtat dhe rolet e tyre me integritet dhe dinjitet. Misioni i saj është *"mbështetja e zhvillimit të demokracisë pjesëmarrëse dhe luftës kundër korrupsionit përmes promovimit të transparencës, llogaridhënies dhe integritetit në të gjitha nivelet dhe sektorët e shoqërisë"*.

Në vitin 2015, KDI më në fund u akreditua si anëtare e plotë e Transparency International, lëvizje udhëheqëse globale kundër korrupsionit. Duke qenë anëtar/kapitull i TI-së, puna e KDI-së i nënshtrohet një procesi të ngurtë dhe të rregullt riakreditimi. Ky proces garanton që organizata të drejtohet bazuar në parimet e paanësisë, transparencës, integritetit, qeverisjes së mirë dhe etikës së lartë të punës.

Puna e KDI-së është e organizuar në katër fusha programore:

- 1) Demokratizimi dhe praktikant parlamentare,
- 2) Transparenca dhe Anti-Korrupsioni.
- 3) Qeverisja Lokale dhe Pjesëmarrja Qytetare, dhe
- 4) Zgjedhjet. Secili prej këtyre katër programeve është përgjegjës për zhvillimin e projekteve specifike që kontribuojnë në zbatimin e prioriteteve strategjike të organizatës.

Ky publikim është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e Institutit Demokratik të Kosovës dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.



Funded by
the European Union

PËRMBAJTJA

06	LISTA E SHKURTESAVE
09	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE
11	HYRJE
14	PROFILI I VENDIT
25	VLERËSIMI I SIK-UT - SHTYLLAT
	1. LEGJISLATIVI 27
	2. EKZEKUTIVI 49
	3. GJYQËSORI 70
	4. PROKURORIA 92
	5. SEKTORI PUBLIK 114
	6. POLICIA E KOSOVËS 132
	7. KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE 148
	8. AVOKATI I POPULLIT 170
	9. ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT 188
	10. AGJENCIA PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT 206
	11. PARTITË POLITIKE 224
	12. MEDIET 244
	13. SHOQËRIA CIVILE 262
	14. BIZNESET 276
	15. NDËRMARRJET PUBLIKE 294

307 PËRFUNDIME/REKOMANDIME POLITIKASH



LISTA E SHKURTESAVE

AAK	Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës
AGK	Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës
APK	Agjencia për Parandalimin Korrupsionit
AQP	Agjencia Qendrore e Prokurimit
ARBK	Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë
BE	Bashkimi Evropian
BIRN	Rrjeti Ballkanik i Raportimit Hulumtues
BPMSHCK	Bordi i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës
BPRG	Grupi për Kërkime Politike në Ballkan
BPV	Bruto Produkti Vendor
CEFTA	Marrëveshja e Tregtisë së Lirë e Evropës Qendrore
DBJN	Departamenti për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar
DnV	Demokracia në Veprim
DP	Deputet i Parlamentit
EUROSAI	Organizata Evropiane e Institucioneve Supreme të Auditimit
FKSHC	Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile
GIZ	Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
GLPS	Grupi për Studime Juridike dhe Politike
IAP	Institucioni i Avokatit i Popullit i Kosovës
IDFI	Instituti për Zhvillimin e Lirisë së Informacionit
IDK	Instituti Demokratik i Kosovës
IKD	Instituti i Kosovës për Drejtësi
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IPA	Instrumenti për Ndihmë Para-anëtarësimit
IPK	Inspektorati Policor i Kosovës
IREX	Bordi Ndërkombëtar i Kërkimeve dhe Shkëmbimeve
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme Audituese
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KMSHK	Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës
KPK	Këshilli Prokurorial i Kosovës



KPM	Komisioni i Pavarur për Media
KPMShCK	Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
KRPP	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
LDK	Lidhja Demokratike e Kosovës
LVV	Lëvizja Vetëvendosje
MINT	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
NDI	Instituti Demokratik Kombëtar
NP	Ndërmarrjet Publike
NSH	Ndërmarrjet shtetërore
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
OJQ	Organizatet Joqeveritare
OMZ	Organi për Menaxhimin e Zgjedhjeve
ORCA	Organizata për Rritjen e Cilësisë së Arsimit
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
OSHC	Organizatet e Shoqërisë Civile
OSHP	Organi Shqyrtues i Prokurimit
PDK	Partia Demokratike e Kosovës
PK	Policia e Kosovës
PPP	Partneritetet publiko-private
PQH	Partneriteti për Qeverisje të Hapur
PSRK	Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës
PZAP	Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
QKSS	Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë
RTK	Radio Televizioni i Kosovës
SIGMA	Mbështetje për përmirësim në qeverisje dhe menaxhim
SL	Lista Serbe
SLAPP	Padi strategjike kundër pjesëmarrjes publike
SMIL	Sistemi për Menaxhimin Informativ të Lëndëve
UÇK	Ushtria Çlirimtare e Kosovës
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar
ZKA	Zyra Kombëtare e Auditimit
ZQM	Zyra për Qeverisje të Mirë





PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në Kosovë, korrupsioni mbetet një sfidë e vazhdueshme, gjë që reflektohet në Indeksin e Perceptimit të Korrupsionit të Transparency International 2022, me rezultatin prej 41 pikësh nga rezultati maksimal i mundshëm i indeksit prej 100, duke e vendosur atë në vendin e 84-të globalisht. Kjo shënon një përmirësim nga luhatjet në vitet e mëparshme, duke filluar me një rezultat prej 36 në 2016 dhe duke arritur deri në 39 në 2017 dhe 2021, me progres të mëtejshëm në 2022.¹

Barometri Global i Korrupsionit të Transparency International 2016 thekson që 10% e qytetarëve kanë deklaruar se në 12 muajt e fundit u është dashur të japin rryshfet për të pasur qasje në shërbimet qeveritare.² Rastet e profilin të lartë të korrupsionit përfshijnë zyrtarë qeveritarë, gjyqtarë dhe figura institucionale, me ndjekjet penale që fokusohen në rastet e keqpërdorimit të detyrës, rryshfetit, mosdeklarimit të pasurisë, pastrimit të parave dhe krimet të organizuar, veçanërisht në prokurimin publik.

Përderisa Kosova ka një kornizë të konsoliduar ligjore, sfidat qëndrojnë në zbatimin efektiv. Dispozitat ligjore përfshijnë Kodin Penal, Kodin e Procedurës Penale dhe ligjet kundër korrupsionit. Një ligj për konfiskimin civil të pasurisë synon konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të pajustificueshme, por efektiviteti i tij aktual mbetet për t'u demonstruar në praktikë.

Reformat kushtetuese për procesin e vetingut janë duke u zhvilluar, me ndryshimet që prekin vetëm krerët e sistemit gjyqësor dhe atij prokurorial. Megjithatë, mangësitë, të tilla si përkufizimi i pasaktë i pavarësisë së autoritetit vlerësues, duke mos përcaktuar statusin e tij ligjor si institucion i pavarur, kushtetues ose qeveritar, dhe mungesa e përfaqësimit gjinor dhe të komuniteteve, paraqesin sfida.

Iniciativat ligjore të Kosovës që ndikojnë në Sistemin e Integritetit Kombëtar mbulojnë aspekte të ndryshme, nga amendamentet kushtetuese, të financimi i partive politike, konfiskimi i pasurisë dhe krijimi i agjencive kundër korrup-

sionit. Këto përpjekje, të udhëhequra nga Ministria e Drejtësisë, synojnë të rrisin integritetin institucional.

Pavarësisht progresit të qeverisë, një raport i vitit 2022 nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë tregon shqetësime të vazhdueshme në mesin e qytetarëve, me rreth 80 për qind që e shohin korrupsionin si një kërcënim të rëndësishëm dhe 36 për qind mendojnë se progresi i qeverisë është i pamjaftueshëm.³ Sfida të tilla si paqëndrueshmëria politike dhe një sistem drejtësie joefikas vazhdojnë, dhe raportet ndërkombëtare tregojnë korrupsionin e vazhdueshëm brenda qeverisë së bashku me veprimet e papërshtatshme korrigjuese.

Kosova, si shtet i ri dhe në zhvillim, demonstroi një sërë aspektesh pozitive në Sistemin e saj të Integritetit Kombëtar, të shënuar nga një kornizë ligjore që teorikisht mbështet parimet e transparencës, llogaridhënies dhe pavarësisë nëpër shtylla të ndryshme. Megjithatë, zbatimi praktik i legjislativ-it nxjerr në pah disa sfida që kërkojnë vëmendje urgjente për të forcuar strukturat qeverisëse të vendit dhe për të luftuar efektivisht korrupsionin.

Korniza ligjore siguron pavarësinë organizative, administrative dhe buxhetore për organet legjislativ, ekzekutive dhe mbikëqyrëse. Megjithatë, shumica e institucioneve janë të varura nga projeksionet dhe ndarjet buxhetore të Ministrisë së Financave, të cilat zakonisht janë më të ulëta se shumata e kërkuara.

Ekzistojnë dispozita në lidhje me transparencën, që i lejojnë publikut qasje në informacionin për institucionet kryesore në kohë optimale. Dispozitat për raportimin financiar, masat mbrojtëse ligjore dhe ligjet gjithëpërfshirëse në disa shtylla nënvizojnë një përkushtim ndaj integritetit dhe llogaridhënies. Prania e organizatave aktive të shoqërisë civile dhe një peizazh i larmishëm mediatik kontribuon në llogaridhënien dhe shpërndarjen e informacionit.





Megjithatë, pavarësisht nga këto pika të forta, sfidat dhe zbrazëtitë kritike vazhdojnë. Mungesa e burimeve, veçanërisht në dimensionet njerëzore dhe infrastrukturore, pengon efektivitetin e institucioneve. Ndikimi i i papërshtatshëm politik, veçanërisht nga ekzekutivi, zvogëlon më tej efektivitetin dhe pavarësinë e organeve kyçe si gjyqësori, prokuroria dhe Kuvendi. Mangësitë e transparencës, duke përfshirë procesverbalet konfidenciale të mbledhjeve të qeverisë dhe mangësitë e llogaridhënies, siç janë mungesa e sanksioneve për gjyqtarët, paraqesin sfida. Për më tepër, zbatimimi i masave të integritetit, si kodet e sjelljes, mbetet i paqëndrueshëm.

Reformat janë të domosdoshme për të adresuar sfidat e identifikuar, në mënyrë gjithëpërfshirëse. Lidhur me burimet e kufizuara të institucioneve, fokusi i menjëhershëm duhet të jetë në adresimin e mangësive të burimeve. Alokimi i burimeve adekuate është thelbësor për optimizimin e performancës së institucioneve kyçe, duke përfshirë gjyqësorin. Zbutja e ndikimeve të jashtme, veçanërisht ndikimet politike, është kritike për ruajtjen e pavarësisë së institucioneve. Forcimi i dispozitave ligjore dhe mekanizmave të zbatimit mund të garantojë autonomi të autoriteteve vendimmarrëse.

Për më tepër, transparencja në proceset e vendimmarrjes duhet të rritet, veçanërisht në mbledhjet e qeverisë ku konfidencialiteti vazhdon, si dhe në përgjigjet ndaj pyetjeve të medieeve. Hapja e këtyre proceseve dhe përmirësimi i komunikimit me mediet jo vetëm që rrit besimin e publikut, por gjithashtu kontribuon ndjeshëm në nxitjen e një qeverisjeje më të përgjegjshme.

Forcimi i mekanizmave të llogaridhënies është gjithashtu një hap jetik, duke përfshirë përcaktimin e qartë të sanksioneve për gjyqtarët për performancë të dobët. Rritja e besimit të publikut kërkon zbatim sistematik të kodeve të sjelljes dhe vendosjen e mekanizmave efektivë për ruajtjen e integritetit. Kjo kërkon zbatimin e masave për të siguruar dokumentimin dhe zbulimin e ndërveprimeve me lobistët, duke siguruar kështu transparencë në proceset legjislative.

Si përfundim, reformat gjithëpërfshirëse janë thelbësore në forcimin e Sistemit të Integritetit Kombëtar në Kosovë. Përpjekjet kolektive për të kapërcyer boshllëqet në burime, për të rritur transparencën dhe për të zbatuar masat e llogaridhënies do të nxisin një kornizë solide të integritetit, duke siguruar efektivitetin dhe besueshmërinë e institucioneve të Kosovës në luftimin e korrupsionit.



HYRJJE

Sistemi i Integritetit Kombëtar (SIK) përfshin institucionet kryesore të qeverisjes në një vend, që janë përgjegjëse për luftën kundër korrupsionit. Kur këto institucione qeverisëse funksionojnë siç duhet, ato përbëjnë një SIK të shëndetshëm dhe të fortë, efektiv në luftimin e korrupsionit si pjesë e luftës më të madhe kundër abuzimit të pushtetit, keqpërdorimit dhe shpërdorimit në të gjitha format e tij. Megjithatë, kur këto institucione karakterizohen nga mungesa e rregulloreve të duhura dhe nga sjellje të papërgjegjshme, korrupsioni ka të ngjarë të lulëzojë, me efekte të pafavorshme mbi qëllimet shoqërore të rritjes së barabartë, zhvillimit të qëndrueshëm dhe kohezionit social. Prandaj, forcimi i SIK-ut promovon qeverisje më të mirë në një vend dhe kontribuon në një shoqëri më të drejtë në përgjithësi.

Transparency International (TI) zhvilloi SIK-un si pjesë e qasjes holistike të TI-së për të luftuar korrupsionin. Ndërsa nuk ka asnjë plan absolut për një sistem efektiv kundër korrupsionit, ekziston një konsensus ndërkombëtar në rritje mbi aspektet e spikatura që funksionojnë më mirë për të parandaluar korrupsionin dhe për të promovuar integritetin. Vlerësimi i SIK-ut vlerëson bazën ligjore dhe performancën aktuale të institucioneve relevante për sistemin e përgjithshëm kundër korrupsionit. SIK përfshin institucionet ose "shtyllat" e paraqitura në Figurën 1, të cilat bazohen në një sërë themelesh sa u përket kushteve politike, sociale, ekonomike dhe kulturore.


SIK bazohet në një qasje holistike për parandalimin e korrupsionit, pasi shikon të gjithë gamën e institucioneve përkatëse dhe gjithashtu fokusohet në marrëdhëniet ndërmjet tyre. Kështu, SIK supozon që mungesa e integritetit në një institucion të vetëm do të çonte në defekte të rënda në të gjithë sistemin e integritetit. Rrjedhimisht, vlerësimi i SIK-ut nuk synon të ofrojë vetëm një vlerësim të thellë të secilës shtyllë, por më tepër vë theksin në mbulimin e të gjitha shtyllave përkatëse dhe vlerësimin e ndërlydhjeve të tyre.

TI beson se një "analizë e sistemit" e tillë holistike është e nevojshme për të diagnostikuar në mënyrë të përshtatshme rreziqet e korrupsionit dhe për të zhvilluar strategji efektive për t'iu kundërvënë atyre rreziqeve. Kjo analizë është e ngulitur në një qasje pjesëmarrëse, duke përfshirë agjentët kryesorë kundër korrupsionit në qeveri, shoqërinë civile, komunitetin e biznesit dhe sektorë të tjerë përkatës për të ndërtuar vrull, vullnet politik dhe presion qytetar për iniciativat përkatëse të reformës.

Vlerësimi i SIK-ut krijon një bazë të shëndoshë empirike që shton të kuptuarit tonë për performuesit e fortë ose të dobët në një nivel kombëtar. Për më tepër, nga një këndvështrim rajonal, rezultatet mund të krijojnë një ndjenjë presioni nga kolegët për reforma dhe një mundësi për të mësuar nga ato vende në faza të ngjashme zhvillimi.



SISTEMI I INTEGRITETIT KOMBËTAR





PROFILI I VENDIT:

2.1 Bazat e Sistemit të Integritetit Kombëtar

1. QEVERISJA DHE POLITIKA

Kosova është republikë parlamentare, që i përmbahet konceptit themelor të ndarjes së pushteteve dhe mbajtjes së një sistemi kontrollesh dhe balancash ndërmjet tyre.⁴ Sovraniteti i popullit ushtrohet përmes përfaqësuesve të tij të zgjedhur,⁵ me Kuvendin e Kosovës që shërben si autoriteti më i lartë përgjegjës për përfaqësimin dhe ligjvënien brenda vendit.⁶ Autoriteti ekzekutiv ushtrohet nga qeveria, e ngarkuar me zbatimin e ligjeve dhe masave të tjera të miratuara nga Kuvendi.⁷ Presidenti, përderisa kryesisht ka rol ceremonial, shërben si kreu simbolik i shtetit dhe zgjidhet nga Kuvendi i Kosovës.⁸ Presidenti është pozicioni i vetëm brenda hierarkisë institucionale që i nënshtrohet një kufizimi, duke lejuar maksimum vetëm dy mandate në detyrë.⁹

Kabineti qeveritar përbëhet nga kryeministri, tre zëvendëskryeministra dhe 15 ministra. Shtatë nga 15 ministritë në qeveri drejtohen nga gratë. Qeveria është autoriteti që drejton dhe menaxhon administratën publike.¹⁰ Që nga viti 2022, qeveria udhëhiqet nga Lëvizja Vetëvendosje dhe Lista Guxo, me kryeministër Albin Kurtin dhe zëvendëskryeministra Donika Gërvalla, Besnik Bislimi dhe Emilja Rexhepi.¹¹ Kuvendi, bazuar në rezultatin e zgjedhjeve parlamentare të vitit 2021, përbëhet nga këto parti: Lëvizja Vetëvendosje ka 56 mandate, Partia Demokratike e Kosovës me 18 mandate, Lidhja Demokratike e Kosovës me 16 mandate, Lista Serbe me nëntë mandate, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës me tetë mandate dhe Partia Demokratike Turke e Kosovës me dy mandate. Partia Unike Gorane, Koalicioni Vakut, Partia e Ashkalive për Integritet, Nisma Qytetare për Liri, Drejtësi dhe Mbijetesë, Bashkimi Social Demokrat, Lëvizja Progresive e Romëve të Kosovës, Nisma Rome, Partia Demokratike Nisma e Re e Kosovës dhe Partia e Re Demokratike kanë nga një mandat secila. Po ashtu, aktualisht ka dy deputetë të pavarur, që janë ndarë nga grupi parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje.

Kosova krenohet me një demokraci vibrante, e ilustruar me tranzicion të shpeshtë të pushtetit. Që nga shpallja e pa-

varësisë në vitin 2008, Kosova ka mbajtur pesë zgjedhje të parakohshme parlamentare (në 2010, 2014, 2017, 2019 dhe 2021). Gjatë kësaj periudhe, Kosova ka pasur gjashtë kryeministra të ndryshëm, duke nënvizuar rregullsinë e ndryshimeve qeveritare. Proceset zgjedhore në Kosovë vazhdimisht kanë marrë vlerësime pozitive, duke u vlerësuar si të lira dhe në përputhje me të standardet themelore. Megjithatë, vlen të theksohet se në komunat me shumicë serbe, ka shqetësime për konkurrencë të kufizuar politike.¹²

Autoriteti institucional i Kosovës shtrihet në pjesën më të madhe të vendit, me përjashtim të komunave me shumicë serbe në veri të vendit. Në pjesën veriore, ndikimi i Serbisë është i madh, derisa institucionet e Kosovës nuk kanë pasur prani të konsoliduar.¹³

Kosova ende përballet me mungesën e vazhdueshme të respektimit të sundimit të ligjit,¹⁴ me korrupsionin dhe kapjen e shtetit që mbeten format më të përhapura dhe më të dukshme.¹⁵ Mangësia në sundimin e ligjit është veçanërisht e dukshme në komunat veriore të Kosovës me shumicë serbe.¹⁶

Që nga formimi i qeverisë së re, të udhëhequr nga Lëvizja Vetëvendosje, ka pasur një fokus të shtuar në reformimin e kornizës ligjore për të rritur efektivitetin e përpjekjeve kundër korrupsionit. Megjithatë, rezultatet konkrete ende nuk janë parë në praktikë.

2. SHOQËRIA & KULTURA

Në përgjithësi, legjislacioni ofron garanci të fuqishme për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Kushtetuta e Kosovës siguron garanci gjithëpërfshirëse, duke promovuar liritë dhe të drejtat e njeriut në Kosovë në nivel të avancuar.¹⁷ Liritë dhe të drejtat e njeriut interpretohen në përputhje me vendimet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, duke siguruar qëndrueshmëri dhe respektim të standardeve ndërkombëtare.^{18,19}

Kosova dallohet si komb demokratik i karakterizuar nga mungesa e ndarjeve të thella shoqërore të rrënjësura në



faktorë fetarë, etnikë apo gjuhësorë. Ka garanci të forta për të siguruar që shoqëria të funksionojë bazuar në parimet e mosdiskriminimit dhe respektit për të gjithë.²⁰

Kushtetuta dhe ligjet, si rregull i përgjithshëm, mbrojnë të drejtat e grupeve minoritare.²¹ Megjithatë, pavarësisht kornizës ligjore ekzistuese, komuniteti serb vazhdon të shprehë shqetësime për kushtet dhe mbrojtjen e pamjaftueshme.²² Decentralizimi në Kosovë, së bashku me ligjin për vetëqeverisje lokale, u ofron komunave të udhëhequra nga komunitetet joshumicë të drejta të mjaftueshme për të promovuar zhvillimin dhe avancimin e lirive dhe të drejtave të tyre kulturore, arsimore dhe ekonomike.²³

Ekziston një nivel dhe numër i kënaqshëm i organizatave të shoqërisë civile (OSHC), të cilat luajnë rol vendimtar në angazhimin me institucionet shtetërore dhe mbikëqyrjen e aktiviteteve të tyre. Si shoqëria civile ashtu edhe mediet kanë hapësirën ligjore për të vepruar lirish, pa ndërhyrje apo imponim të jashtëm. Për më tepër, liria e shprehjes qëndron si një shtyllë themelore e shoqërisë dhe një parakusht kyç për avancimin e saj. Këto të drejta mbrojnë shpërndarjen e informacionit ose ideve që janë të pranueshme për publikun dhe konsiderohen jo ofenduese,²⁴ duke mbrojtur gjithashtu informacionin dhe idetë që përputhen me parimet e pluralizmit dhe tolerancës – si komponentë thelbësorë për një shoqëri demokratike.²⁵

Sipas raportit të Freedom House për vitin 2022, Kosova garanton lirinë e shtypit, me disa media në funksion, duke përfshirë rrjetin televiziv publik - Radio Televizionin e Kosovës (RTK). Megjithatë, ka pasur shqetësime për ndikim të padrejtë në vendimet editoriale, duke përfshirë edhe RTK-në, që rrjedhin nga interesat e qeverisë dhe bizneseve. Gazetarët gjithashtu kanë raportuar për ngacmime dhe kërcënime të shpeshta, me disa raste të sulmeve kundër gazetarëve gjatë mbulimit të ngjarjeve në veri të Kosovës të ndodhura në vitin 2021.²⁶

Megjithatë, peizazhi mediatik në Kosovë ballafaqohet me sfida të shumta kur bëhet fjalë për marrjen dhe shpërndarjen e informacionit. Ndërveprimet e qeverisë me gazetarët shpesh përshkruhen si të papërshtatshme dhe jotransparente nga gazetarët dhe drejtuesit e medieve. Për më tepër, vërehet mungesë e dukshme e transparencës për disa çështje, siç është dialogu me Serbinë dhe aspekte të ndryshme të politikës ditore të qeverisë. Krahas kësaj, emërimi i drejtorit të RTK-së ka hasur në kritika të mëdha, para së gjithash për shkak të përzgjedhjes së një individi me lidhje të ngushta me partinë në pushtet. Ky emërim shihet si një

formë e ndërhyrjes dhe kapjes së rrjetit televiziv publik nga partia në pushtet.²⁷

Në anën tjetër, besimi i qytetarëve në institucionet e Republikës së Kosovës mbetet jooptimal. Gjetjet e një raporti të Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) tregojnë se qytetarët e Kosovës i shohin institucionet e sigurisë si më të besueshme, me një nivel më të lartë besimi në to krahasuar me institucionet e tjera publike në vend, veçanërisht institucionet e drejtësisë, të cilat perceptohen si më pak të besueshme dhe pa integritet. Besimi i qytetarëve në gjykatat dhe prokuroritë e Kosovës është vazhdimisht në rënie, gjë që është shkak për shqetësim. Edhe pse qytetarët kanë treguar një nivel disi të rritur besimi në institucionet publike të nivelit qendror, veçanërisht në krahasim me vitin e kaluar (2020), një ndjenjë skepticizmi ndaj këtyre institucioneve vazhdon të mbizotërojë në përgjithësi.²⁸

3. EKONOMIA

Kosova është kategorizuar si vend me të ardhura të ulëta dhe të mesme, dhe ka përjetuar rritje të qëndrueshme ekonomike që nga përfundimi i luftës në 1998-99. Me një popullsi prej përafërsisht 1.8 milion banor mandateve, Kosova gjithashtu krenohet me një diasporë të konsiderueshme që banon në vendet e Evropës Perëndimore dhe më gjerë, e cila shërben si burimi kryesor i remitancave për vendin. Sipas raportit të Komisionit Evropian të vitit 2022 për Kosovën, politikat e fundit ekonomike janë përqendruar në ofrimin e asistencës politike për të zbutur efektet e pandemisë dhe çmimet e larta të energjisë që prekin familjet dhe bizneset që janë ndikuar më shumë. Megjithatë, ka pasur përparim të kufizuar në zbatimin e reformave strukturore në vend.²⁹

Në vitin 2021, Bruto Produkti Vendor (BPV) i Kosovës për kokë banori ishte 4,456€, duke shënuar një rritje të konsiderueshme prej 17.79 për qind krahasuar me vitin paraprak. Në vitin 2020, BPV për frymë ishte 3,783 €, që përfaqëson një rënie prej 4.08 për qind nga shifrat e vitit 2019.³⁰ Këto statistika pasqyrojnë luhatjet në performancën ekonomike të Kosovës gjatë viteve përkatëse.³¹ Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, shkalla e papunësisë në vitin 2021 është raportuar në 20.7 për qind.³² Papunësia në Kosovë shfaq pabarazi të konsiderueshme, me gratë që përjetojnë një shkallë më të lartë të papunësisë prej 25.0 për qind krahasuar me burrat, të cilët kanë një shkallë prej 19.0 për qind. Grupmosha 15-24 vjeç përballet me shkallën më





të lartë të papunësisë me 38.0 për qind, gjë që tregon sfidë të veçantë për punëkërkesit e rinj. Përveç kësaj, Kosova është përballur me çështjen e migrimit të fuqisë punëtore dhe fenomenin e "ikjes së trurit", ku individë të kualifikuar largohen nga vendi për mundësi më të mira jashtë vendit. Për më tepër, ndikimi ekonomik i pandemisë dhe inflacionit në dy vitet e fundit ka çuar në një rritje të shkallës së varfërisë në Kosovë, duke komplikuar sfidat me të cilat ballafaqohet popullsia.^{33,34}

Në kontekstin social, Kosova ia del relativisht mirë sa i përket sigurimit të nevojave themelore të jetesës. Sipas statistikave të ofruara nga organizatat ndërkombëtare, Kosova ka një shkallë të papunësisë prej 29.9 për qind dhe shkalla e varfërisë është 21 për qind.³⁵ Emigrimi i fuqisë punëtore nga Kosova paraqet një sfidë të madhe për vendin, duke ndikuar në zhvillimin e tij ekonomik, duke përfshirë sektorë si ndërtimi dhe burime të tjera ekonomike. Largimi i punëtorëve të kualifikuar mund të rezultojë në një ikje të trurit dhe të pengojë përparimin e vendit. Përveç kësaj, mungesa e një sistemi gjithëpërfshirës të sigurimit shëndetësor edhe 15 vjet pas fitimit të pavarësisë është një çështje e dukshme.³⁶

Qeveria e Kosovës ndan mbi 500 milionë euro në vit për të mbështetur 15 skema sociale nga të cilat përfitojnë më shumë se 400,000 qytetarë, duke reflektuar përkushtimin e saj për të përmirësuar mirëqenien e një pjese të konsiderueshme të popullsisë.³⁷ Përderisa sektori i minierave në Kosovë njihet si me potencial të konsiderueshëm ekonomik, ai përballlet me sfida të vazhdueshme për shkak të investimeve të kufizuara, duke penguar zhvillimin e tij.³⁸ Anasjelltas, sektori i ndërtimit ka një rëndësi thelbësore për ekonominë e Kosovës, ndonëse i shoqëruar me çështje të ndryshme, duke përfshirë punësimin joformal, barrën tatimore dhe kompensimin e patatuar, ndër të tjera.³⁹ Kosova shfaq stabilitet kur bëhet fjalë për aspektet si ushqimi, banimi dhe qasja në ujë të pijshëm. Megjithatë, një shqetësim i madh lind nga mungesa e sigurisë ushqimore, e cila konsiderohet si një kërcënim për shëndetin publik në vend. Përveç kësaj, qasja në ujë të pijshëm në Kosovë parashikohet të bëhet kërcënim në të ardhmen e afërt për shkak të mungesës së parashikuar si rezultat i keqpërdorimit.⁴⁰

2.2 Korrupsioni dhe Anti-korrupsioni

ÇËSHTJET KRYESORE TË KORRUPSIONIT

Korrupsioni në Kosovë mbetet çështje e vazhdueshme dhe sfiduese. Në vitin 2022, sipas Indeksit të Perceptimit të Korrupsionit të Transparency International, Kosova mori rezultat prej 41 pikësh nga 100 pikë, duke e vendosur atë në vendin e 84-të nga 180 vende globalisht.⁴¹ Ky rezultat tregon për një trend të qëndrueshëm dhe pozitiv të progresit në Indeksin e Perceptimit të Korrupsionit në Kosovë krahasuar me vitet e kaluara. Duke filluar nga viti 2016 kur Kosova u rendit në vendin e 36, vendi pa luhatje në vitet në vijim, duke përfshirë vendin e 39-të në 2017-ën, vendin e 37-të në 2018-ën dhe më pas duke ruajtur vendin e 36-të si në 2019 ashtu edhe në 2020. Në vitin 2021, renditja zbriti në vendin e 39-të, edhe pse shënimi tregon një përmirësim me 41 pikë.

Krahasuar me vendet e Ballkanit Perëndimor, Kosova mban pozitën e dytë në Indeksin e Perceptimit të Korrupsionit, me një rezultat prej 41, duke u pasuar pas Malit të Zi (45). Kosova kalon Maqedoninë e Veriut (40), Shqipërinë dhe Serbinë (36), si dhe Bosnjën dhe Hercegovinën (34). Megjithatë, Kosova ende mbetet prapa mesatares globale prej 50 pikësh dhe dukshëm pas mesatares së Bashkimit Evropian (BE) prej 66 pikësh.⁴² Progresi në Indeksin e Perceptimit të Korrupsionit në Kosovë i atribuohet përmirësimeve në kornizën ligjore që rregullon financimin e partive politike, së bashku me paketën e ligjeve që synojnë reformimin e sistemit të drejtësisë. Përveç kësaj, mungesa e skandaleve të mëdha korruptive në Kosovë mund t'i atribuohet nivelit relativisht të ulët të shpenzimeve kapitale dhe investimeve, gjë që ka reduktuar mundësitë për shfaqjen e rasteve të korrupsionit në shkallë të gjerë.

Sipas raportit të Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) "Pulsi Publik", mesatarisht 23.4 për qind e të anketuarve janë shprehur se ata perceptojnë se ekziston korrupsion i konsiderueshëm brenda institucioneve publike në Kosovë. Kjo shifër pasqyron një rënie prej 1.6 pikë përqindjeje nga maji 2021 (25 për qind) dhe një rënie më të konsiderueshme prej 4.6 pikë përqindjeje nga dhjetori 2020 (28 për qind).⁴³

Sipas Barometrit Global të Korrupsionit të publikuar nga Transparency International, në Kosovë, përqindja e individëve që kanë raportuar se kanë paguar ryshfet për të pasur qasje në shërbime të ndryshme qeveritare në 12 muajt e mëparshëm është gjithsej 10 për qind.⁴⁴



Në Kosovë, rastet më të mëdha të korrupsionit janë ato që zakonisht quhen raste të profilit të lartë. Këto raste shpesh përfshijnë akuza kundër ish-zyrtarëve të qeverisë, si dhe individëve nga profile të tjera si gjyqtarë⁴⁵ dhe zyrtarë të ndryshëm institucionalë. Krimet që ndiqen më shpesh në Kosovë përfshijnë vepra të tilla si keqpërdorimi i detyrës zyrtare, ryshfeti, mosdeklarimi i pasurisë, pastrimi i parave dhe rastet që kanë të bëjnë me krimin e organizuar, duke përfshirë ato që përfshijnë narkotikë dhe armë.⁴⁶

Problemet me korrupsionin janë më së shumti të përqendruara në fushën e prokurimit publik, veçanërisht në lidhje me keqmenaxhimin në procedurat tenderuese, ku përfshihen si zyrtarët qeveritarë ashtu edhe autoritetet lokale. Përkundër inicimit të rasteve si "Brezovica" ku një kryetar komune dhe shumë zyrtarë publikë, së bashku me disa biznesmenë, janë akuzuar për keqpërdorim detyre dhe marrje ryshfeti për ndërtimin e jashtëligjshëm të vilave në zonën e Brezovicës;⁴⁷ si dhe rasti "Subvencionet",⁴⁸ ku disa zyrtarë të Ministrisë së Bujqësisë dhe të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë së bashku me disa persona të tjerë privatë janë akuzuar për keqpërdorim të pozitës zyrtare (marrje dhe dhënie ryshfeti) nga institucionet gjyqësore; mosefikasiteti brenda gjyqësorit vazhdon. Kjo karakterizohet nga një qasje e butë ndaj dënimeve dhe procedurave të tejzgjatura në rastet e mëdha të korrupsionit, përfshirë rastin "Hidrocentralet", ku disa ministra të ish-Qeverisë Thaqi 2 u akuzuan për keqpërdorim të pozitës zyrtare në lidhje me privatizimin e katër hidrocentraleve në Kosovë.⁴⁹ Në një rast tjetër, "Toka 1", ish-deputeti i Kuvendit të Kosovës dhe disa persona të tjerë janë akuzuar për krim të organizuar dhe korrupsion lidhur me privatizimin e disa tokave shtetërore përmes falsifikimit të dokumenteve zyrtare, mashtrimit e akteve të tjera korruptive. Rasti në fjalë edhe pas gjashtë vitesh nga ngritja e aktakuzës ende nuk ka një vendim përfundimtar.⁵⁰ Me zvarritje vazhdon të administrohet edhe rasti "Veteranët", ku ish-komandantë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) dhe disa persona të tjerë janë akuzuar për keqpërdorim të detyrës zyrtare në lidhje me manipulimin e listave të veteranëve të luftës në Kosovë.⁵¹ Me këtë rast, vlen të theksohet se aktakuza është ngritur në vitin 2018 dhe ende nuk ka marrë vendim përfundimtar. Të akuzuarit janë shpallur të pafajshëm nga Gjykata Themelore e Prishtinës, por gjykata në shkallë të dytë e ka kthyer lëndën në rigjykim. Një tjetër rast që u pasua me vonesa të shumta ishte "Stenta 1", ku ish-ministri i Shëndetësisë dhe disa mjekë akuzoheshin për keqpërdorim të detyrës zyrtare. Pas ngritjes së aktakuzës kundër tyre në vitin 2016, ky proces mori vendim përfundimtar gjashtë vite më vonë, ku të gjithë të akuzuarit u shpallën të pafajshëm.⁵² Një shembull tjetër është rasti "53 milionë euro",⁵³ ku një ish-ministër i infrastrukturës në Qeverinë Haradinaj dhe tre zyrtarë të tjerë të

këtij ministri u akuzuan për keqpërdorim të detyrës zyrtare lidhur me ndërtimin e autostradës "Arbën Xhaferi". Vlen të theksohet se në këtë rast ka pasur vonesë sa i përket caktimit të seancës fillestare për shkak se ajo është mbajtur një vit pas ngritjes së aktakuzës.

Rreziqet e korrupsionit që lidhen me investimet kapitale në kontratat publike minojnë efektivitetin e këtyre investimeve dhe i bëjnë ato të cenueshme ndaj keqmenaxhimit. Për më tepër, mbikëqyrja joadekuate gjatë zbatimit të këtyre investimeve paraqet potencial për pasoja afatgjata dhe negative.⁵⁴

Sfida kryesore e Kosovës në lidhje me korrupsionin qëndron më pak në mungesën e kornizës ligjore dhe më shumë në zbatimin efektiv të ligjeve dhe rregulloreve ekzistuese. Kodi Penal, Kodi i Procedurës Penale dhe legjislativi në lidhje me pastrimin e parave, deklarimin e pasurisë dhe masat e tjera kundër korrupsionit përmbajnë dispozita të forta për penalizimin e aktiviteteve korruptive.⁵⁵ Me propozim të qeverisë, Kuvendi ka miratuar një ligj për konfiskimin civil të pasurisë, që synon të trajtojë konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të pajustificueshme.⁵⁶ Efektiviteti aktual i një mekanizmi të tillë do të duhet të demonstronohet përmes zbatimit të tij praktik.

Përveç kësaj, Kosova ka iniciuar një reformë kushtetuese për procesin e vetingut, e cila përfshin procesin e Kuvendit të Kosovës me amendamentet kushtetuese të dizajnuara për të verifikuar krerët e sistemit gjyqësor dhe prokurorial në vend. Megjithatë, këto ndryshime kanë mangësi që shtojnë mundësinë e anulimit dhe rrëzimit nga Gjykata Kushtetuese.⁵⁷ Këto mangësi kryesisht sillen rreth mungesës së një përkufizimi të saktë të pavarësisë së autoritetit përgjegjës për kryerjen e vlerësimeve të integritetit. Për më tepër, ndryshimet nuk trajtojnë përfshirjen e përfaqësimit gjinor dhe komunitet në përbërjen e këtij organi. Gjithashtu, mungojnë sqarimet në lidhje me kufizimet e të drejtave kushtetuese për anëtarët e Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK) gjatë procesit të vlerësimit.

Për më tepër, së fundi është miratuar legjislativi i ri në lidhje me Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, që i ka hequr Agjencisë kompetencat e saj në lidhje me hetimet penale në luftën kundër korrupsionit dhe duke e kufizuar atë në hetime administrative. Ndryshimet fokusohen kryesisht në rritjen e aftësive të saj parandaluese.⁵⁸

Korrupsioni brenda vendit ka shkaktuar paqëndrueshmëri në fusha të ndryshme, duke ndikuar veçanërisht në sundimin e ligjit dhe progresin ekonomik, të cilat të dyja janë thelbësore





për përpjekjet e integritetit ndërkombëtar. Raporte të shumta ndërkombëtare kanë nënvizuar se si përhapja e korrupsionit në Kosovë ka penguar iniciativa të ndryshme zhvillimore. Pasojat e këtij jostabiliteti përfshijnë pengesat në rrugën e Kosovës drejt liberalizimit të vizave dhe anëtarësimit të saj në organizatat ndërkombëtare. Për më tepër, korrupsioni përbën pengesë të konsiderueshme për rritjen ekonomike të vendit, për tërheqjen e investimeve të huaja dhe për realizimin e synimeve strategjike të investimeve.⁵⁹

KORNIZA LIGJORE KUNDËR KORRUPSIONIT

Korniza ligjore në Kosovë në lidhje me luftën kundër korrupsionit, krimin të organizuar dhe pastrimit të parave është e konsoliduar mirë. Kodi Penal⁶⁰ ka dispozita të mjaftueshme që sigurojnë dënimin adekuat të kryerësve të veprave penale të korrupsionit dhe krimin të organizuar, qofshin ata persona zyrtarë apo privatë. Korniza kundër krimin të organizuar dhe pastrimit të parave përfshin gjithashtu Ligjin për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe luftën kundër financimit të terrorizmit,⁶¹ i cili përfshin dispozita të mjaftueshme për të luftuar veprime të tilla. Po ashtu, këto raste ndiqen ekskluzivisht nga Prokurori Special i Republikës së Kosovës (PSRK), i cili ka mandat të hetojë dhe ndjek penalisht personat që kryejnë këto vepra penale.⁶² Ndonëse korniza ligjore për konfiskimin penal është avancuar, mbetet shumë për të bërë për të zbatuar legjislacionin kundër korrupsionit. Pavarësisht përmirësimit të performancës së Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, mjetet parandaluese anti-korrupsion të përcaktuara në legjislacion ende nuk janë shfrytëzuar plotësisht. Kosova vazhdon të ketë probleme me hetime më proaktive, vendime gjyqësore të formës së prerë dhe konfiskim përfundimtar të pasurive.⁶³

Disa iniciativa ligjore kritike lidhen dhe ndikojnë në Sistemin e Integritetit Kombëtar (SIK). Këto përfshijnë amendamentin e Kushtetutës së Kosovës për të futur një proces verifikimi në sistemin e drejtësisë, i cili zakonisht quhet procesi kalimtar për vlerësimin e integritetit të krerëve të sistemit gjyqësor dhe prokurorial. Gjithashtu, janë ndërmarrë nisma legjislative për të adresuar financimin e partive politike,⁶⁴ ngritjen e një byroje për konfiskimin e pasurive të pajustificueshme në mosmarrëveshjet civile,⁶⁵ përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve,⁶⁶ themelimit të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit,⁶⁷ ligjet për deklarimin e pasurisë dhe ligjet që rregullojnë Këshillin Prokurorial dhe Prokurorin e Shtetit.⁶⁸ Për më tepër, disa ndryshime janë bërë në Kodin Penal të Kosovës dhe Kodin e Procedurës Penale.⁶⁹ Këto nisma ligjore luajnë një rol të rëndësishëm në përpjekjet

e qeverisë së Kosovës, kryesisht të udhëhequra nga Ministria e Drejtësisë, për të rritur integritetin e institucioneve në Republikën e Kosovës.

Vlen të theksohet se disa nga këto iniciativa ligjore janë përballur me sfida ligjore dhe janë sjellë në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës. Për shembull, një ligj vendimtar, ai lidhur me Këshillin Prokurorial të Kosovës, është shpallur i pavlefshëm nga Gjykata Kushtetuese. Në një njoftim publik, Gjykata Kushtetuese konstatoi se dispozitat e këtij ligji ishin antikushtetuese, sepse nuk respektonin parimin kushtetues të ndarjes dhe balancimit të pushteteve dhe nuk e mbronin mjaftueshëm pavarësinë kushtetuese të KPK-së dhe anëtarëve të saj.⁷⁰

Për më tepër, Gjykata Kushtetuese ka marrë vendim për amendamentet lidhur me procesin e vetingut, duke pohuar se ndryshimet kushtetuese të propozuara nga Kuvendi i Kosovës nuk cenojnë apo kufizojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të përcaktuara me kapitullin 2 të Kushtetutës. Rrjedhimisht, ky vendim i ka hapur rrugë fillimit të procesit të vetingut pas miratimit të këtyre amendamenteve nga Kuvendi i Kosovës.⁷¹

Në të vërtetë, pavarësisht nga masat e shumta të marra nga qeveria për të futur ligje të reja ose për të ndryshuar legjislacionin ekzistues, këto nisma janë ndeshur vazhdimisht me kundërshtime nga partitë opozitare. Pushteti ekzekutiv e percepton këtë opozitë si një përpjekje për të penguar dhe vonuar reformën në drejtësi duke i sfiduar këto ligje në Gjykatën Kushtetuese. Ky kontestim i vazhdueshëm pasqyron ndarjet politike dhe ideologjike që rrethojnë këto reforma kritike ligjore dhe gjyqësore në Kosovë.⁷²

PUNA KUNDËR KORRUPSIONIT

Në vitet e fundit, përpjekjet e qeverisë për të luftuar korrupsionin kanë treguar përmirësim.⁷³ Pavarësisht këtyre përmirësimeve, statistikave vazhdojnë të zbulojnë një prevalencë të konsiderueshme të korrupsionit brenda vendit. Sipas anketave të kryera nga organizatat vendore mes qytetarëve, afërsisht 80 për qind e të anketuarve besojnë se korrupsioni mbetet kërcënim i lartë për vendin. Për më tepër, vetëm rreth 36 për qind e të anketuarve mendojnë se qeveria ka bërë përparim të pamjaftueshëm në luftën kundër korrupsionit.⁷⁴ Mungesa e stabilitetit politik dhe joefikasiteti i sistemit të drejtësisë⁷⁵ kanë luajtur të dyja role kryesore në ndikimin e përpjekjeve të qeverisë kundër korrupsionit. Anasjelltas, raportet e organizatave ndërkombëtare shpesh sugjerojnë se korrup-



sioni vazhdon brenda qeverisë, me veprime të pamjaftueshme të ndërmarra për të adresuar këtë çështje.⁷⁶

Iniciativat ligjore që synojnë luftimin e korrupsionit konsiderohen të rëndësishme; megjithatë, ekziston nevoja urgjente për të përmirësuar zbatimin e përgjithshëm të këtyre ligjeve.⁷⁷ Ndryshimet ligjore, përfshirë ligjet për financimin e subjekteve politike, Byronë për Konfiskimin e Pasurive të Pajustificuara, Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit dhe ligje të tjera, pritet të ndikojnë pozitivisht në performancën në luftimin e korrupsionit.

Në vitin 2020, Strategjia Kundër Korrupsionit 2021–2023 u miratua pasi u hartua nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit.⁷⁸ Gjatë formulimit të Strategjisë Kundër Korrupsionit 2021–2023 dhe Planit përkatës të Veprimit, iu referua një gamë e gjerë raportesh vendore dhe ndërkombëtare që vlerësonin korrupsionin dhe perceptimin publik të korrupsionit në Kosovë.⁷⁹ Në këtë kontekst, janë përcaktuar sektorët parësorë dhe pritet një përgjegjshmëri më e madhe dhe transparencë e plotë në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi brenda institucioneve përkatëse. Për më tepër, strategjia ka përcaktuar masat dhe aktivitetet që synojnë parandalimin dhe luftimin efektiv të korrupsionit bazuar në çështjet dhe sfidat e identifikuar.

Rrjedhimisht, Strategjia është segmentuar në sektorët e mëposhtëm: Sektori Politik, Administrata Shtetërore dhe Pushteti Lokal, Zbatimi i Ligjit dhe Gjyqësori, Prokurimi Publik dhe Menaxhimi i Financave Publike. Gjatë formulimit të kësaj strategjie, kanë marrë pjesë aktivisht akterë të shumtë institucionalë nga departamentet qeveritare, si dhe një përfaqësues nga shoqëria civile.^{80,81}

Qeveria e Kosovës ka miratuar edhe Strategjinë e Sundimit të Ligjit për periudhën 2021–2026.⁸² Fillimisht, Qeveria e Kosovës, në bashkëpunim me Këshillin Gjyqësor dhe Prokurorial, si dhe me institucione të ndryshme të sektorit të drejtësisë, shoqërinë civile dhe donatorët ndërkombëtarë, iniciuan Procesin e Rishikimit Funkcional për Sektorin e Sundimit të Ligjit. Ky proces iu nënshtrua disa fazave dhe, pas konsultimeve të gjera, në mënyrë specifike evidentoi mangësitë brenda sektorit, kryesisht në sektorin e drejtësisë. Këto mangësi dhe rekomandimet për adresimin e tyre janë të dokumentuara në 16 dokumente politikash dhe të organizuara në katër shtylla: (1) sistemi gjyqësor dhe prokurorial; (2) drejtësia penale; (3) qasja në drejtësi dhe shërbimet gjyqësore; dhe (4) kundër korrupsionit.⁸³

Plani i Veprimit, një komponent integral i Strategjisë, përkrahur në mënyrë gjithëpërfshirëse të gjitha aktivitetet që qeveria, Ministria e Drejtësisë, KGJK-ja, KPK-ja, Akademia e Drejtësisë, Policia e Kosovës dhe institucionet e tjera publike

pritet të ndërmarrin në kuadër të fushëveprimit të masave politike. Këto aktivitete janë krijuar për të trajtuar çështjet e identifikuar dhe për të përmbushur objektivat e synuara.⁸⁴ Ka një mangësi të dukshme në bashkëpunimin ndërmjet bizneseve dhe shoqërisë civile kur bëhet fjalë për avancimin e parimeve si integriteti, transparencja, llogaridhënia dhe qeverisja e mirë. Forma e vetme e ndërveprimit midis bizneseve dhe organizatave duket se janë dhomat e tregtisë⁸⁵ dhe aleancat e biznesit që synojnë të inkurajojnë dhe mbështesin praktikatat e qeverisjes së mirë brenda komunitetit të biznesit.

Në Kosovë ka iniciativa dhe projekte të shumta të financuara nga donatorë të ndryshëm të dedikuara për luftimin efektiv të korrupsionit. Këto iniciativa përfshijnë pjesëmarrje aktive nga ambasadat e vendeve si Shtetet e Bashkuara, Britania e Madhe, Norvegjia, Zyra e Bashkimit Evropian dhe Zyra e Këshillit të Evropës, si dhe organizata të tilla si UNDP, Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ). Këto entitete angazhohen vazhdimisht në mbështetjen e institucioneve kosovare në përpjekjet e tyre kundër korrupsionit.

UNDP-ja, për shembull, është përfshirë në mënyrë aktive në luftën kundër korrupsionit përmes projektit të saj Mbështetja e Përpjekjeve Kundër Korrupsionit në Kosovë (SAEK) III, që shtrihet nga viti 2020 deri në vitin 2024. Ky projekt synon të lehtësojë zbatimin e legjislacionit të ri kundër korrupsionit dhe të avancojë progresin drejt riatdhesimit të pasurive të vjedhura, duke kontribuar përfundimisht në krijimin e një sistemi të fuqishëm kundër korrupsionit.⁸⁶

USAID⁸⁷ mban një përkushtim të vazhdueshëm për Kosovën përmes një sërë projektesh që përfshijnë fusha të ndryshme kritike. Këto projekte përfshijnë drejtësinë, qeverisjen e mirë, zhvillimin ekonomik, rritjen e punësimit (veçanërisht te gratë), prodhimin efikas të energjisë, bujqësinë dhe zhvillimin e bizneseve të vogla dhe të mesme.⁸⁸

Nga maji 2016 deri në maj 2019, Programi i Përbashkët i Instrumentit Horizontal u ekzekutua me bashkëfinancim të siguar nga Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Evropës dhe i realizuar nën kujdesin e Këshillit të Evropës.⁸⁹ Ky program u krijua si një përpjekje bashkëpunuese me objektivin për të ndihmuar Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë, përfituesit, në përafrimin me standardet e Këshillit të Evropës dhe, kur është e nevojshme, zbatimin e *acquis* të BE-së në kuadër të procesit të zgjerimit. Gjatë fazës së fillimit të Instrumentit Horizontal, janë realizuar gjithsej 36 projekte. Ky program tre-vjeçar, i shtrirë nga maji 2016 deri në maj 2019, kishte një fokus të veçantë në tri tema kryesore: sigurimi i drejtësisë, lufta kundër korrupsionit, krimin ekonomik dhe krimin të organizuar, ndër të tjera.⁹⁰





- 70 Për më shumë shihni njoftimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të publikuar më 24 mars 2023. Gjetet në: <https://gjk-ks.org/njoftim-per-vendim-ne-rastin-ki-100-22-dhe-ki-101-22/> [qasur më 4 prill 2023]
Edhe pse Gjykata Kushtetuese e shpalli jokushtetues ligjin për Këshillin Prokurorial të Kosovës, Ministria e Drejtësisë këmbënguli në nxjerrjen e një ligji të ri që sugjeronte rritjen e numrit të anëtarëve të KPK-së nga 13 në 19. Pas prezantimit të këtij ligji të ri, Kryetari i Kuvendit ia dorëzoi për vlerësim Komisionit të Venecias. Komisioni, megjithatë, shprehu mungesën e mbështetjes për propozimin për rritjen e numrit të anëtarëve në 19 dhe rekomandoi mbajtjen e KPK-së me një përbërje të reduktuar prej shtatë anëtarësh.
- 71 Telegrafi.com, "PDK dërgon në Gjykatën Kushtetuese Projektligjin për Byronë Shtetërore." (Shkurt, 2023). Gjetet në: <https://telegrafi.com/pdk-e-dergon-ne-kushtetuese-projektligjin-per-byrone-shteterore/> [qasur më 4 prill 2023]
- 72 Dukagjini, "Kurti: Opozita nuk po i dërgon ligjet Gjykatës Kushtetuese për të ruajtur kushtetutshmerinë" (Mars, 2023). Gjetet në: <https://www.dukagjini.com/kurti-opozita-nuk-po-i-dergon-ligjet-ne-gjykatën-kushtetuese-per-te-ruajtur-kushtetutshmerine/> [qasur më 4 prill 2023]
- 73 Koha.Net, "Kosova shënon përparim të lehtë në luftën kundër korrupsionit" (janar, 2022). Gjetet në: <https://www.koha.net/arberi/307549/kosova-she-non-perparim-te-lehte-ne-luften-kunder-korrupsionit/> [qasur më 19 prill 2023]
- 74 Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, "Perceptimet e qytetarëve për besimin, korrupsionin dhe integritetin e institucioneve publike në Kosovë" (QKSS: Prishtinë, 2022). fq. 13. Gjetet në: https://qkss.org/images/uploads/files/WBSB_2022_Kosovo_Report_1_Dec_2022_ALB.pdf
- 75 Instituti i Kosovës për Drejtësi, "Dështimi i sektorit të drejtësisë në luftën kundër korrupsionit" (Prill, 2023). Gjetet në: <https://kli-ks.org/deshtimi-i-drejtësisë-ne-luftimin-e-korrupsionit/> [qasur më 25 maj 2023]
- 76 UNDP, "Public Pulse Brief XXI" (nëntor, 2021). fq. 23. Gjetet në: <https://www.undp.org/kosovo/publications/public-pulse-brief-xxi> [qasur më 6 shkurt 2023]
- 77 Komisioni Evropian, "Raporti i Kosovës* – 2022", (tetor 2022). fq. 5. Gjetet në: <https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2022-10/Kosovo%20Report%202022.pdf>
- 78 Për më shumë, shihni «Strategjia Kundër Korrupsionit 2021-2023» (nëntor, 2020). Gjetet në: <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/05/Strategjia-Kunder-Korrupsionit-2021-2023.pdf> [qasur më 4 prill 2023]
- 79 Për më shumë, shihni «Strategjia Kundër Korrupsionit 2021-2023» (nëntor, 2020). fq. 4. Gjetet në: <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/05/Strategjia-Kunder-Korrupsionit-2021-2023.pdf> [qasur më 4 prill 2023]
- 80 Lista e institucioneve që marrin pjesë në Grupin e Punës përgjegjëse për hartimin e Strategjisë përfshin: Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punëve të Brendshme, Kuvendi i Kosovës, Ministria e Pushtetit Lokal Policia e Kosovës, Zyra e Kryeministrit, Zyra Kombëtare e Auditimit, Dogana e Kosovës, Inspektorati Policor i Kosovës, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, Organi Shqyrtues i Prokurimit, Ministria e Financave, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Agjencia Kosovare e Privatizimit, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Prokuroria e Këshillit të Kosovës, Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike, Administrata Tatimore e Kosovës, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Shëndetësisë dhe OJQ FOL.
- 81 Në maj të këtij viti, qeveria krijoi një grup pune të ngarkuar me hartimin e Strategjisë Kombëtare kundër Korrupsionit 2023-2026 dhe planin e saj përkatës të veprimit. Pavarësisht angazhimit për të përfunduar këtë detyrë deri në dhjetor të po këtij viti, siç ishte premtuar, procesi mbetet i papërfunduar deri më sot.
- 82 Qeveria e Kosovës, 'Strategjia e Sundimit të Ligjit 2021-2026', (korrik 2021). Gjetet në: <https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/6DC1CBD5-0DF1-46AE-9D1A-78C96146C7D0.pdf> [qasur më 4 prill 2023]
- 83 Qeveria e Kosovës, 'Strategjia e Sundimit të Ligjit 2021-2026', (korrik 2021). Gjetet në: <https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/6DC1CBD5-0DF1-46AE-9D1A-78C96146C7D0.pdf> [qasur më 4 prill 2023]
- 84 Në kuadër të Planit të Veprimit (Korrik 2021), ka një mori ligjesh dhe aktesh ligjore të cilat janë konsideruar të ndryshohen brenda afateve të përcaktuara.
- 85 Për më shumë, shihni faqen e internetit të Odës Ekonomike të Kosovës. Gjetet në: <https://www.oek-kcc.org/Al/rreth-nesh> [qasur më 8 shkurt 2023]
- 86 Për më shumë hollësi, shihni faqen e internetit të UNDP-së në Kosovë. Gjetet në: <https://www.undp.org/kosovo/projects/support-anti-corruption-ef-forts-kosovo-saek-iii> [qasur më 8 shkurt 2023]
- 87 Për më shumë hollësi, shihni faqen e internetit të USAID-it në Kosovë. Gjetet në: https://pdf.usaid.gov/pdf_docs/pdabz154.pdf [qasur më 8 shkurt 2023]
- 88 Për më shumë shikoni faqen e Ministrisë së Integritetit Evropiane. Gjetet në: <https://www.mei-ks.net/sq/kosova/projektet-e-usaid-kontribuojn-ed-he-n-procesin-e-integritetit-evropian> [qasur më 8 shkurt 2023]
- 89 Këshilli i Evropës, «Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë (2016–2019)». Gjetet në: <https://rm.coe.int/hfi-booklet-alb/16809cff67> [qasur më 10 shkurt 2023]
- 90 Këshilli i Evropës, «Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë (2016–2019)». Gjetet në: <https://rm.coe.int/hfi-booklet-alb/16809cff67> [qasur më 10 shkurt 2023]



VLERËSIMI I SIK-ut SHTYLLAT



1


LEGJISLATIVI

> |> > >< <><> ><> > ><>


PËRMBLEDHJE

Kuvendi i Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë që ushtron funksione legjislativë. Kuvendi ka 120 deputetë të zgjedhur për një mandat katërvjeçar, me votim të fshehtë.¹


60/100 Rezultati i përgjithshëm i shtyllës




Kapacitetet



Qeverisja



Roli





Përbërja aktuale politike e Kuvendit pasqyron rezultatin e zgjedhjeve parlamentare të vitit 2021. Lëvizja Vetëvendosje ka 56 deputetë, e ndjekur nga Partia Demokratike e Kosovës me 18 deputetë, Lidhja Demokratike e Kosovës me 16 deputetë, Lista Serbe me nëntë deputetë, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës me tetë deputetë dhe Partia Demokratike Turke e Kosovës me dy deputetë. Po ashtu, Partia Unike Gorane, Koalicioni Vakrat, Partia e Ashkalive për Integrim, Nisma Qytetare për Liri, Drejtësi dhe Mbijetesë, Bashkimi Social Demokrat, Lëvizja Progresive e Romëve të Kosovës, Nisma Rome, Partia Demokratike Nisma e Re e Kosovës dhe Partia e Re Demokratike kanë nga një deputet secila. Më tej, janë dy deputetë të pavarur që janë ndarë nga grupi parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje.

Në fillim të mandatit të legjislativës dhe në marrëveshje me grupet parlamentare, Kryesia propozon numrin dhe strukturën e komisioneve parlamentare.² Kryesia e Kuvendit kërkon nga secili grup parlamentar, i përfaqësuar në Kuvend, t'i propozojë kryetarët, zëvendëskryetarët dhe anëtarët e komisioneve.³

Pavarësisht progresit të tij në disa fusha, Kuvendi i Kosovës është përballur me kriza të njëpasnjëshme politike që kanë degraduar reputacionin e tij dhe kanë dëmtuar besimin e publikut në këtë institucion vitet e fundit. Këto sfida kanë ndikuar në funksionimin normal të Kuvendit dhe e kanë penguar atë në përmbushjen e mandatit kushtetues. Nga jashtë, polarizimi ekstrem i skenës politike është reflektuar në një diskurs më të ashpër mes deputetëve dhe përdorimin e gjuhës joparlamentare. Nga brenda, situatën e ka përkeqësuar menaxhimi i dobët i punës së Kuvendit, përdorimi i praktikave joparlamentare dhe mos respektimi i Rregullores së Punës.

Sfida më e madhe për Kuvendin është mungesa e mbikëqyrjes së ekzekutivit dhe agjencive të pavarura të themeluara nga Kuvendi. Kuvendi është gjithashtu i varur nga qeveria për agjendën legjislative, pasi qeveria sponsorizon shumicën dërrmuese të projektligjeve.

Nga perspektiva e transparencës, Kuvendi ka shënuar progres të dukshëm duke u bërë kështu një nga institucionet më transparente në Kosovë. Megjithatë, përjashtim bën publikimi i votave të deputetëve në seancat plenare. Pajisjet e vjetruara dhe dështimi i tenderit për pajisjet e reja kanë bërë që Kuvendi të mos përdorë votim elektronik prej më shumë se dy vitesh, duke e bërë të pamundur qasjen në të dhënat e votimit.

Kuvendi vazhdon të ketë mungesë të theksuar të infrastrukturës, sidomos hapësirave të përshtatshme dhe zyra për të gjithë deputetët dhe mungesë të burimeve njerëzore për të kryer punën e tij. Tavani buxhetor i Kuvendit përcaktohet nga Qeveria, gjegjësisht Ministria e Financave.

Praktikisht, Kuvendi nuk ka mekanizma të brendshëm të integritetit dhe vuan nga mungesa e theksuar e llogaridhënies kundrejt votuesve. Kuvendi mbështetet në mekanizma të jashtëm, si gjykatat dhe Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, për të mbajtur nën kontroll deputetët në lidhje me deklaratimet e pasurisë.



Kapacitetet



INDIKATORI 1.1.1 BURIMET (SIPAS LIGJIT)

75/100



Ekzistojnë dispozita për të siguruar që legjislativi të ketë pavarësi organizative, administrative dhe buxhetore⁴ për të kryer detyrat e tij në mënyrë efektive. Megjithatë, Ministria e Financave është autoriteti që përcakton kufizimet buxhetore të Kuvendit.

Kuvendi është i varur nga ekzekutivi (Ministria e Financave) sa i përket ndarjes së burimeve dhe përballet me kufizime në numrin e të punësuarve.

Buxhetin e Kuvendit e përgatit Komisioni për Buxhet në bashkëpunim me Sekretarin e përgjithshëm dhe e miraton Kryesia e Kuvendit. Kërkesat buxhetore të Kuvendit duhet të përputhen me kufirin e përcaktuar të shpenzimeve të përcaktuar nga qarkorja buxhetore e nxjerrë nga Ministria e Financave.⁵ Më pas Ministria e Financave përgatit dhe ia dorëzon Qeverisë projektbuxhetin e konsoliduar të Kosovës.⁶

Ligji për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit parasheh gjashtë forma të kompensimit të deputetit gjatë dhe pas përfundimit të mandatit. Deputetët kanë të drejtë në kompensim përmes pagës bazë prej 1,547 euro, e cila është e mjaftueshme dhe një nga pagat më të larta në sektorin publik, si dhe kompensim për pjesëmarrje në seanca dhe mbledhje të komisioneve, kryerjen e funksioneve parlamentare dhe shpenzimet mujore.⁷ Përveç kësaj, legjislacioni siguron burimet e nevojshme për deputetët për të kryer punën e tyre. Në bazë të këtij ligji, deputetëve, komisioneve



dhe grupeve parlamentare u sigurohen zyrat në Kuvend, ndërsa dy të parave u sigurohet edhe stafi ndihmës.⁸ Numri i stafit politik që mbështet punën e Kuvendit, si dhe pagat e tyre, përcaktohen me rregullore të veçantë të cilën e miraton Kryesia e Kuvendit pas propozimit të komisionit për buxhet.⁹

Ligji për financimin e subjekteve politike po ashtu parasheh financim nga buxheti vjetor për të gjitha subjektet politike parlamentare, i cili nuk mund të kalojë 0.34% të Buxhetit të Kosovës.¹⁰ Nga ky fond, 10 për qind e mjeteve financiare të dedikuara për çdo subjekt politik duhet të ndahen nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) për të mbështetur punën e çdo deputeti, përkatësisht funksionimin e grupeve parlamentare.¹¹



INDIKATORI 1.1.2 BURIMET (NË PRAKTIKË)

50/100



Legjislativi ka disa mangësi në burime, veçanërisht në aspektin e burimeve njerëzore dhe infrastrukturës, të cilat çojnë në një shkallë të caktuar joefektiviteti në kryerjen e detyrave të tij.

Buxheti i Kuvendit për vitin 2022 ishte rreth 10 milionë euro.¹² Kjo shënon një rritje të lehtë prej 500,000 € krahasuar me buxhetin e Kuvendit në vitin 2016. Ky buxhet në përgjithësi është i mjaftueshëm që deputetët të kryejnë funksionet e tyre legjislative. Megjithatë, duke qenë se mbi 80 për qind e buxhetit i dedikohet pagave,¹³ kjo lë boshllëqe për shpenzimet në burimet njerëzore dhe kërkimore shoqëruese për deputetët, si dhe për infrastrukturën dhe hapësirat e tyre të punës.



Në vitin 2021, Kuvendi shpenzoi 96 për qind të buxhetit të përgjithshëm, krahasuar me një normë shpenzimi prej 93 për qind në vitin 2020 (një rritje prej tre pikë përqindjeje), megjithëse në vitin 2020 Kuvendit iu desh të ndërpriste disa herë aktivitetin për shkak të përhapjes së COVID-19, gjë që uli shpenzimet.¹⁴ Në përgjithësi, shkalla e realizimit të buxhetit është e kënaqshme.

Lista e pagave për vitin 2022, që është miratuar bashkë me buxhetin, i lejon Kuvendit të paguajë maksimalisht 415 punonjës, duke përfshirë këtu deputetët, administratën dhe stafin mbështetës politik. Nga kjo shifër, mund të vlerësohet se Kuvendi ka rritur numrin e të punësuarve me 67 krahasuar me vitin 2016. Lista e pagave e Kuvendit përmban 120 pozita për deputetët, 82 për stafin politik dhe 208 për nëpunësit civilë dhe 5 nëpunës të Komisionit për Ndhimë Shtetërore.¹⁵ Kuvendi i Kosovës konsideron se burimet e tij njerëzore janë adekuate dhe beson se ato krahasohen në mënyrë të favorshme me vendet e Ballkanit Perëndimor.¹⁶ Gjithashtu, deputetëve iu ofrua ndihmë përmes angazhimit të asistentëve të tyre personal, gjë që ka rritur burimet njerëzore me rreth 90 anëtarë shtesë. Administrata e Kuvendit pohon se kjo ndihmë jo vetëm që rrit efikasitetin e deputetëve në kryerjen e detyrave të tyre, por edhe lehtëson deri diku ngarkesën e stafit administrativ.¹⁷ Hapësirat e punës në Kuvend ende nuk janë të mjaftueshme për kushte normale të punës. Deputetët nuk kanë zyrat e tyre ku mund të kryejnë punën e tyre.¹⁸ Presidenca e Kosovës zë rreth 30 për qind të të gjithë hapësirës së Kuvendit.

Një hap pozitiv në ngritjen e kapaciteteve njerëzore të grupeve parlamentare u arrit në vitin 2018, kur Kryesia e Kuvendit vendosi të angazhojë këshilltarë për grupet parlamentare¹⁹ dhe një asistent për të gjithë kryetarët e grupeve parlamentare. Sigurimi i këtyre kapaciteteve shtesë në një farë mase do t'i sigurojë deputetëve ekspertizë shtesë si dhe lehtësi në ushtrimin e funksioneve të tyre.²⁰ Megjithatë, numri i ekspertëve të angazhuar nuk është i mjaftueshëm, duke pasur parasysh numrin e projektligjeve të cilat trajtohen nga deputetët dhe grupet parlamentare.

Kuvendi përballë me sfida të mëdha në rolin e tij legjislativ, kryesisht për shkak të mungesës së kapaciteteve dhe aftësive. Ligjeve të sponsorizuara nga qeveria shpesh u mungon cilësia, e dukshme në numrin e madh të projektligjeve që kërkojnë të ndryshojnë legjislacionin ekzistues në vitin 2021, duke përbërë rreth 47 për qind të 116 projektligjeve në shqyrtim.²¹ Çdo komision duhet të shqyrtojë afërsisht shtatë projektligje çdo vit, zakonisht brenda një afati kohor tre mujor, duke kërkuar rishikime paralele për të përmbushur agjendat

vjetore. Ky presion mbi komisionet rezulton nga burimet e kufizuara njerëzore – me vetëm dy ose tre koordinatore për komision – për kryerjen e një hulumtimi të plotë mbi projektligjet. Njëkohësisht, ngarkesa në rritje e punës nga qeveria kufizon kohën në dispozicion për shqyrtim të thelluar.

Ekipi aktual brenda Drejtorisë për Hulumtime Parlamentare përbëhet nga dhjetë punonjës, me vetëm pesë të përkushtuar për kryerjen e hulumtimeve.²² Ky aranzhim i personelit është veçanërisht i pamjaftueshëm, kur merret parasysh vëllimi i konsiderueshëm i projektligjeve në shqyrtim dhe miratim nga Kuvendi. Nga viti 2014 deri në vitin 2019, Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), në bashkëpunim me Drejtorinë për Hulumtime të Kuvendit, kanë realizuar një projekt të quajtur "Mbështetje për Hulumtime Parlamentare" të financuar nga USAID. Projekti synonte të rriste kapacitetet kërkimore brenda Kuvendit, me fokus në promovimin e punës së Drejtorisë dhe sigurimin e zhvillimit të vazhdueshëm të aftësive kërkimore, dhe duke i ofruar Drejtorisë një bazë të dhënash të ekspertëve që mund të kontraktohen për qëllime kërkimore.²³

Organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare mbështesin punën e Kuvendit të Kosovës. Instituti Kombëtar Demokratik (NDI) është një nga organizatat që ka mbështetur vazhdimisht Kuvendin që nga viti 2001 përmes programeve të shumta,²⁴ duke përfshirë trajnime, punëtori, seminare dhe seanca mentorimi për deputetët e sapozgjedhur, mbështetje për grupet parlamentare dhe sekretariatit në ndërtimin e kapaciteteve të brendshme në analizën ligjore, mbështetje Kuvendit në të dhënat e hapura dhe rritjen e transparencës.²⁵ Organizata të tjera ndërkombëtare si Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), GIZ Kosova dhe Zyra e BE-së në Kosovë kanë ofruar dhe vazhdojnë të ofrojnë ndihmë në ngritjen e kapaciteteve. Në vitin 2023 janë organizuar 22 sesione trajnimi për ligjvënësit dhe stafin teknik të Kuvendit, në përputhje me vitet e mëparshme.²⁶



INDIKATORI 1.1.3 PAVARËSIA (SIPAS LIGJIT)

75/100



Korniza ligjore siguron nivele të larta të pavarësisë së legjislativit nga akterët e jashtëm. Megjithatë, agjenda legjislative varet kryesisht nga agjenda e ekzekutivit. Emërimi i stafit teknik varet edhe nga burimet financiare të siguruar nga buxheti i propozuar nga qeveria.

Pavarësia institucionale e Kuvendit të Kosovës, si i vetmi institucion në nivel kombëtar i zgjedhur drejtpërdrejt nga populli, garantohet me Kushtetutë. Kuvendi mund të shpërndahet nëse qeveria nuk mund të formohet brenda 60 ditëve nga data kur Presidenti i Republikës së Kosovës emëron kandidatin për Kryeministër; nëse dy të tretat e të gjithë deputetëve votojnë 'pro' shpërndarjes; ose nëse Presidenti i Kosovës nuk zgjidhet brenda 60 ditëve nga data e fillimit të procedurës së zgjedhjes.

Kuvendi mund të shpërndahet edhe pas votimit të suksesshëm të mosbesimit ndaj qeverisë.²⁷ Megjithatë, në këtë aspekt, ekziston një vendim i Gjykatës Kushtetuese që garanton pavarësinë e Kuvendit duke specifikuar se roli i Presidentit në shpërndarjen e Kuvendit nuk është diskrecional, por mund të ndodhë vetëm nëse ekziston vullneti i subjekteve politike.²⁸ Kjo siguron që institucionet e tjera nuk mund të shpërndajnë në mënyrë të njëanshme parlamentin.

Kuvendi mund të thërrasë seanca të jashtëzakonshme në çdo kohë, edhe ndërmjet dy sesioneve të rregullta të punës, me iniciativën e tij.²⁹ Seanca e jashtëzakonshme mund të thirret nëse të paktën një e treta e deputetëve e iniciojnë kërkesën.³⁰

Të drejtën për të iniciuar projektligje e kanë qeveria, deputetët, komisionet parlamentare, grupet parlamentare dhe të paktën gjashtë deputetë, presidenti ose 10,000 votues.³¹

Kryetari i Kuvendit në bashkëpunim me Kryesinë përcakton një agjendën e punës së Kuvendit.³² Ndonëse agjenda legjislative mbikëqyret zyrtarisht nga Kuvendi, me komisionet parlamentare që miratojnë planet vjetore të punës,³³ agjenda legjislative e qeverisë ndikon ndjeshëm në agjendën e vetë Kuvendit.³⁴

Deputetët e Kuvendit të Kosovës gëzojnë vetëm imunitet funksional për fjalime dhe vendimmarrje gjatë ushtrimit të detyrës.³⁵ Gjithashtu, deputeti i Kuvendit nuk mund të arrestohet dhe as ndalohet pa pëlqimin e shumicës së të gjithë deputetëve të Kuvendit. Megjithatë, deputetët nuk janë imunë nga ndjekja penale për veprimet e ndërmarrja jashtë fushëveprimit të përgjegjësisë të tyre.³⁶ Kjo u vërtetua me një vendim të Gjykatës Kushtetuese, e cila vendosi që deputetët të mos gëzojnë imunitet nga ndjekja penale për veprat penale që pretendohet se janë kryer para dhe gjatë mandatit të tyre si deputet.³⁷

Shërbyesit civilë të administratës së Kuvendit të Kosovës, së bashku me strukturën organizative, numrin e stafit dhe organizimin e punës, propozohen nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit dhe kërkojnë miratim nga Kryesia e Kuvendit me rregullore,³⁸ sipas ligjit për zyrtarët publikë.³⁹

Sipas Rregullores së Punës, prania dhe ndërhyrja e shërbyesve të sigurisë, të cilat kryhen nga Policia e Kosovës, gjatë seancave plenare lejohet vetëm me urdhër të Kryetarit të Kuvendit.⁴⁰





INDIKATORI 1.1.4 PAVARËSIA (NË PRAKTIKË)

50/100



Vullneti politik i ekzekutivit, herë pas here ndikon në punën dhe aktivitetet e Kuvendit të Kosovës. Ky ndikim manifestohet përmes vendimmarrjes së shumicës politike brenda Kuvendit.

Ndërsa Kuvendi, veçanërisht komisionet parlamentare, miratojnë zyrtarisht agjendën dhe planet e punës, këto shpesh ndikohen shumë nga agjenda legjislative e qeverisë. Qeveria sponsorizon pjesën më të madhe të projektligjeve, me rreth tri të katërtat, ose 114 nga 155 projektligjet në procedurë legjislative.⁴¹

Duke qenë se ekzekutivi mban shumicën parlamentare në Kuvend, rastet kur projektligjet apo vendimet përballen me miratim kundër qëndrimit të ekzekutivit pothuajse nuk ekzistojnë. Partitë në pushtet kanë bllokuar efektivisht votimin e projektligjeve apo vendimeve të propozuara nga opozita duke votuar kundër tyre ose duke penguar kuorumin e nevojshëm për vendimmarrje.⁴²

Ka raste kur përfaqësues të caktuar akuzojnë ekzekutivin dhe akterë të tjerë për ndikim dhe kontroll në punën e Kuvendit. Një shembull i kësaj ndodhi kur deputeti Haki Abazi akuzoi partinë në pushtet (të cilës ai i përkiste deri pak kohë para se të jepte deklaratën) se ka ushtruar ndikim dhe ka drejtuar aktivitetet e Kuvendit dhe veprimet e deputetëve përmes zyrtarëve të tij.⁴³ Megjithatë, ky rast, së bashku me çështje të tjera të ngritura nga partitë opozitare, nuk i është nënshtruar hetimit zyrtar apo zgjidhjes nga institucionet e drejtësisë.

Kuvendi i Kosovës asnjëherë nuk e ka përfunduar mandatin e rregullt katërvjeçar për shkak të votimit të mocioneve të

mosbesimit ndaj qeverisë apo shpërndarjes me shumicë prej dy të tretave të votave. Shpërbërja e fundit ndodhi në vitin 2019.⁴⁴ Në vitin 2020, Gjykata Kushtetuese në mënyrë efektive shpërndau Kuvendin dhe shpalli zgjedhje të parakohshme pasi konstatoi se zgjedhja e qeverisë "Hoti" nuk ishte në përputhje me Kushtetutën.⁴⁵

Ka pasur raste të arrestimeve dhe burgosjeve të deputetëve për kryerjen e veprave penale jashtë funksionit të tyre parlamentar. Rasti më i fundit ishte ai i ish-deputetit Etem Arifi, pasi ishte gjetur fajtor për mashtrim me subvencione.⁴⁶ Nga ana tjetër, meqenëse përdorimi i gazit lotsjellës nga persona të paautorizuar konsiderohet vepër penale, në vitin 2015, kur u hodh gaz lotsjellës në seanca për shkak të çështjes së demarkacionit të kufirit me Malin e Zi dhe Asociacionit të komunave me shumicë serbe, prokuroria urdhëroi arrestimin e deputetëve. 13 deputetë të opozitës u arrestuan, u paraburgosën apo iu nënshtruan arrestit shtëpiak.



Qeverisja



INDIKATORI 1.2.1 TRANSPARENCA (SIPAS LIGJIT)

100/100



Ekzistojnë dispozita gjithëpërfshirëse në fuqi për të siguruar që publiku të mund të ketë qasje në punën dhe të marrë informacion mbi organizimin dhe funksionimin e legjislativit, për vendimet që kanë të bëjnë me ta dhe se si janë marrë këto vendime.

Transparenca e punës së Kuvendit sigurohet me dispozita kushtetuese dhe me Rregulloren e Kuvendit, të cilat parashohin se mbledhjet e Kuvendit janë publike, por ato mund të mbyllin me kërkesë të Presidentit, Kryeministrit ose një të tretës së deputeteve.⁴⁷ Mbledhjet e komisioneve parlamentare janë përgjithësisht të hapura për publikun, me përjashtim të rasteve që përfshijnë çështje konfidenciale sigurie dhe detaje të kontratës që kualifikohen si sekrete biznesi.⁴⁸

Seancat plenare dhe mbledhjet e komisioneve kërkohet të transkriptohen dhe përgatiten procesverbale për mbledhjet e Kryesisë së Kuvendit.⁴⁹ Këto procesverbale dhe transkripte të mbledhjeve bëhen të disponueshme për publikun nëpërmjet publikimit në faqen e internetit të Kuvendit.⁵⁰ Për më tepër, të gjitha dokumentet dhe publikimet parlamentare janë gjithashtu të disponueshme për publikun.⁵¹

Votimi në kuvend, përfshirë edhe komisionet parlamentare,⁵² zhvillohet në mënyrë të hapur. Në seancat plenare, çdo votim i hapur, duke specifikuar "për", "kundër", "abstenim", regjistrohet me emrin dhe mbiemrin e deputetit. Votimi elektronik

përfshin numrin e pjesëmarrësve, votuesit dhe rezultatin e plotë të votimit. Me kërkesë të një grupi parlamentar dhe me fizibilitet teknik, votat e përfaqësuesve individualë mund të shfaqen në monitorë gjatë votimit elektronik.⁵³ Rezultatet e votimit elektronik shpallen menjëherë pas seancës plenare, ndërsa rezultatet e votimit manual publikohen brenda dy ditëve të punës pas përfundimit të seancës.⁵⁴

Publiku ka mundësinë të angazhohet në procedurat e kuvendit, duke përfshirë dëgjimet për projektligjet në shqyrtim dhe mbikëqyrjen e ligjit dhe zbatimin e politikave.⁵⁵ Seancat e plota plenare duhet të transmetohen nga televizioni publik.⁵⁶ Përfaqësuesit e medieve që mbulojnë aktivitetet e kuvendit janë të akredituar nga Kuvendi,⁵⁷ dhe transmetimet mediatike mund të kryhen pa pagesë. Kuvendi ka një Strategji të Informimit dhe Komunikimit, e cila, ndër të tjera, përfshin përmirësimin dhe përditësimin e faqes së internetit të Kuvendit, organizimin e konferencave për media pas mbledhjeve të Kuvendit dhe nxitjen e bashkëpunimit me mediet dhe shoqërinë civile përmes shkëmbimit të informacionit.⁵⁸

Për më tepër, me Deklaratën për Partneritet mes Kuvendit dhe Shoqërisë Civile, në vitin 2015, Kuvendi themeloi Forumin për Transparençë Parlamentare. Forumi përbëhet nga deputetë, zyrtarë të administratës së Kuvendit dhe përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile.⁵⁹ Ky forumi shërben si trup këshillues për Kuvendin dhe zhvillon një Plan të Veprimit me masat që kërkohen në mënyrë që të arrihen standardet e transparencës të përcaktuara në Deklaratë.

Kuvendi duhet të përgatisë, miratojë dhe publikojë një raport vjetor të punës, së bashku me raportet periodike (muajore) të shpenzimeve dhe raportin financiar vjetor.⁶⁰

Deklaratat e pasurisë së ligjvënësve duhet të publikohen në platformën online të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit brenda 30 ditëve nga afati i deklarimit.⁶¹





**INDIKATORI 1.2.2
TRANSPARENCA
(NË PRAKTIKË)**

75/100



Publiku është në gjendje t'i qaset lehtësisht legjislativ dhe të marrë informacionin përkatës në lidhje me organizimin dhe funksionimin e tij, si dhe me vendimet që kanë të bëjnë me të. Megjithatë, problemet me pajisjet elektronike të votimit të Kuvendit kanë penguar qasjen e publikut në informacione lidhur me votat dhe mungesat e deputetëve.

Pandemia ka ndikuar në transparencën e Kuvendit. Kompanitë private të medieve u angazhuan gjatë pandemisë për të transmetuar punimet e komisioneve, duke përjashtuar seancat plenare. Deri në vitin 2019, Kuvendi publikonte menjëherë të gjitha votimet e seancës plenare, duke lejuar qasje të lehtë në pikat e rendit të ditës dhe votat e deputetëve. Megjithatë, problemet e pajisjeve teknike me votimin elektronik dhe një tender në pritje për pajisje që nga viti 2019 kanë shkaktuar një mungesë prej katër vitesh të regjistrimeve individuale të votave të deputetëve, duke e bërë informacionin të padisponueshëm.⁶² Komisionet parlamentare publikojnë vetëm totalin e votave, kryesisht përmes procesverbalet e mbledhjeve. Megjithatë, Kuvendi ofron qasje në kohë reale në kalendarin e mbledhjeve, duke detajuar agjendat e Kryesisë, seancat plenare dhe komisionet parlamentare.⁶³

Në vitin 2019 është lansuar ueb-faqja e re e Kuvendit e cila e ka lehtësuar qasjen e publikut në informata parlamentare duke i profilizuar dhe kategorizuar informatat. Në kuadër të ueb-faqes së re⁶⁴ janë paraqitur edhe profilet individuale të deputetëve me të dhënat personale të tyre dhe është dhënë hapësira për qytetarët që t'i kontaktojnë drejtpërdrejt deputetët përmes këtyre profileve.⁶⁵ Faqja e internetit e Kuvendit përfshin transkriptet dhe procesverbalet e mbledhjeve të

Kuvendit, të cilat zakonisht publikohen menjëherë pas përfundimit të mbledhjeve.⁶⁶

Në vitin 2018, Kuvendi lansoi edhe Sistemin e përcjelljes së legjislationit, i cili ofron informacione lidhur me procesin legjislativ para se projektligjet të debatohen, duke përfshirë të gjitha hapat e shqyrtimit të projektligjeve dhe i mundëson publikut të japë propozime konkrete në lidhje me përmbajtjen e tyre.⁶⁷ Punimet plenare të Kuvendit të Kosovës transmetohen drejtpërdrejt nga transmetuesi publik dhe kanalet tjera mediatike private. Të gjitha mediet kanë leje të incizojnë mbledhjet e komisioneve dhe t'i transmetojnë ato drejtpërdrejt, gjë që vetë Kuvendi nuk e bën në kanal in e tij zyrtar në YouTube. Kjo përbën përmirësim të dukshëm në aspektin e transmetimit të drejtpërdrejtë të të gjithë punimeve brenda Kuvendit të Kosovës.⁶⁸ Buxheti i Kuvendit është pjesë përbërëse e buxhetit të shtetit, i cili bëhet publik në përputhje me ligjet e tjera.⁶⁹ Kuvendi i Kosovës publikon raportin e punës në ueb faqen zyrtare të Kuvendit më të gjitha aktivitetet, duke përfshirë aktivitetet brenda Kuvendit por edhe aktivitetet e tjera jashtë agjendës.⁷⁰ Ndërsa Kuvendi shpalos shpenzimet dhe raportet financiare⁷¹ çdo tremujor, gjashtëmujor dhe çdo vit, ato publikohen në formate që paraqesin sfida analitike. Për më tepër, problemet e formatit të dokumentit vazhdojnë në fusha të ndryshme, pasi të gjitha dokumentet ofrohen në formatin PDF.

Kuvendi ka lansuar gjithashtu një platformë të re online, të quajtur E-pjesëmarrja,⁷² e cila është platformë gjithëpërfshirëse që u mundëson qytetarëve të angazhohen në vendimmarrje dhe u ofron atyre qasje në shërbimet publike, duke i lejuar ata të shqyrtojnë çështjet e dërguara deputetëve, ndjekin aktivitetet e Kuvendit dhe dorëzojnë formularët elektronik direkt.⁷³

Të gjitha deklaratat e pasurisë së ligjvënësve janë publikuar në faqen e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.⁷⁴



**INDIKATORI 1.2.3
LLOGARIDHËNIA
(SIPAS LIGJIT)**

75/100



Ekzistojnë disa dispozita për të siguruar që Kuvendi duhet të raportojë dhe të përgjigjet për veprimet e tij. Megjithatë, nuk ka asnjë kërkesë ligjore që Kuvendi t'i raportojë drejtpërdrejt ndonjë institucioni specifik apo qytetarëve të Kosovës, përveç detyrimit për raportim financiar tek Zyra Kombëtare e Auditimit. Gjithashtu, organizimi i konsultimeve publike nuk është i detyrueshëm.

Zbatimi i parimeve të kontrollit dhe balancimit të pushtetit dhe Kushtetuta bëjnë të mundur që institucioni i Presidentit, Gjykatës Kushtetuese dhe Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm të kenë kompetenca të veçanta ligjore për shqyrtimin e punës së legjislativ.

Gjykata Kushtetuese është kompetente për shqyrtimin e kushtetutshmërisë së ligjeve dhe akteve të tjera ligjore të miratuara nga Kuvendi. Dhjetë a më shumë deputetë të Kuvendit kanë të drejtë ta kontestojnë kushtetutshmërinë e çfarëdo ligji ose vendimi të miratuar nga Kuvendi dhe të kërkojnë që Gjykata Kushtetuese ta ushtrojë autoritetin e vet përfundimtar për interpretimin e Kushtetutës.⁷⁵

Kushtetuta gjithashtu i jep të drejtën Presidentit që në disa raste të ndërveprojë me Kuvendin e Kosovës, ku presidenti ka të drejtë të kthejë për rishqyrtim ligjet e miratuara nëse konsiderohen të dëmshme për interesat legjitime të Republikës së Kosovës, për një ose më shumë prej komuniteteve të saj. Të drejtën e rikthimit të një ligji, Presidenti mund ta shfrytëzojë vetëm një herë.⁷⁶ Nëse Presidenti e kthen një ligj për rishqyrtim, Kryetari ia përcjell menjëherë komisionit përkatës dhe përfaqësuesve të Kuvendit. Për të anashkuar veton, një minimum prej 61 përfaqësuesish duhet të votojnë

për ligjin e miratuar, duke e bërë atë efektiv. Dështimi për të anuluar veton do të thotë se ligji konsiderohet i anuluar.⁷⁷

Nga ana tjetër, Zyra e Auditorit të Përgjithshëm mbikëqyr aktivitetin financiar të institucioneve publike, përfshirë Kuvendin.⁷⁸

Rregullorja e Kuvendit i lejon komisionet parlamentare, por nuk i detyron ato, të organizojnë seanca dëgjimore apo konsultime publike me palët e interesuara dhe relevante, qoftë gjatë shqyrtimit të projektligjeve apo çështjeve të tjera që bien në fushëveprimin e tyre.⁷⁹ Megjithatë, nuk ka asnjë legjislation që detyron Kuvendin apo deputetët të shqyrtojnë apo të japin komente për kërkesat e palëve të interesuara, qoftë në projektligje apo në aspekte të tjera.

**INDIKATORI 1.2.4
LLOGARIDHËNIA
(NË PRAKTIKË)**

25/100



Dispozitat ekzistuese për llogaridhënien e legjislativ nuk janë mjaftueshëm efektive për të siguruar që anëtarët e legjislativit duhet të raportojnë dhe të përgjigjen për veprimet e tyre në praktikë.

Në përgjithësi, sistemi zgjedhor i Kosovës nuk e favorizon llogaridhënien nga legjislativi. Kjo pasi që Kosova përdorë sistem zgjedhor proporcional si një zonë e vetme zgjedhore, ku qytetarët mund të votojnë vetëm për një parti dhe deri pesë kandidatë të listës së partisë. Kështu, votuesit nuk zgjedhin përfaqësues nga vendi ku ata jetojnë dhe, si rezultat, deputetët nuk kanë lidhje të fortë me elektoratin e tyre.

Sa i përket konsultimeve me publikun, Kuvendi po vazhdon me trendin e numrit dukshëm të ulët të dëgjimeve publike gjatë procesit ligjvënës. Në vitin 2022 Kuvendi ka zhvilluar 22





dëgjime publike, ndërsa në vitin 2023 deri në tetor ka mbajtur vetëm 13 dëgjime publike.⁸⁰ Mungesa e konsultimeve publike gjatë procesit legjislativ konsiderohet nga OSHC-të si shkelje e standardeve parlamentare.⁸¹ Kuvendi në vitin 2011 ka angazhuar një zyrtar për ndërlidhje me organizatat joqeveritare (OJQ) dhe që atëherë ka krijuar korniza për pjesëmarrjen e shoqërisë civile në punën e Kuvendit të Kosovës.⁸² Që nga viti 2018, Forumi ka iniciuar aktivitetin “Ditët e Kuvendit”, në të cilin deputetë nga të gjitha grupet parlamentare përfshihen në diskutime me qytetarët,⁸³ shpesh në mjedise lokale, për të adresuar shqetësimet lokale. Veçanërisht, disa nga këto takime kaluan në platformat online gjatë pandemisë⁸⁴ ku përfaqësues të shoqërisë civile lehtësonin diskutimet. Kjo ilustron një qasje proaktive të legjislativit për të mbështetur mbikëqyrjen publike dhe për të ofruar informacion.

Kur aktet e Kuvendit kontestohen para Gjykatës Kushtetuese, është zakon që Kuvendi, organet e tij të ndryshme dhe grupet parlamentare të paraqesin këndvështrimet dhe argumentet e tyre ligjore. Ky proces përfshin një shkëmbim të plotë qëndrimesh dhe justifikimesh ligjore, gjë që kontribuon në një shqyrtim gjithëpërfshirës dhe të mirëinformuar të çështjes nga Gjykata Kushtetuese.

Meqenëse rregulloret e imunitetit u mungojnë dispozitat për mbrojtjen e deputetëve në lidhje me veprimet jashtë detyrave të tyre parlamentare, ato kanë pak ndikim praktik në llogaridhënien e përfaqësuesve.



Legjislacioni ekziston për të ruajtur integritetin e anëtarëve të legjislativit, megjithëse ka disa mangësi në drejtim të zbatimit të një kodi të sjelljes dhe etikës së ligjvënësve përmes mekanizmave sanksionues. Për më tepër, ka mungesë të legjislacionit që adreson lobimin legjislativ.

Sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, deputeti i Kuvendit të Kosovës nuk mund të mbajë ndonjë post ekzekutiv në administratën publike ose në ndonjë ndërmarrje në pronësi publike, dhe as të ushtrojë ndonjë funksion tjetër ekzekutiv, sikurse është përcaktuar me ligj.⁸⁵

Rregullorja e re e Kuvendit përfshin dispozita që parashohin miratimin e Kodit të Sjelljes për deputetët.⁸⁶ Megjithatë, një vit pas miratimit të Rregullores së Punës, Kodi ende nuk është miratuar, megjithëse aktualisht është në fazat fillestare të hartimit. Drafti aktual i Kodit përfshin, ndër tema të tjera, dispozita që lidhen me etikën parlamentare dhe parandalimin e konfliktit të interesit. Ky dokument gjithashtu parasheh krijimin e një Komiteti për Etikën, i ngarkuar me trajtimin e shkeljeve të mundshme.

Rregullorja e mëparshme e punës përfshinte një kod sjelljeje i cili përmbante dispozita kundër korrupsionit duke theksuar se deputetët nuk duhet të kenë detyrime financiare ndaj individëve ose organizatave që mund të ndikojnë në kryerjen e detyrave të tyre zyrtare; dhe, nëse ka interes financiar personal për ndonjë çështje që shqyrtohet në Kuvend ose në ndonjë komision, deputeti duhet ta deklarojë gojarisht atë përfitim paraprakisht.⁸⁷

Legjislacioni për deklarimin e pasurisë i detyron deputetët të deklarojnë pasurinë e tyre në fillim të mandatit dhe më pas



rregullisht në baza vjetore.⁸⁸ Këto deklarata publikohen nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit. Sipas ligjit në fjalë, personi zyrtar nuk mund të kërkojë ose të pranojë dhurata ose favore të tjera për vete, as për anëtarët e familjes, që kanë të bëjnë me ushtrimin e detyrave zyrtare dhe të cilat ndikojnë, ose mund të ndikojnë në ushtrimin e detyrave zyrtare, përveç dhuratave protokollare dhe dhuratave të rastit.⁸⁹

Veç kësaj, Ligji për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit përcakton që deputeti është i obliguar, që brenda tridhjetë (30) ditëve nga certifikimi i mandatit të deputetit, të bëjë një deklaratë rreth pasurisë, të ardhurave dhe interesave ekonomike të tij, të bashkëshortit/ës ose partnerit të jetës dhe fëmijës/ëve që jeton në të njëjtën familje, tek kryetari i Kuvendit.⁹⁰

Legjislacioni i përgjithshëm për parandalimin e konfliktit të interesit vlen edhe për deputetët. Përfaqësuesit janë të detyruar të trajtojnë dhe zgjidhin në mënyrë efektive çdo konflikt midis interesave të tyre publike dhe private.⁹¹ Anëtarëve të legjislativit u ndalohet të angazhohen në aktivitete profesionale shtesë, të shërbejnë si menaxherë, përfaqësues të autorizuar, ose të ulen në bordet drejtuese ose mbikëqyrëse të OJQ-ve të kompanive private fitimprurëse. Për më tepër, përfaqësuesit nuk mund të mbajnë poste në të njëjtën kohë në organe të shumta drejtuese të ndërmarrjeve publike ose institucioneve të tjera publike.⁹²

Ligji nuk vendos kufizime pas punësimit pas përfundimit të mandatit të një deputeti. Ai garanton ruajtjen e punës së mëparshme të një përfaqësuesi vetëm nëse ai ishte i punësuar në sektorin publik. Deputeti që para fitimit të mandatit ka qenë i punësuar në sektorin publik ose në institucionin që financohet me mjete publike, ka të drejtë vazhdimin e funksionit në pozitën e tij të njëjtë ose në pozitë të rangut të njëjtë pas përfundimit të mandatit.

Kosovës i mungon ndonjë legjislacion që kërkon nga deputetët të dokumentojnë ose të zbulojnë ndërveprimet e tyre me lobistët ose individët dhe grupet e interesit që përpiqen të ndikojnë në procesin legjislativ. Organizatat e shoqërisë civile e konsiderojnë një ligj të tillë hap të rëndësishëm në forcimin e transparencës dhe kornizës ligjore për luftimin e korrupsionit.⁹³



Ekziston një qasje e pjesshme për të garantuar integritetin e ligjvënësve, duke përfshirë vetëm zbatimin e rregullave ekzistuese për deklarimin e pasurisë dhe konfliktin e interesit, ndërkohë që sjellja e keqe mbetet e pasanksionuar për shkak të mungesës së mekanizmave të duhur.

Për shkak të mungesës së masave sanksionuese, parimet e sjelljes së mirë dhe standardet etike të përcaktuara në Rregulloren e mëparshme të Kuvendit kanë shërbyer vetëm si udhëzime për përfaqësuesit. Për rrjedhojë, “zbatimi” i tyre nuk ka siguruar sjellje etike mes ligjvënësve, pasi nuk janë identifikuar shkelje formale. Kuvendi nuk ka arritur që të hartojë planin e integritetit, ndërsa mungesa e një plani të tillë sjell edhe mungesë të mekanizmave për parandalimin e konfliktit të interesit në procesin legjislativ.⁹⁴

Aktualisht Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit siguron që deklarimi i pasurisë nga deputetët të bëhet sipas legjislacionit. Deklaratat e pasurisë së të gjithë ligjvënësve shqyrtohen dhe vihen në dispozicion në faqen e internetit të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.⁹⁵ Çdo deputet që shkel rregullat e deklarimit bartë përgjegjësi penale. Në të paktën tre raste, ligjvënësit u përballën me veprime ligjore të iniciuara nga Agjencia, për mosdeklarim të pasurisë së tyre ose ofrimin e informacionit të pasaktë – duke demonstruar rolin proaktiv të Agjencisë në sigurimin e integritetit të ligjvënësve. Në dy prej këtyre rasteve, gjykata ka vendosur burgim me kusht dhe gjobë ndaj (ish) deputetëve.⁹⁶

Kodi i mirësjelljes, i cili më parë ishte pjesë integrale e Rregullores së Punës, është vlerësuar nga njohësit e punës së Kuvendit si i mangët në përmbajtje dhe nuk është zbatuar pasi Rregullorja e vjetër nuk parashikonte mekanizma sank-





sionues. Pas miratimit të Rregullores së re të Punës, Kuvendi do të hartojë si dokument të veçantë Kodin e ri të Etikës.

Për shkak të mungesës totale të legjislacionit për lobimin legjislativ, ligjvënësit nuk kanë bërë të ditur apo raportuar mbi ndërveprimet apo takimet e tyre me lobuesit apo palët e interesit.

**INDIKATORI 1.2.7
PËRFAQËSIMI GJINOR**

75/100



43 nga 120 (rreth 33 për qind) e deputetëve janë gra, dhe pjesëmarrja e grave dhe burrave në pozitën drejtuese legjislative dhe detyrat e komisioneve është përgjithësisht e balancuar.

Korniza kushtetuese dhe ligjore e Kosovës garanton përfshirje të barabartë gjinore në vendimmarrje, ndonëse zbatimimi i saj në shumë raste ngec për shkak të mungesës së vullnetit politik për zbatimin e këtyre normave. Aktualisht, pjesëmarrja e barabartë e grave në jetën politike dhe publike rregullohet me Kushtetutë.⁹⁷ Ligjin për Barazinë Gjinore,⁹⁸ dhe Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme.⁹⁹

Për zëvendësimin e deputetëve sipas gjinisë, ka një interpretim nga Gjykata Kushtetuese për ligjin për zgjedhjet e përgjithshme. Gjykata kishte konstatuar se dy kandidatëve për deputete në zgjedhjet e vitit 2019, u ishin shkelur të drejtat dhe janë diskriminuar në momentin kur nuk janë lejuar të bëhen deputete për të zëvendësuar deputetët që ishin emëruar në poste tjera, ndonëse kishin më shumë vota se kandidatët pasues. Sipas interpretimit të Gjykatës Kushtetuese të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, zëvendësimi i deputetëve duhet të sigurojë një përfaqësim minimal prej 30 për qind për gjininë e nënpërfaqësuar. Për më tepër, në situatat kur kuota gjinore prej 30 për qind është përmbush-

ur përmes rezultateve të zgjedhjeve, zëvendësimet e kandidatëve për deputetë duhet të përputhen me rezultatin e përgjithshëm të zgjedhjeve, pa kufizuar zëvendësimin në të njëjtën gjini, për sa kohë që përfaqësimi minimal i gjinisë së nënpërfaqësuar ruhet.¹⁰⁰

Gjykata Kushtetuese ka interpretuar Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në 2019 në lidhje me aplikimin e kuotave gjinore, veçanërisht në lidhje me zëvendësimin e deputetëve. Vendimi i gjykatës ripohon dy parime, të cilat përfshijnë: duhet të sigurohet gjithmonë një përfaqësim minimal prej 30 për qind i gjinisë së nënpërfaqësuar (gjinia pakicë) dhe nuk mund të vihet në dyshim; dhe se nëse kuota gjinore prej 30 për qind është përmbushur tashmë përmes rezultateve të zgjedhjeve, zëvendësimet për kandidatët për deputetë duhet të bazohen në ato rezultate zgjedhore, pa u kufizuar në kandidatë të së njëjtës gjini, për sa kohë që ruhet përfaqësimi gjinor minimal i nënpërfaqësuar.¹⁰¹

Zgjedhjet e fundit parlamentare të mbajtura në Kosovë më 14 shkurt 2021 shënuan një sukses të jashtëzakonshëm për gratë sa i përket numrit të votave që kanë marrë në zgjedhje, duke marrë rreth 900 mijë vota. Për më tepër, për herë të parë një grua ishte kandidatja që mori më shumë vota në zgjedhjet parlamentare.¹⁰² Nga 43 gra të zgjedhura, nëntë deputete fituan në Kuvend falë kuotës gjinore, ndërsa 34 të tjera u zgjodhën deputete pa mbështetjen e kuotës.¹⁰³

Rregullorja e punës së Kuvendit obligon subjektet politike parlamentare që të respektojnë përbërjen gjinore tek të gjitha trupat e Kuvendit.¹⁰⁴ Në legjislaturën e kaluar Vjosa Osmani ishte gruaja e parë që u zgjodh Kryetare e Kuvendit.¹⁰⁵ Edhe në legjislaturën aktuale nënkryetaria e parë e Kuvendit është një grua – Saranda Bogujevci.

Ka pasur një përmirësim të dukshëm në përfaqësimin e grave në udhëheqjen e komisioneve parlamentare. Tetë nga 14 komisionet parlamentare të legjislaturës aktuale udhëhiqen nga gratë, ku dy prej tyre janë komisione të përhershme. Po ashtu tetë nga 14 komisionet parlamentare kanë nënkryetare gra.¹⁰⁶

Ekziston një grup i grave deputete, i cili përbëhet nga një përfaqësuese nga të gjitha subjektet politike parlamentare. Misioni i këtij Grupi joformal është që të promovojë barazinë gjinore dhe të përmirësojë pozitën e gruas në pozita vendimmarrëse, duke avokuar për zbatim të legjislacionit dhe politikave gjinore.



Roli

**INDIKATORI 1.3.1
MBIKËQYRJA E EKZEKUTIVIT**

50/100



Përdërisa Kuvendi i Kosovës është disi aktiv në përpjekjen për të kërkuar llogari nga ekzekutivi, efektiviteti i veprimeve të tij është i kufizuar për shkak të dështimit të zbatimit të duhur të dispozitave ekzistuese.

Kuvendi i Kosovës mbikëqyrë ekzekutivin përmes mjeteve të ndryshme si komisionet hetimore, komisionet për çështje të veçanta, pyetjet parlamentare dhe shqyrtimi i ministrive individuale të linjës. Pyetjet parlamentare, me gojë dhe me shkrim, janë forma më e zakonshme. Kuvendi përballet me sfida të vazhdueshme në mbikëqyrjen efektive të ekzekutivit, me efektivitetin e tij aktual që bie nën nivelet e dëshirueshme. Shumica e pyetjeve parlamentare nuk kanë cilësi dhe anojnë në favor të ekzekutivit. Për më tepër, formati ekzistues i debateve parlamentare perceptohet si i padobishëm për procedurat parlamentare.¹⁰⁷

Një komision hetimor në lidhje me përgjegjësitë e qeverisë ose të shtetit mund të iniciohet nga gjashtë deputetë, një komision i përhershëm parlamentar ose një e treta e deputetëve të Kuvendit.¹⁰⁸ Ky komision heton dhe sqaron ngjarjet, si dhe cakton përgjegjësinë, me fuqinë për të thirrur zyrtarë, për qasje në dokumente dhe për të detyruar dëshminë.¹⁰⁹ Megjithatë, zbatimi praktik përballet me sfida të efikasitetit. Pavarësisht nga numri i shtuar i komisioneve, zgjedhjet e parakohshme shpesh pengojnë progresin, duke bërë që shumë të kthehen në fazat e tyre fillestare.¹¹⁰ Partitë në pushtet gjithashtu pengojnë hetimet duke abstenuar, duke rezultuar në një kuorum të pamjaftueshëm. Në rastin

e “rezervave shtetërore”, deputetët e koalicionit qeverisës bojkotuan gjashtë përpjekje për të thirrur mbledhjen konstitutive, duke penguar funksionimin e komisionit.¹¹¹

Kuvendi shqyrtonte tërësisht buxhetin e shtetit të propozuar nga qeveria, duke bërë ndryshime në bazë të komisioneve parlamentare apo propozimet e deputetëve dhe duke e miratuar atë.¹¹²

Auditori i Përgjithshëm dhe Avokati i Popullit zgjidhen dhe shkarkohen nga Kuvendi.¹¹³ Anëtarët e KQZ-së emërohen nga grupet parlamentare të përfaqësuara në Kuvend.¹¹⁴ Ekzekutivi nuk luan rol në emërimin e drejtuesve apo anëtarëve të këtyre institucioneve.

Kushtetuta e Kosovës lejon dy lloje të mocioneve të mosbesimit për kryeministrin: një të iniciuar nga deputetët dhe një tjetër nga kryeministri. Një mocion mosbesimi kërkon një të tretën e mbështetjes nga të gjithë deputetët dhe suksesi i tij varet nga shumica e votave. Nëse dështon, një mocion i ri nuk mund të propozohet për 90 ditë. Edhe Kryeministri mund të kërkojë votëbesimin duke ndjekur të njëjtën procedurë.¹¹⁵ Mekanizmi i mosbesimit është përdorur dy herë, në legjislaturën e pestë dhe të shtatë, kundër kryeministrit të atëhershëm Isa Mustafa dhe kryeministrit aktual Albin Kurti gjatë qeverisjes “Kurti 1”.

Mbikëqyrja buxhetore e ekzekutivit kryhet nga Komisioni Parlamentar për Mbikëqyrjen e Financave Publike. Ky komision mban mbi supë një barrë të madhe sepse duhet të mbikëqyrë buxhetin e të gjitha ministrive. Megjithatë, ky komision nuk ka kompetenca të drejtpërdrejta në monitorimin e kontratave publike nga qeveria.





INDIKATORI 1.3.2 REFORMAT LIGJORE

50/100



Ndonëse ka një sërë reformash ligjore për të luftuar korrupsionin dhe për të promovuar integritetin, ato janë përpjekje të pjesshme, të cilat konsiderohen të jenë disi joefektive në arritjen e qëllimeve të tyre.

Gjatë dekadës së fundit, institucionet e Kosovës kanë intensifikuar punën në krijimin e mekanizmave ligjorë për luftimin e korrupsionit. Megjithatë, kjo ka ardhur kryesisht për shkak të kriterëve të vendosura nga BE-ja për liberalizimin e vizave dhe integrimin në BE. Në vitin 2016 kur Kosova kishte nënshkruar marrëveshjen për Stabilizim Asociim, Agjenda për Reforma Evropiane ishte lansuar si dialog i nivelit të lartë në mes BE-së dhe Kosovës, në mënyrë që të përshpejtohej zbatimi i kësaj marrëveshjeje. Në kuadër të kësaj agjende ishin paraparë shumë veprime që institucionet e Kosovës duhet t'i ndërmerren në luftën kundër korrupsionit.

Sipas një raporti të shoqërisë civile lidhur me zbatimin e kësaj agjende, në periudhën 2017-2018, Kuvendi i Kosovës ka miratuar disa ligje që fuqizojnë luftën kundër korrupsionit.¹¹⁶ Sipas raportit, është miratuar legjislacioni që e bën të detyrueshëm pezullimin dhe/ose largimin nga funksionet e zyrtarëve publikë që akuzohen dhe dënohen për korrupsion.¹¹⁷ Kjo përfshinte Kodin e ri Penal, Kodin e Procedurës Penale, Ligjin e ri për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Prokurorin e Shtetit, si dhe Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore për Gjyqtarët dhe Prokurorët.¹¹⁸ Kjo paketë e ligjeve ndër të tjera mundëson rritjen e numrit të prokurorëve në Prokurorinë Speciale për hetimin dhe ndjekjen e rasteve të korrupsionit dhe krimeve të nivelit të lartë.

Nismat ligjore që synojnë luftimin e korrupsionit vlerësohen si një hap i rëndësishëm në drejtimin e duhur; megjithatë,



ekziston një nevojë urgjente për të përmirësuar zbatimin e përgjithshëm të këtyre ligjeve.¹¹⁹

Qeveria e Kosovës ka ndërmarrë reforma të rëndësishme për të luftuar korrupsionin duke dërguar iniciativa ligjore në Kuvend. Kjo përfshinte iniciativën e vitit 2022 për ndryshimin e Kushtetutës së Kosovës për të futur një proces verifikimi/vetingu¹²⁰ për sistemin e drejtësisë, i njohur zakonisht si procesi kalimtar.¹²¹ Përpjekje të tjera legjislative përfshijnë financimin e partive politike (2022),¹²² krijimin e një byroje për konfiskimin e pasurive (2022),¹²³ adresimin e përgjegjësisë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve (2021),¹²⁴ Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit (2022),¹²⁵ për deklarimin e pasurisë (2022),¹²⁶ dhe reformat për Këshillin Prokurorial (2022),¹²⁷ dhe Prokurorin e Shtetit (2023).¹²⁸

Kosova nuk është palë e konventave ndërkombëtare kundër korrupsionit si Konventa e OKB-së kundër Korrupsionit dhe Konventa e Këshillit të Evropës për të Drejtën Penale për Korrupsionin. Megjithatë, legjislacioni i Kosovës në përgjithësi përputhet me këto konventa dhe u përmbahet standardeve relevante evropiane.¹²⁹

Agjenda legjislative e legjislaturës aktuale tregon po ashtu për fokusin që Kuvendi i Kosovës ka në miratimin e legjislacionit që rregullon fushën kundër korrupsionit. Nga gjithsej 78 ligje të miratuara gjatë vitit të kaluar, 14 prej tyre i takojnë fushës së drejtësisë.¹³⁰



Ndërveprimet

Kuvendi i Kosovës ndërvepron kryesisht me Qeverinë e Kosovës, Zyrën Kombëtare të Auditimit (ZKA) dhe KGJK-në. Rregulloret ligjore, duke përfshirë kornizat kushtetuese dhe legjislative, rregullojnë këto ndërveprime. Përveç procedurave të formalizuara, Kuvendi bashkëpunon joformalisht me qeverinë, duke përfshirë koordinimin e agjendave plenare dhe shkëmbimin e informacionit në lidhje me procedurat në vazhdim të Kuvendit. Niveli i ndërveprimit informal mes Kuvendit dhe Qeverisë varet nga përafrimi i lidhshimit, duke ndikuar në efektivitetin e bashkëpunimit të tyre. Angazhimi i vërtetë ndikon pozitivisht në përpjekjet kundër korrupsionit të Kuvendit, duke pasur parasysh rolin e tij të rëndësishëm legjislativ dhe mbikëqyrës.

Përderisa ndërveprimet e Kuvendit me ZKA-në dhe KGJK-në janë të rregulluara ligjërisht, ka hapësirë për forcimin e komunikimit formal, veçanërisht me KGJK-në. Kjo nevojë u bë e evidente në rastin e deputetit Etem Arifi, ku mungesa e komunikimit bëri që Arifi të mbajë mandatin përkundër dënimit penal. Gjetjet e mëvonshme të Gjykatës Kushtetuese theksuan domosdoshmërinë e bashkëpunimit të zgjeruar ndërinstytucional për të garantuar ligjshmërinë dhe integritetin kushtetues të proceseve zgjedhore dhe aktiviteteve parlamentare.¹³¹

Auditori i Përgjithshëm dhe Avokati i Popullit zgjidhen dhe shkarkohen nga Kuvendi,¹³² ndërsa anëtarët e KQZ-së propozohen nga grupet parlamentare të përfaqësuara në Kuvend.¹³³ Mbikëqyrja buxhetore bëhet përmes Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike. Ky komision mban mbi supë një barrë të madhe sepse duhet të mbikëqyrë buxhetin e të gjitha ministrive.

Kuvendi dhe ekzekutivi përballen me një dobësi të konsiderueshme në mbikëqyrjen e agjencive të pavarura, gjë që mund t'i atribuohet dinamikës politike, mungesës së kulturës politike në mesin e deputetëve të koalicionit qeverisës dhe një kuadri ligjor joadekuat. Ndërsa legjislacioni mandaton raportimin e drejtpërdrejtë të institucioneve të pavarura në Kuvend, mangësitë përfshijnë monitorimin e pamjaftueshëm, afatet e papërcaktuara për raportet dhe mungesën e sanksioneve për raportet e refuzuara.¹³⁴ Vlerësimet, duke përfshirë raportin e progresit të Komisionit Evropian 2021, theksojnë mbikëqyrjen e dobët të Kuvendit të zbatimit të ligjit, duke kërkuar plane strategjike dhe rritje të buxheteve.¹³⁵ Raporte të tjera identifikojnë faktorë të brendshëm, si mangësitë ligjore dhe mungesa e ekspertizës së komisioneve, që kontribuojnë në performancën e dobët të Kuvendit në mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit.¹³⁶

Rekomandimet e shtyllës

- Sigurimi i hapësirës adekuate për deputetët duke i pajisur të gjithë me një zyrë pune në mënyrë që ata të kryejnë detyrat e tyre në mënyrë më efektive.
- Rritja e numrit të hulumtuesve brenda Drejtorisë për Hulumtime Parlamentare.
- Sigurimi i pavarësisë buxhetore dhe administrative të Kuvendit nga ekzekutivi duke zbatuar ndryshime ligjore që mandatojnë qeverinë të ndajë buxhetin për Kuvendin në përputhje me kërkesat e saj, bazuar në një përqindje minimale të buxhetit të caktuar.
- Të ndryshohet korniza ligjore për raportimin e agjencive të pavarura në Kuvend duke përcaktuar sanksione për drejtuesit apo bordet e institucioneve të pavarura në rast të mosmiratimit të raporteve të tyre vjetore nga Kuvendi. Kuvendi duhet t'i përcaktojë afatet për dorëzimin e raporteve vjetore nga secili institucion.
- Rritja e ndjeshme e numrit të konsultimeve dhe dëgjimeve publike lidhur me legjislacionin duke futur mekanizma të detyrueshëm për të pasur dëgjime publike për çdo projektligj që shqyrtohet nga Kuvendi.
- Futja në përdorim e sistemit elektronik të votimit dhe regjistrimit elektronik të pranisë së deputetëve në seancat plenare.
- Të sigurohet transparenca më e madhe duke publikuar votat e deputetëve si në mbledhjet plenare ashtu edhe në komisione në faqen e internetit dhe në platforma të tjera online.
- Miratimi i një ligji për lobimin që detyron deputetët të dokumentojnë dhe zbulojnë ndërveprimet në lidhje me proceset legjislative.
- Forcimi i rregullave të brendshme në lidhje me sanksionet ndaj deputetëve në rastet kur ata përdorin gjuhë dhe sjellje joparlamentare.
- Miratimi i një plani vjetor të punës/mjeti planifikimi dhe menaxhimi për të siguruar menaxhim më të mirë të ngarkesës së punës dhe për të reduktuar numrin e mbetur të pikave në agjendën e Kuvendit.





REFERENCAT

- 1 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 66, pika 1.
- 2 Rregullorja e punës së Kuvendit, neni 19, pika 2.1.
- 3 Rregullorja e punës së Kuvendit, neni 11 dhe 12.
- 4 Rregullorja e punës së Kuvendit, neni 5, pika 2.
- 5 Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, neni 20, paragrafi 4.
- 6 Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, neni 20, paragrafi 8.
- 7 Ligji për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetëve, neni 14, paragrafi 1.
- 8 Ligji për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetëve, neni 33, paragrafët 1 dhe 2.
- 9 Rregullorja e punës së Kuvendit, neni 115, pika 2.
- 10 Ligji për financimin e subjekteve politike, neni 7, pika 3.
- 11 Ligji për financimin e subjekteve politike, neni 9, pika 4.
- 12 Ligji për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022.
- 13 Raporti i shpenzimeve të Kuvendit për vitin 2021. Qasur në: www.kuvendikosoves.org/shq/raporte/raporte-financiare/
- 14 Raporti i shpenzimeve të Kuvendit për vitin 2021. Qasur në: www.kuvendikosoves.org/shq/raporte/raporte-financiare/
- 15 Informata zyrtare nga Zyra e Sekretarit të Kuvendit të Kosovës, qershor 2022.
- 16 Përgjigjja me shkrim e marrë nga Kuvendi i Kosovës më 3 nëntor 2023.
- 17 Përgjigjja me shkrim e marrë nga Kuvendi i Kosovës më 3 nëntor 2023.
- 18 Intervistë me Shefki Kastratin, zyrtar i programit në NDI Kosova, mars 2022.
- 19 Faktimi i këshilltarëve bazohet në numrin e deputetëve në çdo grup parlamentar, me një këshilltar për dhjetë deputetë.
- 20 Intervistë me Shefki Kastratin, zyrtar i programit në NDI Kosova, mars 2022.
- 21 Platforma Vota Ime, e qashshme në: www.votaima.org/Public/DraftLaws?AgendaCompletionYear=2021
- 22 Përgjigjja me shkrim e marrë nga Kuvendi i Kosovës më 3 nëntor 2023.
- 23 Për më shumë, shihni një postim të KDI në rrjetet sociale: www.facebook.com/kosovademocraticinstitute/photos/me-p%C3%ABrkrashjen-e-usaid-it-instituti-demokratik-i-kosov%C3%ABs-kdi-ofron-mb%C3%ABshtetje-p%C3%ABr/10158306862769179/?locale=hi_IN&paipv=0&eav=AfySq0FIU4inVYddRAHOYC4YTYc9ZqiPKY4r2mhjGRX1EBCnptpQR-jEFnJ_qZ3HW8&_rd_ [qasur më 1 nëntor 2023]
- 24 Intervistë me Shefki Kastratin, zyrtar i programit në NDI Kosova, mars 2022.
- 25 Për më shumë shikoni njoftimet e NDI Kosovë në rrjetet sociale: www.facebook.com/NDIKosovo/posts/training-session-on-the-role-of-the-assembly-on-budget-oversight-was-held-with-t/2962415220468497/ dhe www.facebook.com/NDIKosovo/posts/the-second-training-session-on-the-approach-es-and-methodologies-in-the-developme/2966669820043037/. [qasur më 1 nëntor 2023]
- 26 Përgjigjja me shkrim e marrë nga Kuvendi i Kosovës më 16 nëntor 2023.
- 27 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 82, pika 2.
- 28 Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese, i qasshëm më: https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2020/06/ko_72_20_agj_shq.pdf
- 29 Rregullorja e punës së Kuvendit, neni 51, pika 2.
- 30 Rregullorja e punës së Kuvendit të Kosovës, neni 68, paragrafët 1 dhe 3.
- 31 Rregullorja e punës së Kuvendit, neni 70, pika 1.
- 32 Rregullorja e punës së Kuvendit, neni 19, pika 1.
- 33 Rregullorja e punës së Kuvendit, neni 33, pika 1.
- 34 Për më shumë, shikoni seksionin e projektligjeve në Kuvendin e Kosovës. Gjetet në: <https://kuvendikosoves.org/eng/draft-laws-and-laws/> [qasur më 1 nëntor 2023]
- 35 Ligji nr. 03/L-111 për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit, neni 9, paragrafi 1.
- 36 Rregullorja e punës së Kuvendit të Kosovës, neni 22, paragrafët 2 dhe 3.
- 37 Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, në Rastin Nr. KO-98/11. Gjetet në: https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/vendimet/KO98-11_ANG_AKTGJYKIM.pdf [qasur më 2 nëntor 2023]
- 38 Rregullorja e punës së Kuvendit, neni 112, pika 6.
- 39 Ligji për Zyrtarët publik, neni 6, paragrafi 2.
- 40 Rregullorja e punës së Kuvendit të Kosovës, neni 121.
- 41 Për më shumë, shikoni seksionin e projektligjeve në Kuvendin e Kosovës. Gjetet në: <https://kuvendikosoves.org/eng/draft-laws-and-laws/> [qasur më 1 nëntor 2023]
- 42 Portali Dukagjini "Shumica e deputetëve të LVV-së bojkotojnë seancën për nevojën e rritjes së koeficientit të pagave." (Tetor, 2023). Gjetet në: www.dukagjini.com/shumica-e-deputeteve-te-lvv-se-e-bojkotojne-seancen-lidhur-me-nevojen-per-ngritjen-e-koeficientit-te-pagave/ [qasur më 2 nëntor 2023]
- 43 Nacionale, "Haki Abazi kritikon Dejonë Mihalën – kontrollon grupin parlamentar" (maj, 2023). Gjetet në: <https://nacionale.com/politike/haki-abazi-e-kritikon-dejone-mihalin-e-kontrollon-grupin-parlamentar-e-bllokoi-komisionin-hetimor-kunder-privatizimin>



- 44 Radio Evropa e Lirë, "Shpërndahet Kuvendi i Kosovës" (gusht, 2019). Gjetet në: www.evropaelire.org/a/shperndarja-e-kuvendit-/30121899.html [qasur më 2 nëntor 2023]
- 45 Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, në Rastin Nr. KO-95/20. Gjetet në: https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2021/01/ko_95_29_agj_ang.pdf [qasur më 2 nëntor, 2023]
- 46 Portali Radio Evropa e Lirë, dhjetor 2020, www.evropaelire.org/a/30982603.html
- 47 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 68, pika 2.
- 48 Rregullorja e punës së Kuvendit, neni 35, pika 1.
- 49 Rregullorja e punës së Kuvendit të Kosovës, neni 117, paragrafët 2, 3 dhe 4.
- 50 Rregullorja e punës së Kuvendit, neni 117, pika 6.
- 51 Rregullorja e punës së Kuvendit, neni 117, pika 3. Sipas Rregullores së Punës (neni 118, paragrafët 1 dhe 2), dokumentacioni dhe publikimet parlamentare përfshijnë një sërë materiale, duke përfshirë aktet e miratuara në kuvend, dokumentet që lidhen me funksionet e kryetarit të kuvendit, ato që lidhen me përgatitjen dhe zhvillimin e seancave plenare, materialet lidhur me mbledhjet e komisioneve, dokumentet lidhur me veprimtarinë e organeve të kuvendit, produksionet audio-vizuale lidhur me aktivitetet e kuvendit, procesverbalet e seancave plenare, procesverbalet e mbledhjeve të kryesisë, procesverbalet përmbledhëse të mbledhjeve të komisioneve, aktet e miratuara nga kuvendi, prezantimet e aktiviteteve të kuvendit dhe organeve të tij, raportit vjetor për punën e kuvendit dhe publikimet e publikuara në faqen zyrtare të kuvendit.
- 52 Rregullorja e punës së Kuvendit, neni 37, pika 3.
- 53 Rregullorja e punës së Kuvendit të Kosovës, neni 61, paragrafët 4 dhe 6.
- 54 Rregullorja e punës së Kuvendit, neni 61, pika 9.
- 55 Rregullorja e punës së Kuvendit, neni 38, pika 1.
- 56 Rregullorja e punës së Kuvendit, neni 117, pika 7.
- 57 Rregullorja e punës së Kuvendit, neni 116, pika 3.
- 58 Strategjia për informim dhe komunikim të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Gjetet në: [www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Files/17/2019_02_08_StrategjiaperinformimdhedekomunikimeKuvenditteRepublikesseKosoves\(1\)_BH22KECcKL.pdf](http://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Files/17/2019_02_08_StrategjiaperinformimdhedekomunikimeKuvenditteRepublikesseKosoves(1)_BH22KECcKL.pdf)
- 59 Strategjia për informim dhe komunikim të Kuvendit të Republikës së Kosovës.
- 60 Rregullorja e punës së Kuvendit të Kosovës, neni 19, paragrafët 3.5 dhe 3.6, dhe neni 116, paragrafi 2.4.
- 61 Ligji Nr. 08/L-108 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave, neni 12, paragrafi 1.
- 62 Intervistë me Shefki Kastratin, zyrtar i programit në NDI Kosova, mars 2022.
- 63 Për më shumë, shihni kalendarin e Kuvendit të Kosovës. Gjetet në: <https://kuvendikosoves.org/eng/calendar/> [qasur më 3 nëntor 2023]
- 64 Ueb – faqja zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës, e qasshme më: www.kuvendikosoves.org/shq/ballina/
- 65 Intervistë me Musli Krasniqin, Drejtor për Media dhe Marrëdhënie me Publikun në Kuvendin e Kosovës, mars 2022.
- 66 Për më shumë, shihni seksionin e seancave, i cili gjithashtu përmban transkriptet ose procesverbalet. Gjetet në: <https://kuvendikosoves.org/eng/sessions/sessions/>
- 67 Intervistë me Musli Krasniqin, Drejtor për Media dhe Marrëdhënie me Publikun në Kuvendin e Kosovës, mars 2022.
- 68 Intervistë me Musli Krasniqin, Drejtor për Media dhe Marrëdhënie me Publikun në Kuvendin e Kosovës, mars 2022.
- 69 Ligji Nr. 08/L-193 për ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, faqe 23. E qasshme në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=68589>
- 70 Intervistë me Musli Krasniqin, Drejtor për Media dhe Marrëdhënie me Publikun në Kuvendin e Kosovës, mars 2022.
- 71 Për më shumë, shihni Raportet Financiare të Kuvendit. Gjetet në: <https://kuvendikosoves.org/eng/reports/financial-reports/> [qasur më 3 nëntor 2023]
- 72 Për më shumë, shihni platformën: <https://eparticipimi.opendatakosovo.org/issues>
- 73 Intervistë me Musli Krasniqin, Drejtor për Media dhe Marrëdhënie me Publikun në Kuvendin e Kosovës, mars 2022.
- 74 Për më shumë, shihni faqen e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit: <https://pakorrupsion-rks.net/>
- 75 Ligji për Gjykatën Kushtetuese, neni 29.
- 76 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 84, pika 6.
- 77 Rregullorja e punës së Kuvendit të Kosovës, neni 84, paragrafët 2 dhe 4.
- 78 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 137.
- 79 Rregullorja e punës së Kuvendit të Kosovës, neni 38, paragrafët 1; dhe nenet 39 dhe 40.
- 80 Përgjigjja me shkrim e marrë nga Kuvendi i Kosovës më 3 nëntor 2023.
- 81 Raporti i monitorimit të punës së Kuvendit nga "Instituti Demokratik i Kosovës" (2021), fq. 27.
- 82 Intervistë me Musli Krasniqin, Drejtor për Media dhe Marrëdhënie me Publikun në Kuvendin e Kosovës, mars 2022.
- 83 Për më shumë shihni njoftimet e Kuvendit të Kosovës lidhur me aktivitetet në "Ditët e Kuvendit": <https://kuvendikosoves.org/shq/per-publikun/lajmi/ditet-e-kuvendit-ne-peje-deputete-te-ketij-ra-29048/#> ; <https://kuvendikosoves.org/shq/per-publikun/lajmi/aktiviteti-ditet-e-kuvendit-ne-gjake-depute-29423/>
- 84 Intervistë me Musli Krasniqin, Drejtor për Media dhe Marrëdhënie me Publikun në Kuvendin e Kosovës, mars 2022.
- 85 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 72.
- 86 Rregullorja e punës së Kuvendit të Kosovës, neni 129.
- 87 Rregullorja e punës së Kuvendit të Kosovës (2010), shtojca nr.3, pika 2.
- 88 Ligji Nr. 08/L-108 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave, neni 4, paragrafi 1.3; dhe nenet 7, 8, 9, 10 dhe 11.
- 89 Ligji Nr. 08/L-108 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave, neni 22.
- 90 Ligji për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetëve, neni 47, paragrafët 1 dhe 2.





91 Ligji Nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, neni 12.

92 Ligji Nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, neni 13.

93 Portali Radio Evropa e Lirë, dhjetor 2019, <https://www.evropaelire.org/amp/30309807.html>

94 Intervistë me Nur Çekun, zyrtar në Kuvendin e Kosovës, prill 2022.

95 Për më shumë, shihni faqen e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit: <https://pakorrupsion-rks.net/>

96 Për më shumë, shihni artikujt në media: Reporteri.Net, "Një deputet i LVV-së është dënuar vitin e kaluar nga gjykata për mosdeklarim të pasurisë" (gusht, 2023). Gjendet në: <https://reporteri.net/lajme/deputeti-i-vv-se-u-denua-vjet-nga-gjykata-se-nuk-e-deklaroi-pasurine/> [qasur më 6 nëntor 2023]; Bota-pers.info, "Nuk ka deklaruar pasurinë, dënohet ish-deputeti i LDK-së" (nëntor, 2021). Gjendet në: <https://botapress.info/nuk-e-deklaroi-pasurine-deno-het-ish-deputeti-i-ldk-se/> [qasur më 6 nëntor 2023]; Betimi Për Drejtësi, "8 zyrtarë publikë nuk e kanë deklaruar pasurinë në afatin e rregullt vjetor, pesë të tjerë kanë deklaruar pasurinë pas afatit" (prill, 2023). Gjendet në: <https://betimiperdrejtesi.com/8-zyrtare-publike-nuk-e-kane-deklaruar-pasurine-ne-afatin-e-rregullt-vjetor-5-te-tjere-e-deklaruan-pasurine-pas-afatit/> [qasur më 6 nëntor 2023]

97 Kushtetuta e Kosovës, nenet 7, dhe 71, paragrafi 2.

98 Ligji për Barazi Gjinore, neni 6, paragrafët 1, 2, 7 dhe 8.

99 Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme, neni 28, 111, paragrafi 6.

100 Portali Kallxo.com, mars 2021, <https://kallxo.com/lajm/kushtetuesja-vendos-per-rastin-e-tinka-kurtit-dhe-drita-millakut/>

101 Portali Kallxo.com, mars 2021, <https://kallxo.com/lajm/kushtetuesja-vendos-per-rastin-e-tinka-kurtit-dhe-drita-millakut/>

102 Portali Kallxo.com, mars 2021, <https://kallxo.com/gjate/karakteristikat-e-perberjes-se-re-te-kuvendit-te-kosoves/>

103 Platforma Vota Ime, e qasshme në: <http://www.votaime.org/Public/Article/Detail/494>

104 Rregullorja e punës së Kuvendit, neni 112, pika 4.

105 Portali Euronews Albania, shkurt 2020, <https://euronews.al/rajoni/2020/02/04/vjosa-osmani-zgjidhet-kryetare-e-kuvendit-te-kosoves/>

106 Platforma Vota Ime, e qasshme në: <http://www.votaime.org/Public/Commissions>

107 Intervistë me Shefki Kastratin, zyrtar i programit në NDI Kosova, mars 2022.

108 Ligji Nr.03/L –176 për Hetimin Parlamentar, neni 2, paragrafi 2; dhe neni 4, paragrafi 1.

109 Ligji Nr.03/L –176 për Hetimin Parlamentar, neni 2, paragrafi 3.

110 Intervistë me Nur Çekun, zyrtar në Kuvendin e Kosovës, prill 2022.

111 Klan Kosova, "Dështon për të gjashtë herë themelimi i Komisionit Hetimor për Rezervat Shtetërore" (nëntor, 2023). Gjendet në: <https://klankosova.tv/desh-ton-per-te-gjashten-here-konstituimi-i-komisionit-hetimor-per-rezervat-shtetere/> [qasur më 16 nëntor 2023]

112 Rregullorja e punës së Kuvendit, neni 80, 81 dhe 82.

113 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 136, pika 3 dhe neni 134, paragrafi 1.

114 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 139, pika 4.

115 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 100.

116 Agjenda për Reforma Evropiane – Raporti i monitorimit për vitin 2018, fq. 8.

117 Ligji Nr. 08/L-197 për Zyrtarët publikë, neni 69, paragrafi 1.5.

118 Agjenda për Reforma Evropiane – Raporti i monitorimit për vitin 2018, fq. 8.

119 Komisioni Evropian, "Raporti i Kosovës* – 2022", (tetor 2022), fq. 5. Gjendet në: <https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2022-10/Kosovo%20Report%202022.pdf>

120 Për më shumë shihni Koncept dokumentin për zhvillimin e procesit të Vetingut në sistemin gjyqësor. E qasshme në: <https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/09E907A6-06B2-4DBF-AB8B-E2793F4B9049.pdf>

121 EkonomiaOnline, "Dokumenti i Vetingut në Kuvend, Konjufca: Do të forcojë sistemin e drejtësisë në Kosovë" (shtator, 2022). Gjendet në: <https://ekonomia-online.com/dokumenti-i-vetingut-ne-kuvend-konjufca-do-ta-forcoje-sistemin-e-drejtësisë-ne-kosove/> [qasur më 22 nëntor 2023]

122 Për më shumë, shih Ligjin Nr. 08/L-122 për Financimin e Subjekteve Politike. E qasshme në: https://kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Documents/Ligjinr.08-L-122_4jntV3bwPs.pdf

123 Për më shumë shihni Projektligjin për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurive të Pajustificuara. E qasshme në: https://kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Documents/PLperByroneShtetereperverifdhekonfiskiminepasurisesepajustific_Mrtp4KujL.S.pdf

124 Për më shumë shihni Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 06/L – 057 për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve. E qasshme në: https://kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Documents/PLperndrysheLigjitperpërgjegjësinedisiplinoretegyqtarevedheprokurorëve_X6z45HMrMc.pdf

125 Për më shumë, shih Ligjin Nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit. E qasshme në: https://kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Documents/Ligjinr.08-L-017_sxT5abKCEv.pdf

126 Për më shumë, shih Ligjin Nr. 08/L-108 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurive dhe Dhuratave. E qasshme në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=61304>

127 Për më shumë shihni Projektligjin për Këshillin Prokurorial të Kosovës. E qasshme në: https://kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Documents/PLperndrysheligitperKeshillinProkurorialteKosoves_eeT2NHAJce.pdf

128 Për më shumë, shih Ligjin Nr. 08/L-167 për Prokurorin e Shtetit. E qasshme në: https://kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Documents/Ligjinr.08-L-167_L8dSNYXTj.pdf

129 Komisioni Evropian, "Raporti i Kosovës* – 2023", (nëntor, 2023), fq. 28. E qasshme në: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SWD_2023_692_Raporti_i_Kosovës.pdf

130 Evidenca e Ligjeve, e qasshme në: https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Documents/Evidencaeligjeve_ARXdwvuRh.pdf

131 Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit nr. 07/V-014 të Kuvendit të Republikës së Kosovës, datë 3 qershor 2020, për Zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës. E qasshme në: <https://gjk-ks.org/decision/vleresim-i-kushtetutshmerise-se-vendimit-te-kuvendit-te-republikes-se-kosoves-nr-07-v-014-te-3-qershorit-2020-per-zgjedhjen-e-qeverise-se-republikes-se-kosoves/>

132 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 136, pika 3 dhe neni 134, paragrafi 1.



133 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 139, pika 4.

134 Analizë e shkurtër: Tejkalmi i sfidave të Kuvendit përmes miratimit të Rregullores së re të punës nga "Instituti Demokratik i Kosovës" (2019) fq. 11.

135 Raporti për Kosovën i Komisionit Evropian për vitin 2021, fq. 9.


136 Analizë e shkurtër: Kuvendi që (s)mbikëqyrë ligje nga "Instituti Demokratik i Kosovës" (2019).

EKZEKUTIVI




PËRMBLEDHJE


Pushteti ekzekutiv në Kosovë është i pavarur dhe ushtrohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Qeveria funksionon në bazë të Kushtetutës, Ligjit për Qeverinë dhe Rregullores së Punës së Qeverisë.¹




Kapacitetet



Qeverisja



Roli





Presidenti i Kosovës ka kompetenca pasive ekzekutive lidhur me emërimin e ambasadorëve dhe emërimin e kreut të Agjencisë Kosovare të Inteligjencës, të ushtruara në koordinim dhe konsultim me Kryeministrin.^{2,3}

Kabineti qeveritar përbëhet nga kryeministri, tre zëvendëskryeministra dhe 15 ministra. Shtatë nga 15 ministrat në qeveri drejtohen nga gratë. Qeveria është autoriteti që drejton dhe menaxhon administratën publike dhe shtetërore.⁴ Që nga viti 2022, qeveria udhëhiqet nga Lëvizja Vetëvendosje dhe partia Lista Guxo, me kryeministër Albin Kurtin dhe zëvendës kryeministra Donika Gërvalla, Besnik Bislimi dhe Emilja Rexhepi.⁵

Qeveria është e qëndrueshme, ka qëndrueshmëri funksionale dhe pavarësia e saj nuk rrezikohet nga ndërhyrjet e jashtme.

Ka pasur një përmirësim të lehtë në transparencën e qeverisë, përkatësisht në Zyrën e Kryeministrit.⁶ Ligji për Qeverinë, i miratuar në vitin 2022, promovon transparencën dhe llogaridhënien e qeverisë.⁷ Megjithatë, Rregullorja e punës së Qeverisë ende i konsideron procesverbalet e qeverisë si konfidenciale.⁸

Edhe pse e ka shpallur prioritet, qeveria nuk është angazhuar në konsensus dhe dialog me akterët e tjerë institucionalë në luftën kundër korrupsionit, veçanërisht me partitë opozitare dhe Këshillin Gjyqësor dhe atë Prokurorial të Kosovës.

Për më tepër, megjithëse në vitin 2022 janë miratuar një sërë ligjesh që ndikojnë në luftën kundër korrupsionit, mbetet për t'u parë se sa efektive janë ato në praktikë.⁹ Pavarësisht nga shumë ligje të propozuara, vetë qeverisë i mungon një rregullore ligjore për të qeverisur integritetin e anëtarëve të saj dhe të kabinetit të kryeministrit.¹⁰ Nuk ka Kod të Etikës dhe Sjelljes për këta zyrtarë. Për më tepër, rregulloret ekzistuese janë të vjetruara dhe kanë nevojë për rishikim.



Kapacitetet

INDIKATORI 2.1.1 BURIMET (NË PRAKTIKË)

75/100



Qeveria ka burime të mjaftueshme financiare dhe njerëzore për të kryer shërbimet dhe aktivitetet e saj në mënyrë efektive. Megjithatë, dorëheqjet e fundit të zyrtarëve për shkak të pagave të ulëta, mungesës së stimulimit dhe vështirësisë së avancimit në karrierë krijojnë një mangësi në burimet njerëzore.

Shpenzimet buxhetore në vitin 2023 pritet të jenë rreth 3.2 miliardë euro, që shënon një rritje prej 17 për qind, ose rreth 464

milione euro, krahasuar me vitin 2022. Në buxhetin e vitit 2023 pritet një rritje më e shpejtë e shpenzimeve rrjedhëse sesa e shpenzimeve kapitale krahasuar me vitin 2022. Konkretisht, shpenzimet rrjedhëse pritet të rriten me 18 për qind krahasuar me vitin 2022 dhe shpenzimet kapitale me 15 për qind.¹¹

Sipas Zëvendës Sekretarit të Përgjithshëm në Qeverinë e Kosovës, aktualisht janë rreth 10.300 zyrtarë të buxhetuar në administratën shtetërore dhe publike. Megjithatë, vlerësohet se ka një mungesë prej rreth 2.500 pozitave në shërbimin civil në Kosovë në nivel qendror.¹² Megjithatë, në vitin 2021, disa zyrtarë publikë dhanë dorëheqjen nga pozicioni i tyre, duke përmendur pagat e ulëta si dhe pamundësinë për të avancuar në pozita. Madje ka pasur edhe grevë nga zyrtarët publikë për të kërkuar rritjen e pagave dhe zbatimin e sigurimeve shëndetësore.¹³ Sipas një analisti politikash nga organizata Demokracia Plus, kjo është kryesisht për shkak të pagave të ulëta, mungesës së njohjes për punën e tyre dhe vështirësisë së përparimit në karrierë brenda departamenteve qeveritare.¹⁴

Si përgjigje, në vitin 2022, Kuvendi i Kosovës miratoi¹⁵ projektligjin e ri për zyrtarët publikë¹⁶ dhe projektligjin për pagat në sektorin publik¹⁷ me qëllim të rregullimit adekuat të statusit të zyrtarëve publikë dhe pagat e tyre.

Tabela 2.1: Ndarja e buxhetit për qeverinë për periudhën 2018-2023

Viti	Shuma në €	% rritje e buxhetit
2023	2,344,870,119	10.2
2022	2,127,083,691	13.8
2021	1,868,935,619	12.3
2020	1,663,590,448	-1.0
2019	1,680,463,568	10.9
2018	1,515,929,819	





INDIKATORI 2.1.2 PAVARËSIA (SIPAS LIGJIT)

100/100



Ekzistojnë dispozita gjithëpërfshirëse që sigurojnë pavarësinë e ekzekutivit në vendimmarrje dhe që kufizojnë cenimin ose ndërhyrjen në degë të tjera të pushtetit. Në ushtrimin e pushtetit ekzekutiv, Qeveria mbështetet në Kushtetutën e Kosovës dhe Ligjin për Qeverinë.¹⁸

Sipas Kushtetutës, Qeveria është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve dhe politikave të shtetit dhe i nënshtrohet kontrollit parlamentar.¹⁹ Kushtetuta, përmes parimit të ndarjes së pushteteve, kufizon edhe ndërhyrjen e pushtetit në degët e tjera të pushtetit, duke përcaktuar se Kosova është një republikë demokratike e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe me kontrolle dhe balanca ndërmjet tyre.²⁰

Përveç Kushtetutës, ekziston edhe Ligji për Qeverinë e Kosovës, i miratuar në tetor 2022, i cili përcakton përgjegjësitë ekzekutive të qeverisë. Këto përfshijnë: propozimin e projekt-amendamenteve kushtetuese dhe projektligjeve në Kuvend; vendosjen për fillimin e marrëveshjeve ndërkombëtare; dhënien e mendimeve për nismat legjislative dhe projekt-amendamentet kushtetuese kur iniciator nuk është qeveria; propozimin dhe zbatimin e politikës së jashtme të vendit; marrjen e vendimeve dhe nxjerrjen e akteve të tjera ligjore të nevojshme për zbatimin e ligjeve; dhe vendosja për emërimet dhe shkarkimet brenda kompetencave të saj ligjore, ndër të tjera.²¹

Sipas Kushtetutës së Kosovës, duhet të ketë së paku një ministër nga komuniteti serb dhe një ministër nga ndonjë komunitet tjetër joshumicë në Kosovë. Nëse ka më shumë se dymbëdhjetë ministra, qeveria do të ketë edhe një ministër të tretë që përfaqëson një nga komunitetet joshumicë në Kosovë.²²

INDIKATORI 2.1.3 PAVARËSIA (NË PRAKTIKË)

100/100



Në praktikë, ekzekutivi gjatë ushtrimit të funksioneve të tij është i pavarur nga ndërhyrja e degëve të tjera të pushtetit.

Që nga viti 2021, ekzekutivi udhëhiqet nga Lëvizja Vetëvendosje e qendrës së majtë, ndërsa partia e qendrës së djathtë Guxo dhe partitë e tjera të komuniteteve jo-shumicë janë pjesë e kabinetit qeveritar, në përputhje me dispozitat kushtetuese (shih 2.1.2).²³

Në fakt, për shkak të autoritetit të fortë të kryeministrit dhe të qeverisë në tërësi, ka raste kur ka pasur tendencë që ata të ndërhyjnë në degë të tjera të pushtetit dhe jo e kundërta. Në vitin 2017 qeveria me vendim administrativ ka rritur pagën e kryeministrit dhe anëtarëve të qeverisë. Partitë opozitare dhe shoqëria civile e konsideruan këtë si një vendim arbitrar që cenon pavarësinë kushtetuese të Kuvendit. Mirëpo, në vitin 2018, Gjykata Kushtetuese e Kosovës, me aktgjykim të bazuar në bazueshmëri të rastit, konstatoi se vendimi i kryeministrit Haradinaj ishte kushtetues dhe nuk cenonte kompetencat e Kuvendit të Kosovës.²⁴

Nuk ka asnjë rast ku ligjvënësi, gjyqësori apo ndonjë pushtet tjetër të ketë ndërhyrë në punët dhe kompetencat e qeverisë.²⁵ Në fakt, mungon kontrolli apo mbikëqyrja efektive parlamentare e qeverisë (shih 1.3.1).

Sa i përket kuorumit dhe vendimmarrjes, qeveria është e qëndrueshme pasi udhëhiqet nga shumica e konsoliduar e një partie. Për shkak të këtij fakti, nuk ka rrezik ndërhyrjeje apo destabilizimi të qeverisë nga akterë të tjerë të jashtëm.²⁶



Qeverisja

INDIKATORI 2.2.1 TRANSPARENCA (SIPAS LIGJIT)

75/100



Ekzistojnë dispozita gjithëpërfshirëse që i mundësojnë publikut të marrë informacionin përkatës për organizimin dhe funksionimin e ekzekutivit, si dhe për vendimet përkatëse dhe mënyrën se si janë marrë ato. Megjithatë, ka një boshllëk sa i përket procesverbaleve të mbledhjeve të qeverisë, të cilat konsiderohen konfidenciale.

Sipas Ligjit për Qeverinë, dokumentet qeveritare duhet të jenë publike.²⁷ Megjithatë, megjithëse ligji nuk specifikon se cilat dokumente qeveritare janë konfidenciale, rregullorja e punës e qeverisë i konsideron procesverbalet nga mbledhjet e qeverisë si konfidenciale dhe ato nuk bëhen publike.²⁸

Ligji për Qeverinë e obligon ekzekutivin që të informojë publikun për aktivitetet e tij. Gjithashtu, kryeministri është i detyruar të informojë rregullisht mediet për veprimtarinë e tij dhe qeverinë.²⁹

Buxheti i Qeverisë publikohet në Gazetën Zyrtare të Kosovës dhe në ueb faqen e ministrisë brenda 30 ditëve pas miratimit nga Kuvendi dhe shpalljes nga Presidenti i Kosovës në formë gjithëpërfshirëse dhe të kuptueshme nga publiku, në gjuhët zyrtare të përdorura për dokumentet qeveritare.³⁰ Faqja e internetit gjithashtu duhet të mbulojë të gjitha lajmet, vendimet, dokumentet ligjore dhe nënligjore, si dhe informacionin mbi përbërjen e kabinetit qeveritar dhe strukturën e qeverisë. Aktivitetet tjera të qeverisë duhet të publikohen edhe në ueb faqen e Qeverisë së Kosovës.³¹

Të gjithë zyrtarët e lartë të qeverisë, duke përfshirë kryeministrin, zëvendëskryeministrat, ministrat dhe zëvendësministrat, duhet të deklarojnë pasurinë e tyre në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit.³² Agjencia është përgjegjëse për kontrollin dhe mbikëqyrjen e këtyre deklaratave (shih Shtyllën 10).³³ Sipas këtij ligji, të gjitha këto deklarime duhet të publikohen edhe në faqen e internetit të Agjencisë.³⁴

INDIKATORI 2.2.2 TRANSPARENCA (NË PRAKTIKË)

50/100



Edhe pse publiku mund të marrë informacione përkatëse për organizimin dhe funksionimin e ekzekutivit, transparenca në vendimmarrje është selektive. Procesverbalet e mbledhjeve të qeverisë vazhdojnë të jenë konfidenciale dhe gazetarët kanë ngritur shqetësimin se qeveria ose nuk ka adresuar pyetjet e tyre për çështje të ndryshme, ka dërguar përgjigjen e tyre me vonesë të konsiderueshme ose ka dërguar përgjigje joadekuate.

Faqja e internetit e qeverisë është aktive dhe funksionale.³⁵ Të gjitha aktivitetet e përditshme të Kryeministrit dhe qeverisë, struktura organizative e qeverisë,³⁶ informacioni për programin e qeverisë 2021-2025,³⁷ vendimet,³⁸ rregulloret dhe projektligjet e qeverisë publikohen në shqip, serbisht dhe anglisht.³⁹ Megjithatë, raporti vjetor i punës së qeverisë për vitin 2021 nuk është publikuar në faqen e internetit.⁴⁰

Gjithashtu, kryeministri dhe qeveria përdorin rrjetet sociale si Facebook⁴¹ për të publikuar aktivitetet e tyre.





Zyra e Komunikimit Publik përgatit, shpërndan dhe arkivon njoftimet për shtyp dhe njoftimet në gjuhët zyrtare.⁴² Në vitin 2022, kjo zyrë ka pranuar 91 kërkesa për qasje në dokumente publike, prej të cilave 86 janë miratuar, dy janë refuzuar dhe tri janë në proces përgjigje. Ndërkohë në vitin 2021 raportohet se janë pranuar 60 kërkesa për qasje në dokumente publike, nga të cilat 58 janë miratuar dhe dy janë refuzuar.⁴³

Qeveria ka disa zëdhënës për medie, por në faqen e qeverisë nuk ka asnjë informacion zyrtar për ta. Pavarësisht kësaj, gazetarët ankohen vazhdimisht për mungesë transparence nga Zyra e Kryeministrit dhe Qeveria⁴⁴ (shih 12.1.1 dhe 12.1.2). Procesverbalet e mbledhjeve të qeverisë vazhdojnë të jenë konfidenciale dhe pyetjet e gazetarëve shpesh mbeten pa përgjigje ose marrin përgjigje me vonësë ose në mënyrë joadekuatë nga qeveria dhe departamentet e saj.⁴⁵ Ekziston një mungesë transparence në lidhje me proceset e udhëhequra nga ekzekutivi, veçanërisht në lidhje me dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.⁴⁶ Për shembull, dokumentet në lidhje me dialogun me Serbinë, të cilat përfshijnë diskutimet dhe të gjitha marrëveshjet apo angazhimet e aritura që nga viti 2016 e deri më tani, nuk janë publikuar.⁴⁷ Ky problem rrjedh edhe nga konfidencialiteti i përcaktuar ligjërisht i procesverbaleve të qeverisë.

Buxheti bëhet publik dhe është i qasshëm në faqen e Ministrisë së Financave.⁴⁸ Në vitin 2018 ka përfunduar një proces gjyqësor lidhur me transparencën e shpenzimeve të qeverisë. Pas një beteje gjashtëvjeçare, gjykata vendosi se të gjitha shpenzimet e kabinetit qeveritar duhet të jenë transparente për publikun.⁴⁹

Anëtarët e qeverisë deklarojnë pasurinë e tyre edhe në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit. Deklaratat e pasurisë janë të qasshme për publikun.⁵⁰ Sipas raporteve të Agjencisë, mbi 97 për qind e zyrtarëve qeveritarë kanë deklaruar pasurinë e tyre për vitin 2021.⁵¹

**INDIKATORI 2.2.3
LLOGARIDHËNIA
(SIPAS LIGJIT)**

75/100



Ekzistojnë dispozita relativisht gjithëpërfshirëse që kërkojnë dhe sigurojnë raportimin dhe llogaridhënien e anëtarëve të ekzekutivit. Megjithatë, mungesa e llogaridhënies dhe mekanizmave sanksionues në rast shkeljesh përbën problem thelbësor në garantimin e llogaridhënies.⁵²

Sipas Kushtetutës, qeveria i nënshtrohet mbikëqyrjes dhe kontrollit parlamentar (shih Shtylla 1 Legjislativi).⁵³ Ligji për Qeverinë gjithashtu obligon kryeministrin dhe ministrat që me kërkesë të deputetëve ose me iniciativë të tyre t'i raportojnë Kuvendit dhe komisioneve parlamentare.⁵⁴

Megjithatë, legjislacioni nuk parasheh asnjë mekanizëm llogaridhënie apo sanksion për anëtarët e kabinetit nëse ata nuk i arsyetojnë vendimet e tyre. Rregullorja e Kuvendit nuk ka dispozita që do të sanksiononin anëtarët e qeverisë nëse nuk u përgjigjen pyetjeve parlamentare ose nuk marrin pjesë në mbledhjet e Kuvendit apo mbledhjet e komisioneve parlamentare për të raportuar për fushëveprimin e tyre.

Qeveria, sipas rregullores për standardet minimale për procesin e konsultimit publik, është e detyruar të konsultohet me publikun dhe grupet e veçanta, si organizatat e shoqërisë civile apo organizata të tjera, për përgatitjen e çdo projektligji apo të ndonjë strategjie kombëtare.⁵⁵

Ekziston edhe Zyra për Qeverisje të Mirë (ZQM), e cila është e detyruar të krijojë dhe mirëmbajë platformën online e cila përdoret nga të gjitha organet publike për të identifikuar palët e interesuara për zhvillimin e konsultimit publik.⁵⁶ ZQM ka nisur një kornizë për përmirësimin e zbatimit të standardeve minimale për konsultimet publike për periudhën 2021-




2025.⁵⁷ Bazuar në këtë kuadër, janë bërë rekomandime sesi institucionet duhet të përmirësojnë zbatimin e standardeve minimale për përfshirjen e të gjithë publikut në punën e tyre.⁵⁸

Për më tepër, në baza vjetore, qeveria i nënshtrohet një auditimi të pavarur nga Zyra Kombëtare e Auditimit në Kosovë.⁵⁹

Anëtarët e qeverisë mund të mbahen përgjegjës për shpërdorim detyre ose për kryerjen e një vepre penale. Anëtarët e qeverisë së Kosovës gëzojnë imunitet nga ndjekja penale, paditë civile dhe shkarkimi për veprime dhe vendime brenda fushëveprimit të përgjegjësive të tyre si anëtarë të qeverisë.⁶⁰ Megjithatë, nëse ata keqpërdorin autorizimet zyrtare, ata mund të shkarkohen nga posti i tyre dhe të ndiqen penalisht nga Prokuroria e Shtetit.⁶¹

**INDIKATORI 2.2.4
LLOGARIDHËNIA (NË
PRAKTIKË)**

50/100



Dispozitat ekzistuese janë vetëm pjesërisht efektive, sepse qeveria nuk arrin të paraqesë raportin e saj vjetor që adreson sugjerimet që rezultojnë nga konsultimet publike dhe ka pasur raste të mosndëshkimit të zyrtarëve të korrumpuar nga gjykata.

Mbikëqyrja parlamentare e ekzekutivit, veçanërisht zbatimi i ligjeve, mbetet e dobët.⁶² Qeveria nuk raporton mjaftueshëm në Kuvend për aktivitetet e saj. Qeveria nuk e ka dorëzuar raportin e saj vjetor të punës dhe performancës nga viti 2021 apo 2022 në Kuvend për vlerësim. Po kështu, nuk është vërejtur asnjë mbikëqyrje e rreptë parlamentare⁶³ e politikave apo progresit në punën e qeverisë.⁶⁴

Raportet e auditimit publikohen dhe përmbajnë rekomandime për gjetje të ndryshme, si p.sh. për shpenzimet bux-

hetore.⁶⁵ Gjetjet e këtij raporti si dhe shpenzimet e qeverisë i dërgohen Kuvendit, i cili ushtron rol mbikëqyrës nëpërmjet Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike.⁶⁶ Sipas zëvendës sekretarit të përgjithshëm në zyrën e kryeministrit, deri më tani nuk ka pasur raportime për ndërhyrje në punën e auditorëve.⁶⁷

Në vitin 2022, qeveria zhvilloi gjithsej 220 konsultime publike me publikun në lidhje me nismat legjislative.⁶⁸ Ekziston edhe një faqe elektronike ku qytetarët dhe grupet e interesit mund të dërgojnë komentet e tyre për projektligjet e paraqitura në procesin e konsultimit.⁶⁹ Megjithatë, sipas një analisti politikash nga organizata Demokracia Plus, nuk ka efektivitet në drejtim të adresimit të sugjerimeve apo komenteve të palëve të interesuara në këto konsultime publike.⁷⁰

Mekanizmat e ndjekjes penale të anëtarëve të ekzekutivit janë efektiv në rastet kur ka kallëzime penale apo akta-kuza ndaj ministrave dhe zyrtarëve të tjerë. Megjithatë, mosndëshkimi i zyrtarëve të përfshirë në korrupsion nga gjykata mbetet problem.⁷¹ Për shembull, në rastin e njohur si "Pronto", të gjithë të akuzuarit janë shpallur të pafajshëm.⁷² Po kështu, në rastin "veteranët" ku akuzoheshin zyrtarë të lartë shtetërorë, ata u shpallën të pafajshëm.⁷³ Të gjithë të akuzuarit janë shpallur të pafajshëm EDHE në rastin "Hidrocentralet".⁷⁴ Gjykata vazhdojnë të shqiptojnë dënime të ulëta në rastet kur akuzohen zyrtarë të lartë publikë. Shumica dërmuese e dënimeve janë me kusht ose me gjoba simbolike, megjithëse edhe në rastet kur shqiptohen dënime me burg, dënimet janë nën kufirin e poshtëm të dënimit të parashikuar dhe të akuzuarit lejohen të konvertojnë dënimet me burg në gjobë.⁷⁵





**INDIKATORI 2.2.5
INTEGRITETI (SIPAS LIGJIT)**

50/100



Edhe pse ekzistojnë dispozita të caktuara që rregullojnë integritetin e anëtarëve të qeverisë, ka ende një boshllëk të madh në lidhje me sanksionet në rast të shkeljeve për shkak të mungesës së kodit të etikës ose sjelljes që do të parashikonte sanksione të tilla.

Megjithëse ligji për qeverinë ka një dispozitë që thotë se anëtarët e qeverisë duhet t'i përmbahen kodit të sjelljes për anëtarët e qeverisë dhe të emëruarit e tyre, qeveria ende nuk ka miratuar një kod etike dhe sjelljeje për anëtarët e saj, dhe në mungesë ka një boshllëk ligjor sepse rregullat disiplinore për anëtarët e qeverisë nuk janë të përcaktuara me asnjë dokument tjetër.⁷⁶

Megjithatë, ka ligje që përcaktojnë kufizimet në lidhje me konfliktin e interesit dhe rregullat për pranimin e dhuratave.⁷⁷ Anëtarët e qeverisë gjithashtu nuk mund të ushtrojnë asnjë funksion tjetër publik, asnjë funksion të zgjedhur ose të emëruar jashtë detyrave të tyre zyrtare ose të realizojnë ndonjë punë tjetër të bazuar në kontratë, me përjashtim të qëllimeve të kërkimit ose mësimdhënies pas informimit me shkrim të Kryeministrit.⁷⁸

Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit përcakton më tej se një zyrtar i lartë nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi drejtues ose mbikëqyrës të subjekteve juridike private fitimprurëse në shoqëritë tregtare dhe OJQ-të.⁷⁹ Kufizime ka edhe për emërimet pas përfundimit të mandatit, duke përcaktuar një afat kohor prej dy vitesh në të cilin një zyrtar nuk ka të drejtë të drejtojë asnjë institucion publik ose të hyjë në marrëdhënie kontraktuale.⁸⁰

Që nga viti 2018 ka edhe një ligj për mbrojtjen e sinjalizuesve⁸¹ si dhe një rregullore për përcaktimin e procedurës për pranimin dhe trajtimin e rasteve të sinjalizimit, të cilat janë gjithëpërfshirëse dhe parashohin dispozita ligjore konkrete që mbrojnë sinjalizimin si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat.⁸²

**INDIKATORI 2.2.6
INTEGRITETI (NË PRAKTIKË)**

25/100



Në praktikë, rrallë ka ndonjë veprim që do të sigurojë integritetin e anëtarëve të ekzekutivit. Nuk ka kod të sjelljes dhe shkeljet eventuale mbesin kryesisht të pasanksionuara.

Në vitin 2022, disa ministra u hetuan dhe u akuzuan nga institucionet e drejtësisë për mosdeklarim të pasurisë.⁸³ Megjithatë, pavarësisht nisjes së hetimeve, qeveria nuk ka marrë asnjë masë ndaj tyre dhe ata vazhdojnë të ushtrojnë funksionet e tyre.

Qeveria nuk ka kod sjelljeje dhe nuk ka asnjë iniciativë për hartimin e një kodi të tillë. Ka pasur edhe raste kur anëtarët e kabinetit qeveritar emërohen në poste qeveritare në tranzicion ose kalojnë nga sektori i biznesit në poste ekzekutive. Rasti më i fundit është emërimi i Ministrit të Shëndetësisë,⁸⁴ i cili më parë ka qenë menaxher i një kompanie private shëndetësore.⁸⁵

Në vitin 2021, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit regjistroi raporte për 36 raste të konfliktit të interesit brenda ekzekutivit. Nga këto 36 raste, 20 mendime këshilluese janë dhënë nga Agjencia, nga të cilat nëntë janë sjellë në procedurë; në tre raste janë shmangur konfliktet e interesit; dhe në tre raste të tjera nuk u konstatua konflikt interesi.⁸⁶



Në praktikë, ka raste të izoluar të frikësimit ose sulmeve ndaj sinjalizuesve.⁸⁷ Përveç kësaj, ka mungesë të zbatimit efektiv të legjislacionit për sinjalizuesit.⁸⁸ Megjithëse institucionet qeveritare kanë emëruar zyrtarë sinjalizues, shumica e tyre ende nuk i kanë publikuar emrat e tyre në faqen e tyre të internetit.⁸⁹

**INDIKATORI 2.2.7
PËRFAQËSIMI GJINOR**

50/100



Ekzistojnë dispozita ligjore që sigurojnë përfaqësim të barabartë gjinor në Qeverinë e Kosovës. Megjithatë, nuk ka asnjë strategji apo trajnim për promovimin e barazisë gjinore dhe qeveria ka dështuar të dorëzojë raportin e kërkuar ligjërisht për programin për barazi gjinore.

Ligji për Qeverinë siguron që përbërja e kabinetit qeveritar të bazohet në përfaqësim të barabartë gjinor, gjë që duhet të merret parasysh gjatë rekrutimit dhe emërimeve në pozitat qeveritare.⁹⁰ Po kështu, ligji për barazinë gjinore kërkon që përfaqësimi gjinor të bazohet në një përqindje prej 50/50 për të dy gjinitë.⁹¹

Edhe pse qeverisë i mungon një strategji për të promovuar pjesëmarrjen e barabartë të grave në ekzekutiv, gratë aktualisht përbëjnë 40 për qind të Qeverisë së Kosovës.⁹² Gjashtë nga 15 ministratë në qeveri drejtohen nga gratë.⁹³ Veç kësaj, edhe presidentja e Kosovës është grua.⁹⁴ Sipas zëvendës sekretarit të përgjithshëm në zyrën e kryeministrit, nuk ka trajnime për gratë që janë aktualisht drejtuese të institucioneve.⁹⁵

Megjithatë, sipas një analisti politikash të intervistuar për këtë raport, kuota e nevojshme për përfaqësimin gjinor nuk është adekuate brenda të gjitha departamenteve qeveritare. Sipas tij, protokollet dhe udhëzimet e ndjeshme gjinore, aty

ku ekzistojnë, zbatohen vetëm pjesërisht dhe nuk janë në përputhje me standardet e barazisë gjinore. Për shembull, protokollet e zbatuara nga mekanizmat e ankesave dhe hetimit të sektorit publik nuk përfshijnë ndonjë politikë specifike të ndjeshme ndaj gjinisë.

Agjencia për Barazi Gjinore, në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, ka mandat të hartojë politikat e barazisë gjinore dhe të monitorojë zbatimin e tyre.⁹⁶ Agjencia, në koordinim me institucionet tjera, përgatit programin e Kosovës për barazi gjinore, të cilin ia dorëzon qeverisë për shqyrtim. Qeveria është e detyruar të raportojë në Kuvend për këtë program në baza vjetore.⁹⁷ Aktualisht, nuk ka asnjë provë se një raport i tillë është bërë në Kuvend,⁹⁸ dhe nuk ka asnjë raport apo dokument qeveritar për zbatimin e tij.⁹⁹





Roli

INDIKATORI 2.3.1 MENAXHIMI I SEKTORIT PUBLIK (SIPAS LIGJIT DHE NË PRAKTIKË)

50/100



Ekzekutivi është disi aktiv, por relativisht i pasuksesshëm, në zhvillimin e një sektori publik që qeveriset nga nivele të larta transparence, llogaridhënieje, integriteti dhe përfshirjeje. Administrata publike në Kosovë është e mbingarkuar, mungojnë reformat e nevojshme në fushën e digjitalizimit dhe ka pak zhvillim profesional.¹⁰⁰ Ekziston një proces i reformës së administratës publike, por ende nuk ka përfunduar.

Ekzekutivi ka mekanizma për të mbikëqyrur dhe menaxhuar punën e shërbimit civil, por në praktikë nuk është efektiv në kontrollin dhe mbikëqyrjen e administratës. Në nivelin hierarkik, ministrat i raportojnë Kryeministrit për punën e tyre, më pas sekretarët e përhershëm mbikëqyrin stafin e ministrisë që përfshin drejtorë dhe zyrtarë publikë.¹⁰¹ Administrata publike në Kosovë është e mbingarkuar, mungojnë reformat e nevojshme në fushën e digjitalizimit dhe ka pak zhvillim profesional.¹⁰² Megjithatë, sipas një analisti politikash të intervistuar për këtë raport, emërimet partiake në institucionet publike, stafi i tepruar i administratës dhe ndryshimet e shpeshta të qeverive, si dhe mungesa e një vlerësimi dhe kontrolli adekuat mbi performancën e zyrtarëve publikë, ka bërë që mbikëqyrja e punës së shërbimit civil në Kosovë të jetë joefektive.¹⁰³

Ekzekutivi nuk ka zhvilluar një protokoll që ofron stimuj për stafin civil për të kryer punën e tyre në mënyrë transparente



INDIKATORI 2.3.2 SISTEMI LIGJOR

75/100



Qeveria e udhëhequr nga Lëvizja Vetëvendosje ka nisur reformat për të avancuar ligjet për të parandaluar dhe luftuar korrupsionin. Megjithatë, ka vetëm sukses të kufizuar në ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit të profilit të lartë dhe Kosova vazhdon të karakterizohet me shkallë të lartë të korrupsionit.¹¹³ Kjo është kryesisht për shkak të vonësive të procedurave gjyqësore për shkak të mungesës së stafit.¹¹⁴

Në mars të vitit 2021, qeveria e udhëhequr nga Albin Kurti nga Lëvizja Vetëvendosje filloi reformimin e ligjeve për Agjencinë e Parandalimit të Korrupsionit, deklarin e pasurisë, Këshillin Prokuroral, Kodin e Procedurës Penale, financimin politik, vetingun, dhe Byronë për verifikimin dhe konfiskimin e pasurisë së pajustificuar.¹¹⁵

Megjithatë, kanë munguar përpjekjet për të kultivuar një frymë më bashkëpunuese dhe gjithëpërfshirëse me sistemin gjyqësor, në këtë rast KGJK-në, KPK-në dhe OSHC-të, si dhe për të përmirësuar komunikimin dhe koordinimin me këto institucione për të arritur rezultate efikase në zbatimin e strategjisë kundër korrupsionit në këto diskutime. Kjo ka sjellë si pasojë bojkotimin e disa proceseve nga opozita dhe institucionet e drejtësisë.¹¹⁶ Pa pjesëmarrjen e të gjitha institucioneve në këto nisma të rëndësishme, ato as nuk do të zbatohen dhe as do të përvetësohen si vlera.¹¹⁷

Sipas raportit të Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2022, vendi vlerësohet të ketë një kornizë adekuate ligjore në përputhje me standardet e kërkuara, por has në probleme thelbësore të zbatimit në praktikë. Kosova në vitin 2022 ka shënuar edhe mungesë të rezultateve konkrete në zgjidhjen e rasteve të korrupsionit të profilit të lartë, si dhe zvarritje të rasteve si pasojë e mungesës së kapaciteteve (shih 3.3.2). Kosovës i mungojnë rezultatet sa i përket hetimit dhe konfiskimit të pasurive të pajustificuara, edhe pse korniza ligjore që rregullon këtë çështje është relativisht e avancuar.¹¹⁸ Megjithatë, raporti vlerëson pozitivisht përkushtimin e Qeverisë së Kosovës për zbatimin e plotë të Opinionit të Komisionit të Venecias për koncept dokumentin për verifikimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në bashkëpunim të ngushtë me BE-në.¹¹⁹





Ndërveprimet

Qeveria ndërvepron me akterë të tjerë institucionalë në kryerjen e detyrave të saj, në zhvillimin e politikave shtetërore dhe gjithashtu në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit.¹²⁰

Qeveria në përgjithësi bashkëpunon me Kuvendin e Kosovës në krijimin e një kornize ligjore kundër korrupsionit pa mangësi apo zbrazëtira.¹²¹

Përveç Kuvendit, qeveria ndërvepron edhe me sistemin gjyqësor dhe prokurorial duke kërkuar ekspertizë profesionale në ngritjen e kapaciteteve dhe përmirësimin e legjislacionit kundër korrupsionit.¹²² Konkretisht, më 15 mars 2023 është nënshkruar një deklaratë e përbashkët e përkushtimit ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë, KGJK-së dhe KPK-së për krijimin e grupeve punuese me qëllim të përmirësimit të legjislacionit aktual, krijimit të reformave të reja ligjore që do të ndikojnë drejtpërdrejt në llogaridhënien, efikasitetin dhe transparencën e sistemin gjyqësor dhe prokurorial.¹²³

Ekzekutivi ndërvepron edhe me mediet, duke mbuluar punën, aktivitetin dhe performancën e qeverisë në përgjigje të kërkesave për rritjen e transparencës së ekzekutivit nëpërmjet raporteve mediatike dhe informimit publik për vendimmarrjen në interes publik.¹²⁴

Gjyqësori dhe ekzekutivi ndërveprojnë përmes krijimit të grupeve punuese profesionale me të cilat realizohen proceset e reformave ligjore në legjislacionin kosovar, ku promovohet transparenca, llogaridhënia dhe efikasiteti i sistemit gjyqësor në Kosovë.¹²⁵ Ky proces përfshin plotësimin, qartësimin dhe ndryshimin e kornizës ligjore në Kosovë me theks të veçantë në fusha të tilla si procesi i vlerësimit të performancës dhe disiplinës së gjyqtarëve dhe prokurorëve si dhe zhvillimi profesional i tyre, dhe hartimi i ligjit për shërbyesit civilë për stafin profesional të gjykatave dhe prokurorive.¹²⁶

Megjithatë, mungesa e koordinimit për reformat në sistemin e drejtësisë, si procesi i vetingut, apo ndërhyrjet e ekzekutivit në uljen e pagave për gjyqtarët dhe prokurorët,¹²⁷ ka dëshmuar se pavarësisht vullnetit të ekzekutivit për të çuar përpara nismat e tij, mungesa e dialogut ka bërë që ekzekutivi të injorohet dhe të shpëputet veprimtarinë e sistemit gjyqësor.¹²⁸

Rekomandimet e shtyllës

- Të miratohet një Kod Etike dhe Sjelljeje për anëtarët e kabinetit qeveritar që përcakton rregullat për parimet e punës dhe sjelljes së anëtarëve të kabinetit qeveritar si dhe rregullat për disiplinimin dhe sanksionimin e këtyre anëtarëve në rastet kur ata kryejnë veprime të pahijshme dhe jo të duhura e të jashtëligjshme gjatë ose pas orarit të punës.
- Ndryshimi i Rregullores së Qeverisë, përkatësisht nenit 23, ku procesverbali i mbledhjes së qeverisë nuk duhet të konsiderohet konfidencial siç është aktualisht. Qeveria duhet ta harmonizojë këtë rregullore me ligjin për qeverinë, ligjin për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar dhe ligjin për qasje në dokumente publike. Nëpërmjet rregullores, duhet të përcaktohen qartë kriteret specifike se çfarë përbën një dokument konfidencial për punën e qeverisë.
- Reduktimi i ndërhyrjeve në punën e institucioneve të pavarura kushtetuese, veçanërisht në sistemin gjyqësor dhe prokurorial, përmes nismave ligjore për uljen e pagave të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Qeveria gjithashtu duhet të ndalojë praktikën e mos miratimit të plotë të kërkesave buxhetore të KGJK-së dhe KPK-së, por të respektojë legjislacionin për menaxhimin e financave publike që kërkon që kërkesat buxhetore të institucioneve të pavarura gjyqësore të respektohen dhe miratohen kur ato të dorëzohen brenda afati ligjor.



REFERENCAT

- 1 Ligji Nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, botuar në Gazetën Zyrtare (Prishtinë: Nëntor 2022).
- 2 Kushtetuta e Kosovës, neni 84 (Prishtinë: Qershor 2008).
- 3 Sipas Kushtetutës së Kosovës, neni 4: Presidenti i Republikës së Kosovës përfaqëson unitetin e popullit. Presidenti i Republikës së Kosovës është përfaqësues legjitim i vendit, brenda dhe jashtë vendit dhe është garantues i funksionimit demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës, siç parashihet në këtë Kushtetutë. Ai ka kompetenca pasive ekzekutive në disa raste që kanë të bëjnë me emërimin e ambasadorëve dhe emërimin e shefit të inteligjencës kosovare, por të gjitha këto i ushtron në koordinim dhe konsultim me kryeministrin e qeverisë së Kosovës. Për më shumë, shih nenet 84, 85 dhe 86 të Kushtetutës së Kosovës. (15 qershor 2008).
- 4 Ligji për Qeverinë e Republikës së Kosovës, neni 2.
- 5 Shih Kuvendi i Kosovës, vendimi për zgjedhjen e qeverisë, 22 mars 2022. https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/SessionFiles/2021_03_25_VendimperzgjedhjenQeverisesKosoves22.03.2021_rYexDNvAC6.pdf
- 6 Për më shumë, shihni artikullin e Gazetës Blic. <https://gazetabolic.com/kurti-kosova-shenon-progres-ne-qeverisje-digjitale/> [qasur më 9 janar 2024]
- 7 Sipas Ligjit për Qeverinë, neni 17: Qeveria informon publikun për punën e saj, duke siguruar një sistem koherent dhe të koordinuar për të komunikuar me publikun për politikën dhe aktivitetet e saj. Zëvendëskryeministrat dhe ministrat e Qeverisë ose zëdhënës të tyre sigurojnë që mediet të jenë të informuara rregullisht për aktivitetet e tyre. Dokumentet qeveritare janë publike, me përjashtim të dokumenteve që klasifikohen sipas ligjit përkatës për klasifikimin e informacionit.
- 8 Shih Rregulloren nr. 09/2011 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, neni 23 (12 dhjetor 2011).
- 9 Shih ligjin nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=6059>, si dhe Projektligjin nr. 08/L-187 për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit nr. 08/L-032 të procedurës penale, Projektligji nr. 08/L-188 për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit Penal nr. 06/L-074 i Republikës së Kosovës, Projektligji nr. 08/L-168 për Prokurorinë Speciale, Projektligji nr. 08/L-167 për Prokurorin e Shtetit, Projektligji nr. 08/L-136 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, Projektligji nr. 08/L-121 për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurive të Pajustificueshme të publikuar në faqen e Kuvendit të Kosovës: <https://kuvendikosoves.org/shq/projektligjet-dhe-ligjet/>
- 10 Intervistë me Visar Rushitin, analist i politikave në organizatën Demokracia Plus, nëntor 2022.
- 11 Instituti GAP, 'Projektbuxheti 2023, Analiza e të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore', fq. 3-4, (GAP: Prishtinë, dhjetor, 2022).
- 12 Intervistë me Arben Krasniqin, Zëvendës Sekretar i Përgjithshëm në Qeverinë e Kosovës, dhjetor 2022.
- 13 Portali Kallxo.com, tetor 2022, <https://kallxo.com/lajm/pas-me-shume-se-nje-muaji-pezuullohet-greva-ne-administraten-publike/> [qasur më 13 prill 2023].
- 14 Intervistë me Visar Rushitin, analist i politikave në organizatën Demokracia Plus, nëntor 2022.
- 15 Gazeta Nacionale.com, dhjetor 2022, <https://nacionale.com/politike/kuvendi-miraton-projektligjin-per-paga>, [qasur më 22 dhjetor 2022]
- 16 Projektligji për Zyratë Publike, i propozuar nga Qeveria e Kosovës. Gjetet në: https://kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Documents/PLperzyrtaret-publik_mmuNTr6dxc.pdf [qasur më 21 dhjetor 2022]
- 17 Projektligji për paga në sektorin publik, i propozuar nga Qeveria e Kosovës. Gjetet në: https://kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Documents/PLperpagatnesektorinpublik_vst84ChuzA.pdf [qasur më 21 dhjetor 2022]
- 18 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 4, paragrafi 4. (Qershor 2008).
- 19 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 92, paragrafi 3.
- 20 Kushtetuta e Kosovës, neni 4.
- 21 Ligji për Qeverinë e Republikës së Kosovës, neni 8, paragrafi 4.
- 22 Kushtetuta e Kosovës, neni 96, paragrafi 3
- 23 Kushtetuta e Kosovës, neni 96, paragrafi 3.
- 24 Gjykata Kushtetuese e Kosovës, Lënda nr. KO 12/18, më 11 qershor 2018, Ref. Nr.: AGJ 1258/ 18.
- 25 Intervistë me Visar Rushitin, analist i politikave në organizatën Demokracia Plus, nëntor 2022.
- 26 Intervistë me Visar Rushitin, analist i politikave në organizatën Demokracia Plus, nëntor 2022.
- 27 Ligji nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, neni 17, paragrafi 5.
- 28 Rregullorja Nr. 09/2011 për Punën e Qeverisë së Republikës së Kosovës, neni 23, paragrafi 2.
- 29 Ligji për Qeverinë e Republikës së Kosovës, neni 17.
- 30 Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, neni 42.
- 31 Udhëzimi administrativ për ueb faqet e institucioneve publike, neni 9.
- 32 Ligji për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe dhuratave, neni 4, paragrafi 1 pika 1.4.
- 33 Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, <https://www.akk-ks.org/agjencia/41/prgjegjsit/41> [qasur më 30 nëntor 2022]
- 34 Ligji për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe dhuratave, neni 12, paragrafi 1.
- 35 Faqja e internetit e qeverisë së Kosovës, <https://kryeministri.rks-gov.net/en/documents/> [qasur më 2 dhjetor 2022]
- 36 Shihni gjithashtu: <https://kryeministri.rks-gov.net/en/prime-minister/government-cabinet/> [qasur më 6 qershor 2023]
- 37 Shih faqen e internetit të qeverisë së Kosovës: <https://kryeministri.rks-gov.net/en/blog/legislative-programme-for-the-year-2023-5/>, [qasur më 6 qershor 2023]
- 38 Shihni tek Qeveria e Kosovës, faqen e internetit: <https://kryeministri.rks-gov.net/en/documents/> [qasur më 6 qershor 2023]



|||||

- 115 Në fakt, disa nga këto ligje tashmë kanë kaluar në Kuvendin e Kosovës në leximin e parë dhe të dytë. Për shembull, Ligji për KPK-në tashmë ka kaluar në lexim të dytë, por është kontestuar në Gjykatën Kushtetuese. Tashmë janë miratuar dhe kanë hyrë në fuqi edhe ligjet si ai për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit dhe Ligji për Deklarimin e Pasurisë. Ndër të tjera, në lexim të parë janë miratuar ndryshimet në kodin e procedurës penale, në kodin penal dhe në ligjet për prokurorinë speciale dhe ligjin për Byronë shtetërore për verifikimin dhe konfiskimin e pasurisë së pajustificuar.
- 116 Portali Express, nëntor 2021, www.gazetaexpress.com/kpk-dhe-kqjk-bojkotojne-vettingun-ne-ministrine-e-drejtise-thone-se-do-te-vazhdojne-me-reformen/ [qasur më 13 dhjetor 2022]
- 117 KDI, dhjetor 2022, <https://kdi-kosova.org/aktivitetet/kdi-immunizimi-ndaj-korrupsitet-parakusht-per-nje-shoqeri-pa-korrupsiti/> [qasur më 14 dhjetor 2022]
- 118 Shih Grupi për Studime Juridike dhe Politike: Çfarë thuhej në Raportin për Kosovën? - Analiza dhe rekomandime për fushat kryesore (GLPS: Prishtinë, tetor 2022).
- 119 Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën për vitin 2022 (tetor 2022).
- 120 Portali Paparazzi, shtator 2022, <https://paparaci.com/195044/dorezothed-dosja-e-vettingut-ne-kuvend/> [qasur më 15 dhjetor 2022]
- 121 Shih po ashtu portalin Shqip.com, shtator 2022, <https://shqip.com/dosja-per-vettingun-ne-drejtise-dorezohet-ne-kuvend/> [qasur më 12 maj 2023]
- 122 Faqja e internetit e Ministrisë së Drejtësisë, <https://md.rks-gov.net/page.aspx?id=2,15,2540>. [qasur më 14 dhjetor 2022]
- 123 Shih: Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Mars 2023, "Nënshkruhet një deklaratë e përbashkët e përkushtimit për reformën në drejtësi ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë, Këshillit Prokurorial, Këshillit Gjyqësor dhe Gjykatës" gjendet në: <https://www.gjyqesori-rks.org/2023/03/14/nenshkruhet-deklarat-e-perbashket-e-zotimit-per-reformen-ligjore-ne-sistemin-e-drejtise-ne-mes-te-ministrise-se-drejtise-keshillit-gjyqesor-te-kosoves-keshillit-prokurorial-te-kosoves-gjykates/> [qasur më 12 maj 2023]
- 124 Shih portalin Nacionale.com, maj 2023, <https://nacionale.com/politike/qeveria-e-kosoves-falenderon-gazetaret-per-bashkepunimin-dhe-raportimin-e-punes> [qasur më 12 maj 2023]
- 125 Shih: Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Mars 2023, "Nënshkruhet një deklaratë e përbashkët e përkushtimit për reformën në drejtësi ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë, Këshillit Prokurorial, Këshillit Gjyqësor dhe Gjykatës" [qasur më 12 maj 2023]
- 126 Shih gjithashtu faqen e internetit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës: 10 maj 2023, <https://www.gjyqesori-rks.org/2023/05/10/mblidhen-gru-pet-punuese-per-reformen-ne-drejtisi/> [qasur më 12 maj 2023] Në këtë takim u diskutua për rëndësinë e bashkëpunimit ndërinstitucional në kuadër të reformës në drejtësi, si dhe për rezultatet e punës që priten brenda afateve të përcaktuara. Të pranishmit u pajtuan edhe për afatet optimale dhe fillimin e punës në drejtësi të përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga "Deklarata për Reformën në Drejtësi".
- 127 Faqja e internetit e Levizja FOL, nëntor 2022, <http://levizjafol.org/shoqeria-civile-ulja-e-gave-per-sistemin-e-dhritesise-presents-interference-in-dhritesi-dhe-rrit-potentialin-korrupsie/> [qasur më 15 dhjetor 2022]
- 128 Portali Telegrafi, nëntor 2021, www.gazetaexpress.com/kpk-dhe-kqjk-bojkotojne-vettingun-ne-ministrine-e-drejtise-thone-se-do-te-vazhdojne-me-reformen/ [qasur më 15 dhjetor 2022]

|||||


GJYQËSORI

> |> > >< <><> ><> > ><>


PËRMBLEDHJE

Sistemi gjyqësor i Kosovës përbëhet nga Gjykatat Themelore, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme. Gjykatat themelore janë gjykatat e shkallës së parë në shtatë komunat më të mëdha – Prishtinë, Gjiilan, Prizren, Gjakovë, Pejë, Ferizaj dhe Mitrovicë.


71/100 Rezultati i përgjithshëm i shtyllës




Kapacitetet



Qeverisja



Roli





Gjykata e Apelit është gjykata e shkallës së dytë në Prishtinë, përgjegjëse për shqyrtimin e ankesave të bëra kundër vendimeve të Gjykatave Themelore dhe përcaktimin e konflikteve të kompetencës lëndore. Gjykata Supreme është gjykata më e lartë, përgjegjëse për gjykimin e rasteve që kanë të bëjnë me kërkesat për mjete të jashtëzakonshme juridike kundër vendimeve të formës së prerë të gjykatave të Kosovës. Gjithashtu është krijuar një Gjykatë Komerciale për të gjykuar rastet e kontesteve ekonomike. Gjykata Kushtetuese e Kosovës vendos edhe për përputhshmërinë kushtetuese të ligjeve, vendimeve dhe akteve ligjore.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) është autoriteti kushtetues dhe kompetent për emërimin, rekrutimin dhe riemërimin e gjyqtarëve. Këshilli menaxhon funksionimin e sistemit gjyqësor në tërësi dhe mbikëqyr punën e gjykatave dhe gjyqtarëve.

Ekzistojnë ligje gjithëpërfshirëse për të siguruar buxhete adekuate gjyqësore dhe paga të gjyqtarëve. Megjithatë, nuk ka asnjë detyrim ligjor për një buxhet minimal apo rregullim të inflacionit për gjyqësorin. Buxheti i gjyqësorit është rritur në krahasim me vitet e mëparshme, por qeveria nuk i ka miratuar plotësisht kërkesat buxhetore, duke çuar në mungesë të burimeve teknike dhe njerëzore. Për më tepër, qeveria u përpoq të ulë pagat e gjyqtarëve, duke shkelur pavarësinë kushtetuese të gjyqësorit. Megjithatë, Këshilli ka vazhduar me rekrutimin e gjyqtarëve dhe bashkëpunëtorëve të rinj.

Ligjet në përgjithësi sigurojnë raportimin nga gjyqtarët, por atyre u mungojnë sanksionet e përcaktuara për mosdhënien e arsytimit ligjor dhe nuk parashohin mbrojtje për ankuesit. Ndryshimet për përmirësimin e këtij ligji janë duke u zhvilluar. Në praktikë, sanksionet zbatohen rrallë, KGJK-ja është reaguese dhe jo proaktive, dhe ende nuk ka pasur një rast të shkarkimit të gjyqtarit për performancë të dobët. Ekziston Kodi i Etikës gjithëpërfshirës për gjyqtarët, por i mungojnë dispozitat për rimbursimet ose kompensimet në lidhje me udhëtimet e sponsorizuara privatisht.

Nuk ka udhëzime të qarta apo personel të dedikuar për trajtimin e ndjeshmërisë gjinore brenda sistemit gjyqësor. Çështjet gjinore nuk janë të integruara në asnjë akt të brendshëm nënligjor apo përshtkrim të punës.

Përderisa Gjykata Themelore në Prishtinë është efikase në zgjidhjen e rasteve, ajo nuk merr domosdoshmërisht vendime efektive që mbështesin ligjshmërinë. Kjo është e evidente në prapësimin dhe rivendosjen e shpeshtë të lëndëve nga gjykatat më të larta. Pavarësisht pretendimit të gjyqësorit se është i përkushtuar për të luftuar korrupsionin, rezultatet aktuale nuk janë inkurajuese. Dënimet janë shpesh të buta dhe jo shumë raste të profilit të lartë shohin zgjidhje të kënaqshme. Për shkak të paaftësisë së tij për të trajtuar rastet e korrupsionit që përfshijnë politikanë të nivelit të lartë, gjyqësori perceptohet të jetë i ndikuar politikisht. Ka mungesë të të dhënave gjithëpërfshirëse dhe të detajuara, veçanërisht lidhur me korrupsionin dhe ndihmën e ndërsjellë juridike.

Procesi i vettingut me ndryshimet kushtetuese për krerët e sistemit gjyqësor dhe prokurorial nisi në vitin 2021.¹ Qeveria dhe Kuvendi kanë përgatitur amendamentet kushtetuese të cilat i janë dërguar Gjykatës Kushtetuese për interpretim nëse këto amendamente reduktojnë apo cenojnë të drejtat e njeriut të garantuara nga kreu 2 i Kushtetutës.²

Gjithashtu në pritje të përfundimit është edhe amendamenti i ligjit për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe krijimi i Gjykatës Administrative dhe Gjykatës së Punës me ligje të veçanta.³



Kapacitetet



INDIKATORI 3.1.1 BURIMET (SIPAS LIGJIT)

75/100



Ligje gjithëpërfshirëse kërkojnë të sigurojnë burime të mjaftueshme në lidhje me buxhetin e gjyqësorit dhe pagat e gjyqtarëve. Megjithatë, nuk ka asnjë përqindje minimale ligjore apo rregullim inflacioni për buxhetin e gjyqësorit nga buxheti i shtetit.

KGJK-ja propozon dhe mbikëqyr buxhetin për gjyqësorin.⁴ Këshilli përgatit dhe plotëson qarkoren buxhetore të Ministrisë së Financave, e cila parasheh të gjithë planifikimin buxhetor brenda një viti kalendarik dhe shumë të buxhetit brenda afatëve kalendarikë të parashikuara me ligjin për menaxhimin e financave publike. Ministria e Financave nuk mund ta ndryshojë këtë propozim buxhet nëse dorëzohet brenda afatit dhe kufijtë e shpenzimeve janë përcaktuar në qarkoren buxhetore vjetore.⁵ Asnjë dispozitë ligjore nuk e detyron qeverinë të ndajë një përqindje të caktuar të buxhetit ekskluzivisht për gjyqësorin, madje as në lidhje me rritjen e inflacionit.⁶

Pagat në gjyqësor janë të rregulluara në bazë të ligjit të gjykatave.⁷ Ligji për gjykatat parasheh që paga e gjyqtarëve të caktohet sipas një krahasimi në përqindje me pagën e kryetarit të Gjykatës Supreme. Kështu, sipas ligjit, kryetari i Gjykatës Supreme merr pagë të barabartë me Kryeministrin, ndërsa gjyqtarët e Gjykatës Supreme marrin pagë jo më të lartë se 90 për qind e pagës së kryetarit të Gjykatës Supreme. Pagat në gjyqësor mund të rriten përfundimisht nëse paga e kryeministrit rritet. Korniza ligjore i mbron gjyqtarët nga çdo ulje e paga-ve, përveç sanksioneve disiplinore të vendosura nga KGJK-ja.⁸



Megjithatë, qeveria ka propozuar ndërkohë që Parlamenti ka miratuar një ligj të ri për pagat e sektorit publik, duke përfshirë rregullimin e pagave të gjyqtarëve. Ky ligj, i cili parasheh uljen e pagave për gjyqtarët dhe prokurorët, tashmë është kundërshtuar në Gjykatën Kushtetuese nga Avokati i Popullit të Kosovës,⁹ pasi janë paraqitur shumë ankesa nga institucionet lidhur me përmbajtjen e tij.¹⁰



INDIKATORI 3.1.2 BURIMET (NË PRAKTIKË)

75/100



Gjyqësori ka burime dhe buxhet deri diku të mjaftueshëm për të kryer aktivitetet e tij, por në praktikë kërkesat e tij buxhetore nuk miratohen plotësisht nga qeveria. Trajnimi për rastet e lidhura me korrupsionin gjithashtu nuk është i mjaftueshëm.

Buxheti për gjyqësorin ndahet nga qeveria e Kosovës, përkatësisht Ministria e Financave, dhe miratohet nga Kuvendi i Kosovës.¹¹ Buxheti¹² kryesisht shpenzohet për paga, shtesa, mallra dhe shërbime. Për vitin 2022, KGJK-ja ka kërkuar një buxhet prej 38 milionë euro për gjyqësorin, por qeveria ka ndarë vetëm 32 milionë euro, 6 milionë euro më pak se sa është kërkuar.¹³ Sipas kryetarit të KGJK-së, buxheti për gjyqësorin është i pamjaftueshëm dhe nuk i plotëson plotësisht kërkesat e Këshillit Gjyqësor. Këtë e ka mbështetur një hulumtues i lartë nga Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD), i cili thekson se kërkesat buxhetore të Këshillit nuk janë miratuar plotësisht nga qeveria.¹⁴



Tabela 3.1: Buxheti vjetor i KGJK-së

VITI	Buxheti total në € i kërkuar	Buxheti total në € i pranuar	Rritja e buxhetit të pranuar në % në vit
2023	40,526,397.00	34,155,572.00	6.13
2022	38,623,576.84	32,183,896.00	10.24
2021	36,294,571.32	29,194,592.00	-2.1
2020	35,471,334.97	29,821,540.00	1.42
2019	33,356,016.04	29,404,466.00	

Pagat e gjyqtarëve rriten sipas hierarkisë. Paga e kryetarit të Gjykatës Supreme nuk është më e vogël se ajo e Kryeministrit. Paga e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme është jo më pak se 90 për qind e pagës së kryetarit të Gjykatës Supreme.¹⁵

Prandaj, pagat e gjyqtarëve aktualisht janë të mjaftueshme për kryerjen e detyrave të tyre. Megjithatë, Ligji i ri për Pagat i miratuar në vitin 2022 nga Kuvendi i Kosovës parasheh një ulje prej 30 deri në 40 për qind të pagave të gjyqtarëve,¹⁶ që është dekurajuese dhe mund të ndikojë në pavarësinë financiare të gjyqësorit¹⁷ dhe të rriten gjasat e korrupsionit brenda gjyqësorit.¹⁸

Sipas të intervistuar nga IKD-ja për këtë raport, burimet njerëzore të shërbyesve civilë në gjyqësor janë të pamjaftueshme dhe jo shumë stabile. Gjithashtu, sipas Kryesuesit të KGJK-së,¹⁹ shumica e gjyqtarëve kanë vetëm një zyrar ligjor dhe shpesh punojnë me praktikantë ose zyrtarë të tjerë që mbulojnë punën e dy ose tre gjyqtarëve.²⁰ Megjithatë, në nëntor 2022, Këshilli rekrutoi 74 bashkëpunëtorë profesionalë të cilët pritet të përmirësojnë efikasitetin e gjykatave.²¹

KGJK-ja vazhdimisht rekruton gjyqtarë të rinj,²² bashkëpunëtorë profesionalë dhe zyrtarë administrativë për të promovuar punë efikase për të zvogëluar ngarkesën me lëndë.²³ Gjyqtarët ndjekin trajnime në Akademinë e Drejtësisë në fusha të tilla si përmirësimi i arsyetimit ligjor të aktven-

dimeve, menaxhimi i gjykatës dhe trajtimi efikas i lëndëve gjyqësore.²⁴ Megjithatë, duke analizuar sasinë e trajnimeve për korrupsionin në planin e punës dhe performancës së akademisë 2022, mund të vlerësohet se ky trajnim është i pamjaftueshëm dhe ka nevojë për trajnime më të shpeshta dhe jo vetëm tri seanca në dy ditë në vit, për t'u marrë me lëndët e korrupsionit.²⁵

Në gjykatat e Kosovës nuk ekziston një bibliotekë e specializuar për të mbështetur gjyqtarët dhe stafin me hulumtime ligjore për hartim më të mirë të aktvendimeve. Pajisjet kompjuterike nuk janë moderne dhe seancat gjyqësore shpesh dështojnë për shkak të problemeve me teknologjinë. Procesi gjyqësor zhvillohet me mbajtje manuale të procesverbalit për shkak se nuk ka regjistrim audio, transkriptim apo video incizim të seancave gjyqësore.²⁶



**INDIKATORI 3.1.3
PAVARËSIA (SIPAS LIGJIT)**

100/100



Legjislacioni që garanton funksionimin e pavarur të gjyqësorit kundër ndërhyrjeve të jashtme është gjithëpërfshirës dhe i mjaftueshëm. Kushtetuta e Kosovës përcakton se pushteti gjyqësor është unik, i pavarur, i drejtë dhe jopolitik dhe siguron qasje të barabartë në gjykata.²⁷

Gjykata Supreme është autoritet kushtetues fushëveprimtarie e së cilës rregullohet me Kushtetutë por edhe me Ligjin për Gjykatat.²⁸ Ndryshimi i Kushtetutës për të ndryshuar organizimin e gjyqësorit është i vështirë pasi kërkon miratimin e dy të tretave të deputetëve të shumicës dhe pakicës në Kuvend.²⁹

Gjyqtarët në Republikën e Kosovës emërohen nga Presidenti i Kosovës në bazë të propozimit të KGJK-së.³⁰ Procesi i emërimit fillon me themelimin e komisionit të rekrutimit nga KGJK-ja, i cili përbëhet nga pesë anëtarë të rregullt dhe dy anëtarë rezervë, të cilët zgjidhen me konkurs të hapur. Komisioni përbëhet nga tre anëtarë nga radhët e këshillit, dy nga gjykatat dhe dy nga anëtarët rezervë, të gjithë juristë nga radhët e gjyqësorit.³¹

Emërimet e kandidatëve për gjyqtarë bazohen në kritere të qarta dhe janë të përcaktuara me ligj.³² Para se të emërohen, gjyqtarët i nënshtrohen një provimi që përfshin testimin kualifikues, testimin me shkrim dhe intervistat me gojë.³³

Pasi gjyqtarët kalojnë fazën fillestare të emërimit, ata riemërohen me mandat të përhershëm deri në pension, gjë që garanton siguri nga ndikimet e jashtme, si kërcënimet për shkaputjen e kontratave të tyre.³⁴

Gjyqtarët në Kosovë mund të shkarkohen vetëm nëse dënohen për ndonjë veprë të rëndë penale dhe shkelje të detyrës. Procesi për shkarkimin e gjyqtarëve është i ngjashëm me atë të emërimit, ku KGJK-ja bën propozimin për shkarkim dhe Presidenti vendos për shkarkimin. Para se gjyqtari të propozohet për shkarkim, KGJK-ja themelon një panel hetimor për të përcaktuar nëse gjyqtari ka kryer shkelje të rëndë të detyrave të punës apo ndonjë veprë penale, raporti i panelit hetimor më pas i dorëzohet Këshillit për të mbështetur propozimin specifik për shkarkim.³⁵

Pavarësia nga ndikimet e jashtme mbrohet me Ligjin për Gjykatat dhe Kodin e Etikës Profesionale të gjyqtarëve. Kodi i Etikës Profesionale për gjyqtarët përcakton rregullat e sjelljes për gjyqtarët dhe informon publikun për sjelljen që pritet nga gjyqtarët.³⁶


Mbledhjet e KGJK-së dhe procedurat e zhvilluara për testimin dhe vlerësimin e kandidatëve për gjyqtarë rregullohen sipas Ligjit për Këshillin Gjyqësor,³⁷ Ligjit për Gjykatat,³⁸ dhe Rregullores për Rekrutimin, provimin, emërimin dhe riemërimin e gjyqtarëve.³⁹





INDIKATORI 3.1.4 PAVARËSIA (NË PRAKTIKË)

50/100



Gjyqësori shpesh ballafaqohet me ndërhyrje të jashtme që janë zakonisht deklarata publike nga drejtues të institucioneve të ndryshme. Në praktikë, pavarësia e gjyqësorit kufizohet edhe nga ndërhyrjet e qeverisë që përcaktojnë buxhetin për gjyqësorin, si dhe nga ulja e pagave të gjyqtarëve (shih 3.1.1 & 3.1.2)⁴⁰ nëpërmjet vendimeve administrative.⁴¹ Gjyqësori gjithashtu perceptohet të jetë i ndikuar politikisht⁴² për shkak të mungesës së trajtimit të duhur të lëndëve të korrupsionit, veçanërisht kur përfshihen zyrtarë të rangut të lartë.⁴³

Gjyqtarët në Kosovë emërohen në bazë të kriterëve të qarta profesionale⁴⁴ përmes konkursit publik të shpallur nga KGJK-ja. Një raport monitorues i vitit 2021 nga Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) dhe Internews Kosova thekson se në vitin 2021, 141 gjyqtarë iu nënshtruan vlerësim-it të performancës nga KGJK-ja dhe të dhënat tregojnë se asnjëri prej tyre nuk ka rezultuar me vlerësim “të dobët” për të nisur më pas ndonjë procedurë disiplinore ose shkarkim ndaj tyre.⁴⁵

Propozimet për shkarkimin e gjyqtarëve para përfundimit të mandatit të tyre janë të rralla.⁴⁶ Sa herë që ka pasur propozime të tilla, KGJK-ja e ka arsyetuar vendimin e saj.⁴⁷ Ka raste kur gjyqtarët janë transferuar dhe degraduar në detyrë për shkak të përmbajtjes së vendimeve të tyre.⁴⁸

Vendimet për transferim dhe degradim burojnë nga një proces hetimor disiplinor i kryer nga KGJK-ja, bazuar në vlerësimin e performancës dhe efikasitetit të gjyqtarëve në zgjidhjen e rasteve.⁴⁹

Deri më tani, Gjykata Supreme nuk është përballur me ndonjë ndryshim ligjor që ka ndryshuar apo ka ndërhyrë në kompetencat dhe mënyrën e funksionimit të saj.⁵⁰

Këshilli është i pavarur dhe efikas në kryerjen e aktiviteteve të tij. Këshilli cakton edhe komisionin përkatës për rekrutimin e gjyqtarëve të rinj dhe ky komision ka mandatin të organizojë procedurën e rekrutimit të gjyqtarëve të rinj.⁵¹

Megjithatë, rastet e korrupsionit, si “Pronto”,⁵² “Veteranët”,⁵³ “Vizat”,⁵⁴ dhe “Hidrocentralet”,⁵⁵ ku shumë zyrtarë të rangut të lartë janë hetuar dhe të gjitha kanë përfunduar me lirime dhe pa asnjë dënim (shih 3.3.2), kanë ushqyer perceptimin në Kosovë se sistemi gjyqësor nuk i dënon politikanët e akuzuar për korrupsion.

Për më tepër, sulmet verbale si nga qeveria apo drejtuesit e institucioneve publike janë të zakonshme.⁵⁶ Për shembull, në vitin 2021, Ministria e Drejtësisë e quajti “skandaloz dhe të padrejtë” vendimin e gjyqtarëve të Gjykatës në Pejë lidhur me një rast vrasjeje.⁵⁷



Qeverisja

INDIKATORI 3.2.1 TRANSPARENCA (SIPAS LIGJIT)

100/100



Ekzistojnë dispozita gjithëpërfshirëse që i lejojnë publikut të marrë informacion mbi organizimin dhe funksionimin e gjyqësorit, mbi vendimet që kanë të bëjnë me të dhe se si merren këto vendime.

Ligji për KGJK-në dhe Ligji për Gjykatat përmbajnë dispozita të mjaftueshme që kërkojnë nga gjyqësori të bëjë publike të gjitha informacionet, duke përfshirë gjykimet,⁵⁸ statistikën mbi rastet e trajtuara, seancat dhe aktivitetet e tjera.⁵⁹ Legjislacioni përkatës gjithashtu kërkon që të gjitha aktivitetet e KGJK-së, të cilat kanë të bëjnë edhe me emërimin,⁶⁰ transferimin dhe shkarkimin e gjyqtarëve,⁶¹ të bëhen publike.⁶²

Përveç kësaj, sipas Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, termat dhe kushtet se kur informacioni nga institucionet publike, duke përfshirë gjyqësorin, duhet të bëhen publike janë të përcaktuara në detaje. Neni 6 thekson se institucionet publike duhet të publikojnë në mënyrë proaktive të gjitha dokumentet publike brenda 15 ditëve nga momenti kur bëhen të qasshme.⁶³

KGJK-ja ka nxjerrë disa akte, si rregulloren për emërimin e gjyqtarëve,⁶⁴ Rregulloren për vlerësimin e punës së gjyqtarëve⁶⁵ dhe rregulloren për punën dhe organizimin e brendshëm të gjykatave,⁶⁶ të cilat sqarojnë se të gjitha informacionet për aktivitetet e gjyqësorit duhet të bëhen publike.



Ekzistojnë gjithashtu dispozita ligjore që kërkojnë që gjykimet të jenë publike. Kushtetuta e Kosovës garanton shqyrtimin gjyqësor publik për çdo person.⁶⁷ Po kështu, Kodi i Procedurës Penale kërkon rishikim gjyqësor publik.⁶⁸

INDIKATORI 3.2.2 TRANSPARENCA (NË PRAKTIKË)

75/100



Në përgjithësi, publiku mund të marrë lehtësisht informacion mbi aktivitetet gjyqësore, por mbledhjet e Këshillit ku diskutohen dhe shqyrtohen ankesat disiplinore kundër gjyqtarëve janë të mbyllura për publikun.

KGJK-ja ka një faqe zyrtare interneti ku publikohen periodikisht raportet e rregullta, aktivitetet mbi shpenzimet dhe vendimmarrja.⁶⁹ Këto raporte përfshijnë të dhëna për raportet vjetore të punës⁷⁰ dhe statistika të ndryshme për trajtimin e çështjeve gjyqësore dhe zgjidhjen e tyre nga gjykatat e niveleve të ndryshme. Përveç kësaj, publikohen informacione në lidhje me aktivitetet e KGJK-së⁷¹, duke përfshirë takimet, vendimet disiplinore dhe informacione të tjera.⁷² Në faqen e internetit të KGJK-së, ekziston gjithashtu një platformë e hapur e të dhënave e cila i ofron publikut të gjerë dhe çdo përdoruesi të internetit qasje në statistikat gjyqësore rreth punës së gjykatave dhe gjyqtarëve në Kosovë.⁷³

Të gjitha degët e gjykatave kanë edhe faqe interneti funksionale ku qytetarët mund të kenë qasje në trajtimin e lëndëve, publikimin e vendimeve dhe orarën e seancave gjyqësore.⁷⁴



Sa i përket orarit të seancave, jo të gjithë gjyqtarët i bëjnë publike seancat e tyre, veçanërisht oraret e seancave në Departamentin Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë,⁷⁵ të cilat publikohen shumë rrallë.⁷⁶

Faqja e internetit e KGJK-së është mjaft aktive dhe kushdo që dëshiron informacione për emërimin, transferimin dhe shkarkimin e gjyqtarëve, mund t'i qaset lehtësisht disa prej këtyre vendimeve.⁷⁷ Problematike mbetet vetëm situata me vendimet disiplinore pasi KGJK-ja i publikon emrat e gjyqtarëve që i nënshtrohen kësaj procedure krejt në fund të procesit. Edhe mbledhjet ku diskutohen këto çështje mbahen të mbyllura.

**INDIKATORI 3.2.3
LLOGARIDHËNIA
(SIPAS LIGJIT)**

75/100



Në përgjithësi ekzistojnë dispozitat të mjaftueshme ligjore që garantojnë dhe sigurojnë raportimin e gjyqtarëve për punën e tyre. Megjithatë, ka disa mangësi sa i përket mungesës së përcaktimit të sanksioneve⁷⁸ për gjyqtarët që nuk japin arsyetimin ligjor për një vendim gjyqësor,⁷⁹ si dhe faktit që ankuesit nuk mbrohen shprehimisht me ligj.

Kushtetuta e Kosovës⁸⁰ kërkon që të respektohet parimi i gjyqimit të drejtë dhe të arsyeshëm duke kërkuar nga gjyqtarët të shpjegojnë arsyetimin e tyre për çfarëdo vendimi që marrin.⁸¹ Ka disa nivele ku mund të parashtrohen ankesa kundër gjyqtarëve, duke filluar nga KGJK-ja, e cila është instanca kryesore përmes së cilës gjyqtarët mbikëqyren dhe mbahen përgjegjës.⁸²

Edhe pse Ligji për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve përfshin aftësinë e arsyetimit ligjor në kriteret e vlerësimit për punën e gjyqtarit, ligji nuk parasheh shprehimisht asnjë sanksion⁸³ për gjyqtarët që nuk ofrojnë arsye ligjore për

një vendim gjyqësor.⁸⁴ Ligji gjithashtu nuk përmban ndonjë dispozitë të veçantë për mbrojtjen e ankuesve, qofshin ata persona fizikë apo juridikë.

Prej prillit 2022, ky ligj po i nënshtrohet procedurës së ndryshim-plotësimit nga Ministria e Drejtësisë pasi ka nevojë për përmirësim.⁸⁵

Sipas Kushtetutës, të gjithë gjyqtarët gëzojnë imunitet nga ndjekja penale, paditë civile dhe shkarkimi nga detyra për vendimet e marra, votimet, mendimet e shprehura dhe veprimet e tjera të kryera në kuadër të detyrave dhe përgjegjësi të tyre si gjyqtarë.⁸⁶

Gjyqtarët nuk gëzojnë imunitet nëse shkelin rëndë detyrën e punës ose kryejnë vepra penale. Mund të shqiptohen masa disiplinore, si p.sh. ulje page prej 50 për qind⁸⁷, transferim i përkohshëm ose i përhershëm në një nivel më të ulët (ulje në detyrë) ose largim nga puna.⁸⁸ KGJK-ja është i vetmi autoritet që merr masa të tilla, shqipton vendime disiplinore dhe propozon shkarkimin e gjyqtarëve⁸⁹ në Kosovë.⁹⁰

**INDIKATORI 3.2.4
LLOGARIDHËNIA
(NË PRAKTIKË)**

50/100



Dispozitat ekzistuese janë vetëm pjesërisht efektive në sigurimin e llogaridhënies së gjyqtarëve për punën e tyre. KGJK-ja ka më shumë gjasa të veprojë sa herë që ka raste që ngjallin më shumë presion publik sesa kur ngritet një rast disiplinor për gjyqtarët që kryejnë veprime në kundërshtim me ligjin.⁹¹

Sipas një organizate që monitoron sistemin e drejtësisë, në praktikë, gjyqtarët shpesh japin arsye për vendimet e tyre,



por ato nuk kuptohen lehtë nga palët. Arsyet për vendimet gjyqësore bazohen gjithashtu në një shabllon dhe priren të përshkruajnë rrjedhën e proceseve gjyqësore.⁹² Shumë vendime përmbajnë pak analiza ligjore dhe janë larg standardeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.⁹³

Sanksionet ndaj gjyqtarëve për mosarsyetim të vendimit nuk zbatohen në praktikë. Një arsyezim i paqartë ose jo i plotë që mbështet një vendim gjyqësor zakonisht ankimohet në një shkallë më të lartë gjyqësore nga palët e prekura, gjë që mund të rezultojë në anulimin e vendimit. Megjithatë, nuk ka masa konkrete disiplinore për gjyqtarët që nuk arsyetojnë ose nuk arsyetojnë në mënyrë adekuate vendimet e tyre.⁹⁴

Në bazë të legjislacionit, Këshilli është i pavarur, por jo efektiv në praktikë.⁹⁵ Kjo pasi deri më tani nuk ka asnjë rast që KGJK-ja t'i ketë propozuar Presidentit të vendit shkarkimin e një gjyqtari për shkak të performancës së dobët në punë. Komisionet disiplinore të krijuara nga KGJK-ja nuk kanë qenë efektive në shqiptimin e masave disiplinore ndaj gjyqtarëve që kryejnë veprime të pahijshme. Shumica e vendimeve janë ose ulje e pozicionit, transferim në një departament tjetër ose një ulje 50 për qind e pagës për një periudhë të caktuar.⁹⁶

KGJK-ja ka Komisionin për Vlerësimin e Performancës së Gjyqtarëve.⁹⁷ Në vitin 2021, ky komision vlerësoi 139 gjyqtarë, nga të cilët 25 u vlerësuan "mirë", 90 "shumë mirë", 24 "shkëlqyeshëm", ndërsa asnjë gjyqtar nuk pati rezultat vlerësimi "të dobët".⁹⁸ Deri më tani, nuk ka pasur raste të shkarkimit të një gjyqtari për performancë të dobët.⁹⁹

Gjatë vitit 2022, Komisioni ka shënuar performancë më të dobët se në vitin 2021 në lidhje me nxjerrjen e vendimeve disiplinore për gjyqtarët. Në të njëjtën periudhë, KGJK-ja ka nxjerrë 12 vendime të formës së prerë,¹⁰⁰ krahasuar me 16 në vitin 2021.¹⁰¹

Edhe pse në vitin 2021 asnjë gjyqtar nuk u vlerësua me notë "të dobët", gjyqësori vazhdon të jetë joefektiv në trajtimin e lëndëve të korrupsionit. Ka, për shembull, raste të korrupsionit për të cilat parashkruhen vepra penale,¹⁰² por i akuzuari dënohet me kusht dhe gjobë¹⁰³ ose është liruar plotësisht nga aktakuza.¹⁰⁴

**INDIKATORI 3.2.5
MEKANIZMAT E
INTEGRITETIT (SIPAS LIGJIT)**

75/100



Ekzistojnë mekanizma ligjor që garantojnë integritetin e anëtarëve të sistemit gjyqësor të Kosovës. Megjithatë, Kodi i Etikës Profesionale për gjyqtarët nuk rregullon aspektet e rimbursimeve, arkëttimeve ose kompensimit në lidhje me udhëtimet e sponsorizuara privatisht aty ku është e nevojshme.¹⁰⁵

Kodi i Etikës Profesionale për gjyqtarët përcakton rregullat e sjelljes profesionale. Çdo shkelje e këtyre rregullave përbën shkelje disiplinore.¹⁰⁶ Kodi përcakton se gjyqtarët duhet të sillen me profesionalizëm, integritet dhe paanshmëri¹⁰⁷ në jetën e tyre profesionale dhe personale.¹⁰⁸

Gjyqtarët janë të obliguar të deklarojnë pasurinë e tyre edhe në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit. Në raportin e publikuar nga Agjencia, më shumë se 99 për qind e gjyqtarëve kishin deklaruar pasurinë e tyre.¹⁰⁹

Kodi i Etikës është mjaft gjithëpërfshirës dhe i ndalon gjyqtarët të marrin kompensim dhe honorare ose të pranojnë dhurata të çdo lloji¹¹⁰ gjatë ushtrimit të detyrave të tyre si gjyqtarë.¹¹¹ Kodi lejon angazhimin e gjyqtarëve jashtë orarit të punës si ligjerues ose trajnerë nga aktiviteti i të cilit ata mund të kenë të ardhura deri në 25 për qind të pagës së tyre.¹¹² Gjithashtu, Kodi parasheh që gjyqtari nuk do të lejojë që interesat financiare apo familja e ngushtë të cenojnë integritetin e funksionit të ushtruar.¹¹³

Ekziston edhe një ligj për parandalimin e konfliktit të interesit, i cili ndalon përfshirjen e gjyqtarëve në veprime që bien ndesh me këtë ligj.¹¹⁴ Ky ligj i ndalon gjyqtarët të kërkojnë dhe






të pranojnë dhurata, shpërblime ose ndonjë përfitim tjetër për veten ose personat e tjerë,¹¹⁵ dhe gjithashtu ndalon përfshirjen dhe angazhimin në punë të tjera që mund të cenojnë paanshmërinë e tyre.¹¹⁶

Gjyqtarët nuk kanë asnjë kufizim në lidhje me angazhimin e tyre në sektorin publik apo privat pas largimit nga gjyqësori. I vetmi kufizim është kur dalin në pension dhe nuk mund të emërohen më në poste publike.¹¹⁷

Nëse qytetarët e vërejnë paanshmërinë ose joprofesionalizmin e gjyqtarit gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre apo edhe jashtë funksioneve të tyre, ata mund të ankohen në KGJK dhe autoritetet tjera kompetente, si kryetarët e gjykatave dhe Avokati i Popullit.¹¹⁸

Si zyrtarë publikë, gjyqtarët janë të detyruar të deklarojnë pasurinë e tyre në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit çdo vit prej 1 mars deri më 31 mars¹¹⁹ për vitin paraprak (1 janar deri më 31 dhjetor).¹²⁰ Deklaratat e pasurisë duhet të jenë të disponueshme për çdo institucion dhe publikun dhe janë të qasshme¹²¹ në faqen e internetit të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.¹²²

**INDIKATORI 3.2.6
MEKANIZMAT E
INTEGRITETIT (NË PRAKTIKË)**



Megjithëse ekzistojnë rregullore dhe Kodi i Etikës, në praktikë, ato nuk zbatohen në mënyrë efektive për të kryer hetime më proaktive për shkeljet nga ana e të gjyqtarëve, për të sanksionuar sjelljen e pahijshme ose për të mbështetur trajnimin e rregullt të stafit për çështjet e integritetit.¹²³

Sipas Raportit të BE-së për Kosovën 2022,¹²⁴ edhe pse ka një rritje më të madhe të aplikimit të masave disiplinore ndaj



gjyqtarëve krahasuar me vitet e kaluara, KGJK-së i duhet punë e zellshme për të siguruar zbatimin konsistent dhe efektiv të procedurave disiplinore kundër gjyqtarëve.¹²⁵

Vendimet disiplinore të Këshillit janë kryesisht të buta, duke përfshirë vërejtjet me shkrim jo-publike, vërejtjet me shkrim publike, një ulje të përkohshme të pagës prej 50 për qind për një vit ose një transferim të përkohshëm në një gjykatë më të ulët. Ka pak pezullime dhe asnjë propozim për shkarkimin e gjyqtarëve.¹²⁶

KGJK-ja siguron pajtueshmërinë me Kodin e Etikës. KGJK-ja gjithashtu ka një Komision Këshillëdhënës për Etikën Gjyqësore, i cili i ndihmon gjyqtarët me këshilla për trajtimin e situatave apo sjelljeve të mundshme që mund të konsiderohen në kundërshtim me Kodin e Etikës Profesionale për Gjyqtarët.¹²⁷

Gjithashtu mungon trajnimi i rregullt dhe i shpeshtë i stafit për integritetin. Në vitin 2022, ishte planifikuar vetëm një seancë trajnimi për integritetin dhe sjelljen etike për stafin e administratës gjyqësore.¹²⁸ Në praktikë, kjo është e pamjaftueshme dhe nuk shërben për të ndërtuar siç duhet kapacitetet dhe vetëdijesimin e stafit të gjykatës për integritetin.

Gjyqtarët deklarojnë pasurinë e tyre edhe në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit. Në vitin 2022 nuk është raportuar asnjë rast në të cilin gjyqtarët nuk kanë deklaruar pasurinë apo që ndaj tyre janë marrë masa.¹²⁹ Ndonëse ka prova që në vitin 2021 dy gjyqtarë nuk kanë deklaruar pasurinë brenda afatit ligjor,¹³⁰ nuk ka raportime për ndonjë masë ndaj tyre.

Shkeljet disiplinore të gjyqtarëve hetohen dhe trajtohen nga KGJK-ja. KGJK-ja ka një komision për vlerësimin e performancës së gjyqtarëve dhe KGJK-ja merret me çdo ankesë kundër një gjyqtari.¹³¹ KGJK-ja themelon Panelet Hetimore që kryejnë hetime nëse janë të qëndrueshme pretendimet e ankuesve.¹³²

Qytetarët kanë mundësinë në praktikë të kundërshtojnë paanshmërinë e gjyqtarit në çdo situatë ku ata besojnë se gjyqtari është ndikuar ose është sjellë në mënyrë joprofesionale. KGJK-ja ofron formularin përkatës të ankesës që qytetarët mund ta plotësojnë dhe paraqesin kur bëjnë ankesë.¹³³

Aktualisht, faqja e internetit e KGJK-së¹³⁴ raporton se këtë vit janë dorëzuar 95 ankesa disiplinore kundër gjyqtarëve¹³⁵, prej të cilave 29 janë në shqyrtim.¹³⁶



**INDIKATORI 3.2.7
GJINIA**



Gjyqësorit në Kosovë i mungojnë protokollet dhe udhëzimet e qarta për ndjeshmërinë gjinore. Ka disa të dhëna të ndara sipas gjinisë.

Pavarësisht rregullimit të përfaqësimit gjinor të përcaktuar me Kushtetutë¹³⁷ dhe Ligjin për Barazinë Gjinore,¹³⁸ asnjë akt nënligjor i brendshëm i sistemit gjyqësor nuk e përmend integritimin e elementit gjinor në dokumentet dhe politikat e tyre.¹³⁹

Nuk ka persona të dedikuar përgjegjës për çështjet gjinore në sistemin gjyqësor dhe çështjet që lidhen me gjininë, të drejtat e njeriut,¹⁴⁰ dhe mosdiskriminimin nuk përfshihen në asnjë përshtkrim pune në sistemin gjyqësor.¹⁴¹

Në raportin vjetor të KGJK-së nuk përmendet trajnimi i detyrueshëm për përfshirjen gjinore për gjyqtarët apo personelin administrativ në sistemin gjyqësor.¹⁴²

Përveç kësaj, nuk ka asnjë raportim të të dhënave të ndara sipas gjinisë në lidhje me numrin e ankesave të pranuar, as ndonjë raportim të të dhënave të ndara sipas gjinisë në lidhje me kohën e përpunimit të ankesave të marra ose të hedhura poshtë.¹⁴³

Megjithatë, KGJK-ja ka krijuar Sistemin Informativ për Menaxhimin e Lëndëve (SMIL), i cili ofron statistika të ndjeshme gjinore për palët procedurale gjyqësore.¹⁴⁴ Të dhënat e publikuara në platformën e të dhënave të hapura zbulojnë se rreth 132,000 burra dhe 36,000 gra kanë qenë palë në gjykatat e vendit si të pandehur, paditës, të pandehur dhe të dëmtuar.¹⁴⁵ Megjithatë, asgjë konkrete nuk specifikon se sa ankesa janë pranuar nga gra apo burra.





Roli



INDIKATORI 3.3.1 MBIKËQYRJA E EKZEKUTIVIT

75/100



Gjyqësori ushtron mbikëqyrje efektive mbi vendimet ekzekutive. Megjithatë, ka raste të rrëzuara nga Gjykata Themelore ku organi administrativ përkatës thjesht ka përsëritur të njëjtin vendim.

Gjykata Themelore e Prishtinës, Departamenti për Çështje Administrative ka juridiksion për kontrollin dhe shqyrtimin e këtyre vendimeve nga organet administrative ekzekutive, të cilat janë përfundimtare. Kjo gjykatë vendos për të gjitha rastet e konfliktit administrativ që rrjedhin nga vendimet e organeve ekzekutive.¹⁴⁶

Aktgjykimet e Gjykatës Themelore të Prishtinës që prishin vendimet përmbarimore janë të zbatueshme kur ato marrin formë të prerë; megjithatë, këto vendime të gjykatave të Prishtinës nuk janë shumë efektive në vërtetimin e ligjshmërisë.¹⁴⁷ Kjo për shkak se në shumicën e rasteve gjykatat e larta thjesht rrëzojnë dhe rivendosin lëndët në organet përkatëse administrative, por nuk vendosin si ta zgjidhin çështjen në fjalë në mënyrë efektive.¹⁴⁸

Edhe “Betimi për Drejtësi” në vitin 2021 ka raportuar se si rreth 40 për qind e lëndëve janë kthyer në rigjykim nga Gjykata e Apelit në Kosovë. Gjithashtu, për disa çështje tregohet se përfundimi i tyre është zgjatur me rigjykimet të shpeshta dhe se gjykata e shkallës së dytë, Gjykata e Apelit, edhe pse ka të drejtë t’i gjykojë vetë këto lëndë, i kthen vazhdimisht në rigjykim.¹⁴⁹

Në praktikë, sa herë që vendimet ekzekutive prishen dhe rivendosen, organet administrative shpesh përsërisin të njëjtin vendim, pavarësisht nga konstatimet e gjykatës.¹⁵⁰ Për shembull, në rastin e uljes së pagave të gjyqtarëve në një vendim administrativ ekzekutiv, Gjykata vendosi të pezullojë këtë vendim deri në zgjidhjen efektive të çështjes (shih 3.1.1).¹⁵¹

Sipas të dhënave të raportuara për punën e gjykatave për vitin 2022, departamenti administrativ i Gjykatës Themelore në Prishtinë ka pranuar rreth 2,933 lëndë të tilla, nga të cilat kjo gjykatë ka zgjidhur ose mbyllur 2,463 lëndë.¹⁵²

Në bazë të përqindjes së lëndëve të përfunduara, rreth 84 për qind e lëndëve zgjidhen brenda një viti nga kjo gjykatë, dhe në këtë mënyrë, të dhënat tregojnë efikasitetin në proces, por jo domosdoshmërisht në cilësinë e këtyre vendimeve.



INDIKATORI 3.3.2 GJYKIMI I KORRUPSIONIT

50/100



Ndërsa gjyqësori kërkon të penalizojë shkelësit në rastet e lidhura me korrupsionin, përpjekjet e tij janë të kufizuara dhe shpesh të pasuksesshme. Gjyqësori është kryesisht reagues në kontributin e tij në luftën kundër korrupsionit dhe zakonisht nuk propozon reforma kundër korrupsionit.

Në parim, gjyqësori është i përkushtuar për të luftuar korrupsionin duke trajtuar raste të tilla, por sfidë mbetet politika e butë ndëshkuese për rastet e korrupsionit të profilit të lartë. Ka gjithashtu mungesë të vendimeve gjyqësore të formës së prerë që ndëshkojnë efektisht me burgim zyrtarët e



akuzuar për korrupsion, si dhe mungesë të vendimeve për konfiskimin e pasurisë.¹⁵³

Gjatë vitit 2021, sipas një raporti monitorues të BIRN-it dhe Internews Kosova, nga 108 lëndë të korrupsionit, 22 kanë rezultuar me burgim, 31 me gjobë, gjashtë lëndë janë dënuar me kusht, 26 me pafajësi, katër me aktgjykim refuzues dhe 19 lëndë të tjera me një përfundim tjetër.¹⁵⁴

KGJK-ja nuk ofron të dhëna të veçanta për rastet e korrupsionit. Të gjitha statistikat e dhëna janë të përgjithshme dhe bazohen në numrin e përgjithshëm të lëndëve të pranuar dhe numrin e lëndëve të zgjidhura, të kategorizuara sipas natyrës së tyre penale, civile ose administrative.¹⁵⁵

KGJK-ja merr pjesë në grupet punuese për ndryshimin apo hartimin e çdo ligji që ka të bëjë me sistemin e drejtësisë duke ofruar sugjerime dhe ekspertizë në lidhje me luftën kundër korrupsionit.¹⁵⁶ Megjithatë, KGJK-ja ka refuzuar të bashkëpunojë me Ministrinë e Drejtësisë për reformat që kanë të bëjnë me procesin e vetingut në Kosovë.¹⁵⁷ Sipas KGJK-së, ata nuk e mbështesin këtë reformë përmes ndryshimeve kushtetuese dhe kanë sqaruar se nuk do të jenë pjesë e asnjë grupi punues që përfshin hartimin e ligjit të vetingut.

Sa u përket lëndëve të pastrimit të parave, vërehet një mungesë efikasiteti nga ana e gjyqësorit në trajtimin e këtyre lëndëve. Në vitin 2021, vetëm Gjykatat Themelore të Prishtinës dhe Prizrenit janë marrë me lëndë të kësaj natyre. Gjykata e Prishtinës ka pasur gjithsej nëntë lëndë, prej të cilave vetëm një e ka zgjidhur dhe atë me lirim. Gjykata e Prizrenit është marrë me një lëndë për të cilën ende nuk ka vendim përfundimtar.¹⁵⁸ Kjo tregon mungesën e efektivitetit të gjyqësorit në ndëshkimin e këtyre veprave penale.¹⁵⁹

Sipas drejtorit të Departamentit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar të Ministrisë së Drejtësisë, autoritetet gjyqësore bashkëpunojnë mjaftueshëm me agjencitë e huaja të zbatimit të ligjit duke iu përgjigjur, ofruar dhe marrë menjëherë ndihmë juridike reciproke.¹⁶⁰¹⁶¹ Përveç Serbisë, Kosova ka marrëveshje me vende si Gjermania, Zvicra,¹⁶² Turqia, Greqia, Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria.¹⁶³ Ministria e Drejtësisë është autoriteti qendror për pranimin dhe paraqitjen e kërkesave për bashkëpunim juridik ndërkombëtar.¹⁶⁴ Ministria ka një departament për bashkëpunim juridik ndërkombëtar¹⁶⁵ i cili siguron përpunimin e të gjitha kërkesave për ndihmë juridike ndërkombëtare në çështjet që janë në kuadër të përgjegjësisë së saj.¹⁶⁶ Drejtori thekson se sa u përket vendeve të Ballkanit Perëndimor, por edhe shumë vendeve të BE-së, shpejtësia e ekzekutimit të kërkesave është sfidë për Republikën e Kosovës, por kërkesat që janë në kompetencë të Prokurorisë Themelore dhe gjykatave në Kosovë ekzekutohen në kohën e duhur.¹⁶⁷ Gjatë vitit 2021 ka përpunuar në mënyrë efektive kërkesat për ndihmë juridike ndërkombëtare të transmetuara nga brenda dhe të marra nga jashtë. Gjatë kësaj periudhe (1 janar – 31 dhjetor 2021), Departamenti për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar (DBJN) ka përpunuar 6078 kërkesa/përgjigje për ndihmë juridike ndërkombëtare: 1548 kërkesa të reja (raste), 1592 kërkesa të reja në kuadër të lëndëve të hapura, 2381 përgjigje dhe 557 të natyrës tjetër.¹⁶⁸



INDIKATORI 3.3.3 – NDIHMA E NDËRSJELLË JURIDIKE

75/100



Autoritetet gjyqësore u përgjigjen në kohë të gjitha kërkesave për ndihmë juridike nga agjenci të huaja. Ato gjithashtu përdorin plotësisht ndihmën e ndërsjellë juridike gjatë hetimit të rasteve. Megjithatë, Ministria e Drejtësisë nuk ka publikuar asnjë statistikë për trajtimin e këtyre kërkesave në faqen e saj të internetit. Në faqen e internetit janë publikuar vetëm disa marrëveshje bashkëpunimi me vende të huaja, si Turqia, por nuk ka asnjë raport apo publikim që paraqet të dhëna statistikore për këto lëndë.

Sipas drejtorit të Departamentit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar të Ministrisë së Drejtësisë, autoritetet gjyqësore bashkëpunojnë mjaftueshëm me agjencitë e huaja të zbatimit të ligjit duke iu përgjigjur, ofruar dhe marrë menjëherë ndihmë juridike reciproke.¹⁶⁰¹⁶¹ Përveç Serbisë, Kosova ka marrëveshje me vende si Gjermania, Zvicra,¹⁶² Turqia, Greqia, Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria.¹⁶³ Ministria e Drejtësisë është autoriteti qendror për pranimin dhe paraqitjen e kërkesave për bashkëpunim juridik ndërkombëtar.¹⁶⁴ Ministria ka një departament për bashkëpunim juridik ndërkombëtar¹⁶⁵ i cili siguron përpunimin e të gjitha kërkesave për ndihmë juridike ndërkombëtare në çështjet që janë në kuadër të përgjegjësisë së saj.¹⁶⁶ Drejtori thekson se sa u përket vendeve të Ballkanit Perëndimor, por edhe shumë vendeve të BE-së, shpejtësia e ekzekutimit të kërkesave është sfidë për Republikën e Kosovës, por kërkesat që janë në kompetencë të Prokurorisë Themelore dhe gjykatave në Kosovë ekzekutohen në kohën e duhur.¹⁶⁷ Gjatë vitit 2021 ka përpunuar në mënyrë efektive kërkesat për ndihmë juridike ndërkombëtare të transmetuara nga brenda dhe të marra nga jashtë. Gjatë kësaj periudhe (1 janar – 31 dhjetor 2021), Departamenti për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar (DBJN) ka përpunuar 6078 kërkesa/përgjigje për ndihmë juridike ndërkombëtare: 1548 kërkesa të reja (raste), 1592 kërkesa të reja në kuadër të lëndëve të hapura, 2381 përgjigje dhe 557 të natyrës tjetër.¹⁶⁸





Ndërveprimet

Gjyqësori angazhohet në bashkëpunim të vazhdueshëm reciprok me autoritete dhe institucione të tjera, si prokuroria, policia, media dhe shoqëria civile.

Ndërveprimi me prokurorinë dhe policinë lidhet kryesisht me kërkesën ligjore dhe të detyrueshme për ndjekjen penale, hetimin dhe gjykimin e rasteve të korrupsionit, si dhe çështje të tjera.¹⁶⁹ Bashkëpunimi me mediet dhe me shoqërinë civile në veçanti lidhet me memorandumet e mirëkuptimit për monitorimin dhe vëzhgimin e rasteve të korrupsionit.¹⁷⁰

Kështu, shumica e ndërveprimeve synojnë të forcojnë kapacitetin për të luftuar korrupsionin; në parim, këto janë ndërveprime pozitive. Megjithatë, në praktikë ka probleme në zgjidhjen efikase të lëndëve, vonesa të gjykimeve dhe mungesë dënimi efektive në rastet e korrupsionit (shih 3.3.2).

Në Kosovë, gjykatat ende po zbatojnë një politikë të butë ndëshkuese për rastet e korrupsionit dhe kjo dukuri është rezultat i shumë faktorëve. Kjo është kryesisht për shkak se policisë dhe prokurorisë i mungojnë kapacitetet për të kryer hetime efektive (shih 4.3.1 dhe 6.3.1 shtyllat) dhe për të mbledhur provat e besueshme të nevojshme që gjykata të shqiptojë dënimet e duhura kundër të akuzuarve për vepra penale të korrupsionit.¹⁷¹

Rekomandimet e shtyllës

- Kërkesat buxhetore të KGJK-së të miratohen nga ekzekutivi sipas kërkesës, në mënyrë që të përmirësohet efektiviteti i sistemit gjyqësor.
- Rekrutimi i më shumë stafi mbështetës të kualifikuar, përfshirë bashkëpunëtorë dhe zyrtarë ligjorë në mënyrë që rastet të trajtohen më shpejt dhe me efikasitet.
- Të sigurohet që në gjykatat e Kosovës të ketë një bibliotekë me literaturë profesionale e cila mbështet gjyqtarët gjatë kryerjes së detyrave të tyre.
- Organizimi në bashkëpunim me Akademinë e Drejtësisë i seancave të trajnimit më të shpeshta dhe të detyrueshme për gjyqtarët dhe stafin e gjykatave për çështje që përfshijnë arsyetimin më të mirë të vendimeve gjyqësore, çështjet që kanë të bëjnë me barazinë gjinore dhe integritetin e punës së gjyqtarëve. Gjithashtu, gjyqtarët duhet të pajisen me databaza të jurisprudencës me komentim ligjor, në mënyrë që të sigurohet unifikimi i gjykimeve dhe zhvillimi i arsyetimit të vendimeve/aktgjykimeve.
- Të ketë më shumë transparencë në trajtimin e rasteve disiplinore kundër gjyqtarëve; Konkretisht, takimet ku procedohen ankesat kundër gjyqtarëve duhet të jenë publike dhe të publikohen emrat e gjyqtarëve që hetohen nga panelet hetimore. Të ndryshohet rregullorja për vlerësimin e performancës së gjyqtarëve dhe të parashihet shqiptimi i masave disiplinore si ato të përcaktuara sipas Ligjit për përgjegjësinë disiplinore për gjyqtarët dhe prokurorët (vërejtje publike me shkrim, ulje në detyrë dhe transferim apo ulje të përkohshme të pagës) ndaj gjyqtarëve që nuk shkruajnë vendime të arsyetuara, ose që shkruajnë vendime gjyqësore të arsyetuara në mënyrë të pamjaftueshme.
- Të krijohet një bazë të dhënash ku të dhënat për efikasitetin e gjyqësorit në trajtimin e lëndëve gjyqësore të korrupsionit dhe pastrimit të parave regjistronen, përditësohen dhe publikohen sipas veprave të veçanta penale dhe llojit të dënimit të shqiptuar.



REFERENCAT

- 1 Më 13 tetor 2021, Qeveria e Kosovës miratoi koncept dokumentin për vettingun në fushën e drejtësisë, i cili ka për qëllim forcimin e sundimit të ligjit. Në koncept-dokumentin e hartuar, grupi punues i krijuar nga Ministria e Drejtësisë ka sugjeruar "vettingun e ndryshimeve kushtetuese nga një organ ad-hoc dhe i njëjti organ më pas të vazhdojë vlerësimin e vazhdueshëm në kuadër të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës". Për më shumë shihni linkun: <https://www.evropaelire.org/a/ndryshime-kushtetuese-procesi-i-vettingut-/31527212.html> [qasur më 24 korrik 2023]
- 2 Shih portalin Koha.net, mars 2023, <https://www.koha.net/arberi/368040/konjufca-i-dergon-ne-gjykatën-kushtetuese-amendament-kushtetuese-per-vettingun-ne-drejtësi/> [qasur më 16 qershor 2023]
- 3 Shih tek Ministria e Drejtësisë, prill 2023, <https://md.rks-gov.net/page.aspx?id=1.15.3000> [qasur më 16 qershor 2023]
- 4 Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, neni 7, paragrafi 1, pika 13.
- 5 Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, neni 66, paragrafi 1.
- 6 Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, neni 7, paragrafi 1, pika 1,13 (dhjetor 2018).
- 7 Ligji për Gjykatat, neni 35 përcakton se pagat e gjyqtarëve caktohen në nivelin e kategorisë dhe hierarkisë së ushtrimit të detyrës. Sipas ligjit, kryetari i Gjykatës Supreme merr pagë të barabartë me Kryeministrin, ndërsa gjyqtarët e Gjykatës Supreme marrin pagë jo më të lartë se 90 për qind e pagës së kryetarit të Gjykatës Supreme.
- 8 Ligji për Gjykatat, neni 35, paragrafi 2.
- 9 Shih portalin Kallxo.com, prill 2023, <https://kallxo.com/lajm/liqji-per-paga-dergohet-ne-kushtetuese/> [qasur më 16 qershor 2023]
- 10 Portali Demokracia.com, gusht 2022 https://demokracia.com/wp-content/uploads/2022/08/Projektligji-per-pagat-ne-sektorin-publik.pdf?fbclid=IwAR-2Rb-V4wJORKTKDGCQbZ3Dirr-5HBzpmvrt1aiLf6iel5KHVvPrD_YhsjE [qasur më 2 shtator 2022]
- 11 Shih portalin Kallxo.com, 24 nëntor 2021, <https://kallxo.com/gjate/budxheti-2022-ijqesorit-dhe-prokurorise-i-shtohen-5-7-milione-euro/> [qasur më 19 shtator 2022] Në këtë artikull theksohet se në krahasim me vitet e kaluara, tashmë buxheti për gjyqësorin është më i lartë. Tani është 32 milionë euro krahasuar me 29 milionë euro për 2021 dhe 2020.
- 12 Shih Ligjin Nr. 08/L-066 për ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, faqe 85 (dhjetor 2021). Të dhënat zyrtare për buxhetin e KGJK-së janë paraqitur edhe në ligjin për buxhetin e vitit 2022. Këto të dhëna tregojnë se shumica e mjeteve buxhetore shpenzohen për paga, shërbime dhe mallra, ndërsa diku rreth 2.22 milionë euro janë ndarë për investime kapitale.
- 13 Intervistë me Albert Zogajn, "Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës", tetor 2022.
- 14 Intervistë me Gzim Shalën, "Hulumtues i lartë në IKD, shtator 2022.
- 15 Sipas ligjit për gjykatat, gjyqtarët e Apelit gëzojnë pagë jo më pak se 90 për qind të pagës së kryetarit të Gjykatës së Apelit, ndërsa gjyqtarët e Gjykatës Themelore kanë pagë jo më pak se 80 për qind e pagës së kryetarit të Gjykatës Themelore.
- 16 Shih Ligjin Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik (janar 2023). Ky ligj është dërguar për interpretim edhe në Gjykatën Kushtetuese nga Avokati i Popullit pasi janë paraqitur më shumë se 104 ankesa nga subjekte të ndryshme nga sektori publik. Shih po ashtu portalin Kallxo.com Portal, prill 2023, <https://kallxo.com/lajm/liqji-per-paga-dergohet-ne-kushtetuese/> [qasur më 16 maj 2023]
- 17 Shih portalin Ekonomia Online, dhjetor 2022, <https://ekonomiaonline.com/ulja-e-pagave-ne-drejtësi-mund-te-ule-performancën-te-rri-ise-korrupsionin/> [qasur më 16 maj 2023]
- 18 Shih Transparency International <https://www.transparency.org/en/our-priorities/judiciary-and-law-enforcement/> [qasur më 16 maj 2023]
- 19 Intervistë me Albert Zogajn, "Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës", tetor 2022.
- 20 Intervistë me Gzim Shalën, "Hulumtues i lartë në IKD, shtator 2022.
- 21 Këshilli Gjyqësor i Kosovës, ceremonia e rekrutimit të 74 bashkëpunëtorëve profesionalë <https://www.gjyqesori-rks.org/2022/11/16/kgjk-organizon-ceremoninë-e-startilimit-te-punes-per-74-bashkepunetore-profesionale-ne-gjykatat-e-republikes-se-kosovo/> [qasur më 17 nëntor 2022]
- 22 Shih njoftimin e Këshillit Gjyqësor, i cili thekson se janë rekrutuar 29 gjyqtarë të rinj, prill 2023, <https://www.gjyqesori-rks.org/2023/04/07/dekretohen-29-gjyqtare-te-rinj/> [qasur më 16 maj 2023]
- 23 Intervistë me Gzim Shalën, "Hulumtues i lartë në IKD, shtator 2022.
- 24 Akademia e Drejtësisë, "Plani i punës dhe performancës 2022", (nëntor 2021), fq. 14.
- 25 Shih Akademia e Drejtësisë, "Plani i punës dhe performancës 2022", (nëntor 2021), fq. 45-46, ku parashikohet që për rastet e korrupsionit, trajnimet për gjyqtarë dhe prokurorë të zhvillohen në tri seanca dhe vetëm dy ditë.
- 26 Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë, shkurt 2021, <https://www.amchamksv.org/en/judge-challenges-negatively-affect-the-efficient-resolution-of-business-disputes/> [qasur në shtator, 2021]
- 27 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 102, paragrafi 1 (qershor 2008).
- 28 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 103, paragrafi 2.
- 29 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 144 paragrafi 2 dhe 3, përcakton se çdo ndryshim i Kushtetutës së Kosovës kërkon votën e dy të tretave të deputetëve të shumicës dhe votën e dy të tretave të deputetëve të pakicës.
- 30 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 104, paragrafët 1 deri 6.
- 31 Rregullore për rekrutimin, ekzaminimin, emërimin dhe rëmërimin e gjyqtarëve, neni 5 paragrafët 2 deri në 4, (Nëntor 2021).
- 32 Ligji për Gjykatat, neni 8.
- 33 Rregullore për rekrutimin, ekzaminimin, emërimin dhe rëmërimin e gjyqtarëve, (nëntor 2021) neni 13.
- 34 Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, neni 22, (dhjetor 2018).
- 35 Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, neni 24.
- 36 Kodi i Etikës Profesionale për Gjyqtarët (gusht 2016).





37 Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, neni 4 dhe neni 14.

38 Ligji për Gjykatat (dhjetor 2018).

39 Rregullorja për rekrutimin, ekzaminimin, emërimin dhe riemërimin e gjyqtarëve, (nëntor 2021).

40 Portali Dukagjini.com, nëntor 2022, <https://www.dukagjini.com/ulen-gat-e-lyqtareve-dhe-prokurore-ve-kondershtohet-vendimi/> [qasur më 24 nëntor 2022] Me këtë vendim, qeveria në mënyrë të paprecedentit ka vendosur të ulë pagat e gjyqtarëve siç ishin para se të realizohet rritja në vitin 2017. Ky vendim i marrë në mënyrë të tillë ad-hok, ka cenuar drejtpërdrejt pavarësinë kushtetuese të gjyqësorit sepse është një vendim që nuk ka arsytetimin, nuk ka një qëllim legjitim se përse ndodh ulja dhe mbi të gjitha, është në kundërshtim me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës KO.nr.12/18 të datës 11 qershor 2018, si dhe në kundërshtim me nenin 35 paragrafi 2 të Ligjit për Gjykatat, ku theksohet se pagat e gjyqtarëve nuk mund të ulen gjatë kohës që janë duke ushtruar mandatin e tyre, përveç rasteve kur KGJK-ja shqipton masë disiplinore ndaj tyre.

41 Portali Kallxo.com, prill 2022, <https://kallxo.com/qiate/pavaresia-financiare-e-cunguar-e-keshillit-lyqesor-dhe-prokurorial-te-kosoves/> [qasur më 21 nëntor 2022]

42 Shih portalin Kallxo.com, shtator 2020, <https://kallxo.com/lajm/dash-gjykatat-e-kosoves-shihen-si-te-dikuara-dhe-me-dritesi-selective/> [qasur më 21 nëntor 2022] Ky artikull paraqet një raport të Departamentit Amerikan të Shtetit, ku theksohet se gjykatat e Kosovës konsiderohen të ndikuara politikisht dhe se në raport me palët, gjykatat e Kosovës bëjnë "drejtësi selektive".

43 Portali Telegrafi.com, janar 2022, <https://telegrafi.com/deshtimi-rastet-e-korrupsionit-dhe-krimit-te-organizuar-gjate-vitit-2021-ne-kosove/> [qasur më 22 nëntor 2022]

44 Ligji për Gjykatat, neni 30 përcakton kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët për emërim në pozitën e gjyqtarit, të cilat janë: të jetë shtetas i Kosovës, të ketë të përfunduar fakultetin juridik, të ketë të përfunduar provimin e jurisprudencës dhe të ketë të paktën 3 vjet përvojë pune profesionale në fushën juridike.

45 BIRN & Internews Kosova, raporti monitorues, 'Imuniteti ndaj Korrupsionit' (Prishtinë, 2021), faqe 34. Në këtë raport monitorues theksohet se në vitin 2021, 141 gjyqtarë u nënshtuan vlerësimit të performancës nga KGJK-ja dhe të dhënat tregojnë se asnjëri prej tyre nuk ka rezultuar me vlerësim "të dobët" për të nisur më pas ndonjë procedurë disiplinore ose shkarkim ndaj tyre.

46 Grupi për Studime Juridike dhe Politike, Analizë: 'Masat disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve' faqe 12. (GLPS: Prishtinë, maj 2022).

47 "Betimi për Drejtësi", korrik 2022, <https://betimiperdrejtesi.com/kgjk-propozon-presidentes-shkarkimin-e-lyqtarit-rafet-ismajli-te-cilit-ue-vertetua-denimi-nga-apeli-per-korrupsion/> [qasur më 26 tetor 2022]

48 "Betimi për Drejtësi", shtator 2022, <https://betimiperdrejtesi.com/gjykatesia-naime-krasniqi-jashanica-degradohet-ne-departmentin-e-pergiithsh-em-te-gjykates-themelore-ne-prishtine/> [qasur më 26 tetor 2022]

49 Neni 7 i Ligji për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

50 Ligji për Gjykatat, nenet 25 dhe 26.

51 Rregullorja për rekrutimin, ekzaminimin, emërimin dhe riemërimin e gjyqtarëve, neni 5.

52 Shih, portalin Insajderi.Com, Tre vjet më parë, <https://insajderi.com/te-gjithe-te-akuzuarit-ne-rastin-ponto-shpallen-te-pafajshem/> [qasur më 16 maj 2023]

53 Shih portalin Fax.al, janar 2021, <https://tvklan.al/veteranet-e-rreme-pafajesi-per-anetaret-e-komisionit-ne-kosove/> [qasur më 16 maj 2023]

54 Shih portalin Kallxo.Com, mars 2023, <https://kallxo.com/ligji/uke-rugova-astrit-haraqija-e-te-tjeret-lirohen-nga-akuza-per-rastin-e-vizave-italiane/> [qasur më 16 maj 2023]

55 Shih portalin Kallxo.Com, nëntor 2022, <https://kallxo.com/lajm/lirohen-nga-aktakuza-4-ish-ministrat-e-qeverise-thaci-2-akuzoheshin-per-faljen-e-4-hi-drocentraleve/> [qasur më 16 maj 2023]

56 Shih Infokus.com, prill 2023, <https://gazetainfokus.com/miftaraj-nderhyrja-e-kurtit-ne-rastin-e-nagip-krasniciq-ishte-flagrante/> [qasur më 24 korrik 2023] Gjithashtu, portali Koha.Net, mars 2023, <https://www.koha.net/lajmet-e-mbremjes-ktv/371128/haxhiu-e-akuzon-gjykatën-kushtetuese-per-interesa-individuele/> [qasur më 24 korrik 2023] Shih Nacionale.com, maj 2023, <https://nacionale.com/politike/dorezohu-seshte-vone-ministria-haxhiu-merr-rea-gime-te-ashpra-kerkohet-doreheqja>, [qasur më 24 korrik 2023]

57 Portali Paparaci.com, tetor 2021, Ministri i Drejtësisë në Qeverinë e Kosovës, e quan skandaloz dhe të padrejtë vendimin e gjyqtarëve të Gjykatës në Pejë lidhur me një rast të vrasjes së ndodhur në qytetin e Pejës, <https://paparaci.com/220319/ministria-haxhiu-nderhyne-ne-drejtesi-e-cileson-skandaloz-ven-dimin-per-gogajin/> [qasur më 26 tetor 2022]

58 Ligji për Gjykatat, neni 6, paragrafi 3.

59 Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, neni 14.

60 Sa i përket emërimit, ekziston edhe një rregullore për rekrutimin, ekzaminimin, emërimin dhe riemërimin e gjyqtarëve që rregullon këtë çështje. (Nëntor 2021).

61 Sa i përket transferimit dhe shkarkimit të gjyqtarëve, ekziston edhe Ligji për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve (nëntor 2018).

62 Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, neni 14, paragrafi 7.

63 Sipas Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, neni 6 thekson se institucionet publike janë të obliguara që në mënyrë proaktive t'i publikojnë të gjitha dokumentet publike brenda 15 ditëve nga dita që ato bëhen të qasshme. Gjithashtu, ky ligj parasheh një afat prej shtatë ditësh për dhënien e përgjigjeve në dokumente dhe informacione publike për palën nga të gjitha institucionet nga të cilat kërkohet të japin një informacion të tillë.

64 Rregullorja për rekrutimin, ekzaminimin, emërimin dhe riemërimin e gjyqtarëve, (nëntor 2021).

65 Rregullore për vlerësimin e performancës së gjyqtarëve (janar 2021).

66 Rregullore për organizimin e veprimtarisë së brendshme të Gjykatave në Republikën e Kosovës (korrik 2020).

67 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 31, paragrafi 2. Kjo dispozitë e detyron gjyqësorin të mbajë dhe të ofrojë shqyrtimin gjyqësor publikisht për çdo person.

68 Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, në nenin 293, përcakton qartë karakterin publik të shqyrtimit gjyqësor. Aty theksohet se shqyrtimi gjyqësor është publik dhe i hapur.

69 Këshilli Gjyqësor i Kosovës, faqja zyrtare: <https://www.gjyqesori-rks.org/> [qasur më 31 tetor 2022]

70 Shih Këshilli Gjyqësor i Kosovës, 'Raporti Vjetor për 2022' <https://www.gjyqesori-rks.org/raportet/> [qasur më 17 maj 2023]

71 Shih Këshilli Gjyqësor i Kosovës, faqja zyrtare: 'Vendimet disiplinore dhe statistikat' <https://www.gjyqesori-rks.org/decisions-of-the-disciplinary-commission/?lang=en> [qasur më 17 maj 2023]

72 Intervistë me Albert Zogajn, 'Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës', tetor 2022.



73 Faqja e internetit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, 'Platforma e të dhënave të hapura', <https://odp.gjyqesori-rks.org/> qasur më 3 nëntor 2022. Kjo platformë është një mekanizëm digjital që u mundëson përdoruesve të marrin dhe analizojnë të dhëna jopersonale dhe anonime nga Sistemi Informativ i Menaxhimit të Lëndëve.

74 Shih faqen zyrtare të Gjykatës Themelore në Prishtinë, <https://prishtine.gjyqesori-rks.org/?lang=en> [qasur më 17 maj 2023]

75 Faqja e internetit e Gjykatës Themelore në Prishtinë, orari i seancave' <https://prishtine.gjyqesori-rks.org/> [qasur më 1 nëntor 2022]

76 Intervistë me Gzim Shalën, Hulumtues i lartë në IKD, shtator 2022.

77 Faqja e internetit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, 'mundësi punësimi' <https://www.gjyqesori-rks.org/mundesi-punesimi/> [qasur më 3 nëntor 2022]

78 Ekziston edhe Rregullorja për Vlerësimin e Performancës së Gjyqtarëve (janar 2021), e cila në 11 nenet e saj, ndër kriteret e vlerësimit të gjyqtarit, jep edhe kriterin e aftësisë së arsyetimit cilësor të gjyqtarit për vendimin por nuk përmend ndonjë dënim specifik për mospërfshirje të këtij arsytimi.

79 Shih nenin 5 të Ligji për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Në këtë nen nuk përmendet mosarsyetime i vendimit të gjykatës si masë sanksionuese apo shkelje disiplinore.

80 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 31, paragrafi 1.

81 Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, neni 384 paragrafi 1 pika 1, pika 11. Ky nen i jep të drejtën Gjykatës së shkallës më të lartë të kontrollojë nëse vendimi përmban shkelje apo mangësi që anulojnë plotësisht vendimin dhe procesin gjyqësor. Mosarsyetime i një vendimi gjyqësor ose arsytetime kontradiktor dhe i paqartë përbën shkelje thelbësore të dispozitave të këtij kodi.

82 Neni 9 i Ligji për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, neni 9. Ankesat kundër gjyqtarëve fillimisht mund t'u drejtohen kryetarëve të gjykatave përkatëse, Këshillit Gjyqësor apo edhe Avokatit të Popullit.

83 Ekziston edhe Rregullorja për Vlerësimin e Performancës së Gjyqtarëve (janar 2021), e cila në 11 nenet e saj, ndër kriteret e vlerësimit të gjyqtarit, jep edhe kriterin e aftësisë së arsyetimit cilësor të gjyqtarit për vendimin por nuk përmend ndonjë dënim specifik për mospërfshirje të këtij arsytimi.

84 Shih nenin 5 të Ligji për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Në këtë nen nuk përmendet mosarsyetime i vendimit të gjykatës si masë sanksionuese apo shkelje disiplinore.

85 Në prill të vitit 2022, Ministria e Drejtësisë ka ngritur grupin e punës për ndryshimin dhe plotësimin e këtij ligji, pasi janë evidentuar disa probleme me ligjin ekzistues, duke filluar nga ato teknike, e deri te probleme më thelbësore si p.sh. si: sqarimi i përkufizimeve të përdorura në ligj, përmbajtjes së ankimit ndaj gjyqtarit dhe prokurorit, çështjeve që lidhen me masat disiplinore dhe pasojave të dhënies së tyre, aplikimit të mjeteve juridike dhe problemeve të tjera të konstatuara. Për më shumë shihni Gazetën Express: Prill 2022, <https://www.gazetaexpress.com/disciplinimi-i-gjyqtareve-dhe-prokurore-ve-nis-plotesim-ndryshimi-i-ligjit>, [qasur më 22 nëntor 2022]

86 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 107, paragrafi 1.

87 Ligji për përgjegjësinë disiplinore për gjyqtarët dhe prokurorët, neni 7 përcakton si sanksion disiplinor uljen e pagës prej 50 për qind në rast se gjyqtari kryen shkelje disiplinore kur ata shkelin ligjin dhe detyrat e tyre si gjyqtar. Për shembull, ata nuk i kryejnë detyrat në kohë, përfshihen në takime me palët në procedurë jashtë detyrës zyrtare, ose bëjnë deklaratat publike për lëndët që gjykojnë ose nuk i trajtojnë siç duhet palët në procedurë etj. Gjithashtu, ligji parasheh që një gjyqtar mund të zbrësë në detyrë për performancë të dobët në punë ose të transferohet nga një departament më i lartë në një departament më të ulët. Po kështu, shkarkimi mund të propozohet për kryerjen e një vepre penale dhe për shkelje të rënda të detyrës së gjyqtarit.

88 Po aty, neni 107.

89 Kushtetuta e Kosovës në nenin 104, paragrafët 1 dhe 4, përcakton se gjyqtarët mund të shkarkohen nga Presidenti i Kosovës me propozimin e Këshillit Gjyqësor vetëm për shkak të dënimit për vepër të rëndë penale ose për mospërmbushje serioze të detyrave.

90 Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, neni 7, paragrafi 1, pika 1 dhe pika 2.

91 Gazeta Zëri, tetor 2021, <https://zeri.info/aktuale/428930/kerkohet-shkarkimi-i-lyqtarës-florije-zatriqi-qe-noi-dhunenin-me-vetem-8-muah-imprison/> [qasur më 22 nëntor 2022] Këshilli Gjyqësor, pas protestave të qytetarëve, kishte vendosur pezullimin e gjyqtarës në fjalë deri në përfundimin e hetimit disiplinor ndaj saj.

92 Shih, Instituti i Kosovës për Drejtësi, 'Politika e dënimit në Kosovë' (Analizë mbi zbatimin e Udhëzuesit për Politikën e Dënimit nga Gjykatat e Kosovës), faqe 31. (IKD: Prishtinë, nëntor 2019). Për më shumë, shihni linkun: <https://kli-ks.org/politika-e-denimeve-ne-kosove/>, [qasur më 17 maj 2023] Gjetjet e IKD-së të paraqitura më poshtë tregojnë se zbatimi i Udhëzimeve në praktikë në rastet e korrupsionit nuk ishte zbatuar as për së afërmi. Për më tepër, siç do të vërejmë në këtë kapitull, politika e dënimit në gjykimet për korrupsion është model, pasi në shumicën e gjykimeve ka përsëritje të të njëjtëve faktorë, ndërsa përshtatshmëria e aktgjyimeve përgjithësisht arsyeohet dhe merret si i mirëqenë. Të dhënat e mëposhtme tregojnë se parimet e dënimit të përshtuara në Udhëzime janë të parregullta në rastet e korrupsionit. Prandaj, nëse Udhëzimet përdoren si pikë referimi për një politikë të ligjshme të dënimit, mund të konkludojmë se politika e dënimit në sistemin gjyqësor të Republikës së Kosovës në rastet e korrupsionit është jo më pak se arbitrare. Sa i përket arsytimit në aktgjykimet për caktimin e llojit dhe peshës së dënimit, në bazë të standardeve të përcaktuara në Udhëzime, palët dhe publiku në asnjë rrethanë nuk do të binden se pse është shqiptuar një dënim i caktuar në një rast konkret.

93 Intervistë me Gzim Shalën, Hulumtues i lartë në IKD, shtator 2022.

94 Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Prill 2022, '2021 Raporti Vjetor i Punës', faqe 26 dhe 27.

95 Shih, Grupi për Studime Juridike dhe Politike, 'Natyra e çështjeve disiplinore në sistemin gjyqësor dhe prokurorial të Kosovës dhe funksionimi i mekanizmit disiplinor', faqe 17 deri më 24 (Prishtinë: Qershor 2021), [qasur më 19 maj, 2023 në këtë link: <https://www.rolpik.org/wp-content/uploads/2021/07/Me-kanizmi-disiplinore-English-1.pdf>

96 Për më shumë, shih Instituti i Kosovës për Drejtësi, Prill 2023 'Sfidat në administratën gjyqësore' faqe 12 deri më 14, [qasur më 19 maj 2023] në linkun: https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2023/04/Raportit-i-monitorimit-te-KGJK-se-per-vitin-2022-FINAL_12.04.2023.pdf?fbclid=IwAR36wuumX_nbbpJ9j-E3dJvvleeji0DaKoMaNpf8J6AnrxVs44V38ZsRXqxs

97 Komisioni për Vlerësimin e Performancës së Gjyqtarëve ka kompetencën të vlerësojë performancën e gjyqtarëve me mandat të përhershëm sipas metodës "të rastësishme", gjyqtarëve me mandat fillestar dhe atyre që janë kandidatë për avancim. Në vlerësimin e performancës së gjyqtarëve, Komisioni vlerëson bazën për gradimin ose uljen e gjyqtarëve, duke përfshirë fillimin e procedurës së shkarkimit dhe vlerësimin me qëllim riemërimin.

98 Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Prill 2022, '2021 Raporti Vjetor i Punës', faqe 27.

99 Intervistë me Gzim Shalën, Hulumtues i lartë në IKD, shtator 2022.

100 Të dhënat e ofruara nga faqja e internetit e KGJK-së, <https://www.gjyqesori-rks.org/vendimet-e-komisionit-disiplinor/>, [qasur më 23 nëntor 2022] Këshilli gjithashtu raportoi se pezulloi tre gjyqtarë në vitin 2022, ndërsa nxori shtatë dënime dhe katër lirime. Nga shtatë vendimet penale, një është vërejtje jopublike me shkrim dhe një vërejtje publike me shkrim, tri vendime janë ulje të përkohshme e pagës prej 50 për qind dhe dy vendime kalojnë në gjykatën më të ulët. Ndërkohë që nuk ka asnjë propozim për shkarkimin e gjyqtarëve.

101 Po aty, uebfaqja e KGJK-së, <https://www.gjyqesori-rks.org/vendimet-e-komisionit-disiplinor/>, [qasur më 23 nëntor 2022] Në vitin 2021, Këshilli raportoi se pezulloi një gjyqtar, shpalli nëntë vendime disiplinore penale dhe shtatë lirime. Nga nëntë vendimet penale, tri janë vendime vërejtje jopublike me shkrim, katër vërejtje publike me shkrim, një vendim me ulje të përkohshme pagë 50 për qind dhe një vendim transferimi në një gjykatë më të ulët. Nuk ka propozime për shkarkim.




PROKURORIA

> |> > >< <><> ><> > ><>


PËRMBLEDHJE

Sistemi prokurorial në Kosovë përbëhet nga Prokurori i Shtetit si institucion i pavarur i prokurorisë dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) si organ mbikëqyrës administrativ. Kryeprokurori i Shtetit është kryesuesi i prokurorisë së shtetit.


61/100 Rezultati i përgjithshëm i shtyllës




Kapacitetet



Qeverisja



Roli





Ekzistojnë shtatë prokurori themelore (në Prishtinë, Ferizaj, Gjakovë, Gjiilan, Mitrovicë, Pejë dhe Prizren), Prokuroria Speciale (ekskluzivisht përgjegjëse për korrupsionin e profilit të lartë, krimin e organizuar dhe rastet e pastrimit të parave),¹ Prokuroria e Apelit, përgjegjëse për të gjitha ankesat për lëndët e vendosura nga gjykatat themelore dhe Kryeprokurori i Shtetit.² Analiza në vijim do të fokusohet kryesisht në Kryeprokurorin e Shtetit dhe KPK-në.

Angazhimi i Prokurorit të Shtetit në luftimin e korrupsionit mbetet i pamjaftueshëm. Pavarësisht pagave të larta të prokurorëve, kjo nuk është përkthyer në progres në luftën kundër korrupsionit pasi që nuk janë ngritur aktakuza profesionale dhe nuk janë mbështetur me prova të forta që i shpallin të dyshuarit fajtorë. Gjatë viteve të fundit ka pasur një rritje të lehtë të numrit të aktakuzave të ngritura për korrupsion. Megjithatë, gjatë vitit 2022, Prokurori i Shtetit ka pësuar regres në zgjidhjen e rasteve të korrupsionit. Prokurori i Shtetit gjatë vitit 2022 nuk ka arritur të zgjidhë as aq lëndë sa ka pranuar. Rrjedhimisht, gjatë kësaj periudhe kohore, Prokurori i Shtetit ka zgjidhur lëndët e 826 personave ndërsa ka pranuar lëndë për 1,140 persona. Kështu, në fund të vitit 2022, numri i lëndëve të pazgjidhura të korrupsionit është rritur në gjithsej 314 lëndë.³


Performanca e dobët në luftën kundër korrupsionit mund të lidhet edhe me ndërhyrjen e ekzekutivit në pavarësinë kushtetuese dhe financiare të Prokurorit të Shtetit në formën e mosmiratimit të kërkesës së plotë buxhetore dhe synimit për uljen e ndjeshme të pagave të prokurorëve me ligjin e ri për pagat.

Përderisa ka disa përpjekje për transparencë përmes publikimit të raporteve vjetore dhe ditore, faqja e internetit e KPK-së shpesh ballafaqohet me probleme funksionale dhe i mungojnë raportet dhe statistikat gjithëpërfshirëse. Praktika për t'u kërkuar zëdhënësve të prokurorisë që të kërkojnë miratimin e KPK-së përpara se të ndajnë informacionin, ka ngjallur kritika nga media dhe shoqëria civile sepse shpesh çon në kërkesa të zvarritura ose pa përgjigje.

KPK-së i mungojnë burimet e mjaftueshme financiare, stafi dhe bashkëpunëtorët profesional për prokurorët e shtetit. Buxheti i KPK-së për vitin 2023 është më i larti që ka pasur ndonjëherë, duke mundësuar rekrutimet e reja të prokurorëve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë për të mbushur zbrazëtitë aktuale të burimeve njerëzore për funksionim efektiv. Megjithatë, KPK-ja thekson se nuk është buxhet i mjaftueshëm për të realizuar të gjitha synimet dhe kërkesat e tyre.⁴ Disa prokurorë gjithashtu kanë mungesë të kapaciteteve dhe ekspertizë të pamjaftueshme për të hetuar dhe luftuar krimin e organizuar dhe korrupsionin. Me ndryshimet e reja legjislative në vitin 2023, përbërja, funksioni dhe mandati i KPK-së pritet të ndryshojë.



Kapacitetet

 **INDIKATORI 4.1.1
BURIMET (SIPAS LIGJIT)**

75/100




Ekzistojnë ligje gjithëpërfshirëse që sigurojnë burime të mjaftueshme në lidhje me buxhetin e prokurorisë dhe pagat për prokurorët. Megjithatë, ekzistojnë mangësi të vogla në përcaktimin e qartë të asaj që ligji i referohet si "buxhete të përshtatshme" dhe në përcaktimin e "klasave të pagave" të përshtatshme me koeficientë⁵ për prokurorët me rritje të inflacionit, të përcaktuara me ligj.

Sipas ligjit, KPK-ja harton, dorëzon⁶ dhe administron buxhetin e konsoliduar të Prokurorit të Shtetit dhe KPK-së.⁷ Ministria e Financave nuk mund ta ndryshojë këtë propozim buxhet⁸ nëse dorëzohet brenda afatit dhe limiteve të shpenzimeve të përcaktuara në qarkoren buxhetore vjetore.⁹ Megjithatë, kufijtë e shpenzimeve kanë çuar në burime të pamjaftueshme në praktikë (4.1.2). Sipas Ligjit për Prokurorin e Shtetit, qeveria duhet të sigurojë "fondet adekuate" nga buxheti i konsoliduar.¹⁰ Megjithatë, nuk ka kërkesë për një përqindje minimale të buxhetit të konsoliduar që e siguron këtë.

Ligji për Prokurorin e Shtetit përcakton pagat e prokurorëve sipas përqindjeve specifike të pagës¹¹ të Kryeprokurorit të Shtetit.¹² Por, nuk ka asnjë rregullore për rritjen e inflacionit. Paga e Kryeprokurorit të Shtetit (dhe rrjedhimisht edhe prokurorëve të tjerë) rritet me rritjen e pagës së kryeministrit.¹³ Pagat e prokurorëve nuk mund të ulen gjatë mandatit të tyre (vetëm në rastin e sanksioneve disiplinore),¹⁴ që ka rezultuar në paga aktualisht më të larta të prokurorëve kur kryeministri aktual (që nga marsi 2021) Albin Kurti uli pagën e tij me 50 për qind.¹⁵ Nuk ka gjithashtu një rregullim të përcaktuar ligjor të pagave në lidhje me inflacionin.



Në vitin 2019, një ligj i ri për pagat në sektorin publik synonte reformimin e këtyre rregulloreve duke ulur pagat e sektorit të gjyqësorit dhe prokurorisë. Ligji i ri prezantoi një sistem të "klasës së pagave" duke caktuar koeficientët.¹⁶ Megjithatë, në korrik 2020, Gjykata Kushtetuese e anuloi ligjin,¹⁷ duke e konsideruar atë diskriminues, në kundërshtim me parimin e pavarësisë kushtetuese financiare të Prokurorit të Shtetit.¹⁸ Një ligj i ri pagash me "klasat e pagave" është aktualisht në fazën e konsultimit publik, por ka ngritur shqetësime për uljen e pagave (bazuar në koeficientët e rinj) që prek edhe prokurorët.¹⁹

 **INDIKATORI 4.1.2
BURIMET (NË PRAKTIKË)**

50/100



Prokuroria e Shtetit ka disa burime financiare, njerëzore dhe infrastrukturore, por të cilat nuk janë të mjaftueshme për të kryer detyrat e saj në mënyrë efektive.

KPK-ja ka një buxhet të ndarë prej €17.1 milion²⁰ për vitin 2022, edhe pse KPK-ja fillimisht kishte kërkuar një buxhet prej €21.7 milion.²¹ Buxheti aktual është pothuajse trefishi i buxhetit të ndarë për KPK-në në vitin 2015, për shkak të rritjes së numrit të prokurorëve dhe numrit të zyrtarëve në prokurori. Megjithatë, kërkesat buxhetore të KPK-së asnjëherë nuk janë miratuar plotësisht. Në vitin 2023, KPK-ja kërkoj 21.3 milionë euro nga Qeveria, por Kuvendi në ligjin për buxhetin, miratoi vetëm 15.9 milionë euro. Ndërkohë, në vitin 2022, KPK-ja ka kërkuar 18.26 milionë euro dhe fillimisht ka marrë 14.6 milionë euro të miratuara. Mirëpo, pas rishikimit në qershor, buxheti i KPK-së u zvogëlua për 3.66 milionë euro. Një ulje e tillë buxhetore afatmesme ka ndodhur edhe në vitet e mëparshme.



Tabela 3.1: Ndarjet buxhetore për funksionimin e prokurorive, 2015 – 2023

Viti	Buxheti i kërkuar në €	Shuma në € ²²	Rritja në përqindje në vit
2023	21,267,112.00	15,913,983.00	8.27
2022	18,255,706.00	14,596,934.00	7.26
2021	21,697,194.00	13,536,238.00	-1
2020	18,266,633.00	13,672,561.00	-2.53
2019	18,305,402.00	14,018,592.00	10.58
2018	13,611,927.00	12,535,110.03	27.36
2017	13,171,930.00	9,104,443.00	9.34
2016	8,013,619.00	8,253,448.26	1.62

Sipas ushtruesit të detyrës së drejtorit të Sekretariatit të KPK-së, si pasojë e mosmiratimit të kërkesave fillestare buxhetore të KPK-së në vitin 2022, prokurorisë i mungojnë burimet për rekrutimin e 38 pozitave të reja të prokurorëve dhe janë 52 pozita të hapura për bashkëpunëtorë profesionalë.²³ Megjithatë, krahasuar me vitin 2015, tani ka një rritje të numrit të bashkëpunëtorëve profesionalë në kuadër të Prokurorisë së Shtetit, ku një bashkëpunëtor profesional punon për dy prokurorë. Megjithatë, ligji për prokurorinë e shtetit kërkon të paktën një bashkëpunëtor profesional për një prokuror, një qëllim që ende nuk është arritur.²⁴

Pagat e prokurorëve në Kosovë janë thujse më të lartat në rajon dhe kjo dëshmon se ata kanë mundësi të shërbejnë dhe të kryejnë detyrën siç duhet.

Prokurorët kanë paga të mjaftueshme për të mos u ndikuar nga asnjë presion apo tentativë për të qenë të korrumpuar në ushtrimin e detyrës, duke pasur pagat më të larta në rajonin e Ballkanit Perëndimor.²⁵ Prokurorët gëzonin një rritje pagash prej gati 100 për qind që nga viti 2017, duke shkuar nga një

mesatare prej 1,400 euro në 2,655 euro në 2022.²⁶ Pagat variojnë sipas hierarkisë së departamentit dhe prokurorisë ku punon prokurori.²⁷ Por me ligjin e ri të pagave të propozuar nga qeveria dhe miratuar në Kuvendin e Kosovës, pagat e prokurorëve kanë pësuar ulje të ndjeshme.²⁸ Për rrjedhojë, Këshilli Prokurorial kishte paraqitur ankesë pranë Avokatit të Popullit, i cili e kishte dërguar ligjin në fjalë në Gjykatën Kushtetuese për interpretim pikërisht për shkak të pakënaqësisë me këtë ligj.²⁹

Prokurorët janë të pajisur me kompjuterë zyre dhe printerë, por ka nevojë të vazhdueshme që pajisjet teknologjike të mirëmbahen dhe të përditësohen me kompjuterë dhe pajisje të reja.

Nga ana tjetër, prokurorëve u ofrohen vazhdimisht programe trajnimi, të organizuara nga Akademia e Drejtësisë.³⁰ Këto programe trajnimi kanë për qëllim kryesisht promovimin e profesionalizmit dhe aftësive ligjore të prokurorëve në menaxhimin e lëndëve, pastaj në fushën e parandalimit të konfliktit të interesit dhe respektimit të kodit të etikës. Meg-



jithatë, ky trajnim nuk është i mjaftueshëm, pasi që aktakuzat konsiderohen të jenë të shkruara dobët dhe kanë mangësi të shumta në përmbajtjen e tyre.³¹



Ka ligje gjithëpërfshirëse që kërkojnë të garantojnë pavarësinë e prokurorisë. Megjithatë, përbërja aktuale e KPK-së e përbërë kryesisht nga prokurorë krijon rrezik të korporatizimit, ndërsa ndryshimet e propozuara ligjore për të zvogëluar numrin e anëtarëve dhe për të rritur proporcionin e anëtarëve joprokurorë, të zgjedhur me shumicë të thjeshtë në Kuvend, po ashtu rrit rrezikun e ndikimit politik. Për më tepër, Kryeprokurori i Shtetit zgjidhet nga Presidenti, duke siguruar vetëm pavarësi nominale.

Prokuroria përbëhet nga dy institucione të pavarura kushtetuese: Prokurori i Shtetit dhe KPK-ja. KPK-ja është përgjegjëse për propozimin, riemërimin dhe disiplinimin e prokurorëve, ndërsa Prokurori i Shtetit është përgjegjës për ndjekjen e personave të akuzuar për çdo vepër penale.³²

Amendamentet e Kushtetutës në lidhje me Prokurorinë e Shtetit janë të vështira, duke forcuar pavarësinë e themeluar ligjërisht të institucionit. Ndryshimet kushtetuese duhet të miratohen me shumicë të dyfishtë, që nënkupton votat e dy të tretave të deputetëve, duke përfshirë dy të tretat e deputetëve që përfaqësojnë komunitetet jo shumicë.³³

KPK-ja nominon kandidatët në bazë të meritave në mënyrë transparente, duke marrë parasysh barazinë gjinore dhe përbërjen etnike.³⁴ Prokurorët emërohen për një mandat të përhershëm dhe u ndalohe anëtarësimi në ndonjë parti politike.³⁵ Ata emërohen, riemërohen dhe shkarkohen nga Presidenti i Kosovës me propozim të KPK-së.³⁶

KPK-ja përbëhet nga trembëdhjetë anëtarë, nga të cilët dhjetë³⁷ janë në mesin e prokurorëve, ndërsa tre³⁸ të tjerë janë joprokurorë.³⁹ Anëtarët joprokurorë zgjidhen nga Kuvendi i Kosovës me shumicën e votave të deputetëve që janë të pranishëm dhe votojnë.⁴⁰ Përbërja pothuajse tërësisht me prokurorë është kritikuar nga Komisioni i Venecias se është i prirur ndaj rrezikut të korporatizimit.⁴¹ Megjithatë, sipas ligjit të ri për KPK-në, Ministria e Drejtësisë ka propozuar uljen e numrit të anëtarëve nga 13 në shtatë, dhe kuorumin e punës nga dhjetë në pesë anëtarë. Tre duhet të jenë prokurorë të zgjedhur nga kolegët e tyre, tre anëtarë porotë të zgjedhur me shumicë të thjeshtë votash të deputetëve dhe një prokuror i zgjedhur nga Kuvendi, sërish me shumicë të thjeshtë.⁴² Gjithashtu, është propozuar që një sërë anëtarësh të KPK-së të humbasin mandatin menjëherë pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. Komisioni i Venecias kritikoi këto amendamente të propozuara për rritjen e rrezikut të ndikimit të padrejtë politik në KPK për shkak të zgjedhjes së anëtarëve joprokurorë me shumicë të thjeshtë në vend të "një sistemi proporcional të zgjedhjeve, apo emërimit të disa anëtarëve porotë nga institucione të jashtme të pavarura ose shoqëria civile".⁴³

Ky projektligj me këto propozime është anuluar nga Gjykata Kushtetuese sepse është në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës dhe cenon pavarësinë kushtetuese të KPK-së.⁴⁴ Madje, Gjykata ka sqaruar se anëtarët joprokurorë nuk duhet të jenë faktor vendimtar në funksionimin e KPK-së dhe as të jenë shkaktarë të bllokimit të punës së KPK-së. Sipas Gjykatës Kushtetuese, anëtarët joprokurorë zgjidhen me shumicë të thjeshtë votash nga Kuvendi dhe kjo rrezikon që ata të ndikohen politikisht dhe të kenë fuqinë për të bllokuar funksionimin e KPK-së.⁴⁵

Pas këtij vendimi, Qeveria, përkatësisht Ministria e Drejtësisë, ka hartuar sërish një projektligj të ri për Këshillin Prokurorial. Tashmë, në projektligjin e ri, propozohet që deri në vitin 2026, përbërja e KPK-së të shtohet me tetë anëtarë shtesë joprokurorë dhe si rrjedhojë, KPK-ja të ketë 19 anëtarë nga shtatë sa u propozuan në fillim. Po ashtu, me propozimet e ligjit, kuorumi i mbledhjeve është përcaktuar të jetë 12 anëtarë. Kjo sërish duket se bie ndesh me vendimin e Gjykatës Kushtetuese të datës 5 prill 2023, pasi Gjykata ka kërkuar që anëtarët joprokurorë të mos jenë faktor vendimtar në përcaktimin e kuoromit dhe vendimmarrjes së Këshillit Prokurorial si organ kushtetues dhe i pavarur.⁴⁶

Kushtetuta përcakton se Kryeprokurori i Shtetit emërohet dhe shkarkohet nga Presidenti i Kosovës me propozim të KPK-së. Kjo siguron vetëm një mbrojtje nominale nga ndërhyrjet politike. Mandati i Kryeprokurorit është shtatë vjet,⁴⁷





pa mundësi rizgjedhjeje.⁴⁸ Prokurorët e shtetit emërohen për një mandat tre vjeçar dhe më pas rrimërohen deri në moshën e pensionimit, përveç nëse shkarkohen për shkak të dënimit për një vepër të rëndë penale ose për moskryerje të detyrës.⁴⁹


Procesi i rekrutimit për prokurorët e shtetit zhvillohet në bazë të kriterëve të meritës⁵⁰ nga Komisioni për emërimin e prokurorëve të krijuar nga KPK-ja, i cili përbëhet nga shtatë anëtarë, të cilët japin anëtarë të rregullt dhe dy rezervë, të cilët janë prokurorë me mandat të përhershëm, kanë një vlerësim pozitiv të performancës dhe të mos kenë pasur masa disiplinore. Shoqëria civile dhe organizatat ndërkombëtare marrin pjesë në monitorimin e procesit të përzgjedhjes së prokurorëve.⁵¹

Legjislacioni ofron garanci të plota për mbrojtjen e mandatit të prokurorëve nga shkarkimet arbitrare. Prokurorët shkarkohen nga Presidenti i Kosovës vetëm me propozim të KPK-së.⁵² Shkarkimi mund të bëhet vetëm në rastet kur prokurorët dënohen për vepra penale (përveç veprave penale të kryera nga pakujdesia) si dhe për mospërbushje të rëndë të detyrave të punës.

Duke marrë për bazë kriteret e përcaktuara për shkarkimin e prokurorëve, procedura e shkarkimit nuk është e lehtë edhe nëse një prokuror akuzohet për kryerjen e një veprë penale. Sa i përket shkarkimit për shkak të mospërbushjes së rëndë të detyrave, pas ankesave disiplinore ndaj prokurorëve, KPK-ja ka diskrecion në vlerësimin e fakteve që lidhen me situata të mospërbushjes së rëndë të detyrave. Sa i përket procedurës së shkarkimit të prokurorëve, apo shkarkimit nga detyra para përfundimit të mandatit, legjislacioni përcakton se prokurorët mund të shkarkohen me propozimin e KPK-së nga Presidenti i Republikës së Kosovës, për shkaqe që përfshijnë rastet kur janë dënuar për vepra penale (me përjashtim të veprave penale të kryera nga pakujdesia) si dhe për mospërbushje të rëndë të detyrave të punës.⁵³

**INDIKATORI 4.1.4
PAVARËSIA (NË PRAKTIKË)**

50/100



Ka raste të përsëritura kur akterë të jashtëm, si qeveria, politikanë të tjerë dhe biznesmenë të fuqishëm që ndërhyjnë në aktivitetet e prokurorisë.

Qeveria ushtron ndikim në aktivitetet dhe vendimet e Prokurorit të Shtetit duke mos miratuar nevojat buxhetore të KPK-së (shih 4.1.2).⁵⁴

Në vitin 2018, prokurori special Elez Blakaj dha dorëheqje nga pozita e prokurorit special disa ditë para aktakuzës për rastin e ashtuquajtur “Veteranët” për mashtrim lidhur me listën përfundimtare të luftëtarëve veteranë të UÇK-së. Ai dyshohet se ka qenë subjekt i frikësimit nga politikanët gjatë hetimit të rastit dhe dyshohet se ka marrë kërcënime në Facebook.⁵⁵

Në Kosovë nuk ka raste kur një prokuror të jetë shkarkuar apo ulur nga pozita e tyre për shkak të performancës. Kryesisht, uljet në gradat e prokurorëve janë bërë për shkak të ndonjë mase disiplinore apo infiltrimit në afera të dyshimta.⁵⁶ Për shembull, në rastin e një prokurorëje të përfshirë në përgjime me ish-kryeprokurorin e shtetit dhe një gjyqtare të gjykatës në Prishtinë, KPK-ja mori masa disiplinore ndaj saj, duke degraduar atë nga departamenti i krimeve të rënda në Prokurorinë e Prishtinës në departamentin e përgjithshëm të Prokurorisë së Mitrovicës.⁵⁷ Në një rast tjetër që ka të bëjë me ish-kryeprokurorin e Prokurorisë së Gjakovës, KPK-ja ka shqiptuar masa disiplinore degradimi dhe transferim të përhershëm nga kjo pozitë në atë të prokurorit të përgjithshëm në Prokurorinë e Pejës⁵⁸ për faktin se ai kishte pyetjet e testit me shkrim për pozitën bashkëpunëtorit dhe i ka dërguar me telefon një personi në bazë të konkursit të shpallur nga Këshilli Prokurorial. KPK-ja kishte reaguar së fundi ndaj deklaratave të kryeministrit dhe ministrit të Drejtësisë, të cilët shprehën pakënaqësi për punën e prokurorisë në trajtimin e rasteve të dhunës seksuale në vend.⁵⁹



Qeverisja

**INDIKATORI 4.2.1
TRANSPARENCA
(SIPAS LIGJIT)**

100/100



Ka dispozita gjithëpërfshirëse të citat i mundësojnë publikut të marrë informacion mbi organizimin dhe funksionimin e prokurorisë, për vendimet që kanë të bëjnë me to dhe se si janë marrë këto vendime.⁶⁰

“Klauzola e marrëdhënieve me publikun” në Ligjin për Prokurorin e Shtetit është dispozita kryesore që kërkon që Prokurori i Shtetit të informojë publikun për aktivitetet e tij.⁶¹

Të gjitha mbledhjet e KPK-së duhet të jenë të hapura. Rendi i ditës duhet të publikohet të paktën 48 orë përpara mbledhjes.⁶² KPK-ja mund të mbajë mbledhje të mbyllura nëse diskuton sekrete zyrtare shtetërore, çështje të personelit, vlerësime të performancës, informacione konfidenciale, pronësore etj. Në rastet kur kryetari i KPK-së ose anëtarët e Këshillit vlerësojnë se një nga arsyet e sipërpërmendura është aktuale për rastet konkrete ata shtjellojnë të gjitha arsyet dhe me shumicën e votave vendosin dhe arsyetojnë nëse mbledhja duhet të mbyllet.⁶³


KPK-ja duhet të publikojë rregulloren e procedurës për funksionimin dhe zgjedhjen e KPK-së.⁶⁴ KPK-ja duhet gjithashtu të publikojë informacione dhe të dhëna statistikore për sistemin prokurorial.⁶⁵ Të gjitha dokumentet e detyrueshme të publikuara në faqen e internetit rregullohen nga Ligji për Qasje në Dokumente Publike,⁶⁶ duke përfshirë misionin, vizionin, dokumentin strategjik, legjislacionin primar, aktivitetin publik

dhe informacionin e kontaktit. Të gjitha informacionet për emërimin,⁶⁷ transferimin⁶⁸ dhe largimin⁶⁹ e prokurorëve kërkohet gjithashtu të jenë publike.⁷⁰

Në maj të vitit 2021, Kryeprokurori i Shtetit ka nxjerrë udhëzimin për zbatimin, monitorimin, raportimin dhe publikimin e aktivitetëve të kryera nga Prokurori i Shtetit në kuadër të përgjegjësisë dhe obligimeve ligjore. Ky udhëzim promovon dhe rrit transparencën pasi u mundëson medieeve, shoqërisë civile dhe publikut të gjerë të kenë qasje dhe informacion të plotë për të gjithë punën dhe aktivitetet e Prokurorit të Shtetit.⁷¹

**INDIKATORI 4.2.2
TRANSPARENCA
(NË PRAKTIKË)**

50/100



Ekziston njëfarë transparence përmes publikimit të raporteve vjetore dhe ditore; megjithatë, faqja e internetit e KPK-së shpesh ka probleme funksionale dhe raportet dhe statistikat janë jo të plota. Politika që zëdhënësit e Prokurorisë duhet t'i kërkojnë KPK-së leje përpara se të japin informacion është kritikuar edhe nga media dhe shoqëria civile.

KPK-ja ka një faqe interneti, por shpesh nuk është funksionale ose e qasshme dhe nuk është gjithëpërfshirëse në ofrimin e raporteve apo statistikave për punën dhe vendimet e KPK-së.⁷² Prandaj, qytetarët nuk kanë qasje të besueshme në informacion.





Të gjitha informacionet në lidhje me konkurset dhe aktivitetet e rekrutimit për emërimin e prokurorëve apo kryeprokurorëve si dhe stafit administrativ publikohen në një faqe tjetër interneti referuar punës së prokurorisë. Raportet vjetore, planet e punës, konkurset e rekrutimit dhe vendimet disiplinore ndaj prokurorëve publikohen në këtë faqe interneti.⁷³ Megjithatë, problemi mbetet që faqja e internetit nuk ka qasje, sepse ajo nuk është funksionale dhe raportet për KPK-në publikohen në rubrika të veçanta në rubrikën e dokumenteve dhe publikimeve.⁷⁴

Më tej, pavarësisht ekzistencës së një zyrtari për marrëdhënie me publikun për çdo degë të prokurorisë, bashkëpunimi i tyre me shoqërinë civile dhe mediet varet nga leja e KPK-së.⁷⁵

Prokuroria jep rregullisht deklarata për shtyp dhe informacion sipas kërkesës dhe publikon raportin e punës 24-orësh në faqen e prokurorisë, por jo në faqen e KPK-së. Gjithashtu, në faqen e Prokurorisë publikohen raportet periodike të punës dhe realizimi i planeve të punës.⁷⁶ Qytetarët informohen kryesisht nga raportimet e medieve dhe publikimi i raporteve të ndryshme të organizatave ndërkombëtare dhe vendore që monitorojnë këtë institucion.

Deri më tani nuk ka pasur raste të tilla kur Kryetari i KPK-së të mbledhte dhe të mbante konferenca publike në të cilat do të raportonte për aktivitetet e ndryshme të KPK-së. Konferenca vjetore aktualisht mbahet vetëm nga Kryeprokurori i Shtetit, ku prezantohen të arriturat, problemet dhe sfidat e sistemit prokurorial.⁷⁷ KPK-ja zakonisht fton organizatat e shoqërisë civile që monitorojnë punën dhe veprimtarinë e tyre.⁷⁸ Ai gjithashtu zhvillon takime konsultative në grupet e punës në lidhje me hartimin e rregulloreve të KPK-së – Rregulloret për Organizimin e Brendshëm të Prokurorive si dhe Rregulloret për Emërimin dhe Riemërimin e Prokurorëve.⁷⁹ Për këtë qëllim, KPK-ja ka nënshkruar një memorandum bashkëpunimi me OShC të ndryshme.

Prokurorët raportojnë pasurinë e tyre në Agjencinë Kosovare për Parandalimin e Korrupsionit, e cila i bën ato të disponueshme për publikun. Sipas raportit vjetor të vitit 2021, rreth 99 për qind e zyrtarëve që punojnë në Prokurori kanë plotësuar deklaratën vjetore të pasurisë.⁸⁰

**INDIKATORI 4.2.3
LLOGARIDHËNIA
(SIPAS LIGJIT)**



Ka dispozita të mjaftueshme që sigurojnë që prokurorët duhet të raportojnë dhe të përgjigjen për veprimet e tyre.

Kushtetuta dhe legjislacioni i japin KPK-së autoritetin për të nisur masat disiplinore dhe për të kërkuar përgjegjësi nga prokurorët për çdo sjellje të keqe apo shkelje në vendimarrje.⁸¹

Të gjithë personat fizikë dhe juridikë mund të parashtrojnë ankesë ndaj prokurorëve për shkelje disiplinore tek Kryeprokurori i Shtetit për Kryeprokurorët, si dhe tek Kryeprokurorët për Prokurorët.⁸² Pas pranimit të ankesave të mundshme, kryeprokurorët e prokurorive ose Kryeprokurori i Shtetit vlerësojnë vlefshmërinë e tyre dhe nëse ato janë të bazuara, pastaj i referojnë rastet përkatëse të shkeljeve disiplinore në KPK për shqyrtim dhe vendimarrje të mëtejshme. KPK-ja me marrjen e ankesës, formon një panel hetimor i cili kryen të gjitha hetimet për shkeljet disiplinore të pretenduara nga çdo palë dhe bazuar në raportin e këtij paneli.⁸³ Më pas KPK-ja vendos nëse do të vendosen masa disiplinore ndaj prokurorëve apo jo.⁸⁴

Me hyrjen në fuqi të ligjit të ri për përgjegjësinë disiplinore, janë ndërprerë mekanizmat që ishin funksionale deri në vitin 2018, si Zyra e Komisionit Disiplinor. Kjo zyrë është zëvendësuar me panele hetimore në kuadër të KPK-së. Ndërprerja e punës së kësaj zyre ishte imperativ sepse eliminoi burokracitë e panevojshme dhe tani procedurat e zhvilluara në kuadër të njësive të KPK-së janë adekuate dhe mundësojnë trajtim të përsheptuar dhe më efikas të rasteve disiplinore.⁸⁵



Duhet theksuar se nuk ka ligj të veçantë për mbrojtjen e të drejtave të ankuesve në situatën në fjalë. Ligji për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve fatkeqësisht nuk përmban dispozita që flasin për mbrojtjen e të drejtave të ankuesve.⁸⁶ Megjithatë, ekziston një Kod Penal i Kosovës që dënon çdo person zyrtar (në këtë rast prokurorët) nëse ata tentojnë të abuzojnë me pushtetin e tyre duke kryer veprime me qëllim të frikësimit ose ushtrimit të ndikimit ndaj dikujt që parashtron ankesë.⁸⁷

Prokurorët gëzojnë imunitet⁸⁸ nga ndjekja penale, paditë civile dhe shkarkimi nga detyra për veprimet e ndërmarra, vendimet e marra ose mendimet e shprehura që janë brenda fushëveprimit të përgjegjësisë së tyre.⁸⁹

Sipas ligjit, rastet kur prokurorët dënohen për një vepër penale, shkelin ligjin ose shpërfillin detyrat e tyre zyrtare si prokurorë kualifikohen si shkelje disiplinore. Përveç këtyre shkeljeve themelore, ligji përcakton shkeljen e përgjegjësisë së veprimeve të prokurorit me dashje ose për shkak të pakujdesisë së rëndë.⁹⁰

Për shkeljet disiplinore, KPK-ja mund të shqiptojë disa lloje sanksionesh disiplinore ndaj prokurorëve, duke përfshirë vërejtjet me shkrim jopublike, vërejtjet me shkrim publike, uljen e përkohshme të pagës deri në 50 për qind për një periudhë deri në një vit, përcaktimin e përkohshëm ose të përhershëm në një prokurori tjetër të shkallës më të ulët ose një propozim për shkarkim.⁹¹

Prokurorët kanë të drejtë të ankohen kundër vendimeve disiplinore të KPK-së⁹² drejtpërdrejt në Gjykatën Supreme të Kosovës.⁹³

**INDIKATORI 4.2.4
LLOGARIDHËNIA (NË
PRAKTIKË)**



Dispozitat ekzistuese janë deri diku efektive për të siguruar që anëtarët e prokurorisë duhet të raportojnë dhe të përgjigjen, por prokurorët, në praktikë, nuk mbahen mjaftueshëm përgjegjës për punën dhe veprimtarinë e tyre.

Sipas IKD-së, mekanizmi disiplinor i KPK-së gjithmonë ka qenë i kufizuar vetëm në shqiptimin e masave të buta disiplinore dhe janë shumë të pakta rastet kur KPK-ja ka propozuar shkarkimin e një prokurori, qoftë për performancë të dobët apo për shkelje të ndryshme disiplinore.⁹⁴ Duke qenë se ka një numër të madh të ankesave të refuzuara, përkatësisht prokurorët nuk janë shpallur fajtorë për shkelje disiplinore, kjo i ka "trimëruar" disi prokurorët që nuk e marrin seriozisht punën e tyre.⁹⁵

Në bazë të raportit vjetor të punës së KPK-së për vitin 2021, sa i përket shqyrtimit të performancës së prokurorëve, vërehen më shumë raste të transferimit dhe ngritjes në detyrë të prokurorëve sesa ulje në detyrë apo propozime për shkarkim. Megjithatë, duhet theksuar se për dështimet e prokurorisë në rastet famëkeqe të korrupsionit, si "Pronto", "Stenta 1" dhe "Veteranët", si dhe në shumë raste kur veprat penale kanë qenë subjekt i parashkrimit dhe të akuzuarit janë liruar nga ndjekja penale, asnjë prokuror që përfaqëson këto raste nuk është mbajtur përgjegjës.⁹⁶

Përveç raporteve të rregullta që ata u bëjnë kryeprokurorëve të tyre, deri më tani ka një rast nga viti 2019 ku KPK-ja ka propozuar shkarkimin e një prokurori në Kosovë për shkak të performancës së dobët⁹⁷ dhe mospërfaqësimit të aktakuzave.⁹⁸ Në vitin 2022 ka pasur raste të uljes në detyrë⁹⁹ dhe pezullimit të prokurorëve, por ky veprim është bërë për shkak të përfshirjes së tyre në disa skandale përgjimesh.¹⁰⁰





Lidhur me vendimet disiplinore nga viti 2019 deri në qershor 2021, KPK-ja ngriti 20 panele hetimore për mbledhjen e provave dhe përpilimin e raporteve të pretendimeve për shkelje disiplinore nga prokurorët. Nga raportet e këtyre paneleve, KPK-ja ka nxjerrë 16 vendime disiplinore, ndërsa katër lëndë disiplinore janë ende në pritje. Në lidhje me vendimet e KPK-së gjatë kësaj periudhe, në shtatë raste kur prokurorët i janë nënshtruar procedurës hetimore për shkelje disiplinore, nuk janë mbajtur përgjegjës për shkak se është vërtetuar se shkeljet e pretenduara disiplinore nuk janë kryer.¹⁰¹

Në rastet kur u vendosën sanksionet, ato varionin nga vendosja e vërejtjeve me shkrim jo-publike, ulja e pagës (me 30 për qind për gjashtë muaj), ricaktimi i një prokurori nga një departament më i lartë në një më të ulët të së njëjtës prokurori dhe rasti i një marrëveshjeje për pranimin e fajësisë.¹⁰²

Përfundimisht, për të gjitha rastet e ankimuar për këto çështje, nuk është raportuar se ka pasur raste kur ankesat janë ankuar për mos sigurimin e mbrojtjes efektive apo moslejimin e përdorimit të ankesës.

**INDIKATORI 4.2.5
MEKANIZMAT E
INTEGRITETIT (SIPAS LIGJIT)**



Ekzistojnë dispozita gjithëpërfshirëse për të garantuar integritetin e anëtarëve të prokurorisë, si për sa i përket kodit të etikës, pranimit të dhuratave dhe kufizimeve pas largimit nga detyra. Megjithatë, nuk ka kufizime pas punësimit për prokurorët publikë.

Integriteti i Prokurorit të Shtetit është përcaktuar në Ligjin për Prokurorin e Shtetit dhe Kodin e Etikës dhe Sjelljes Profesionale të Prokurorëve. Kodi i ri i Etikës dhe Sjelljes u miratua në vitin 2019, duke shfuqizuar kodin e vitit 2012.¹⁰³ Kodi i

Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Prokurorët përcakton standardet e etikës profesionale për të gjithë prokurorët e shtetit.¹⁰⁴

Parandalimi i konfliktit të interesit rregullohet me Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, i cili vlen për të gjitha institucionet publike në Kosovë, duke përfshirë edhe Prokurorin e Shtetit. Ky ligj mbron integritetin e Prokurorit të Shtetit, duke përfshirë çështjen e konfliktit të interesit,¹⁰⁵ si dhe shkëmbimin e dhuratave dhe mikpritjen për prokurorët.¹⁰⁶

Prokurorët janë të detyruar të deklarojnë pasurinë e tyre dhe t'ia vënë në dispozicion Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit çdo vit¹⁰⁷ pasi që ata konsiderohen zyrtarë të lartë publik.¹⁰⁸ Këto mund të përfshijnë pasuri të paluajtshme, prona me vlerë më shumë se 5,000 €, aksione në organizata biznesi, letra me vlerë, kursime në banka dhe institucione të tjera financiare, detyrime financiare dhe të ardhura vjetore.¹⁰⁹ Mos raportimi i pasurisë së tyre ose deklaratimet e rreme në Agjenci përbëjnë vepër penale bazuar në Kodin e Penal, i cili ka hyrë në fuqi në janar 2019.¹¹⁰

Të veprosht me integritet për një prokuror do të thotë që prokurori duhet të punojë dhe të jetë përgjegjës për veprimet dhe mosveprimet e tij në jetën e tij profesionale dhe private.¹¹¹ Sa u përket shkeljeve të integritetit, këto mund të përfshijnë një veprim ose mosveprim, qoftë në ushtrimin e detyrës apo të jetës private, në kundërshtim me ligjin, politikat dhe strategjitë e sistemit prokurorial, udhëzimet administrative apo çdo akt që përbën vepër penale.¹¹²

Për më tepër, në lidhje me parandalimin e konfliktit të interesit, Kodi i Etikës specifikon se prokurorët nuk mund të kërkojnë dhe të marrin asnjë formë të dhuratave, shpërblimeve dhe përfitimeve të tjera të padrejta për veten ose për ndonjë person tjetër që mund të çojë ose duket se çon në ndikim të padrejtë në vendimet dhe veprimet zyrtare. Prokurori nuk mund të marrë dhuratat për raste të caktuara me vlerë totale që tejkalojnë 500 euro në vit dhe nuk mund të marrë më shumë se një dhuratë në vit nga i njëjti person ose institucion.¹¹³

Prokurorët gjithashtu nuk mund të angazhohen në asnjë aktivitet ekonomik, duke përfshirë çdo lloj pune ose biznesi, për të fituar interesa materiale ose jomateriale që mund të çojnë pavarësinë e tij ose të saj ose mund të krijojnë përshtypjen e përdorimit të detyrës për interesat e tij ose të saj.¹¹⁴

Qytetarët mund të ankohen në KPK për çdo hezitim të prokurorit në kryerjen e detyrave të tyre zyrtare.¹¹⁵ Prokurori duhet të hetojë dhe ndjekë penalisht veprat penale të paraqitura



nga kushdo që ka dyshim të arsyeshëm se po ndodhë apo ka ndodhur një vepër.¹¹⁶

Ligji parasheh që prokurorit i ndërpritet mandati me dorëheqjen, moshën e pensionit ose shkarkimin nga detyra.¹¹⁷ Kur mbushet moshja e pensionit 65 vjeç, prokurori nuk lejohet të punojë në institucione publike, por mund të veprojë si avokat dhe të japë këshilla ligjore.¹¹⁸

Pas përfundimit të mandatit të tyre, asnjë dispozitë ligjore nuk i ndalon prokurorët të hyjnë në sektorin privat apo publik, qoftë edhe për subjektet që ata kanë hetuar. Legjislacioni rregullon vetëm aspektin e papajtueshmërisë së ushtrimit të funksionit gjatë ushtrimit të funksionit të prokurorit, duke përcaktuar se prokurorët nuk mund të angazhohen në asnjë funksion apo veprimtari politike.¹¹⁹

**INDIKATORI 4.2.6
MEKANIZMAT E
INTEGRITETIT (NË PRAKTIKË)**



Ekziston një qasje e pjesshme dhe reaktive për të garantuar integritetin e anëtarëve të prokurorisë.

Respektimi i kodit të etikës dhe sjelljes sigurohet nga KPK-ja dhe Kryeprokurorët e Prokurorisë. KPK-ja zotëron gjithashtu Njësien e Vlerësimit të Performancës së Prokurorisë, e cila mbështet procesin e vlerësimit të performancës së prokurorisë dhe prokurorëve individualë.¹²⁰ Në vitin 2022, KPK-ja ka bërë 62 vlerësime të performancës për prokurorët e të gjitha niveleve dhe në vitin 2021 ka bërë 61 vlerësime. Në vitin 2020, një prokuror është vlerësuar me performancë "shumë të mirë", 24 prokurorë me vlerësim "të mirë", 39 me vlerësime "mesatare" dhe një "të pamjaftueshëm". Në vitin 2022 asnjë prokuror nuk është vlerësuar "shumë mirë", 28

prej tyre janë vlerësuar "mirë", ndërsa 32 prokurorë janë vlerësuar "mesatar" dhe një prokuror "i pamjaftueshëm".¹²¹

KPK-ja ndjek dhe heton rastet e shkeljeve disiplinore ndaj prokurorëve, por nuk është efikase në propozimet për shkarkimin e prokurorëve. Për shembull, KPK-ja nuk ka nisur procedura disiplinore ndaj ish-kryeprokurorit Aleksandër Lumezi, i cili ka qenë shënjestër e skandaleve të shumta të raportuara në medie.¹²² KPK-ja merr kryesisht masa disiplinore, të cilat priren të shprehen në shkallën e uljes nga pozita e prokurorit,¹²³ ulje rroge apo edhe transferim në një prokurori tjetër.¹²⁴ Për shembull, KPK-ja e degradoi ish-prokuroren Shemsije Asllani pasi mediet raportuan se ajo dyshohet se ka pasur ndikim të papërshtatshëm apo kundërligjor për të caktuar një gjyqtar (shih 3.1.4).

Pas përfundimit të mandatit, nuk ka asnjë kufizim nga asnjë rregullore që ndalon prokurorët të punojnë në sektorin privat. Kur angazhohen në sektorin privat, prokurorët zakonisht punojnë si avokatë dhe kjo është e lejueshme.

Nuk ka trajnim të gjerë për prokurorët dhe stafin për çështjet e integritetit. KPK-ja nuk prodhon materiale apo broshura për këtë aspekt.

Ndërkohë, qytetarët janë në gjendje dhe mund të kundërshtojnë paanshmërinë e një prokurori nëse janë të pakënaqur me mënyrën se si trajtohet një lëndë. Për shembull, në rastin që kishte të bënte me përdhunimin e një vajze 11-vjeçare, pati një protestë qytetare që kërkonte shkarkimin e prokurorit dhe kryeprokurorit të prokurorisë në Prishtinë, për shkak se ata dyshohet se nuk i kanë ndjekur penalisht autorët në një rast të mëparshëm.¹²⁵

Në praktikë, prokurorët deklarojnë pasurinë e tyre (shih 4.2.2).





**INDIKATORI 4.2.7
GJINIA**

0/100



Në Prokurorinë e Shtetit nuk ka protokolle dhe udhëzime për ndjeshmërinë gjinore.

Pavarësisht rregullimit të përfaqësimit gjinor të përcaktuar sipas Kushtetutës¹²⁶ dhe Ligjit për Barazinë Gjinore,¹²⁷ asnjë akt nënligjor i sistemit të prokurorisë nuk përmend integrimin gjinor në dokumentet dhe politikat e tyre. Të dhënat e ndara sipas gjinisë mblidhen rregullisht, por nuk përdoren për politikëbërje.

Në përgjithësi, strategjitë dhe politikat e brendshme të Prokurorisë së Kosovës shpërfillin çështjet gjinore dhe nuk adresojnë nevojat dhe shqetësimet potencialisht të ndryshme të grave dhe burrave. Nuk ka pika kontakti gjinore dhe trajtimi i çështjeve që lidhen me gjininë, të drejtat e njeriut dhe diversitetin nuk figurojnë në asnjë përshkrim pune brenda shërbimit të prokurorisë.¹²⁸

Të gjitha këto reflektojnë si rezultat i mungesës së njohurive, kapaciteteve, mungesës së politikave të brendshme që rregullojnë këtë çështje, mosnjohjes së konceptit dhe mungesës së stafit të trajnuar përgjegjës për këto çështje. Në fakt, nuk ka trajnime të detyrueshme për çështjet gjinore dhe gjithëpërfshirëse në prokurori për prokurorët apo stafin administrativ.¹²⁹


Në raportin e punës për vitin 2021, të publikuar në faqen e Prokurorisë, nuk ka të dhëna të KPK-së të zbërthyer si pas gjinisë sa i përket numrit të ankesave të pranuar dhe as të dhëna statistikore të paraqitura në lidhje me kohën e përpunimit të ankesave të paraqitura apo të refuzuara nga pikëpamja gjinore.¹³⁰



Roli

**INDIKATORI 4.3.1 NDJEKJA
PENALE E KORRUPSIONIT**

50/100



Prokuroria mbetet përgjithësisht joefektive në luftimin e korrupsionit. Gjatë gjithë vitit 2021, ka pasur një rënie të vazhdueshme të efikasitetit dhe performancës së prokurorisë në ndjekjen e autorëve të veprave penale të korrupsionit (shih tabelën më poshtë).

Në shumë raste, aktakuzat kanë probleme thelbësore pasi nuk ka ekspertizë financiare sa i përket masës së dëmit, nuk identifikon qartë të dëmtuarin ose nuk kanë prova cilësore që mund të vërtetojnë fajësinë e autorëve për veprat penale të korrupsionit.¹³¹ Megjithatë, ka pasur pak masa disiplinore nga KPK-ja për çështjen e performancës së prokurorëve (shih 4.2.4).

	Numri i aktakuzave të ngritura për korrupsion ¹³²	% rritje(+)/rënie(-) nga viti i kaluar
2022	98	-4
2021	102	-18.40
2020	125	-19.87
2019	156	-5.45
2018	165	-26.01
2017	223	





Në vitin 2021 u proceduan 1,025 raste korrupsioni me 1,827 persona. Nga këto, vetëm 793 raste (77,32 për qind) janë zgjidhur, duke përfshirë 1,316 persona (72,3 për qind).¹³³ Kjo tregon qartë se gjatë gjithë vitit 2021 ka pasur një performancë të dobët të Prokurorisë në ngritjen dhe procedimin e çështjeve të korrupsionit ndaj personave dhe zyrtarëve të niveleve të ndryshme.¹³⁴ Ndërkohë, për vitin 2022, Prokurori i Shtetit ka ngritur gjithsej 98 aktakuza për rastet e korrupsionit. Nga këto raste, Prokuroria Speciale ka akuzuar 25 persona, shtatë prej tyre të profilin të lartë. Ndërkohë, prokuroria në Prishtinë ka akuzuar 19 persona, mes tyre edhe një person të profilin të lartë. Numri më të vogël të aktakuzave për korrupsion mban prokuroria e Ferizajt, me vetëm tre persona të akuzuar për korrupsion.¹³⁵

Sa i përket performancës së prokurorisë në sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë së fituar me vepra penale, të dhënat zyrtare të paraqitura nga prokuroria tregojnë shifra shumë të ulëta për konfiskimin e pasurisë. Sipas të dhënave të vitit 2021, pasuritë me vlerë më shumë se 14 milionë euro janë ngrirë ose sekuestruar, ndërsa pasuri me vlerë vetëm rreth 770,000 euro janë konfiskuar.¹³⁶

Krahas problemeve të evidentuara në vitet e mëparshme, sistemi prokurorial u sfidua nga pandemia COVID-19, veçanërisht në vitin 2020, e cila në mënyrë të pashmangshme përkeqësoi punën e prokurorisë. Vetëm një numër i vogël lëndësh janë ngritur dhe proceduar në lidhje me korrupsionin.¹³⁷ Trendi i përgjithshëm i trajtimit të këtyre lëndëve gjatë pesë viteve të fundit mbetet shqetësues. Në vitin 2021, gjykatat e Kosovës kanë pranuar më pak lëndë të korrupsionit se në vitin paraprak, por kanë zgjidhur edhe më pak lëndë, edhe pse në praktikë kanë pasur më pak punë.¹³⁸

Numri i vogël i aktakuzave lidhur me veprat penale të korrupsionit në vitin 2021 është shfaqur edhe në një numër të vogël të lëndëve të aktakuzave për pastrim parash. Në vitin 2021, Prokuroria ngriti vetëm shtatë aktakuza për rastet e pastrimit të parave.¹³⁹

Prokurori i Shtetit ofron statistika të veçanta për ndjekjen penale të lëndëve të korrupsionit duke ofruar raporte periodike, qoftë çdo gjashtë muaj¹⁴⁰ ose edhe çdo vit.¹⁴¹ Ato janë gjithëpërfshirëse dhe japin informacion të detajuar me të dhëna statistikore për trajtimin e këtyre subjekteve.



Ndërveprimet

Prokurori i Shtetit ka bashkëpunim të ngushtë kryesisht me policinë, gjyqësorin dhe Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit.

Ekzistojnë memorandume mirëkuptimi ndërmjet KPK-së, CIVIKOS-it dhe Këshillit të Medieve të Shkruara të Kosovës (KM-SHK) për ngritjen e kapaciteteve dhe kanalet e komunikimit për raportimin e rasteve të identifikuara nga media dhe shoqëria civile. Po ashtu ka një memorandum bashkëpunimi ndërmjet Prokurorit të Shtetit, KQZ-së dhe policisë për mbarëvajtjen e zgjedhjeve, si dhe marrëveshje mes KPK-së dhe Akademisë së Drejtësisë për trajnime të detyrueshme dhe trajnime shtesë për prokurorët.¹⁴²

Kryesuesi i KPK-së ka nënshkruar marrëveshje të ndryshme bashkëpunimi me institucionet vendore dhe ndërkombëtare në emër të KPK-së. Ndër to janë marrëveshja ndërmjet KGJK-së dhe KPK-së për shkëmbimin elektronik të të dhënave për sistemin informativ për menaxhimin e lëndëve (SMIL).¹⁴³ Sistemi SMIL është një projekt i përgatitur nga KGJK-ja dhe KPK-ja që merret me regjistrimin e lëndëve në mënyrë elektronike dhe i cili ofron qasje publike në të dhënat për administrimin e lëndëve nga këto dy institucione.

Megjithatë, në praktikë ka probleme në zgjidhjen efikase të lëndëve, vonesa në gjykime dhe gjithashtu mungesë dënimi efektiv në lëndët e korrupsionit (shih 3.2.2).

Rekomandimet e shtyllës

- Miratimi i plotë i kërkesave buxhetore të KPK-së në mënyrë që ata të rrisin rekrutimin e prokurorëve dhe stafit profesional për të përmbushur rolin e tyre të ndjekjes penale të korrupsionit.
- Ndryshimi i ligjit për KPK-në në lidhje me përbërjen dhe emërimin e tij për ta bërë atë vërtet pluralist sipas rekomandimeve të Komisionit të Venecias: zgjedhja me shumicë të thjeshtë duhet të zëvendësohet me sistemin proporcional të zgjedhjeve dhe emërimi i disa anëtarëve jo prokuror nga institucione të jashtme të pavarura ose të shoqërisë civile.
- Të punohet për ndryshime në Ligjin për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve për të përfshirë mundësinë e shkarkimit të prokurorëve për performancë të dobët.
- Organizimi, bashkë me Akademinë e Drejtësisë, i trajnimeve shtesë të specializuara për korrupsionin dhe krimet ekonomike. Kjo duhet të përfshijë një listë të trajnimeve të detyrueshme në lidhje me procesin e hetimit dhe hartimin e aktakuzave më cilësore për veprat penale të korrupsionit zyrtar dhe pastrimit të parave. Trajnim i veçantë është i nevojshëm edhe për prokurorët për zhvillimin e aftësive në hetimin dhe mbledhjen e provave në rastet e konfiskimit të pasurive të fituara në mënyrë të jashtëligjshme. KPK-ja duhet të angazhohet për prokurorët që marrin pjesë në trajnime speciale për këtë çështje në projektet e Këshillit të Evropës në Prishtinë, i cili organizon punëtorin dhe trajnime vjetore lidhur me çështjet e pastrimit të parave dhe konfiskimit të pasurisë së pajustificueshme.
- Rritja e nivelit të transparencës së KPK-së duke rregulluar problemet teknike të faqes së saj të internetit dhe duke rekrutuar zëdhënës. Në këtë drejtim, KPK-ja duhet të ndryshojë edhe paragrafin 2 të nenit 10 të Rregullores për Shërbimin e Komunikimit Publik në Prokurori, në mënyrë që zëdhënësi të mos ketë nevojë të kërkojë leje nga Kryeprokurorët përkatës ose KPK-ja para se të japë informacion.
- Të krijohet me Prokurorin e Shtetit një protokoll apo rregullore nënligjore që trajton çështjet me ndjeshmëri gjinore duke hartuar rregullore të veçanta për përcaktimin e politikave gjinore në institucionin e prokurorisë.
- Të sigurohet rekrutimi i një zyrtari për barazi gjinore në të gjitha qendrat e prokurorisë në Kosovë, i cili do të kishte për detyrë të trajtojë dhe shqyrtojë çështjet që kanë të bëjnë me gjininë, të drejtat e njeriut dhe diversitetin brenda prokurorisë.



REFERENCAT

- 1 Ai është gjithashtu ekskluzivisht përgjegjës për rastet më të ndërlikuara dhe me rrezikshmëri të lartë që lidhen me terrorizmin, gjenocidin dhe krimet e luftës.
- 2 Ligji Nr.03/L –225 për Prokurorin e Shtetit, neni 21.1.1, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2710>
- 3 Shih “Betimi për Drejtësi”, 15 prill 2023, <https://kli-ks.org/ikd-rritet-numri-i-rasteve-te-pazgjidhura-te-korrupsionit-gjykatat-dhe-prokurorite-u-treguan-joefikase-ne-vitin-2022/>, [qasur më 11 korrik 2023]
- 4 Intervistë me Kryetarin e Këshillit Prokurorial të Kosovës, Jetish Maloku, korrik 2022.
- 5 Një koeficient përcakton një shumë të caktuar dhe çdo kategori pagash i caktohet një faktor i caktuar koeficienti.
- 6 Buxheti i dorëzohet Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, e cila më pas e dorëzon buxhetin si pjesë e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës në Kuvendin Kombëtar për miratim. Shih: Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, neni 66.2, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2524>
- 7 Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës, Neni 7.1.10, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18920>
- 8 Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, neni 66.1, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2524>
- 9 Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, neni 20.2, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2524>
- 10 Ligji për Prokurorin e Shtetit, neni 21.1.1, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2710>
- 11 Paga e prokurorëve të Prokurorit të Shtetit është e barabartë me 90 përqind të pagës së Kryeprokurorit të Shtetit, paga e Kryeprokurorit të Prokurorisë Speciale është e barabartë me 95 përqind të pagës së Kryeprokurorit të Shtetit dhe paga e prokurorëve në Prokurorinë Themelore është jo më pak se 70 përqind e pagës së Kryeprokurorit të Shtetit.
- 12 Ligji për Prokurorin e Shtetit, neni 21, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2710>
- 13 Paga e Kryeprokurorit të Shtetit duhet të jetë e barabartë me pagën e Kryetarit të Gjykatës Supreme, paga e të cilit duhet të jetë e barabartë me pagën e Kryeministrit. Ndaj pagat rriten automatikisht kur i rritet paga e kryeministrit Shih: Ligji Nr.03/L –225 Për Prokurorin e Shtetit, neni 21.1.1, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2710>; Ligji për Gjykatat, neni 35.2, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18302>
- 14 Ligji për Prokurorin e Shtetit, neni 21,10, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2710>
- 15 Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese (2020), Kabineti i ri Kurti shfuqizon vendimet e ish-Qeverisë së Kosovës, <https://balkaninsight.com/2020/02/12/new-kurti-cabinet-repeals-former-kosovo-governments-decisions/>
- 16 Ligji për pagat në sektorin publik.
- 17 Aktgjykimi i lëndës nr. K0219/19 i Vlerësimit të Kushtetutshmërisë së Ligjit Nr. 06/L-111 për Pagat në Sektorin Publik, https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2020/07/gjk_ko_219_19_agj_ang.pdf
- 18 Për shembull, për shkak të përjashtimeve për disa institucione, (d.m.th. Dhomat e Posaçme e Kosovës, Agjencia Kosovare e Intelgjencës, Agjencia Kosovare e Privatizimit, Banka Qendrore e Kosovës dhe Kuvendi. Për më shumë shih: Grupi për Studime Juridike dhe Politike (2021), Ligji i Ri për Pagat në Kosovë: çfarë mungon dhe çfarë nevojitet për të siguruar një politikë të barabartë, efikase dhe jodiskriminuese të pagave, http://www.legalpoliti-calstudies.org/wp-content/uploads/2021/01/GLPS_PolicyAnalysis_Law-on-Salaries_Rr.H.pdf
- 19 <https://www.dukagjini.com/del-ne-konsultim-publik-projektligji-per-pagat/>; <https://www.gazetaexpress.com/enver-hasani-draft-ligji-aktual-i-paga-ve-nuk-i-kalon-filtrat-e-gjyqates-kushtetuese/>
- 20 Ligji për ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022.
- 21 Ligji për ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022.
- 22 Të dhënat e paraqitura në tabelë janë siguruar nga Këshilli Prokurorial i Kosovës përmes kërkesës për qasje në informata, të datës 13 korrik 2023. Shifrat e paraqitura në tabelë janë të dhëna për buxhetin përfundimtar të KPK-së të përcaktuara pas rishikimit të buxhetit që bëhet në qershor të çdo viti kalendarik.
- 23 Intervistë me Valdrin Krasniqin, ushtrues detyre i drejtorit të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, qershor 2022.
- 24 Ligji Nr. 08/L-167 për Prokurorin e Shtetit, neni 19, paragrafi 1, maj 2023.
- 25 Shih portalin Kallxo.Com, 28 dhjetor 2017: <https://kallxo.com/shkurt/tahiri-gjyqtaret-dhe-prokuroret-pagat-te-larta-ne-rajon/>, [qasur në korrik 2023]
- 26 Shih “Betimi për Drejtësi”, 28 dhjetor 2017, <https://betimiperdrejtisi.com/pagat-mujore-te-gjyqatesve-dhe-prokuroreve-kosovare/>, [qasur në korrik 2023]
- 27 Për shembull, një prokuror që shërben në Departamentin e Përgjithshëm tani merr pagë mujore prej rreth 1,700 €. Në bazë të këtij orientimi, prokurorët që shërbejnë në departamentet e larta marrin pagë mbi 2000€. Shih: Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, mars, 2022, “Deklaratat” https://akkks.org/en/deklarimi_i_pasuris/2044/Prokuroria_e_Shtetit/2044 [qasur më 5 tetor 2022]
- 28 Shih portalin Reporteri.net, nëntor 2022, <https://reporteri.net/lajme/ligji-i-ri-ul-pagat-ne-drejtisi-ky-eshte-koeficienti-per-gjyqtaret-dhe-prokuroret/> [qasur më 12 korrik 2023]
- 29 Portali Kallxo.Com, prill 2023, <https://kallxo.com/lajm/ligji-per-paga-dergohet-ne-kushtetuese/> [qasur më 12 korrik 2023]
- 30 Nga janari deri në dhjetor 2021, Akademia e Drejtësisë ka zhvilluar 114 aktivitete trajnimi. Në lidhje me programin e trajnimit 2022, numri i gjithëmbarshëm i trajnimeve të planifikuara për t’u kryer nga Akademia e Drejtësisë është dhënë nga Zyra për Marrëdhënie me Publikun e Akademisë së Drejtësisë, sipas kërkesës për qasje në informacion, dërguar më 4 korrik 2022.
- 31 Drejtësia Sot, “Mungesat e aktakuzave në veprat penale të korrupsionit”, (Prishtinë: GLPS, 2021), faqe 5.
- 32 Kushtetuta e Republikës së Kuvendit të Kosovës, neni 109, pika 1 dhe 2.
- 33 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 144.

- 34 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 110.
- 35 Ligji për Prokurorin e Shtetit, neni 26.
- 36 Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, neni 7, paragrafi 1, pika 3.
- 37 Kryeprokurori i Shtetit; shtatë anëtarë, prokurorë nga prokuroritë bazë, të përfaqësuar nga një anëtar, të zgjedhur nga prokurorët e asaj prokurorie; një anëtar, prokuror i Prokurorisë së Apelit, i zgjedhur nga prokurorët e asaj prokurorie; dhe një anëtar, prokuror nga Prokuroria Speciale, i përzgjedhur nga prokurorët e asaj prokurorie.
- 38 Një anëtar, avokat nga Oda e Avokatëve të Kosovës; një anëtar, profesor universitar i drejtësisë; dhe një anëtar përfaqësues i shoqërisë civile.
- 39 Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, neni 9, paragrafi 1, pikat 1 deri 4.
- 40 Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, neni 7, paragrafi 1, pika 3.
- 41 Komisioni i Venecias, Opinioni nr. 1063/2021 i Komisionit të Venecias mbi “Projekt-amendamentet e Ligjit për Këshillin Prokurorial” (Strasbourg: Komisioni i Venecias, 2021), p. 7
- 42 Shih Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, neni 20, paragrafi 4.
- 43 Komisioni i Venecias, Opinioni nr. 1063/2021 i Komisionit të Venecias mbi “Projekt-amendamentet e Ligjit për Këshillin Prokurorial” (Strasbourg: Komisioni i Venecias, 2021), fq. 14
- 44 Shih Gjykata Kushtetuese e Kosovës, Aktgjykimi në Rastin nr. K0100_101/22, 5 prill 2023 [qasur më 21 korrik 2023]
- 45 Shih po ashtu Gjykata Kushtetuese e Kosovës, Aktgjykimi në lëndën nr.Ko.100,101/22, paragrafi 294.
- 46 Gjithashtu, me Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, paragrafi 319, gjithashtu ka rekomanduar, por pohan se i) duhet të vendoset për pesë vota, përkatësisht dy të tretat në dy raundet e votimit; dhe (ii) çdo mënyrë e përcaktimit të vendimit të Këshillit duhet të vlerësohet në këndvështrimin e tij të përgjithshëm, duke shmangur vetëqeverisjen e prokurorëve por edhe politizimin e Këshillit, me theks në funksionalitetin e tij, për shkak të funksionimit ose joefikasitetit të një performancë siç është KPK-ja, ka një ndikim të jashtëzakonshëm në sundimin e ligjit dhe funksionimin e shtetit të së drejtës. Ndaj dhe një sqarim si më sipër, një zgjidhje e tillë e përshtatur përmes pikës 2/a të nenit kontestues, lidhur me funksionet më thelbësore kushtetuese të KPK-së dhe në kuadër të kulturës së pjesëmarrjes në KPK, pjesa e anëtarësisë joprokurorë të tyre do të cenonte “pavarësinë e plotë” funksionale të Këshillit, jashtë paragrafit 1 të nenit 110 të Kushtetutës dhe do të cenonte gjithashtu parimet e ndarjes dhe balancimit të pushteteve, të përcaktuara në nenin 4 të Kushtetutës.
- 47 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 109, paragrafi 7.
- 48 Rregullorja nr. 19/06 për emërimin e Kryeprokurorit të Shtetit dhe Kryeprokurorëve të Prokurorive të Republikës së Kosovës, të Këshillit Prokurorial të Kosovës.
- 49 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 109.
- 50 Kriteret përcaktojnë se kandidati duhet të jetë prokuror me mandat të përhershëm, të mos ketë ngritur aktakuzë, të mos jetë i dënuar për vepra penale, të ketë vlerësim pozitiv të performancës në tre vitet e fundit dhe të mos ketë masë disiplinore të shqiptuar në pesë vitet e mëparshme. Gjithashtu, kandidati duhet të ketë së paku tetë vjet përvojë pune si prokuror. Shih: Rregullorja nr. 19/06 për emërimin e Kryeprokurorit të Shtetit dhe Kryeprokurorëve të Prokurorive të Republikës së Kosovës, të Këshillit Prokurorial të Kosovës, neni 3, paragrafi 1. & Rregullorja nr. 19/06 për emërimin e Kryeprokurorit të Shtetit dhe Kryeprokurorëve të Prokurorive të Republikës së Kosovës, të Këshillit Prokurorial të Kosovës, neni 4, paragrafi 1, pika 1.
- 51 Kjo përcaktohet nga rregullorja e këshillit për riemërimin, shqyrtimin dhe emërimin e prokurorëve, ku theksohet se Këshilli mund të nënshkruajë marrëveshje bashkëpunimi me organizata vendore dhe ndërkombëtare në monitorimin e këtij procesi. Për më shumë shih Rregulloren për Riemërimin, shqyrtimin, emërimin e prokurorëve, neni 5.
- 52 Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës, neni 25.
- 53 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 109, paragrafi 6.
- 54 Portali Kallxo.Com, prill 2022, <https://kallxo.com/gjate/pavaresia-financiare-e-cunguar-e-keshillit-gjygesor-dhe-prokurorial-te-kosoves/> [qasur më 6 tetor 2022]
- 55 Drejtësia Tranzicionale Ballkanike (2018), Prokurori i Kosovës jep dorëheqjen pas kërcënimeve të supozuara, <https://balkaninsight.com/2018/08/15/kosovo-prosecutor-quits-mes-pretended-threats-08-15-2018/>; Drejtësia Tranzicionale Ballkanike (2018), ish-prokurori i Kosovës që po heton listën e veteranëve përballtet me ‘kërcënime të vazhdueshme’, <https://balkaninsight.com/2018/08/20/fake-veterans-lists-demtuar-buxheti-kosovar-pasluftem-prokurori-20-08-2018/>
- 56 “Betimi për Drejtësi”, mars 2022, <https://betimiperdrejtisi.com/perseri-hudhet-poshte-aktakuza-per-korrupcion-ndaj-liburn-aliut-dhe-te-tjereve/> [qasur më 3 gusht 2022]
- 57 Shih “Betimi për Drejtësi”, shkurt 2022, <https://betimiperdrejtisi.com/edhe-ldk-e-dergon-ne-kushtetuese-ligjin-per-zyrtaret-publike/> [qasur më 21 korrik 2023]
- 58 Shih portalin Nacionale.Com, prill 2023, <https://nacionale.com/drejtisi/degradohet-ish-kryeprokurori-buzhala-gjykata-supreme-konfirmon-vendi-min-e-kpk-se>, [qasur më 21 korrik 2023]
- 59 Portali Kallxo.Com, shtator 2022, <https://kallxo.com/lajm/keshilli-prokurorial-i-kosoves-dhe-prokurori-i-shtetit-reagojne-ndaj-deklaratave-te-kryeministrit-kurti-dhe-ministres-haxhiu/> [qasur më 6 tetor 2022]
- 60 Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës, neni 7, paragrafi 1, pikat 24 dhe 30.
- 61 Ligji për Prokurorin e Shtetit, neni 10.
- 62 Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës, neni 12, paragrafi 3.
- 63 Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës, neni 12, paragrafi 3.
- 64 Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës, neni 4.
- 65 Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës, neni 4.
- 66 Ligji për qasje në dokumente publike, neni 16.
- 67 Rregullorja për Riemërimin, shqyrtimin dhe emërimin e prokurorëve (qershor 2022)
- 68 Rregullore për transferimin dhe avancimin e prokurorëve të shtetit, (nëntor 2021)
- 69 Ligji për disiplinën, përgjegjësinë e gjyqtarëve dhe prokurorëve, (dhjetor 2018).
- 70 Rregullore për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve (Janar, 2021).
- 71 Portali Telegrafi, maj 2021, <https://telegrafi.com/prokurori-shtetit-publikon-udhezimin-per-aktivitetet-e-ke-tij-institutit/> [qasur më 4 korrik 2022]



72 Faqja e internetit e Këshillit Prokurorial të Kosovës, <http://www.psh-ks.net/?page=1,1> [qasur më 23 qershor 2022]

73 Faqja e internetit e Këshillit Prokurorial të Kosovës, <https://prokuroria-rks.org/> [qasur më 23 qershor 2022]

74 Shih <https://prokuroria-rks.org/kpk/dokumente-publikime/82/93/646/646/>, [qasur më 23 korrik 2023]

75 Intervistë me Ehat Miftaraj, IKD, Qershor 2022.

76 Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, "Raport-Monitorimi i Planit të Punës së Prokurorit të Shtetit 2021", (Prishtinë: 2021).

77 "Betimi për Drejtësi", shkurt 2022, <https://betimiperdrejtesi.com/cfare-thote-aktakuza-per-korrupsion-ndaj-pal-lekajt-dhe-te-tjereve-per-rastin-e-bech-tel-enka/> [qasur më 29 korrik 2022]

78 Memorandum mirëkuptimi ndërmjet KPK-së, Lëvizjes FOL, Internews Kosova dhe Qendrës së Debatit, (nëntor 2020).

79 Memorandumi i Mirëkuptimit në mes të KPK-së dhe GLPS-së, maj 2019.

80 Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, "Raporti vjetor i punës për 2021". (Prishtinë: Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, 2022), faqe 5.

81 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 110.

82 Ligji për përgjegjësinë e gjyqtarëve dhe prokurorëve, neni 9

83 Vlen të theksohet se përveç ligjit në fjalë, KPK-ja ka miratuar edhe Rregulloren për Procedurën Disiplinore për Prokurorët, e cila rregullon më hollësisht procedurën e pranimit, shqyrtimit të ankesave dhe vendosjes për këto ankesa disiplinore.

84 Ligji për përgjegjësinë e gjyqtarëve dhe prokurorëve, neni 1

85 Ligji për përgjegjësinë e gjyqtarëve dhe prokurorëve, neni 8

86 Ligji parasheh mundësinë që ankuuesit të mund t'i paraqesin ankesë Avokatit të Popullit nëse duan të mos rrezikohen ose për shkak të frikës nga hak-marrja ose ndonjë situatë tjetër.

87 Kodi Penal i Republikës së Kosovës (janar, 2019).

88 Megjithatë, ata nuk gëzojnë imunitet dhe mund të shkarkohen nga detyra nëse kanë kryer një shkelje të qëllimshme të ligjit ose për shkak të një dënimi për një vepër të rëndë penale që mund të jetë e një natyre korruptive ose tjetër.

89 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 109, pika 6.

90 Ligji për përgjegjësinë e gjyqtarëve dhe prokurorëve, neni 6

91 Ligji për përgjegjësinë e gjyqtarëve dhe prokurorëve, neni 7.

92 Gjykatat e tjera nuk kanë juridiksion për të shqyrtuar dhe vendosur për procedurën disiplinore ndaj prokurorëve. Gjykata Supreme mund ta lërë në fuqi vendimin e Këshillit, ta ndryshojë ose ta kthejë në KPK për rishqyrtim. Vendimi i Gjykatës Supreme është përfundimtar.

93 Ligji për përgjegjësinë e gjyqtarëve dhe prokurorëve, neni 15, paragrafi 8 dhe 9.

94 Intervistë me Ehat Miftaraj, IKD, qershor 2022.

95 Shih raportin vjetor të punës së KPK-së për vitin 2021.

96 Për shkak të performancës së dobët të prokurorëve në këto raste, KPK-ja nuk ka marrë masa disiplinore.

97 Portali Kallxo, nëntor 2019, <https://kallxo.com/ligji/aktakuze-kunder-ish-prokurorit-agron-matjani/> [qasur më 10 gusht 2022]

98 Portali Telegrafi, maj 2019, <https://telegrafi.com/shkarkohet-nje-prokuror-dhe-suspendohet-nje-prokurore-nga-kpk/> [qasur më 10 gusht 2022]

99 "Betimi për Drejtësi", shkurt 2022, <https://betimiperdrejtesi.com/kpk-degradon-dhe-transferon-prokuroren-shemsije-asllani/> [qasur më 10 tetor 2022]

100 Portali Kallxo.Com, korrik 2022, <https://kallxo.com/lajm/raportimi-i-kallxo-suspendohet-kryeprokurori-i-gjakoves-ramiz-buzhala/> [qasur më 10 tetor 2022]

101 Drejtësia Sot, "Natyra e çështjeve disiplinore në sistemin gjyqësor dhe prokurorial të Kosovës dhe funksionimi i mekanizmit disiplinor", (Prishtinë: GLPS, 2021), faqe 25.

102 Drejtësia Sot, "Natyra e çështjeve disiplinore në sistemin gjyqësor dhe prokurorial të Kosovës dhe funksionimi i mekanizmit disiplinor", (Prishtinë: GLPS, 2021), faqe 28.

103 Instituti Demokratik i Kosovës, dhjetor 2018, <https://kdi-kosova.org/aktivitetet/prokuroria-e-shtetit-me-kod-te-ri-te-etikes/> [qasur më 5 korrik 2022]

104 Kodi i Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Prokurorët, i miratuar nga Këshilli Prokurorial i Kosovës në vitin 2019, faqe 6.

105 Konflikti i interesit është një rrethanë në të cilën prokurori ka një interes privat që prek, mund të ndikojë ose duket se ndikon në paanshmërinë dhe objektivitetin e detyrës së tij zyrtare.

106 Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkzionit Publik, neni 2.

107 Sipas ndryshimeve të reja ligjore, emri i këtij institucioni do të jetë Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit.

108 Ligji për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë, neni 1.

109 Ligji për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë, neni 5.

110 Kodi Penal i Kosovës, neni 430.

111 Kodi i Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Prokurorët, i miratuar nga Këshilli Prokurorial i Kosovës në vitin 2019, faqe 12.

112 Kodi i Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Prokurorët, faqe 12.

113 Kodi i Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Prokurorët, i miratuar nga Këshilli Prokurorial i Kosovës në vitin 2019, faqe 14.

114 Kodi i Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Prokurorët, faqe 9.

115 Ligji për përgjegjësinë e gjyqtarëve dhe prokurorëve, neni 9

116 Ligji për Prokurorin e Shtetit, neni 2 dhe 4.

117 Ligji për Prokurorin e Shtetit i ndryshuar dhe plotësuar në vitin 2015 dhe 2018.

118 Ligji për avokatinë, neni 10.

119 Ligji për Prokurorin e Shtetit, neni 38.



120 Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës, neni 30.

121 Shih Komisionin për vlerësimin e prokurorëve, 'Raport statistikor për vlerësimin e performancës së prokurorëve për vitet 2014-2022', https://prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/Vleresimet_e_performanca_se_prokuroreve_nga_Komisioni_2014-2022.pdf [qasur më 21 korrik 2023]

122 Shih portalin JavaneWS.al, dhjetor 2017, <https://javaneWS.al/skandali-pronto-3-pergjimet-tregojne-se-kryeprokurori-lumezi-eshte-njeriu-pdk-se/> [qasur më 21 korrik 2023]

123 Ndërkohë, ka pasur veprime lidhur me çështjen ndaj ish-prokurores Shemsije Asllani, e cila u degradua në pozitë nga Këshilli Prokurorial pas publikimit të këtij skandali.

124 Këshilli Prokurorial i Kosovës, Raporti i Punës për vitin 2021, faqe 30.

125 Portali Radio Evropa e Lirë, shtator 2022, <https://www.evropalire.org/a/shkarkim-dhunimi-i-te-mitures-/32033112.html?fbclid=IwAR0p> [qasur më 11 tetor 2022]

126 Kushtetuta e Kosovës, neni 9.

127 Ligji për barazinë gjinore (qershor 2015).

128 Raporti nga Axiom International, "Vlerësimi Institucional Gjinor dhe Përfshirja Sociale i Prokurorisë së Kosovës" (Prishtinë, 2021), faqe 14.

129 Raporti nga Axiom International, "Vlerësimi Institucional Gjinor dhe Përfshirja Sociale i Prokurorisë së Kosovës" (Prishtinë, 2021), faqe 24.

130 Këshilli Prokurorial i Kosovës, 'Raporti vjetor i punës për 2021'.

131 "Betimi për Drejtësi", gusht 2022, <https://betimiperdrejtesi.com/rasti-stenta-1-ferid-agani-dhe-gani-shabani-lirohen-nga-akuzat-per-korrupsion/> [qasur më 2 gusht 2022]

132 BIRN Kosovë/Internews Kosova, "Imuniteti kundër korrupsionit", (Prishtinë: BIRN, 2022), faqe 26.

133 Këshilli Prokurorial i Kosovës, 'Raporti Vjetor i Punës për vitin 2021', faqe 12.

134 BIRN Kosovë/Internews Kosova, "Imuniteti kundër korrupsionit", (Prishtinë: BIRN, 2022), faqe 26.

135 Shih raportin "Betimi për Drejtësi", "Dështimi i drejtësisë në luftën kundër korrupsionit", faqe 6. Për më shumë, shih linkun: <https://kli-ks.org/desh-timi-i-drejtësisë-ne-luftimin-e-korrupsionit/>, [qasur më 21 korrik 2023]

136 Këshilli Prokurorial i Kosovës, 'Raporti Vjetor i Punës për vitin 2021', faqe 16.

137 BIRN Kosovë/Internews Kosova, "Imuniteti kundër korrupsionit", (Prishtinë: BIRN, 2022), faqet 25 dhe 26.

138 BIRN Kosovë/Internews Kosova, "Imuniteti kundër korrupsionit", (Prishtinë: BIRN, 2022), faqe 26.

139 Drejtësia Sot, "Monitorimi i Sistemit Gjyqësor dhe Prokurorial në Kosovë", (Prishtinë: GLPS, 2022)

140 Këshilli Prokurorial i Kosovës, 'Raporti gjashtëmuor mbi Prokurorin e Shtetit -Janar-Qershor 2022'. (Prishtinë: KPK, gusht, 2022.

141 Këshilli Prokurorial i Kosovës, 'Raporti Vjetor i Punës për vitin 2021', (Prishtinë, mars 2022).

142 Këshilli Prokurorial i Kosovës, 'Raporti Vjetor i Punës për vitin 2021', faqe 51.

143 Marrëveshja ndërmjet Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës për shkëmbimin elektronik të të dhënave SMIL, nëntor 2021





SEKTORI PUBLIK




PËRMBLEDHJE


Sektori publik është një nga sektorët më kompleks në vend, me rreth 90,000 punonjës në nivel qendror dhe komuna.¹




Kapacitetet



Qeverisja



Roli





Sektori u është nënshtruar ndryshimeve të mëdha në vitin 2022. Administrata publike në Kosovë është e organizuar në disa kategori të shërbimit civil. Këto kategori ndahen ndërmjet autoriteteve qendrore dhe lokale. Zyra e Kryeministrit dhe ministritë janë zyrat më të larta të administratës publike. Autoritetet qendrore varen nga shërbimi civil për të kryer detyra joministore dhe detyra të tjera administrative. Shërbimi civil lokal është pjesë e autoritetit komunal. Legjislacioni njeh gjithashtu organet e pavarura të administratës publike si persona juridikë të krijuar për të kryer veprimtari administrative që kërkojnë një shkallë të lartë pavarësie për interesin publik.

Disa institucione janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e funksionimit të aspekteve të ndryshme të sektorit publik, si Auditori i Përgjithshëm, Bordi i Pavarur Mbikëqyrës dhe Institucioni i Avokatit të Popullit. Njësia e Monitorimit dhe Politikës së Ndërmarrjeve Publike (NP) është përgjegjëse për monitorimin e ndërmarrjeve shtetërore (NSH), por ka burime dhe autoritet të kufizuar në vendimmarrje lidhur me pasuritë strategjike. Njësia i mungon transparenca, me raporte të rralla të performancës dhe funksionon pa drejtues.

Sektori publik përballet me mungesë të burimeve njerëzore, veçanërisht për shkak të pagave jokonkurrese dhe grevave të punëtorëve. Përderisa Kosova ka ligje gjithëpërfshirëse për të siguruar pavarësinë e sektorit publik, ka shqetësime rreth ndikimit politik, veçanërisht në emërimet e shërbyesve të lartë civilë. Bordi i Pavarur Mbikëqyrës luan rol në mbrojtjen e të drejtave të punonjësve, por është përballur me sfida operationale. Llogaridhënia në sektorin publik konsiderohet e pakënaqshme, me një rritje të abuzimeve të raportuara dhe mungesë të sanksioneve efektive për rastet e korrupsionit. Korrupsioni mbetet i përhapur dhe luftimi i tij në praktikë shpesh mungon, duke kontribuar në perceptimin e mosndëshkimit në mesin e politikanëve dhe shërbyesve civilë. Sjellja etike nuk është e rregulluar në mënyrë efektive dhe trajnimi për integritet është i pamjaftueshëm.

Kosova ka dispozita të forta ligjore për transparencë, duke i lejuar publikut qasje në informacione për aktivitetet e sektorit publik. Veçanërisht, ka pasur përmirësime në disponueshmërinë e të dhënave të prokurimit publik përmes një platforme të prokurimit elektronik dhe transparencës në shpalljet e konkurseve të punës. Prokurimi publik, veçanërisht në sektorin e shëndetësisë, raportohet të jetë i korruptuar, duke çuar në joefikasitet dhe shpërdorim. Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik përballet me sfida në monitorimin e aktiviteteve të prokurimit, duke përfshirë mungesën e stafit, dhe disa zyrtarë të lartë të përfshirë në korrupsion vazhdojnë të veprojnë pa u ndëshkuar.



Kapacitetet

**INDIKATORI 5.1.1
BURIMET (NË PRAKTIKË)**

50/100



Sektori publik ka burime të ndryshme. Megjithatë, ka mangësi të konsiderueshme në burimet njerëzore, veçanërisht sa u përket pagave jokonkurrese, gjë që kontribuon në një shkallë të caktuar joefektiviteti në kryerjen e detyrave të tij..

Në vitin 2022, buxheti i ndarë për paga dhe mëditje në sektorin publik ishte rreth 670 milionë euro. Kjo shënon një rritje prej 5 për qind në krahasim me vitin 2021, kur buxheti i ndarë ishte 640 milionë euro.² Pavarësisht kësaj rritjeje dhe kryesisht për shkak të krizës ekonomike të shkaktuar nga pandemia COVID-19, vendi është përballur me presion të vazhdueshëm nga sindikatat e sektorit publik, duke çuar në greva. Grevistët kërkuar rritje të pagave në sektorin publik dhe ndarjen e 100 eurove si pagesë të njëhershme për punëtorët deri në hyrjen në fuqi të Projektligjit për pagat.³

Pagat në sektorin publik pritet të rriten me Ligjin e ri për Pagat, i cili parasheh nivelizimin e koeficientëve në pagat e sektorit publik. Megjithatë, mospërcaktimi i vlerës monetare të një koeficienti për pagat e sektorit publik është bërë burim i vazhdueshëm mosmarrëveshjeje me sindikatat.⁴

Sipas raportit të Komisionit Evropian, progresi drejt lehtësimit të procedurave administrative është ngadalësuar. Portali “e-Kosova” është funksional, por ende i mungojnë një numër shërbimesh digjitale që do ta bënin atë më efektiv dhe më të lehtë për t’u përdorur nga qytetarët dhe bizneset.⁵

**INDIKATORI 5.1.2
PAVARËSIA (SIPAS LIGJIT)**

75/100



Ekzistojnë ligje gjithëpërfshirëse që sigurojnë pavarësinë e sektorit publik. Megjithatë, legjislacioni i sapomiruar për zyrtarët publikë në shtator 2023 ofron liri të panevojshme në procedurat e rekrutimit, transferimit dhe disiplinës, duke krijuar probleme për rekrutimin e bazuar në merita.

Ligji për Zyrtarët Publikë⁶ dhe Ligji për Shërbyesit Civilë janë mekanizmat kryesorë ligjorë që rregullojnë funksionimin e sektorit publik. Ligji për zyrtarët publikë përcakton se punësimi i zyrtarëve publikë në institucionet e Republikës së Kosovës bazohet në meritë, integritet moral, paanshmëri dhe stabilitet.⁷ Megjithatë, ligji në këtë formë është kritikuar për mos adresimin e komenteve të BE-së dhe Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) Mbështetja për Përmirësim në Qeverisje dhe Menaxhim (SIGMA). Sipas Zyrës së BE-së në Kosovë, “ligji i ri për zyrtarët publikë është problematik në lidhje me sigurimin e një shërbimi civil të bazuar në merita që mund të menaxhojë efektivisht burimet njerëzore, pasi shton diskrecionin e tepruar në rekrutimin, transferimin dhe procedurat disiplinore të shërbyesve civilë, potencialisht duke e bërë shërbimin civil të cenueshëm ndaj politizimit.”⁸ Ligji për shërbyesit civilë përcakton menaxhimin dhe organizimin e një shërbimi civil të paanshëm.⁹

Rregullorja për pranimet dhe karrierën në shërbimin civil rregullon rekrutimin dhe avancimin në shërbimin civil. Sipas rregullores, panelet e rekrutimit dhe promovimit krijohen nga qeveria dhe përbëhen nga pesë anëtarë, njëri prej të





cilëve është ekspert i jashtëm.¹⁰ Lidhur me emërimet dhe shkarkimet brenda departamenteve të caktuara në sektorin publik, menaxherët e lartë janë pjesë e komisioneve të vlerësimit dhe kanë diskrecion në përcaktimet e stafit.¹¹

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës (KPSHMCK) është mekanizëm për mbrojtjen e punonjësve të sektorit publik. Ligji i jep Bordit kompetencën për të shqyrtuar dhe marrë vendime për ankesat e shërbyesve civilë dhe kandidatëve për t'u pranuar në shërbimin civil.¹² Ky Bord gjithashtu mbikëqyr procedurën e përzgjedhjes dhe vendos nëse emërimi i shërbyesve civilë në nivelin e lartë drejtues është kryer në përputhje me legjislacionin, rregullat dhe parimet përkatëse.¹³ Vendimet e Bordit janë përfundimtare dhe mund të apelojnë vetëm në gjykatat kompetente.

Kosova nuk e ka rregulluar çështjen e lobimit parlamentar për përfshirjen apo mospërfshirjen e disa projekteve apo çështjeve në programin apo buxhetin qeverisës.¹⁴



Bartësit e institucioneve shtetërore, veçanërisht ata që përfaqësojnë partitë në pushtet, herë pas here ndërhyjnë në aktivitetet e sektorit publik, siç është procesi i rekrutimit në këtë sektor.

Një ndërhyrje e tillë manifestohet në praktikë përmes emërimeve politike, të cilat ndër vite kanë ndikuar në aktivitetet e këtij sektori. Për shembull, hulumtimi i vitit 2020 i publikuar nga organizata BPRG zbuloi se rekrutimi dhe promovimi në pozicione në sektorin publik rrallëherë bazohen në nevojat institucionale ose kualifikimet e kandidatëve.¹⁵ Proceset e rekrutimit ose punësimit të stafit mbeten shumë të politizuara. Kështu, besnikëria e partisë është shpesh më e rëndë-

sishme se kapaciteti profesional.¹⁶ Në qershor të vitit 2021, pas shqetësimeve për ndikim politik dhe emërimet të pabazuara në meritë, Kuvendi shkarkoi pesë anëtarët e bordit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil.¹⁷

Raporti i Komisionit Evropian nënvizon gjithashtu se mungon një sistem i centralizuar për rekrutimin e bazuar në merita për kategorinë e lartë të zyrtarëve publikë dhe ndonjëherë me ndikim politik.¹⁸ Për shembull, Naim Bardiqi u shkarkua nga pozita e sekretarit të Ministrisë së Shëndetësisë në vitin 2020 kur në postin e ministrit ishte Armend Zemaj (pjesë e Lidhjes Demokratike të Kosovës [LDK]) me akuzat se ka keqpërdorur detyrën zyrtare. Ky shkarkim erdhi si rezultat i ndryshimeve në qeverisjen politike të ministrisë në fjalë, pasi Bardiqi u emërua sekretar në kohën e ministrit Uran Ismajli.¹⁹ Pas marrjes së detyrës së ministrit të Shëndetësisë, Arben Vitia (pjesë e Lëvizjes Vetëvendosje [LVV]) e kishte kthyer sërish në postin e sekretarit të Ministrisë së Shëndetësisë.²⁰ Në arsyetimin e këtij vendimi thuhet se që nga vendimi i Zemajt në vitin 2020, kur Naim Bardiqi ishte pezulluar pa pagesë, ndaj tij nuk është nisur, zhvilluar dhe përfunduar procedura disiplinore.²¹ Një rast tjetër është shkarkimi i sekretarit të përgjithshëm të Ministrisë së Infrastrukturës Izedin Bytyqi në vitin 2020 nga ish-ministri i Infrastrukturës Arban Abrashi (LDK) për t'u rikthyer në të njëjtën pozitë në korrik 2023 nga ministri Liburn Aliu (LVV). Shkarkimi i Bytyqit u pa si ndërhyrje në emërimin dhe lirin e pozitave.²² Një situatë e ngjashme është vënë re edhe në ministrinë e tjera, ku me ndryshimin e qeverisë kanë ndodhur shumë shkarkime, emërimet dhe transformime në poste të larta.²³

Ligji për zyrtarët publikë ka hyrë në fuqi në vitin 2023; megjithatë, ky ligj rrezikon të krijojë dhe përkeqësojë zbrazëtitë ekzistuese në kapacitetet administrative.²⁴ Gjithashtu, ritmi i përgjithshëm i reformave të administratës publike mbetet i pamjaftueshëm për të dhënë rezultate të prekshme.²⁵

KPSHMCK mbron të drejtat e punonjësve të sektorit publik, duke shqyrtuar ankesat e dorëzuara nga nëpunësit civilë dhe kandidatët për praninë në shërbimin civil. Gjatë vitit 2022, Bordi shqyrtoi 1692 ankesa dhe mori vendime për 971 prej tyre, nga të cilat 287 u miratuan.²⁶ Megjithatë, gjatë dy periudhave kohore, në vitet 2019-2020 dhe 2021, Bordi nuk ishte funksional për shkak të mungesës së anëtarëve.²⁷



Qeverisja



Sipas Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurive dhe Dhuratave, zyrtarët e lartë të sektorit publik janë të detyruar të deklarojnë pasurinë e tyre në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit për një periudhë njëvjeçare. Deklarimet duhet të publikohen në faqen e internetit të Agjencisë.²⁸


Ligji për Qasjen në Dokumente Publike është baza e vetme ligjore që rregullon menaxhimin e informacionit publik.²⁹ Ligji detyron institucionet publike të publikojnë në mënyrë proaktive të gjitha dokumentet publike të prodhuara, të marra, të mbajtura ose të kontrolluara në formë elektronike.³⁰

Emërimet në institucionet e sektorit publik rregullohen me ligjin për zyrtarët publikë. Ligji përcakton detyrimin që procedura e rekrutimit të bazohet në "konkurs të hapur dhe publik". Megjithatë, kjo nuk është përcaktuar më tej se çfarë saktësisht duhet të publikohet në lidhje me procesin e rekrutimit.³¹

Të dhënat e prokurimit publik në Kosovë rregullohen me Ligjin për Prokurimin Publik në Kosovë, i cili është ndryshuar dhe plotësuar në vitin 2014 dhe 2016. Me Ligjin e ri për Prokurimin Publik dhe kërkohet që ato të jenë publike.



Kjo përfshin të dhëna për kushtet e kontratës, njoftimin për dhënien e kontratës dhe detajet e përfutjesit.³² Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik është përgjegjës për ruajtjen e të dhënave në lidhje me prokurimin publik.³³



Publiku mund të marrë informacionin më të rëndësishëm për aktivitetet e sektorit publik. Megjithatë, OSHC-të dhe mediat kanë kritikuar disa institucione për kufizimin e qasjes në disa raste.

Qytetarët kanë mundësi të qasen në informacionin mbi aktivitetet e sektorit publik nëpërmjet platformave institucionale. Megjithatë, OSHC-të dhe mediet kanë kritikuar vazhdimisht institucionet publike, veçanërisht Ministrinë e Shëndetësisë, dhe qeverinë në lidhje me Fondin e Sigurisë³⁴ për mos adresimin e kërkesave të tyre për qasje në dokumente publike dhe pretendojnë se institucionet publike janë selektive në dokumentet që ofrojnë qasje dhe priren të fshehin kontrata të rëndësishme.³⁵ Gazetarët dhe hulumtuesit përballesh me sfida në qasjen e dokumenteve publike. Për shembull, Saranda Ramaj, gazetare, hulumtoi 78 ditë, dërgoi emaille të shumta pasuese dhe paraqiti ankesë në Agjencinë për Informim dhe Privatësi përpara se të merrte një përgjigje nga Ministria e Shëndetësisë.³⁶ Agjencia për Informim dhe Privatësi është institucion i pavarur sipas ligjit për qasje në dokumente publike. Gjatë vitit 2022, ky institucion ka pranuar më shumë se 180 ankesa për qasje në dokumente publike.³⁷



Deklarimi i pasurisë së zyrtarëve të sektorit publik dhe punonjësve që duhet të deklarojnë pasurinë e tyre (shih 5.2.6) janë lehtësisht të qasshme në faqen zyrtare të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.³⁸ Me kërkesë të Agjencisë, organet qendrore dhe vendore, institucionet e sektorit publik, bartësit e autorizimeve publike dhe personat e tjerë juridikë publikë ose privatë, duhet t'i paraqesin ato pa pagesë në Agjenci, brenda 8 ditëve pas kërkesës së tillë, të gjitha të dhënat, përfshirë të dhënat personale dhe dokumentet e nevojshme për kryerjen e detyrave të Agjencisë.³⁹

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP) publikon rregullisht në portalin e prokurimit elektronik të dhëna në lidhje me kontratat, ftesat dhe njoftimet e tjera lidhur me procedurat e prokurimit.⁴⁰ Të dhënat në lidhje me procedurat e tenderimit publikohen edhe në platformat e institucioneve përkatëse, si emri i autoritetit kontraktues, aktiviteti, vendi, lloji i furnizimit, subjekti, vlera, procedurat dhe datat⁴¹

Transparenca në lidhje me publikimin e vendeve të lira të punës në sektorin publik është mjaft e kënaqshme. Në shumicën e rasteve, shpalljet e vendeve të lira janë publike dhe bëhen zakonisht në platformat online dhe gjithashtu në media.⁴²

**INDIKATORI 5.2.3
LLOGARIDHËNIA
(SIPAS LIGJIT)**

100/100

Ekzistojnë dispozita të forta që sigurojnë që punonjësit e sektorit publik duhet të raportojnë dhe të jenë përgjegjës për veprimet e tyre. Ligji i ri për zyrtarët publikë ka forcuar më tej llogaridhënien duke përfshirë dispozita për reduktimin e periudhës së vlerësimit të periudhës kontraktuale nga pesë vjet në katër vjet.

Ligji për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, i cili ka zëvendësuar Ligjin për Mbrojtjen e Informatorëve, rregullon mbrojtjen e sinjali-



zuesve të korrupsionit. Dispozitat e këtij ligji janë gjithëpërfshirëse dhe shpjegojnë format e sinjalizimit apo ekspozimit. Ligji parasheh që zyrtari përgjegjës për sinjalizimin në institucione është përgjegjës për marrjen e raporteve nga sinjalizuesit në lidhje me shkeljet ose keqpërdorimin e detyrës zyrtare.⁴³

Ligji për zyrtarët publik parasheh sanksione për punonjësit e sektorit publik nëse konsiderohet se kanë shkelur detyrat e tyre të punës dhe detyrimet ligjore nëpërmjet zhvatjes, ryshfetit, korrupsionit ose abuzimit të informacionit të privilegjuar shtetëror.⁴⁴ Krahas sanksioneve disiplinore, në Kodin Penal parashihen edhe sanksione penale në lidhje me keqpërdorimin e pozitës apo autoritetit zyrtar.⁴⁵


Qytetarët mund të paraqesin ankesa kundër autoriteteve të sektorit publik në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Institucionin e Avokatit të Popullit dhe Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm, varësisht nga natyra e ankesës. Sa u përket ankesave për procedurat e prokurimit publik, Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) është autoriteti më i lartë ligjor për shqyrtimin e ankesave apo aplikacioneve nga operatorët ekonomikë dhe autoritetet kontraktuese dhe marrjen e vendimeve përkatëse. Vetëm gjyqësori mund të ndryshojë vendimet e OSHP-së.⁴⁶ Nga ana tjetër, KPSHMC është organi që shqyrton dhe vendos për ankesat e shërbyesve civilë kundër vendimeve të institucioneve të cilave ata u përkasin.⁴⁷

Zyra Kombëtare e Auditimit dhe Njësia e Auditimit të Brendshëm janë mekanizmat kryesorë për auditimin e sektorit publik (shih shtyllën e Zyrës Kombëtare të Auditimit).⁴⁸ Agjencitë e pavarura duhet t'i raportojnë Kuvendit të Kosovës në mënyrë periodike.⁴⁹



**INDIKATORI 5.2.4
LLOGARIDHËNIA
(NË PRAKTIKË)**

50/100



Ndërsa punonjësit e sektorit publik duhet të raportojnë dhe të japin llogari për veprimet e tyre, kjo përgjegjësi është e pjesshme pasi ka një numër të madh të abuzimeve të raportuara.

Niveli i llogaridhënies së zyrtarëve të sektorit publik konsiderohet i pakënaqshëm sipas raporteve të Komisionit Evropian, kryesisht në zbatimin e Ligjit për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura.⁵⁰

Sipas kryesuesit të KPSHMC-së, ka një rritje që nga viti 2021 në rastet dhe ankesat raportuar për abuzime nga punonjësit e sektorit publik.⁵¹ Ka pasur raste kur ndaj zyrtarëve publikë, veçanërisht atyre të profilit të lartë, janë iniciuar procedura disiplinore dhe kallëzime për vepra penale. Që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës, prokurorët kanë ngritur 298 aktakuza kundër 216 politikanëve – shumica dërrmuese e tyre për vepra penale të korrupsionit. Megjithatë, asnjëri prej tyre nuk është dënuar me vendim të formës së prerë me burgim efektiv.⁵²

KPSHMC në vitin 2021 ka pranuar gjithsej 884 ankesa të cilat janë dorëzuar drejtpërdrejt nga shërbyesit civilë si dhe nga kandidatët për pranim në shërbimin civil të Republikës së Kosovës.⁵³ Përveç numrit të ankesave, KPSHMC-ja ka pranuar edhe 328 aktgjykime nga Gjykata Themelore në Prishtinë, ku janë shqyrtuar gjithsej 1235 ankesa. Nga këto ankesa kishte detyrim ligjor për zbatimin e 217 vendimeve të bordit, prej të cilave 182 ishin përfundimtare. Ndërkohë, 27 vendime kanë detyruar subjektet e punësimit të rishqyrtojnë vendimet e tyre.⁵⁴

Monitorimi i prokurimit është një çelës për të kontrolluar aktivitetet e prokurimit. Me mandat, Departamenti i Monitorimit të KRPP-së duhet të kontrollojë aktivitetet e prokurimit në dy faza, përkatësisht para dhënies së kontratës dhe pas dhënies së kontratës.⁵⁵ Përderisa departamenti kryen monitorim para dhënies së kontratës, ata nuk kryejnë monitorim pas dhënies së kontratës; një nga problemet është mungesa e stafit.⁵⁶ Nuk ka statistika për numrin e rasteve të sinjalizimit në lidhje me prokurimin publik. Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka disa statistika në përmbledhjen e saj, por ato nuk detajojnë nëse raste të tilla vijnë nga sinjalizimi apo forma të tjera.⁵⁷

Raporti i Departamentit të Shtetit të SHBA-së thekson se ka shumë raste kur zyrtarë të lartë në sektorin publik janë përfshirë në korrupsion, por ende veprojnë pa u ndëshkuar.⁵⁸

**INDIKATORI 5.2.5
MEKANIZMAT E
INTEGRITETIT (SIPAS LIGJIT)**

75/100



Ekzistojnë dispozita për të garantuar integritetin e shërbyesve civilë. Megjithatë, Kodi i Sjelljes nuk parasheh sanksione specifike për shkeljet e kryera nga zyrtarët.

Mekanizmat e integritetit rregullohen përmes Kodit të Sjelljes së Shërbimit Civil,⁵⁹ Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurive dhe Dhuratave, dhe Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Kryerjen e Një Funkcioni Publik.⁶⁰ Megjithatë, Kodi i Sjelljes, i cili ka hyrë në fuqi që nga viti 2015, nuk parasheh sanksione specifike për shkeljet e kryera nga zyrtarët.

Kodi i Sjelljes së Shërbimit Civil specifikon pavarësinë profesionale, integritetin personal dhe llogaridhënien si parime bazë për përmbushjen e detyrave. Keqpërdorimi i aseteve





financiare, konflikti i interesit, kufizimet pas punësimit dhe përdorimi i informacionit zyrtar përfshihen gjithashtu në këtë kuadër.⁶¹ Megjithatë, këto rregullore janë përpunuar vetëm si parime dhe nuk janë të strukturuar në detaje të mjaftueshme për të siguruar rregullore për integritetin e shërbyesve civilë.

Sipas Ligjit për Zyrtarët Publikë, marrja e ryshfetit në forma direkte ose indirekte – si pranimi i dhuratave, favoreve ose përfitimeve të tjera të dhëna për shkak të detyrës së kryer – konsiderohet shkelje e rëndë. Masat disiplinore që mund të shqiptohen në raste të tilla kategorizohen në katër nivele dhe mund të variojnë nga qortimi deri në largim nga shërbimi civil.⁶²

Sa i përket prokurimit publik, ligji parasheh që çdo dosje e tenderit që përgatitet dhe përfshin të gjitha dokumentet kontraktuale të përmbajë edhe një “Deklaratë nën betim”. Ky dokument shërben si bazë për të kërkuar llogari nga operatorët të cilët mund të përballen me ndjekje penale dhe civile, gjopa dhe ndëshkime në rastet që lidhen me kërkesat e përshtatshmërisë, duke përfshirë korrupsionin.⁶³

**INDIKATORI 5.2.6
MEKANIZMAT E
INTEGRITETIT (NË PRAKTIKË)**

25/100



Ekziston një qasje e pjesshme dhe reaguese për të garantuar integritetin e sektorit publik dhe shpërdorimi i detyrës vazhdon të jetë i pranishëm.

Në Indeksin e Perceptimit të Korrupsionit 2022, Transparency International e ka renditur sërish Kosovën në mesin e vendeve me nivel të lartë të korrupsionit, pavarësisht progresit të vogël.



Keqpërdorimi i detyrës, veçanërisht korrupsioni, mbetet i përhapur, pavarësisht premtimeve politike për ta luftuar atë dhe një baze ligjore ekzistuese për ta bërë këtë. Zbatimi mbetet i mangët, duke forcuar përshtypjen e publikut se politikanët e zgjedhur dhe shërbyes civilë veprojnë pa u ndëshkuar. Progresi në luftën kundër korrupsionit është veçanërisht i kufizuar në lidhje me rastet e nivelit të lartë dhe konfiskimin e aseteve, dhe Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit u mungon stafi i nevojshëm.⁶⁴

Ndëshkimi për sjellje joetike nuk është i rregulluar në Kodin e Sjelljes pavarësisht rekomandimeve të bëra nga mekanizmat e ankesës dhe si i tillë, ai dobëson zbatimin e sjelljes etike nga punonjësit e sektorit publik.⁶⁵

Sipas kryetares së KPSHMC-së, Instituti i Kosovës për Administratë Publike, si institucion qeveritar i themeluar për trajnimin e shërbyesve civilë, ofron trajnime të rregullta⁶⁶ në kategori të ndryshme për punonjësit e sektorit publik.⁶⁷ Megjithatë, nuk ka kategori specifike për trajnimin e integritetit. Në praktikë, vlerat thelbësore të sektorit publik janë gjithëpërfshirëse dhe, si të tilla, përfshihen në kontratat dhe detyrat e të gjithë punonjësve të sektorit publik.⁶⁸

Prokurimi publik mbetet një nga sektorët më të korruptuar në vend.⁶⁹ Edhe organizatat në vend kanë ngritur shqetësime për korrupsionin në prokurimin publik. Raportet e organizatave joqeveritare vendore kanë evidentuar shkelje të shumta gjatë pandemisë COVID-19 në prokurimin publik në sektorin shëndetësor.⁷⁰ Raportet identifikojnë disa fusha shumë problematike të shpenzimeve, të cilat përveçse ndikojnë në efikasitetin e prokurimit, sjellin humbje të konsiderueshme, për shkak të pagesave që janë 3 deri në 300 për qind më të larta se në kontratat e tyre me institucionet.⁷¹



**INDIKATORI 5.2.7
GJINIA**

25/100



Protokollet dhe udhëzimet e ndjeshme gjinore për mekanizmat e ankesave të sektorit publik nuk ekzistojnë, por ka disa të dhëna të ndara sipas gjinisë për ankesat e marra.

Numri i grave në pozita vendimmarrëse në sektorin publik është ende i vogël, nuk ka iniciativa për të krijuar politika adekuate që do t'i inkurajojnë gratë të aplikojnë për pozita vendimmarrëse dhe nuk ka formulime të konkurseve që pasqyrojnë ndjeshmërinë gjinore.⁷² KPSHMC ka pesë anëtarë në strukturën e tij të brendshme organizative, dy prej të cilëve janë gra.⁷³

KPSHMC, si mekanizëm ankimor, publikon të dhëna të ndara sipas gjinisë për ankesat e paraqitura nga punonjësit e sektorit publik në raportet vjetore të tij.⁷⁴ Megjithatë, sipas KPSHMC-së, protokollet e zbatuara nga mekanizmat e ankesave dhe hetimeve të sektorit publik nuk përfshijnë ndonjë politikë specifike të ndjeshme gjinore. Të gjitha ankesat trajtohen brenda afateve dhe nuk u jepet prioritet rasteve me bazë gjinore.⁷⁵

Qeveria e Kosovës miratoi Programin për Barazi Gjinore 2020-2024, i cili përfshin hapat që duhet të ndërmerren për të forcuar barazinë gjinore në të gjithë sektorët, përfshirë sektorin publik, si fuqizimi ekonomik, të drejtat e grave, qasja në drejtësi, zhvillimi njerëzor dhe marrëdhëniet gjinore.⁷⁶ Kjo strategji bazohet në tri shtylla, të cilat përfshijnë fuqizimin dhe mirëqenien ekonomike, zhvillimin e roleve dhe mirëqenies gjinore, dhe të drejtat, qasjen dhe sigurinë për gratë.⁷⁷





Roli



Fushatat ekzistuese për edukimin e publikut për korrupsionin dhe rolin e qytetarëve në luftimin e tij udhëhiqen kryesisht nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit. Nuk ka veprime të këtij lloji në pjesën tjetër të sektorit publik.

Në përgjithësi, fushatat e informimit publik nuk kanë mbështetje politike të nivelit të lartë. Mbështetja për fushata të tilla kryesisht rrjedh nga shoqëria civile në vend.

Nga ana tjetër, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka organizuar rregullisht fushata për të edukuar publikun për rolin e saj në luftimin e korrupsionit (shih 10.3.2).⁷⁸ Agjencia ka edhe linjë telefonike ku qytetarët mund të raportojnë korrupsionin, ndërsa institucionet si Policia e Kosovës dhe Dogana e Kosovës kanë vënë në dispozicion numrat pa pagesë ku qytetarët mund të raportojnë korrupsionin.



Ndërsa sektori publik bashkëpunon me akterë të tjerë për nismat kundër korrupsionit, këto nisma janë të pakta dhe nuk gjejnë shumë mbështetje të nivelit të lartë.

Nxitja për bashkëpunim më së shumti vjen nga shoqëria civile dhe agjencitë e pavarura si Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit që kërkojnë të krijojnë bashkëpunim me institucionet e sektorit publik në luftën kundër korrupsionit.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, autoriteti kryesor për luftimin e korrupsionit, bashkëpunon rregullisht për iniciativat kundër korrupsionit me organizatat e shoqërisë civile në vend dhe rajon. Në vitin 2022, Agjencia bashkëpunoi me Iniciativën Rajonale Kundër Korrupsionit, duke dhënë këshilla për format e raportimit dhe mundësitë për të inkurajuar raportimin e shkeljeve përmes sinjalizimit.⁷⁹

Sektori publik gjithashtu ndërvepron me shoqërinë civile në zbatimin e projekteve në fusha të caktuara që kanë të bëjnë kryesisht me ngritjen e kapaciteteve të sektorit publik, si "Matja e performancës së institucioneve të drejtësisë"⁸⁰ dhe "Reforma e Administratës Publike".⁸¹



Ekzistojnë dispozita për të siguruar që sektori publik të ushtrojë përgjegjësitë e tij të prokurimit publik në mënyrë ligjore dhe etike. Megjithatë, në praktikë, vonesat në procesin e prokurimit mbeten problem.

Ligji për Prokurimin Publik e përcakton ofertën e hapur si një rregull të përgjithshëm.⁸² Si rezultat, 85.23 për qind e aktiviteteve të prokurimit në Kosovë kryhen përmes procedurave të hapura, përveç rasteve emergjente dhe kontratave të klasifikuara.⁸³ Ligji ka rregulla të përcaktuara qartë dhe ofron dokumente standarde për tenderim dhe vlerësim, të cilat sigurojnë kritere që synojnë arritjen e objektivitetit në vlerësimin e ofertave.⁸⁴ Në të njëjtën kohë, ligji detyron autoritetin kontraktues që të informojë të gjitha palët e interesuara për çdo ndryshim gjatë procesit të tenderimit, si dhe vendimet për dhënien e kontratës.⁸⁵ Zbatimi i platformës elektronike "e-prokurimi" ka mundësuar aplikimin e saj në praktikë, duke shmangur mundësinë e neglizhencës nga autoriteti kontraktues, pasi vë në dispozicion të publikut informacionin për detajet e kontratës, shumën, periudhën e zbatimit dhe kontraktuesin.⁸⁶

Ligji përcakton tri autoritete kyçe që kontrollojnë aktivitetin e prokurimit publik: KRPP,⁸⁷ OSHP⁸⁸ dhe Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP).⁸⁹ KRPP-ja dhe OSHP-ja janë autoritete të pavarura të emëruara nga qeveria dhe të zgjedhura nga Kuvendi.⁹⁰ Megjithatë, në praktikë, ankesat në OSHP i kanë zgjatur proceset e prokurimit në mungesë të legjislacionit që parasheh sanksione për vonesat në vendimet e nxjerra nga OSHP-ja.⁹¹ Për më tepër, gjatë pjesës më të madhe të vitit

2021, ky organ ka qenë jofunksional për shkak të mungesës së bordit drejtues, i cili ka ndikuar që të mbajë rreth 700 ankesa lidhur me procedurat e prokurimit.

Ligji për Prokurimin Publik përmban vetëm tri klauzola në lidhje me menaxhimin e kontratës të cilat përcaktojnë zgjedhjen e menaxherit të kontratës dhe formën e raportimit.⁹² Ligji⁹³ përcakton qartë se i gjithë personeli i përfshirë në faza të ndryshme të prokurimit duhet të jetë i ndryshëm, për të shmangur konfliktin e interesit.⁹⁴

Në mars 2022, Kosova iu bashkua Vlerësimit Transparent të Prokurimit Publik si vendi i 42-të që do të vlerësohet në kuadër të iniciativës ndërkombëtare të Institutit për Zhvillimin e Lirisë së Informacionit (IDFI).⁹⁵





INDIKATORI 5.3.4 MBIKËQYRJA E NDËRMARRJEVE PUBLIKE

75/100



Politika e pronësisë së shtetit është jokonsistente. Njësia e monitorimit ka një rol të kufizuar në menaxhimin e NSH-ve dhe ka burime të pamjaftueshme për të kryer efektivisht mandatin e saj.

Kushtetuta i jep qeverisë autoritetin për të ruajtur pronësinë e të gjitha ndërmarrjeve publike dhe lejon mundësinë e privatizimit, koncesioneve ose dhënies me qira, për sa kohë që këto veprime kryhen në përputhje me ligjin.⁹⁶ Ndërmarrjet publike në Republikën e Kosovës ndahen në ndërmarrje publike qendrore dhe lokale.

Këto ndërmarrje funksionojnë në bazë të Ligjit për Ndërmarrjet Publike dhe Ligjit për Shoqëritë Tregtare.⁹⁷ Ligji për ndërmarrjet publike kërkon që Njësia e Monitorimit dhe Politikës së NP-ve duhet të publikojnë informacione për të gjitha NP-të në faqen e tyre të internetit.⁹⁸

Përgjegjësia kryesore e Njesisë së Monitorimit dhe Politikës së NP-ve është të mbikëqyrë operacionet e NSH-ve që raportojnë në Ministri.⁹⁹ Megjithatë, Njësia e Monitorimit dhe Politikës së NP-ve nuk merr pjesë në marrjen e vendimeve në lidhje me asetet strategjike që janë të një rëndësie të qëndrueshme për shtetin. Ky autoritet mbahet nga qeveria, e cila është përgjegjëse për ofrimin e informacionit të besueshëm se si NSH-të qendrore i shërbejnë interesave të publikut.¹⁰⁰

Mungon dukshëm transparencja brenda Njesisë së Monitorimit dhe Politikës së NP-ve. Instituti GAP ka vënë në dukje se kjo njësi nuk ka publikuar raportin e performancës për ndërmarrjet publike për disa vite. Ata ia atribuojnë këtë faktit se këto raporte nuk kanë marrë miratimin nga Kuvendi.¹⁰¹

Numri i të punësuarve në Njësine për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike është 12. Megjithatë, kjo njësi funksionon pa drejtues që nga viti 2021 kur ish-lideri Besnik Krasniqi dha dorëheqje.¹⁰²



Ndërveprimet

Sektori Publik bashkëpunon ngushtë me qeverinë, Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, shoqërinë civile dhe institucione të tjera ligjzbatuese. Ky ndërveprim bazohet në ligj. Sektori publik mbikëqyrjet drejtpërdrejt nga qeveria¹⁰³ duke e mbështetur atë në prodhimin e strategjive shtetërore, nismave ligjore dhe mbikëqyrjen e zbatimit të tyre.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit është përgjegjëse për mbikëqyrjen e deklarimit të pasurisë së zyrtarëve publikë dhe në këtë mënyrë ndikon pozitivisht në transparencën e zyrtarëve publikë.¹⁰⁴ Sektori publik gjithashtu ndërvepron me shoqërinë civile në zbatimin e projekteve që lidhen kryesisht me ngritjen e kapaciteteve të sektorit publik. Megjithatë, një bashkëpunim i tillë nuk është mjaft i fortë në lidhje me zhvillimin e fushatave dhe programeve, veçanërisht në luftën kundër korrupsionit.

Rekomandimet e shtyllës

- Ndryshimi i Kodit të Etikës për të përfshirë sanksione disiplinore për shkeljet e Kodit.
- Ofrimi i sesioneve të brendshme të trajnimit mbi integritetin për institucionet e sektorit publik.
- Të ndryshohet legjislacioni i KRPP-së dhe OSHP-së në mënyrë që të përfshijë një afat deri në të cilin duhet të zgjidhet një anëtar i ri i bordit për të shmangur bllokimin e funksionimit të organeve të tilla në kryerjen e prokurimit publik dhe për të siguruar vazhdimësinë e proceseve dhe procedurave.
- Angazhimi më i lartë me agjencitë e tjera shtetërore, OSHC-të dhe bizneset që lidhen drejtpërdrejt me luftën kundër korrupsionit. Kjo duhet të jetë në formën e memorandumëve të mirëkuptimit që parashohin trajnime për çështjet e integritetit, sinjalizimin, etj.
- Të zhvillohen protokolle të qarta të ndjeshme gjinore për sektorin publik, veçanërisht për menaxhimin e ankesave.



REFERENCAT

- 1 Statistikat më të afërta zyrtare për numrin e të punësuarve mund të merren nga Ligji për Buxhetin për vitin 2022, i cili përcakton se numri i të punësuarve në organizatat buxhetore të nivelit qendror është 42,467, ndërsa në komuna është 44,404, dhe së bashku me 437 punëtorë në Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror, arrijnë gjithsej 87,308 punëtorë. Kjo mund të krahasohet me vitin 2015, kur numri i të punësuarve në shërbimin publik ishte 78.565. Për më shumë shih Ligjin për ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, Tabela 2, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=68589>.
- 2 Ligji për ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, Tabela 2.
- 3 Gazeta Express, 25 gusht 2022, <https://www.gazetaexpress.com/greva-e-sektorit-publik-nis-sot-sindikalistet-su-moren-vesh-me-institucionet/> [qasur më 29 shtator 2022]
- 4 Radio Evropa e Lirë, 17 maj 2022, <https://www.evropaelire.org/a/projektligji-per-paga-koeficienti-kosove-/32004517.html> [qasur më 1 tetor 2022]
- 5 Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën për 2021, tetor 2021, faqe 15
- 6 Ligji për zyrtarët publikë, neni 1.
- 7 Ligjit për shërbimin civil të Republikës së Kosovës, neni 1.
- 8 Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, 12 dhjetor 2022, https://www.eeas.europa.eu/delegations/kosovo/eu-concerned-over-several-provisions-new-kosovo-law-public-officials_en?s=321 [qasur më 2 tetor 2023]
- 9 Ligji për shërbimin civil të Republikës së Kosovës, neni 25.
- 10 Rregullorja për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, neni 17.
- 11 Rregullorja për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, kapitulli 5.
- 12 Ligji për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës, neni 1,
- 13 Ligji për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës, nenet 2 dhe 3,
- 14 Këtë çështje e ka ngritur KDI-ja, duke publikuar një punim lidhur me mungesën e ligjit për lobim. KDI, Është koha për Ligjin për Lobim në Kosovë, qershor 2021, faqe 6.
- 15 Grupi për Hulumtimin e Politikave Ballkanike (BPRG), Reforma e Administratës Publike në Kosovë: Përpjekje e vazhdueshme për ta arritur atë, 2020, f. 58.
- 16 BPRG, Reforma e Administratës Publike në Kosovë: Përpjekje e vazhdueshme për ta arritur atë, 2020, f. 58.
- 17 BPRG, barometri i progresit në Kosovë për vitin 2021, 2022, faqe 71.
- 18 Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën për 2023, tetor 2023, faqe 76.
- 19 Gazeta Shneta, korrik 2020, <https://gazetashneta.net/shkarkohet-sekretari-i-pergjithshem-i-msh-se-naim-bardiqi/> [qasur më 22 nëntor 2023]
- 20 Insajderi, tetor 2021, <https://insajderi.com/qeveria-ia-vazhdon-mandatin-sekretarit-te-msh-se/> [qasur më 2 tetor 2023]
- 21 Koha.net, mars 2021, <https://www.koha.net/arberi/263669/vitia-e-rikthen-naim-bardiqin-ne-poziten-e-sekretarit-ne-msh-se/> [qasur më 22 nëntor 2023]
- 22 Telegrafi, <https://telegrafi.com/shkarkohet-sekretari-ministrise-se-infrastrukures-izedin-bytyqi/>
- 23 “Betimi për Drejtësi”, tetor 2022, <https://betimiperdrejtesi.com/shkarkimet-emerime-transfere-hapje-te-konkurseve-te-jashteligjshme-e-protesta-ne-ministrine-e-jashtme-dhe-diaspores/> [qasur më 23 nëntor 2023]
- 24 Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën për 2023, tetor 2023, faqe 11.
- 25 Intervistë me një ekspert anonim, tetor 2023.
- 26 Raporti vjetor i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës për vitin 2022, faqe 207.
- 27 Kallxo.com, 24 qershor 2021, <https://kallxo.com/lajm/kuvendi-diskuton-per-shkarkimin-e-anetareve-te-kpmschck-se-opozita-kunder/> [qasur më 2 tetor 2023]
- 28 Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, Mbikëqyrjen e Pasurive, https://www.akk-ks.org/parandalimi_i_korrupsionit/163/mbikqyrja-e-pasurive/163. [qasur më 2 tetor 2022]
- 29 Ligji për qasje në dokumente publike, neni 1.
- 30 Ligji për qasje në dokumente publike, neni 5, pika 1.
- 31 Ligji për zyrtarët publikë, neni 7.
- 32 Ligji për Prokurimin publik të Republikës së Kosovës.
- 33 Organi Shqyrtues i Prokurimit, Roli, <https://oshp.rks-gov.net/sq/Pages/Details?id=2> [qasur më 10 tetor 2022]
- 34 Dukagjini, 28 prill 2023, <https://www.dukagjini.com/qasja-ne-dokumente-zyrtare-kusari-vv-ja-po-e-keqperdor-ligjin-per-klasifikimin-e-informacione-ve-ge-te-mos-turperohet/> [qasur më 15 nëntor 2022]
- 35 Radio Evropa e Lirë, 14 maj 2019, çfarë lloj shembulli, shembuj kur persona të caktuar kanë hasur në vështirësi në marrjen e këtyre dokumenteve, [qasur më 3 tetor 2022]
- 36 Radio Evropa e Lirë, 28 shtator 2022, <https://www.evropaelire.org/a/agjencia-dokumentet-publike-institucionet-gazetaret-/32056311.html/> [qasur më 15 nëntor 2022]
- 37 Evropa e lirë, 28 shtator 2022, <https://www.evropaelire.org/a/agjencia-dokumentet-publike-institucionet-gazetaret-/32056311.html> [qasur më 3 tetor 2023]
- 38 Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, Mbikëqyrjen e Pasurive, https://www.akk-ks.org/deklarimi_i_pasuris/171/deklarimet/171 [qasur më 10 tetor 2022]
- 39 Ligji për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, neni 20.
- 40 Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, E-prokurimi, <https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/ClanakItemNew.aspx?id=327> [qasur më 9 tetor 2022]
- 41 <https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/ClanakItemNew.aspx?id=227>
- 42 Sistemi i Informacionit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (SIMBNJ), <https://konkursi.rks-gov.net/>, [qasur më 9 tetor 2023]
- 43 Ligji për mbrojtjen e sinjalizuesve, neni 14.
- 44 Ligji për zyrtarët publikë, neni 46.
- 45 Kodi Penal, neni 414.
- 46 Organi Shqyrtues i Prokurimit, Roli i OSHP-së, <https://oshp.rks-gov.net/sq/Pages/Details?id=2> [qasur më 10 tetor 2022]
- 47 Ligji për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës, neni 4.
- 48 Ligji për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, neni 1.
- 49 Kushtetuta e Kosovës, kapitulli 12.
- 50 Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën për 2022, tetor 2022, faqe 12.
- 51 Intervistë me Jeton Koca, Kryetar i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës, shtator 2022.
- 52 Radio Evropa e Lirë, 20 prill 2021, <https://www.evropaelire.org/a/korrupsioni-i-nivelit-te-larte-/31212863.html> [qasur më 15 dhjetor 2022]
- 53 Raporti vjetor i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës për vitin 2021, faqe 8.
- 54 Raporti vjetor i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës për vitin 2021, faqe 31.
- 55 Raporti mbi Aktivitetet e Prokurimit Publik në Kosovë për vitin 2021, faqe 12.
- 56 Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën për 2022, tetor 2022, faqe 63.
- 57 Ligji për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, faqe 12.
- 58 Radio Evropa e Lirë, 30 mars 2021, <https://www.evropaelire.org/a/31178830.html> [qasur më 2 tetor 2022]
- 59 Rregullore mbi Kodin e Sjelljes së Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës.
- 60 Ligji për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave.
- 61 Rregullore mbi Kodin e Sjelljes së Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës. Neni 5.14 dhe 16.
- 62 Ligji për zyrtarët publikë, neni 47.
- 63 Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik të Kosovës, e-prokurimi, Dosja e Tenderit për Kontratën Publike Kornizë, faqe 20.
- 64 Indeksi i Transformimit Bertelsmann, Raporti i Shtetit për Kosovën 2022, <https://bti-project.org/en/reports/country-report/RKS> [qasur më 15 tetor 2023]
- 65 Intervistë me Jeton Koca, Kryetar i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës, shtator 2022.
- 66 <https://ikap.rks-gov.net/news-category/18>
- 67 Intervistë me Jeton Koca, Kryetar i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës, shtator 2022.
- 68 Intervistë me Jeton Koca, Kryetar i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës, shtator 2022.
- 69 Europa e lirë, 25 janar 2022, <https://www.evropaelire.org/a/31670694.html>. [qasur më 5 tetor 2022]
- 70 KDI, “Tenderët gjatë pandemisë”, (Prishtinë: KDI, 2022), faqe 10.
- 71 KDI, “Tenderët gjatë pandemisë”, (Prishtinë: KDI, 2022), faqe 10.
- 72 Instituti Riinvest, “Vendimarrja e Grave në Sektorin Publik dhe Privat në Kosovë” (Prishtinë: Insituti Riinvest, 2022), faqe 7.
- 73 Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës, Uebfaqja zyrtare/Përbërja e Bordit.
- 74 Raporti vjetor i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës për vitin 2021, faqe 11.
- 75 Intervistë me Jeton Koca, Kryetar i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës, shtator 2022.
- 76 Agjencia për Barazi Gjinore, “Programi për Barazi Gjinore në Kosovë 2020-2024”. (Prishtinë: AGE, 2020), faqe 11.
- 77 Qeveria e Republikës së Kosovës, Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024 (Prishtinë, 2020), faqe 20. Të gjitha objektivat e kësaj strategjie janë paraqitur me anë të tabelave të veçanta në kuadër të shtyllave nga faqja 59.
- 78 Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, 16 dhjetor 2020, https://akk-ks.org/lajmi_i_plote/49238, [qasur më 5 tetor 2022]
- 79 Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, 16 dhjetor 2022, https://www.akk-ks.org/lajmi_i_plote/49349, [qasur më 13 tetor 2022]
- 80 Levizja FOL, <https://levizjafol.org/publikimet/> [qasur më 21 tetor 2022]
- 81 Grupi Ballkanik për Kërkime Politike, <https://balkansgroup.org/reforma-e-administrates-publike-nje-perpjekje-e-vazhdueshme-2/> [qasur më 21 tetor 2022]
- 82 Ligji për zyrtarët publikë, neni 32.
- 83 Raporti Vjetor i Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2021, faqe 23.
- 84 Raporti vjetor i Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2021, faqe 15. Megjithatë, vitet e fundit ka pasur një trend të rritjes së ankesave nga operatorët ekonomikë në OSHP, me 881 ankesa të dorëzuara në vitin 2021, 184 ankesa në vitin 2020 dhe 981 ankesa në vitin 2019.
- 85 Ligji për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, neni 7.
- 86 Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik të Kosovës, E-Prokurimi. <https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/ClanakItemNew.aspx> <https://albanianpost.com/mungesa-e-bordit-te-oshp-se-blokohen-mbi-200-milione-euro/> [qasur më 7 tetor 2022]
- 87 Ligji për Prokurimin publik të Republikës së Kosovës.
- 88 Ligji për Prokurimin Publik, Titulli VIII Organi Shqyrtues i Prokurimit.
- 89 Ligji për Prokurimi publikë, neni 94.
- 90 Ligji për Prokurimin Publik, neni 86, 89 dhe 94. AQP operon nën ombrellën e Ministrisë së Financave, kjo agjenci ka kapacitetet e nevojshme financiare dhe profesionale dhe operon në mënyrë të pavarur nga autoritetet e tjera të prokurimit, megjithëse kryen prokurime të centralizuara për të gjitha.
- 91 Albanian Post, 9 dhjetor 2021, <https://albanianpost.com/mungesa-e-bordit-te-oshp-se-blokohen-mbi-200-milione-euro/> [qasur më 7 tetor 2022]
- 92 Ligji për Prokurimi publikë, neni 81. Megjithatë, ligji nuk përmban asnjë dispozitë për të përcaktuar rolin e të gjithë akterëve të përfshirë në këtë proces dhe nivelet e llogaridhënies.
- 93 Ligji për Prokurimi publikë, neni 4.
- 94 Rregullat dhe Udhëzimet Operacionale për Prokurimin Publik, neni 4, 40, 59 dhe 61.
- 95 <https://idfi.ge/en/kosovo-joins-the-transparent-public-procurement-rating>
- 96 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 160, faqe 61
- 97 Ligji Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, neni 1 dhe 4. Ky ligj është duke ndryshuar dhe plotësuar Ligjin Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 në maj 2015.
- 98 Ligji Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, neni 37 paragrafi 4.
- 99 Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike, <https://me.rks-gov.net/njpmnp/per-ne/>
- 100 Intervistë me një ekspert anonim, 13 dhjetor 2022.
- 101 Instituti GAP, raport tematik: ‘Menaxhimi financiar dhe transparenci në ndërmarrjet publike’, faqe 24.
- 102 Kallxo.com, 28 prill 2021, <https://kallxo.com/lajm/besnik-krasniqi-jep-doreheqje-nga-njësia-per-monitorim-te-ndermarrjeve-publike/> [qasur më 5 tetor 2023]
- 103 Ligji për Qeverinë, Kapitulli 5.
- 104 Faqja zyrtare e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, Deklarimi i Pasurisë. <https://pakorrupsion-rks.net/>


POLICIA E KOSOVËS




PËRMBLEDHJE

Policia e Kosovës (PK) është institucion kushtetues përgjegjës për ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike në gjithë territorin e Republikës së Kosovës.¹


74/100 Rezultati i përgjithshëm i shtyllës




Kapacitetet



Qeverisja



Roli





1
Funksionon në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme. PK-ja udhëhiqet nga Drejtori i Përgjithshëm, të cilin Kryeministri e emëron me rekomandimin e Ministrit të Punëve të Brendshme.² Drejtori i Përgjithshëm raporton dhe i përgjigjet drejtpërdrejt Ministrit.³ PK-ja ka pesë departamente kryesore: operativa, hetime, kufi, burime njerëzore dhe shërbime mbështetëse.

Policia është e organizuar në nivel qendror dhe lokal. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës është niveli qendror përgjegjës për tërë Republikën e Kosovës. Ndërkohë, niveli vendor përbëhet nga tetë drejtori rajonale, duke përfshirë komisariatet dhe nënstacionet e policisë, të cilat janë përgjegjëse për policinë lokale në çdo komunë.⁴

Inspektorati Policor i Kosovës është institucion që inspekton strukturat dhe funksionet e Policisë së Kosovës për të siguruar llogaridhënie, efektivitet dhe efikasitet në zbatueshmërinë e ligjeve, akteve nënligjore dhe procedurave standarde operative në fuqi.⁵

PK-ja është pjesërisht e pavarur, pasi menaxhon operacionet e veta, por çështjet organizative, si emërimet dhe ndarja e buxhetit, ndikohen nga ekzekutivi, përfshirë zgjedhjen e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë. Policët e Kosovës përballen me paga të ulëta. Mungojnë edhe testet e integritetit për policinë. Kodi i Etikës së Policisë nuk është gjithëpërfshirës sepse nuk parasheh standarde etike për punonjësit e lartë të policisë.



Kapacitetet



INDIKATORI 6.1.1 BURIMET (NË PRAKTIKË)

75/100



PK-ja kishte burime të mjaftueshme njerëzore, megjithatë dorëheqja e oficerëve serbë çoi në disa zbrazëti në burimet njerëzore. Megjithatë, ka disa mangësi në burimet financiare, të cilat çojnë në një shkallë të caktuar joefektiviteti në kryerjen e detyrave të saj.

Buxheti i Policisë përgatitet nga Drejtori i Policisë,⁶ dhe miratohet nga Ministria e Financave⁷ pasi propozohet nga Ministria e Punëve të Brendshme.⁸ Buxheti i Policisë për vitin 2021 ishte 87,036,096 €. Krahasuar me vitin 2020, ky buxhet përfaqëson një shkurtim prej rreth 10 milionë euro.¹⁰

Sipas Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS), e cila mbikëqyr sektorin e sigurisë, buxheti dhe pagat e policëve konsiderohen të ulëta duke pasur parasysh detyrat dhe rreziqet e të qenit polic. Meqenëse pagat janë të ulëta, rolet e punonjësve të policisë janë më pak tërheqëse për stafin e kualifikuar dhe të përkushtuar, ku paga bazë rritet, por shtesat ulen.¹¹

Numri i punonjësve të policisë në detyrë për vitin 2021 ishte 9,079.¹² Megjithatë, në vitin 2022 numri u ul në 8,699 duke çuar në mungesën e burimeve njerëzore në PK të shkaktuar nga dorëheqja e policëve të komunitetit serb nga ky institucion.¹³

Për të ndërtuar kapacitete menaxheriale dhe teknike, PK-ja në vazhdimësi pasuron nivelin logjistik dhe operacional me mbështetje të jashtme. UNDP-ja është një nga donatorët kryesorë të Policisë së Kosovës.¹⁴ Sipas QKSS-së, donacionet e pranuar janë të përshtatshme për të plotësuar nevojat logjistike të PK-së.¹⁵

Megjithatë, pandemia COVID-19 ka rritur vështirësinë e detyrave rutinë të policisë dhe detyrimet e saj për të mbrojtur ligjin dhe rendin e vendit.

PK-ja ka mekanizma të specializuar që merren me luftën kundër korrupsionit: Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit dhe Njësia e Hetimeve Speciale.¹⁶ Policia ka personel ekspert dhe të specializuar për hetimin e korrupsionit.¹⁷

Tabela 6.1: Buxheti vjetor i PK-së, 2019-2023

	Buxheti total në €	Rritje/ulje buxheti në % në vit
2023	115,357,617	3.91
2022	111,014,078	27.54
2021	87,036,096	-10
2020	96,701,309	0.65
2019	96,077,535	0.76





**INDIKATORI 6.1.2
PAVARËSIA (SIPAS LIGJIT)**

75/100



Ekzistojnë ligje që sigurojnë një shkallë të pavarësisë së PK-së, veçanërisht në aspektin operativ. Megjithatë, nuk ka asnjë rregull për përkatësinë politike të Drejtorit të Përgjithshëm.

Sipas legjislacionit, Drejtori i Përgjithshëm i PK-së emërohet nga Kryeministri.¹⁸ Rekrutimi për Drejtor të Përgjithshëm është i brendshëm dhe emërimi bëhet në bazë të kriterëve profesionale. Kandidatët duhet të jenë të diplomuar, të kenë të paktën pesë vjet gradën policore të kolonelit, nënkolonelit ose majorit dhe të mos jenë dënuar për vepër penale.¹⁹ Procesi i rekrutimit është publik dhe shpallet nga Ministria e Punëve të Brendshme.²⁰ Ligji për Policinë parasheh që Drejtori i Përgjithshëm ose Zëvendës Drejtorët e Përgjithshëm mund të lirohen ose shkarkohen nga detyra nga Kryeministri për shkak të performancës së dobët. Nëse mandati i Drejtorit të Përgjithshëm dhe Zëvendës Drejtorëve të Përgjithshëm të Policisë përfundon në vitin kalendarik të zgjedhjeve të përgjithshme, atëherë mandati i tyre zgjatet automatikisht për një vit pas certifikimit të zgjedhjeve.²¹

Sa u përket kriterëve profesionale për emërimin e punonjësve të tjerë të policisë, rregullat janë të qarta dhe specifikojnë kriteret mbi të cilat ata mund të emërohen. Standardet e kërkuara për emërim janë në përputhje me standardet e përcaktuara nga Kodi i Etikës. Kodi parasheh që kandidatët duhet të emërohen në bazë të kualifikimeve të tyre arsimore për të përmbushur detyrat e tyre profesionale dhe t'i nënshtrohen trajnimit profesional.²²

Legjislacioni përcakton qartë detyrimin e punonjësve të policisë për të mos rënë nën ndikimin e asnjë partie politike dhe për të siguruar që performanca e tyre të mos varet në asnjë mënyrë nga përkatësia e tyre politike.²³ Megjithatë, një rregull i tillë nuk zbatohet për Drejtorin e Përgjithshëm.

**INDIKATORI 6.1.3
PAVARËSIA (NË PRAKTIKË)**

50/100



Ministria e Punëve të Brendshme dhe ekzekutivi në përgjithësi ndikojnë në punën e policisë, duke përfshirë organizimin, emërimet dhe ndarjen e buxhetit.²⁴

Sfidë e rëndësishme është përzgjedhja e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, i cili emërohet drejtpërdrejt nga Kryeministri, në bazë të rekomandimit të ministrit të Punëve të Brendshme. Meqenëse Drejtori ka përgjegjësinë për emërimin e drejtuesve të tjerë të policisë, emërimet e tjera vartëse mund të jenë subjekt i ndikimit politik.

Shqetësimet raportohen shpesh për politizimin e PK-së, duke theksuar se, në shumë raste, drejtorët e policisë nuk janë të paanshëm politikisht.²⁵ Në vitin 2020, ish-kryeministri Avdullah Hoti shkarkoi ish-drejtorin e Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj, "për shkak të performancës së dobët".²⁶ Ky vendim dyshohet se ishte hakmarrje e qëllimshme ndaj arrestimit të zyrtarëve të partisë në pushtet nga LDK-ja në atë kohë. Procesi ligjor i kësaj çështjeje është në vazhdim.²⁷ Rashit Qalaj ishte zgjedhur në krye të PK-së në vitin 2018. Pas largimit nga kjo pozitë, ai u bë pjesë e PDK-së në vitin 2021 dhe kandidoi për pozitën e deputetit të PDK-së në vitin 2021 – ku u zgjodh deputet në Kuvendin e Kosovës,²⁸ gjë që "vë në pikëpyetje veprimtarinë e tij gjatë kohës që ishte në krye të Policisë së Kosovës."²⁹

Në shumë raste, raportet ndërkombëtare kanë theksuar pavarësinë operacionale të policisë si problem me të cilin përballet ky institucion.³⁰ QKSS konkludon se si rrjedhojë, Ministrat e Punëve të Brendshme janë përfshirë në njoftimet për veprimet e ndërmarra nga policia, të cilat nuk janë pjesë e detyrave të ministrit.³¹ Si rezultat, ministri minon reputacionin e policisë duke mos i atribuar as sukses dhe as kritikë aktiviteteve të tyre.³² Deri më tani, nuk janë raportuar raste të pengimit të punonjësve të policisë në kryerjen e detyrave të tyre hetimore.



Qeverisja

**INDIKATORI 6.2.1
TRANSPARENCA
(SIPAS LIGJIT)**

100/100



Ka dispozita gjithëpërfshirëse të cilat i mundësojnë publikut të marrë informacion mbi organizimin dhe funksionimin e agjencive të zbatimit të ligjit, për vendimet që kanë të bëjnë me to dhe se si janë marrë këto vendime.

Ligji për Policinë thotë se PK-ja duhet të udhëhiqet nga parimi i transparencës, siç është informimi për qytetarët dhe të qenit i hapur për publikun.³³

Në aspektin ligjor, PK-ja si institucion publik është i obliguar që të publikojë të gjitha dokumentet që nxjerr. Ligji për Qasjen në Dokumente Publike kërkon që të gjitha dokumentet publike të zbulohen publikisht brenda 15 ditëve.³⁴ Të njëjtat rregulla vlejnë edhe për Inspektoratin Policor të Kosovës.³⁵

Ligji i ri për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave, i cili hyri në fuqi në gusht 2022, specifikon se zyrtarët e lartë të policisë, duke përfshirë Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë, Zëvendës Drejtorët e Policisë, Drejtorët e Divizioneve, Drejtorët e Departamenteve, drejtorët rajonalë të dhe komandantët e stacioneve policore i nënshtrohen deklarimit të pasurisë.³⁶ Oficerët e lartë të policisë deklarojnë pasurinë e tyre në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, e cila duhet t'i publikojë ato në faqen e internetit të Agjencisë.³⁷

Legjislacioni parasheh gjithashtu që PK-ja duhet të japë informacion me kërkesë të ndonjë personi që bën një kërkesë, me përjashtim të rasteve kur dhënia e një informacioni të tillë mund të pengojë hetimet.³⁸

**INDIKATORI 6.2.2
TRANSPARENCA
(NË PRAKTIKË)**

75/100



Publiku në përgjithësi mund të marrë informacion për organizimin dhe aktivitetet e PK-së, por jo për proceset vendimmarrëse, veçanërisht ato operacionale.

Policia përgatit dhe publikon raporte 24 orëshe, të cilat shpërndahen në mediet publike dhe kombëtare. Të dhënat e përgjithshme, duke përfshirë raportet vjetore dhe statistikat, rregulloret dhe udhëzimet e brendshme administrative të PK-së publikohen në faqen zyrtare të internetit.³⁹ Policia prezanton informacione për operacione dhe aksione edhe në konferenca për shtyp, të cilat postohen edhe në rrjetet sociale.⁴⁰

Sa i përket deklarimit të pasurisë, legjislacioni në fuqi parasheh që vetëm drejtorët e policisë të deklarojnë pasurinë, e cila është e qasshme në faqen e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.⁴¹

Ka raste të praktikave të këqija kur PK-ja nuk ka publikuar dokumente të brendshme të policisë,⁴² si raporte, vendime, marrëveshje dhe memorandume.⁴³ Megjithatë, është ende e paqartë nëse janë të qasshme të gjitha rregulloret dhe udhëzimet administrative (të cilat përbëjnë legjislacionin dytësor) apo jo, pasi vetëm një numër i caktuar i tyre është i disponueshëm në faqen e internetit të policisë.⁴⁴

Policia e Kosovës ka hartuar një plan për Forcimin e Integritetit në Policinë e Kosovës, i cili përfshin edhe aspektin e brendshëm organizativ të PK-së. Si i tillë, ai thekson nevojën





për përmirësimin e zinxhirit të raportimit në njësitë organizative për të siguruar mbikëqyrje dhe auditim efektiv të vendimeve dhe detyrave të policisë.⁴⁵

**INDIKATORI 6.2.3
LLOGARIDHËNIA
(SIPAS LIGJIT)**

100/100



Legjislacioni aktual ka dispozita për të siguruar që PK-ja duhet të raportojë dhe të jetë përgjegjëse për veprimet e saj.

Drejtori i Përgjithshëm i PK-së raporton dhe i përgjigjet drejtpërdrejt Ministrit të Punëve të Brendshme për administrimin dhe menaxhimin e policisë.⁴⁶ Drejtori është i obliguar t'i raportojë Komisionit Parlamentar për Çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes kur shfaqen çështje në fushën e tyre të përgjegjësisë.⁴⁷

Inspektorati Policor i Kosovës (IPK) është agjenci e pavarur para së cilës PK-ja është llogaridhënëse. Inspektorati është drejtpërdrejt përgjegjës për parandalimin, zbulimin, dokumentimin dhe hetimin e veprave penale të kryera nga zyrtarët e PK-së.⁴⁸ Qytetarët mund të paraqesin ankesa pranë këtij institucioni edhe për sjelljen e punonjësve të policisë gjatë ushtrimit të detyrës.⁴⁹

Zyrtarët e PK-së nuk kanë imunitet nga ndjekja penale. Ata mund të hetohen, sidomos nga IPK-ja për përfshirje në kryerjen e veprave penale.⁵⁰ IPK-ja mund të kërkojë ndihmë nga PK-ja dhe institucionet e tjera të zbatimit të ligjit në aktivitetet e saj ligjore. Kur një rast përfshin drejtpërdrejt PK-në, ajo duhet të ndërmarrë menjëherë të gjitha masat dhe veprimet për sigurimin e provave dhe të njoftojë Inspektoratin pa vonesë.⁵¹

Sa u përket të drejtave të viktimave, të gjithë personat që ndihen të viktimizuar nga një krim kanë të drejtë të denoncojnë rastin në polici. Policia mblledh informacione nga hetimet të cilat i dërgon në prokurorinë përkatëse. Ndërsa për aspektin e shkeljeve të policisë, Inspektorati Policor i Kosovës është përgjegjës për hetimin e veprave penale të kryera nga punonjësit e Policisë së Kosovës.⁵²

**INDIKATORI 6.2.4
LLOGARIDHËNIA (NË
PRAKTIKË)**

75/100



Dispozitat ekzistuese janë kryesisht efektive për të siguruar që policia duhet të raportojë dhe të përgjigjet për veprimet e saj në praktikë. Megjithatë, rritja e ankesave tregon nga njëra anë rritje të kontrollit dhe llogaridhënies së PK-së për veprimet e saj, por edhe përkeqësim të sjelljes së policisë.

Në vitin 2022, Inspektorati ka pranuar 1,697 ankesa kundër zyrtarëve policorë, nga të cilat 291 raste, ose 15 për qind, janë dorëzuar nga PK-ja, 30,2 për qind e ankesave janë dorëzuar nga qytetarët dhe 33,6 për qind e ankesave janë dorëzuar në formë elektronike. Ankesat janë pranuar nga IPK-ja edhe në forma të tjera.⁵³ Pas shqyrtimit të këtyre ankesave janë bërë 108 arrestime, janë dhënë 164 rekomandime për pezullim dhe janë dorëzuar 106 kallëzime penale ndaj të dyshuarve për vepra penale, përfshirë edhe rastet e korrupsionit.⁵⁴

Rritje e numrit të lëndëve të paraqitura në IPK⁵⁵ tregon, nga njëra anë, rritje të kontrollit dhe llogaridhënies së PK-së për veprimet e saj, por edhe përkeqësim të sjelljes së punonjësve të policisë. IPK-ja shqyrton pranueshmërinë e ankesave brenda një periudhe të shkurtër pesë-ditore.⁵⁶ Procedurat e mëvonshme varen nga vëllimi i rasteve.⁵⁷



	Numri i ankesave në vit	Rritje/ulje e ankesave në % në vit
2022	1,697	-15.69
2021	2,013	21.41
2020	1,658	15.21
2019	1,439	1.40
2018	1,419	15.74

Në fillim të vitit 2022, 48 zyrtarë policie u arrestuan dhe ndaj tyre filloi procedura penale për shkak të dyshimeve për përfshirje në skema të jashtëligjshme dhe korruptive.⁵⁸ Kjo tregon se në praktikë, punonjësit e policisë nuk gëzojnë imunitet për asnjë veprë penale, veçanërisht gjatë kryerjes së detyrës zyrtare.

**INDIKATORI 6.2.5
MEKANIZMAT E
INTEGRITETIT (SIPAS LIGJIT)**

75/100



Ka dispozita gjithëpërfshirëse për të garantuar integritetin e policëve në Kosovë. PK-ja ka një Kod Etike, duke konsoliduar dispozitat e ligjeve të ndryshme që mbulojnë këtë fushë.⁵⁹ Megjithatë, Kodi i Etikës nuk zbatohet për oficerët e lartë dhe Drejtori i Përgjithshëm dhe oficerët e policisë nuk i nënshtrohen testeve të integritetit.

PK-ja po zbaton Planin për Forcimin e Integritetit të vitit 2021, i vlefshëm deri në vitin 2025. Ky plan parasheh objektiva të

qarta për forcimin e integritetit dhe aktivitetet që çdo mekanizëm brenda policisë duhet të ndërmarrë për të arritur objektivat e përcaktuara. Progresi në arritjen e këtyre objektivave matet në bazë të këtij plani. Dispozitat e këtij plani janë krijuar për të rritur integritetin.⁶⁰

Masat parandaluese dhe ndëshkuese janë parashikuar me ligj për të parandaluar konfliktin e interesit. Duke qenë zyrtarë publikë, zyrtarët e policisë janë gjithashtu të detyruar të respektojnë dispozitat e Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në kryerjen e një funksioni publik, i cili i referohet një konflikti të interesit si përfitimi privat i çdo zyrtari publik që mund të ndikojë në kryerjen e detyrës publike me transparencë, ndershmëri dhe ligjshmëri.⁶¹ Megjithatë, në rastin e Kosovës, zyrtarët policorë nuk u nënshtrohen testeve të integritetit, si në shumë vende të tjera.⁶²

Ligji për policinë specifikon se personeli i policisë nuk mund të pranojë një pozicion ose detyrim ose të marrë pjesë në aktivitete që mund të krijojnë konflikt interesi, si emërimi ose zgjedhja në poste publike ose poste të tjera qeveritare, punësim ose pjesëmarrje në ndonjë aktivitet biznesi për kompensim ose aktiv. pjesëmarrja në ndonjë parti politike. Megjithatë, përcaktimi i pozicioneve dhe aktiviteteve që përbëjnë një konflikt interesi përfshin, por nuk kufizohen në, angazhime specifike dhe lë të paqartë se cilat janë opsionet që oficerët e policisë të angazhohen në aktivitete të tjera.⁶³ Legjislacioni specifikon se punonjësit e lartë të policisë nuk kanë të drejtë të angazhohen në marrëdhënie kontraktuale drejtpërdrejt ose me institucionin ku kanë ushtruar funksionin e tyre publik për një periudhë deri në dy vjet pas përfundimit të funksionit të tyre publik. Kjo dispozitë zbatohet veçanërisht për zyrtarët e nivelit të lartë, si Drejtori i Përgjithshëm dhe Shefi i Inspektoratit Policor.⁶⁴ Në të njëjtën kohë, legjislacioni





nuk përmban dispozita lidhur me kufizimin e punësimit të policëve të rregullt pas shërbimit të tyre në PK.

Zyrtarët policorë duhet të kryejnë një trajnim standard prej 40 orësh⁶⁵ çdo vit në fushat e parashikuara sipas nevojës nga menaxhmenti.⁶⁶

Ligji i ri për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurive dhe Dhuratave, i cili hyri në fuqi në gusht 2022, specifikon se zyrtarët e lartë të policisë, duke përfshirë Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë, Zëvendësdrejtorët e Policisë, Drejtorët e Divizioneve, Drejtorët e Departamenteve, Drejtorët e Deklarimit të pasurisë i nënshtrohen drejtorive, drejtorëve rajonalë të Policisë së Kosovës dhe komandantëve të stacioneve policore të Kosovës. Për mosdeklarim të pasurisë ndaj zyrtarëve të lartë të policisë merren dy lloje masash: gjobë administrative dhe kallëzim penal në prokurorinë përkatëse.⁶⁷

INDIKATORI 6.2.6
MEKANIZMAT E INTEGRITETIT (NË PRAKTIKË)

50/100



Ka një qasje kryesisht reaktive për zbatimin e masave që sigurojnë integritetin e punonjësve të policisë. Kodet e sjelljes dhe mekanizmat përgjegjës për integritetin zbatohen dobët në praktikë për shkak të monitorimit të pamjaftueshëm.

Zyrtarët e policisë nuk u nënshtrohen testeve të integritetit, si në shumë vende të tjera.⁶⁸

PK ka krijuar mekanizma mbikëqyrës për zyrtarët e saj, të cilët përfshijnë mbikëqyrësit e drejtpërdrejtë dhe nivelet e tjera të sektorit të inspektimit në Policinë e Kosovës, Drejtorinë e Auditimit, Drejtorinë e Hetimeve të Brendshme, Komisionin e Brendshëm Disiplinor, Komisionin e Ankesave

dhe Komisionin për Vlerësimin e Përdorimit të Forcës.⁶⁹ Ky mekanizëm funksionon në kuadër të Divizionit për Standarde Profesionale.

Policia bën publike rastet disiplinore të administruara nga Drejtoria e Hetimeve të Brendshme dhe Komisioni i Brendshëm Disiplinor.⁷⁰ Megjithatë, informacionet dhe të dhënat në raportet e publikuara nga këto organe, të cilat vlerësojnë efektivitetin e mekanizmave disiplinore, përmendin vetëm shkurt në raportet vjetore të policisë, dhe për rrjedhojë të dhënat janë të pamjaftueshme. Parregullsitë janë gjithashtu të pranishme gjatë informimit të palëve për procedurat disiplinore që ndjekin procedurat standarde të veprimit.⁷¹

Deri më tani nuk ka asnjë kallëzim penal ndaj punonjësve të policisë për mosdeklarim.⁷² Mirëpo, sipas Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, për dallim nga vitet e kaluara, tani ka drejtorë dhe ish-drejtorë të PK-së që nuk kanë deklaruar pasurinë, dhe kallëzime penale ndaj tyre pritet të ngrihen.⁷³

Arrestimi i policëve në vitin 2022 e minoi disi këtë perceptim në krahasim me vitet e kaluara kur PK-ja shihej si një institucion i besueshëm, por pak i korruptuar.⁷⁴

Sipas Barometrit të Sigurisë 2020, sa i përket besimit në institucionet e vendit, 41 për qind e të anketuarve thanë se PK-ja ishte institucioni që i besonin më së shumti.⁷⁵

PK ka programe trajnimi në fusha të ndryshme që kanë të bëjnë me detyrat e tyre. Trajnimet kryesisht ofrohen nga Akademia e Kosovës për Siguri Publike në mënyrë periodike dhe sipas kategorive.⁷⁶ Oficerët e policisë duhet të kryejnë një trajnim standard prej 40 orësh çdo vit në fushat e parashikuara sipas nevojës nga menaxhmenti.⁷⁷ Megjithatë, testet e integritetit mungojnë për zyrtarët e policisë.



INDIKATORI 6.2.7
GJINIA

25/100



PK-së i mungojnë protokollet dhe udhëzimet mjaftueshëm të qarta lidhur me ndjeshmërinë gjinore. Policia nuk ofron trajnime për zbatimin e barazisë gjinore.

Nga ana tjetër, mekanizmat e ankesave në IPK kanë protokolle për barazinë gjinore.⁷⁸ Në raportet e tij vjetore, IPK-ja publikon të dhëna të ndara sipas gjinisë, duke përfshirë numrin e ankesave të paraqitura nga gratë dhe burrat për një vit.⁷⁹ Megjithatë, Policia e Kosovës nuk prodhon të dhëna të tilla të ndara sipas gjinisë.

IPK punëson gra oficere si personel në departamentin e hetimeve dhe menaxhimit të ankesave, por numri i tyre luhetet në varësi të vëllimit të ankesave.⁸⁰

PK-ja ka një agjendë për barazinë gjinore në Planin e Veprimit 2021–2023, me objektiv afatgjatë rritjen e kontributit të grave në të gjitha pozitat, gradat dhe nivelet vendimmarrëse.⁸¹ Por kjo nuk zbatohet në mënyrë efektive në praktikë. PK-ja nuk ndërmerr veprime për përmirësimin e përfaqësimit të barabartë gjinor në këtë institucion.⁸² Në strukturat e PK-së, asnjë grua nuk ka marrë grada të larta dhe nuk ka pasur gradime të grave oficere në poste të larta.⁸³

Në planin vjetor të trajnimit për vitin 2022, nuk është parashikuar asnjë trajnim për barazinë gjinore.⁸⁴





Roli



INDIKATORI 6.3.1 HETIMI I KORRUPSIONIT

75/100



PK-ja ka autoritetin ligjor për të kryer hetime për rastet e korrupsionit, me autorizimet që ndiqen edhe në praktikë. Megjithatë, kompetencat e Policisë janë drejtpërdrejt të ndërvarura me Prokurorinë dhe mungesa e burimeve njerëzore çon në nivele të caktuara joefektiviteti.

PK-ja nuk ka kompetenca të drejtpërdrejta për të hetuar rastet e korrupsionit sepse kompetencat janë të ndërlidhura dhe të ndërvarura me prokurorinë.⁸⁵ Policia është e autorizuar vetëm të përdorë mjete dhe teknika hetimore, të cilat përfshijnë kryerjen e kontrolleve të personave, objekteve dhe lokaleve, marrjen në pyetje të të dyshuarve dhe dëshmitarëve dhe sekuestrimin ose konfiskimin e gjërave që shërbejnë si provë.⁸⁶ Gjithashtu, policia përdor masa hetimore të fshehta, si vëzhgimi, fotografimi, hetimi, regjistrimi, përgjimi i telefonatave dhe simulimi i akteve korruptive.⁸⁷

Në vitin 2022, PK-ja trajtoi 318 raste për luftimin e krimeve ekonomike, korrupsionit dhe pasurisë. Në këto raste janë arrestuar 81 të dyshuar, ndër të cilët janë ngritur 178 kallëzime penale për rastet e korrupsionit.⁸⁸ Në vitin 2022, 75 për qind e rasteve dhe kallëzimeve penale për veprat e lidhura me korrupsionin dhe krimet ekonomike, të cilat prokuroria i ka pranuar, janë iniciuar nga PK-ja. Në një raport të Institutit të Kosovës për Drejtësi në lidhje me korrupsionin, faktori kryesor që ata identifikuan si shpjegim të mungesës së dëni-

meve ndaj të akuzuarve për korrupsion është kapaciteti i ulët i policëve të angazhuar në ndjekjen e korrupsionit (shih 6.1.1).⁸⁹

Deri në vitin 2020, PK-ja kishte edhe Departamentin Special Kundër Korrupsionit, ose siç njihet "Task Forca Kundër Korrupsionit", e cila ishte pjesë e policisë dhe kishte për qëllim parandalimin, hetimin dhe zbulimin e veprave penale që kishin të bënin me ekonominë, financat dhe korrupsionin, por edhe hetimin dhe luftën kundër korrupsionit të nivelit të lartë në Kosovë. Në vitin 2020, kjo task forcë u shua nga qeveria e udhëhequr nga ish-kryeministri Avdullah Hoti. Mbyllja e saj shpërfaqti mungesën e vullnetit politik për të luftuar korrupsionin.⁹⁰



Ndërveprimet

PK-ja bashkëpunon ngushtë me Prokurorin e Shtetit, gjykatat, Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit dhe institucionet tjera të zbatimit të ligjit. Këto marrëdhënie, aq sa janë të ndërtuara mbi përcaktime ligjore, janë edhe të natyrës reciproke dhe kanë të bëjnë me luftën kundër korrupsionit.

Policia zbaton urdhrat dhe udhëzimet e dhëna në mënyrë të ligjshme nga prokuroria dhe gjykatat dhe këto ndërveprime janë të përcaktuara me ligj.⁹¹

PK-ja gjithashtu bashkëpunon me Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit në dhënien e informacionit të dyanshëm në parandalimin, hetimin dhe ndalimin e dukurive korruptive. Madje këto dy institucione kanë nënshkruar një memorandum bashkëpunimi për të forcuar bashkëpunimin në zbulimin dhe hetimin e korrupsionit.⁹²

Këto ndërveprime janë pozitive sepse synojnë përmbushjen e detyrimit ligjor për të ndjekur dhe luftuar me sukses korrupsionin. Megjithatë, edhe pse ka një synim të përbashkët të ndërveprimit në efikasitetin e rasteve të korrupsionit, situata në praktikë tregon mungesë të rezultateve konkrete në dënimin e rasteve të tilla, nga mosndëshkimi në raste më të larta.⁹³

Rekomandimet e shtyllës

- Zbatimi i një mekanizmi transparence për rekrutimin dhe emërimin e drejtuesve të lartë të policisë, duke siguruar që këto procese të jenë profesionale dhe të mos ndikohen politikisht. Ky mekanizëm duhet ta bëjë të detyrueshëm publikimin e të gjitha dokumenteve të brendshme që mund të jenë me interes për publikun, duke përfshirë fletët e notimit të kandidatëve dhe përmbledhjet dhe arsyetimin e vlerësimit të rekrutimit.
- Ndryshimi i legjislacionit për të përfshirë kufizimet pas punësimit për zyrtarët e lartë policorë të Policisë së Kosovës.
- Organizimi i trajnimeve shtesë të specializuara për PK-në mbi integritetin dhe kryerja e testeve të vazhdueshme të integritetit për policët.
- Rritja e transparencës në proceset vendimmarrëse të PK-së, veçanërisht vendimet operative, dhe në publikimin e dokumenteve të saj të brendshme.
- Ndryshimi i Kodit të Etikës së Policisë së Kosovës në mënyrë që të përfshijë edhe zyrtarët e lartë dhe Drejtorin e Përgjithshëm.





REFERENCAT

- 1 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 128.
- 2 Kushtetuta e Kosovës, neni 128.
- 3 Ligji për Policinë, neni 5.
- 4 Ligji për Policinë, neni 34.
- 5 Ligji për Inspektoratin Policor të Kosovës, neni 2.
- 6 Ligji për Policinë, neni 51.
- 7 Ligji për ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, faqe 57.
- 8 Ligji për menaxhimin e financave publike, neni 10.
- 9 Ligji për ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, faqe 57.
- 10 Indeksonline, 25 nëntor 2020. <https://indeksonline.net/sindikata-e-policise-reagojne-ashper-nuk-i-pranojme-shkurtime-buxhetore-7/>. [qasur më 10 shtator 2022]
- 11 Intervistë me Plator Avdiu, QKSS, korrik 2022
- 12 Raporti vjetor i punës së Policisë së Kosovës, për vitin 2021, faqe 6.
- 13 Deutsche Welle, 11 nëntor 2022, <https://www.dw.com/sq/kosovë-serbët-largohen-nga-institucionet-policët-serbë-në-veri-dorëhiqen/a-63661034/> [qasur më 8 tetor 2022]
- 14 Zëri, 09 korrik 2022, <https://zeri.info/aktuale/454330/policia-e-kosoves-pranon-donacion-nga-undp-ja-ndihmon-ne-gjetjen-e-armeve-ilegale/> [qasur më 5 gusht 2022]
- 15 Intervistë me Plator Avdiu, QKSS, korrik 2022
- 16 Policia e Kosovës, <https://www.kosovopolicia.com/departamentet/departamenti-i-hetimeve/> [qasur më 8 tetor 2022]
- 17 Intervistë me zyrtarë të Policisë së Kosovës, gusht 2022.
- 18 Ligji për Policinë, neni 37.
- 19 Ligji për Policinë, neni 38.
- 20 Udhëzimi Administrativ për Marrëdhëniet e Punës në Policinë e Kosovës, neni 6, paragrafi 4 [qasur më 7 shtator 2023]
- 21 Ligji për Policinë, neni 39.
- 22 Kodi i Etikës i Policisë së Kosovës, neni 8.
- 23 Kodi i Etikës së Policisë, neni 24.
- 24 Intervistë me Plator Avdiu, QKSS, korrik 2022
- 25 Gazeta Blic, tetor 2022, <https://gazetablic.com/ne-pritje-te-drejtorit-te-ri-ekspertet-thone-se-politika-duhet-ti-largoje-dart-nga-policia-e-kosoves/> [qasur më 25 tetor 2022]
- 26 Gazeta Express, shtator 2022, <https://www.gazetaexpress.com/gara-per-drejtor-te-policise-miftaraj-pak-kandidate-politika-nuk-e-zgjedh-me-te-mi-rin/> [qasur më 8 tetor 2023]
- 27 Telegrafi, mars 2023, <https://telegrafi.com/veliu-mohon-pretendimet-e-qalajt-per-nderhyrje-politike-ne-shkarkimin-e-tij/> [qasur më 8 tetor 2023]
- 28 Sinjali, tetor 2021, <https://sinjali.com/cilet-deputete-te-pdk-se-do-ta-zevendesojne-hamzen-e-nuren-ne-grupin-parlamentar/> [qasur në nëntor 2023]
- 29 Insajderi, janar 2021, <https://insajderi.org/aderimi-i-rashit-qalajt-ne-pdk-e-ve-ne-dyshim-punen-e-tij-ne-krye-te-policise/> [qasur në tetor 2023]
- 30 Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën për 2022, tetor 2022, faqe 46.
- 31 Ligji për Policinë, neni 33
- 32 Intervistë me Plator Avdiu, QKSS, korrik 2022.
- 33 Ligji për Policinë, neni 2.
- 34 Ligji për qasje në dokumente publike, neni 6.
- 35 Ligji për Inspektoratin Policor të Kosovës, neni 3.
- 36 Ligji për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe dhuratave, neni 4.
- 37 Agjencia Kundër Korrupsionit, Deklarimi i pasurisë, https://akk-ks.org/deklarimi_i_pasuris/2141/Ministria_e_Punëve_të_Brendshme_dhe_Administratës_Publike/2141/ [qasur më 24 tetor 2023]
- 38 Ligji për Policinë, neni 31.
- 39 Policia e Kosovës, <https://www.kosovopolicia.com/informacione/> [qasur më 8 tetor 2022]
- 40 Intervistë me Plator Avdiu, QKSS, korrik 2022
- 41 Agjencia Kundër Korrupsionit, https://akk-ks.org/assets/cms/uploads/files/Deklarimi_i_Pasurise/Deklarimet/declaration/2020/Qeveria/Ministria_e_Puneve_te_Brendshme_dhe_Administrates_Publike/Samedin_Mehmeti.pdf [qasur më 9 tetor 2022]
- 42 Policia e Kosovës, <https://www.kosovopolicia.com/dokumente/dokumentet-strategjike/> [qasur më 8 tetor 2022]
- 43 Intervistë me Plator Avdiu, QKSS, korrik 2022
- 44 Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, Gjendja e Politikave të Integritetit në Policinë e Kosovës, (Prishtinë: QKSS, 2020), fq. 15.
- 45 Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, Gjendja e Politikave të Integritetit në Policinë e Kosovës, (Prishtinë: QKSS, 2020), fq. 18.



- 46 Ligji për Policinë, neni 5.
- 47 Rregullorja e punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, neni 35.
- 48 Ligji për Inspektoratin Policor të Kosovës, neni 2.
- 49 Udhëzimi Administrativ nr. 20/2015 për procedurën e fillimit të hetimit penal, neni 5. Gjetendet në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2720> [qasur më 9 nëntor 2022]
- 50 Ligji për Inspektoratin Policor të Kosovës, neni 17.
- 51 Ligji për Inspektoratin Policor të Kosovës, neni 1.
- 52 Ligji për Inspektoratin Policor të Kosovës, neni 2.
- 53 Ankesat e pranua në formë elektronike 34,7 për qind, të pranua në zyrat rajonale të IPK-së 2,5 për qind, ankesat (inicimet) nga Departamenti i Hetimeve 5,6 për qind, të pranua përmes postës 10,5 për qind, Inicimet e brendshme nga Policia e Kosovës 4.6 për qind dhe forma të tjera me më pak përqindje.
- 54 Inspektorati Policor i Kosovës, Raporti Vjetor i Punës 2022, (Prishtinë: IPK, 2022), faqe 8.
- 55 Inspektorati Policor i Kosovës, Raporti Vjetor i Punës 2022, (Prishtinë: IPK, 2022), faqe 12.
- 56 Ligji për Inspektoratin Policor të Kosovës, neni 17.
- 57 Intervistë me Kushtrim Hodaj, Inspektorati Policor i Kosovës, Gusht 2022.
- 58 Portali Kallxo, 14 mars 2022, <https://kallxo.com/lajm/policet-kufitar-sushohen-se-moren-qindra-euro-ryshfet/>. [qasur më 5 gusht 2022]
- 59 Dispozitat nga Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Kryerjen e Funksionit Publik, Ligji për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurive dhe Dhuratave si dhe Ligji për Policinë.
- 60 Policia e Kosovës, Plani për forcimin e integritetit në Policinë e Kosovës 2021-2025, faqe 10.
- 61 Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, neni 6.
- 62 Intervistë me Plator Avdiu, QKSS, korrik 2022
- 63 Ligji për Policinë, neni 49.
- 64 Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, neni 18.
- 65 Policia e Kosovës, <https://www.kosovopolicia.com/departamentet/departamenti-per-shebime-njerezore/> [qasur më 8 tetor 2023]
- 66 Intervistë me zyrtarë të Policisë së Kosovës, gusht 2022.
- 67 Ligji për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe dhuratave, neni 28.
- 68 Intervistë me Plator Avdiu, QKSS, korrik 2022
- 69 Intervistë me zyrtarë të Policisë së Kosovës, gusht 2022.
- 70 Raporti i Policisë së Kosovës, Raporti Vjetor 2021, faqe 19.
- 71 Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, Gjendja e Politikave të Integritetit në Policinë e Kosovës, (Prishtinë: QKSS, 2020), fq. 26.
- 72 Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, "Raporti vjetor i punës për 2021". (Prishtinë: Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, 2022), faqe 4.
- 73 Kallxo.com, 8 qershor 2022, <https://kallxo.com/lajm/akk-ka-drejto-re-policise-qe-nuk-e-kane-ber-deklarimin-e-pasurise/> [qasur më 28 gusht 2022]
- 74 Albanian post, mars 2022, <https://albanianpost.com/operacioni-pika-50-persona-te-arrestuar-18-te-tjere-ne-arrati/> [qasur më 15 tetor 2023].
- 75 Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, Besimi i qytetarëve të Kosovës në institucionet e sigurisë dhe drejtësisë, (Prishtinë: QKSS, 2020), faqe 6.
- 76 Akademia e Kosovës për Siguri Publike, Plani i Trajnimit 2022, (Vushtrri: AKSP, 2021), faqe 7.
- 77 Intervistë me zyrtarë të Policisë së Kosovës, gusht 2022.
- 78 Ligji për Inspektoratin Policor të Kosovës, neni 5.
- 79 Inspektorati Policor i Kosovës, Raporti Vjetor i Punës 2021, (Prishtinë: PIK, 2022), faqe 13.
- 80 Intervistë me Kushtrim Hodaj, Inspektorati Policor i Kosovës, Gusht 2022.
- 81 Intervistë me Kushtrim Hodaj, Inspektorati Policor i Kosovës, Gusht 2022.
- 82 Sipas Raportit Vjetor të Punës së Policisë, vetëm 14,96 për qind e punonjësve janë gra, që është larg kuotës 50 për qind të përfaqësimit gjinor në institucionet publike. Po ashtu, shih Raportin Vjetor të Punës së Policisë së Kosovës, për vitin 2021, faqe 6.
- 83 Intervistë me Plator Avdiu, QKSS, korrik 2022.
- 84 Akademia e Kosovës për Siguri Publike, Plani i Trajnimeve 2022 http://aksp-ks.net/repository/docs/20220824073436_Plani_i_Trajnimeve_i_AK-SP_p_r_vitin_2022_Gjuha_Shqipe_pdf [qasur më 9 nëntor 2022]
- 85 Kodi i Procedurës Penale, neni 70.
- 86 Kodi i Procedurës Penale, neni 71.
- 87 Kodi i Procedurës Penale, neni 87, paragrafi 1.
- 88 Raporti vjetor i punës së Policisë së Kosovës, për vitin 2022, faqe 15.
- 89 Instituti i Kosovës për Drejtësi, Raporti i Korrupsionit, (Prishtinë: KIJ, 2022), faqe 5.
- 90 Deutsche Welle në shqip, 26 tetor 2020, <https://www.dw.com/sq/shuarja-e-task-forcës-antikorrupcion-gre-xqetësime-të-mdha/a-55397378>. [qasur më 27 korrik 2022] Ky vendim u shoqërua me kritika dhe debate të ashpra nga opozita, shoqëria civile dhe përfaqësues ndërkombëtarë.
- 91 Ligji për Policinë, neni 6.
- 92 Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit. https://www.akk-ks.org/lajmi_i_plote/936. [qasur më 15 tetor 2022]
- 93 Instituti Demokratik i Kosovës, "Kultura e Mosndëshkimit" në Kosovë, (Prishtinë: KDI, 2020), faqe 22.




KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE




PËRMBLEDHJE

Kjo shtyllë analizon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), duke përfshirë Sekretariatit e KQZ-së dhe Zyrën për Regjistrimin, Certifikimin dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike (Zyrën).


58/100 Rezultati i përgjithshëm i shtyllës




Kapacitetet



Qeverisja



Roli





KQZ-ja është përgjegjëse për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve,¹ asistuar nga Sekretariati i KQZ-së.² Zyra është përgjegjëse për përditësimin dhe mirëmbajtjen e regjistrit të partive politike, certifikimin e subjekteve politike dhe kandidatëve të tyre, kufizimin e shpenzimeve gjatë fushatës, monitorimin dhe kontrollin e financave të subjekteve politike.³

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka bërë përparim të kufizuar që nga vlerësimet e Sistemit të Integritetit Kombëtar (SIK) në 2011 dhe 2015. KQZ-ja ka vijuar të përmirësojë nivelin e transparencës dhe llogaridhënies lidhur me punën dhe vendimmarrjen e saj. KQZ-ja vlerësohet pozitivisht për organizimin dhe administrimin e rregullt të zgjedhjeve, veçanërisht në afate të shkurtra kohore. Mbajtja e zgjedhjeve nën juridiksionin e plotë dhe praktik të KQZ-së në katër komunat veriore të vendit pa mbështetjen e OSBE-së është një tjetër zhvillim pozitiv për organet e menaxhimit të zgjedhjeve. Megjithatë, proceset zgjedhore karakterizohen ende nga probleme të përsëritura, si shkalla e lartë e votimit të asistuar, vështirësitë në gjetjen e emrit në listën e zgjedhësve, fletëvotimet e pavlefshme, çështjet që lidhen me procesin e numërimit dhe ato që kanë të bëjnë me votimin jashtë vendit.

Pas më shumë se një dekade, Kuvendi i Kosovës e përmbylli procesin e reformës zgjedhore duke miratuar një ligj të ri për zgjedhjet, i cili përtej përmirësimeve teknike, ka cenuar integritetin zgjedhor në lidhje me të drejtën ligjore të kandidatëve, duke lejuar kandidimin e të gjithë individëve, me përjashtim të atyre që dënohen me një ose më shumë vjet burgim efektiv. Ekziston gjithashtu një politizim në rritje i anëtarëve dhe stafit të KQZ-së, i cili ndikon negativisht në pavarësinë e KQZ-së dhe çon në një boshllëk në funksionimin e mekanizmave të llogaridhënies dhe integritetit.



Kapacitetet

 **INDIKATORI 7.1.1 BURIMET (NË PRAKTIKË)**

75/100



Burimet financiare të KQZ-së janë përgjithësisht të mjaftueshme për të përmbushur rolin e tij. Megjithatë, sa u përket burimeve njerëzore, një pjesë e stafit të KQZ-së kanë një nivel të pamjaftueshmërisë sa i përket aftësive të mira hartuese ligjore dhe ekspertizës financiare. Sa u përket burimeve teknike, KQZ-së i mungon hapësira e duhur e përditshme për zyra si dhe një server i centralizuar i dosjeve.

Sipas Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, KQZ-ja merr çdo vit një ndarje të buxhetit të konsoliduar të Kosovës.⁴ Në vitet jozgjedhore, buxheti i përgjithshëm i KQZ-së është rreth 6 milionë euro. Pjesa e ndarë e këtij buxheti për Sekretariatit dhe Zyrën ka shënuar rritje të lehtë me një buxhet total në vitin 2022 prej 1.7 milionë euro. Gjithashtu, buxheti i ndarë për zgjedhjet gjatë viteve zgjedhore është rritur nga 8.1 milionë euro në 2017 në 13.9 milionë euro në vitin 2021.⁵ Kjo ka të ngjarë të lidhet me një rritje të kostos mesatare për votues nga 3.3 € në 2013 në 4.1 € në 2021.⁶ Sipas kryetarit të KQZ-së, buxheti ka qenë i mjaftueshëm, pasi asnjë operacion zgjedhor nuk ka dështuar për mungesë buxheti.⁷

Sa u përket burimeve njerëzore, KQZ-ja ka gjithsej 11 anëtarë, ndërsa Sekretariati ka një numër të qëndrueshëm prej 86 deri në 93 punonjës, kryesisht me kontrata pune të pakufizuara,⁸ ndërmjet viteve 2017-2023.⁹ Ky numër përfshin një numër të përgjithshëm prej dhjetë punonjësish të Zyrës, shtatë prej të cilëve do të rekrutohen gjatë viteve 2023-24, siç parashihet me ligj.¹⁰ Megjithatë, deri në vitin 2022, Zyra



kishte vetëm tre anëtarë të stafit, të cilëve, sipas ish-drejtorit të saj, u mungon ekspertiza e nevojshme financiare për të përmbushur rolin e saj të ri për të kryer kontrole financiare (shih 7.3.1).¹¹ Përveç kësaj, sipas burimeve anonime brenda KQZ-së, disa nga stafi i Sekretariatit nuk kanë aftësi për shkrim ligjor.¹²

Me legjislacionin e mëparshëm, anëtarëve të KQZ-së u kërkohet të kenë të paktën pesë vjet përvojë pune dhe një diplomë universitare në drejtësi, shkencë sociale, administrim zgjedhor ose statistika.¹³ Ligji i ri nuk parasheh ndonjë kërkesë të tillë. Sa i përket personelit jo permanent, KQZ-së i mungojnë profilet e punës të përcaktuara qartë që pasqyrojnë nevojat reale të Sekretariatit, gjë që ka çuar në rekrutime politike (shih 7.1.3). Organizatat ndërkombëtare dhe donatorët e tjerë, veçanërisht OSBE-ja, ofrojnë trajnime për ndërtimin e kapaciteteve për stafin e KQZ-së.¹⁴

Sipas Kryeshefit të Sekretariatit, KQZ-së i mungon hapësira e nevojshme për zyra dhe më pas detyrohet të operojë deri në katër objekte të ndryshme gjatë zgjedhjeve, duke e bërë më të vështirë komunikimin dhe koordinimin ndërmjet departamenteve të ndryshme.¹⁵ Aktualisht, Sekretariati nuk ka një "server dosjesh" të centralizuar, me të gjitha dokumentet e lidhura me zgjedhjet të ruajtura dhe të publikuara në baza ad-hoc. Ka plane për të arkivuar çdo dokument dhe material të KQZ-së nga viti 2009 e në vazhdim,¹⁶ megjithatë nuk është e qartë se kur do të funksionalizohet serveri i dosjeve.

**INDIKATORI 7.1.2
PAVARËSIA (SIPAS LIGJIT)****75/100**

Ndonëse Kushtetuta garanton pavarësinë e KQZ-së,¹⁷ emërimi i anëtarëve të tij sipas propozimeve të partive politike në parlament ka sjellë politizimin e institucionit.

Legjislacioni i mëparshëm përmbante mangësi në lidhje me shkarkimin e kryetarit dhe anëtarëve të KQZ-së, të karakterizuara nga përfshirja e referencave të paqarta për cenimin e integritetit të KQZ-së.¹⁸ Pas ndryshimeve të fundit legjislative, ndërkohë që ligji ka përcaktuar kriteret për shkeljen e integritetit, ai ka cenuar pavarësinë e KQZ-së duke përcaktuar që shkarkimet në raste të tilla kërkojnë miratimin e dy të tretave të anëtarëve të tij.¹⁹

Në mesin e 11 anëtarëve të KQZ-së, Presidenti emëron kryesuesin nga radhët e gjyqtarëve dhe dhjetë të tjerët në bazë të propozimeve të grupeve parlamentare të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës. Grupet parlamentare, pavarësisht për qindjes në Kuvend, marrin një anëtar.²⁰ Mandati i Kryetarit të KQZ-së është i kufizuar në shtatë vjet, me mundësi rizgjedhjeje (kufizuar në dy mandate të njëpasnjëshme).²¹

Në kuadër të funksionimit të brendshëm, pavarësia e KQZ-së sigurohet nëpërmjet një ndarjeje ligjore të pushteteve dhe funksionit ndërmjet anëtarëve të zgjedhur të KQZ-së si organ vendimmarrës dhe personelit administrativ të Sekretariatit si zbatues i vendimeve.²² Kryeshefi Ekzekutiv drejton Sekretariatit dhe raporton ligjërisht drejtpërdrejt në KQZ.²³ Drejtori i Zyrës i përgjigjet drejtpërdrejt Kryetarit të KQZ-së.²⁴

Në përgjithësi, ligji i mëparshëm për shërbimin civil,²⁵ ligji aktual për zyrtarët publikë,²⁶ dhe rregulloret e brendshme të KQZ-së²⁷ sigurojnë që rekrutimi i stafit të Sekretariatit dhe Zyrës të bazohet në meritokraci dhe jo diskriminim.

Megjithatë, në vitin 2020, udhëzimi administrativ në lidhje me procesin e rekrutimit të Kryeshefit u ndryshua sa i përket përbërjes së panelit të rekrutimit (nga pesë u rrit në të 11 anëtarë të KQZ-së).²⁸ Ky ndryshim ushtroi një ndikim të drejtpërdrejtë politik në përzgjedhjen e kryeshefit të ri të Sekretariatit të KQZ-së. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës fillimisht e anuloi të gjithë procesin.²⁹ Megjithatë, Gjykata Themelore e Prishtinës ka pezulluar ekzekutimin e këtij vendimi në pritje të zgjidhjes përfundimtare të rastit.³⁰ Ndërkohë, stafi tjetër në Sekretariat rekrutohet nga një komision ad-hoc.³¹

Sekretariati dhe stafi i Zyrës -së mbrohen nga shkarkimet e paarsyeshme.³² Sipas ligjit të ri zgjedhor, kriteret e shkarkimit për anëtarët dhe Kryetarin e KQZ-së janë sqaruar për të përfshirë veprime të tilla si mbajtja e një posti tjetër publik në Kosovë apo gjetkë, marrja e një roli vendimmarrës në subjektet politike, cenimi i funksionimit të KQZ-së dhe zbulimi i informacionit konfidencial. Megjithatë, ligji paraqet një potencial për ndikim politik, pasi përfundimi i mandatit të kryetarit ose ndonjë anëtarit të KQZ-së kërkon një propozim me shkrim të miratuar nga dy të tretat e anëtarëve të KQZ-së, duke i lejuar ata të bllokojnë përfundimin edhe në rast shkeljeje. Kjo është në kontrast me legjislacionin e mëparshëm, të cilit i mungonte një përkufizim i qartë i sjelljes së shkarkimit,³³ duke i dhënë Presidentit një diskrecion të tepruar në vendimet e pajustificuara të shkarkimit. (Për një rast ilustrues, i referoheni 7.1.3.)

**INDIKATORI 7.1.3
PAVARËSIA (NË PRAKTIKË)****25/100**

Praktikisht, pavarësia e KQZ-së kufizohet nga partishmëria e anëtarëve dhe stafit të sekretariatit të saj, qëndrimet shtytëse dhe mbrojtëse të partive që i kanë emëruar ose punësuar dhe shkarkimet e politizuara të anëtarëve të KQZ-së.

Edhe pse nuk ka pasur raste të raportuara të përfshirjes së anëtarëve të KQZ-së në aktivitete partiake, Raporti i Vëzhgimit të Zgjedhjeve 2021 nga rrjeti "Demokracia në Veprim" (DNP) arrin në përfundimin se KQZ-ja është bërë gjithnjë e më e politizuar nga brenda.³⁴ Për shembull, në vitin 2021 pati diskutime të ashpra për çështje të tilla si certifikimi i subjekteve politike³⁵ dhe kandidatët e tyre dhe votimi jashtë vendit, me partitë politike që përpiqeshin të shtynin përpara certifikimin e kandidatëve, në kundërshtim me kërkesat e ligjit.³⁶

Sipas një burimi anonim nga një organizatë ndërkombëtare e intervistuar për këtë raport, ka mosbesim mes anëtarëve të KQZ-së dhe stafit të Sekretariatit. Kjo vjen kryesisht për shkak se një pjesë e stafit që punon në KQZ konsiderohet se janë punësuar në bazë të përkatësisë së tyre politike, në periudhën kur Kosova karakterizohej me kapje të shtetit dhe punësim në bazë të përkatësisë partiake. Si rezultat i këtij mosbesimi, anëtarët e KQZ-së përfshihen në çështjet e Sekretariatit, si p.sh. vendimi për vlefshmërinë e aplikimeve nga votimi jashtë vendit, emërimi i anëtarëve në vendvotime, ose regjistrimi dhe certifikimi i partive politike.³⁷

Në kushte anonimiteti, një stafi i Sekretariatit kritikoi se anëtarët e KQZ-së kryejnë vlerësimin e performancës së stafit menaxherial³⁸ bazuar në një shabllon joadekuat që nuk kërkon informacion të detajuar dhe vlerësim mbi performancën.³⁹ Gjithashtu në kontekstin e ndërhyrjeve nga

anëtarët e KQZ-së, shumë pozicione drejtuese të Sekretariatit plotësohen duke promovuar punonjësit aktualë dhe jo duke rekrutuar staf të ri, duke aplikuar sistemin e rekrutimit të bazuar në merita.⁴⁰

Në vitin 2021, presidentja Vjosa Osmani shkarkoi kryetaren e KQZ-së, Valdete Daka, katër vjet para përfundimit të mandatit ligjor dhe një ditë para shpalljes së zgjedhjeve. Arsyetimi zyrtar përfshin shkeljen lidhur me të dhënat personale dhe gabimet në listat e votuesve. Megjithatë, shoqëria civile dhe partitë opozitare kritikuan se këto dështime "i atribuoheshin ekskluzivisht kryetares së KQZ-së, pavarësisht faktit se kryetarja e KQZ-së është vetëm një nga njëmbëdhjetë anëtarët me të drejtë vote"⁴¹ dhe e panë atë si të motivuar politikisht.⁴²





Qeverisja

**INDIKATORI 7.2.1
TRANSPARENCA
(SIPAS LIGJIT)**

75/100



Ekzistojnë dispozita relativisht gjithëpërfshirëse në fuqi, të cilat i mundësojnë publikut të marrë informacion mbi organizimin dhe funksionimin e KQZ-së për vendimet që kanë të bëjnë me të dhe si janë marrë këto vendime. Megjithatë, zbrazëtirat ligjore që nuk kërkojnë që kandidatët të bëjnë publik financimin e tyre, çojnë në një mangësi në informacionin përkatës që KQZ-ja kërkohe të ofrojë publikut.

Të gjitha aktet e KQZ-së, rregulloret, rregullat zgjedhore, vendimet, udhëzimet, dhe rekomandimet duhet të publikohen në faqen e internetit brenda 48 orëve nga miratimi.⁴³ Mbledhjet e KQZ-së duhet të jenë gjithashtu të hapura për publikun, me përjashtim të rasteve specifike kur diskutohen çështje të personelit. Dispozita të veçanta rregullojnë publikimin e rezultateve të zgjedhjeve.⁴⁴ Sekretariati është i detyruar të publikojë vendndodhjet e sakta të të gjitha qendrave të votimit⁴⁵ dhe informacionin për procedurat e votimit, subjektet politike dhe kandidatët e tyre.

Vëzhguesit e zgjedhjeve mund të monitorojnë pa pengesa dhe të marrin informacion për të gjitha çështjet para, gjatë dhe pas zgjedhjeve.⁴⁶ Në ditën e zgjedhjeve, vëzhguesve u garantohet qasje e papenguar në procesin e votimit.

Me një ndryshim të vitit 2022 të legjislacionit për financimin politik, Zyrës pranë KQZ-së i kërkohet që të publikojë pasqyrat financiare vjetore deri më 30 qershor të vitit pasardhës, raportin e auditimit brenda 15 ditëve nga marrja e tij

dhe raportin financiar për fushatën zgjedhore të subjekteve politike brenda 45 ditëve pas mbajtjes së zgjedhjeve.⁴⁷ Megjithatë, për shkak të mangësive në ligj në lidhje me financimin dhe vetëfinancimin e kandidatëve (shih 7.3.1 dhe 11.2.1), KQZ-së nuk i kërkohet - ose më mirë thënë nuk është në gjendje - të zbulojë informacion mbi financimin e kandidatëve publikun.

**INDIKATORI 7.2.2
TRANSPARENCA
(NË PRAKTIKË)**

75/100



Publiku mund të gjejë informacione të rëndësishme mbi organizimin, funksionimin dhe të dhënat për zgjedhjet në faqen e internetit të KQZ-së. Megjithatë, KQZ-ja ndonjëherë nuk i përmbahet afateve të kërkuara për publikimin e vendimeve, konfirmimin e rezultateve të zgjedhjeve dhe pasqyrave financiare të subjekteve politike. Transparenca gjithashtu nuk shtrihet tek trupat menaxhuese zgjedhore lokale. Gjithashtu, raportet vjetore 2017-2020 të KQZ-së nuk janë të disponueshme në faqen e internetit.

Raporti i vitit 2022 i Misionit të Bashkimit Evropian të Vëzhgimit të Zgjedhjeve e vlerësoi punën e KQZ-së si "kryesisht transparente".⁴⁸ KQZ-ja publikon të gjitha dokumentet e saj thelbësore,⁴⁹ numrat e kontaktit për sektorë dhe departamente të ndryshme⁵⁰ dhe një kalendar me datat kyçe⁵¹ (datat e regjistrimit, regjistrimi i partisë, dita e zgjedhjeve) në faqen e saj të internetit.⁵² Megjithatë, shpesh jo brenda 48 orëve të kërkuara pas miratimit. Faqja e internetit gjithashtu nuk liston të gjitha vendimet.⁵³



KQZ-ja publikon vendndodhjet e qendrave të votimit me kohë (40 ditë para ditës së zgjedhjeve) në një platformë online.⁵⁴ Që nga viti 2017, KQZ-ja ka publikuar rezultatet e zgjedhjeve në faqen e saj të internetit në format të hapur të të dhënave të lexueshme nga makineritë (xls).⁵⁵ Që nga viti 2013, KQZ-ja mbledh rezultatet paraprake përmes platformës online të quajtur sistemi K-Vote dhe i publikon ato. Megjithatë, periudhat e gjata të certifikimit të rezultateve (për shembull, në 2019, dy muaj pas zgjedhjeve) minojnë besueshmërinë e rezultateve të zgjedhjeve.⁵⁶ Që nga viti 2017, KQZ ka zhvilluar një platformë për raportimin falas të shkeljeve zgjedhore nga qytetarët.⁵⁷

Raportet vjetore të punës (ndërmjet 2017-2020)⁵⁸ dhe raportet financiare të KQZ-së nuk janë të disponueshme në faqen e tij të internetit. Sipas KQZ-së kjo është për shkak të disa problemeve në faqen e internetit. Raportet e auditimit publikohen vetëm në faqen e internetit të ZKA-së.⁵⁹

KQZ-ja publikon në faqen e tij të internetit pasqyrat financiare dhe raportet e auditimit të subjekteve politike, por asnjëherë brenda afatit të kërkuar (30 qershor të vitit vijues), për shkak të vonesave të vazhdueshme në auditim. Ligji i mëparshëm për financimin politik parashihte që pasqyrat financiare duhet të publikohen së bashku me raportet e auditimit. KQZ-ja e interpretoi këtë duke nënkuptuar se nuk mund të publikojnë raporte të pa audituara. Ndryshimi i ligjit të vitit 2022 e ndryshoi këtë dhe raportet po publikohen brenda afateve ligjore.

KQZ-ja ndjek ligjin për qasje në informacion. Në vitin 2021, KQZ-ja mori dhe miratoi dhjetë kërkesa për qasje në dokumente publike.⁶⁰

Mbledhjet e KQZ-së zakonisht janë të hapura për publikun, megjithëse, gjatë zgjedhjeve të parakohshme, shumica e seancave zhvillohen në baza ad-hoc.⁶¹ KQZ-ja është përmirësuar me organizimin e konferencave të rregullta mediatike nga zëdhënësi, sidomos gjatë zgjedhjeve, kur mbahen deri në katër konferenca në ditën e zgjedhjeve.⁶²

Trupat menaxhuese zgjedhore lokale nuk janë transparente sepse të dhënat e tyre vendimmarrëse nuk janë publike. Asnjë nga OMZ-të nuk ka një faqe interneti funksionale ose ndonjë mjet tjetër me të cilin mund të publikojë informacionin përkatës.

**INDIKATORI 7.2.3
LLOGARIDHËNIA
(SIPAS LIGJIT)**

75/100



Ekzistojnë një sërë ligjesh për të siguruar që KQZ-ja duhet të raportojë dhe të përgjigjet për veprimet e veta. Megjithatë, afati për Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) për të vendosur për një ankesë ishte shumë i shkurtër për të siguruar trajtimin e duhur të ankesave.

Në prill të çdo viti, KQZ-ja duhet të dorëzojë një raport vjetor duke përfshirë aktivitetet dhe rekomandimet që KQZ i konsideron të nevojshme për t'u adresuar nga Kuvendi. Megjithatë, ligji nuk e specifikon nivelin e detajeve që duhet të përfshijë raporti. Thjesht theksohet se raporti vjetor duhet të përfshijë informacion rreth aktiviteteve.⁶³ Gjithashtu, KQZ-ja duhet të dorëzojë në Ministrinë e Financave një raport vjetor financiar për vitin e kaluar jo më vonë se data 31 janar. KQZ-ja duhet gjithashtu të përgatisë një raport të plotë për shpenzimet e zgjedhore, të cilat kontrollohen nga Zyra Kombëtare e Auditimit.⁶⁴ Raportet vjetore dhe financiare përbëjnë një dokument publik, prandaj, sipas Ligjit për Qasjen në Dokumente Publike, KQZ-ja duhet të publikojë të gjitha informacionet brenda 15 ditëve nga qasja e tyre.⁶⁵

Partitë politike kanë të drejtë ankesë gjatë dhe jashtë procesit zgjedhor në dy nivele: Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) dhe Gjykata Supreme, të cilat janë të obliguara t'i trajtojnë ankesat brenda pak ditësh. Gjykata Themelore ka kompetenca vetëm për të kundërshtuar saktësinë e listave zgjedhore. PZAP-ja është organ i pavarur i ngarkuar për të vendosur për ankesat dhe parashtrësia lidhur me administrimin zgjedhor.⁶⁶

Çdo person ka të drejtë të ankohet në PZAP kur i janë shkelur të drejtat në lidhje me procesin zgjedhor.⁶⁷ Koha për të ven-





dosur për ankesat e dorëzuara në PZAP është 96 orë (që shënon rritje krahasuar me 72 orë sa ishte në legjislacionin e mëparshëm).⁶⁸ Megjithatë, kjo kornizë kohore ishte shumë e shkurtër që PZAP të vlerësojë të gjitha rastet si duhet, veçanërisht gjatë zgjedhjeve kur ankesat rriten në mënyrë drastike.⁶⁹ PZAP-ja ka mangësi serioze sa u përket resurseve njerëzore, pasi që edhe gjatë viteve zgjedhore funksionon me vetëm dhjetë zyrtarë.

Vendimet e PZAP-it që prekin të drejtat themelore ose parashohin gjobë më të lartë se 5,000 euro mund të apelojnë në Gjykatën Supreme brenda 48 orëve (sipas legjislacionit të mëparshëm ishte 24 orë). Gjykata Supreme ka pesë ditë (sipas legjislacionit të mëparshëm ishte 72 orë) për të vendosur për çështjen.⁷⁰

INDIKATORI 7.2.4
LLOGARIDHËNIA (NË PRAKTIKË)

75/100



Ndërkohë që KQZ-ja duhet të raportojë dhe të përgjigjet për veprimet e caktuara të saj, ka pasur vonesa në miratimin e raportit vjetor 2020, me pretendime për pasaktësi. Përderisa PZAP-ja demonstroi trajtim efikas të ankesave, shqetësimet mbeten rreth miratimit të vonuar dhe shqyrtimit të kufizuar të raporteve vjetore të KQZ-së nga Kuvendi dhe qasja e kufizuar në dokumentet në internet.

Në vitin 2022, raportet vjetore të punës janë shqyrtuar dhe miratuar pa vonesa në Kuvend nga Komisioni Parlamentar për Legjislacion dhe Komisioni Parlamentar për Buxhet. Megjithatë, në vitin 2021 miratimi i raportit vjetor të KQZ-së për vitin 2020 u vonua, sepse dy komisionet rekomanduan mosmiratimin e raportit vjetor dhe votimi në Kuvend kishte dështuar.⁷¹ Deputetët e partisë në pushtet, të cilët udhëho-

qën komisionet përkatëse parlamentare, pohuan se raporti i KQZ-së për vitin 2020 dështon të demonstrojë një përkushtim për adresimin e çështjeve sistematike të zgjedhjeve në Kosovë. Ata argumentuan se raporti nuk identifikon në mënyrë adekuate fushat që kanë nevojë për përmirësim, duke përfshirë pasaktësitë në listën e votuesve, adresimin e mangësive, shpërndarjen e gabuar të votuesve nëpër qendra votimi, sfidat në votimin jashtë vendit, rinumërimet e shumta, pasaktësitë në plotësimin e formularëve të votimit dhe fletëvotimet e shumta të pavlefshme. Në të kundërtën, partitë opozitare e interpretuan mosmiratimin e raportit si përpjekje për të justifikuar shkarkimin e ish-kryetares së KQZ-së, Valdete Daka.

KQZ-ja ka bërë progres në vlerësimin nga ZKA-ja, duke ulur numrin e rekomandimeve të auditorëve nga rreth 20 në 2016 në vetëm dy në raportin e vitit 2022.⁷²

Të gjitha palët e përfshira në zgjedhje përdorin gjerësisht të drejtën e ankesës. Sipas raportit të vitit 2021 të Misioneve të BE-së për Vëzhgimin e Zgjedhjeve, PZAP ka një performancë shumë pozitive në trajtimin e ankesave në periudha optimale kohore dhe me nivel të lartë profesionalizmi,⁷³ edhe pse nuk ka staf të mjaftueshëm.⁷⁴ Në vitin 2021, PZAP-ja ka trajtuar 1,920 raste. Shumica e tyre ishin ankesa nga subjektet politike. Vendimet e PZAP-së janë ankimuar në Gjykatën Supreme në 70 raste, prej të cilave vetëm gjashtë janë miratuar. Gjithashtu, PZAP-ja ka dërguar 48 lëndë tek Prokurori i Shtetit për shkak të dyshimit për vepra penale.⁷⁵

PZAP-ja ka shqiptuar gjoba të majme edhe për subjektet politike, me mbi 250 mijë euro gjoba vetëm për thyerjen e heshtjes zgjedhore.⁷⁶ Deri më sot, vendosja e sanksioneve dhe përmbushja e obligimeve ndaj tyre ka ndodhur në vazhdimësi, pasi që mos pagesa e gjobave të PZAP-së ka pasojë potenciale mohimin e certifikimit për subjektet politike apo kandidatët e tyre për të marrë pjesë në zgjedhje, edhe pse një gjë e tillë nuk ka ndodhur deri më tani.

KQZ-ja organizon takime të rregullta me partitë politike për të diskutuar çështjet brenda fushëveprimit të tyre, veçanërisht para proceseve zgjedhore.⁷⁷



INDIKATORI 7.2.5
INTEGRITETI (SIPAS LIGJIT)

75/100



Ekzistojnë dispozita relativisht gjithëpërfshirëse për të garantuar integritetin e stafit të Sekretariatit.⁷⁸ Megjithatë, nuk ka Kod të Sjelljes për anëtarët e KQZ-së.

Anëtarët e KQZ-së duhet të betohen se do t'i kryejnë detyrat e tyre në mënyrë të ndershme, besnike, të paanshme, profesionale dhe të përgjegjshme.⁷⁹ Megjithatë, nuk ka Kod specifik sjelljeje për anëtarët.

Rregullorja e Punës së KQZ-së specifikon se anëtarët nuk lejohen të jenë pjesë e vendimmarrjes në lidhje me çështjet në të cilat ata ose anëtarët e familjes së tyre kanë interesa që mund të vënë në pikëpyetje aftësinë e anëtarit për të vepruar në mënyrë të paanshme.⁸⁰ Sa i përket parandalimit të konfliktit të interesit, kodi i personelit të Sekretariatit i ndalon punonjësit të lejojnë që interesat e tyre private të bien ndesh me pozicionin e tyre. Për më tepër, punonjësit nuk lejohen të marrin përsipër përgjegjësi të tjera private ose publike që mund të bien ndesh me pozicionin dhe angazhimin e tyre.⁸¹ Anëtarët e KQZ-së dhe stafi i Sekretariatit nuk lejohen të kërkojnë ose pranojnë dhuratat ose favore, për veten ose anëtarët e familjes së tyre, me përjashtim të dhuratave protokollare dhe të rastit,⁸² të cilat lidhen me detyrat e tyre zyrtare dhe mund të ndikojnë në performancën e tyre.⁸³ Ligji i mëparshëm për Shërbimin Civil dhe Ligji aktual për Zyrtarët Publikë rregullojnë integritetin e punonjësve të Sekretariatit, duke promovuar neutralitetin partiak.⁸⁴ Nuk ka dispozita të qarta që ndalojnë stafin e Sekretariatit të jetë pjesë e partive politike apo të marrë pjesë në tubimet e tyre, edhe pse kjo ishte e paraparë me legjislacionin e mëparshëm. Asnjë nga kodet nuk përfshin obligimin për ofrimin e një shërbimi cilësor ndaj votuesve, apo një obligim të qartë për ruajtjen e integritetit të proceseve zgjedhore.

Anëtarët mund të shkarkohen nëse, ndër të tjera, cenojnë integritetin e KQZ-së. Legjislacioni i mëparshëm nuk kishte përcaktim se çfarë lloj sjelljeje dhe veprimesh përfshin kjo,⁸⁵ ndërsa ligji i ri zgjedhor përshkruan kriteret e shkarkimit të anëtarëve të KQZ-së, duke përfshirë mbajtjen e posteve të tjera publike, rolet vendimmarrëse në subjektet politike, pengimin e funksionimit të KQZ-së dhe zbulimin e informacionit konfidencial. Në anën tjetër, nëse punonjësit e Sekretariatit shkelin dispozitat e kodeve, parashihen masa disiplinore dhe ata mund të shkarkohen vetëm nëse kjo shkelje përbën veprë penale.⁸⁶

Si zyrtarë të lartë publikë, Kryetari dhe anëtarët e KQZ-së i nënshtrohen deklaratimit të pasurisë.⁸⁷





INDIKATORI 7.2.6 INTEGRITETI (NË PRAKTIKË)

25/100



Në praktikë, qasja për të garantuar integritetin e anëtarëve apo stafit të KQZ-së është e pjesshme. Mungesa e masave disiplinore, shkarkimet e politizuara nga puna dhe nevoja që Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit të ndërhyjë për të vënë në dukje konfliktet e interesit, të gjitha tregojnë drejt mekanizmave të pamjaftueshëm të integritetit.

I gjithë stafi i Sekretariatit duhet të nënshkruajë⁸⁸ Kodin e Sjelljes për Nëpunësit Civilë,⁸⁹ dhe Kodin e Sjelljes për Stafin e Sekretariatit.⁹⁰

Megjithatë, pavarësisht se stafi i Sekretariatit ka nënshkruar Kodin e Sjelljes për stafin e Sekretariatit⁹¹ dhe ankesat dhe komisionet disiplinore brenda Sekretariatit, Kodi i Sjelljes nuk duket të jetë efektiv, sepse nuk ka pasur raste të shqiptimit të masave disiplinore ndaj personelit.⁹² Edhe në rastin kur anëtarëve të një komisioni rekrutimi për pozitën e Zyr-tarit të Lartë të Listës së Votuesve u ishte shqiptuar masë disiplinore, për shkak të shkeljeve procedurale nga anëtarët e komisionit,⁹³ i njëjti vendim është shfuqizuar një muaj më vonë, pa dhënë shpjegim për vendimin.⁹⁴

I vetmi rast kur mekanizmi i integritetit dukej efektiv ishte në nëntor 2020, kur presidentja Vjosa Osmani i ndërpreu mandatin anëtarit të KQZ-së Nenad Rikalo për shkak se ai ishte emëruar në një post të lartë publik (si zëvendës shef i të ashtuquajturës Zyra për Kosovën) në Qeverinë e Serbisë.⁹⁵ Në rastin tjetër të shkarkimit të ish-kryetares së KQZ-së, Val-dete Daka, për shkelje të pretenduar të integritetit, shoqëria civile⁹⁶ e ka kritikuar arsyetimin e Presidentit si të motivuar politikisht (shih 7.1.3). Një tjetër dështim i mekanizmit të integritetit të KQZ-së është rasti i vitit 2022, kur kryetari i KQZ-së, Kreshnik Radoniqi, ka dashur të futet në garë për kryetar

të Gjykatës së Apelit. Vetëm pasi Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit vuri në dukje konfliktin e interesit, Kryetari u tërhoq nga gara.⁹⁷

Sipas vëzhgimeve të KDI-së, asnjë anëtar i KQZ-së nuk është parë të marrë pjesë në tubime publike, megjithëse ata vazhdimisht kanë shprehur dhe mbrojtur interesat e partisë në mbledhjet e KQZ-së. Pavarësisht politizimit të skajshëm të diskutimeve⁹⁸ (shih 7.1.3), që mund të perceptohet si shkelje e betimit dhe integritetit të KQZ-së, asnjë procedurë nuk është nisur nga Presidenti i Kosovës.⁹⁹

I gjithë informacioni për pasurinë dhe të ardhurat e anëtarëve të KQZ-së është i disponueshëm për publikun në faqen e internetit të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.¹⁰⁰ Deri më tani, për shkak se anëtarët kanë bërë deklaratimet e tyre me kohë, ndaj anëtarëve nuk ka filluar asnjë procedurë për mosdeklarim të pasurisë.



Roli

INDIKATORI 7.3.1 RREGULLIMI I FUSHATËS

50/100



Ndërsa KQZ-ja synon të rregullojë financimin politik, sukcesi i saj është i kufizuar për shkak të zbrazëtirave në lidhje me financimin dhe vetëfinancimin e kandidatëve, si dhe dështimet e mëparshme për të publikuar në kohë raportet vjetore financiare dhe të fushatës së subjekteve politike. Për më tepër, gjohet për shkeljet e rregulloreve të financimit politik janë relativisht të ulëta dhe nuk kanë efekt të mjaftueshëm parandalues.

Me ndryshimet në Ligjin për Financimin e Subjekteve Politike dhe Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në vitin 2022, KQZ-ja, ose më konkretisht Zyra, tani ka kompetenca të gjera përtej regjistrimit, duke përfshirë rregullimin e financimit të partive politike, kryerjen e kontrollit financiar dhe publikimin e raporteve financiare vjetore dhe të fushatës.¹⁰¹ Ndryshimet sigurojnë gjithashtu rritjen e pavarësisë funksionale dhe burime shtesë për Zyrën.¹⁰²

Ndryshimet e fundit ligjore i kanë rikthyer KQZ-së përgjegjësinë për mbikëqyrjen e financave të subjekteve politike, konkretisht Zyrës. Kjo përfshin përzgjedhjen e auditorëve për raportet vjetore financiare dhe fushatat zgjedhore përmes një konkursi të hapur publik.¹⁰³ Drejtori i Zyrës do të ketë gjithashtu kompetenca të zgjeruara për kontrollin ex-post të raporteve të auditimit.¹⁰⁴ Sipas ligjit, i gjithë procesi i auditimit për raportet financiare vjetore duhet të përfundojë brenda datës 15 qershor të vitit vijues,¹⁰⁵ duke siguruar kohë të mjaftueshme për auditimin, duke përfshirë çdo procedurë për sfidimin, plotësimin ose korrigjimin e gjetjeve të auditorit.

Nga ana tjetër, sipas legjislacionit të mëparshëm, deri në datën 30 qershor të vitit vijues, KQZ-ja duhej të publikonte të centralizuar në faqet e internetit të KQZ-së raportin vjetor financiar dhe të auditimit si dhe raportin financiar të fushatës zgjedhore të subjekteve politike.¹⁰⁶ Megjithatë, për shkak të vonësve në auditim, kjo nuk ka ndodhur kurrë në kohë (shih 7.2.2).¹⁰⁷ Përveç kësaj, numri minimal i gjobave¹⁰⁸ ndaj subjekteve politike tregon kontroll të pamjaftueshëm, i cili mund të lidhet me mungesën e ekspertizës financiare të stafit të Zyrës (shih 7.1.1).¹⁰⁹

Subjektet politike të regjistruara duhet të dorëzojnë raportet e tyre financiare vjetore në KQZ jo më vonë se data 1 mars i vitit vijues.¹¹⁰ Këto raporte duhet të përfshijnë bilancin e gjendjes që pasqyron pasuritë, detyrimet dhe kapitalin, pasqyrën e fitimit dhe humbjeve që detajon të ardhurat dhe shpenzimet, dhe një pasqyrë të pagesave që tejkalojnë 5,000 € të bëra për çdo individ. Raportet gjithashtu përfshijnë faturat për të gjitha shpenzimet, gjendjet bankare dhe një regjistër të kontributeve që tejkalojnë 100€ nga një burim i vetëm. Zyra dhe subjektet politike duhet t'i publikojnë këto raporte vjetore financiare deri më 30 korrik të vitit vijues.¹¹¹ Gjithashtu, çdo subjekt politik pjesëmarrës në zgjedhje është i detyruar ligjërisht të paraqesë një deklaratë financiare për fushatën zgjedhore brenda 30 ditëve nga certifikimi i rezultateve zgjedhore.¹¹² Ky raport duhet të bëhet publik brenda 6 muajve pas ditës së zgjedhjeve.¹¹³

Ndryshimet e reja ligjore paraqesin një regres serioz sa u përket gjobave të mundshme financiare në rast të shkeljeve. Ligji specifikon një gamë të gjerë gjobash, duke filluar nga vetëm 4,000 € në vetëm 40,000 €. ¹¹⁴ Gjoha janë parashikuar edhe për zyrtarët përgjegjës të partisë, kandidatët për kryetar komune dhe kandidatët e pavarur.¹¹⁵ Veçanërisht, ligji nuk parasheh gjoha apo sanksione të tjera për kandidatët e subjekteve politike, si kandidatët për deputetë apo asamble komunale, në rast të shkeljes së dispozitave ligjore.

Megjithatë, është ende e vështirë për KQZ-në të përbushë rolin e saj të kontrollit financiar për shkak të zbrazëtirave të mbetura në Ligjin për Financimin e Subjekteve Politike. Sipas këtij ligji, vetëm subjektet politike mund të marrin donacione dhe të kryejnë të gjitha shpenzimet përmes një llogarie të vetme bankare.¹¹⁶ Ligji nuk përmban dispozita të tilla për kandidatët e subjekteve politike, gjë që lejon financimin e pa raportuar dhe vetëfinancimin e kandidatëve,¹¹⁷ që është një fenomen i përhapur¹¹⁸ (shih 11.2.1 dhe 11.2.2).





Nuk ka gjithashtu asnjë rregullore për fushatën "Online" dhe fushatën e palëve të treta.¹¹⁹ Vetëm në zgjedhjet e fundit lokale të vitit 2021, EUEOM zbuloi se palët e treta sponsorizuan afërsisht një të tretën e reklamave të fushatës që qarkullonin në Facebook dhe Instagram përpara raundit të dytë të zgjedhjeve.¹²⁰

KQZ-ja nuk ka asnjë përgjegjësi për në raport me alokimin e kohës në medie, pasi kjo rregullohet dhe kontrollon nga Komisioni i Pavarur i Medieve.¹²¹

**INDIKATORI 7.3.2
ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE**

50/100



KQZ-ja është deri diku aktive në sigurimin e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme, sidomos në zonat e banuara me shumicë serbe. Suksesi i KQZ-së është paksa i kufizuar për shkak të problemeve të vazhdueshme me listat e pasakta të votuesve, votimin jashtë vendit, fletëvotimet e pavlefshme, vonesat në certifikimin e rezultateve, problemet me votat e kandidatëve dhe rinumërimet e një numri të konsiderueshëm qendrash votimi.¹²²

Që nga viti 2015, KQZ-ja ka administruar rreth dhjetë procese zgjedhore (tri palë zgjedhje parlamentare dhe të paktën gjashtë palë zgjedhje lokale/komunale). Që nga viti 2019, organizon zgjedhje në komunat veriore të vendit pa ndihmën e misionit të OSBE-së.¹²³

Subjektet politike, organizatat joqeveritare, qeveritare dhe ndërqeveritare, si dhe organizatat ndërkombëtare, kanë të drejtë të akreditojnë vëzhgues për të gjitha operacionet zgjedhore. Nuk parashihet vëzhgimi nga individët. DnV është koalicioni kryesor i organizatave të shoqërisë civile për vëzhgimin e zgjedhjeve. Në zgjedhjet e vitit 2021, për herë të parë në historinë e Kosovës, DnV-ja aplikoi metodologjinë e Tabela Paralel të Votave (PVT) për vëzhgimin e zgjedhjeve.¹²⁴

Misionet vëzhguese vendore dhe ndërkombëtare kanë vëre-

jtur ende lista të pasakta të votuesve në zgjedhjet e fundit të vitit 2021. Arsyet për këtë janë përfshirja e të vdekurve në listë, listat e pasakta të adresave dhe fakti se lista e votuesve ka më shumë votues se sa ka banorë Kosova sipas statistikeve.¹²⁵ Saktësia e listës zgjedhore mund të kundërshtohet dhe kontestohet nga qytetarët,¹²⁶ por afatet e shkurtra dhe procedurat burokratike i demotivojnë qytetarët nga ushtrimi i kësaj të drejte.¹²⁷ Lista e votuesve për çdo vendvotim nuk mund të përmbajë më shumë se 750 votues.¹²⁸ Numri mesatar i votuesve për vendvotim është 761, me rreth 1.9 milionë votues të shpërndarë në rreth 2,500 qendra votimi.¹²⁹ Pavarësisht shpërndarjes proporcionale të votuesve në qendrat e votimit, ata ende përballen me vështirësi në gjetjen e emrave të tyre në qendrat e votimit, ku në dy të tretat e vendvotimeve raportohen raste të votuesve që kanë probleme me gjetjen e emrave të tyre në listën e votuesve.¹³⁰ KQZ-ja publikon në mënyrë aktive në faqen e saj të internetit vendndodhjet e të gjitha Qendrave të Votimit 40 ditë përpara ditës së zgjedhjeve dhe rezultatet paraprake disa orë pas përfundimit të procesit të votimit (shih 7.2.2). Megjithatë, për shkak të parregullsive me votat e kandidatëve, problemeve teknike dhe vendimeve të institucioneve të drejtësisë, KQZ-së iu desh të rinumëronte nga 30 për qind deri në 90 për qind të vendvotimeve (88.2 për qind në zgjedhjet parlamentare të vitit 2019).¹³¹

Një ndryshim i dukshëm në procesin zgjedhor të Kosovës do të jenë Qendrat Komunale të Numërimit, ku do të numërohen vetëm votat për kandidatët e subjekteve politike. Ky centralizim synon të adresojë parregullsitë dhe sfidat e hasura në numërimin e votave për kandidatët e subjekteve.

Votimi jashtë vendit shquhet si një nga proceset zgjedhore më të ndjeshme dhe më të cenushme në Kosovë, i shënuar me parregullsi dhe manipulime pothuajse në çdo cikël zgjedhor. Në vitin 2017, manipulimet¹³² çuan në anulimin dhe përsëritjen e zgjedhjeve për kryetar komune në Komunën e Istogut.¹³³ Ngjashëm, në vitin 2021, keqpërdorimet¹³⁴ rezultuan me anulimin dhe përsëritjen e zgjedhjeve në Komunën e Dragashit.¹³⁵ Edhe në vitin 2021, administrimi i votimit jashtë vendit u përball me sfida të shumta në administrimin e procesit.¹³⁶ Në këtë drejtim, një nga ndryshimet kryesore në ligjin e ri zgjedhor ka të bëjë me votimin jashtë vendit, duke prezantuar tri forma të votimit jashtë vendit: votimi fizik në misionet diplomatike, votimi në kuti postare jashtë Kosovës dhe votimi në kuti postare brenda Kosovës. Ligji përshkruan gjithashtu afatet procedurale dhe metodat e aplikimit për votuesit jashtë vendit, me regjistrimin e votuesve të lehtësuar përmes një platforme elektronike dhe kutisë postare të KQZ-së për verifikim. Ligji i ri zgjedhor sjell një ndryshim thelbësor, duke rritur numrin e votave preferenciale për votuesit nga pesë në dhjetë. Megjithatë, ky rregullim duket se më shumë i zhvendosë konfliktet mes votuesve në vend që të



nxisë përfaqësim më të mirë në Kuvend. Statistikisht, votuesit zakonisht zgjedhin rreth katër kandidatë, edhe pse ata kanë mundësinë të zgjedhin deri në pesë. Në zgjedhjet e vitit 2007, në të cilat votimi preferencial ishte deri në dhjetë kandidatë, kishte një përzgjedhje mesatare prej vetëm 5.3 kandidatësh. Përtej preferencave të votuesve, rritja në dhjetë vota preferenciale paraqet sfida praktike për administrimin e procesit zgjedhor. Kjo jo vetëm zgjat kohën e numërimit, por gjithashtu rrit mundësinë e manipulimit nga komisionerët, veçanërisht kur votuesit shënojnë më pak se maksimumi prej dhjetë kandidatësh, duke ofruar mundësi për ndikim në rezultate.

Ndër ndryshimet e fundit ligjore, aspekti më shqetësues është integriteti i kandidatëve. Dispozita e propozuar ua mohon të drejtën për të kandiduar vetëm atyre që janë dënuar me burgim efektiv prej një viti ose më shumë. Ky interpretim i ngushtë lejon që kandidatët pa dënime të tilla të përfshihen në listat zgjedhore në zgjedhjet e ardhshme.¹³⁷ Numri relativisht i lartë i fletëvotimeve të pavlefshme, që varion nga 3 në 5 për qind në zgjedhjet parlamentare dhe deri në 10 për qind në zgjedhjet lokale, është një tregues i qartë se informimi i publikut për procesin zgjedhor,¹³⁸ i mbikëqyruar nga Këshilli Mbikëqyrës i Informimit Publik pranë KQZ-së,¹³⁹ nuk ka qenë efektiv.

**INDIKATORI 7.3.3
GJINIA**

50/100



Ekzistojnë dispozita ligjore në fuqi për të siguruar që gratë të kenë të drejtën e votës dhe të kandidojnë për zgjedhje, dhe mandatojnë KQZ-në të monitorojë dhe mbrojë pjesëmarrjen politike të grave lidhur me votimin. Megjithatë, shpesh votat e grave kontrollohen nga të afërmit meshkuj përmes keqpërdorimit të votimit të asistuar. Gjithashtu, kuotat në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme nuk janë në përputhje me Ligjin për Barazinë Gjinore dhe vetëm një nga 11 anëtarët e KQZ-së është grua, për shkak të zbrazëtive në ligji.

Në praktikë, gratë mund të ushtrojnë të drejtën e tyre aktive dhe pasive për të votuar lirisht. KQZ-ja monitoron pjesëmarr-

jen e grave në zgjedhje duke përgatitur raporte për pjesëmarrjen e votuesve që përfshijnë pjesëmarrjen e votuesve në bazë të gjinisë.¹⁴⁰ Megjithatë, raportet e vëzhgimit të zgjedhjeve dëshmojnë përdorimin e lartë të "votimit të asistuar" në 98 për qind të vendvotimeve, me deri në 50 raste të votimit të asistuar për vendvotim.¹⁴¹ Dhe, meqenëse sipas raporteve të KQZ-së, ky fenomen është i përhapur veçanërisht në zonat rurale tek gratë votuese, të cilat përbëjnë rreth 70 për qind të votuesve të asistuar,¹⁴² kjo tregon një tendencë keqpërdorimi të kësaj forme votimi nga të afërmit meshkuj, si formë e cenimit të fshehtësisë së votimit për gratë.

Sipas Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, zbatohen kuota të dyfishta gjinore: kuota legislative prej 30 për qind në listat e dorëzuara nga subjektet politike dhe 30 për qind vende të rezervuara në Kuvendin e Kosovës. Kuotat legislative janë të detyrueshme dhe mospërmblidhja e këtij detyrimi gjatë aplikimit për pjesëmarrje në zgjedhje mund të rezultojë në refuzimin e aplikimit për certifikim.¹⁴³ Megjithatë, këto ligje nuk janë në përputhje me Ligjin për Barazinë Gjinore që parasheh përfaqësim të barabartë të grave në 50 për qind.¹⁴⁴

Nuk ka legjislacion që detyron që një përqindje e caktuar e anëtarëve të trupave menaxhuese zgjedhore të jenë gra. Edhe pse partitë politike nënshkruan një deklaratë ku zotoheshin për të zgjedhur të paktën 40 për qind të grave si anëtare të trupave menaxhuese zgjedhore,¹⁴⁵ vetëm një nga 11 anëtarët aktualë të KQZ-së është grua.

KQZ-ja nuk ofron trajnime për pjesëmarrjen e barabartë gjinore politike. Edhe në qendrat e votimit, përfshirja e grave është e ulët, me afro 30 për qind si anëtare dhe më pak se 20 për qind si kryesuese.¹⁴⁶





Ndërveprimet

KQZ-ja i përgjigjet Kuvendit të Kosovës dhe Zyrës Kombëtare të Auditimit. PZAP-ja dhe Gjykata Supreme sigurojnë llogaridhënien e KQZ-së ndaj votuesve dhe subjekteve politike (shih 7.2.4). KQZ-ja ndërvepron me qeverinë vetëm në lidhje me buxhetin e saj vjetor dhe buxhetet për zgjedhjet e jashtëzakonshme (shih 7.1.1).

KQZ-ja ndërvepron drejtpërdrejt me partitë politike në lidhje me administrimin e proceseve zgjedhore, me partitë politike që emërojnë komisionet e vendotimeve dhe komisionet komunale zgjedhore. Gjithashtu, KQZ-ja ndërvepron me partitë politike në lidhje me raportimin financiar.

KQZ-ja ka nënshkruar shumë memorandume bashkëpunimi me institucione, si Ministria e Arsimit, kompania e furnizimit me energji elektrike, shoqata të ndryshme të grupeve të marginalizuara dhe organizata ndërkombëtare. Memorandumi më i rëndësishëm i KQZ-së është ai i nënshkruar në vitin 2016 me Policinë e Kosovës, Prokurorin e Shtetit, PZAP-në dhe KGJK-në për parandalimin e shkeljeve zgjedhore dhe trajtimin e rasteve që bien ndesh me ligjin zgjedhor.¹⁴⁷ Për shkak të këtij memorandumi, i cili nisi një nivel më të lartë bashkëpunimi mes këtyre institucioneve, ka pasur një përmirësim të dukshëm në administrimin e procesit zgjedhor.

Gjatë gjithë procesit zgjedhor, e veçanërisht gjatë verifikimit të kandidatëve, KQZ-ja pranon bazat e të dhënave të personave të dënuar, nga Këshilli Gjyqësor dhe Prokurorial i Kosovës, Forca e Sigurisë së Kosovës, Policia e Kosovës, Dogana e Kosovës, Agjencia Kosovare e Inteligjencës etj. Ato po ashtu informojnë KQZ-në nëse në radhët e tyre bëjnë pjesë kandidatët që kanë aplikuar për certifikim.¹⁴⁸

Në rastet e nisjes së procedurave hetimore për çështjet penale ndaj personelit zgjedhor nga Prokuroria, KQZ-ja duhet të bashkëpunojë për ndarjen e informacionit përkatës. Megjithatë, ka mangësi në drejtim të njoftimit të KQZ-së për vendimet e lëndëve penale nga Prokuroria. Si rrjedhojë, KQZ-ja nuk ndjek lëndë të tilla.¹⁴⁹

Rekomandimet e shtyllës

Edhe pse Kuvendi i Kosovës ka miratuar ligjin e ri për zgjedhjet e përgjithshme në vitin 2023, shumë çështje dhe tema nuk janë trajtuar. Prandaj, duhet të bëhet një reformë gjithëpërfshirëse zgjedhore:

- Kuvendi duhet të përfundojë procesin e nevojshëm të reformës zgjedhore, duke përfshirë:
 - Shqyrtimi i aspekteve thelbësore dhe politike të sistemit zgjedhor, duke mbuluar çështje si zonat zgjedhore, pragun zgjedhor, mënyrën e zgjedhjes së Presidentit, listat e partive, kuotat gjinore 50-50 për qind dhe përbërjen e KQZ-së.
 - Rritja e standardeve për pranueshmërinë ligjore të kandidatëve: Për të garantuar integritet në kandidim, individëve të dënuar me vendim të formës së prerë për vepra të rënda penale të përcaktuara në nenin 22 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës duhet t'u refuzohet kandidimi, pavarësisht nga lloji dhe ashpërsia e dënimit. Kufizimi i kandidimit për shkak të veprës penale nga duhet të rritet nga tre në katër vjet, duke e përafuar me kohëzgjatjen e mandatit.
 - Të kufizohet votimi preferencial në vetëm tre kandidatë: Kufizimi i votimit preferencial në tre kandidatë, duke marrë parasysh numërimin e votës për subjektin politik si votë për mbajtësin e listës, mund të rrisë drejtësinë në konkurrencën ndërmjet kandidatëve.
 - Prezantimi i modelit "zebër" të përfaqësimit të barabartë (50-50) të grave në listat e kandidatëve të subjekteve politike.
 - Ndryshimi i përbërjes së anëtarëve të KQZ-së duke rritur numrin e gjyqtarëve të emëruar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës në mënyrë që të krijohet një balancë me përfaqësuesit e subjekteve politike.
- Ndryshimi i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme për t'u përafuar me Ligjin për Barazinë Gjinore për të mandatuar që listat e komisionerëve të propozuara nga partitë në nivel shtetëror dhe komunal të përbëhen nga minimumi prej 50 për qind të grave dhe që të paktën 30 për qind të kryetarëve nga qendrat e votimit janë gra.
- Zhvillimi dhe kryerja e programeve për ngritjen e kapaciteteve me mbështetjen e OSBE-së dhe organizatave të tjera ndërkombëtare ose vendase për të forcuar kapacitetet e Sekretariatit dhe stafit të Zyrës së KQZ-së, veçanërisht në lidhje me shkrimin ligjor, aftësitë financiare dhe prezantimin publik.
- Zgjerimi i dispozitave të transparencës dhe llogaridhënies së KQZ-së në nivelet vendore të organeve drejtuese të zgjedhjeve.
- Të rishikohen ligjet për financimin zgjedhor dhe politik për t'u kërkuar kandidatëve të subjekteve politike të raportojnë financimet dhe shpenzimet e tyre. Gjithashtu, duhet të parashihen gjoba për kandidatët e subjekteve politike në rastet e shkeljeve.
- Raportet financiare të audituara të subjekteve politike të prezantohen në formate më lehtësisht të qasshme dhe kuptueshme (user-friendly dhe open-data).
- Qeveria të ndajë një kod të veçantë buxhetor për Zyrën e sapokrijuar për Financimin e Partive Politike dhe të ndajë buxhetin e nevojshëm për funksionimin dhe operimin e pavarur të Zyrës.



REFERENCAT

- 1 Ligji nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, neni 3, paragrafi 1.12. E qasshme në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=77074>
- 2 Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, neni 65.
- 3 Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, neni 12.
- 4 Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, neni 59, paragrafi 2; dhe neni 113, paragrafët 1, 2 dhe 3.
- 5 2022 – 5.9 Milion EUR; Buxheti i Sekretariatit: 1.7 milion - E qasshme në: Ligji për Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022. Fq. 76- 77. E qasshme në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=51763>
Për më shumë shikoni buxhetet e shtetit 2017-2021: 2021 – 14.0 milionë euro; Buxheti i Sekretariatit: 1.7 milion euro – e qasshme në: https://kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Documents/Ligjinr07L-041_JcrHewkrVb.pdf
2020 – 6.2 milionë euro; Buxheti i Sekretariatit: 1.5 milion euro – e qasshme në: https://kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Documents/Ligjin-r07L-001_tWxRxfzGn.pdf
2019 – 6.0 milionë euro; Buxheti i Sekretariatit: 1.6 milion euro – e qasshme në: https://kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Documents/Ligji06L-133_TUvScadcyv.pdf
2018- 5.6 milionë euro; Buxheti i Sekretariatit: 1.3 milion euro – e qasshme në: https://kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Documents/Ligjinr.06L-020perBuxhetineRepublikeKosovespervitin2018_6KsBu2BSbU.pdf
2017 – 16.6 milionë euro; Buxheti i Sekretariatit: 1.5 milion euro – e qasshme në: https://kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Documents/Ligjiperndrysheligitperbuxhetin2017_vrmrAavkXe.pdf [qasur më 18 mars 2022]
- 6 Raporti i KQZ-së për Shpenzimet për Zgjedhjet Lokale (2021), faqe 28. E qasshme në: https://kqz-ks.org/wp-content/uploads/2022/03/Vendimet-10-2022_al.pdf
- 7 Intervistë me Kreshnik Radoniqin, Kryetar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, mars 2022.
- 8 Mandati i posteve të larta drejtuese në KQZ është i kufizuar, me mundësi vazhdimi.
- 9 Për më shumë shikoni buxhetet e shtetit 2017-2023.
- 10 Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, neni 12, paragrafi 1.5.
- 11 Intervistë me Nexhmedin Hysenin, ish-Drejtor i Zyrës për Regjistrimin dhe Certifikimin e Partive Politike (ZPRCPP) në KQZ, mars 2022.
- 12 Intervistë me një burim anonim brenda KQZ-së, mars 2022.
- 13 Ligji nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, neni 61.7. E qasshme në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2544>
- 14 Intervistë me Burim Ahmetaj, Kryeshefi Ekzekutiv i Sekretariatit të KQZ-së, prill 2022.
- 15 Intervistë me Burim Ahmetaj, Kryeshefi Ekzekutiv i Sekretariatit të KQZ-së, prill 2022.
- 16 Intervistë me Mulë Desku, Udhëheqës i Sekretariatit të PZAP-së, mars 2022.
- 17 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 139.
- 18 Ligji nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, neni 61, paragrafi 5.c. E qasshme në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2544>
- 19 Ligji nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, neni 61, paragrafi 7.4. dhe paragrafi 8.
- 20 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 139. Shënim: Përbërja politike e KQZ-së përgjithësisht reflektohet në organe të tjera vartëse, si Komisionet Komunale të Zgjedhjeve dhe Këshillat e Vendotimeve.
- 21 Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, neni 61, paragrafët 2 dhe 3.
- 22 Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, neni 65, paragrafi 2.
- 23 Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, neni 66.
- 24 Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, neni 12, paragrafi 2.
- 25 Ligjit për shërbimin civil të Republikës së Kosovës, neni 3. Ky ligj nuk është më në fuqi, pas miratimit të ligjit të ri për zyrtarët publikë.
- 26 Ligji Nr. 08/L-197 për Zyrtarët publikë, neni 7, paragrafi 1.
- 27 Rregullorja Nr. 03/2017 për Procedurat e Rekrutimit, Emërimit dhe Punës Provuese të Punonjësve në KQZ. Neni 3. E qasshme në: https://kqz-ks.org/wp-content/uploads/2018/01/Rregullore-03_2017.pdf
- 28 Vendim për ndryshimin e Udhëzimit Administrativ nr. 01/2022 për emërimin dhe shkarkimin e KE/ZV/SKQZ-së, Drejtorit Ekzekutiv të ZPRCPP-së dhe Zëdhënësit. Neni 1.
- 29 Koha.Net, "Emërimi i Kryeshefit Ekzekutiv të SKQZ-së anulohet" (dhjetor, 2020). Gjetet në: <https://www.koha.net/arberi/249386/anulohet-zgjedhja-e-kryeshefit-te-kqz-se/> [qasur më 2 tetor 2023]
- 30 Koha.Net, "Gjykata me vendim "ekspres" shtyn anulimin e emërimit të Kryeshefit Ekzekutiv të SKQZ-së." (dhjetor, 2020). Gjetet në: <https://www.koha.net/arberi/250134/gjykata-e-shtyn-ekzekutimin-e-vendimit-per-kryeshefin-e-kqz-se/> [qasur më 2 tetor 2023]
- 31 Rregullorja Nr. 03/2017 për Procedurat e Rekrutimit, Emërimit dhe Punës Provuese të Punonjësve në KQZ. Neni 7. E qasshme në: https://kqz-ks.org/wp-content/uploads/2018/01/Rregullore-03_2017.pdf
- 32 Ligji parasheh vetëm shkarkimin e personelit si masë të fundit, e cila zbatohet në rast shkeljesh të rënda apo veprave të tjera penale. Shih: Ligji për shërbimin civil të Republikës së Kosovës, neni 67 dhe 87. Shkarkimi i drejtuesve të lartë në Sekretariat bëhet me shumicë të thjeshtë të votave të anëtarëve të KQZ-së për shkak të kryerjes së veprës penale, performancës së dobët ose vendimit të komisioneve disiplinore. Shih: Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2012 për Emërimin dhe shkarkimin e KE/ZV/SKQZ-së, Drejtorit Ekzekutiv të ZPRCPP-së dhe Zëdhënësit, neni 8.
- 33 Ligji nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, neni 61.5. E qasshme në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2544>



|||||

[?ActID=2544](#)

- 34 "Demokracia në Veprim", Raporti i Vëzhgimit të Zgjedhjeve – Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës 2021, (Prishtinë: DnV, 2021), faqe 16.
- 35 Gjatë zgjedhjeve parlamentare të vitit 2021, subjektet politike u përpoqën të ndikojnë në punën e KQZ-së nëpërmjet anëtarëve të tyre, duke tentuar të certifikojnë kandidatët të ndryshëm që realisht nuk plotësonin kriteret ligjore për kandidim. Për shkak të presioneve pas vendimit për të mos certifikuar kandidatët që kishin probleme me ligjin, pranë KQZ-së ka pasur polici të shtuar. Shih: Agjencia e lajmeve KosovaPress, tetor 2020, <https://kosovapress.com/forca-te-shtuara-te-policise-ne-kqz/> [qasur më 25 mars 2022]
- 36 Agjencia e lajmeve EkonomiaOnline, tetor 2020, <https://ekonomiaonline.com/politike/nderpritel-mbledhja-e-kqz-se-zihen-elshani-dhe-kurteshi/> [qasur më 23 mars 2022]
- 37 Intervistë me një burim anonim, maj 2022.
- 38 Kryeshefi Ekzekutiv, Zëvendës Shefi, Drejtori i ZPRCPP-së dhe Zëdhënësi i KQZ-së.
- 39 Intervistë me një burim anonim brenda Sekretariatit të KQZ-së, mars 2022.
- 40 Intervistë me një burim anonim, maj 2022.
- 41 Portali Koha, qershor 2021, <https://www.koha.net/arberi/275645/shoqeria-civile-kundershton-shkarkimin-dakes/> [qasur më 23 mars 2022]
- 42 Portali Kallxo, qershor 2021, <https://kallxo.com/lajm/shkarkimi-i-dakes-opozita-e-konsideron-tendence-per-qeverisje-autoritare/> [qasur më 23 mars 2022] Shkarkimi i Valdete Dakës, Kryetares së KQZ-së, u konsiderua gjerësisht si veprim politik, që buronte nga besimi se arsyet e përmendura për shkarkimin e saj ishin të pabaza dhe buronin nga keqinterpretimi i situatës nga Presidenti. Kësaj ngjarjeje i ka paraprirë një incident i paprecedentë gjatë procesit të zgjedhjeve parlamentare të vitit 2021 në Kosovë. Ushtruese e detyrës së Presidentes, Vjosa Osmani Sadriu, e cila ishte edhe kandidatja në zgjedhje, mbajti një konferencë për media ku kërcënoi haptazi me veprime ndaj anëtarëve të KQZ-së dhe kryesuesit lidhur me çështjet e certifikimit të kandidatëve. Këtu përfshihej edhe moscertifikimi i disa kandidatëve, veçanërisht Albin Kurti, lideri i Vetëvendosjes, derisa në atë kohë kandidatonte në të njëjtën listë.
- 43 Rregullorja e punës e Komisionit Qendror Zgjedhor, neni 17, paragrafi 3.
- 44 Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, neni 106, paragrafi 4.
- 45 Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, neni 83, paragrafi 1.
- 46 Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, neni 56, paragrafi 1.
- 47 Ligji Nr. 08/L-122 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për Financimin e Partive Politike, Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-058 dhe Ligjin Nr. 04/L-122 dhe Ligjin Nr. 03/L-073 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 03/L-256, neni 19, paragrafi 16. E qasshme në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=62600>
- 48 EUEOM, Kosova* Raporti Përfundimtar 2021 – Zgjedhjet komunale, (Prishtinë: EUEOM, 2022), faqe 9.
- 49 Për më shumë, shihni seksionin e legjislacionit në faqen e internetit të KQZ-së: <https://kqz-ks.org/an/> [qasur më 23 nëntor 2023]
- 50 Për më shumë, shihni seksionin e kontaktit në faqen e internetit të KQZ-së: <https://kqz-ks.org/an/kontakti/> [qasur më 6 prill 2022]
- 51 Për shembull, shihni kalendarin e aktiviteteve kryesore elektorale në lidhje me zgjedhjet në katër komunat veriore që u mbajtën më 23 prill 2023. Qasur në: <https://kqz-ks.org/keto-jane-afatet-e-aktiviteteve-per-organizimin-e-zgjedhjeve-te-23-prillit-per-kryetar-te-kater-komunave-dhe-per-anetare-te-dy-kuvendeve-komunale/>
- 52 "Demokracia në Veprim", Raporti i Vëzhgimit të Zgjedhjeve – Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës 2021, (Prishtinë: DnV, 2021), faqe 8. Qasur në: <https://kdi-kosova.org/wp-content/uploads/2021/04/01-Raporti-Përfundimtar-i-Vëzhgimit-te-Zgjedhjeve-ENG-03.pdf>
- 53 Për më shumë, shihni seksionin e vendimeve në faqen e internetit të KQZ-së: <https://kqz-ks.org/an/cec-decisions-2023/> [qasur më 23 nëntor 2023]
- 54 KQZ, Platforma Online për Ndërrimin e Qendrës së Vitimit Për më shumë, shihni: <https://eomp.kqz-ks.org/VChangeRequests/> [qasur më 5 prill 2022] Shënim: platforma është funksionale vetëm gjatë zgjedhjeve
- 55 Për më shumë shikoni lidhjet e mëposhtme: <https://kqz-ks.org/an/zgjedhjet-e-pergjithshme/>; <https://kqz-ks.org/an/zgjedhjet-per-kuvende-komunale/> [qasur më 5 prill 2022]
- 56 Kjo ishte kryesisht për shkak të vendimeve gjyqësore për rinuemërim, parregullsive teknike dhe vonesave në mbërritjen e fletëve të votimit jashtë vendit. Shih: "Demokracia në Veprim", Raporti i Vëzhgimit të Zgjedhjeve – Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës 2019, (Prishtinë: DnV, 2019), faqet 4, 23, dhe 40. E qasshme në: <http://demokracianeveprim.org/wp-content/uploads/2019/12/DnV-ELECTION-OBSERVATION-REPORT-EN.pdf>
- 57 Për më shumë, shihni platformën: <https://kqzkosova.ushahidi.io/> [qasur më 6 prill 2022]
- 58 Për më shumë, shihni faqen e internetit të KQZ-së në kategorinë e raporteve vjetore: <https://kqz-ks.org/raporte-per-kuvendin/> [qasur më 15 prill 2022]
- 59 Për më shumë, shihni faqen e internetit të ZKA-së dhe raportet përkatëse të auditimit të KQZ-së. E qasshme në: <https://zka-rks.org/?s=komisioni-qendror-i-zgjedhjeve&search-type=publications>
- 60 Raporti Vjetor i KQZ-së lidhur me kërkesat për qasje në dokumente publike.
- 61 "Demokracia në Veprim", Raporti i Vëzhgimit të Zgjedhjeve – Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës 2017, (Prishtinë: DnV, 2017), faqe 13. E qasshme në: <https://kqz-ks.org/wp-content/uploads/2018/04/132-dnv-raporti-perfundimtar-zgjedhjet-parlamentare-2017-alb.pdf>
- 62 Për më shumë, shihni faqen e KQZ-së, njoftimin për planin e konferencave të KQZ-së për ditën e zgjedhjeve të përgjithshme 2021: <https://kqz-ks.org/an/15986/> [qasur më 8 prill 2022]
- 63 Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, neni 63, paragrafi 10.
- 64 Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, neni 113, paragrafi 7. Gjithashtu, sipas nenit 23 të Ligjit për Zyrën Kombëtare të Auditimit, ZKA publikon raportet përfundimtare të auditimit të institucioneve, një ditë pas dorëzimit të tyre tek institucionet. Për më shumë shihni ligjin: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12517> Ndërsa, sipas akteve nënligjore, faqet e internetit të institucioneve duhet të përfshijnë raporte vjetore, përfshirë ato financiare. Për më shumë shikoni udhëzimin administrativ në faqet e internetit të institucioneve publike. E qasshme në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11007>
- 65 Ligji për qasje në dokumente publike, neni 6.
- 66 Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, neni 115, paragrafi 1.
- 67 Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, neni 119.
- 68 Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, neni 89, paragrafi 3; neni 106, paragrafi 3; dhe neni 119, paragrafi 1.
- 69 Intervistë me Mulë Desku, Udhëheqës i Sekretariatit të PZAP-së, mars 2022.

|||||

|||||

- 70 Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, neni 118, paragrafi 4.
- 71 Portali Kallxo.com, dhjetor 2021, <https://kallxo.com/lajm/mungesa-e-kuorumit-deshton-votimi-i-raportit-vjetor-te-kqz-se-per-vitin-2020/> [qasur më 14 prill 2022]
- 72 Zyra Kombëtare e Auditimit, Raporti i Auditimit, Auditimi i ZKA-së për Pasqyrat Vjetore Financiare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2022, (Prishtinë, ZKA, 2023), faqe 6.
- 73 EUEOM, Kosova* Raporti Përfundimtar 2021 – Zgjedhjet komunale, (Prishtinë: EUEOM, 2022), faqe 36. "Demokracia në Veprim", Raporti i Vëzhgimit të Zgjedhjeve – Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës 2021, (Prishtinë: DnV, 2021), faqe 9.
- 74 Intervistë me Mulë Desku, Udhëheqës i Sekretariatit të PZAP-së, mars 2022.
- 75 Raporti Vjetor i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa (2021).
- 76 Raporti Vjetor i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa (2021), faqet 80 dhe 81.
- 77 Për më shumë shikoni njoftimin nga takimi i fundit mes KQZ-së dhe partive politike: <https://kqz-ks.org/kqz-mban-tryeze-me-perfaqesuesit-e-subjekte-teve-politike/> [qasur më 15 prill 2022]
- 78 Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, qasja në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=77074/>; Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, i qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=16314/>; Ligji për Shërbimin Civil, i qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2679/>; Ligji për Zyrtarët Publikë, i qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=81430/>; dhe Kodi i Sjelljes për nëpunësit civilë; Kodi i Sjelljes për stafin e Sekretariatit të KQZ-së, https://kqz-ks.org/wp-content/uploads/2018/01/Rregullore-05_2017.pdf
- 79 Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, neni 62, paragrafi 1.
- 80 Rregullorja e punës e Komisionit Qendror Zgjedhor, neni 14.
- 81 Rregullorja Nr. 05/2017 – Kodi i Sjelljes për Stafin e Sekretariatit të Komisionit Qendror Zgjedhor. E qasshme në: https://kqz-ks.org/wp-content/uploads/2018/01/Rregullore-05_2017.pdf
- 82 Sipas ligjit, dhuratat protokolare përfshijnë dhuratat e dhëna nga një përfaqësues i një vendi ose organizate tjetër ndërkombëtare, gjatë një vizite ose rasti tjetër. Dhuratat të rastit janë ato që merren në çdo rast të veçantë që nuk lidhet me ushtrimin e funksionit zyrtar. Për më shumë, shih nenin 3 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurive dhe Dhuratave.
- 83 Ligji Nr. 08/L-108 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave, neni 22. E qasshme në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=61304>
- 84 Ligji Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Neni 6.1. I qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2679> Ligji Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, neni 8, paragrafi 1; dhe neni 25, paragrafi 1. I qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=81430>
- 85 Ligji nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, neni 61.5. E qasshme në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2544>
- 86 Ligji për zyrtarët publikë, nenet 72, 73 dhe 74.
- 87 Ligji Nr. 08/L-108 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurive dhe Dhuratave, neni 4, paragrafët 1.8 dhe 1.30, në lidhje me nenin 6.
- 88 Intervistë me Burim Ahmetaj, Kryeshefi Ekzekutiv i Sekretariatit të KQZ-së, mars 2022. Sipas ligjit për shërbimin civil në fuqi deri në shtator 2023, ishte e detyrueshme që të gjithë shërbyesit civilë të nënshkruajnë një kod sjelljeje. Me ligjin e ri, parashihet që zyrtarët publikë (që si nocion përfshin edhe stafin e KQZ-së) duhet të veprojnë në përputhje me kodin e mirësjelljes dhe se qeveria duhet të miratojë një kod të tillë që është i detyrueshëm për të gjithë zyrtarët publikë.
- 89 Rregullore (QRK) - Nr.04/2015 Për Kodin e Sjelljes së Shërbyesve Civilë të Republikës së Kosovës, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10764>
- 90 Rregullorja nr.05/2017 e KQZ-së për Kodin e Sjelljes së Personelit të Sekretariatit të Komisionit Qendror Zgjedhor, nenet 4, 9 dhe 11. E qasshme në: https://kqz-ks.org/wp-content/uploads/2018/01/Rregullore-05_2017.pdf
- 91 Intervistë me Burim Ahmetaj, Kryeshefi Ekzekutiv i Sekretariatit të KQZ-së, mars 2022.
- 92 Intervistë me Burim Ahmetaj, Kryeshefi Ekzekutiv i Sekretariatit të KQZ-së, mars 2022.
- 93 Vendim Nr. 252/2022 i Kryeshefit Ekzekutiv të Sekretariatit.
- 94 Vendim për shfuqizimin e vendimit nr. 252/A/20222.
- 95 Portali Kallxo.com, nëntor 2021, <https://kallxo.com/lajm/pas-punesimit-ne-qeverine-e-serbise-osmani-e-shkarkon-rikallon-nga-kqz-dokument/> [qasur më 19 prill 2022]
- 96 Portali Reporter, qershor 2021, <https://reporteri.net/lajme/ky-eshte-vendimi-i-plote-i-presidentes-per-shkarkimin-e-valdete-dakes/> [qasur më 19 prill 2022]
- 97 "Betimi për Drejtësi", prill 2022, <https://betimiperdrejtes.com/nje-kandidat-terhiqet-nga-gara-per-kryetar-te-apelit-per-pese-te-tjere-kqjk-perfundon-intervistat/> [qasur më 18 prill 2022]
- 98 "Demokracia në Veprim", Raporti i Vëzhgimit të Zgjedhjeve – Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës 2021, (Prishtinë: DnV, 2021), faqe 16.
- 99 Intervistë me një burim anonim, mars 2022.
- 100 Për më shumë, shihni seksionin e deklarimit të pasurisë në faqen e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit: https://akk-ks.org/deklarimi_i_pasur-is/1664/2019/1664 [qasur më 18 prill 2022]
- 101 Ligji Nr. 04/L-212 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-174 për Financimin e Partive Politike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-058, neni 11.6. I qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2705>
- 102 Ligji Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme, neni 12, paragrafi 1.3. I qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=77074>
- 103 Ligji Nr. 04/L-212 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-174 për Financimin e Partive Politike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-058, neni 11 (19), paragrafi 10. I qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2705>
- 104 Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, neni 12, paragrafi 1.9.
- 105 Ligji Nr. 04/L-212 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-174 për Financimin e Partive Politike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-058, neni 11 (19). I qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2705>
- 106 Ligji Nr. 04/L-212 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-174 për Financimin e Partive Politike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-058, neni 6,1 dhe neni 8.5. I qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=8866>
- 107 Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për financimin e subjekteve politike (2013), neni 11 (19), paragrafët 9 dhe 10.

|||||



- 108 Sipas të dhënave të ofruara nga Zyra, gjatë vitit 2021, kur janë organizuar dy palë zgjedhje, Zyra ka shqiptuar vetëm tetë gjoba, të gjitha në shumën prej 1,000€, për shkelje lidhur me paraqitjen e vonuar të pasqyrave vjetore financiare. Asnjë nga gjobat nuk iu shqiptua subjekteve politike parlamentare. Në anën tjetër, sipas një raporti të KDI-së për shpenzimet e fushatës për zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2019, subjektet politike kishin shpenzuar gati dy herë më shumë sesa që raportuan më vonë në raportet vjetore. Për më tepër, sipas këtij raporti, shpenzimet e një partie politike (LDK) kanë tejkaluar kufirin e shpenzimeve të përcaktuar nga KQZ-ja, duke vlerësuar vetëm koston e aktiviteteve publike.
- 109 Intervistë me Albert Krasniqin, Demokracia Plus, mars 2022.
- 110 Ligji Nr. 03/L-174 për Financat e Partive Politike, neni 15. I qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2705>
- 111 Ligji Nr. 04/L-212 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-174 për Financimin e Partive Politike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-058, neni 8 (15). I qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2705>
- 112 Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, neni 41.
- 113 Ligji Nr. 04/L-212 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-174 për Financimin e Partive Politike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-058, neni 8 (15), paragrafi 5.2. I qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2705>
- 114 Ligji Nr. 04/L-212 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-174 për Financimin e Partive Politike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-058, neni 21 paragrafi 6. I qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2705>
- 115 Ligji Nr. 04/L-212 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-174 për Financimin e Partive Politike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-058, neni 21, paragrafët 8, 9, 10, dhe 11. I qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2705>
- 116 Ligji Nr. 04/L-212 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-174 për Financimin e Partive Politike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-058, neni 4.3.
- 117 EUEOM, Kosova* Raporti Përfundimtar 2021 – Zgjedhjet komunale, (Prishtinë: EUEOM, 2022), faqe 20.
- 118 EUEOM, Kosova* Raporti Përfundimtar 2021 – Zgjedhjet komunale, (Prishtinë: EUEOM, 2022), faqe 20.
- 119 "Demokracia në Veprim", Raporti i Vëzhgimit të Zgjedhjeve – Fushata e Zgjedhjeve Lokale 2021 (Prishtinë: DnV, 2021), fq. 14.
- 120 EUEOM, Kosova* Raporti Përfundimtar 2021 – Zgjedhjet komunale, (Prishtinë: EUEOM, 2022), faqe 21.
- 121 Ligji për zgjedhjet e përgjithshme, neni 47.
- 122 "Demokracia në Veprim", Raporti i Vëzhgimit të Zgjedhjeve – Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës 2021, (Prishtinë: DnV, 2021), faqe 7.
- 123 "Demokracia në Veprim", Raporti i Vëzhgimit të Zgjedhjeve - Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetarët e Komunave të Mitrovicës Veriore, Zubin Potokut, Leposaviqit dhe Zveçanit (Prishtinë: DnV, 2019), faqe 11.
- 124 "Demokracia në Veprim", Raporti i Vëzhgimit të Zgjedhjeve – Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës 2021, (Prishtinë: DnV, 2021), faqe 10.
- 125 Portali KOHA, maj 2017, <https://www.koha.net/arberi/18989/me-shume-votues-se-banore-ne-kosove/> [qasur më 26 prill 2022]
- 126 Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, neni 9.
- 127 "Demokracia në Veprim", Raporti i Vëzhgimit të Zgjedhjeve – Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës 2021, (Prishtinë: DnV, 2021), faqe 23.
- 128 Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, neni 82, paragrafi 1.
- 129 EUEOM, Kosova* Raporti Përfundimtar 2021 – Zgjedhjet komunale, (Prishtinë: EUEOM, 2022), faqe 8.
- 130 "Demokracia në Veprim", Raporti i Vëzhgimit të Zgjedhjeve – Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës 2021, (Prishtinë: DnV, 2021), faqe 36.
- 131 "Demokracia në Veprim", Raporti i Vëzhgimit të Zgjedhjeve – Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës 2019, (Prishtinë: DnV, 2019), faqe 4.
- 132 Klan Kosova, "Arsyet që çuan në rivotimin në Istog" (nëntor, 2017). Gjetet në: <https://www.youtube.com/watch?v=CyzpoWeUFxk> [qasur më 23 nëntor 2023]
- 133 Ekonomia Online, "Komuna e Istogut do të ketë rivotim" (dhjetor, 2017). Gjetet në: https://ekonomiaonline.com/istogu-shkon-ne-rivotim/?page_similar_news=64 [qasur më 23 nëntor 2023]
- 134 Telegrafi, "Gjykata Supreme vendos të përsërisë votimin jashtë vendit për Komunën e Dragashit" (nëntor, 2021). Gjetet në: <https://telegrafi.com/supremja-vendos-qe-te-perseritet-votimi-nga-jashte-per-komunen-e-dragashit/> [qasur më 23 nëntor 2023]
- 135 Insajderi, "Votat me postë anulohen në Dragash" (nëntor, 2021). Gjetet në: <https://insajderi.org/anulohen-votat-me-poste-ne-dragash/> [qasur më 23 nëntor 2023]
- 136 "Demokracia në Veprim", Raporti i Vëzhgimit të Zgjedhjeve – Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës 2021, (Prishtinë: DnV, 2021), faqet 8, 24 dhe 26.
- 137 Në këtë kontekst, shqetësimi qëndron në kulturën e përhapur të mosdëshkimit në Kosovë, veçanërisht në lidhje me rastet e korrupsionit që përfshijnë zyrtarë publikë. Në vitin 2021, nga 108 raste korrupsioni, vetëm 22 rezultuan me dënime efektive me burgim. Gjoba janë shqiptuar në 31 raste dhe dënime me kusht në gjashtë. Në vitin 2022, nga 45 persona të dënuar për korrupsion, vetëm 15 morën dënime efektive me burgim, me mbi 60 për qind të gjobave ose me kusht. Gjithashtu, vetëm 19 persona morën dënime plotësuese, duke e përkeqësuar situatën. Për më shumë, shih: BIRN&Internews Kosova, "Raporti i Monitorimit, 'Imuniteti ndaj Korrupsionit'" (Prishtinë: Qershor 2022). Fq. 26 dhe 27; Instituti i Kosovës për Drejtësi, "Dështimi i drejtësisë në luftën kundër korrupsionit" (Prishtinë: Prill, 2023). Fq. 18 dhe 19.
- 138 Fushatat e informimit dhe edukimit të votuesve ofrojnë informacion se si të votojnë përmes video spotëve, GIF-ve, posterave, fletushkave dhe tabelave, por mbeten të pamjaftueshme për të adresuar numrin e madh të fletëvotimeve të pavlefshme ose pengesat që hasin qytetarët në gjetjen e qendrave të duhura të votimit. Materialet e fushatës informative perceptohen si jokreative dhe përdorin modele të ngjashme. Për më shumë, shihni faqen e internetit të KQZ-së për komponentin e edukimit të votuesve: <https://kqz-ks.org/an/informimi-publik/> [qasur më 28 prill 2022]
- 139 Sekretariati i KQZ-së, Strategjia e Informimit Publik për Zgjedhjet Lokale 2021 (Prishtinë: KQZ, 2021), faqe 19. E qasshme në: <https://kqz-ks.org/wp-content/uploads/2021/06/English-Strategjia-e-IP-se-per-Zgjedhjet-Lokale-2021-ueb.pdf>; Këshilli Mbikëqyrës i Informimit Publik brenda KQZ-së zakonisht përbëhet nga pesë anëtarë, duke përfshirë anëtarë të KQZ-së dhe anëtarë të tjerë nga Sekretariati.
- 140 Raporti i KQZ-së për trendet zgjedhore në Republikën e Kosovës 2009 – 2019, faqe 21. E qasshme në: https://kqz-ks.org/wp-content/uploads/2021/02/Trendet-Zgjedhore-09-19_EN.pdf
- 141 "Demokracia në Veprim", Raporti i Vëzhgimit të Zgjedhjeve – Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës 2021, (Prishtinë: DnV, 2021), faqe 36.
- 142 Analiza e KQZ-së për votimin me asistencë për zgjedhjet e parakohshme parlamentare 2019. E qasshme në: https://kqz-ks.org/wp-content/uploads/2020/09/Analizë-e-votave-me-asistencë-Zgjedhjet-e-parakohshme-për-Kuvendin-e-Republikës-së-Kosovës-2019_ALB.pdf
- 143 Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, neni 28, në lidhje me nenin 27.
- 144 Ligji Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore, neni 6.2.1 dhe 6.2.2. E qasshme në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10923>



- 145 Për më shumë shikoni njoftimin nga organizata joqeveritare D4D, si iniciatore e nënshkrimit të kësaj deklarate: <https://d4d-ks.org/aktivitetet/nenshkrimi-i-deklarates-per-rritjen-e-perfshirjes-se-grave-ne-proceset-zgjedhore/> [qasur më 29 prill 2022]
- 146 Raporti i KQZ-së për trendet zgjedhore në Republikën e Kosovës 2009 – 2019, faqe 21. E qasshme në: https://kqz-ks.org/wp-content/uploads/2021/02/Trendet-Zgjedhore-09-19_EN.pdf
- 147 Memorandum bashkëpunimi ndërmjet KQZ-së, PK-së, PS-së, PZAP-së dhe KGJK-së, i nënshkruar në vitin 2016. E qasshme në: <https://kqz-ks.org/wp-content/uploads/2018/02/6-Memorandum-me-PK-PSH-PZAP-KGJK.pdf> [qasur më 3 maj 2022]
- 148 Ligji për zgjedhjet e përgjithshme, neni 30, pika 11.
- 149 Intervistë me Burim Ahmetaj, Kryeshefi Ekzekutiv i Sekretariatit të KQZ-së, prill 2022.




AVOKATI I POPULLIT




PËRMBLEDHJE


Institucioni i Avokatit të Popullit të Kosovës (IAP) është institucion i pavarur¹ përgjegjës për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të individëve nga veprimet apo mosveprimet e jashtëligjshme të autoriteteve publike.²




Kapacitetet



Qeverisja



Roli





Në strukturën organizative të Institucionit të Avokatit të Popullit është i përfshirë edhe Avokati i Popullit, pesë zëvendësit e Avokatit të Popullit – prej të cilëve së paku njëri duhet të jetë nga radhët e komuniteteve joshumicë në Kosovë³ – si dhe personeli civil i institucionit.⁴ Personeli i IAPK-së përfshin zyrën e Avokatit të Popullit, Sekretarin e Përgjithshëm, drejtorët e departamenteve dhe shefat e zyrave.

Autoriteti dhe kompetencat e Avokatit të Popullit shtrihen në tërë territorin e Kosovës.⁵ Selia e Avokatit të Popullit është në Prishtinë, ndërsa shërbimet e tij ofrohen edhe përmes zyrave rajonale, të cilat gjenden në Ferizaj, Graçanicë, Gjakovë, Gjiilan, Mitrovicë Jugore, Mitrovicë Veriore, Pejë dhe Prizren.⁶

Institucioni i Avokatit të Popullit konsiderohet se ka burime të mjaftueshme financiare dhe njerëzore. Megjithatë, ka nevojë për staf më të specializuar për të trajtuar në mënyrë efektive çështjet specifike të drejtave të njeriut.

Avokati i Popullit është aktiv në trajtimin e ankesave, por sfida mbetet moszbatimi i rekomandimeve të tij nga institucionet përgjegjëse. Edhe pse nuk ka politika dhe protokolle specifike të miratuara për mekanizmin e ankesave të Avokatit të Popullit, ky institucion merr parasysh ndjeshmërinë gjinore dhe ka procedura të veçanta për trajtimin e rasteve të diskriminimit gjinor. Përpjekjet për të ngritur vetëdijen për standardet etike dhe çështjet e të drejtave të njeriut janë të kufizuara, reaguese dhe konsiderohen të paefektshme.

Avokati i Popullit është mjaft transparent dhe i përgjegjshëm, dhe raportet vjetore e financiare ia dorëzon Kuvendit me kohë. Në përgjithësi, Institucioni i Avokatit të Popullit shihet si një nga institucionet më të besuara në Kosovë. Megjithatë, trajtimi i raporteve të Avokatit të Popullit nga Kuvendi shpesh vonohet. Ekzistojnë dispozita gjithëpërfshirëse për të garantuar integritetin e institucionit të Avokatit të Popullit, duke përfshirë kodet e etikës dhe deklarin e pasurisë, por zbatimi i kodeve të sjelljes dhe rregulloreve për integritetin konsiderohet reaktiv dhe ka mungesë të hetimeve proaktive dhe procedurave disiplinore për shkelje të mundshme.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka garantuar pavarësinë nga institucionet e tjera me Kushtetutë dhe ligj. Megjithatë, procesi i zgjedhjes së Avokatit të Popullit çoi në vonesa në emërimin e Avokatit të Popullit duke e përdorur atë si levë politike.



Kapacitetet



INDIKATORI 8.1.1 BURIMET (NË PRAKTIKË)

100/100



Institucioni i Avokatit të Popullit ka burime të mjaftueshme financiare, njerëzore dhe infrastrukturore për të përmbushur detyrat dhe synimet e veta.

Sipas Ligjit për Avokatin e Popullit, buxheti i këtij institucioni nuk mund të jetë më i vogël se ai i vitit paraprak.⁷ Zakonisht, kërkesat buxhetore të IAP-së miratohen pothuajse tërësisht nga Kuvendi, përkatësisht nga qeveria.⁸ Për vitin 2023, IAP-së i është ndarë buxheti në vlerë prej 1,296,704€.⁹

Në vitin 2022, IAP-ja përbëhej nga gjithsej 78 persona të punësuar.¹⁰ Numri i stafit të angazhuar ka mbetur i pandryshuar gjatë viteve të fundit. Sipas një ish Avokati të Popullit, numri i stafit konsiderohet i mjaftueshëm në krahasim me numrin e rasteve dhe ankesave të trajtuara nga IAP-ja.¹¹ Për pagat e këtyre personave ndahet një buxhet i mjaftueshëm prej rreth 1 milion € në vit,¹² që përfaqëson rreth 80 për qind të buxhetit vjetor për kategorinë e pagave.¹³

Tabela 8.1: Ndarja e buxhetit për Avokatin e Popullit për periudhën 2014 deri 2023

Viti	Shuma në €
2023	1,296,704
2022	1,282,766
2021	1,269,280
2020	1,373,815
2019	1,373,754
2018	1,373,167





Tabela 8.2: Numri i të punësuarve në zyrën e Avokatit të Popullit

Viti	Numri i pozitave të stafit sipas sistematizimit	Numri i pozitave të stafit të plotësuar	% e pozicioneve të pplotësuar
2022		78	
2021		78	
2020		78	
2019		81	
2018		78	

Stafi i IAP-së vlerësohet nga organizatat joqeveritare si kompetent në kryerjen e detyrave të tyre.¹⁴ Ata kanë fituar përvojë të shtuar nga trajtimi i përditshëm i rasteve.¹⁵ Megjithatë, IAP-së i mungon stafi i mjaftueshëm i specializuar specialist i aftë për t'u marrë me çështje të natyrave specifike të drejtave të njeriut, si shëndeti riprodhues, çështjet e sigurisë dhe të ngjashme.¹⁶

Avokati i Popullit është i obliguar të miratojë politika për ngritjen e kapaciteteve dhe trajnimin e stafit në IAP për detyrat që kanë të bëjnë me fushëveprimtarinë dhe përgjegjësitë e këtij institucioni.¹⁷ Për këtë qëllim parashihet miratimi dhe zbatimi i një programi trajnimi për arritjen e objektivave të punës së Avokatit të Popullit.¹⁸ Krahas trajnimeve të përgjithshme të organizuara nga IAP-ja për stafin në fushën e të drejtave të njeriut, stafi¹⁹ ka marrë pjesë edhe në sesione të veçanta trajnimi të zhvilluara nga Këshilli i Evropës dhe gjyqtarët e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.²⁰

INDIKATORI 8.1.2 PAVARËSIA (SIPAS LIGJIT)

75/100



Korniza normative që siguron pavarësinë e Institucionit të Avokatit të Popullit është përgjithësisht gjithëpërfshirëse. Megjithatë, ekziston një boshllëk ligjor, pasi nuk ka periudhë kufizuese (cooling-period) për aktivitetin e mëparshëm politik të Avokatit të Popullit.

Kushtetuta i garanton Avokatit të Popullit pavarësinë nga çdo institucion apo pushtet tjetër.²¹ Sipas ligjit, Avokati i Popullit udhëhiqet nga parimet e paanshmërisë dhe pavarësisë,²² dhe ka pavarësi organizative, administrative dhe financiare.²³ Zyrtat dhe materialet²⁴ e IAP-së gëzojnë imunitet nga çdo kontroll nga veprimet ekzekutive, administrative, gjyqësore ose legjislativë.²⁵

Avokati i Popullit nuk mund të jetë anëtar i asnjë partie politike, të ushtrisë veprimtari politike, shtetërore ose private



profesionale ose të marrë pjesë në menaxhimin e organizatave civile, ekonomike ose tregtare.²⁶ Megjithatë, këto kufizime zbatohen vetëm pas momentit të aplikimit për pozitën e Avokatit të Popullit, dhe jo paraprakisht.

Avokati i Popullit zgjidhet nga Kuvendi i Kosovës, me shumicën e votave të të gjithë deputetëve. Mandati është pesëvjeçar, pa të drejtë rizgjedhjeje.²⁷ Komisioni Parlamentar për të Drejtat e Njeriut është përgjegjës për zhvillimin e procedurave të rekrutimit.²⁸ Rregullat parashohin deri në tri runde votimi për zgjedhjen e Avokatit të Popullit, në maksimum dy seanca të ndryshme.²⁹

Pagat në IAP financohen nga buxheti i shtetit.³⁰ Në rangimin e koeficientëve të pagave, Avokati i Popullit ka koeficient të barabartë me drejtuesit e institucioneve të tjera të pavarura, përfshirë kryetarin e KQZ-së, Komisionin e Pavarur të Medieve dhe Auditorin e Përgjithshëm dhe një koeficient të përafërt me deputetë, ministra, gjyqtarë dhe prokurorë.³¹

Rekrutimi i personelit kryhet sipas Ligjit për Shërbimin Civil, por pa ndërhyrë në pavarësinë e IAP-së.³² Procedura e rekrutimit zhvillohet sipas planit të rekrutimit në IAP, bazuar në kritere të qarta profesionale.³³ Përgjegjësitë e Avokatit të Popullit në lidhje me personelin janë të kufizuara në miratimin e politikave, pa të drejtën e vendimmarrjes efektive gjatë rekrutimit.³⁴

Avokati i Popullit dhe zëvendësit e tyre mbrohen nga shkarkimi i paarsyeshëm ose arbitrar.³⁵ Procedura e shkarkimit mund të fillohet me kërkesën e më shumë se një të tretës së të gjithë deputetëve të Kuvendit, ndërsa shkarkimi mund të ndodhë me votat e dy të tretave.³⁶ Për shkarkimin e stafit të IAP-së vlen Ligji për Shërbimin Civil, sipas të cilit shkarkimi është masa e fundit disiplinore, në rastet e performancës së dobët, shkeljes së kodeve të sjelljes, si dhe shkeljeve të ligjit që kanë rezultuar në vepra penale.³⁷

I gjithë personeli i Institucionit të Avokatit të Popullit gëzon imunitet nga ndjekja penale, paditë civile ose shkarkimi nga puna për fjalët e dhëna ose me shkrim, për aktivitete ose vendime që janë në kuadër të përgjegjësisë së institucionit.³⁸



INDIKATORI 8.1.3 PAVARËSIA (NË PRAKTIKË)

75/100



Në praktikë, Avokati i Popullit vepron në mënyrë të pavarur nga ndërhyrjet e akterëve të jashtëm. Megjithatë, pasi që Kuvendi i Kosovës është përgjegjës për emërimin e Avokatit të Popullit në mesin e tre kandidatëve, ekziston mundësia e përzgjedhjes së kandidatëve të preferuar nga partia në pushtet, si dhe mundësia e vonesave të paarsyeshme.

Në vitin 2020, zgjedhja e Avokatit të Popullit nga deputetët e Kuvendit dështoi në mungesë të kuorumit.³⁹ Gjithashtu, në vitin 2021, zgjedhja e Avokatit të Popullit dështoi në mungesë të votave të mjaftueshme. Deri më tani nuk ka pasur asnjë rast të ndërhyrjes politike në aktivitetet e Avokatit të Popullit. As nuk është raportuar ndonjë ndërhyrje politike apo ndërhyrje tjetër me interes në rekrutimin e personelit në IAP-së. Megjithatë, në vitin 2020, si rezultat i zbrazëtirave ligjore (shih 8.1.2), Avokati i Popullit u zgjodh Naim Qelaj, ndonëse ai kishte shërbyer si zëvendësministër nga radhët e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës në mandatin qeverisës 2017-2019.⁴⁰

Mirëpo, pas emërimit të tij në pozitën e Avokatit të Popullit, si dhe në raport me mandatet e mëparshme, nuk është vërejtur apo raportuar asnjë rast që përfshin pjesëmarrje në aktivitete apo pozita që mund të vënë në pikëpyetje paanshmërinë dhe integritetin e Avokatit të Popullit. Deri më tani nuk ka pasur asnjë rast të shkarkimit të Avokatit të Popullit para përfundimit të mandatit ligjor. IAP nuk njihet për shkarkime politike apo të parakohshme, madje as të stafit të nivelit drejtues.⁴¹

Nuk janë raportuar raste kur persona kanë akuzuar IAP-në për mosrespektim të të drejtave të tyre për privatësi. Përveç kësaj, nuk ka pasur pasoja (të paktën të evidentuara zyrtarisht) tek personat që kanë raportuar raste në IAP. Sipas Zëvendësës së Avokatit të Popullit, ankesat mund të parashtrihen pa frikë dhe mekanizmat për ruajtjen e konfidencialitetit të të gjitha informatave dhe sigurisë së ankuesve zbatohen në mënyrë efektive në praktikë.⁴²



Qeverisja

INDIKATORI 8.2.1 TRANSPARENCA (SIPAS LIGJIT)

100/100

Ekziston një kornizë ligjore gjithëpërfshirëse dhe e konsoliduar që i mundëson publikut të marrë informacion në lidhje me punën dhe vendimmarrjen e Avokatit të Popullit.

Avokati i Popullit është i obliguar të publikojë informacione në lidhje me aktivitetet zyrtare, duke përfshirë njoftimet, opinionet, rekomandimet, propozimet dhe raportet,⁴³ si dhe të dhënat statistikore të mbledhura për çështjet e diskriminimit dhe barazisë.⁴⁴ Sipas Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, Avokati i Popullit ka një afat ligjor për të publikuar në mënyrë proaktive të gjitha informacionet brenda 15 ditëve nga marrja e tyre.⁴⁵ Publikut duhet t'i jepet qasje në të dhënat që kanë të bëjnë me punën e IAP-së përmes njoftimeve për shtyp apo konferencave për shtyp, si dhe publikimit të kohës së takimeve të Avokatit të Popullit.⁴⁶

Qytetarët kanë të drejtën e qasjes në dokumentet e IAP-së në përputhje me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike.⁴⁷

IAP-ja duhet të mbrojë konfidencialitetin e të gjithë informacionit që merr dhe trajton, si dhe t'i kushtojë vëmendje të veçantë sigurisë së ankuesve, palëve të dëmtuara dhe dëshmitarëve.⁴⁸ Publiku nuk mund të ketë qasje në informatat për pranimin, shqyrtimin dhe hetimin e ankesave, projekt rekomandimet, projektvendimet dhe çdo njoftim të bërë nga zyrtarët e IAP-së gjatë procedurës përgatitore dhe shqyrtimit paraprak të kërkesave.⁴⁹ IAP-ja duhet të jetë veçanërisht e

kujdesshme kur publikon rastet individuale, veçanërisht ato që përfshijnë fëmijë. Këto detyrime zbatohen edhe pas përfundimit të mandatit të Avokatit të Popullit.⁵⁰

Avokati i Popullit, zëvendësit e tij, shefi i stafit/zyrës së Avokatit të Popullit, Sekretari i Përgjithshëm, drejtorët e departamenteve, si dhe drejtuesit e divizioneve janë të detyruar të deklarojnë pasurinë e tyre në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit,⁵¹ çdo vit nga 1 deri më 31 mars.⁵²

Avokati i Popullit lejohet të angazhojë palë të treta për shërbimet që lidhen me punën e IAP-së.⁵³ Avokati i Popullit bashkëpunon me partnerët socialë, si dhe me OSHC-të që merren me çështjet e barazisë dhe mosdiskriminimit.⁵⁴ Bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë civile bëhet nëpërmjet organizimit të përbashkët të dëgjimeve publike dhe organizimit të aktiviteteve tjera të përbashkëta.⁵⁵

INDIKATORI 8.2.2 TRANSPARENCA (NË PRAKTIKË)

100/100

Publiku mund të marrë lehtësisht të gjitha informatat lidhur me Institucionin e Avokatit të Popullit, duke përfshirë organizimin, funksionimin dhe vendimmarrjen e IAP-së lidhur me çështjet me interes publik.

Faqja e internetit e IAP-së është funksionale dhe lehtësisht e qasshme për publikun. Të gjitha të dhënat në lidhje me IAP-në janë në dispozicion, duke përfshirë raportet vjetore



që nga viti 2013,⁵⁶ raportet e rasteve,⁵⁷ raportet speciale,⁵⁸ raportet *ex-officio*,⁵⁹ opinionet,⁶⁰ rekomandimet,⁶¹ dhe një sërë dokumentesh të tjera.⁶² Raportet vjetore përmbajnë të dhëna përmbledhëse të detajuara për numrin, përqindjen ose përshkrimin e rasteve të hetuara në krahasim me rastet e përgjithshme të paraqitura.⁶³ Raporti përmban gjithashtu informacion të detajuar për trajtimin e rasteve specifike në interes publik.⁶⁴ Raportet dhe dokumentet e IAP-së publikohen gjithmonë sapo të miratohen.

Gjatë vitit 2021, IAP-ja kishte publikuar në ueb-faqen e saj 26 raporte, ndërsa ishin lëshuar rreth 100 njoftime për media.⁶⁵ Gjatë vitit 2021 në IAP janë dorëzuar 15 kërkesa për qasje në dokumente publike, të cilave iu është dhënë përgjigje.⁶⁶

Avokati i Popullit, si dhe zyrtarët tjerë drejtues, deklarojnë pasurinë e tyre në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit. Në vitin 2022, të 18 personat e paraparë me ligj, nga Institucioni i Avokatit të Popullit, kishin deklaruar pasurinë.⁶⁷

Shoqëria civile dhe ekspertë të tjerë janë të përfshirë vazhdimisht në punën e IAP-së, përmes tryezave, takimeve dhe fokus grupeve të përbashkëta.⁶⁸ Në fakt, në tetor 2021, IAP-ja themeloi Forumin e Dialogut me Shoqërinë Civile për të strukturuar bashkëpunimin dhe zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta.⁶⁹

INDIKATORI 8.2.3 LLOGARIDHËNIA (SIPAS LIGJIT)

100/100

Ekzistojnë dispozita gjithëpërfshirëse që sigurojnë që Avokati i Popullit duhet të raportojë dhe të jetë përgjegjës për veprimet e tyre.

Institucioni i Avokatit të Popullit duhet të dorëzojë një raport vjetor dhe financiar drejtpërdrejt në Kuvendin e Kosovës, deri më 31 mars.⁷⁰ Raporti vjetor mbulon punën dhe aktivitetet e IAP-së, si dhe çështjet dhe rekomandimet për përmirësime në lidhje me shkeljet e të drejtave të njeriut nga autoritetet publike.⁷¹ Përveç kësaj, Avokati i Popullit duhet të dorëzojë raporte periodike ose raporte të tjera siç kërkohet nga Kuvendi.⁷² Raportet e Avokatit të Popullit duhet të shqyrtohen në seancë plenare nga deputetët gjatë sesionit pranveror.⁷³ Avokati i Popullit ka përgjegjësi ligjore për publikimin e raporteve.⁷⁴

Avokati i Popullit mund të bëjë rekomandime dhe të propozojë veprime për autoritetet publike,⁷⁵ të cilat mund të përfshijnë ministrinë, gjykatat, etj. Ai gjithashtu mund t'i referojë Gjykatës Kushtetuese çështje specifike të të drejtave të njeriut.⁷⁶

Edhe pse vendimet e Avokatit të Popullit janë përfundimtare, ato dhe veprimtaria dhe puna e IAP-së nuk mund t'i nënshtrohen shqyrtimit gjyqësor, për shkak të imunitetit funksional të stafit të institucionit.⁷⁷

Ligji për Mbrojtjen e Sinjalizuesve⁷⁸ dhe Rregullorja për përcaktimin e procedurës për pranimin dhe trajtimin e rasteve të sinjalizimit parashikojnë dispozita konkrete ligjore që mbrojnë sinjalizuesit në sektorin publik, përfshirë IAP-në.⁷⁹ Avokati i Popullit është i detyruar të ketë një zyrtar përgjegjës për sinjalizimin.⁸⁰





**INDIKATORI 8.2.4
LLOGARIDHËNIA
(NË PRAKTIKË)**

75/100



Dispozitat në fuqi janë relativisht efektive në sigurimin e llogaridhënies së Avokatit të Popullit për veprimet e tij në praktikë. Megjithatë, vonesat e Kuvendit dhe trajtimi joadekuat i raporteve vjetore të institucioneve të pavarura (shih Kapitullin e Legjislativit për më shumë) e bëjnë nivelin e llogaridhënies së Avokatit të Popullit relativisht sipërfaqësor.

Në vitin 2020 dhe 2021, Avokati i Popullit i dorëzoi raportet vjetore Kuvendit të Kosovës brenda afatit ligjor.⁸¹ Raportet përmbajnë të dhëna të hollësishme për gjendjen e respektimit të të drejtave të njeriut, të drejtave të fëmijëve dhe barazisë para ligjit në vend, si dhe qëndrimin e Avokatit të Popullit për këtë situatë.⁸² Raportet gjithashtu paraqesin aktivitetet, statistikat dhe financimin e IAP-së.⁸³

Megjithatë, raportet në përgjithësi nuk trajtohen në kohë dhe në mënyrë thelbësore nga Kuvendi. Raporti vjetor i vitit 2021, megjithëse u dorëzua në mars 2021, u miratua vetëm në janar 2023.⁸⁴ Miratimi i raportit është bërë pa diskutim nga deputetët e Kuvendit. Nga ana tjetër, raporti vjetor i vitit 2020 u miratua vetëm në tetor 2021.⁸⁵ Gjatë rishikimit në seancë raporti në fjalë u prezantua dhe u diskutua për rreth 20 minuta nga vetëm katër deputetë.⁸⁶

IAP-ja ka një person të caktuar përgjegjës për pranimin e rasteve të sinjalizimit.⁸⁷ Megjithatë, deri më tani, nuk është raportuar asnjë rast i sinjalizimit,⁸⁸ gjë që e bën të pamundur vlerësimin e efektivitetit të vetë politikës së sinjalizimit.

**INDIKATORI 8.2.5
MEKANIZMAT E
INTEGRITETIT (SIPAS LIGJIT)**

75/100



Ekzistojnë dispozita gjithëpërfshirëse që sigurojnë integritetin e Institucionit të Avokatit të Popullit. Mekanizmat e integritetit bazohen në ligjet përkatëse për parandalimin e konfliktit të interesit,⁸⁹ deklarimin e dhuratave⁹⁰ dhe rregulloren e punës së IAP-së.⁹¹ IAP-ja, në përputhje me Rregulloren e Punës, ka një Kod të Etikës, i cili megjithatë është i vjetëruar, pasi është miratuar në vitin 2011.⁹²

Kodi i Etikës rregullon në mënyrë të përgjithshme dhe sipërfaqësore paanshmërinë dhe pavarësinë e stafit, integritetin, transparencën, konfliktin e interesit, korrupsionin, dhuratat dhe çështjet e përfaqësimit të institucionit. Në lidhje me integritetin, Kodi parasheh që stafi të mos ndikohet nga pikëpamje politike, sociale, fetare apo ekonomike dhe të mos kryejë veprime që dëmtojnë imazhin e IAP-së.⁹³

Stafi i IAP-së është i detyruar të ruajë konfidencialitetin e informacionit që posedon, por pa paragjykuar detyrimet që dalin nga ligjet e tjera për qasje në informacione publike.⁹⁴ Punonjësit janë gjithashtu të detyruar të deklarojnë dhe parandalojnë rastet e konfliktit të interesit apo konfliktit të mundshëm të interesit, duke zgjedhur konflikte në favor të institucionit dhe jo të interesave private.⁹⁵ Kërkimi dhe pranimi i dhuratave ose përfitimeve të tjera që mund të vënë në pikëpyetje pavarësinë dhe integritetin e institucionit është i ndaluar.⁹⁶

Rregulla të ngjashme parashihen edhe për rastet e korrupsionit, të cilat kërkohet të raportohen menjëherë.⁹⁷ Punonjësit e Avokatit të Popullit nuk duhet t'u bëjnë favore kolegëve, ankesve apo grupeve të tjera për favore financiare dhe politike apo përfitime seksuale apo ndonjë përfitim tjetër.⁹⁸



Deklarimi i pasurisë rregullohet vetëm me ligje të tjera përkatëse.⁹⁹

**INDIKATORI 8.2.6
MEKANIZMAT E
INTEGRITETIT (NË PRAKTIKË)**

50/100



Qasja e Institucionit të Avokatit të Popullit ndaj zbatimit të kodeve të sjelljes dhe rregulloreve të tjera për integritetin është relativisht gjithëpërfshirëse, por reaktive. Gjithashtu mungojnë trajnimet për çështjet e integritetit.¹⁰⁰

Kodet janë vlerësuar si efektive nga përfaqësues të OSHC-ve dhe ish-Avokati i Popullit i intervistuar për këtë raport. Megjithatë, ky përfundim bazohet kryesisht në faktin se nuk ka raste të shkeljeve të kodeve dhe rregulloreve të tjera ligjore të raportuara.¹⁰¹ Sipas një zëvendës Avokati të Popullit, mungon hetimi proaktiv dhe fillimi i procedurave disiplinore për shkelje të mundshme.¹⁰² Gjithashtu, sipas ish-Avokatit të Popullit, qasja e IAP-së për trajtimin e rasteve kur integriteti i institucionit është cenuar potencialisht nga anëtarët e stafit është i orientuar kryesisht drejt zgjidhjes së tyre në mirëbesim me punonjësin, përveç rasteve kur mund të ketë elemente të veprave penale.¹⁰³

Raportet e deklarimit të pasurisë së Avokatit të Popullit, zëvendësve dhe personelit tjetër që janë të detyruar të deklarojnë pasurinë publikohen dhe janë të qasshme në uebfaqen e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.¹⁰⁴

**INDIKATORI 8.2.7
GJINIA**

50/100



Megjithëse nuk ka politika dhe protokolle specifike të miratuara, Institucioni i Avokatit të Popullit vepron duke marrë parasysh ndjeshmërinë gjinore. Sipas Ligjit për Barazi Gjinore, Avokati i Popullit është institucion që merret me rastet që kanë të bëjnë me diskriminimin gjinor.¹⁰⁵

Avokati i Popullit shihet si një nga promovuesit më të mëdhenj të Ligjit për Barazi Gjinore.¹⁰⁶ Sipas Rregullores së Punës, IAP-ja zbaton procedura të veçanta për trajtimin e rasteve dhe ankesave lidhur me diskriminimin gjinor.¹⁰⁷ Për këtë qëllim është krijuar një departament i posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi,¹⁰⁸ dhe një nga zëvendësit e Avokatit të Popullit është përgjegjës vetëm për çështjet gjinore.¹⁰⁹ IAP-ja zhvillon dhe merr pjesë në trajnime që përfshijnë, mes temave të tjera, çështjet gjinore, të organizuara kryesisht nga donatorë ndërkombëtarë.¹¹⁰ Stafi përgjegjës për pranimin e ankesave janë kryesisht gra.¹¹¹

IAP-ja zberthen statistikat dhe të dhënat në lidhje me ankesat e dorëzuara tek Avokati i Popullit në bazë gjinore. Raportet vjetore përmbajnë të dhëna për gjininë e ankesve dhe gjininë e ankesve në ankesat e hetuara.¹¹²





Roli



INDIKATORI 8.3.1 HETIMI

75/100



Avokati i Popullit është përgjithësisht aktiv në shqyrtimin dhe trajtimin e ankesave të paraqitura nga qytetarët. Megjithatë, problem mbetet moszbatimi i rekomandimeve nga institucionet përgjegjëse për shkak të natyrës jodetyruese të vendimeve të Avokatit të Popullit.

Procedurat për paraqitjen e ankesave janë relativisht të thjeshta. Ankesat mund të jenë në formë të shkruar ose verbale.¹¹³ Ankuesit mund t'i paraqesin ankesat e tyre në zyrën qendrore ose në zyrat rajonale të IAP-së, përmes postës, e-mailit, faksit, kutive të ankesave dhe madje edhe përmes telefonatave.¹¹⁴ Së fundi, Avokati i Popullit ka bërë të mundur paraqitjen e ankesave online përmes faqes së internetit të institucionit.¹¹⁵

Megjithatë, parashtrimi i ankesave konsiderohet paksa i vështirë në rastet e shkeljes së të drejtave të komuniteteve joshumicë, për shkak të nivelit të tyre arsimor dhe statusit socio-ekonomik.¹¹⁶ Këto vështirësi manifestohen në numrin e vogël të ankesave nga këto komunitete.¹¹⁷

Gjatë vitit 2021, IAP-ja ka administruar gjithsej 1,612 ankesa me rreth 2,500 persona të involvuar.¹¹⁸ Krahasuar me vitin paraprak (2020), është regjistruar një rritje prej rreth 200 rastesh.¹¹⁹ Shkeljet më të shpeshta të pretenduara në ankesa kanë të bëjnë me të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të drejtën për mjete juridike, si dhe të drejtën për të punuar dhe për të ushtruar një profesion.¹²⁰ Megjithatë,

pothuajse dy të tretat e ankesave janë kategorizuar si të pa-pranueshme.¹²¹

Avokati i Popullit ka kompetencën të kryejë hetime me iniciativë të veten, duke u mbështetur në informacionin e marrë nga çdo burim, kur ka arsye se të drejtat dhe liritë e njeriut janë shkelur.¹²² Gjatë gjithë vitit 2021, Avokati i Popullit ka iniciuar 45 hetime dhe janë hartuar raporte për dhjetë raste.¹²³ Numri i rasteve të hetuara sipas detyrës zyrtare është përgjithësisht i njëjtë përgjatë viteve.¹²⁴

Avokati i Popullit ka pak ndikim në përmirësimin e legjislatcionit dhe punën e institucioneve. Institucionet dhe autoritetet publike neglizhojnë rekomandimet e IAP-së. Në vitin 2021, Avokati i Popullit ofroi 157 rekomandime, nga të cilat vetëm 43 (27 për qind) u zbatuan.¹²⁵ Mbi 70 për qind e rekomandimeve të Avokatit të Popullit janë në pritje të zbatimit dhe janë të përsëritura përgjatë viteve.¹²⁶ Ekzekutivi ka nivelin më të ulët të zbatimit të rekomandimeve nga IAP-ja.¹²⁷

Avokati i Popullit është ndër institucionet më të besuara në vend. Sipas Barometrit Ballkanik për vitin 2022, 68 për qind e qytetarëve i besojnë Avokatit të Popullit.¹²⁸ Kjo statistikë përbën nivelin më të lartë të besimit në IAP që nga viti 2017. Në të njëjtën kohë, ky është niveli më i lartë i besimit për një institucion të Avokatit të Popullit në krahasim me të gjitha vendet e tjera të rajonit.

IAP-ja zhvillon fushata informuese herë pas here, kryesisht në nivel lokal.¹²⁹ Gjatë vitit 2021 zhvilloi fushatën "*Njihuni me Institucionin e Avokatit të Popullit*" me të rinj nga 14 komuna.¹³⁰



INDIKATORI 8.3.2 PROMOVIMI I PRAKTIKAVE TË MIRA

75/100



Edhe pse Avokati i Popullit synon të rrisë vetëdijësimin e publikut dhe ekzekutivit për standardet etike, përpjekjet e bëra janë të kufizuara dhe reaktive, dhe si të tilla shihen si joefektive.

Çdo institucion dhe autoritet publik, si dhe personat që ushetrojnë veprimtari publike, janë nën juridiksionin e punës së Avokatit të Popullit.¹³¹ Të gjitha institucionet janë të obliguara t'u përgjigjen kërkesave të Avokatit të Popullit.¹³² Në praktikë, Avokati i Popullit zakonisht konsultohet me palët e përfshira në raste, veçanërisht për çështje të ndjeshme.¹³³

IAP-ja ka përgjegjësi ligjore për të rritur vetëdijësimin e publikut për të drejtat e njeriut përmes fushatave informuese dhe edukative, si dhe përmes mediave, dhe për të luftuar të gjitha format e diskriminimit.¹³⁴ Megjithatë, fushatat publike apo fushatat për nëpunësit civilë nuk janë tipike për punën e Avokatit të Popullit. Ato janë të rralla, reaktive dhe ndodhin gjatë shënimit të datave të caktuara.¹³⁵

Institucioni i Avokatit të Popullit është aktiv në publikimin e gjetjeve, rekomandimeve dhe raporteve për rastet. Faqja e internetit e Avokatit të Popullit përmban të dhëna të përditësuarara për rastet e trajtuara dhe rekomandimet e ofruara nga Avokati i Popullit.¹³⁶ Avokati i Popullit gjithashtu përdor mediet dhe rrjetet sociale për të paraqitur gjetjet për raste të ndryshme. Rasti i fundit ishte njoftimi i Avokatit të Popullit për rastin e Dejan Pantiqit, i arrestuar dhe mbajtur në veri të vendit, nën dyshimin për kryerjen e veprave të rënda penale. Sipas njoftimit, Avokati i Popullit kishte biseduar online me të për gjendjen e tij shëndetësore, pasi për shkak të situatës së tensionuar dhe vendosjes së barrikadave, ai nuk kishte mundur të dërgohet në qendrën përkatëse të paraburgimit.¹³⁷

Gjetjet, mendimet dhe rekomandimet e dhëna paraprakisht monitorohen vazhdimisht nga Avokati i Popullit.¹³⁸ Niveli i zbatimit të tyre paraqitet në raportet vjetore¹³⁹ si dhe në seksionin e raporteve në faqen e internetit të institucionit.¹⁴⁰





Ndërveprimet

Për shkak të mandatit dhe fushëveprimit të tij ligjor, Institucioni i Avokatit të Popullit ndërvepron me pothuajse çdo institucion publik në Kosovë. Megjithatë, institucionet kryesore me të cilat IAP-ja ka ndërveprim më të shpeshtë janë Kuvendi i Kosovës, Qeveria e Kosovës dhe institucionet e drejtësisë.

Avokati i Popullit nuk ndërvepron vetëm me Kuvendin në lidhje me llogaridhënien e drejtpërdrejtë dhe ndarjen e buxhetit, por edhe në proceset legislative, duke vlerësuar përputhshmërinë e akteve ligjore me standardet e të drejtave të njeriut dhe përmbushjen e detyrimeve pozitive të shtetit për të rregulluar disa të drejta dhe liri.¹⁴¹

Nga ana tjetër, ndërveprimi i Avokatit të Popullit me gjykatat përfshin dhënien e rekomandimeve për funksionimin e sistemit gjyqësor dhe mendimeve në cilësinë e mikut të gjykatës (*amicus curie*), ose rekomandime individuale në rastet kur trajtimi i çështjeve gjyqësore vonohet.¹⁴² Avokati i Popullit gjithashtu ka të drejtë të iniciojë lëndë për vlerësimin e kushtetutshmërisë në Gjykatën Kushtetuese.¹⁴³ Edhe bashkëpunimi me OSHC-të dhe partnerët socialë rregullohet me ligj.¹⁴⁴

Rekomandimet e shtyllës

- Ndryshimi i Ligjit për Avokatin e Popullit në mënyrë që të përcaktohet se kandidatët për këtë pozitë të mos kenë qenë pjesë e partive politike, ekzekutivit ose në poste të tjera politike për një periudhë të paktën pesë vjet përpara konkurrimit për t'u zgjedhur Avokati i Popullit, duke garantuar një nivel edhe më të lartë të pavarësisë së Avokatit të Popullit.
- Miratimi i një Kod të ri të Etikës i cili përcakton qartë subjektet për të cilat zbatohet; përcakton llojet e informacionit që duhet të jetë konfidencial; ndalon angazhimet dhe kontributet ndaj subjekteve politike; përcakton politikën e sinjalizimit; dhe specifikon mbikëqyrjen e zbatimit dhe shqiptimin e masave disiplinore. Ndryshimet duhet gjithashtu të parashohin obligimin e IAP-së për të zhvilluar trajnime specifike për punëtorët lidhur me çështjet e integritetit.
- Të zhvillohen fushata të veçanta të vetëdijesimit në lidhje me promovimin e praktikave të mira dhe standardeve të sjelljes etike. Duhet të zhvillohen fushata informative të synuara për komunitetet joshumicë në lidhje me mundësitë dhe format e raportimit të rasteve të mundshme të shkeljeve të të drejtave të njeriut.
- Fokusimi, në bashkëpunim me Kuvendin e Kosovës, në gjetjen e mënyrave për rritjen e nivelit të zbatimit të rekomandimeve të IAP-së nga institucionet publike. Duhet të merret në konsideratë kushtëzimi i ndarjes së mjeteve për institucionet publike në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit.



REFERENCAT

- 1 Kushtetuta e Kosovës, kapitulli XII.
- 2 Kushtetuta e Kosovës, neni 132, paragrafi 1.
- 3 Kushtetuta e Kosovës, neni 133, paragrafi 2.
- 4 Ligji për Avokatin e Popullit, neni 5.
- 5 Ligji për Avokatin e Popullit, neni 16, paragrafi 2.
- 6 Rregullorja Nr. 03/2022 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Institucionin e Avokatit të Popullit, neni 5, paragrafi 1, si dhe neni 10, paragrafi 1, pika 7.
- 7 Ligji për Avokatin e Popullit, neni 35, paragrafi 2.
- 8 Për buxhetin e vitit 2021, kërkesa buxhetore e IAP-së ishte 1,373,815€, ndërsa buxheti i miratuar është 1,269,278,99€, ose rreth 50,000€ më pak.
- 9 Ligji për ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, faqe 77 dhe 85.
- 10 Ligji për ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, faqe 77.
- 11 Intervistë me një nga ish-Avokatët e Popullit në Kosovë, gusht 2022.
- 12 Ligji për ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, faqe 77.
- 13 Raporti Vjetor 2021 i Institucionit të Avokatit të Popullit, faqe 207.
- 14 Intervistë me Blendë Pira, Koordinatore e Programit në Iniciativën Rinore për të Drejtat e Njeriut në Kosovë, gusht 2022.
- 15 Intervistë me një nga ish-Avokatët e Popullit në Kosovë, gusht 2022.
- 16 Intervistë me Majlinda Sinani-Lulaj, Zëvendës Avokate e Popullit, gusht 2022.
- 17 Rregullorja nr. 02/2016 për Punën e Institucionit të Avokatit të Popullit, neni 15, paragrafi 1, pika 5.
- 18 Rregullorja nr. 02/2016 për Punën e Institucionit të Avokatit të Popullit, neni 29.
- 19 Intervistë me Majlinda Sinani-Lulaj, Zëvendës Avokate e Popullit, gusht 2022.
- 20 Intervistë me një nga ish-Avokatët e Popullit në Kosovë, gusht 2022.
- 21 Kushtetuta e Kosovës, neni 132, paragrafi 2.
- 22 Ligji për Avokatin e Popullit, neni 3, paragrafi 1.
- 23 Ligji për Avokatin e Popullit, neni 3, paragrafi 3.
- 24 Arkivat, rastet, komunikimet, pronat, fondet dhe asetet e tjera.
- 25 Ligji për Avokatin e Popullit, neni 12, paragrafi 2.
- 26 Kushtetuta e Kosovës, neni 134, paragrafi 3.
- 27 Kushtetuta e Kosovës, neni 134, paragrafi 1.
- 28 Ligji për Avokatin e Popullit, neni 8.
- 29 Sipas Ligjit për Avokatin e Popullit, neni 9, përcaktohet se në raundin e parë votohen të gjithë kandidatët e propozuar nga komisioni parlamentar. Raundi i dytë zhvillohet ndërmjet dy kandidatëve me më shumë vota. Nëse asnjëri prej tyre nuk ka siguruar më parë votat e nevojshme. Nëse edhe pas raundit të dytë, asnjë nga kandidatët nuk ka arritur shumicën e nevojshme të votave, zhvillohet raundi i tretë, ku kandidati me numrin më të madh të votave në raundin paraprak është i vetmi kandidat.
- 30 Ligji për Avokatin e Popullit, neni 34.
- 31 Ligji për Pagat në Sektorin Publik (2023), faqe 20.
- 32 Ligji për Avokatin e Popullit, neni 20, paragrafi 2.
- 33 Rregullorja nr. 02/2017 për procedurën e rekrutimit, emërimit dhe punës provuese të të punësuarve në Institucionin e Avokatit të Popullit, neni 5.
- 34 Rregullorja nr. 02/2016 për Rregulloren e Punës së Institucionit të Avokatit të Popullit, neni 20, paragrafi 3.
- 35 Sipas Ligjit për Avokatin e Popullit, neni 13, Avokati i Popullit mund të shkarkohet për shkak të paaftësisë fizike dhe mendore; dënimin me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale të dënueshme me gjashtë ose më shumë muaj burgim; ushtrimi i funksioneve politike; si dhe pjesëmarrjen në nivelet drejtuese të organizatave civile, ekonomike dhe tregtare.
- 36 Kushtetuta e Kosovës, neni 134, paragrafi 5.
- 37 Ligjit për shërbimin civil të Republikës së Kosovës, neni 87.
- 38 Ligji për Avokatin e Popullit, neni 12.
- 39 Agjencia e Lajmeve EkonomiaOnline, maj 2021, <https://ekonomionline.com/desh-ton-vojja-e-avokatit-te-popullit-ne-mungese-te-koorumit/> [qasur më 16 gusht 2022]
- 40 Portali Indeksonline, shtator 2020, <https://indeksonline.net/kush-eshte-naim-qelaj-i-sapo-lofur-avokat-i-popullit/> [qasur më 16 gusht 2022]
- 41 Intervistë me një nga ish-Avokatët e Popullit në Kosovë, gusht 2022.
- 42 Intervistë me Majlinda Sinani-Lulaj, Zëvendës Avokate e Popullit, gusht 2022.
- 43 Ligji për Avokatin e Popullit, neni 18, paragrafi 1, pika 6.
- 44 Rregullorja Nr. 01/2016 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Institucionin e Avokatit të Popullit, neni 11.
- 45 Ligji për qasje në dokumente publike, neni 6.
- 46 Rregullorja nr. 02/2016 për Rregulloren e Punës së Institucionit të Avokatit të Popullit, neni 27, paragrafi 1.





47 Ligji për qasje në dokumente publike, neni 10.

48 Ligji për Avokatin e Popullit, neni 18, paragrafi 1, pika 11.

49 Rregullorja nr. 02/2016 për Rregulloren e Punës së Institucionit të Avokatit të Popullit, neni 27, paragrafi 3.

50 Ligji për Avokatin e Popullit, neni 18, paragrafi 1.12.

51 Para ndryshimeve të fundit ligjore, kjo agjenci quhej “Agjencia Kundër Korrupsionit”.

52 Ligji për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe dhuratave, neni 4, paragrafi 1.12.

53 Rregullorja nr. 02/2016 për Punën e Institucionit të Avokatit të Popullit, neni 22.

54 Ligji për Avokatin e Popullit, neni 16, paragrafi 16.

55 Rregullorja nr. 02/2016 për Rregulloren e Punës së Institucionit të Avokatit të Popullit, neni 82, paragrafi 2.

56 Për më shumë, shihni seksionin e faqes së internetit të IAP-së mbi raportet vjetore, në: <https://oik-rks.org/en/reports/annual-reports/>

57 Për më shumë, shihni seksionin e faqes së internetit të IAP-së për raportet e rasteve, në: <https://oik-rks.org/en/reports/case-reports/>

58 Për më shumë, shihni seksionin e faqes së internetit të IAP-së mbi raportet e veçanta, në: <https://oik-rks.org/en/reports/special-reports/>

59 Për më shumë, shihni seksionin e faqes së internetit të IAP-së mbi raportet ex-officio, në: <https://oik-rks.org/en/reports/ex-officio-reports/>

60 Për më shumë, shihni faqen e internetit të IAP-së mbi opinionet, në: <https://oik-rks.org/en/reports/opinions/>

61 Për më shumë, shihni faqen e internetit të IAP-së mbi rekomandimet, në: <https://oik-rks.org/en/reports/letter-recommendations/>

62 Për më shumë, shihni faqen e internetit të Avokatit të Popullit. Gjetet në: <https://oik-rks.org/> [qasur më 19 gusht 2022]

63 Raportet vjetore përmbajnë statistika që lidhen me numrin total të rasteve, ndarjen e të dhënave demografike për rastet, autoritetet tek të cilat janë paraqitur ankesat, llojin e vendimmarrjes për rastet dhe nivelin e zbatimit të rekomandimeve të IAP-së. Për më shumë, shihni si shembull raportin vjetor të Avokatit të Popullit për vitin 2021. Gjetet në: <https://oik-rks.org/2022/03/31/raporti-vjetor-2021/> [qasur më 19 gusht 2022]

64 Për më shumë, shih kapitullin VI të raportit vjetor të Avokatit të Popullit për vitin 2021. Gjetet në: <https://oik-rks.org/2022/03/31/raporti-vjetor-2021/> [qasur më 19 gusht 2022]

65 Raporti Vjetor 2021 i Institucionit të Avokatit të Popullit, faqe 192.

66 Raporti Vjetor 2021 i Institucionit të Avokatit të Popullit, faqe 192.

67 Për më shumë shih rubrikën për deklarimin e pasurisë së zyrtarëve të Institucionit të Avokatit të Popullit, në faqen e internetit të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit. Gjetet në: https://akk-ks.org/deklarimi_i_pasuris/2033/Institucioni_i_Avokatit_t%C3%AB_Popullit/2033/ [qasur më 19 gusht 2022]

68 Intervistë me Blendë Pira, Koorditore e Programit në Iniciativën Rinore për të Drejtat e Njeriut në Kosovë, gusht 2022.

69 Raporti Vjetor 2021 i Institucionit të Avokatit të Popullit, faqe 45 dhe 46.

70 Ligji për Avokatin e Popullit, neni 29.

71 Institucioni i Avokatit të Popullit. Raportit Vjetor i vitit 2014. Nr. 14. 31 mars 2015, fq. 8.

72 Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Neni 135, fq. 52.

73 Ligji për Avokatin e Popullit, neni 29, paragrafi 3.

74 Ligji për Avokatin e Popullit, neni 18, paragrafi 1.6.

75 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 135.

76 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 135.

77 Ligji për Avokatin e Popullit, neni 12.

78 Ligji për mbrojtjen e sinjalizuesve, neni 9.

79 Shih Rregulloren për përcaktimin e procedurës për pranimin dhe trajtimin e rasteve të sinjalizimit, prill 2021.

80 Ligji për mbrojtjen e sinjalizuesve, neni 17 paragrafi 1.

81 Raporti vjetor i IAP-së për vitin 2021 është publikuar në faqen e internetit të institucionit më 31 mars 2022. Gjetet në: <https://oik-rks.org/2022/03/31/raporti-vjetor-2021/>

82 Raporti vjetor i vitit 2021 i Institucionit të Avokatit të Popullit, kapitujt II, III dhe IV.

83 Raporti vjetor i vitit 2021 i Institucionit të Avokatit të Popullit, kapitujt IX, X dhe XI.

84 Për më shumë shihni njoftimin e Kuvendit të Kosovës për seancën e 18 janarit 2023. Gjetet në: <https://kuvendikosoves.org/shq/per-publikun/lajmi/vazhdimi-i-seances-plenare-31643/> [qasur më 19 janar 2023]

85 Portali Kallxo.com, tetor 2021, “Miratohet raporti vjetor i Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2020”. Gjetet në: <https://kallxo.com/lajm/mirato-het-raporti-vjetor-i-institucionit-te-avokatit-te-popullit-per-vitin-2020/> [qasur më 16 dhjetor 2022]

86 Transkripti i mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, mbajtur më 19 tetor dhe 6 dhjetor 2021, faqet 83 deri 91. Gjetet në: https://kuvendikosoves.org/Uploads/Data/SessionFiles/2021_10_19_ts_Seanca_8EsjYPDzJf.pdf [qasur më 16 dhjetor 2022]

87 Intervistë me Majlinda Sinani-Lulaj, Zëvendës Avokate e Popullit, gusht 2022.

88 Intervistë me një nga ish-Avokatët e Popullit në Kosovë, gusht 2022.

89 Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkzionit Publik. Gjetet në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=16314>

90 Ligji për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave. Gjetet në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=61304>

91 Rregullorja nr. 02/2016 për Punën e Institucionit të Avokatit të Popullit. Gjetet në: https://www.oik-rks.org/wp-content/uploads/2018/08/Rregullor-ja_IAP_02-2016_shqip.pdf

92 Kodi i Etikës i Institucionit të Avokatit të Popullit. Gjetet në: <https://oik-rks.org/2018/08/20/kodi-i-etikes-se-iap-2011/> [qasur më 16 dhjetor 2022]

93 Kodi i Etikës i Institucionit të Avokatit të Popullit, neni 4.

94 Kodi i Etikës i Institucionit të Avokatit të Popullit, neni 5.

95 Kodi i Etikës i Institucionit të Avokatit të Popullit, neni 13.

96 Kodi i Etikës i Institucionit të Avokatit të Popullit, neni 15.

97 Institucioni i Avokatit të Popullit. Kodi i Etikës i Institucionit të Avokatit të Popullit. Nr. 01/ 2011, nenet 14 dhe 15.



98 Institucioni i Avokatit të Popullit. Kodi i Etikës i Institucionit të Avokatit të Popullit. Nr. 01/2011, neni 16.

99 Ligji për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe dhuratave, neni 4, paragrafët 1.12 dhe 1.14, dhe neni 5, paragrafi 2.

100 Intervistë me Majlinda Sinani-Lulaj, Zëvendës Avokate e Popullit, gusht 2022.

101 Intervistë me Blendë Pira, Koorditore e Programit në Iniciativën Rinore për të Drejtat e Njeriut në Kosovë, gusht 2022. Intervistë me një nga ish-Avokatët e Popullit në Kosovë, gusht 2022.

102 Intervistë me Majlinda Sinani-Lulaj, Zëvendës Avokate e Popullit, gusht 2022.

103 Intervistë me një nga ish-Avokatët e Popullit në Kosovë, gusht 2022.

104 Për më shumë, shihni bazën e të dhënave të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, ku janë të qasshme raportet e deklarimit të pasurisë nga stafi përkatës i Institucionit të Avokatit të Popullit. Gjetet në: https://akk-ks.org/deklarimi_i_pasuris/2033/Institucioni_i_Avokatit_t%C3%AB_Popullit/2033/ [qasur më 19 dhjetor 2022]

105 Ligji për Barazi gjinore, neni 13.

106 Intervistë me Blendë Pira, Koorditore e Programit në Iniciativën Rinore për të Drejtat e Njeriut në Kosovë, gusht 2022.

107 Rregullorja nr. 02/2016 për Punën e Institucionit të Avokatit të Popullit, neni 69.

108 Rregullorja nr. 02/2016 për Rregulloren e Punës së Institucionit të Avokatit të Popullit, neni 69, paragrafi 3.

109 Intervistë me një nga ish-Avokatët e Popullit në Kosovë, gusht 2022.

110 Intervistë me Majlinda Sinani-Lulaj, Zëvendës Avokate e Popullit, gusht 2022.

111 Intervistë me Blendë Pira, Koorditore e Programit në Iniciativën Rinore për të Drejtat e Njeriut në Kosovë, gusht 2022.

112 Raporti Vjetor i vitit 2021 i Institucionit të Avokatit të Popullit, Kapitulli XI, faqet 211 dhe 213.

113 Rregullorja nr. 02/2016 për Punën e Institucionit të Avokatit të Popullit, neni 36.

114 Rregullorja nr. 02/2016 për Rregulloren e Punës së Institucionit të Avokatit të Popullit, neni 34, paragrafi 2.

115 Për më shumë, shihni faqen e internetit të Institucionit të Avokatit të Popullit. E qasshme në: <https://oik-rks.org/>

116 Intervistë me Blendë Pira, Koorditore e Programit në Iniciativën Rinore për të Drejtat e Njeriut në Kosovë, gusht 2022.

117 Sipas Raportit Vjetor të IAP-së për vitin 2021, në mesin e 1612 ankesave të pranuar, më pak se 10 për qind e tyre janë nga pjesëtarët e komuniteteve joshumicë.

118 Raporti Vjetor i vitit 2021 i Institucionit të Avokatit të Popullit, Kapitulli XI, faqe 211.

119 Raporti Vjetor i vitit 2020 i Institucionit të Avokatit të Popullit, Kapitulli IX, faqe 160.

120 Raporti Vjetor i vitit 2021 i Institucionit të Avokatit të Popullit, Kapitulli XI, faqe 213.

121 Raporti Vjetor i vitit 2021 i Institucionit të Avokatit të Popullit, Kapitulli XI, faqe 213. Po ashtu, arsyt kryesore për shpalljen e ankesave si të papranueshme është konstatimi se nuk ka shkelje por keqadministrim, pala është duke përdorur mjete juridike dhe se mjetet e tjera juridike nuk janë ezauruar.

122 Ligji për Avokatin e Popullit, neni 16, paragrafët 4, 6 dhe 7.

123 Raporti Vjetor i vitit 2021 i Institucionit të Avokatit të Popullit, Kapitulli XI, faqe 214.

124 Sipas Raportit Vjetor të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2020, IAP-ja kishte hapur 43 raste për hetime sipas detyrës zyrtare.

125 Raporti Vjetor i vitit 2021 i Institucionit të Avokatit të Popullit, Kapitulli XI, faqet 214, 215 dhe 216.

126 Raporti Vjetor i vitit 2021 i Institucionit të Avokatit të Popullit, Kapitulli XI, faqe 221.

127 Sipas Raportit Vjetor të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2021, nga 100 rekomandime drejtuar Qeverisë dhe ministrive, vetëm 21 prej tyre janë zbatuar.

128 Për më shumë, shihni bazën e të dhënave të Barometrit Ballkanik. Gjetet në: <https://www.rcc.int/balkanbarometer/results/2/public> [qasur më 16 dhjetor 2022]

129 Intervistë me Blendë Pira, Koorditore e Programit në Iniciativën Rinore për të Drejtat e Njeriut në Kosovë, gusht 2022.

130 Raporti Vjetor i vitit 2021 i Institucionit të Avokatit të Popullit, Kapitulli IX, faqe 200.

131 Ligji për Avokatin e Popullit, neni 1, paragrafi 1.

132 Ligji për Avokatin e Popullit, neni 25.

133 Intervistë me një nga ish-Avokatët e Popullit në Kosovë, gusht 2022.

134 Ligji për Avokatin e Popullit, neni 18, paragrafi 1, pika 4.

135 Sipas Raportit Vjetor të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2021, IAP-ja është përfshirë në fushata që kanë të bëjnë me çështjet e lirisë së medie, barazisë gjinore, mjedisit, të drejtave të fëmijëve, personave me aftësi të kufizuara dhe punëtorëve. Zakonisht, në kuadër të aktiviteteve të organizuara për shënimin e ditëve përkatëse, IAP-ja përmes konferencave apo komunikatave për medie ka kërkuar nga institucionet përkatëse përkushtim dhe masa konkrete në adresimin e problemeve përkatëse.

136 Për më shumë, shihni seksionin e raporteve në faqen e internetit të Institucionit të Avokatit të Popullit. Gjetet në: <https://oik-rks.org/raportet/> [qasur më 23 janar 2023]

137 Për më shumë shikoni postimin e Institucionit të Avokatit të Popullit në rrjetin social «Facebook»: https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=pfbid02VGDpo24bawQY6zoqr63H3FXmpWVqwWK3Qedh6SdghJf3yvkRGru7XDtviE3dbwHRI&id=100069494886197 [qasur më 23 janar 2023]

138 Intervistë me Blendë Pira, Koorditore e Programit në Iniciativën Rinore për të Drejtat e Njeriut në Kosovë, gusht 2022.

139 Raporti Vjetor i vitit 2021 i Institucionit të Avokatit të Popullit.

140 Për më shumë, shihni seksionin specifik të raporteve në faqen e internetit të Institucionit të Avokatit të Popullit. Gjetet në: <https://oik-rks.org/raportet/> [qasur më 23 janar 2023]

141 Raporti Vjetor i vitit 2021 i Institucionit të Avokatit të Popullit, Kapitulli II, faqe 18.

142 Ligji për Avokatin e Popullit, neni 16, paragrafët 8 dhe 9.

143 Ligji për Avokatin e Popullit, neni 16, paragrafi 10.

144 Ligji për Avokatin e Popullit, neni 16, paragrafi 16, përcakton se Avokati i Popullit bashkëpunon me partnerët socialë dhe organizatat joqeveritare që merren me çështjet e barazisë dhe mosdiskriminimit, si dhe me organet ndërkombëtare të ngjashme me Avokatin e Popullit.




ZYRA .. KOMBËTARE E AUDITIMIT




PËRMBLEDHJE

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është organ kushtetues i përhershëm dhe i pavarur, të cilit i janë dhënë kompetenca për të audituar aktivitetet ekonomike të institucioneve publike, ndërmarrjeve publike dhe subjekteve të tjera juridike në të cilat shteti ka një pjesë.¹


81/100 Rezultati i përgjithshëm i shtyllës




Kapacitetet



Qeverisja



Roli





Auditori kontrollon përdorimin dhe mbrojtjen e fondeve publike nga organet e qeverisjes qendrore dhe lokale. Aktivitetet e Auditorit të Përgjithshëm mbështeten nga një Zëvendës Auditor, një Drejtor i Përgjithshëm, gjashtë Ndihmës Auditorë dhe Drejtori për Komunikim Publik.² Zyra Kombëtare e Auditimit ka pesë njësi organizative, si departamentet e auditimit, departamentet mbështetëse, divizionet, njësitë dhe auditimi i brendshëm. Për më tepër, janë gjithsej 15 departamente të auditimit, ndërsa janë edhe pesë departamente mbështetëse.

ZKA është institucion i konsoliduar mirë, i cili perceptohet të jetë një nga institucionet me integritetin dhe besueshmërinë më të lartë në Kosovë.³ Përveç zhvillimit të mekanizmave të brendshëm për të mbështetur profesionalizmin dhe etikën në vendin e punës,⁴ ky institucion themeloi edhe një njësi të posaçme për koordinim dhe bashkëpunim me prokurorinë në vitin 2018.⁵ Megjithatë, vlerësimi ngre shqetësime për mungesën e kornizës ligjore dhe mekanizmave që u ofrojnë institucioneve të audituara mjete për të apeluar gjetjet e auditorit ose për të marrë masa korrigjuese ose sanksione bazuar në gjetjet e auditorit.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit gjejnë aplikim të gjerë në zinxhirin e llogaridhënies së Kuvendit të Kosovës dhe Prokurorisë, por edhe në shoqërinë civile, mediet dhe organet ndërkombëtare monitoruese. Edhe pse Auditori i Përgjithshëm emërohet nga Kuvendi dhe sipas legjislacionit konsiderohet si organ i pavarur, vlerësimi ngre shqetësimin se Auditori i Përgjithshëm mund ta ekspozojë institucionin ndaj rritjes së ndërhyrjeve politike për shkak të mungesës së dispozitave ligjore që kanë të bëjnë me procesin për përzgjedhjen e kandidatit për Auditor të Përgjithshëm.

Gjithashtu, vlerësimi i raporteve të Zyrës Kombëtare të Auditimit nuk gjeti dëshmi të ndonjë analize institucionale mbi shkakun rrënjësor të gjetjeve sistematike, të cilat në këmbim do të ndihmonin qeverinë dhe Kuvendin të iniciojnë përmirësime në proceset dhe praktikën në menaxhimin e financave publike.

Megjithëse ligji për qasjen në dokumente publike parasheh një afat kohor për publikimin e të gjitha dokumenteve publike, ligji për Zyrën Kombëtare të Auditimit nuk përcakton se deri në cilën datë raporti vjetor i performancës së ZKA-së, duke përfshirë pasqyrat financiare të audituara, udhëzimet dhe rregulloret e brendshme dhe informacione të tjera në lidhje me administrimin e zyrës, aktivitetet dhe llogaridhënia e saj duhet të publikohen në faqen e internetit.



Kapacitetet

**INDIKATORI 9.1.1
BURIMET (NË PRAKTIKË)**

75/100



Zyra Kombëtare e Auditimit ka një sasi të mirë burimesh për të kryer detyrimet e saj ligjore në lidhje me auditimet e rregullsisë.⁶ Megjithatë, nuk mjafton t'i mundësohet ZKA-së të vendosë një fokus më të madh në auditimet e performancës dhe pagat e auditorëve janë nën normat e tregut, gjë që mund të dëmtojë qëndrueshmërinë e ZKA-së.

Buxheti i ZKA-së në vitin 2022⁷ ishte 3,066,355 €, që paraqet një rritje prej 9.8 për qind krahasuar me vitin 2021 (2,791,388 €). Buxheti i vitit 2021⁸ ishte rreth 10 për qind më i ulët se në vitin 2020.⁹

Tabela 9.1: Buxheti vjetor i ZKA-së (shumat janë në €)

Sipas Auditorit të Përgjithshëm, ZKA-ja i është drejtuar qeverisë dhe Kuvendit të Kosovës për nevojën e fondeve shtesë.¹¹ Për shkak të kërkesave ligjore që e detyrojnë ZKA-në të auditojë edhe organizatat e vogla buxhetore, nevojat e ZKA-së si në aspektin buxhetor ashtu edhe në burimet njerëzore nuk janë të mjaftueshme, duke reduktuar mundësinë e një fokusi më të madh në auditimet e performancës (shih 9.3.1).¹²

Numri i të punësuarve është rritur në 180 në vitin 2022, me 20 vende të reja të krijuara që nga viti 2017.¹³ Gjatë vitit 2021, ZKA-ja punësoi tre punonjës të rinj dhe dhjetë punonjës i dhanë fund punësimit.¹⁴ Megjithatë, sipas Auditorit të Përgjithshëm, ZKA-ja nuk ka zyrë të përhershme dhe vazhdon të marrë me qira ambiente për hapësirë pune.¹⁵

Tabela 9.1: Buxheti vjetor i ZKA-së¹⁰ (shumat janë në €)

	Buxheti total në €	Rritje/ulje buxheti në % në vit
2023	3,266,591	6.53
2022	3,066,355	9.85
2021	2,791,388	-10.36
2020	3,114,149	-7.25
2019	3,357,792	-





Tabela 9.2: Burimet njerëzore (të dhënat e marra nga Raportet Vjetore të Performancës së ZKA-së 2017-2021)¹⁶:


	Numri i pozitive të stafit sipas sistematizimit	Pozicionet e plotësuara	Pozicionet e paplotësuara	% e pozicioneve të paplotësuara
2022	180	-		
2021	173	164	9	5
2020	173	171	2	1
2019	172	171	1	1
2018	167	165	2	1
2017	160	159	1	1

Pagat e auditorëve të angazhuar janë nën normën e tregut, gjë që shkakton vështirësi në motivimin dhe mbajtjen e auditorëve, si dhe mungesë interesi në tregun e punës për t'iu bashkuar ZKA-së. Sipas Kryetarit të Sindikatës së Punëtorëve të ZKA-së gjatë vitit 2022, tre herë është shpallur një vend i lirë pune për auditor dhe të tria herë konkursi është mbyllur pa konkurrues.¹⁷ Janë të certifikuar gjithsej 98 auditorë, nga të cilët 83 janë auditorë të certifikuar në sektorin publik, 11 auditorë në sektorin privat dhe katër ndihmës auditorë në sektorin publik.¹⁸

Megjithatë, sipas kryetarit të Sindikatës së Punëtorëve, deri më tani nuk ka pasur një veprim konkret për harmonizimin e pagave me normën e tregut.¹⁹

Auditorët e ZKA-së kanë trajnim akademik, siç kërkohet me ligj,²⁰ dhe certifikata për auditor ose auditor të certifikuar në sektorin publik. Po kështu, brenda institucionit ekzistojnë mekanizma për nxitjen e zhvillimit të vazhdueshëm profesional nëpërmjet trajnimeve të brendshme, si dhe nëpërmjet vizitave trajnuese dhe trajnimeve ndërkombëtare.²¹ Megjithatë, nuk ka informacion publik për numrin e seancave trajnuese dhe se kush ishin përfituesit e tyre.

INDIKATORI 9.1.2 PAVARËSIA (SIPAS LIGJIT)



Kushtetuta²² dhe Ligji për Auditorin e Përgjithshëm dhe ZKA-në përmbajnë disa dispozita që sigurojnë pavarësinë e ZKA-së.²³ Megjithatë, ajo është pak e kufizuar nga e drejta e qeverisë për të modifikuar kërkesat e saj buxhetore dhe diskrecionin e lartë në zgjedhjen e Auditorit të Përgjithshëm nga Presidenti.

Kushtetuta e përcakton qartë ZKA-në si institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik dhe financiar dhe përcakton përgjegjësitë e saj.²⁴ Marrëdhënia ndërmjet ZKA-së dhe legjislativit është e përcaktuar edhe në Kushtetutë.²⁵ Nuk ka institucione të jashtme apo organe shtetërore që kanë fuqinë ligjore për të ndërhyrë në agjendën e Zyrës Kombëtare të Auditimit. Zyra




Kombëtare e Auditimit ka lirinë të hartojë programin dhe planet vjetore të auditimit sipas metodave dhe standardeve të Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI).²⁶ Megjithatë, sipas legjislationit aktual, qeveria ka të drejtën të modifikojë kërkesën buxhetore të ZKA-së.²⁷ ZKA-ja tashmë ka kërkuar një ndryshim të ligjit që të drejtat e tilla t'i barten Kuvendit të Kosovës në përputhje me Deklaratën e Limës dhe Deklaratën e Meksikës për Pavarësinë e Institucioneve Supreme të Auditimit.²⁸

Auditori i Përgjithshëm propozohet nga Presidenti i Republikës së Kosovës dhe emërohet nga Kuvendi.²⁹ Ligji përcakton disa kriteret për të siguruar që Auditori i Përgjithshëm i përzgjedhur të jetë person që zotëron kualifikimet e nevojshme të moralit të lartë, i paanshëm, i ndershëm dhe me integritet për kryerjen e funksionit.³⁰ Përzgjedhja e kandidatit për Auditor të Përgjithshëm duhet të bëhet nga një komision i themeluar nga Presidenti, megjithatë, nuk ka dispozita ligjore që kanë të bëjnë me përgjegjësinë e Komisionit dhe as të Zyrës së Presidentit nëse nuk merren parasysh rezultatet e Komisionit.³¹ Nga ana tjetër, ligji përcakton vetëm në mënyrë të paqartë detyrimin e Auditorit të Përgjithshëm për të zgjedhur Zëvendës Auditorin e Përgjithshëm, Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm dhe Drejtorin e Përgjithshëm të Zyrës përmes një thirrjeje të hapur, dhe nuk specifikon asnjë kriter që punësimi për këto pozita të plotësohet.³² Sa i përket rekrutimit të stafit, kriteret e punësimit të ZKA-së bazohen në aftësitë profesionale.³³

Auditori i Përgjithshëm ka mandatin pesëvjeçar,³⁴ me mundësi të rizgjedhjes. Auditori i përzgjedhur nuk duhet të ketë qenë politikisht aktiv për të paktën tre vjet përpara përzgjedhjes.³⁵ Kjo siguron që Auditori i Përgjithshëm mund të kryejë mandatin pa frikë nga hakmarrja. Pavarësia e ZKA-së sigurohet më tej nga drejtuesit e ZKA-së dhe punonjësit e tjerë që kufizohen nga ushtrimi i ndonjë funksioni tjetër brenda sektorit publik, të qenit anëtar i bordeve të sektorit privat, mbajtja e një funksioni në një parti politike ose ndjekja e udhëzimeve nga partitë politike, ose ushtrimi i ndonjë aktiviteti shtesë me shpërblim, përveç nëse autorizohet paraprakisht nga Auditori i Përgjithshëm.³⁶ Nuk ka rregullore nëse Auditori i Përgjithshëm mund të angazhohet në aktivitete politike.

Auditori i Përgjithshëm mbrohet me ligj nga largimi pa arsytetime përkatëse. Auditori i Përgjithshëm mund të shkakohet me shumicë prej dy të tretave të deputetëve, me propozimin e Presidentit ose me iniciativën e një të tretës së deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.³⁷ Të drejtat e punës së ZKA-së mbrohen me ligjin e punës,³⁸ si dhe janë të imunizuar nga ndjekjet penale që rrjedhin nga kryerja normale e detyrave të tyre.³⁹

INDIKATORI 9.1.3 PAVARËSIA (NË PRAKTIKË)



Institucioni i auditimit operon në mënyrë të pavarur nga akterët e tjerë dhe aktivitetet e tij janë jopartiake dhe nuk tregojnë shenja të njëanshmërisë. Megjithatë, rekrutimi i Auditorit të Përgjithshëm në vitin 2021 është kritikuar nga opozita dhe media se përbën konflikt interesi.

Nuk ka raste të njohura të Auditorit të Përgjithshëm ose stafit tjetër të ZKA-së që kryejnë ndonjë aktivitet politik ose mbajnë poste që mund të rrezikojnë pavarësinë e ZKA-së.

Auditorja e Përgjithshme aktuale, Vlora Spanca, është në detyrë që nga viti 2021,⁴⁰ dhe paraardhësi i saj kreu mandatin e tij të plotë pesëvjeçar. Gjithashtu, asnjë nga personeli i lartë i institucionit suprem të auditimit nuk është shkarkuar nga detyra para përfundimit të mandatit të tyre pa arsytetime përkatëse (ose për arsye politike).

Megjithatë, ka mungesë të qartësisë ligjore (shih 9.1.3) në lidhje me metodën e përzgjedhjes së kandidatit, duke i dhënë Presidentit diskrecion të plotë mbi procesin e përzgjedhjes. Gjatë procesit të përzgjedhjes së kandidatit për Auditor të Përgjithshëm nga Presidenti, i cili më pas u prezantua në Kuvend, pati raportime për disa parregullsi si mospërputhje ndërmjet Komisionit të Vlerësimit të krijuar me mbështetjen e Ambasadës Britanike dhe rekomandimit të Komitetit të Vlerësimit Kombëtar (i krijuar nga Presidenti).⁴¹ Këto nuk u morën parasysh nga Presidentja gjatë procesit të përzgjedhjes dhe nuk u publikua apo iu komunikua ekipeve të vlerësimit asnjë arsytim se pse nuk u morën parasysh rekomandimet dhe vlerësimet e ekipit kombëtar.⁴² Për më tepër, Partia Demokratike e Kosovës (një parti opozitare) ka ngritur shqetësime për një gjoja konflikt interesi, sepse ZKA e zgjedhur është motra e një prej këshilltarëve të Kryeministrit.⁴³





Qeverisja

**INDIKATORI 9.2.1
TRANSPARENCA
(SIPAS LIGJIT)**

100/100



Ekzistojnë dispozita gjithëpërfshirëse të cilat i lejojnë deputetët dhe publikun të marrin informacion për organizimin dhe funksionimin e ZKA-së, për vendimet që kanë të bëjnë me ta dhe mënyrën se si merren këto vendime.

Ligji për Zyrën Kombëtare të Auditimit i garanton publikut të drejtën për të marrë informacion në lidhje me aktivitetet e ZKA-së.⁴⁴ ZKA duhet të publikojë raportet përfundimtare të auditimit duke përfshirë raportet e auditimit të rregullsisë me opinione mbi pasqyrat financiare vjetore,⁴⁵ raportet e auditimit të performancës dhe raportin vjetor të auditimit një ditë pas dorëzimit të institucioni i audituar⁴⁶ në faqen e tij të internetit.⁴⁷

Ligji për Zyrën Kombëtare të Auditorit nuk përcakton se deri në cilën datë duhet të publikohet në faqen e internetit raporti vjetor i performancës së ZKA-së, duke përfshirë pasqyrat financiare të audituara, udhëzimet dhe rregulloret e brendshme dhe informacione të tjera në lidhje me administratën e Zyrës, aktivitetet dhe llogaridhënien e saj;⁴⁸ megjithatë, publikimi proaktiv i të gjitha dokumenteve publike brenda 15 ditëve nga hyrja në fuqi e tyre është e obliguar me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike.⁴⁹

**INDIKATORI 9.2.2
TRANSPARENCA
(NË PRAKTIKË)**

100/100



Publiku është në gjendje të marrë lehtësisht informacionin përkatës për organizimin dhe funksionimin e ZKA-së, për vendimet që kanë të bëjnë me të dhe si merren këto vendime, si dhe raporte dhe informacione shtesë për aktivitetet e institucionit.

Në vitin 2021 dhe 2020, të gjitha dokumentet e kërkuara ligjërisht janë publikuar me kohë në faqen e internetit.⁵⁰ ZKA-ja publikon raportet vjetore të auditimit, raportet e rregullta të auditimit të të gjitha organizatave buxhetore, raportet e auditimit të menaxhmentit, raportet e auditimit të performancës dhe raportet e ZKA-së. ZKA-ja gjithashtu publikon planet e veprimit të dërguara nga organizatat buxhetore në përgjigje të çështjeve të ngritura nga auditori. Faqja zyrtare e ZKA-së⁵¹ përditësohet rregullisht me dokumente të reja që do të publikohen dhe është e qasshme për të gjithë.

Raporti Vjetor i Auditimit 2021 përmban informacion të detajuar për sa vijon: auditimin dhe llogaridhënien e jashtme; raportin vjetor financiar të buxhetin e Kosovës dhe llogaridhënien e qeverisë; menaxhimin dhe kontrollin financiar; dhe ekzekutimin e buxhetit të sektorit publik. Ky raport u drejtohet deputetëve të Kuvendit.⁵²

Raporti Vjetor i ZKA-së përbëhet nga pesë kapituj që shtellojnë: (1) kornizën ligjore dhe qeverisjen e brendshme; (2) fushëveprimin e punës, cilësinë e auditimit dhe raportimit; (3) menaxhimin financiar dhe administrativ; (4) komunikimin dhe



bashkëpunimin me palët e jashtme; dhe 5) llogaridhënien dhe aktivitetet e planifikuara të ZKA-së për vitin e ardhshëm të periudhës raportuese. Raporti ofron informacion të hollësishëm në lidhje me aktivitetet e ZKA-së për secilën nga kategoritë e lartpërmendura.⁵³

Për më tepër, në vitin 2021, ZKA-ja lansoi një platformë digjitale rekomandimesh ku publiku mund të shohë në kohë reale çështjet e ngritura, rekomandimet e bëra dhe shkallën e realizimit (shih 9.3.3).⁵⁴

**INDIKATORI 9.2.3
LLOGARIDHËNIA
(SIPAS LIGJIT)**

75/100



Ekzistojnë dispozita të shumta ligjore që sigurojnë që ZKA-ja duhet t'i përgjigjet Kuvendit për veprimet e saj, dhe në veçanti Komisionit të Financave Publike.⁵⁵ Megjithatë, nuk ka asnjë mekanizëm për të apeluar vendimin e ZKA-së për subjektet e audituara, përveçse duke shtuar komente në raportin përfundimtar.

Si organ i pavarur, Auditori i Përgjithshëm i raporton Kuvendit të Kosovës për aktivitetet e veta si dhe për performancën financiare të institucioneve publike në Kosovë.⁵⁶ Baza ligjore për llogaridhënie është pasqyruar edhe në ligjin aktual për Auditorin e Përgjithshëm dhe ZKA-në, i miratuar në vitin 2016.

Këto dispozita përfshijnë kërkesën që ZKA-ja të nxjerrë pasqyra financiare vjetore dhe raporte vjetore të performancës që përfshijnë opinionet e dhëna nga auditori i jashtëm. Auditori i jashtëm zgjidhet nga Kuvendi.⁵⁷

Raportimi i ZKA-së në Kuvendin e Kosovës është obligim kushtetues⁵⁸ sipas të cilit ky institucion është i detyruar t'i paraqesë Kuvendit një raport për zbatimin e buxhetit të shtetit.



Auditori i Përgjithshëm gjithashtu duhet t'i paraqesë Kuvendit raport vjetor për veprimtarinë e tij brenda katër muajve nga fundi i vitit fiskal,⁵⁹ si dhe informacione për rezultatet e auditimeve sa herë që ato kërkojnë nga Kuvendi.⁶⁰ Ndërkohë, ligji për menaxhimin e financave publike dhe llogaridhënien⁶¹ përcakton se përmbajtja e raporteve të auditimit për institucionet publike⁶² i dorëzohet Kuvendit dhe institucionit të audituar⁶³ jo më vonë se 90 ditë pas auditimit të Pasqyrave Vjetore Financiare përfundimtare të institucionit.

Megjithatë, nuk ka asnjë organ administrativ ku subjektet e audituara mund të apelojnë gjetjet e ZKA-së ose që trajton ankesat në lidhje me aktivitetet e ZKA-së. Institucionet e audituara që nuk pajtohen me opinionin e auditorit mund t'i dërgojnë auditorit komentet e tyre vetëm brenda 15 ditëve dhe ato do t'i bashkëngjiten raportit.⁶⁴

**INDIKATORI 9.2.4
LLOGARIDHËNIA
(NË PRAKTIKË)**

75/100



Dispozitat ligjore janë efektive për të garantuar që Zyra Kombëtare e Auditimit të raportojë dhe të jetë përgjegjëse për veprimet e saj në praktikë. Megjithatë, për shkak të një zbrastënie në ligjin e ZKA-së, nuk ka mekanizma që garantojnë të drejtën e institucioneve të audituara për të apeluar gjetjet e ZKA-së.

Në vitin 2021, Zyra Kombëtare e Auditimit u bë anëtare e INTOSAI-t dhe Organizatës Evropiane të Institucioneve Supreme të Auditimit (EUROSAI). Duke ndjekur standardet e anëtarësimit,⁶⁵ ky anëtarësim do të thotë që ZKA-ja operon në standarde të larta si qeverisja e mirë, rritja e transparencës dhe llogaridhënies dhe rritja e kompetencës profesionale.⁶⁶ ZKA-ja gjithashtu përfiton nga anëtarësimi në aspektin e avancimeve profesionale në hap me avancimet e institucioneve supreme të auditimit në nivel global.⁶⁷



Sipas Auditorit të Përgjithshëm, operacionet e ZKA-së vlerësohen vazhdimisht nga auditori i brendshëm, i cili vlerëson efikasitetin e sistemeve të brendshme.⁶⁸ Përveç kësaj, Kuvendi i Kosovës kontraktonte një auditor të jashtëm⁶⁹ i cili kërkohet të auditojë pasqyrat financiare vjetore të ZKA-së. Rezultatet e auditimit të jashtëm janë bashkangjitur raportit vjetor të performancës së ZKA-së.⁷⁰ Në vitin 2020,⁷¹ 2021⁷² dhe 2022⁷³ ZKA-ja përgatiti raportet vjetore të performancës dhe ia dërgoi Kuvendit brenda afatit prej katër muajsh nga fundi i vitit fiskal paraardhës.⁷⁴ Këto raporte janë shqyrtuar dhe diskutuar në Kuvend në nëntor 2021 dhe tetor 2022.

ZKA-ja gjithashtu i dërgoi me kohë Kuvendit për shqyrtim raportet e auditimit të vitit paraprak para datës 31 gusht. Kuvendi shqyrtonte raportin vjetor të auditimit gjatë seancës plenare. Raporti i fundit për vitin 2020 është shqyrtuar dhe miratuar nga Kuvendi më 30 korrik 2021, ndërsa Raporti Vjetor i Auditimit të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2021 është dorëzuar nga Auditori i Përgjithshëm në Kuvendin e Kosovës më 31 gusht 2022. Raportet e auditorit ndahen me të gjitha institucionet përkatëse, me ç'rast këto institucione kanë të drejtë të pranojnë ose kundërshtojnë këtë të fundit. Nuk ka asnjë organ administrativ ku subjektet e audituara mund të apelojnë gjetjet e ZKA-së. Kundërshtimet nga institucionet përkatëse i bashkëngjiten raportit përfundimtar të auditorit, me ç'rast përcaktohet edhe opinioni i auditorit.⁷⁵

**INDIKATORI 9.2.5
MEKANIZMAT E
INTEGRITETIT (SIPAS LIGJIT)**

100/100

Ekzistojnë dispozita ligjore gjithëpërfshirëse që synojnë të garantojnë integritetin e zyrtarëve të ZKA-së. Këto përfshijnë kodin e sjelljes, rregullat në lidhje me konfliktin e interesit, rregullat për dhuratat dhe mikpritjen, dhe kufizimet pas punësimit.

Kodi i Etikës dhe Sjelljes së ZKA-së bazohet në standardet e auditimit të INTOSAI-t të njohura ndërkombëtarisht. Ato



specifikojnë se si i gjithë stafi do t'i kryejë detyrat e tyre në mënyrë të pavarur dhe profesionale.

ZKA-ja ka miratuar kodin e etikës INTOSAI, mbi të cilin është zhvilluar kodi profesional i sjelljes dhe i cili duhet të zbatohet nga i gjithë stafi. Ky kod përputhet me kërkesat ligjore për të krijuar një Kod të Etikës dhe Sjelljes për punonjësit, bazuar në të njohurit ndërkombëtarisht⁷⁶ dhe kërkesat e Deklaratës së Limës, Deklaratës së Meksikës, si dhe nenit 12 të kërkesave ISSAI 130.⁷⁷ Në vitin 2022, ZKA-ja u pajis me një kod të ri etike që përmban katër pjesë kryesore: vlerat dhe parimet etike; rregullat e sjelljes; rreziqet dhe masat mbrojtëse; dhe monitorimin e etikës. Kodi i etikës dhe sjelljes së ZKA-së mbulon të gjitha dispozitat që lidhen me sjelljet joetike, duke përfshirë konfliktin e interesit, rregullat për dhuratat, punësimin dhe pavarësinë, dhe ushtrimin e detyrës në mënyrë profesionale, të paanshme dhe objektive.⁷⁸

Ligji i ZKA-së i detyron punonjësit e ZKA-së të mos kenë asnjë lidhje me partitë politike për të paktën tre vjet para angazhimit të tyre në këtë institucion, si dhe të mos krijojnë asnjë marrëdhënie pune me asnjë institucion që lidhet me veprimtarinë e ZKA-së për tre vjet pas largimit nga institucioni.⁷⁹

Ndërkohë, kodi i etikës i detyron punonjësit e ZKA-së të refuzojnë dhuratat ose shpërblimet që mund të ndikojnë ose duket se ndikojnë në pavarësinë dhe integritetin e tyre. Gjithashtu, audituesit duhet të shmangin të gjitha marrëdhëniet me menaxherët dhe stafin e subjekteve të audituara dhe me palët e tjera që mund të ndikojnë, komprometojnë ose kërcënojnë aftësinë e audituesve për të vepruar dhe duket se po veprojnë në mënyrë të pavarur.

Kodi i etikës gjithashtu përcakton qartë se auditorët nuk duhet të përdorin pozicionin e tyre zyrtar për qëllime private dhe duhet të shmangin marrëdhëniet që përfshijnë rrezikun e korrupsionit ose që mund të ngrenë dyshime për objektivitetin dhe pavarësinë e tyre, dhe ata nuk duhet të përdorin informacionin e mbledhur gjatë kryerjes së detyrave të tyre si një formë e sigurimit të përfitimeve personale për veten ose të tjerët.



**INDIKATORI 9.2.6
MEKANIZMAT E
INTEGRITETIT (NË PRAKTIKË)**

100/100

Ekziston një qasje gjithëpërfshirëse për garantimin e integritetit të anëtarëve të ZKA-së, e cila përfshin zbatimin efektiv të rregullave ekzistuese, hetime proaktive për shkeljet e supozuara, sanksionimin e sjelljes së keqe dhe trajnimin e rregullt të stafit për çështjet e integritetit.

Sipas Auditorit të Përgjithshëm, ligji për ZKA-në⁸⁰ dhe kodi i etikës⁸¹ dhe standardet e auditimit⁸² janë të zbatueshme në praktikë dhe garantojnë integritetin dhe sjelljen e duhur të stafit të ZKA-së. Personeli i ZKA-së është i njohur me kodin e etikës dhe sjelljes dhe e nënshkruan atë.⁸³ Gjithashtu, në baza vjetore, i gjithë personeli i ZKA-së i nënshtrohet një trajnimi rifreskues mbi kodin e etikës.⁸⁴ Para fillimit të një detyre individuale auditimi, stafi gjithashtu nënshkruan një dokument që konfirmon se nuk kanë ndonjë interes specifik në lidhje me projektin e caktuar.⁸⁵ Të njëjtën gjë e konfirmoi edhe drejtuesi i sindikatës së punëtorëve të ZKA-së.⁸⁶

ZKA-ja raportonte se ndaj punonjësve të saj janë marrë në disa raste masa për shkelje të kodit të etikës dhe sjelljes.⁸⁷ Sipas Auditorit të Përgjithshëm, në vitin 2022 ka pasur një shkelje të Kodit të Etikës së ZKA-së, Rregullores 04/2021 për Disiplinë dhe Ankesat e Personelit në ZKA, dhe individit është penalizuar me zbritje page për tre muaj rresht.⁸⁸ Deri më tani, nuk ka reagime të vërtetuara për raportet e ZKA-së, gjë që mund të jetë një tregues se mekanizmat ekzistues të integritetit funksionojnë mirë.

**INDIKATORI 9.2.7
GJINIA**

75/100

Protokollet dhe udhëzimet e ndjeshme gjinore ekzistojnë dhe zbatohen në mënyrë aktive, ka trajnime mbi protokollet e bazuara në gjini dhe gjithashtu Kodin e Etikës dhe Sjelljes, dhe mekanizmi i ankesave ka personel femra që trajtojnë këto çështje. Në planin e saj për 2022-2023, ajo ka vendosur barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave në fokusin e auditimeve të performancës.⁸⁹

Kryetarja e komisionit të ankesave është grua.⁹⁰ Sipas Auditorit të Përgjithshëm, protokollet për trajtimin e çështjeve të ngritura nga gratë kanë dispozita të veçanta që janë të ndjeshme ndaj gjinisë.⁹¹ Gjithashtu, këto protokolle ofrojnë udhëzime të veçanta se si të trajtohen çështjet ose ankesat e paraqitura nga gratë, të cilat mund të jenë të një natyre të ndjeshme si ngacmimi seksual.⁹² Megjithatë, ZKA-ja deri më tani nuk ka prodhuar të dhëna të ndara sipas gjinisë për ankesat e marra.⁹³

Në kuadër të trajnimit vjetor për kodin e etikës dhe sjelljes, ZKA-ja trajton edhe çështjen e sjelljes profesionale dhe etikës së punës.⁹⁴ Përveç Auditorit të Përgjithshëm, mbi 50 për qind e stafit të ZKA-së janë gjithashtu gra.⁹⁵ Gjithashtu, komisioni për shqyrtimin e ankesave të punëtorëve përbëhet nga më shumë se 50 për qind gra.

Në vitin 2023, ZKA-ja nënshkroi një marrëveshje me Institucionet Supreme të Auditimit të Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut për realizimin e auditimit të përbashkët të performancës me temën: "Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave në zonat rurale nëpërmjet përfshirjes së tyre në tregun e punës" për periudhën 2019-2023.⁹⁶ Përveç kësaj, ZKA-ja u zotua të përfshijë buxhetimin gjinor në procedurat e tyre të auditimit.⁹⁷





Roli

**INDIKATORI 9.3.1
AUDITIMET FINANCIARE
EFEKTIVE**

75/100



Zyra Kombëtare e Auditimit ka autoritet të plotë për të mbikëqyrur të gjitha operacionet financiare publike⁹⁸ dhe gjithmonë raporton rezultatet e auditimit në Kuvend. Megjithatë, ndikimet mjedisore nuk vlerësohen gjithmonë.

Zyra Kombëtare e Auditimit kontrollon edhe funksionimin e njësisë së auditimit të brendshëm⁹⁹ të institucionit përkatës si pjesë e auditimit të rregullt.¹⁰⁰ Përveç 90 auditimeve rregullative, gjatë sezonit të auditimit 2021/2022, ZKA-ja kreu gjithashtu auditime të rregullsisë në 12 ndërmarje shtetërore (shih 15.2.4), si dhe 13 projekte të udhëhequra nga degë të ndryshme të qeverisë të financuara nga Banka Botërore dhe donatorë të tjerë.¹⁰¹ Më pas, ZKA-ja ka kryer edhe auditimin e raportit financiar vjetor të buxhetit të Republikës së Kosovës, si dhe tri raporteve të auditimit të pajtueshmërisë, dy prej të cilave janë raporte me informacion të klasifikuar (niveli i klasifikimit – i kufizuar) si dhe 14 auditime¹⁰² të performancës të cilat janë të një rëndësie të veçantë dhe sipas Auditorit të Përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme.¹⁰³

Të gjitha raportet e auditorit janë të përditësuara dhe në përputhje me manualin e auditimit bazuar në natyrën e auditimit¹⁰⁴ dhe janë paraqitur në Kuvendin e Kosovës.¹⁰⁵

Zyra Kombëtare e Auditimit kishte kryer disa auditime të investimeve me ndikim në mjedis.¹⁰⁶ Megjithatë, raportet e auditimit të performancës nuk trajtojnë ndikimin mjedisor

dhe klimatik të shpenzimeve dhe projekteve publike, përveç rasteve kur ndikimi mjedisor dhe klimatik i nënshtrohet auditimit.¹⁰⁷

Sipas Auditorit të Përgjithshëm, ZKA-ja i ka dërguar rekomandim legjislativ për heqjen e kërkesës për auditime vjetore të rregullsisë të të gjitha organizatave buxhetore, me qëllim që të reduktohen auditimet e detyrueshme të institucioneve të vogla dhe të alokohen burime për rritjen e auditimeve të performancës, gjë që do të rriste efektivitetin e ZKA-së në këtë drejtim. Aktualisht ligji për ZKA-në është në proces rishikimi.¹⁰⁸

**INDIKATORI 9.3.2 ZBULIMI
DHE SANKSIONIMI I
SHKELJEVE**

75/100



ZKA angazhohet në zbulimin dhe hetimin e sjelljes së keqe; megjithatë, sanksionimi i veprimeve të tilla është i kufizuar për shkak të kompetencave të kufizuara në drejtim të hetimit dhe sanksionimit të sjelljeve të pahijshme të cilat bien nën përgjegjësinë e autoriteteve të tjera.

ZKA mund të kryejë, në çdo kohë auditimin e punës së çdo institucioni publik.¹⁰⁹ ZKA ka mekanizma adekuat për të identifikuar sjelljet joadequate në menaxhimin financiar.¹¹⁰ ZKA-ja ka autoritetin ligjor për të hetuar mospajtueshmërinë ligjore. Megjithatë, nëse identifikohet mos pajtueshmëri financiare dhe ligjore,¹¹¹ gjetjet e saj i dërgohen Prokurorit të Shtetit,¹¹² i cili ka mandat të hetojë më tej dhe të vërtetojë shkaqet e sjelljes së keqe në menaxhimin financiar.¹¹³



Në vitin 2019, Zyra Kombëtare e Auditimit themeloi një njësi speciale e cila ka për detyrë të analizojë gjetjet e auditorit dhe t'i krahasojë ato me Kodin Penal dhe Civil të Republikës së Kosovës.¹¹⁴ Të gjeturat e vërtetuara i janë përcjellë Prokurorit të Shtetit dhe Prokurorive Themelore përkatëse. Gjatë auditimeve 2019-2021, ZKA-ja ka dërguar gjithsej 158 lëndë në Prokurori.¹¹⁵ Në vitin 2022 janë dërguar 76 lëndë në Prokurori.¹¹⁶

Zyra Kombëtare e Auditimit nuk ka mandat ligjor për të përcaktuar sanksionet e zbatueshme. Vendimet për sanksionet dhe masat kundër shkeljeve të bazuara mbeten përgjegjësi e gjykatave përkatëse.¹¹⁷

**INDIKATORI 9.3.3
PËRMIRËSIMI I MENAXHIMIT
FINANCIAR**

75/100



ZKA bën rekomandime të hollësishme, të bazuara mirë dhe realiste se si të përmirësohet menaxhimi financiar dhe qeveria i ndjek në mënyrë efektive për të siguruar zbatimin e tyre. Megjithatë, zbatimi mbetet i ulët dhe ka mungesë të identifikimit të shkaqeve rrënjësore për çështjet që ZKA gjen vazhdimisht.

Gjatë auditimit të pasqyrave financiare të vitit fiskal 2020, ZKA-ja ka dhënë 654 rekomandime, nga të cilat janë adresuar vetëm rreth 50 për qind, që shënon një rritje krahasuar me 45 për qind të rekomandimeve të adresuara një vit më parë.¹¹⁸

Për të paraqitur një pamje më të mirë të statusit të zbatimit të rekomandimeve të auditorit, ZKA-ja lansoi një platformë rekomandimi digjitale në vitin 2021, e cila është e disponueshme për publikun dhe tregon statusin e gjetjeve¹¹⁹ (shih 9.2.2).

Megjithatë, zbatimi mbetet i ulët, gjë që mund të shpjegohet me mungesën e një organi administrativ¹²⁰ për të hetuar dhe sanksionuar plotësisht çështjet e përsëritura, ose me dështimin për të adresuar rekomandimet (shih 9.3.2). Pas përfundimit të auditimit, institucioni i audituar është i detyruar të paraqesë një plan veprimi.¹²¹ Përveç publikimit të këtyre planeve të veprimit në ueb faqen e ZKA-së, realizimi i këtyre planeve i përcillet secilit prej institucioneve të audituara dhe Kuvendit dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike në mënyrë periodike, çdo tre muaj nga ZKA.¹²²

ZKA analizon çështjet e njëjta apo të ngjashme të identifikuar brenda kategorive buxhetore dhe u jep rekomandime Kuvendit dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës. Në vitin 2021, këto përfshinin çështje të tilla si zbatimi i dobët i buxhetit të investimeve kapitale, shqetësimet për pagesat përmes procedurave përmbarimore dhe vonesat në pagesa.¹²³ Megjithatë, ZKA nuk analizon çështjet e ngritura sistematikisht me organizatat buxhetore ndër vite dhe analizën e shkakut rrënjësor të problemit. Kjo nuk ka ndryshuar që nga viti 2021.

Raportet e ZKA-së merren si pikë referimi nga komisionet përgjegjëse të Kuvendit të Kosovës dhe përdoren si bazë për thirrjet për raporte nga organizatat buxhetore.





Ndërveprimet

Zyra Kombëtare e Auditimit ka detyrimin ligjor të bashkëpunojë me institucione dhe organizata të ndryshme në fushat që lidhen me auditimin apo zhvillimin profesional, firmat e kualifikuara apo çdo Institucion tjetër të Lartë të Auditimit për t'i ndihmuar në kryerjen e çdo detyre të Zyrës së Auditimit dhe Gjykatës Evropiane të Auditorëve dhe Institucionet Supreme të Auditimit të vendeve të huaja dhe të përfaqësojnë Kosovën në INTOSAI. Një nga bashkëpunimet më të ngushta është me Kuvendin e Republikës së Kosovës.¹²⁴

Krahas këtyre detyrimeve ligjore, në kuadër të forcimit të mekanizmave dhe përpjekjeve në luftën kundër korrupsionit, ZKA ka një memorandum bashkëpunimi me Prokurorin e Shtetit, ku përgatiten dhe dorëzohen raste të dyshuara për korrupsion gjatë proceseve të auditimit të organizatave buxhetore në prokurori. Gjatë auditimeve 2019-2021, ZKA-ja ka dërguar gjithsej 158 lëndë në Prokurori. Në vitin 2022 janë dërguar 76 lëndë në Prokurori.¹²⁵

ZKA ka një marrëveshje bashkëpunimi edhe me Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik, ku i është dhënë qasje e veçantë në platformën e Prokurimit elektronik për të shmangur vonesat në qasjen e informacionit gjatë auditimit të prokurimit publik.¹²⁶ ZKA gjithashtu ka një marrëveshje jozyrtare me Agjencinë e Informacionit dhe Privatësisë për qëllime me interes të përbashkët në drejtim të promovimit të transparencës dhe të drejtës për informacion.¹²⁷ Auditori i Përgjithshëm gjithashtu ka kërkuar nga Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit që të krijojë një lidhje bashkëpunimi, por kjo ende nuk është zyrtarizuar.¹²⁸

Në funksion të avancimit profesional, ZKA ka marrëdhënie të vazhdueshme bashkëpunimi me Kontrollin e Lartë të Shtetit të Republikës së Shqipërisë (KLSH),¹²⁹ Zyrën Kombëtare të Auditimit të Suedisë¹³⁰ dhe Helvetas.¹³¹ Në lidhje me kontributin në luftën kundër korrupsionit, ZKA ka një marrëdhënie të vazhdueshme bashkëpunimi me USAID¹³² dhe UNDP.¹³³

Këto bashkëpunime ndërinstitucionale kanë rezultuar që Zyra Kombëtare e Auditimit të Kosovës të vlerësohet me besueshmërinë më të lartë në mesin e institucioneve të auditimit në rajon.¹³⁴

Rekomandimet e shtyllës

- Qeveria e Kosovës duhet:
 - Të bëjë përshtatjet e nevojshme ligjore për krijimin e mekanizmave, përfshirë organin administrativ, rolet dhe procedurat, që do të trajtonin sanksionet dhe masat ndëshkuese për çështjet sistematike të identifikuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit dhe rekomandimet e pa adresuara.
 - Të bëjë përshtatjet e nevojshme ligjore për krijimin e mekanizmave, përfshirë organin administrativ, rolet dhe procedurat, ku palët e audituara mund të apelojnë gjetjet e raportuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.
 - Analizojë tregun vendor të punës për kategorinë e auditorëve dhe përafrojnë ofertën e saj me normën e tregut privat për të garantuar cilësinë e kandidatëve si dhe stabilitetin e punësimit.
- Zyra Kombëtare e Auditimit duhet:
 - Të sigurojë përbushjen e detyrimeve të ligjit për barazi gjinore gjatë të gjitha auditimeve të organizatave buxhetore.
 - Të vlerësojë çështjet sistematike në nivel lokal dhe kombëtar, me synimin për të identifikuar shkakun rrënjësor të problemit dhe për të kontribuar në përmirësimin e proceseve dhe praktikave publike në menaxhimin e financave publike.
 - Të ndryshohet Ligji për Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm për të kufizuar diskrecionin e Presidentit për të emëruar më shumë se një komision për përzgjedhjen e kandidatit për Auditor të Përgjithshëm, duke krijuar kështu mundësi për të zgjedhur nga kandidatët e ndryshëm dhe për të përcaktuar qartë procedurat për rekrutim të bazuar në merita Auditorin e Përgjithshëm dhe llogaridhënie për anulimin e kritereve të përcaktuara.



REFERENCAT

- 1 Kushtetuta e Kosovës, neni 136.
- 2 Ligji për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, (05/L-055), <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12517>
- 3 Barometri Ballkanik 2022, Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal, korrik 2022: <https://zka-rks.org/en/news/the-national-audit-office-of-kosovo-is-the-most-trusted-among-the-audit-institutions-in-the-region/>
- 4 "Në Kosovë, por edhe ndërkombëtarisht, Zyra Kombëtare e Auditimit ka krijuar një reputacion të mirë të profesionalizmit. Kjo është një trashëgimi që ia vlen të respektohet dhe të vazhdojë". Deklarata e Tomáš Szunyog, Shefi i Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë dhe Përfaqësuesi Special i BE-së, 18 tetor 2021: <https://zka-rks.org/news/shefi-i-zyres-se-be-se-uron-auditorin-e-pergjithshme-thote-se-zka-ja-ka-krijuar-nje-reputacion-te-mire-te-profesionalizmit/>
- 5 *Kosova—Komunitet transparent, efektive dhe të përgjegjshme (EKIPI i USAID-it), përmbledhje e projektit*: <https://www.dai.com/our-work/projects/kosovo-transparent-effective-and-accountable-municipalities-team>
- 6 Ligji Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, neni 18.
- 7 Ligji Nr. 08/L-066 për ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, shtojca 1. Buxheti për vitin 2022 dhe Parashikimet për 2023-2024
- 8 Ligji Nr. 07/L-0041 për ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, shtojca 1. Buxheti për vitin 2021 dhe Parashikimet për 2021-2023
- 9 Ligji Nr. 07/L-001 për ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, faqe 50
- 10 Ministria e Financave, Ligjet për Buxhetin për 2019 – 2023 <https://mf.rks-gov.net/page.aspx?id=2.16>
- 11 Intervistë me Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme, Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, 25 gusht 2022.
- 12 Intervistë me Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme, Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, 25 gusht 2022.
- 13 Po aty
- 14 Raporti vjetor i performancës 2021, Zyra Kombëtare e Auditimit, f. 51 https://zka-rks.org/wp-content/uploads/2022/04/ZKA_RVP_2021_Shqip.pdf
- 15 ¹⁰ Intervistë me Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme, Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, 25 gusht 2022.
- 16 Raportet Vjetore të Performancës së ZKA-së 2017 - 2021, <https://zka-rks.org/per-ne/raportet/>
- 17 Intervistë me Ernest Bekën, Kryetar i Sindikatës së Punëtorëve të ZKA-së, Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, 25 gusht 2022.
- 18 Raporti vjetor i performancës 2021, Zyra Kombëtare e Auditimit, f. 54 https://zka-rks.org/wp-content/uploads/2022/04/ZKA_RVP_2021_Shqip.pdf
- 19 Intervistë me Ernest Bekën, Kryetar i Sindikatës së Punëtorëve, Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, 25 gusht 2022.
- 20 Rregullorja (ZKA) Nr. 01/2021 për klasifikimin e vendeve të punës në Zyrën Kombëtare të Auditimit; Kapitulli III
- 21 Raporti Vjetor i ZKA-së 2021, fq. 54 Zhvillimi profesional dhe trajnimi i stafit, https://zka-rks.org/wp-content/uploads/2022/04/ZKA_RVP_2021_Shqip.pdf
- 22 Kushtetuta e Kosovës, neni 136.
- 23 Ligji Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës
- 24 Kushtetuta e Kosovës, neni 136 dhe 137
- 25 Kushtetuta e Kosovës, neni 138.
- 26 Ligji Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, neni 20.
- 27 Ligji Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, neni 13.
- 28 Raporti Vjetor i Performancës i ZKA-së 2021, fq. 14, https://zka-rks.org/wp-content/uploads/2022/04/ZKA_RVP_2021_Shqip.pdf
- 29 Kushtetuta e Kosovës, neni 136 dhe 137
- 30 Ligji Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, neni 4.
- 31 Ligji Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, neni 4.4.
- 32 Ligji Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, neni 9.
- 33 Rregullorja (ZKA) Nr. 01/2021 për klasifikimin e vendeve të punës në Zyrën Kombëtare të Auditimit; Kapitulli III
- 34 Ligji Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, neni 4.4.
- 35 Ligji Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, neni 4.
- 36 Ligji Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, neni 17.1.
- 37 Auditori mund të shkarkohet nëse për një periudhë prej gjashtë (6) muajsh ai ose ajo nuk është në gjendje të kryejë detyrat e tij, për shkak të sëmundjes fizike ose mendore, shkeljes së kodit të etikës ose krijimit për çdo rrethanë që mund të ndikojë në aftësinë e tyre për të kryer këto detyra, të tilla si shpallja fajtor për një veprë penale dhe dënimi me burg, ose nëse auditori bëhet i paaftë për pagim ose kërkon të përfitojë nga ndonjë ligj ose rregull për shkarkimin e të falimentuarit ose debitorët e falimentuar. Shih: Ligji Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, neni 4.13.
- 38 Ligji Nr. 03/L-212 për Punën.
- 39 Ligji Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, neni 27.
- 40 Gazeta Ndërkombëtare e Auditimit të Qeverisë, Vlora Spanca Emërohet Auditor i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës, <https://intosajournal.org/vlora-spanca-appointed-auditor-general-of-the-republic-of-kosovo/> [qasur më 12 janar 2023]
- 41 Ligji Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, neni 4.4.





42 Hollësi nga konkursi për Auditorin e Përgjithshëm, Kallxo.com <https://kallxo.com/gjate/detaje-nga-gara-per-auditor-te-pergjithshem/>

43 Vlora Spanca zgjidhet Auditore e Përgjithshme, opozita thotë se është motra e këshilltares së kryeministrit, Kallxo.com. 12.8.2021 <https://kallxo.com/lajm/vlora-spanca-zgjidhet-auditore-e-pergjithshme-opozita-thote-se-eshte-motra-e-keshilltares-se-kryeministrit/>

44 Ligji Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, neni 7.

45 Ligji Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, neni 3.1.12

46 Ligji Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, neni 23.1.

47 Ligji Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, neni 23.6.

48 Ligji Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, nenet 7 dhe 23.6; Ligji nr. 03/048 për menaxhimin dhe përgjegjësinë e financave publike, neni 47.4; Udhëzimi Administrativ (UA) nr. 01/2015 në ueb faqet e institucioneve publike Neni 9 Ligji nr. 06/L-081 për qasje në dokumente publike, kreu II

49 Ligji Nr.06/L-081 për Qasje në dokumente publike, neni 6.

50 Ibid

51 Faqja zyrtare e ZKA-së: <https://zka-rks.org/>

52 Raporti Vjetor i Auditimit të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2021, Zyra Kombëtare e Auditimit http://zka-rks.org/wp-content/uploads/2022/08/RaportiVjetoriAuditimit_2021_Shqip.pdf

53 Ibid

54 Sistemi i monitorimit të rekomandimeve, Zyra Kombëtare e Auditimit, <http://rekomandimet.zka-rks.org:3000/portal/retracking?lang=SQ>

55 Ligji Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, neni 4.

56 Ligji Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, neni 4; Ligji Nr. 03/L-048 për menaxhimin dhe llogaridhënien e financave publike, Kapitulli II Auditimi i Jashtëm

57 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 136.

58 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 138, pika 1.

59 Ligji Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, neni 14.

60 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 138.

61 Ligji Nr. 03/L-048 për menaxhimin dhe llogaridhënien e financave publike, Kapitulli II Auditimi i jashtëm

62 Ligji Nr. 03/L-048 për menaxhimin dhe llogaridhënien e financave publike, Pjesa VIII Raportimi, kontabiliteti dhe auditimi

63 Ligji Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, neni 23.2.

64 Ligji Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, neni 22.2.

65 INTOSAI <https://www.intosai.org/focus-areas/audit-standards>

66 Gazeta Ndërkombëtare e Auditimit të Qeverisë, Dimër 2019, <http://intosaijournal.org/knao-pledges-active-participation/>

67 Po aty

68 Intervistë me Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme, Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, 25 gusht 2022.

69 d.m.th. kontrata trevjeçare e Kuvendit Nr. 101-22-3756-2-2-1/C85 me "Universum Audit Sh.p.k." për Auditimin e pasqyrave financiare të ZKA-së për vitin 2021, 2022, 2023, dhënë në qershor 2022; <https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/ClanakItemNew.aspx>

70 Raporti vjetor i performancës 2022, Zyra Kombëtare e Auditimit, fq. 80 – 104; https://zka-rks.org/wp-content/uploads/2023/05/ZKA_RVP_2022_Shqip-1.pdf

71 Dërguar në Kuvendin e Kosovës më 30 prill 2021

72 Dërguar në Kuvendin e Kosovës më 29 prill 2022

73 Dërguar në Kuvendin e Kosovës më 4 maj 2023

74 Ligji Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, neni 14.2.

75 ISSAI 200

76 Ligji Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, neni 16.1.

77 Kodi i Etikës dhe Sjelljes, 22 korrik 2022, Zyra Kombëtare e Auditimit; https://zka-rks.org/wp-content/uploads/2018/02/719_KodiEtik_Shqip.pdf

78 Kodi i Etikës së ZKA-së, 2022; https://zka-rks.org/wp-content/uploads/2018/02/719_KodiEtik_Shqip.pdf

79 Ligji Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, neni 17.

80 Ligji Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës

81 Kodi i Etikës i Zyrës Kombëtare të Auditorit 2022 https://zka-rks.org/wp-content/uploads/2018/02/719_KodiEtik_Shqip.pdf

82 http://oag-rks.org/repository/docs/Code_of_Ethics_and_Auditing_Standards_-ONTOSAI_970836.pdf

83 Intervistë me Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme, Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, 25 gusht 2022.

84 Po aty

85 Po aty

86 Intervistë me Ernest Bekën, Kryetar i Sindikatës së Punëtorëve të ZKA-së, Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, 25 gusht 2022.

87 Intervistë me Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme, Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, 25 gusht 2022.

88 Përgjigja ndaj kërkesës për qasje në informacionin publik, marrë nga Zyra Kombëtare e Auditimit më 9 mars 2023

89 Plani i Auditorit për auditimet 2022-2023: Auditimet e performancës: Mirëqenia sociale: Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i grave dhe vajzave

90 Po aty

91 Intervistë me Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme, Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, 25 gusht 2022.

92 Rregullore mbi punën dhe përgjegjësitë e Komisionit për Etikën dhe Sjelljen, Përgjigje ndaj FOIA 9 mars 2023

93 Intervistë me Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme, Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, 25 gusht 2022.

94 Kodi i Etikës së ZKA-së 2022; shih https://zka-rks.org/wp-content/uploads/2018/02/719_KodiEtik_Shqip.pdf



95 Raporti vjetor i performancës 2021, Zyra Kombëtare e Auditimit, f. 52 https://zka-rks.org/wp-content/uploads/2022/04/ZKA_RVP_2021_Shqip.pdf

96 Nënshkruhet marrëveshja trepalëshe për auditimin e përbashkët të performancës «Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave në zonat rurale nëpërmjet përfshirjes së tyre në tregun e punës»; Shiko <https://zka-rks.org/news/39802/>

97 Auditori i Përgjithshëm është i përkushtuar që buxheti dhe auditimet e përgjegjshme gjinore në këtë fushë të jenë prioritet; Shiko <https://zka-rks.org/news/auditorja-e-pergjithshme-angazhohet-qe-buxhetimi-i-pergjegjshem-gjinor-dhe-auditimet-ne-kete-fushe-te-jene-me-prioritet/>

98 Ligji nr. 03/048 për Menaxhimin dhe përgjegjësinë e financave publike, nenet 44, 47, 48, 73, 75

99 Ligji Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, neni 3. paragrafi 1.1

100 Raporti Vjetor i Auditimit të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2021, Zyra Kombëtare e Auditimit https://zka-rks.org/wp-content/uploads/2022/08/RaportiVjetoriAuditimit_2021_Shqip.pdf

101 Raporti vjetor i performancës 2021, Zyra Kombëtare e Auditimit, f. 52 https://zka-rks.org/wp-content/uploads/2022/04/ZKA_RVP_2021_Shqip.pdf

102 Po aty

103 Intervistë me Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme, Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, 25 gusht 2022.

104 Parimet e Administratës Publike, Raporti Monitorues i Kosovës, SIGMA OECD 2021, fq. 169 <https://www.sigmaxweb.org/publications/Monitoring-Report-2021-Kosovo.pdf>

105 Zyra Kombëtare e Auditimit, Publikime, <https://zka-rks.org/en/publications/>

106 Sistemi i licencimit të hidrocentraleve dhe monitorimi i ndikimit të tyre në mjedis dhe ujë (2022), programi mjedisor i Kosovës 2021, grumbullimi, trajtimi dhe deponimi i mbeturinave komerciale (2021); Procesi i licencimit të përdoruesve të mineraleve ndërtimore dhe industriale dhe mbrojtja e mjedisit nga ky aktivitet (2020)

107 Po aty

108 Intervistë me Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme, Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, 25 gusht 2022.

109 Ligji Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, neni 18.

110 Rregullorja (ZKA) Nr. 01/2021 për klasifikimin e vendeve të punës në Zyrën Kombëtare të Auditimit; neni 21

111 Ligji nr. 03/048 për Menaxhimin dhe përgjegjësinë e financave publike, neni 73

112 Ligji Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, neni 24.

113 Ligji Nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-034 dhe Ligjin Nr. 06/L-025, neni 7

114 Video e rezultateve të projektit TEAM të USAID-it në Kosovë, sek 0:47; <https://www.dai.com/news/usaid-extends-anticorruption-efforts-in-kosovo-under-new-project>

115 Përgjigja e kërkesës për qasje në informacionin publik, marrë nga Zyra Kombëtare e Auditimit më 21 gusht 2022.

116 Intervistë me Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme, Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, 25 gusht 2022.

117 Kodi nr. 06/L-074 - Kodit Penal i Republikës së Kosovës

118 Raporti Vjetor i Auditimit të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2021, f.8, 84 Zyra Kombëtare e Auditimit https://zka-rks.org/wp-content/uploads/2022/08/RaportiVjetoriAuditimit_2021_Shqip.pdf

119 Baza e të dhënave të rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm; <http://rekomandimet.zka-rks.org:3000/portal/retracking?lang=SQ>

120 Menaxhimi i financave publike nga këndvështrimi i Auditorit Kombëtar, Fq. 11, KDI 2018, <https://kdi-kosova.org/wp-content/uploads/2019/01/81-Menaxhimi-i-parasë-publike-në-sytë-e-Auditorit-ALB-01.pdf>

121 Ligji Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, neni 23. paragrafi 5

122 <http://rekomandimet.zka-rks.org:3000/portal/retracking?lang=SQ>

123 Raporti Vjetor i Auditimit të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2021, Zyra Kombëtare e Auditimit https://zka-rks.org/wp-content/uploads/2022/08/RaportiVjetoriAuditimit_2021_Shqip.pdf

124 ZKA ndau përvojën e saj të punës me parlamentin përpara komunitetit ndërkombëtar të auditimit, 16 dhjetor 2021 <https://zka-rks.org/news/zka-jandane-pervojen-e-saj-te-bashkepunimit-me-parlament-pre-the-international-auditing-community/>

125 Përgjigja e kërkesës për qasje në informacionin publik, marrë nga Zyra Kombëtare e Auditimit më 21 gusht 2022.

126 Zyra Kombëtare e Auditimit dhe Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik nënshkruajnë një memorandum bashkëpunimi për rritjen e llogaridhënies dhe transparencës në fushën e zbatimit të legjislacionit të prokurimit publik, 6 tetor 2022 <https://zka-rks.org/news/zyra-kombetare-e-audit-ing-and-the-regulatory-commission-of-public-procurement-sign-a-memorandum-of-cooperation-for-increasing-llogari-dhe-transparence-ne-fushen-e-aplikimit-te-legjislacionit-te-p/>

127 Auditori i Përgjithshëm dhe Komisioneri për Informacionin dhe Privatësinë pajtohen të rrisin bashkëpunimin ndërmjet institucioneve që ata drejtojnë (<https://zka-rks.org/news/auditorja-e-gjerjshme-dhe-commissionerja-per-informim-dhe-privacy-bien-okord-per-te-ritur-skepuninim-mes-institutuneve-qe-deheqin/>)

128 Auditorja e Përgjithshme përgëzon drejtorin e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit për marrjen e detyrës, shpreh përkushtimin për thellimin e bashkëpunimit ndërinstitucional, 12 janar 2022 <https://zka-rks.org/news/auditorja-e-pergjithshme-uron-drejtorin-e-Agency-against-corruption-for-taking-the-task-expresses-the-commitment-for-deepening-e-bashkepunimit-nderinstitucional/>

129 Spanca dhe Shehu zotohen për avancimin e bashkëpunimit mes dy institucioneve (<https://zka-rks.org/news/spanca-e-shehu-zotohen-per-avancim-te-bashkepunimit-ne-mes-te-dy-institucioneve/>)

130 Suedia dhe Kosova fillojnë dekadën e dytë të bashkëpunimit në fushën e Auditimit (<https://zka-rks.org/news/suedia-dhe-kosova-fillojne-dekaden-e-dyte-te-bashkepunimit-ne-fushen-e-auditimit/>)

131 ZKA dhe Helvetas janë të përkushtuara për intensifikimin e bashkëpunimit në përmirësimin e ofrimit të shërbimeve për qytetarët (<https://zka-rks.org/new/>)

132 ZKA dhe USAID avancojnë bashkëpunimin përmes projektit të ri 'Integriteti i Komunave të Kosovës' <https://zka-rks.org/news/zka-ja-dhe-usaid-i-avancojne-bashkepunimin-permes-projektit-on-the-new-integrity-of-the-municipalities-of-Kosovo/>

133 Zyra Kombëtare e Auditimit dhe UNDP bien dakord për bashkëpunim të mëtejshëm në luftën kundër korrupsionit <https://zka-rks.org/news/zyra-kombetare-e-auditimit-dhe-undp-dakordohen-per-bashkepunim-te-metejshem-in-the-war-against-corruption/>

134 Barometri Ballkanik 2022, Korrik 2022, Këshilli për Bashkëpunim Rajonal <https://www.rcc.int/balkanbarometer/home>




**AGJENCIA PËR
PARANDALIMIN
E KORRUPSIONIT**




PËRMBLEDHJE

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit është organ i pavarur dhe i specializuar për zbatimin e politikave shtetërore për parandalimin e korrupsionit në Kosovë. Që nga themelimi i saj, Agjencia ka luajtur një rol të rëndësishëm në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit në Kosovë.


71/100 Rezultati i përgjithshëm i shtyllës




Kapacitetet



Qeverisja



Roli





Struktura organizative e Agjencisë përcaktohet me rregulloren për organizimin e brendshëm, të cilën e miraton Drejtori i Agjencisë.¹ Sipas kësaj rregulloreje, struktura organizative e Agjencisë përbëhet nga Zyra e Drejtorit, katër departamente (Departamenti për Vlerësim, Monitorim dhe Analizë; Departamenti për Parandalimin e Konfliktit të Interesit; Departamenti për Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave; dhe Departamenti për Administratë dhe Shërbimet e Përgjithshme), divizionet, pastaj zyra për mbështetje dhe bashkëpunim profesional dhe zyra për marrëdhënie me publikun.² Drejtori i Agjencisë zgjidhet nga Kuvendi i Kosovës me konkurs publik, të shpallur dhe të udhëhequr nga Komisioni Parlamentar për Legjislacion. Megjithatë, zgjedhja e Drejtorit kërkon vetëm një shumicë të thjeshtë të votave.

Kuvendi i Kosovës miratoi ligjin e ri për Agjencinë në korrik të vitit 2022, duke i hequr kompetencat Agjencisë në lidhje me hetimet penale në luftën kundër korrupsionit. Agjencia tani ka juridiksion vetëm për të kryer aktivitete parandaluese dhe hetime administrative në lidhje me deklarin e pasurisë dhe konfliktin e interesit. Gjithashtu, derisa sipas ligjit të mëparshëm, Agjencia ishte përgjegjëse për hartimin e strategjisë kombëtare kundër korrupsionit dhe hartimin e planeve të integritetit, tani kjo përgjegjësi i ka kaluar qeverisë dhe Agjencia do të luajë rol mbikëqyrës dhe do të monitorojë zbatimin e këtyre planeve.³

Buxheti i Agjencisë është i mjaftueshëm për të kryer aktivitetet e saj; megjithatë, kompetencat shtesë të futura me ligjin e ri kanë krijuar nevojën për buxhet shtesë dhe rritje të stafit profesional. Në aspektin e transparencës, Agjencia ka bërë progres të vazhdueshëm duke pranuar kërkesat dhe duke ofruar informacione lidhur me hetimet dhe raportimet për zyrtarët lidhur me problemet me deklarin e pasurisë. Agjencia ka një kod etike për punonjësit e saj; megjithatë, ai nuk vlen për Drejtorin e Agjencisë. Agjencia ofron informacione përkatëse për operacionet e saj, dhe përderisa nuk janë raportuar shkelje të Kodit të Etikës, trajnimi për integritetin është i kufizuar. Nuk ka gjithashtu një protokoll specifik apo udhëzime të qarta për ndjeshmërinë gjinore, dhe ligjit i mungojnë dispozitat që përcaktojnë mekanizmat e ndjeshëm ndaj gjinisë.

Ndërsa Agjencia është përgjithësisht aktive dhe e suksesshme në aktivitetet parandaluese kundër korrupsionit, ligji i ri ka reduktuar funksionet e saj në lidhje me parandalimin e korrupsionit. Agjencia angazhohet në hartimin e legjislacionit dhe vlerësimin e rrezikut, duke promovuar bashkëpunimin me institucionet shtetërore dhe shoqërinë civile. Megjithatë, i mungon një njësi e dedikuar kërkimore dhe mbetet pjesë e Këshillit Kombëtar Kundër Korrupsionit që është joaktiv. Megjithëse është përgjegjëse për fushatat vetëdijesuese, përpjekjet e saj janë të kufizuara dhe të fokusuara në aspekte të veçanta, me fushata pothuajse inekzistente kohët e fundit.

Agjencia është aktive dhe deri diku e suksesshme në hetimin e rasteve të dyshuara për korrupsion, duke u fokusuar në hetimet administrative. Agjencia bashkëpunon me institucionet tjera të zbatimit të ligjit si Policia e Kosovës, Prokuroria dhe Gjykata në mënyrë stabile dhe pothuajse të përditshme. Sipas ligjit të ri, Prokurori i Shtetit duhet t'a njoftojë Agjencinë për çdo rezultat që ka arritur në lidhje me rastet dhe kallëzimet penale të dërguara nga Agjencia.



Kapacitetet

 **INDIKATORI 10.1.1 BURIMET (SIPAS LIGJIT)**

75/100



Ekzistojnë dispozita të mjaftueshme ligjore që i sigurojnë Agjencisë burimet për të kryer në mënyrë efektive detyrat e saj. Megjithatë, buxheti i Agjencisë i nënshtrohet kufirit buxhetor të përcaktuar nga Ministria e Financave dhe nuk ka ligj që i lejon Agjencisë të marrë fonde të tjera nga konfiskimi i aseteve.

Agjencia mund të propozojë buxhetin e saj, të cilin duhet t'ia dorëzojë qeverisë në projektbuxhetin vjetor, të cilin më pas e miraton Kuvendi i Kosovës.⁴ Megjithatë, Ministria e Financave mund të reduktojë ose të mos miratojë kërkesat e saj buxhetore, duke rezultuar në pavarësi të kufizuar buxhetore për Agjencinë.⁵ Ulja e buxhetit të Agjencisë mund të ndodhë me vendim të qeverisë në vitin pasues të rasteve kur Agjencia nuk e shfrytëzon plotësisht buxhetin e parashikuar.⁶

Agjencia nuk është e obliguar me ligj të konfiskojë pasurinë dhe për këtë arsye të ardhurat e saj arkëtohen ekskluzivisht nga buxheti i shtetit. Agjencia mund të shqiptojë gjopa penale për personat që nuk deklarojnë pasurinë deri në 500€, por ato mjete shkojnë në buxhetin e shtetit dhe nuk ndahen për nevojat e saj.⁷ Megjithatë, Agjencia mund të marrë fonde të tjera nga organizatat ndërkombëtare të cilat synojnë të forcojnë infrastrukturën e brendshme, duke përfshirë përmirësimin dhe digjitalizimin e punës së Agjencisë.⁸

 **INDIKATORI 10.1.2 BURIMET (NË PRAKTIKË)**

75/100



Agjencia ka burime të mjaftueshme për të përmbushur detyrimet e saj ligjore në praktikë. Megjithatë, shtimi i kompetencave të reja ligjore të Agjencisë për të vendosur sanksione për mosdeklarimin e pasurisë dhe për të kryer hetime administrative pas miratimit të ligjit të ri në korrik 2022 nuk është përkthyer në burime shtesë njerëzore dhe financiare. Për më tepër, në praktikë, Agjencia ka probleme me planifikimin e buxhetit dhe implementimin adekuat të tij.

Për vitin 2022, buxheti i ndarë për Agjencinë ishte 545,778€,⁹ që paraqet një rënie të vogël prej rreth 10,000€ krahasuar me buxhetin e vitit 2021. Në fund të vitit fiskal 2021, qeveria ka marrë fonde të papërdorura në shumën rreth 125 mijë euro, duke i kthyer ato në buxhetin e shtetit.¹⁰





Tabela 10.1 Buxheti vjetor i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, 2019-2023

Viti	Shuma në €	% rritje/ulje
2023	557,844	2.21
2022	545,778	-2.27
2021	558,470	12.06
2020	498,336	-6.92
2019	535,402	-

Burimet njerëzore kanë mbetur relativisht të qëndrueshme. Agjencia aktualisht ka 43 punonjës, vetëm tre më shumë se në vitin 2015.¹¹ Megjithatë, pas ndryshimeve të reja ligjore, Agjencia ka nevojë për burime njerëzore shtesë për të zbatuar plotësisht aktivitetin e saj në çështjet e mbikëqyrjes së legjislacionit anti-korrupsion, hartimit të planeve të integritetit dhe mbrojtjes së sinjalizuesve. Ekziston gjithashtu nevoja për të rekrutuar staf profesional administrativ në fushën teknologjike.

Agjencia ka autonomi në zhvillimin e procedurave të rekrutimit të personelit, të cilat kryhen sipas Ligjit për shërbyesit civilë. Ligji përcakton kritere të përgjithshme dhe specifike, në varësi të rolit, ku përfshihen përvoja e punës dhe diploma universitare, si dhe dëshmia që kandidati nuk është dënuar me vendim të formës së prerë për vepër penale.¹² Kandidatët nuk i nënshtrohen asnjë kursi ose trajnimi fillestar përpara se të bëhen staf i Agjencisë.¹³

Gjatë vitit 2021, Agjencia organizoi 20 sesione trajnimi për zyrtarët e saj lidhur me menaxhimin e administratës publike, karrierën në shërbimin civil, mbrojtjen e të dhënave personale, qasjen në dokumente publike dhe planet e integritetit.¹⁴ Agjencia nuk ofron shumë mundësi zhvillimi në karrierë për stafin, kryesisht për shkak të detyrave specifike të punës në institucion dhe emërimit të zyrtarëve me mandat të përhershëm.¹⁵ Në fakt, Agjencia nuk shqehet për avancim në karrierë, promovim të stafit apo avancim në detyrë.¹⁶

INDIKATORI 10.1.3 PAVARËSIA (SIPAS LIGJIT)

75/100

Rregullativa ligjore që garanton pavarësinë funksionale dhe institucionale të Agjencisë është e konsoliduar, por ka mangësi në përzgjedhjen e drejtorit, i cili zgjidhet me shumicë të thjeshtë në Kuvend.

Përderisa Kushtetuta e Kosovës mbulon institucionet e pavarura si KQZ-ja, Komisioni i Pavarur për Media apo Auditori i Përgjithshëm i Kosovës, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit nuk është pjesë e kornizës kushtetuese të institucioneve të pavarura, por ka status të pavarur juridik, duke mos qenë pjesë e ekzekutivit.¹⁷

Agjencia drejtohet nga Drejtori i saj, i cili nuk lejohet të ushrojë asnjë funksion tjetër dhe nuk mund të paguhet për de-



tyra të tjera nga buxheti i shtetit.¹⁸ Drejtori i Agjencisë zgjidhet me shumicë të thjeshtë në Kuvendin e Kosovës për një mandat pesëvjeçar, pa të drejtë rizgjedhjeje.¹⁹ Kriteret për zgjedhjen e Drejtorit janë të qarta dhe të bazuara në parimin e profesionalizmit.²⁰ Për të garantuar paanshmërinë dhe neutralitetin politik të Drejtorit, Drejtori nuk duhet të ketë ushtruar funksion në një parti politike dhe nuk duhet të jetë zgjedhur në institucione legjislative ose ekzekutive në nivel qendror ose lokal në gjashtë vitet e fundit.²¹

Me ligj, të gjithë zyrtarët e Agjencisë gëzojnë pavarësi të plotë dhe mbrojtje nga presionet e jashtme gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare.²² Shkeljet e këtyre dispozitave përbëjnë vepër penale.²³

Drejtori dhe stafi i Agjencisë nuk mund të shkarkohen pa arsyetimet përkatëse. Drejtori mund të shkarkohet nga Kuvendi i Kosovës vetëm nëse ai ose ajo nuk e përmbush mandatin ligjor. Mandati i drejtorit përfundon automatikisht nëse ai dënohet për një vepër penale ose zgjidhet në ndonjë pozicion tjetër.²⁴ Personeli i Agjencisë mund të shkarkohet nga komisioni disiplinor në rast të shkeljeve të rënda disiplinore si masë përfundimtare.²⁵

Sipas ligjit, asnjë punonjës, përfshirë drejtorin, nuk ka imunitet nga ndjekja penale gjatë kryerjes së detyrës. Megjithatë, nëse paditet, drejtori suspendohet sipas ligjit, në pritje të përfundimit të çështjes.²⁶

INDIKATORI 10.1.4 PAVARËSIA (NË PRAKTIKË)

75/100

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit funksionon kryesisht pa ndërhyrje nga akterë të tjerë, veçanërisht nga ekzekutivi apo partia në pushtet. Agjencia ka hetuar dhe raportuar për zyrtarë të ndryshëm të lartë publikë, të cilët nuk e kanë deklaruar saktë pasurinë e tyre, ose që kanë shkelur ligjin e konfliktit të interesit. Megjithatë, Agjencia mund të kryejë vetëm hetime administrative dhe duhet të mbështetet në agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit.

Aktualisht ka disa raste kur Agjencia ka ndërmarrë vepërime hetimore dhe ka ngritur kallëzime penale në prokurori kundër zyrtarëve qeveritarë, përfshirë ministra dhe ambasadorë, nga radhët e partisë në pushtet.²⁷ Një prej këtyre kallëzimeve penale, konkretisht ndaj ministres Rozeta Hajdari, ka rezultuar me aktakuzë të ngritur nga Prokurori i Shtetit.²⁸

Marrëdhëniet e Agjencisë me organet e tjera ligjzbatuese janë të mira dhe të bazuara në bashkëpunim të ndërsjellë, kryesisht për shkak të natyrës së punës që ka me organe si Policia, prokuroritë dhe gjykatat. Megjithatë, ka pasur pakënaqësi në trajtimin e lëndëve të Agjencisë nga prokuroritë, për shkak të përmbajtjes dhe cilësisë së provave të disa kallëzimeve penale që Agjencia u ka dërguar atyre.²⁹

Agjencia ka kompetencën të kryejë hetime administrative për rastet që janë në juridiksionin e saj.³⁰ Hetimet administrative kufizohen vetëm në shqiptimin e gjobave administrative dhe ngritjen e kallëzimeve penale. Hetimet duhet të përfundojnë brenda 6 muajve nga marrja e informacionit ose maksimumi një vit. Agjencia zhvillon bashkëpunim sipas nevojës me agjenci të tjera, veçanërisht për rastet e konfliktit të interesit dhe deklarimit të rremë të pasurisë.³¹ Agjencia nuk ka raportuar asnjë rast të ndërhyrjes politike në punën e saj hetimore.³² Asnjë nga drejtorët e Agjencisë nuk është shkarkuar dhe nuk ka të dhëna për ndonjë rast të shkarkimit të stafit.





Qeverisja

**INDIKATORI 10.2.1
TRANSPARENCA
(SIPAS LIGJIT)**



Ekzistojnë dispozita ligjore të mjaftueshme dhe gjithëpërfshirëse që i mundësojnë publikut të marrë informacion mbi funksionimin, veprimtarinë dhe vendimmarrjen e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.

Çdo akt i nxjerrë nga Agjencia, duke përfshirë vendimet, opinionet për konfliktin e interesit, raportet vjetore të punës dhe informacione të tjera, duhet të publikohen në faqen e internetit të Agjencisë brenda 15 ditëve.³³ Megjithatë, ka afate specifike për publikimin e dokumenteve të tjera dhe vendimmarrjen e Agjencisë. Agjencia është e detyruar të publikojë deklaratat e pasurisë nga zyrtarët publikë në platformën online jo më vonë se 30 ditë pas përfundimit të afatit për deklarim.³⁴ Agjencia është gjithashtu e detyruar të publikojë të gjitha gjobat e shqiptuara ndaj subjekteve raportuese jo më vonë se 30 ditë nga dita e shqiptimit.³⁵ Agjencia duhet të përgatisë dhe publikojë raportin e përgjithshëm vjetor në lidhje me sinjalizimin për vitin paraprak deri më 31 mars të vitit pasardhës.³⁶

Agjencia ka detyrimin ligjor të ruajë konfidencialitetin e informacionit që lidhet me të dhënat personale të individëve që po hetohen, të dhënat personale të raportuesve të rastit, si dhe informacione të tjera që mund të dëmtojnë procesin hetimor administrativ.³⁷

Me ligjin e ri për deklarimin e pasurisë të miratuar në korrik 2022, platforma për deklarimin e pasurisë jo vetëm që do të

jetë publike, por do të mundësohet edhe dorëzimi elektronik i deklarimit.³⁸

Sa i përket faqes së internetit të Agjencisë, kërkohet që të gjitha informacionet që lidhen me punën dhe aktivitetin publik të Agjencisë, duke përfshirë politikat e miratuara, raportet vjetore, buxhetin vjetor, raportin e shpenzimeve dhe të dhëna të tjera, të jenë të qasshme.³⁹

**INDIKATORI 10.2.2
TRANSPARENCA
(NË PRAKTIKË)**



Në praktikë, publiku është në gjendje të marrë informacionin përkatës për funksionimin, punën dhe vendimmarrjen e Agjencisë.

Agjencia publikon raportet, publikimet, vendimet dhe opinionet e saj, përfshirë ato për rastet e konfliktit të interesit,⁴⁰ brenda afateve ligjore. Këto të dhëna dhe informacione janë të qarta dhe të paraqitura në detaje në faqen e saj të internetit.


Faqja e internetit e Agjencisë është funksionale dhe lehtësisht e qasshme për publikun.⁴¹ Faqja e internetit përmban informacione të kategorizuara mbi opinionet, vendimet, publikimet, lajmet dhe të tjera. Aktivitetet e Agjencisë publikohen edhe në një faqe të re, të krijuar në rrjetin social Facebook,⁴² duke kontribuar në avancimin e transparencës së kësaj Agjencie.

Megjithatë, "Levizja FOL", një organizatë e shoqërisë civile⁴³ që bashkëpunon ngushtë me Agjencinë, vuri në dukje se faqja e internetit e Agjencisë mund të përmirësohet në paraqitjen



e të dhënave edhe më lehtë, veçanërisht për deklarimin e pasurisë, që kërkon disa klikime.⁴⁴

**INDIKATORI 10.2.3
LLOGARIDHËNIA
(SIPAS LIGJIT)**



Ekzistojnë dispozita të mjaftueshme për të siguruar raportimin dhe llogaridhënien e Agjencisë për punën e saj. Megjithatë, dispozitat e ligjit të ri për Agjencinë përmbajnë dobësi sa i përket verifikimit të pasurisë së zyrtarëve të lartë në Agjenci – meqë këtë proces do ta kryejë Komisioni Parlamentar për Legjislacion.

Ligjërisht, Agjencia i përgjigjet vetëm Kuvendit të Kosovës. Agjencia duhet të dorëzojë raportin vjetor të punës për vitin paraprak më së voni deri më 31 mars.⁴⁵ Komisioni për Legjislacion është përgjegjës për mbikëqyrjen e punës së Agjencisë, duke përfshirë shqyrtimin e raporteve të Agjencisë para miratimit të tyre në seancë plenare, si dhe vlerësimin e punës së drejtorit.⁴⁶ Komisioni parlamentar nuk ka të drejtë ligjore të ndërhyjë në procedurat hetimore administrative të Agjencisë.⁴⁷ Megjithëse Komisioni ka të drejtë të zbatojë verifikimin e pasurisë për zyrtarët e lartë të Agjencisë,⁴⁸ ka paqartësi serioze lidhur me modalitetin se si bëhet ky verifikim. Për shembull, ligji përcakton që Komisioni e kryen këtë proces, por nuk është përcaktuar në ligj se si Komisioni e bën këtë verifikim ose kur Komisioni i shqyrton këto deklarata.⁴⁹

Në raportin vjetor, Agjencia duhet të paraqesë informacion në lidhje me hetimet administrative dhe numrin e rasteve të referuara në organet e zbatimit të ligjit. Raporti duhet të përfshijë gjithashtu informacion statistikor për shkarkimet, hetimet, aktakuzat dhe vendimet në lidhje me rastet e referuara nga Agjencia dhe krahasimet me vitet e mëparshme.⁵⁰ Ligji për Agjencinë parasheh që raportet vjetore të punës duhet të jenë të qasshme dhe të publikohen në faqen e internetit të Agjencisë në momentin e dorëzimit të tyre në Kuvend.⁵¹




Mbrojtja e sinjalizuesve është përgjegjësi ligjore e Agjencisë.⁵² Sinjalizuesi nuk mund t'i nënshtrohet procedurave penale, përgjegjësisë civile ose disiplinore.⁵³ Sinjalizuesit gëzojnë gjithashtu mbrojtje sipas Rregullores për Mbrojtjen e Sinjalizuesve në rastet kur ata raportojnë çdo informacion që kërcënon interesin publik.⁵⁴ Agjencia duhet të ruajë konfidencialitetin e sinjalizuesit.⁵⁵

Agjencia i nënshtrohet kontrollit financiar dhe auditimit të pasqyrave financiare nga Zyra Kombëtare e Auditimit në baza vjetore.⁵⁶ Opinionet dhe rekomandimet e ZKA-së që rrjedhin nga auditimi janë të detyrueshme për Agjencinë.⁵⁷

Vendimet e Agjencisë në lidhje me trajtimin e çështjeve të mosdeklarimit të pasurisë ose konfliktit të interesit, si dhe refuzimin e çdo njoftimi, mund të jenë objekt shqyrtimi gjyqësor.⁵⁸ Edhe pse vendimet e Agjencisë janë të formës së prerë në procedurën administrative, ato mund të kontestohen me padi në gjykatë. Këto lëndë trajtohen nga departamenti për çështje administrative në Gjykatën Themelore të Prishtinës.⁵⁹

Aktualisht nuk ka komisione të veçanta qytetare që mbikëqyrin punën e Agjencisë, por ka organizata të shoqërisë civile që monitorojnë punën e Agjencisë.⁶⁰

**INDIKATORI 10.2.4
LLOGARIDHËNIA
(NË PRAKTIKË)**



Në praktikë, dispozitat që sigurojnë raportimin dhe llogaridhënien e Agjencisë janë kryesisht efektive, por Agjencia nuk jep detaje në lidhje me rastet e iniciuara dhe të hetuara dhe informacioni kufizohet në të dhëna statistikore.

Në vitin 2020 dhe 2021 Agjencia i ka dorëzuar me kohë Kuvendit të Kosovës raportet vjetore të punës.⁶¹ Drejtori i Agjencisë ka raportuar të paktën një herë në vit në Komisionin





Parlamentar të Legjislacionit për punën e Agjencisë,⁶² si dhe për veprimtarinë e stafit.⁶³ Kuvendi miraton raportet e punës së Agjencisë.⁶⁴

Agjencia i nënshtrohet gjithashtu një auditimi vjetor të pasqyrave të saj financiare nga Zyra Kombëtare e Auditimit. Për vitin 2021, raporti i auditimit ka vlerësuar pasqyrat financiare dhe në të gjitha aspektet i ka vlerësuar si të drejta dhe të sakta. Rrjedhimisht, nuk është dhënë asnjë rekomandim në Raportin e Auditimit të Jashtëm nga Zyra Kombëtare e Auditimit për Pasqyrat Vjetore Financiare.⁶⁵ Personeli i lartë drejtues i Agjencisë ka deklaruar pasurinë çdo vit.⁶⁶

Raportet vjetore të Agjencisë përmbajnë të dhëna statistike lidhur me numrin e hetimeve, rastet e deklarimit të pasurisë, raportet e konfliktit të interesit dhe vendimet apo opinionet e nxjerra. Agjencia ofron edhe të dhëna për vendimmarrjen e institucioneve gjyqësore në bazë të rasteve të ngritura nga Agjencia. Megjithatë, nga gjithsej 375 raste të hetimeve paraprake të raportuara nga Agjencia për vitin 2021, nuk ofrohen të dhëna të hollësishme për raste specifike. Agjencia raporton gjithashtu⁶⁷ për bashkëpunimin me institucionet e tjera, çështjet financiare dhe buxhetin, si dhe rekrutimin e stafit.⁶⁸

Edhe pse Agjencia ka emëruar një zyrtar për sinjalizim, ende nuk është raportuar asnjë rast sinjalizimi.⁶⁹ Nuk ka gjithashtu asnjë rast të raportuar të ankesave gjyqësore lidhur me masat administrative të shqiptuara nga Agjencia.

**INDIKATORI 10.2.5
MEKANIZMAT E
INTEGRITETIT (SIPAS LIGJIT)**

75/100



Ekzistojnë dispozita relativisht gjithëpërfshirëse që garantojnë integritetin e stafit dhe drejtorit të Agjencisë, duke përfshirë Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit⁷⁰ dhe Ligjin për Deklarimin e Pasurisë.⁷¹ Megjithatë, kodi i etikës për punonjësit e saj nuk përfshin Drejtorin e Agjencisë.

Agjencia ka një kod etike për punonjësit e saj, i cili është miratuar në vitin 2013; megjithatë, ai nuk vlen për Drejtorin e Agjencisë.

Kodi është përgjithësisht gjithëpërfshirës meqë mbulon çështjet e konfliktit të interesit dhe rregullat e dhuratave.⁷² Kodi përcakton si të detyrueshëm parimin e shmangies së konfliktit të interesit dhe thotë se punonjësit e Agjencisë nuk duhet të lejojnë që interesat e tyre private të bien ndesh me pozicionin e tyre publik, duhet të shmangin konfliktin e interesit dhe të mos e shfrytëzojnë kurrë pozicionin e tyre për interesat e tyre.⁷³ Lidhur me dhuratat, Kodi i ndalon zyrtarët e Agjencisë të pranojnë dhurata ose përfitime të tjera nga palët për veten, familjen ose të afërmit, të cilat vënë në pikëpyetje pavarësinë, paanshmërinë dhe integritetin e Agjencisë.⁷⁴ Zbatimi i kodit mbikëqyret nga një Komision Etike, i përbërë nga tre anëtarë, i cili formohet me vendim të Drejtorit.⁷⁵

Megjithatë, Kodi përmban mangësi në lidhje me deklarimin e pasurisë për zyrtarët e lartë të Agjencisë, pasi nuk e evendon si shkelje mosdeklarimin e pasurisë nga këta zyrtarë. Kodi gjithashtu nuk përfshin në mënyrë specifike asnjë dispozitë që trajton sjelljen e zyrtarëve të Agjencisë sipas parimit të integritetit.⁷⁶ Rregullorja ligjore, përfshirë kodin, nuk përmban dispozita që kufizojnë punësimin, pas përfundimit të mandatit të drejtorit apo personelit të Agjencisë. Kodi



zbatohet për të gjithë punonjësit e Agjencisë dhe të gjithë personat e angazhuar në shërbime të veçanta. Dhe ligji për Agjencinë përcakton se drejtori nuk mund të pranojë asnjë pagesë nga buxheti i shtetit për asnjë detyrë tjetër të kryer.⁷⁷

I vetmi kontroll i integritetit gjatë pranimit të punonjësve të rinj është zbatimi i kriterit të punësimit që kandidatët duhet të mos jenë dënues nga gjykata me vendim të formës së prerë dhe të mos kenë pasur masa disiplinore nëse kanë punuar më parë në shërbimin civil.⁷⁸

**INDIKATORI 10.2.6
MEKANIZMAT E
INTEGRITETIT (NË PRAKTIKË)**

50/100



Ka paqartësi në lidhje me integritetin në praktikë të zyrtarëve të Agjencisë.

Deri më tani, nuk ka të dhëna për shkelje të Kodit të Etikës apo dispozitave të tjera ligjore.⁷⁹

Deri më tani, Agjencia ka raportuar se nuk ka pasur sanksione ndaj zyrtarëve të Agjencisë nga Komisioni i Etikës.

Në vitin 2021, në mesin e 20 seminareve trajnuese në të cilat morën pjesë zyrtarët e Agjencisë, vetëm një u mbajt për çështjet e integritetit.⁸⁰ Të gjitha seancat trajnuese të ndjekura nga zyrtarët e Agjencisë u organizuan nga institucione të tjera vendore dhe ndërkombëtare.⁸¹

**INDIKATORI 10.2.7
GJINIA**

0/100



Në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit nuk ka asnjë protokoll specifik apo udhëzime të qarta me ndjeshmëri gjinore.

Ligji për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit nuk ka asnjë dispozitë ligjore që përkufizon mekanizmat e ndjeshmërisë gjinore brenda Agjencisë. Edhe Rregullorja për organizimin e brendshëm të punës së Agjencisë nuk parasheh asnjë dispozitë për mekanizmat e ndjeshëm ndaj gjinisë. Ndonëse kodi i etikës përcakton parimin e barazisë gjinore dhe mosdiskriminimit, nuk ka mekanizma për mbikëqyrje dhe zbatim efektiv të këtyre parimeve.⁸²

Nuk ka asnjë rregullore apo përcaktim në lidhje me personelin e gjinisë femërore. Sa i përket mekanizmit të ankesës dhe hetimit, Agjencia nuk mban dhe nuk publikon të dhëna statistike të ndara sipas gjinisë. Agjencia nuk prodhon të dhëna të ndara sipas gjinisë në lidhje me trajtimin, zgjidhjen dhe përpunimin e ankesave.⁸³ Në vitin 2021, Agjencia nuk ka organizuar asnjë sesion trajnimi dhe nuk ka prodhuar materiale vetëdijësuese për stafin lidhur me mekanizmat e ndjeshmërisë gjinore.

Që nga themelimi i saj, asnjë nga drejtorët e Agjencisë nuk ka qenë grua. Megjithatë, konkursi i fundit për Drejtor të Agjencisë në vitin 2021 u anulua një herë nga Komisioni Parlamentar i Legjislacionit pasi asnjë grua nuk kishte aplikuar.⁸⁴ Në Agjenci ka një numër të konsiderueshëm të grave që punojnë dhe kanë detyra drejtuese si shefe divizionesh apo edhe departamentesh. Përfaqësimi i grave në Agjenci tejkalon nivelin e 50 për qind të personelit që janë gra në krahasin me burrat.⁸⁵ Megjithatë, kjo nuk kontribuon domosdoshmërisht drejtpërdrejt në mekanizmat e ndjeshëm ndaj gjinisë.





Roli

INDIKATORI 10.3.1 PARANDALIMI

75/100



Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit në përgjithësi është shumë aktive dhe ka qenë relativisht e suksesshme në aktivitetet e saj parandaluese kundër korrupsionit, të tilla si arritja e reformave të mëdha legjislativë dhe ndikimi në ndryshimin e politikave. Megjithatë, Agjencisë i mungon një zyrë për aktivitete kërkimore.

Agjencia është përgjegjëse për punën parandaluese kundër korrupsionit, duke përfshirë parandalimin e konfliktit të interesit, mbikëqyrjen e deklarimit të pasurisë, mbikëqyrjen e pranimit të dhuratave, mbrojtjen e sinjalizuesve dhe ofrimin e asistencës profesionale dhe teknike institucioneve të tjera për parandalimin e korrupsionit.

Agjencia nuk ka kompetencë të propozojë reforma ligjore, por ka të drejtë të japë mendime dhe ndihmë profesionale. Megjithatë, Agjencia ka për detyrë të japë mendime dhe këshilla për qeverinë dhe Kuvendin në lidhje me aktet ligjore në mënyrë që të përafrohet me standardet ndërkombëtare kundër korrupsionit, si dhe të kryejë vlerësime të rrezikut në fushat ku ka boshllëqe dhe potencial për korrupsion. ⁸⁶ Për shembull, në shkurt 2023, Agjencia mori pjesë në hartimin e legjislacionit për procesin kontrollit të integritetit në sistemin gjyqësor dhe prokurorial, të organizuar nga Ministria e Drejtësisë. ⁸⁷

Agjencia gjithashtu ka për detyrë të promovojë bashkëpunimin me institucionet shtetërore dhe shoqërinë civile për vetëdijesimin e publikut për parandalimin e korrupsionit. ⁸⁸ Në praktikë, sipas një zyrtari ligjor të intervistuar për këtë raport, ka pasur raste të koordinimit dhe ndërveprimit të mirë mes medie dhe Agjencisë në raportimin e rasteve të mosdeklarimit të pasurisë. ⁸⁹ Përkushtimin e Drejtorit të

Agjencisë për rritjen e bashkëpunimit dhe angazhimin e përbashkët në promovimin e aktiviteteve për parandalimin e korrupsionit e vlerësojnë pozitivisht edhe përfaqësues të shoqërisë civile nga Lëvizja FOL. ⁹⁰ Në fakt, Agjencia shpesh herë mban takime konsultative me përfaqësues të OSHC-ve në Kosovë, ku i ka falënderuar për rolin e tyre dhe aktivitetet që zhvillojnë në parandalimin e korrupsionit. ⁹¹

Agjencia nuk ka një njësi të veçantë që merret me kërkime dhe hulumtime akademike. Sipas organogramit të Agjencisë ekziston një zyrë për mbështetje dhe bashkëpunim profesional e cila merret me ofrimin e mbështetjes profesionale dhe tekniko-administrative për stafin e Agjencisë. ⁹²

Në vitin 2020, me pjesëmarrjen dhe kontributin e Agjencisë, qeveria ka hartuar një Strategji Kundër Korrupsionit dhe Plan Veprimi për vitet 2021-2023. ⁹³ Agjencia vazhdon të jetë pjesë e Këshillit Kombëtar Kundër Korrupsionit, i cili megjithatë është joaktiv. ⁹⁴

INDIKATORI 10.3.2 EDUKIMI

25/100



Edhe pse Agjencia ka përgjegjësinë të zhvillojë fushata sensibilizuese në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit, ⁹⁵ përpjekjet e saj në këtë drejtim janë shumë të kufizuara dhe në të kaluarën janë fokusuar në aspekte specifike si deklarimi i pasurisë, të cilat nuk kanë qenë mjaftueshëm efektive në praktikë.

Vitet e fundit, fushatat vetëdijesuese të Agjencisë dhe aktiviteteve të edukimit të publikut kanë qenë pothuajse inekzistente. Faqja e internetit e Agjencisë nuk ka paraqitur informacion për ndonjë fushatë konkrete në pesë vitet e fundit. ⁹⁶ Faqja e



internetit e Agjencisë tregon se janë organizuar 12 seminare në dhjetë komuna për të prezantuar Strategjinë Kundër Korrupsionit dhe Planin e Veprimit, legjislacionin kundër korrupsionit, mandatin e tyre ligjor dhe aktivitetet e kryera. ⁹⁷ Megjithatë, nuk ka detaje mbi kohën e zhvillimit të tyre apo impaktin e tyre. Fushata e fundit substanciale e Agjencisë është ajo e vitit 2016, lidhur me luftën kundër korrupsionit nëpërmjet deklarimit të pasurisë. ⁹⁸ Agjencia nuk ka deklaruar se ka bërë ndonjë vlerësim të ndikimit të aktiviteteve të saj për ngritjen e kapaciteteve arsimore dhe profesionale.

Agjencia ka bashkëpunim të mirë me shoqërinë civile. Agjencia zhvillon takime konsultative në lidhje me hartimin e legjislacionit që ka të bëjë me fushën e rregullimit të brendshëm të Agjencisë dhe legjislacionit për luftimin dhe parandalimin e korrupsionit. ⁹⁹

Agjencia nuk ka ofruar trajnime për stafin e institucioneve të tjera publike apo private. Plani i punës për 2022 përfshin plane për hartimin e një plani trajnimi dhe organizimin e vizitave studimore, si dhe një sërë aktiviteteve që pritet të financohen nga buxheti i tij dhe donatorët e jashtëm. ¹⁰⁰

INDIKATORI 10.3.3 HETIMI

75/100



Agjencia është përgjithësisht aktive dhe deri diku e suksesshme në hetimin e rasteve të dyshuara për korrupsion. Megjithatë, ligji i ri i vitit 2022 i ka hequr kompetencat Agjencisë në lidhje me hetimet penale në luftën kundër korrupsionit dhe i ka kufizuar kompetencat e saj në aktivitete parandaluese dhe hetime administrative në lidhje me deklarimin e pasurisë dhe konfliktin e interesit.

Përgjegjësitë e Agjencisë në hetimin e rasteve janë të kufizuara vetëm në hetimin administrativ, ¹⁰¹ ndërsa institucionet e zbatimit të ligjit si Policia e Kosovës dhe Prokuroria janë përgjegjëse për hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve. ¹⁰²

Për më tepër, Agjencia kryen një auditim të plotë të deklarimit të pasurisë së vetëm një të tretës së zyrtarëve të lartë publikë me përzgjedhje të rastësishme – dhe kjo listë nuk është publike. ¹⁰³

Në praktikë, Agjencia ka kryer hetime ndaj niveleve të ndryshme të zyrtarëve publikë. ¹⁰⁴ Agjencia ka hetuar edhe zyrtarë të lartë qeveritarë, përfshirë rastet kundër ministres së Jashtme, Donika Gërvalla, ¹⁰⁵ si dhe ministres së Industrisë dhe Tregtisë, Rozeta Hajdari. Për këto raste Agjencia ka paraqitur kallëzim penal në prokurori për moskallëzim ose kallëzim të rremë të pasurisë. ¹⁰⁶ Po ashtu, Agjencia ka dorëzuar kallëzim penal në prokurori edhe ndaj ambasadorit të Kosovës në Kroaci, Martin Berishaj, për shkak të mosdeklarimit të pasurisë. ¹⁰⁷ Së fundi, Agjencia ka pranuar një raport për kryeministrin Albin Kurti lidhur me një rast të konfliktit të interesit për shkak të një shtëpie të marrë me qira nga ai dhe do të fillojë një hetim. ¹⁰⁸

Agjencia kryesisht kryen hetime në bazë të raportimit. Përafërsisht nga 20 për qind e rasteve, 76 raste janë iniciuar në bazë të detyrës zyrtare, ndërsa 26 raste të tjera janë nisur në bazë të burimeve anonime. ¹⁰⁹ Gjatë vitit 2021, Agjencia ka kryer hetime për gjithsej 375 raste, nga të cilat 150 janë përcjellë në prokurori dhe polici, ndërsa dy raste janë përcjellë në organet përkatëse administrative me kërkesë për fillimin e procedurës disiplinore. 71 raste të tjera janë mbyllur nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit. Sipas aktakuzave të ngritura nga prokuroria në bazë të kallëzimeve penale të Agjencisë, gjykatat kanë nxjerrë 25 aktgjykime dënimi dhe një lirim për rastet e dyshuara për korrupsion. ¹¹⁰

Krahasuar me vitet e kaluara, numri i vendimeve të gjykatave penale në rastet e nxjerra nga Agjencia është përgjithësisht i njëjtë. Në vitin 2020, nga 124 lëndë procedurale në prokurori, sipas aktakuzave të ngritura, gjykatat shpallën 22 dënime dhe një lirim nga akuzat. ¹¹¹





Ndërveprimet

Agjencia ka bashkëpunim të ngushtë kryesisht me prokurorinë, policinë dhe gjyqësorin. Këto marrëdhënie, aq sa janë të ndërtuara mbi përcaktime ligjore, janë edhe të natyrës reciproke dhe kanë të bëjnë me luftën kundër korrupsionit.

Në praktikë, bashkëpunimi me prokurorinë është i qëndrueshëm sa i përket reagimit të informacionit në Agjenci për procedime të mëtejshme dhe vendime përfundimtare në lidhje me rastet e ngritura nga Agjencia. Gjatë gjithë vitit, në baza mujore, Agjencia shkëmben informacione me Prokurorinë Themelore për numrin e lëndëve të përcjella për të mbajtur statistikat të përditësuara.¹¹²

Agjencia gjithashtu bashkëpunon me policinë për të marrë informacione në lidhje me verifikimin e të shkuarës kriminale, pra nëse një person është arrestuar, hetuar dhe ndjekur penalisht për ndonjë vepër penale. Me gjyqësorin, bashkëpunimi lidhet me informacionin për trajtimin dhe përfundimin e lëndëve në gjykatë që kanë të bëjnë me mosdeklarimin ose deklarimin e rremë të pasurisë dhe krahasohen të dhënat statistikore lidhur me gjykimet dhe përmbytjen e vendimeve të tyre.¹¹³

Ndikimi i këtyre ndërveprimeve është pozitiv pasi ka dëshmuar se të gjitha rastet e hetuara dhe të ngritura nga Agjencia në drejtim të hetimit dhe ndjekjes penale për veprat e korrupsionit¹¹⁴ janë vlerësuar në bazë të meritave dhe nuk janë anashkaluar (shih 10.3.3).¹¹⁵

Megjithatë, ka nevojë për më shumë përkushtim dhe profesionalizëm të policisë dhe prokurorisë (shih kapitullin 4 për Prokurorin e Shtetit – Indikatorin e ndërveprimit) në ndjekjen penale duke kryer hetime efikase dhe duke mbledhur prova bindëse në mënyrë që efekti i tyre në gjykatë të jetë shqiptimi i dënimeve përkatëse për të akuzuarit për vepra penale të korrupsionit.¹¹⁶

Rekomandimet e shtyllës

- Qeveria dhe Kuvendi duhet të rrisin buxhetin e Agjencisë për të përmbushur kompetencat e saj të zgjeruara të lidhura me amendamentin e fundit të vitit 2022 në ligjin e Agjencisë për të rekrutuar staf të ri dhe gjithashtu nevojitet një buxhet më i madh që Agjencia të zbatojë plotësisht planet e saj për aktivitetet dhe fushatat për parandalimin e korrupsionit.
- Agjencia duhet:
 - Të bëhet më aktive në angazhimin e saj informues në fushatat e vetëdijesimit dhe edukimit të publikut mbi rëndësinë e raportimit të rasteve të konfliktit të interesit, mosdeklarimit të pasurisë dhe korrupsionit.
 - Të adaptojë Planin e Veprimit Kundër Korrupsionit dhe ta harmonizojë atë me detyrat dhe kompetencat e tij sipas situatës aktuale.
 - Të organizojë aktivitetet më të shpeshta të trajnimit për stafin e saj lidhur me integritetin, mbrojtjen e sinjalizuesve dhe çështje të tjera që janë me interes për Agjencinë.
 - Të shtojë burimet njerëzore për të zbatuar plotësisht aktivitetin e saj në çështjet e mbikëqyrjes së legjislatcionit anti-korrupsion, hartimit të planeve të integritetit dhe mbrojtjes së sinjaleve. Ekziston gjithashtu nevoja për të rekrutuar staf profesional administrativ në fushën teknologjike.
 - Të zhvillohet, sa më shpejt të jetë e mundur, një platformë elektronike për deklarimin e pasurisë, për të thjeshtuar dhe bërë më efikas plotësimin e deklarimit të pasurisë dhe të ardhurave, si dhe qasjen në këtë informacion.
 - Të plotësohet dhe ndryshohet Kodi i Etikës për zyrtarët e saj, pasi ai daton nga viti 2013 dhe duhet të përditësohet në drejtim të rregullimit më të mirë të integritetit të zyrtarëve të agjencisë. Kodi duhet të ndryshohet edhe për të mbuluar Drejtorin e Agjencisë.
 - Të mbahen të dhëna dhe krijohet një bazë të dhënash të raporteve ose ankesave që dorëzohen në bazë gjinore, në mënyrë të tillë që të inkurajojë ose të masë nivelin e raporteve që janë të ndjeshme për gjininë.
 - Të hartohet një rregullore përkatëse brenda Agjencisë për të rregulluar çështjet e ndjeshme gjinore.



REFERENCAT

- 1 Ligji Nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, neni 4 pika 2. (korrik, 2022).
- 2 Rregullorja nr. 01/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores nr. 01/2013 për organizimin e brendshëm dhe sistemin e pozitës së punës në agjencinë kundër korrupsionit, neni 4. (maj 2019).
- 3 Ligji nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, (korrik 2022); Lëvizja FOL (2023), Kapacitetet e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit në Përmbushjen e Detyrimeve Ligjore, <https://levizjafol.org/wp-content/uploads/2023/08/Agency-for-the-Prevention-of-Corruption-ENG-1.pdf>
- 4 Ligji Nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, neni 7.
- 5 Sipas Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike, Qeveria mund të mos aprovojë plotësisht kërkesat buxhetore të Agjencisë.
- 6 Ligji Nr. 08/L-066 për ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës, neni 16, paragrafi 3.
- 7 Ligji Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, neni 23, paragrafi 1, pika 1. (korrik, 2022).
- 8 Ligji Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, neni 12, paragrafi 1, pika 6. Drejtori në emër të agjencisë ka të drejtë sipas ligjit të lidhë marrëveshje bashkëpunimi me institucionet vendore dhe organizatat ndërkombëtare.
- 9 Ligji Nr.08/L-066 për Buxhetin e Kosovës për vitin 2022, faqe 45.
- 10 Bazuar në intervistën me Lindita Ademin, Zyrtare Ligjore në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit (gusht 2022), agjencia nuk kishte arritur të shpenzojë plotësisht buxhetin e alokuar fillimisht për të si rezultat i zhvillimit të aktiviteteve me ndihmën financiare të organizatave ndërkombëtare, si dhe kufizimeve për shkak të pandemisë COVID-19. Për më shumë, shihni Raportin Vjetor të Punës 2021 të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, faqe 32.
- 11 Ligji Nr.08/L-066 për Buxhetin e Kosovës për vitin 2022, faqe 45.
- 12 Ligji Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Neni 18.
- 13 Intervistë me Lindita Ademin, Zyrtare Ligjore në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, gusht 2022.
- 14 Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, "Raporti vjetor i punës për 2021", faqe 49.
- 15 Intervistë me Lindita Ademin, Zyrtare Ligjore në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, gusht 2022.
- 16 Intervistë me Lindita Ademin, Zyrtare Ligjore në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, gusht 2022.
- 17 Ligji Nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, neni 4 paragrafi 1.
- 18 Ligji Nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, neni 9.
- 19 Ligji Nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, neni 11 paragrafi 8.
- 20 Kriteret kryesore për zgjedhjen e Drejtorit janë tetë vjet përvojë profesionale, nga të cilat pesë vjet përvojë menaxheriale; që në gjashtë vitet e fundit, ai nuk ka ushtruar funksion në një subjekt politik, ose nuk ka qenë kandidat, i zgjedhur apo emëruar në organet legjislative ose ekzekutive në nivel qendror dhe vendor; dhe nuk i është nënshtruar asnjë mase disiplinore, aktakuze apo vendimi përfundimtar nga gjykata. Shih: Ligji për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, neni 10.
- 21 Ligji Nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, neni 10 paragrafi 1.5.
- 22 Ligji Nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, neni 8.
- 23 Kodi Penal Republikës së Kosovës, neni 401. Sipas Kodit Penal të Kosovës, kushdo që pengon apo sulmon personin zyrtar gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare dënohet me burgim nga 3 muaj deri në 5 vjet.
- 24 Ligji Nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, neni 13.
- 25 Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenet 60 dhe 61.
- 26 Ligji Nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, neni 13 paragrafi 3.
- 27 Gazeta Nacionale, korrik 2022, <https://nacionale.com/politike/lista-e-gjate-e-zyrtareve-te-v-se-ge-u-hetuan-nga-kunder-korrupioni-8010> [qasur më 18 tetor 2022]
- 28 Portali Kallxo.com, tetor 2022, <https://kallxo.com/lajm/aktakuze-ndaj-ministres-rozeta-hajdari-per-mosdeklarim-te-pasurise/> [qasur më 18 tetor 2022]
- 29 Intervistë nga një burim anonim me një anëtar të një organizate ndërkombëtare (korrik 2022).
- 30 Sipas ligjit Për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit (neni 5), Agjencia ka në objekt parandalimin e konfliktit të interesit, mbikëqyrjen e deklarimit të pasurisë, si dhe pranimin e dhuratave gjatë detyrave zyrtare, duke përfshirë mbrojtjen e sinjalizuesve.
- 31 Ligji Nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, neni 6.
- 32 Intervistë me Lindita Ademin, Zyrtare Ligjore në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, (gusht 2022).
- 33 Neni 6 i Ligjit për Qasje në Dokumente Publike.
- 34 Ligji Nr. 04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave, neni 12, paragrafi 1.
- 35 Ligji Nr.04/L-050 për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe dhuratave, neni 31, paragrafët 1 dhe 2.
- 36 Ligji Nr. 06/L-085 për Mbrojtjen e sinjalizuesve, neni 29 paragrafi 3.
- 37 Ligji Nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, neni 28.
- 38 Ligji për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe dhuratave (korrik 2022).
- 39 Udhëzimi Administrativ (MAP) Nr.01/2015 për Uebfaqet e Institucioneve Publike, neni 9.
- 40 Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, Vendimet, <https://akk-ks.org/vendimet/1979/2022/1979> [qasur më 27 korrik 2022]
- 41 Për më shumë, shihni faqen e internetit: <https://akk-ks.org/> [qasur më 27 tetor 2022]





42 Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, platforma Facebook, Agjencia kundër Korrupsionit / Agjenci Protiv Korupcije | Facebook [qasur më 12 gusht 2022]

43 Levizja FOL është organizatë e shoqërisë civile e cila fokuson punën e saj në shpenzimet publike, luftimin e formave të ndryshme të korrupsionit dhe neglizhencës institucionale, si dhe promovimin e llogaridhënies. Ata kanë bërë hulumtime në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit ose punojnë ngushtë në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, ose janë autoriteti kryesor në organet e pavarura mbikëqyrëse.

44 Intervistë me Mexhide Demollin, Drejtoreshë Ekzekutive në organizatën Lëvizja FOLL, gusht, 2022.

45 Ligji Nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, neni 15 paragrafi 1 (korrik 2022).

46 Ligji Nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, neni 16 paragrafi 2.

47 Ligji Nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, neni 16 paragrafi 2.

48 Intervistë me Mexhide Demollin, Drejtoreshë Ekzekutive në organizatën Lëvizja FOLL, gusht, 2022.

49 Ligji Nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, neni 16 paragrafi 2 pika 2.4.

50 Ligji Nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, neni 15 paragrafi 2, pika 2.6.

51 Ligji Nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, neni 15 paragrafi 3.

52 Ligji Nr.06/L-085 për Mbrojtjen e sinjalizuesve, (dhjetor 2018).

53 Ligji Nr. 06/L-085 për Mbrojtjen e sinjalizuesve, neni 9 paragrafi 2.

54 Rregullorja për përcaktimin e procedurës për pranimin dhe trajtimin e rasteve të sinjalizimit, (maj 2021).

55 Rregullorja për përcaktimin e procedurës për pranimin dhe trajtimin e rasteve të sinjalizimit, (maj 2021).

56 Ligji Nr.05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Kosovës neni 18 paragrafi 1 dhe 3.

57 Zyra Kombëtare e Auditimit, "Raporti i Auditimit për Pasqyrat Vjetore Financiare të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit", (Prishtinë: ZKA, qershor, 2022).

58 Ligji Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Qershor, 2016)

59 Intervistë me Lindita Ademin, Zyrtare Ligjore në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, gusht 2022.

60 Për më shumë shikoni Portalin Telegrafi.com, gusht, 2021, <https://telegrafi.com/levizja-fol-agjencia-kunder-korrupsionit-ka-deshtuar-ne-zbatimin-e-ligjit-per-deklarimin-e-pasurise/>, [qasur më 16 mars 2023]

61 Shih portalin Kallxo.Com, gusht 2022, <https://kallxo.com/lajm/drejtori-i-akademise-se-drejtise-raporton-para-komisionit-per-legjislacion/> [qasur më 17 mars 2023]

62 Shih portalin Lajmi.net, nëntor 2021, <https://lajmi.net/miratohet-raporti-vjetor-i-agjencise-kunder-korrupsionit-per-vitin-2020/>, [qasur më 16 mars 2021]

63 Intervistë me Lindita Ademin, Zyrtare Ligjore në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, gusht 2022.

64 Për më shumë shihni njoftimin e Agjencisë: https://www.akkks.org/lajmi_i_plote/548107fbclid=IwAR0Gg9psJSNMTwZVGFQ7uD0Q1cHJq2rE3z5v5GH_uRNw605PpuTIHpldMyQ [qasur më 27 tetor 2022]

65 Shih, Zyrën Kombëtare të Auditimit, "Raporti i Auditimit mbi pasqyrat financiare vjetore të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit për vitin 2021", botuar në qershor, 2022, faqe 3.

66 Shih, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, 'Deklarata e Pasurisë', linku më poshtë: https://akk-ks.org/en/deklarimi_i_pasuris/2016/Agjencia_kunder_Korrupsionit/2016

67 Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, 'Raporti Vjetor 2021', faqe 26, [Prishtinë, mars 2022]

68 Ligji Nr.08/L-17 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, neni 15, paragrafi 2 (korrik, 2022).

69 Intervistë me Lindita Ademin, Zyrtare Ligjore në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, gusht 2022.

70 Ligji Nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit (prill, 2018).

71 Ligji Nr.04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurive dhe Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publikë (gusht, 2022).

72 Kodi në fjalë nuk ka dispozita që rregullojnë kufizimet pas punësimit. Ekziston një ligj tjetër që thotë se zyrtarëve të lartë publikë në poste drejtuese u ndalohej kthimi në të njëjtin institucion brenda dy viteve pas largimit nga posti. Neni 18 thekson: "Një zyrtar i lartë nuk ka të drejtë të punësohet ose emërohet për një periudhë deri në dy vjet pas përfundimit të funksionit publik, në pozicione drejtuese ose menaxhuese, ose të përfshihet në kontrollin ose auditimin e institucioneve publike e private dhe institucionet në vartësi të tyre që kanë marrëdhënie biznesi me institucionin ku ai ka ushtruar funksion publik, kufizimet për zyrtarët e lartë pas përfundimit të funksionit publik.."

73 Kodi i Etikës për Punonjësit e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, neni 4, paragrafi 9.

74 Kodi i Etikës për Punonjësit e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, neni 4, paragrafi 13.

75 Kodi i Etikës për punonjësit e Agjencisë, neni 6.

76 Shih nenin 4 të Kodit të Etikës, mungon pjesa sqaruese për parimin e integritetit.

77 Ligji Nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, neni 12 paragrafi 3.

78 Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, konkursi, https://akk-ks.org/assets/cms/uploads/files/konkursi_publick.pdf [qasur në gusht 2022]

79 Intervistë me Lindita Ademin, Zyrtare Ligjore në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, gusht 2022.

80 Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, "Raporti vjetor i punës për 2021", faqe 49.

81 Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, "Raporti vjetor i punës për 2021", faqe 49.

82 Kodi i Etikës për Punonjësit e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, neni 4, paragrafi 2.

83 Intervistë me Lindita Ademin, Zyrtare Ligjore në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, gusht 2022.

84 Portali Kallxo.com, 28 qershor 2021, <https://kallxo.com/lajm/nuk-aplikoi-asnje-grua-konkursi-per-direktor-te-antikorrupsionit-do-te-rishpallet/> [qasur më 17 gusht 2022]

85 Intervistë me Lindita Ademin, Zyrtare Ligjore në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, gusht 2022.

86 Ligji Nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, neni 5, paragrafi 1.2, pika 6.

87 Shih, Ministria e Drejtësisë, shkurt 2023, <https://md.rks-gov.net/page.aspx?id=1,15,2927> [qasur më 22 mars 2023]



88 Ligji Nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, neni 5, paragrafi 1.2, pika 4.

89 Gazeta Nacionale, gusht 2022, <https://nacionale.com/politike/skandali-financiar-kunder-korrupsioni-dorezon-kallezim-penal-ndaj-martin-berishajt> [qasur më 17 gusht 2022]

90 Intervistë me Mexhide Demollin, Drejtoreshë Ekzekutive në organizatën Lëvizja FOL, gusht, 2022.

91 Shih Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, janar 2022, https://akk-ks.org/en/lajmi_i_plote/54690 [qasur më 22 mars 2023]

92 Rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, (maj, 2019), neni 12.

93 Zyra e Kryeministrit, "Plani i Veprimit Kundër Korrupsionit 2021-2023", (Prishtinë: Dhjetor, 2020).

94 Këshilli Kombëtar Kundër Korrupsionit funksionon në kuadër të zyrës së Presidentit të Kosovës <https://president-ks.gov.net/sq/keshilli-kombetar-kunder-korrupsion> [qasur më 18 gusht 2022]

95 Ligji Nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, neni 5, paragrafi 1, pika 1.10.

96 Faqa e internetit e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, <https://akk-ks.org/agjencia/41/prgjeqis/41> [qasur më 18 gusht 2022]

97 Faqa e internetit e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, Vetëdija kundër korrupsionit, https://akk-ks.org/vetedijesimi_kunder_korsuprisit/168/vetdijesimi-kunder-korsuprisit/168 [qasur më 22 gusht 2022]

98 Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, https://akk-ks.org/vetedijesimi_kunder_korrupsionit/179/tv-spote/179 [qasur më 20 tetor 2022]

99 Agjencia Kundër Korrupsionit, "Raporti vjetor i punës për 2021", faqe 30.

100 Agjencia Kundër Korrupsionit, "Plani i punës për 2022", (Prishtinë: APPK, shkurt 2022), faqe 7.

101 Ligji Nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, neni 5, paragrafi 1.

102 Ligji Nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, neni 17, paragrafët 5, 6 dhe 7.

103 Ligji Nr. 04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave, neni 18, paragrafi 8.

104 Personat e përfshirë në këto raste u përkasin niveleve të ndryshme si: Deputetët, zëvendësministrat, koordinatorët kombëtarë, kryetarët e komunave dhe nënkryetarët e komunave, gjyqtarët, këshilltarët politikë të kabinetit qeveritar, sekretari i përgjithshëm në nivel qendror, ambasadorët, këshilltarët e kuvendeve komunale, zëvendëskryetarët, dekanët, kryeshefat ekzekutivë të institucioneve të pavarura, kryeshefat ekzekutivë të agjencive, drejtuesit e agjencive brenda ministrive, menaxherët e prokurimit në nivel qendror, zyrtarët kryesorë financiarë në institucionet e pavarura dhe në nivel lokal, anëtarët e bordeve të ndërmarrjeve publike qendrore dhe lokale, pronarët e bizneseve të caktuara, etj. Për më shumë, shih Raportin Vjetor të Punës së Agjencisë për vitin 2021.

105 Gazeta Express, tetor 2022, <https://www.gazetaexpress.com/dyshimet-se-fshehu-pasurine-prokuroria-eshte-duke-e-hetuar-ministren-donika-ger-valla/> [qasur më 27 tetor 2022]

106 Gazeta Express, mars 2022, <https://www.gazetaexpress.com/agjencia-kunder-korrupsionit-dorezon-kallezim-penal-kunder-ministres-rozeta-haj-dari/> [qasur më 22 gusht 2022]

107 Gazeta Nacionale, gusht 2022, <https://nacionale.com/politike/skandali-financiar-kunder-korrupsioni-dorezon-kallezim-penal-ndaj-martin-berishajt> [qasur më 23 gusht 2022]

108 Gazeta Nacionale, qershor 2022, <https://nacionale.com/politike/merr-informaten-nga-nacionalja-anti-korrupsioni-nis-hetimet-per-qerane-e-li-re-te-kryeministrit-kurti-7798> [qasur më 23 gusht 2022]

109 Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, "Raporti vjetor i punës për 2021", faqe 11.

110 Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, "Raporti vjetor i punës për 2021", faqe 16.

111 Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, "Raporti vjetor i punës për 2020", faqe 14.

112 Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, "Raporti vjetor i punës për 2021", faqe 25.

113 Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, "Raporti vjetor i punës për 2021", faqe 25.

114 Shih gjithashtu 'Raportin vjetor të punës për vitin 2021' faqet 16 dhe 17.

115 Intervistë me Lindita Ademin, Zyrtare Ligjore në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, gusht 2022.

116 Shih gjithashtu kapitullin mbi Policinë, treguesin e perceptimit të korrupsionit 6.3.1 dhe ndërveprimin.



PARTITË POLITIKE





Prej tyre, 14 subjekte politike janë të përfaqësuara në Kuvend në bazë të mandateve të fituara në zgjedhjet e fundit parlamentare të vitit 2021. Zyra për Regjistrimin, Certifikimin dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike (“Zyra”), e cila funksionon në kuadër të KQZ-së, është përgjegjëse për regjistrimin dhe certifikimin e partive politike, mbajtjen e regjistrit të partive, caktimin e kufijve të shpenzimeve të fushatës dhe zbatimin e dispozitave të raportimit financiar.²

Ky raport fokusohet në vlerësimin e subjekteve kryesore që kanë ndikim të rëndësishëm politik brenda peizazhit politik të Kosovës, duke përfshirë Lëvizjen Vetëvendosje (LVV) – si parti në pushtet – dhe Partinë Demokratike të Kosovës (PDK), Lidhjen Demokratike të Kosovës (LDK) dhe Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), të cilat të gjitha luajnë role kritike si partitë kryesore opozitare që i japin formë dinamikës politike në Kosovë ndër vite. Përveç kësaj, vlerësimi përfshin Listën Serbe (LS), partinë kryesore që përfaqëson komunitetin serb në institucionet e Kosovës. Edhe pse në praktikë këtyre partive politike u mungojnë profile të dallueshme ideologjike, LVV-ja kategorizohet si parti e qendrës së majtë, ndërsa, në anën tjetër, tri partitë opozitare, PDK, LDK dhe AAK, përkufizohen si parti të qendrës së djathtë.

Korniza rregullative e Kosovës është e favorshme për formimin, regjistrimin dhe funksionimin e partive politike. Megjithatë, sistemi i partive politike ende nuk ka kontestime të forta pluraliste në zgjedhjet demokratike të lira nga ndërhyrjet e jashtme, duke e përkthyer pluralitetin më të gjerë të interesave në shoqëri në politika mbarëkombëtare dhe transparencën e duhur dhe respektimin e detyrimeve financiare.

Kosova nuk ka ligj specifik për partitë politike. Funksionimi i partive politike rregullohet vetëm me Rregulloren për regjistrimin dhe funksionimin e partive politike, të cilën e miraton KQZ-ja. Megjithatë, ligje të shumta rregullojnë financimin politik në Kosovë, duke përfshirë Ligjin për Financimin e Subjekteve Politike, Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, Ligjin për Zgjedhjet Lokale dhe Ligjin për Buxhetin e Kosovës.

Sa i përket financimit të subjekteve politike, Kosova karakterizohet me mungesë transparence dhe llogaridhënieje financiare, për shkak se raportet financiare nuk janë të plota dhe nuk ka mbikëqyrje të duhur. Në këtë drejtim, është shënuar progres me miratimin e ndryshimeve në ligjin për financimin e subjekteve politike në gusht 2022. Megjithatë, ka ende mangësi, veçanërisht në lidhje me financat e kandidatëve dhe fushatat digjitale.

Në kuptimin strukturor dhe organizativ, partitë politike janë të ngjashme. Shumica e partive politike janë në thelb “lideriste”. Në këtë këndvështrim, për interesa personale dhe politike, ata vazhdojnë të ushtrojnë ndikim në institucionet publike dhe të dëmtojnë pavarësinë e tyre. Kjo është arsyeja pse partitë politike konsiderohen si institucionet më së paku të besueshme të vendit.³



Kapacitetet



INDIKATORI 11.1.1 BURIMET (SIPAS LIGJIT)

75/100



Korniza ligjore që rregullon formimin dhe funksionimin e partive politike është përgjithësisht adekuate. Në mungesë të një ligji specifik për partitë politike, rregullimi aktual i partive politike bazohet në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe rregullat zgjedhore të KQZ-së.

Partia politike ka të drejtën e themelimit bazuar në parimin e lirisë së asociimit.⁴ Për regjistrim, partitë duhet të dorëzojnë aplikacionin e tyre në Zyrë, së bashku me statutin dhe programin e partisë, listën e zyrtarëve të lartë drejtues, deklaratën financiare më të re, datën e mbledhjes së konventës dhe nënshkrimet e të paktën 500 anëtarëve themelues.⁵ Tarifa e regjistrimit është 500 €.⁶

Zyra duhet të shqyrtojë aplikacionet brenda dhjetë ditëve⁷ dhe rekomandon regjistrimin ose refuzimin e aplikimit në KQZ brenda 30 ditëve.⁸ Kërkesa për regjistrim mund të refuzohet nëse dokumentet nuk i përmbahen legjislacionit, nëse emri ose simboli i partisë mund të nxisë urrejtje dhe dhunë, ose nëse ato janë të njëjta ose të ngjashme me ndonjë parti tjetër.⁹ Në rast refuzimi, palët kanë të drejtë të ankohen në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) brenda 24 orëve.¹⁰

Një kod sjelljeje përcakton kufizimet në lidhje me aktivitetet e fushatës zgjedhore të partive politike.¹¹ Për vendimmarrjen e brendshme, legjislacioni garanton të drejtën e votës së barabartë për të gjithë anëtarët në të gjitha vendimet e marra nga asamblëta e partive.¹²



Subjektet politike financohen, ndër të tjera, nga buxheti publik.¹³ Për këtë qëllim është krijuar Fondi për Mbështetjen e Subjekteve Politike, në kuadër të të cilit ndahen fonde deri në 0.34 për qind të buxhetit të shtetit.¹⁴ Fondi mund të përdoret për financimin e aktiviteteve të subjekteve politike, degëve, njësisve të organizatave të grave dhe rinisë, aktivitetet parazgjedhore dhe zgjedhore, si dhe aktivitetet e grupeve parlamentare.¹⁵ Mjetet e këtij fondi u ndahen subjekteve politike të përfaqësuara në Kuvend në bazë të numrit të mandateve të fituara.¹⁶

Për të mbështetur partitë politike gjatë proceseve zgjedhore, atyre mund t’u ndahen fonde shtesë deri në 0.05 për qind të buxhetit të shtetit.¹⁷ Në kuadër të këtyre mjeteve, 90 për qind u ndahen partive që kanë fituar mandate në Kuvend, apo kuvendeve komunale, ndërsa 10 për qind për partitë e tjera të certifikuar në zgjedhje.¹⁸



INDIKATORI 11.1.2 BURIMET (NË PRAKTIKË)

50/100



Konkurrenca politike në Kosovë zhvillohet kryesisht ndërmjet partive të mëdha dhe partisë apo partive në pushtet. Partitë e vogla, veçanërisht ato joparlamentare, kanë vështirësi në sigurimin e burimeve financiare, të cilat janë shumë më të vogla se ato të partive të mëdha.

Partitë parlamentare kanë marrë 4.2 milionë euro çdo vit vetëm nga buxheti publik.¹⁹ Kështu, subjektet politike parlamentare, veçanërisht ato të mëdha, kanë një gjendje financiare dukshëm më të qëndrueshme. Deri më tani nuk ka pasur raste të ndarjes së mjeteve shtesë nga buxheti publik për



financimin e aktiviteteve të fushatës së partive politike. Kjo e ka bërë edhe më të vështirë qëndrueshmërinë financiare të partive të vogla dhe të reja, duke i detyruar ato të kërkojnë donacione private, të cilat janë të pakta dhe kryesisht të orientuara drejt partive të mëdha (shih tabelën 11.1). Sipas pasqyrave financiare vjetore të partive politike, financimi publik përfaqëson pjesën

më të madhe të burimeve të tyre financiare. Bazuar në raportet vjetore të partive parlamentare për vitin 2021 dhe 2020, donacionet private, qofshin ato në para apo në natyrë, janë shumë më të pakta se financimi publik, edhe në vite elektorale. Përkundër kornizës ligjore që e ofron si mundësi (shih 11.1.2), deri më tani nuk janë ndarë fonde për fushatat zgjedhore të partive politike.

Tabela 11.1 Të dhënat financiare të subjekteve politike parlamentare, të krijuara nga autori bazuar në raportet vjetore financiare të subjekteve politike për vitin 2021 dhe 2020

Subjekti politik	2021		2020	
	Financimi publik	Donacionet private	Financimi publik	Donacionet private
LVV ²⁰	€ 1,655,326.95	€ 427,251.96	€ 913,500.00	€ 59,626.09
PDK ²¹	€ 647,081.42	€ 166,531.90	€ 756,000.00	€ 26,259.00
LDK ²²	€ 285,457.61	€ 10,152.82	€ 882,000.00	€ 0
AAK ²³	€ 292,719.62	€ 2,250.00	€ 404,954.58	€ 17,200.00
LS ²⁴	€ 424,459.03	€ 0	€ 355,225.66	€ 0

Megjithatë, raportet nuk përputhen me realitetin në terren. Sipas organizatave joqeveritare që merren me financimin politik në Kosovë, vlerësohet se partitë politike nuk publikojnë apo raportojnë shumicën e donacioneve private të pranuar.²⁵ Një pjesë e mungesës së zbulimit të donacioneve mund të jetë për shkak të kufizimeve ligjore që i pengojnë kompanitë të përfitojnë nga kontratat publike nëse kanë bërë donacione për partitë politike.²⁶ Ndonëse kjo dispozitë ndihmon në parandalimin e ndikimit të padrejtë përmes donacioneve të fushatës, ajo gjithashtu mund të dekurajojë donatorët që të bëjnë donacionet e tyre në përputhje me rregulloret ekzistuese.

Sipas raporteve të vëzhgimit të zgjedhjeve lokale, partitë përgjithësisht gëzojnë trajtim të barabartë në mbulimin mediatik gjatë zgjedhjeve.²⁷ Megjithatë, mediet private e kanë më sfiduese të mbulojnë partitë në zonat lokale për shkak të mungesës së kapaciteteve.²⁸

INDIKATORI 11.1.3 PAVARËSIA (SIPAS LIGJIT)

75/100

Ekzistojnë dispozita të ligjeve të ndryshme që trajtojnë pavarësinë e partive politike, por që përmbajnë mangësi dhe kontradikta kur bëhet fjalë për ndërhyrjen në partitë politike përmes ndërprerjes së veprimtarisë apo ndalimit të tërësishëm të tyre.

Legjislacioni zgjedhor përcakton se sanksioni penal ndaj një partie të regjistruar politike çon në çregjistrimin e tyre, në



bazë të vendimit të gjykatës.²⁹ Megjithatë, legjislacioni penal nuk lejon ndërprerjen e punës apo ndalimin e veprimtarisë së partive politike.³⁰ Prandaj, ligji penal ofron garanci më të forta ligjore kundër ndërhyrjeve sesa ligji zgjedhor.

Legjislacioni parasheh mundësinë e hetimit të partive politike, kryesisht në aspektin e financimit të tyre,³¹ me raportet e tyre vjetore financiare të dërguara nga KQZ-ja në Prokurorinë e Shtetit, Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Njësinë e Inteligjencës Financiare apo Administratën Tatimore të Kosovës kur dyshimi për parregullsi bie në kompetencën e tyre. Monitorimi është paraparë për funksionimin e brendshëm, duke përfshirë mbajtjen e kuvendeve dhe ndryshime të tjera të brendshme. Zyra në kuadër të KQZ-së lejohet të kryejë aktivitete monitoruese për kuvendet zgjedhore – ku duhet të ftohen si vëzhgues³² – dhe monitorimin e shpenzimeve.³³

Në çështjet penale, partitë politike mund t’iu nënshtrohen masave të fshehta të vëzhgimit, duke përfshirë vëzhgimin, fotografimin, përgjimin, zbulimin e të dhënave financiare dhe të tjera.³⁴ Megjithatë, ato janë të kufizuara vetëm për qëllimin e hetimit në përputhje me interesin publik dhe qëllimet e ligjeve përkatëse.

INDIKATORI 11.1.4 PAVARËSIA (NË PRAKTIKË)

75/100

Partitë politike veprojnë kryesisht pa ndërhyrje të jashtme në aktivitetet e tyre. Ato përgjithësisht i nënshtrohen mbikëqyrjes dhe hetimeve vetëm në raste të përcaktuara ligjorisht. Megjithatë, ka raste të procedurave penale të ndjekura nga shteti kundër aktivistëve të partive tv caktuara si dhe frikësimit elektorale të sponsorizuar nga jashtë kundër kandidatëve në komunat me shumicë serbe.³⁵

Në Kosovë nuk ka pasur asnjë rast apo tentativë nga autoritetet shtetërore që të ndalojnë dhe t’u ndërhyjnë partive politike

në përfaqësimin e interesave të tyre. Madje, deri më sot nuk ka pasur vendime gjyqësore ndaj partive politike.

Partitë politike përgjithësisht marrin trajtim të barabartë dhe jo preferencial nga autoritetet. Megjithatë, ka pasur arrestime dhe ndalime të zyrtarëve të partive politike për shkak të protestave apo aksioneve politike. Gjatë dy viteve të fundit, ka pasur disa arrestime të aktivistëve dhe zyrtarëve të Partisë Socialdemokrate për shkak të aktiviteteve dhe veprimeve të tyre protestuese, përfshirë hedhjen e ngjyrës në ndërtesat qeveritare.³⁶ Po kështu, të paktën dy raste të tjera të arrestimit të aktivistëve të PDK-së pas veprimeve politike të kryera nga ta.³⁷ Të gjithë të arrestuarit u liruan brenda një periudhe të shkurtër.³⁸

Ndër proceset penale më të ndjeshme ndaj aktivistëve të partive politike ishte rasti i sulmit në Kuvendin e Kosovës, për të cilin në vitin 2016 u arrestuan gjashtë aktivistë të LVV-së nën akuzën e terrorizmit.³⁹ Një nga të arrestuarit kishte vdekur në rrethana të dyshimta në qendrën e paraburgimit,⁴⁰ e cila ende nuk është sqaruar plotësisht. Si rrjedhojë, ky proces u shoqërua me përplasje të shumta mes LVV-së dhe partive në pushtet në atë kohë, ku LVV-ja i cilësoi arrestimet si persekutim të kundërshtarëve politikë.⁴¹ Aktivistët e akuzuar fillimisht u dënuan me 21 vjet burg.⁴² Por pas rigjyqimit të lëndës në fund të vitit 2022, të gjithë të akuzuarit u shpallën të pafajshëm.⁴³

Sipas raportit të Freedom House për Kosovën për vitin 2022, partitë ndonjëherë përballen me frikësim, gjë që ndikon negativisht në aftësitë e tyre konkurruese, me theks të veçantë në Listën Serbe,⁴⁴ e cila është akuzuar vazhdimisht në raportet ndërkombëtare për presion ndaj rivalëve politikë.⁴⁵ Përveç kësaj, ndikimi i jashtëm u manifestua përmes mbështetjes së drejtpërdrejtë të Listës Serbe nga figura të ndryshme institucionale serbe, së bashku me taktika të pretenduara të frikësimit dhe stigmatizimit që synonin të heshtin partitë e tjera politike serbe me bazë në Kosovë.⁴⁶





Qeverisja

**INDIKATORI 11.2.1
TRANSPARENCA
(SIPAS LIGJIT)**

75/100



Rregullativa aktuale ligjore është relativisht gjithëpërfshirëse në lidhje me detyrimin e partive politike për të bërë publik informacionin e tyre financiar. Megjithatë, mungesa e një detyrimi të tillë ligjor për vetëfinancimin dhe financimin e kandidatëve të partive politike, zvogëlon transparencën financiare.

Ndryshimet ligjore për financimin politik në Kosovë, të miratuar në gusht 2022, kanë avancuar disi transparencën financiare të partive politike.

Partitë politike duhet të dorëzojnë një raport financiar vjetor çdo vit, përpara datës 1 mars.⁴⁷ Raportet duhet të përmbajnë informacion mbi pasqyrat financiare, faturat e të gjitha shpenzimeve, bilancet bankare dhe një regjistër të donacioneve të marra.⁴⁸ Për donacionet mbi 100 €, partitë duhet të japin informacion mbi vlerën, datën e dhurimit, emrin e plotë, adresën dhe numrin personal të kontribuuesit.⁴⁹ Partitë duhet gjithashtu të dorëzojnë në Zyrë një deklaratë financiare për fushatën zgjedhore brenda 45 ditëve pas përfundimit të zgjedhjeve,⁵⁰ e cila duhet të publikohet jo më vonë se gjashtë muaj pas zgjedhjeve.⁵¹

Dispozitat detyrojnë palët që të mbajnë raportet financiare të publikuara për të paktën një vit në faqet e tyre zyrtare dhe gazetata e përditshme deri më 30 korrik të vitit vijues.⁵² Partitë parlamentare duhet të publikojnë shpenzimet e tyre tre muajore në faqet e tyre të internetit dhe të përditësojnë listën e detajuar të donatorëve çdo tre muaj, ndërsa raportet financi-

are duhet të publikohen për tre vjet.⁵³ Këto dokumente duhet të dorëzohen në Zyrë.⁵⁴ Zyra më pas krijon dhe publikon një dosje të informimit publik që përmban kopje të regjistrin të donatorëve, raportet e financimit të fushatës, formularët e deklaramit financiar të kandidatëve të certifikuar dhe raportet përfundimtare të auditimit.⁵⁵

KQZ-ja duhet të përgatisë një raport vjetor për Kuvendin e Kosovës lidhur me shpërndarjen dhe mënyrën e shpenzimit të mjeteve të Fondit për mbështetjen e subjekteve politike.⁵⁶

Legjislacioni kërkon raportimin e çdo shpenzimi të bërë për qëllime fushate.⁵⁷ Megjithatë, fushatat digjitale nuk janë të rregulluara qartë në mënyrë normative. Megjithëse legjislacioni ndalon pranimin e drejtpërdrejtë të donacioneve për kandidatin,⁵⁸ kontrolli financiar i shpenzimeve dhe vetëfinancimi nuk rregullohen me ligj.

**INDIKATORI 11.2.2
TRANSPARENCA
(NË PRAKTIKË)**

25/100



Në përgjithësi, publiku përballet me vështirësi në marrjen e informacionit financiar nga subjektet politike. Partitë politike dorëzojnë raportet e tyre financiare në Zyrën e KQZ-së sipas afatit ligjor,⁵⁹ por nuk ndërmarrin asnjë hap proaktiv në publikimin e informacionit financiar, por përkundrazi mbështeten në procedurat e KQZ-së, të cilat zakonisht zgjasin shumë (shih 7.3.1).

Kuvendi i Kosovës deri në vitin 2019 kishte dështuar vazhdimisht në procedurat e prokurimit për përzgjedhjen e audi-



torëve për shkak të ndarjes së buxhetit të pamjaftueshëm.⁶⁰ Si rezultat, vonesat e këtij procesi shkuan deri në tre ose katër vjet.⁶¹ Megjithatë, KQZ-ja nuk publikonte raportet financiare përpara përfundimit të procesit të auditimit, duke e lënë publikun me zero transparencë. Vetëm në vitin 2019, KQZ-ja vendosi të publikojë pasqyrat financiare të pa audituara.⁶²

Faqja e internetit e KQZ-së është burimi kryesor ku publiku mund të marrë informacion për financat e partive politike.⁶³ Krahas raporteve financiare dhe të fushatës, për çdo proces zgjedhor, KQZ-ja publikon një listë të donacioneve të partive politike.⁶⁴ Përveç LVV-së,⁶⁵ partitë e tjera,⁶⁶ shumicën e kohës, nuk i publikojnë në mënyrë proaktive raportet e tyre financiare vjetore në faqet e tyre të internetit.

Fushatat digjitale janë kanë përqendrim dukshëm më të madh, veçanërisht në zgjedhjet lokale të vitit 2021.⁶⁷ Megjithatë, partitë nuk i deklarojnë shpenzimet e tyre në këto fushata. Që nga shtatori 2022, *Ads Library* në Facebook ka filluar të ofrojë informacion të detajuar mbi shpenzimet e reklamave politike në faqet e medieve sociale të partive politike dhe kandidatëve të tyre.

**INDIKATORI 11.2.3
LLOGARIDHËNIA
(SIPAS LIGJIT)**

75/100



Ekzistojnë dispozita të konsoliduara që detyrojnë partitë politike të mbajnë dhe raportojnë të dhënat e tyre financiare. Megjithatë, ky detyrim nuk vlen për financat e kandidatëve të partive politike, financat dhe vetëfinancimet e të cilëve mbeten jashtë fushëveprimit ligjor.

Me ndryshimet ligjore të gushtit 2022, Zyrës për Regjistrimin, Certifikimin dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike i garantohet një pavarësi më e madhe funksionale⁶⁸ dhe

burime shtesë⁶⁹ për monitorimin dhe kontrollin e financave të subjekteve politike. Auditimi i raporteve financiare kryhet nga auditorët e përzgjedhur nga Zyra me konkurs të hapur publik.⁷⁰ Zyrës i garantohet pavarësia vendimmarrëse në shqiptimin e gjobave.^{71,72}

Ligji i detyron partitë politike të dorëzojnë dy lloje raportesh financiare: raportin financiar vjetor dhe raportin e deklaratës financiare të fushatës.⁷³ Raporti financiar vjetor përfshin informacion mbi pasuritë, kapitalin dhe detyrimet e partisë, pasqyrën e fitimeve dhe humbjeve, raportin e pagesave, faturat e të gjitha shpenzimeve, bilancet bankare, regjistrin e donatorëve dhe kreditë e partisë.⁷⁴ Ky raport duhet të dorëzohet në KQZ jo më vonë se data 1 mars i vitit pasardhës.⁷⁵ Ndërkohë, partitë që konkurrojnë në zgjedhje duhet të dorëzojnë Raportet e Deklaratës Financiare të Fushatës, duke përfshirë të gjitha degët dhe pjesët e partive, duke filluar 90 ditë para zgjedhjeve dhe duke përfunduar në ditën e zgjedhjeve.⁷⁶ Raporti duhet të dorëzohet jo më vonë se 45 ditë pas zgjedhjeve.⁷⁷ Formatet e pasqyrave financiare vjetore janë modele të përcaktuara nga rregullat e zgjedhjeve të KQZ-së.⁷⁸

Kandidatët e partive politike nuk janë të detyruar të raportojnë për financat e fushatës së tyre. Duke qenë se atyre u ndalohet të pranojnë drejtpërdrejt donacione, kjo çështje ka të bëjë më shumë me vetëfinancimin.⁷⁹ Kandidatëve u kërkohet vetëm të plotësojnë një formular të deklaramit financiar gjatë zgjedhjeve⁸⁰ që përbëhet nga të dhëna sipërfaqësore mbi gjendjen financiare të kandidatit përpara zgjedhjeve, duke përfshirë të ardhurat, asetet, aksionet në biznese, rrjedhën e parave, detyrimet financiare dhe borxhet e tjera.

Legjislacioni përmban mangësi serioze sa u përket gjobave ndaj partive politike për shkelje të raportimit financiar. Ligji parasheh një gamë të gjerë gjobash, nga 4,000 € deri në 40,000 €, pa specifikuar se cila gjobë shqiptohet në cilat raste. Kjo lihet në diskrecionin e Zyrës, në varësi të peshës dhe llojit të shkeljes.⁸² Gjohat mund të shqiptohen për shkeljet që lidhen me mënyrën se si përdoren fondet, deklaratat bankare, donacionet, mosrespektimin e afateve të raportimit dhe publikimit, ose dështimin për të siguruar qasje të përshtatshme për auditimin nga auditorët.⁸³





**INDIKATORI 11.2.4
LLOGARIDHËNIA
(NË PRAKTIKË)**

50/100



Në përgjithësi, partitë politike dorëzojnë raportet e tyre vjetore financiare dhe të fushatës në Zyrën e KQZ-së, por këto kanë mangësi dhe janë të cilësisë së ulët pasi nuk përmbajnë informacion të detajuar për financat, veçanërisht për shpenzimet.

Meqenëse legjislacioni i ri ka hyrë në fuqi në fund të vitit 2022, efektet në praktikë nuk mund të analizohen ende. Përpara ndryshimeve, pajtueshmëria e partive politike me legjislacionin ekzistues shfaqte disa mangësi. Nga njëra anë, partitë politike i dorëzonin në kohë raportet e tyre financiare vjetore dhe raportet e fushatës.⁸⁴ Në vitin 2021, si vit zgjedhor, Zyra kishte shqiptuar vetëm shtatë gjoba, të gjitha në vlerë prej 1000€, për shkak të vonësive të partive politike në dorëzimin e raporteve vjetore financiare.⁸⁵ Asnjë nga gjobat nuk iu shqiptua partive parlamentare.

Megjithatë, problematike mbeti përmbajtja dhe saktësia e pasqyrave financiare të subjekteve politike. Raportet e Komisionit Evropian për Kosovën nënvizuan se raportimi financiar ishte jo i plotë dhe nuk kishte mbikëqyrje përmbajtësore të raporteve.⁸⁶ Deri në ndryshimet ligjore të gushtit 2022, Zyra nuk kontrollonte përmbajtjen dhe saktësinë e raporteve, por ishte e fokusuar në kontrollin e rregullsisë dhe kriterëve formale, për shembull, nëse partitë politike i dorëzonin dokumentet (si informacionet bankare), pa i shqyrtuar ato.

Formularët e raportimit financiar të KQZ-së nuk përmbajnë kategorinë e fushatave digjitale. Pra, supozohet se shumë burime të të ardhurave dhe shpenzimeve të partive politike mbeten të padeklaruara.⁸⁷

Gjetjet e raporteve të auditorëve financiarë të partive politike nxjerrin në pah probleme me dokumentacionin mbështetës

të shpenzimeve të bëra nga partitë, veçanërisht në lidhje me shpenzimet e transportit,⁸⁸ si dhe shpenzime të tjera të pakategorizuara.⁸⁹ Në përgjithësi, raportet e auditorëve për financat e partive politike theksojnë se shumica e partive politike nuk mbajnë kontabilitet të duhur, nuk zhvillojnë procedura adekuate tenderimi, nuk përmbushin detyrimet tati-more ose nuk kanë procedura të kontrollit të brendshëm dhe zyrtarët përkatës financiarë nuk kanë njohuri kontabiliteti.⁹⁰

Megjithatë, shkeljet e zbuluara dhe evidentuara nga auditorët deri më tani kanë mbetur të pasanksionuara nga Zyra për shkak të mungesës së burimeve, veçanërisht atyre njerëzore.⁹¹

Saktësia e raporteve financiare të fushatave kontestohet edhe për shpenzimet gjatë fushatës, të cilat faktikisht kanë tejkaluar kufijtë e shpenzimeve të përcaktuara nga KQZ-ja. Në bazë të monitorimit të shpenzimeve të subjekteve politike për fushatën zgjedhore 2019, koalicioni i organizatave monitoruese zgjedhore “Demokracia në Veprim” ka konstatuar se LDK-ja nuk i ishte përmbajtur kufirit për shpenzime maksimale gjatë fushatës, duke shpenzuar 220,957 euro më shumë se sa kufiri i vendosur nga KQZ-ja.⁹²

**INDIKATORI 11.2.5
INTEGRITETI (SIPAS LIGJIT)**

75/100



Partitë kryesore politike rregullojnë qeverisjen dhe vendimmarrjen e brendshme përmes statuteve të tyre. Megjithatë, zgjedhjet konkurruese për lidërshipin partiak nuk janë obligative sipas asnjë nga rregulloret e brendshme të partive politike. Shumica e partive kanë gjithashtu një qasje të centralizuar në zgjedhjen e organeve partiake, ku votimi është i fshehtë.

Partitë politike janë të detyruara të organizojnë mbledhje të kuvendit të partisë së paku një herë në katër vjet dhe të rino-



**INDIKATORI 11.2.6
INTEGRITETI (NË PRAKTIKË)**

50/100



Në përgjithësi, partitë kryesore politike ndjekin vetëm nominalisht dispozitat procedurale të qeverisjes dhe demokracisë brendapartiake. Si rezultat, partitë politike në Kosovë konsiderohen parti ‘lideriste’.¹¹⁰

vojnë strukturat e brendshme të partisë.⁹³ Partitë gjithashtu duhet të sigurojnë pjesëmarrjen e anëtarëve të partisë në zgjedhjen e kandidatëve elektoral, ndërsa kandidatët për kuvendet komunale duhet të zgjidhen nga degët përkatëse të partisë.⁹⁴

Lëvizja Vetëvendosje është e vetmja parti politike që aplikon demokracinë e drejtpërdrejtë sipas parimit një anëtar-një votë për zgjedhjen e kryetarit të partisë, drejtuesve të njësive organizative dhe miratimin e programit politik.⁹⁵ Partitë tjera të mëdha (Partia Demokratike e Kosovës,⁹⁶ Lidhja Demokratike e Kosovës⁹⁷ dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës⁹⁸) zgjedhin organet ekzekutive dhe miratojnë programin politik të partisë përmes demokracisë së deleguar në kuvendet e partisë. Megjithatë, asnjë nga rregulloret e brendshme të partive politike nuk kërkon zgjedhje konkurruese për lidërshipin partiak. Në rastin e Lidhjes Demokratike të Kosovës, kandidatëve për kryetar partie u kërkohet që kandidaturat e tyre të miratohen paraprakisht nga 50 për qind +1 delegatë.⁹⁹ Duke përjashtuar LVV-në, zgjedhja e strukturave drejtuese të partive politike bëhet me votim të fshehtë.^{100,101,102}

Statutet e partive kryesore politike rregullojnë edhe kandidaturat për president, kryeministër, deputetë dhe asamblistë të kuvendeve komunale. Këshillat e përgjithshëm apo drejtues të partive politike thirren për të miratuar listat e kandidatëve për deputetë të Kuvendit të Kosovës, si dhe për kandidaturat e tjera për pozitat ekzekutive institucionale (president apo kryeministër). Propozimet e listave të kandidatëve për deputetë përpilohen kryesisht nga degët dhe miratohen nga këshillat e përgjithshëm^{103,104} ose këshillat drejtuese.¹⁰⁵ Për zgjedhjet në nivel lokal, listat përpilohen nga nivelet përkatëse të organizimit vendor dhe kërkojnë miratimin e drejtuesve të partisë.^{106,107,108,109}

Në shumicën e rasteve, proceset zgjedhore brendapartiake janë formalitet, madje edhe garat për kryetar partie organizohen kryesisht me një kandidat të vetëm. Duke përjashtuar LDK-në,¹¹¹ në partitë tjera kryesore në vend, garat e fundit zgjedhore janë mbajtur me një kandidat të vetëm.¹¹² Kjo qasje reflektohet më pas në njësitë organizative të partive, ku krerët e degëve apo qendrave, si dhe kandidatët e tjerë për poste publike, zgjidhen në bazë të diktatit apo preferencave të drejtuesve të nivelit qendror.

Ndër partitë kryesore, LVV-ja konsiderohet relativisht prijëse sa i përket demokratizimit të brendshëm përmes përfshirjes së anëtarëve të saj në zgjedhjen e strukturave drejtuese përmes zgjedhjeve të drejtpërdrejta.¹¹³ Mirëpo, në procesin e fundit zgjedhor, gara për kryetar të kësaj partie është zhvilluar me një kandidat të vetëm, Albin Kurtin, i cili më parë ka qenë kryetar i kësaj partie për dy mandate.¹¹⁴ Për shkak të përplasjeve të lidhura me këtë garë, pothuajse gjysma e deputetëve dhe aktivistëve të tjerë dhanë dorëheqjen nga LVV-ja dhe themeluan një parti të re.¹¹⁵

Lidhja Demokratike e Kosovës është e vetmja parti që zhvilloi një garë konkurruese zgjedhore për liderin e partisë në zgjedhjet e tyre të fundit të brendshme. Gara u zhvillua me figurave kryesore të partisë, megjithëse fillimisht kandidatura u shpallën edhe nga disa kandidatë të tjerë.¹¹⁶ LDK-ja është gjithashtu partia me më së shumti ndryshime në kryesinë e partisë, me gjithsej katër kryetarë që nga formimi i saj në vitin 1989, e ndjekur nga PDK-ja me tre kryetarë që nga viti





1999, LVV-ja me dy kryetarë që nga viti 2005 dhe AAK-ja me një kryetar që nga themelimi i saj në vitin 2000.

Kur bëhet fjalë për vendimmarrjen brenda partisë, përfshirë përzgjedhjen e kandidatëve apo miratimin e programit politik, në praktikë, vendimet merren nga struktura të ngushta vendimmarrëse, duke përfshirë kryetarin dhe drejtuesit e tjerë të lartë të partisë, pa përfshirë organet tjera të partisë.¹¹⁷ Miratimi nga të fundit zakonisht është thjesht formalitet. Programet politike ndjekin një qasje nga lart-poshtë,¹¹⁸ veçanërisht në nivelin qendror, ku platformat miratohen me nxitim për shkak të zgjedhjeve të shpeshta të jashtëzakonshme dhe afateve të shkurtra. Kur bëhet fjalë për nivelin lokal, në praktikë, degët dhe kandidatët për kryetarë komune kanë autonomi të konsiderueshme në hartimin e programeve politike, ku niveli qendror është i përfshirë vetëm në shqyrtimin e tyre dhe ofrimin e ekspertizës.¹¹⁹



Ekzistojnë dispozita ligjore që rregullojnë pjesëmarrjen e graas në jetën politike, por ato nuk zbatohen plotësisht në praktikë. Po kështu, partitë politike nuk zbatojnë masa afirmative vullnetare për të nxitur pjesëmarrjen e barabartë të grave në proceset vendimmarrëse brendapartiake.

Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme përcakton dy nivele të kuotave gjinore. Ligji përcakton kuotat legjislativ¹²⁰ dhe praktikisht vendet e rezervuara për gratë në Kuvend,¹²¹ të cilat ligjërisht përshkruhen si vende për gjininë e nënpërfaqësuar. Të dyja këto kuota janë në nivelin 30 për qind. Rregullat zgjedhore përcaktojnë se subjektet politike nuk mund të certifikohen nëse nuk plotësojnë kriterin ligjor për përfshirjen e të paktën 30 për qind të grave në listën zgjedhore.¹²²



Ligji përcakton që në rast të përfundimit të parakohshëm të mandatit, deputetët zëvendësohen me kandidatin e radhës të së njëjtës gjini.¹²³ Megjithatë, zbatimimi i kësaj dispozite është vlerësuar si kundërkushtetues nga Gjykata Kushtetuese¹²⁴ pas ankesës së dy kandidatëve për deputete se nuk mund të zëvendësonin deputetët të cilëve u mbaroi mandati për shkak se zëvendësimi ishte bërë nga kandidatë të së njëjtës gjini, megjithëse ato kishin më shumë vota.¹²⁵

Nga ana tjetër, në mungesë të detyrimeve ligjore, në praktikë subjektet politike nuk kanë ndërmarrë asnjë iniciativë për aplikimin e kuotave të brendshme vullnetare, qoftë në nivel strukturor, qoftë organizativ, madje as në listat zgjedhore. Në fakt, partitë rrallëherë e kalojnë detyrimin ligjor të kriterit minimal prej 30 për qind të përfshirjes së grave në lista.

Gratë kryesojnë vetëm katër nga 50 partitë politike të regjistruara aktualisht në KQZ.¹²⁶



Roli



Edhe pse sistemi partiak në Kosovë është relativisht efektiv në grumbullimin dhe përfaqësimin e interesave të grupeve të ndryshme të votuesve, ende ka grupe dhe interesa shoqërore që partitë politike nuk i përfaqësojnë, si sindikatat dhe/ose shoqatat e biznesit. Disa parti politike vazhdojnë të bazohen në lidhje klienteliste dhe përfaqësojnë interesa të ngushta, e në disa raste shfaqin edhe tipare populiste.

Pavarësisht përcaktimeve statutoare për profilin e tyre ideologjik, në realitet partitë politike në Kosovë nuk shquhen për një profil të qartë ideologjik.¹²⁷ Pozicionet programore bazohen kryesisht në marrëveshjet e koalicionit, duke bërë që partitë të bëhen parti "catch-all", duke përfaqësuar interesat e sa më shumë grupeve shoqërore.¹²⁸ Pra, është më e favorshme që partitë të mos deklarohen ideologjikisht dhe në baza programore.¹²⁹ Nuk ka nivele të larta kohezioni ideologjik ndërmjet anëtarëve të partive politike.¹³⁰ Klientelizmi në Kosovë manifestohet në veçanti përmes ndikimit të bizneseve private në vendimet që marrin partitë politike duke favorizuar dhe shpërblyer kompanitë private të cilat kanë financuar partitë politike me kontrata publike ose licenca për përdorimin e të mirave apo pasurive publike.¹³¹ Përveç kësaj, ka lidhje individualiste klienteliste, veçanërisht në lidhje me punësimin e personave që janë anëtarë ose të afërt me partitë politike në pushtet. Prandaj, afërsia me një program politik zakonisht nuk është arsyeja kryesore pse individët u bashkohen partive politike.¹³²

Partitë politike janë institucioni me nivelin më të ulët të besimit nga qytetarët në Kosovë tash e një dekadë.¹³³ Kjo situatë nuk ka ndryshuar pavarësisht përpjekjeve të partive për ndryshime strukturore dhe prurjeve të reja, veçanërisht nga akterët e shoqërisë civile¹³⁴ të cilët janë emëruar në poste të larta drejtuese. Në këtë drejtim, organizatat e shoqërisë civile kanë një nivel bashkëpunimi me partitë politike që varet nga tema përkatëse



dhe nga interesat e partive politike, siç ishte rasti me kundërshtimin e projektligjit për financimin e partive politike nga shoqëria civile, i cili si një nismë u mbështet nga partitë opozitare.¹³⁵



Partitë politike i kushtojnë vëmendje llogaridhënies publike dhe luftës kundër korrupsionit kryesisht vetëm gjatë fushatave zgjedhore, por reformat dhe iniciativat pasuese në praktikë janë të fragmentuara dhe zakonisht larg arritjes së qëllimeve të tyre.

Lufta kundër korrupsionit dhe llogaridhënia publike kanë qenë pjesë e diskursit dhe retorikës politike për më shumë se një dekadë, por ajo është e kufizuar kryesisht në fushatat parazgjedhore. Në zgjedhjet e fundit parlamentare të vitit 2021, çështjet e drejtësisë dhe sundimit të ligjit, përfshirë luftën kundër korrupsionit, ishin ndër temat më të spikatura të aktiviteteve të fushatës së partive kryesore politike.¹³⁶ Këto çështje kanë gjetur hapësirë të konsiderueshme në platformat politike të subjekteve politike. Sipas raporteve të organizatave joqeveritare për premtimet e partive politike në fushën e sundimit të ligjit, LVV-ja gjatë vitit 2021 ka premtuar gjithsej 19 pika për luftimin e korrupsionit, pasuar nga PDK-ja me dhjetë, LDK-ja me pesë, dhe AAK-ja me katër pika apo premtime programore për luftën kundër korrupsionit.¹³⁷ Megjithatë, shumë nga premtimet e partive politike janë vlerësuar në kundërshtim me parimet kushtetuese dhe praktikatat ndërkombe-tare, ndërsa disa si të përealizueshme në praktikë.¹³⁸

Qeveria aktuale e drejtuar nga LVV-ja ka nisur të zbatojë premtimet dhe pikat programore që lidhen me luftën kundër korrupsionit, përfshirë procesin e vetingut në sistemin e drejtësisë,¹³⁹ konfiskimin e pasurive të pajustificueshme¹⁴⁰ dhe rritjen burimeve për institucionet e angazhuara në luftën kundër korrupsionit. Lufta kundër korrupsionit dhe rritja e llogaridhënies janë çështje që liderët e partive u kushtojnë rëndësi të madhe në deklaratat e tyre publike.^{141,142}



Ndërveprimet

Partitë politike në Kosovë kanë ndërveprime pothuajse me të gjitha institucionet në Kosovë. Megjithatë, ndërveprimet më të shpeshta përfshijnë Kuvendin dhe Qeverinë, KQZ-në dhe shoqërinë civile.

Partitë, përmes përfaqësimit të tyre politik në Kuvend dhe në qeveri, kanë mundësinë të shtyjnë nisma të ndryshme për përmirësimin e performancës së institucioneve në luftën kundër korrupsionit. Në kuadër të nismave për të luftuar korrupsionin, siç është procesi i vetingut, ka edhe një konsensus mes spektrit politik, i cili është shfaqur edhe në punën e komisionit përkatës parlamentar.¹⁴³

Sa i përket transparencës dhe llogaridhënies, veçanërisht në kuptimin financiar, partitë politike kanë ndërveprimin më aktiv me KQZ-në, veçanërisht me Zyrën. Ky ndërveprim buron nga detyrimet ligjore për raportimin financiar,¹⁴⁴ por lidhet edhe me funksionimin e brendshëm të partive politike.¹⁴⁵ Ndërkohë, për të rritur kapacitetet dhe cilësinë e raportimit financiar të partive politike, Zyra dhe KQZ-ja organizojnë edhe sesione trajnimi për përfaqësuesit financiarë të partive politike.¹⁴⁶

Sa i përket rritjes së kapaciteteve të brendshme të partive politike, organizatat ndërkombëtare dhe organizatat joqeveritare vendore luajnë rol të rëndësishëm duke ofruar trajnime dhe forma të tjera të mbështetjes që synojnë përmirësimin e integritetit të brendshëm të partive politike.¹⁴⁷

Rekomandimet e shtyllës

- Kuvendi i Kosovës duhet të iniciojë konsultime dhe procedura legjislativë për kodifikimin e të gjitha rregulloreve për partitë politike në një ligj të vetëm për partitë politike. Ligji i ri duhet të përcaktojë qartë prerogativat, detyrimet dhe kushtet e tjera që u mundësojnë partive politike të përmbushin funksionet e tyre në shoqëri, duke përfshirë minimalisht dispozita që sigurojnë:
 - Funksionalitet – procedurat e regjistrimit, statusin ligjor dhe organizimin strukturor;
 - Demokraci të brendshme – procedurat e përzgjedhjes së kandidatëve, miratimin e platformave partiake dhe dokumenteve të tjera të rëndësishme qeverisëse dhe zgjedhjen e pozitave dhe organeve qendrore qeverisëse;
 - Përfshirja e grave në vendimmarrjen e lartë dhe buxhetimin gjinor;
 - Transparenca financiare.
- Kuvendi i Kosovës duhet të rishikojë Ligjin për Financimin e Subjekteve Politike për:
 - Vënien e obligimeve për kandidatët e subjekteve politike që të raportojnë në Zyrë për të ardhurat dhe shpenzimet e tyre nga aktivitetet e tyre të fushatës, duke përfshirë edhe vetëfinancimin, në të njëjtat kushte si subjektet politike.
 - Donacionet e bëra nga kandidatët për fushatën e tyre (vetëfinancimi) t'i nënshtrohen të njëjtëve kufij dhe kushte që janë të zbatueshme për kontribuuesit ose burimet tjera të financimit e tjerë ose burimet e fondeve, duke përfshirë donacionet për organizatat e tyre politike.
 - Të sigurohet që mosrespektimi dhe shkeljet e detyrimeve të financimit politik të ballafaqohen me sanksione të rrepta, duke filluar nga përgjegjësia administrative dhe penale, proporcionalisht me peshën e shkeljeve në lidhje me transparencën dhe llogaridhënien financiare.
 - Të kërkohet një deklaratë të pronësisë përfituese (beneficial ownership) nga kompanitë që bëjnë donacione për partitë politike ose kandidatët (për të verifikuar lidhjet me kontraktuesit publikë dhe për të siguruar që donacionet nga persona juridikë të mos vijnë nga subjekte dhe individë të huaj).
 - T'i kërkohet Zyrës brenda KQZ-së që të mundësojë dorëzim digjital të raporteve financiare, në mënyrë që informacioni të mund të përdoret nga OSHC-të dhe agjencitë e tjera për qëllime shqyrtimi dhe verifikimi.
- Partitë politike duhet të miratojnë politika të brendshme për të rritur pjesëmarrjen e grave në vendimmarrje duke promovuar modelin e përfaqësimit "zebra" – me çdo listë zgjedhore të partive politike që përfshin 50 për qind të grave. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet buxhetimit të barabartë gjinor, pra përgatitjes së buxhetit të partisë duke marrë parasysh perspektivat gjinore.



REFERENCAT

- 1 Për më shumë, shihni Regjistrin e Partive Politike të KQZ-së, përditësuar për herë të fundit më 18 janar 2023. Gjetet në: <https://kqz-ks.org/wp-content/uploads/2023/01/Regjistri-i-Partive.pdf> [qasur më 6 shkurt 2023]
- 2 Ligji nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (2008), neni 11.
- 3 Barometri i Sigurisë së Ballkanit Perëndimor, Perceptimi Publik mbi Besimin, Korrupsionin dhe Integritetin e Institucioneve Publike në Kosovë, (QKSS: Prishtinë, 2022) Fq. 8.
- 4 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 44.
- 5 Rregullorja nr. 01/2013 – Regjistrimi dhe funksionimi i partive politike, neni 3.
- 6 Rregullorja Nr. 01/2013 – Regjistrimi dhe Veprimtaria e Partive Politike, neni 3, paragrafi 1, pika 9.
- 7 Ligji për zgjedhjet e përgjithshme, neni 12, pika 4.
- 8 Ligji për zgjedhjet e përgjithshme, neni 12, pika 5.
- 9 Rregullorja nr. 01/2013 – Regjistrimi dhe funksionimi i partive politike, neni 5.
- 10 Rregullorja nr. 01/2013 – Regjistrimi dhe funksionimi i partive politike, neni 9.
- 11 Sipas Kodit të Sjelljes për subjektet politike, mbështetësit dhe kandidatët e tyre, veprimet e ndaluara gjatë fushatës përfshijnë dëmtimin e materialeve të fushatës së partive të tjera, vendosjen e materialeve të fushatës në hapësira publike, mbajtjen e armëve, prishjen e aktiviteteve të fushatës së partive të tjera, pengimin e gazetarëve, blerjen dhe shitjen e votave, përdorimin e gjuhës së urrejtjes dhe të tjera. Për më shumë, shih Rregulloren Zgjedhore Nr. 11/2013 Kodi i Sjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit dhe Kandidatët e tyre, nenet 4, 5, 6 dhe 7.
- 12 Rregullorja Nr. 01/2013 – Regjistrimi dhe Veprimtaria e Partive Politike, neni 15, paragrafi 4.
- 13 Ligji për financimin e subjekteve politike, neni 4, paragrafi 1, pika 3.
- 14 Ligji për financimin e subjekteve politike, neni 7, paragrafi 1, pika 3.
- 15 Ligji për financimin e subjekteve politike, neni 8.
- 16 Ligji për financimin e subjekteve politike, neni 9, pika 1.
- 17 Ligji për financimin e subjekteve politike, neni 10, pika 1.
- 18 Ligji për financimin e subjekteve politike, neni 10, pika 2.
- 19 Vendim i KQZ-së për ndarjen e shumës së fondeve nga Fondi për Mbështetjen e Subjekteve Politike për periudhën 1 janar 2023 deri më 31 dhjetor 2023, faqe 16 dhe 17. Gjetet në: https://kqz-ks.org/wp-content/uploads/2023/01/Vendimet-02-2023_al-1.pdf [qasur më 6 shkurt 2023]
- 20 Raporti Vjetor Financiar i Lëvizjes Vetëvendosje për vitin 2021. Gjetet në: https://kqz-ks.org/wp-content/uploads/2022/10/LVV_Redacted.pdf [qasur më 9 shkurt 2023]
- 21 Raporti Vjetor Financiar i Partisë Demokratike të Kosovës për vitin 2021. Gjetet në: https://kqz-ks.org/wp-content/uploads/2022/10/PDK_Redacted.pdf [qasur më 9 shkurt 2023]
- 22 Raporti Vjetor Financiar i Lidhjes Demokratike të Kosovës për vitin 2021. Gjetet në: https://kqz-ks.org/wp-content/uploads/2022/10/LDK_Redacted.pdf [qasur më 9 shkurt 2023]
- 23 Raporti Vjetor Financiar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës për vitin 2021. Gjetet në: https://kqz-ks.org/wp-content/uploads/2022/10/AAK_Redacted.pdf [qasur më 9 shkurt 2023]
- 24 Raporti Vjetor Financiar i Listës Serbe për 2021. Gjetet në: https://kqz-ks.org/wp-content/uploads/2022/10/SRPSKA-LISTA_Redacted.pdf [qasur më 9 shkurt 2023]
- 25 Radio Evropa e Lirë, Sekreti i financimit të partive politike (nëntor, 2020). Gjetet në: <https://www.evropaelire.org/a/30930142.htm> [qasur më 13 shkurt 2023]
- 26 Ligji për financimin e subjekteve politike, neni 11, paragrafi 1, pika 6.
- 27 "Demokracia në Veprim", Raporti i monitorimit të medieve gjatë fushatës zgjedhore – Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës (Prishtinë: DnV, 2021), Fq. 13.
- 28 "Misioni i Vëzhgimit të Zgjedhjeve të Bashkimit Evropian – Kosovë 2021", Raporti Përfundimtar për Zgjedhjet Komunale 2021 (Prishtinë: EUEOM, 2021), Fq. 26.
- 29 Ligji për zgjedhjet e përgjithshme, neni 14, pika 1.
- 30 Ligji për përgjegjësinë e personave juridikë për vepra penale, neni 11, paragrafi 2, dhe neni 31, paragrafi 2.
- 31 Ligji për financimin e subjekteve politike, neni 18, pika 17.
- 32 Rregullorja Nr. 01/2013 – Regjistrimi dhe Veprimtaria e Partive Politike, neni 15, paragrafi 6.
- 33 Ligji për financimin e subjekteve politike, neni 19.
- 34 Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, neni 87.
- 35 "Misioni i Vëzhgimit të Zgjedhjeve të Bashkimit Evropian – Kosovë 2019", Raporti Përfundimtar për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare 2019 (Prishtinë: EUEOM, 2019), fq. 2, 4, dhe 22.
- 36 Për më shumë, shihni artikujt medial që lidhen me arrestimet: <https://albanianpost.com/arrestohet-daradan-molligaj/> [qasur më 6 shkurt 2023]; <https://albanianpost.com/arrestohen-disa-aktiviste-te-psd-se/> [qasur më 6 shkurt 2023]; <https://euronews.al/sulm-ne-godinen-e-qeverise-arrestohen-4-aktiviste-te-psd-se/> [qasur më 6 shkurt 2023]
- 37 Për më shumë, shihni artikujt medial që lidhen me arrestimet: <https://ekonomiaonline.com/arrestohen-dy-aktiviste-te-pdk-se-ne-aksionin-para-mp-ld-se/> [qasur më 6 shkurt 2023]; <https://kosovapress.com/pdk-nuk-arrestohet-martini-arrestohet-miloti/> [qasur më 6 shkurt 2023]





38 Për më shumë, shihni artikujt medial që lidhen me lirim e të arrestuarve: <https://kosovapress.com/lirohet-aktivisti-i-pdk-se-milot-krasnqi/> [qasur më 6 shkurt 2023]; <https://www.gazetaexpress.com/lirohet-dardan-molliqaj/> [qasur më 6 shkurt 2023]; <https://abcnews.al/lirohet-dardan-molliqaj-dhe-aktivistet-e-tjere-te-psd/> [qasur më 6 shkurt 2023]

39 Portali Insajderi, Prokuroria: Aktivistët e arrestuar të LVV-së dyshohen për terrorizëm (nëntor, 2016). Gjetet në: <https://insajderi.com/prokuroria-aktivistet-e-arrestuar-te-vv-se-dyshohen-per-terrorizem/> [qasur më 6 shkurt 2023]

40 Koha.Net, Vdes aktivisti i Lëvizjes Vetëvendosje, Astrit Dehari, i parburgosur në burgun e Prizrenit. (nëntor, 2016). Gjetet në: <https://archive.koha.net/?id=&l=140983> [qasur më 6 shkurt 2023]

41 Portali Insajderi, LVV: Arrestimet e aktivistëve, persekutimi i kundërshtarëve politikë (gusht, 2016). Gjetet në: <https://insajderi.org/vv-arrestimet-e-aktivisteve-perndjekje-e-kundershtareve-politike/> [qasur më 6 shkurt 2023]

42 Betimi për Drejtësi, Të katër aktivistët e LVV-së u shpallën fajtorë për terrorizëm, mbi 21 vjet burg (nëntor, 2017). Gjetet në: <https://betimiperdrejtisi.com/shpallen-fajto-re-per-terrorizem-mbi-21-vjet-burgim-per-kater-aktivistet-e-vv-se/> [qasur më 6 shkurt 2023]

43 Dukagjini, Sulm në Kuvend: Ish-aktivistët dhe aktivistët e LVV-së lirohen nga akuzat (dhjetor, 2022). Gjetet në: <https://www.dukagjini.com/sulmi-ne-kuvend-lirohen-nga-akuzat-ish-aktivistet-dhe-aktivistet-e-lvv-se/> [qasur më 6 shkurt 2023]

44 Raporti i Freedom House, Liria në botë 2022 – Kosovë. Gjetet në: <https://freedomhouse.org/country/kosovo/freedom-world/2022> [qasur më 7 shkurt 2023]

45 "Misioni i Vëzhgimit të Zgjedhjeve të Bashkimit Evropian – Kosovë 2019", Raporti Përfundimtar për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare 2019 (Prishtinë: EUEOM, 2019), fq. 2, 4, dhe 22.

46 Radio Evropa e Lirë, Beogradi është fajësuar për nxitjen e tensioneve mes serbëve të Kosovës (shtator, 2019). Gjetet në: <https://www.evropaelire.org/a/veri-tensione-beogradi-serbet-kosove-/30163084.html> [qasur më 28 gusht 2023]

47 Ligji për financimin e subjekteve politike, neni 15, pika 1.

48 Ligji për financimin e subjekteve politike, neni 15, pika 3.

49 Ligji për financimin e subjekteve politike, neni 15, paragrafi 3, pika 4.

50 Ligji për financimin e subjekteve politike, neni 19, pika 16.

51 Ligji për financimin e subjekteve politike, neni 15, paragrafi 5, pika 2.

52 Ligji për financimin e subjekteve politike, neni 15, paragrafi 5.

53 Ligji për financimin e subjekteve politike, neni 19/A, paragrafi 1.

54 Ligji për financimin e subjekteve politike, neni 19/A, paragrafi 3.

55 Ligji për zgjedhjet e përgjithshme, neni 43.

56 Ligji për financimin e subjekteve politike, neni 15, paragrafi 4.

57 Ligji për financimin e subjekteve politike, neni 15, paragrafi 3, pika 2.

58 Ligji për financimin e subjekteve politike, neni 11, pika 4.

59 Intervistë me Nexhmedin Hysenin, ish-drejtor i Zyrës për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim në KQZ, mars 2022.

60 Për më shumë, shihni: <https://kallxo.com/gjate-deja-vu-ne-tenderet-e-kuvendit-per-auditimin-kuletet-se-partive-politike/>

61 Raportet financiare të partive politike për periudhën 2013-2016 janë audituar vetëm në vitin 2019.

62 Për më shumë shihni njoftimin e KQZ-së. Gjetet në: <https://kqz-ks.org/kqz-publikoi-raportet-financiare-te-partive-politike-per-vitit-2019/> [qasur më 10 shkurt 2023]

63 Megjithatë, as në faqen e KQZ-së nuk publikohen raportet financiare vjetore të partive politike për periudhën 2010-2019.

64 Për më shumë, shihni seksionin Shërbimet për subjektet politike në faqen e internetit të KQZ-së. Gjetet në: <https://kqz-ks.org/sherbime-per-subjektet-politike/raportet-financiare-te-fushatave-zgjedhore-te-audituar/> [qasur më 10 shkurt 2023]

65 Për më shumë shihni faqen e Lëvizjes Vetëvendosje. Gjetet në: https://www.vetevendosje.org/publikimet_tax/raporte/ [qasur më 10 shkurt 2023]

66 Faqja e internetit e Partisë Demokratike të Kosovës aktualisht nuk funksionon. Lidhja Demokratike e Kosovës nuk i ka publikuar raportet financiare në ueb faqen e saj. Në faqen e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës janë publikuar vetëm raportet vjetore financiare para vitit 2016.

67 "Demokracia në Veprim", Raport mbi fushatën e zgjedhjeve lokale 2021 (Prishtinë: DnV, 2021), Fq. 14.

68 Pavarësia funksionale e Zyrës do të garantohet përmes metodës së përzgjedhjes dhe raportimit të Drejtorit. Ndryshe nga situata aktuale, Drejtori i Zyrës nuk do të zgjidhet apo shkarkohet nga përbërja e plotë (politike) e KQZ-së. Kjo kompetencë tani i takon një paneli të përbërë nga Kryetari i KQZ-së dhe krerët e katër institucioneve të pavarura: Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, Avokati i Popullit, Agjencia për Informim dhe Privatësi, si dhe Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Për më shumë shih nenin 11.2/b të Ligjit të ndryshuar për financimin e subjekteve politike.

69 Sipas nenit 11.1/c të ligjit të ndryshuar për financimin e subjekteve politike, për auditimin e financave të subjekteve politike, Zyra do të ketë buxhet shtesë në masën jo më pak se 5 për qind të Fondit për Mbështetjen e Subjekteve Politike. Ndërkohë, një buxhet shtesë prej jo më pak se 3 për qind e Fondit do t'i ndahet Zyrës për auditimin e raporteve financiare të fushatës zgjedhore gjatë cikleve zgjedhore. Zyra gjithashtu do të ketë të paktën dhjetë persona të angazhuar si staf.

70 Ligji për financimin e subjekteve politike, neni 19, paragrafi 1, pika 2.

71 Ligji për financimin e subjekteve politike, neni 21, paragrafi 1, pika 12.

72 Sipas legjisllacionit të mëparshëm, Zyra kishte të drejtë vetëm të propozonte shqiptimin e gjobave ndaj subjekteve politike, ndërsa vendimin për shqiptimin e gjobave duhej ta merrte KQZ-ja.

73 Ligji për financimin e subjekteve politike, neni 15 dhe 19.

74 Ligji për financimin e subjekteve politike, neni 15, paragrafi 2, pika 3.

75 Ligji për financimin e subjekteve politike, neni 15, paragrafi 1.

76 Sipas nenit 40, paragrafi 2, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, raportet financiare të fushatës duhet të përmbajnë të dhëna të plota për të ardhurat e subjektit politik, duke përfshirë burimin dhe datën e të gjitha kontributeve në para, të gjitha shpenzimet, duke përfshirë shpenzimet e fushatës, si dhe një bilanc që paraqet asetet, detyrimet dhe kapitalin e njësisë ekonomike.

77 Ligji për zgjedhjet e përgjithshme, neni 40.



78 Shtojcat e Rregullores Nr. 14/2015 – Financimi i subjekteve politike dhe sanksionet.

79 Ligji për financimin e subjekteve politike, neni 11, paragrafi 4.

80 Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme, neni 43, paragrafi 1, pika c.

81 Ligji për financimin e subjekteve politike, neni 21, paragrafi 6.

82 Ligji për financimin e subjekteve politike, neni 21, paragrafi 13.

83 Ligji për financimin e subjekteve politike, neni 21, paragrafi 6.

84 Intervistë me një zyrtar të Zyrës për Regjistrimin, Certifikimin dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike, shkurt 2023.

85 Informacioni i siguruar nga Zyra për Regjistrim, Certifikimi dhe Kontroll Financiar të Subjekteve Politike në kopje fizike, në qershor 2022.

86 Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën, për vitin 2021. Fq. 25.

87 Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën, për vitin 2022. Fq. 26.

88 Raporti i Auditorëve të Pavarur mbi Pasqyrat Financiare të fushatës së Lëvizjes Vetëvendosje për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të vitit 2019. Fq. 3

89 Raporti i Auditorëve të Pavarur mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës për vitin 2019. Fq. 3.

90 Gjetet nga Raportet e Auditimit të Raporteve Vjetore Financiare dhe Raportet e Fushatës së Subjekteve Politike për 2018, 2019 dhe 2020.

91 Intervistë me një zyrtar të Zyrës për Regjistrimin, Certifikimin dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike, shkurt 2023.

92 "Demokracia në Veprim", Raporti i Vëzhgimit të Zgjedhjeve – Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës 2019, (Prishtinë: DnV, 2019), Fq. 33.

93 Rregullorja Nr. 01/2013 – Regjistrimi dhe Veprimtaria e Partive Politike, neni 15, paragrafët 1 dhe 3.

94 Rregullorja nr. 01/2013 – Regjistrimi dhe funksionimi i partive politike, neni 16.

95 Statuti i Lëvizjes Vetëvendosje, neni 28.

96 Statuti i Partisë Demokratike të Kosovës, neni 36.

97 Statuti i Lidhjes Demokratike të Kosovës, neni 19.

98 Statuti i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, neni 13, paragrafët 6, 8 dhe 9.

99 Statuti i Lidhjes Demokratike të Kosovës, neni 25, paragrafi 2.

100 Statuti i Lidhjes Demokratike të Kosovës, neni 21.

101 Statuti i Partisë Demokratike të Kosovës, neni 38, paragrafi 2, dhe neni 41, paragrafi 4.

102 Sipas Statutit të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, neni 41, paragrafi 3, votimi për çështjet e personelit është i fshehtë.

103 Sipas Statutit të Lëvizjes Vetëvendosje, neni 87, gjysma e kandidatëve propozohen nga qendrat, një e katërta nga kryetari dhe një e katërta nga kryesia e partisë.

104 Statuti i Lidhjes Demokratike të Kosovës, neni 24.

105 Statuti i Partisë Demokratike të Kosovës, neni 39, paragrafi 8, dhe neni 44, paragrafi 13.

106 Sipas Statutit të Lëvizjes Vetëvendosje, neni 42, listat zgjedhore për nivel lokal miratohen nga Kryesia e Qendrës në koordinim me Sekretarin Organizativ të partisë.

107 Sipas Statutit të Lidhjes Demokratike të Kosovës, neni 45, paragrafi 4, për listën e kandidatëve në nivel lokal vendos kryetari i degës.

108 Sipas Statutit të Partisë Demokratike të Kosovës, neni 85, paragrafi 2, listat e kandidatëve për zgjedhjet lokale përgatiten nga kryetari i degës dhe duhet të marrin pëlqimin e kryesisë së partisë.

109 Sipas Statutit të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, neni 18, paragrafi 12, listat e kandidatëve në nivel lokal miratohen nga kryesia e partisë, pas propozimit të kryesisë së degës.

110 Radio Evropa e Lirë, Partitë në duart e liderëve (qershor, 2019). Gjetet në: <https://www.evropaelire.org/a/partite-kosova-profilizimi/30002226.html> [qasur më 27 shkurt 2023]

111 Radio Evropa e Lirë, Haziri dhe Abdixhiku, kandidatë për kryetar të LDK-së (mars, 2021). Gjetet në: <https://www.evropaelire.org/a/31140245.html> [qasur më 27 shkurt 2023]

112 Portali Insajderi, Albin Kurti, kandidati i vetëm për kryetar të LVV-së (dhjetor, 2017). Gjetet në: <https://insajderi.com/albin-kurti-kandidat-vetem-per-kryetar-te-vv-se/> [qasur më 27 shkurt 2023]; Portali AlbanianPost, Memli Krasniqi, kandidati i vetëm për kryetar të PDK-së (korrik, 2021). Gjetet në: <https://albanianpost.com/memli-krasnqi-kandidati-i-vetem-per-kryetar-te-pdk-se/> [qasur më 27 shkurt 2023]; Gazeta Express, Ramush Haradinaj është sërish kandidati i vetëm për kryetar të AAK-së (qershor, 2022). Gjetet në: <https://www.gazetaexpress.com/ramush-haradinaj-serish-i-vetmi-kandidat-per-kryetar-te-aak-se/> [qasur më 27 shkurt 2023]

113 Adem Beha, Midis Stabilitetit dhe Demokratizimit (Prishtinë: Qendra për Guxim Politik dhe Departamenti i Shkencave Politike, Universiteti i Prishtinës, 2017). Fq. 207.

114 Portali Insajderi, Albin Kurti, kandidati i vetëm për kryetar të LVV-së (dhjetor, 2017). Gjetet në: <https://insajderi.com/albin-kurti-kandidat-vetem-per-kryetar-te-vv-se/> [qasur më 27 shkurt 2023]

115 Portali Koha Jonë, Lëvizja Vetëvendosje është e ndarë (mars, 2018). Gjetet në: <https://kohajone.com/ndahet-levizja-vetevendosje/> [qasur më 27 shkurt 2023]

116 Radio Evropa e Lirë, Lumir Abdixhiku zgjidhet kryetar i ri i LDK-së (mars, 2021). Gjetet në: <https://www.evropaelire.org/a/ldk-kryetari-i-ri-/31149466.html> [qasur më 27 shkurt 2023]

117 Adem Beha, Midis Stabilitetit dhe Demokratizimit (Prishtinë: Qendra për Guxim Politik dhe Departamenti i Shkencave Politike, Universiteti i Prishtinës, 2017). Fq. 251.

118 Beha, 2017: 265.

119 "Demokracia në Veprim", Raport mbi fushatën e zgjedhjeve lokale 2021 (Prishtinë: DnV, 2021), Fq. 12.

120 Ligji për zgjedhjet e përgjithshme, neni 27, pika 1.

121 Ligji për zgjedhjet e përgjithshme, neni 111.

122 Rregullorja Zgjedhore Nr. 08/2013 – Certifikimi i subjekteve politike dhe kandidatëve të tyre, nenet 5 dhe 6.





- 123 Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme, neni 112, paragrafi 2, pika a.
- 124 Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese në rastet KI45/20 dhe KI46/20 (2021). Gjetet në: https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2021/03/ki_45-46_20_agj_shq.pdf [qasur më 27 shkurt 2023]
- 125 Nëpërmjet këtij aktgjykimi, Gjykata kishte vendosur që qëllimi i kuotës gjinore prej 30 për qind – si masë e veçantë për të ndihmuar arritjen e përfaqësimit të barabartë ndërmjet dy gjinive në Kuvendin e Republikës – është që përfaqësimi i gjinisë më pak të përfaqësuar të mos jetë nën 30 për qind dhe jo që ky të konsiderohet si kufiri maksimal i përfaqësimit.
- 126 Për më shumë shikoni Regjistrin e Partive Politike në faqen e KQZ-së. Gjetet në: <https://kqz-ks.org/wp-content/uploads/2023/01/Regjistri-i-Partive.pdf> [qasur më 27 shkurt 2023]
- 127 Adem Beha, Midis Stabilitetit dhe Demokratizimit (Prishtinë: Qendra për Guxim Politik dhe Departamenti i Shkencave Politike, Universiteti i Prishtinës, 2017). Fq. 81.
- 128 Doan Tahirbegolli, Partitë politike në Kosovë, profilizimi dhe funksionimi i tyre [Teza dhe Disertacione] (Universiteti për Biznes dhe Teknologji në Kosovë: 2020). Fq. 25 dhe 26.
- 129 Demokracia për Zhvillim, Busulla ideologjike e Kosovës – Evolucioni i orientimit partiak 2014-2020, Vlerat dhe populizmi (Prishtinë: D4D, 2020). Fq. 70.
- 130 Demokracia për Zhvillim, 2020: 67
- 131 Beha, 2017: 210
- 132 Demokracia për Zhvillim, Busulla ideologjike e Kosovës – Evolucioni i orientimit partiak 2014-2020, Vlerat dhe populizmi (Prishtinë: D4D, 2020). Fq. 13.
- 133 Barometri i Sigurisë së Ballkanit Perëndimor, Perceptimi Publik mbi Besimin, Korrupsionin dhe Integritetin e Institucioneve Publike në Kosovë, 2022 (Prishtinë: QKSS, 2022). Fq. 8.
- 134 Kosova 2.0, Konteksti: Nga shoqëria civile në politikë – çfarë ndryshon? (Shtator, 2019). Gjetet në: <https://kosovotwopointzero.com/konteksti-prej-shoqerise-civile-ne-politike-cka-ndryshon/> [qasur më 27 shkurt 2023]
- 135 Ekonomia Online, Shoqëria civile marshon në kundërshtim të Projektligjit për Financimin e Subjekteve Politike (qershor, 2019). Gjetet në: <https://ekonomiaonline.com/marshohet-ne-kundershtim-te-projektligjit-per-financimin-e-partive-vv-ja-pajtohet/> [qasur më 28 shkurt 2023]
- 136 "Demokracia në Veprim", Raporti i Monitorimit të Fushatës Zgjedhore – Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës, 14 shkurt 2021 (Prishtinë: DnV, 2021), Fq. 22.
- 137 IKD: Programe të partive politike në fushën e drejtësisë të mbushura me populizëm dhe ndërhyrje në drejtësi (shkurt, 2021). Gjetet në: <https://kli-ks.org/ikd-programet-e-partive-politike-ne-fushen-e-sistemit-te-drejtises-te-mbushura-me-popullizma-dhe-nderhyrje-ne-drejtisi/> [qasur më 1 mars 2023]
- 138 IKD: Programe të partive politike në fushën e drejtësisë të mbushura me populizëm dhe ndërhyrje në drejtësi (shkurt, 2021). Gjetet në: <https://kli-ks.org/ikd-programet-e-partive-politike-ne-fushen-e-sistemit-te-drejtises-te-mbushura-me-popullizma-dhe-nderhyrje-ne-drejtisi/> [qasur më 1 mars 2023]
- 139 Lëvizja Vetëvendosje, Dosja me dokumentet e vetingut është dorëzuar në Kuvend. (shtator, 2022). Gjetet në: <https://www.vetevendosje.org/dorezohet-ne-kuvend-dosja-e-dokumente-per-vetting/> [qasur më 14 gusht 2023]
- 140 Kallxo.Com, Miratohet Ligji për Byronë e Konfiskimit të Pasurive të Pajustificuara (shkurt, 2023). Gjetet në: <https://kallxo.com/lajm/miratohet-ligji-per-byrone-e-konfiskimit-te-pasurise-se-pajustificueshme/> [qasur më 14 gusht 2023]
- 141 Koha.Net, Kurti: Lufta kundër korrupsionit u mohua nga elitat politike që vodhën të ardhmen (janar, 2023). Gjetet në: <https://www.koha.net/arberi/363698/kurti-luftimi-i-korrupsionit-u-mohua-nga-elitat-politike-qe-vidhnen-te-ardhmen/> [qasur më 1 mars 2023]
- 142 Epoka e Re, Kurti: Lufta kundër korrupsionit nuk është e pashpresë (korrik 2022). Gjetet në: <https://www.epokaere.com/kurti-luftimi-korrupsionit-nuk-eshte-pashprese/> [qasur më 1 mars 2023]
- 143 Instituti Demokratik i Kosovës, Vetingu drejt Gjykatës Kushtetuese. Draft-amendamentet u finalizuan me konsensus të gjerë politik (mars, 2023). Gjetet në: <https://www.facebook.com/kosovademocraticinstitute/posts/pfbid0cCaHiBtP9sc3isup4mi6QxPLXp4RKPPvTJigapLjfZZPm8HTmT1u4SjnvwmN-qtI> [qasur më 2 mars 2023]
- 144 Ligji për financimin e subjekteve politike, neni 15 dhe 19.
- 145 Rregullorja nr. 01/2013 – Regjistrimi dhe funksionimi i partive politike.
- 146 Komisioni Qendror Zgjedhor, KQZ-ja zhvillon trajnime me përfaqësuesit financiarë të partive politike për hartimin e raportit financiar vjetor (shkurt, 2023). Gjetet në: <https://kqz-ks.org/kqz-mban-trajnim-me-perfaqesuesit-financiar-te-partive-politike-per-hartimin-e-raportit-vjetor-financiar-2/> [qasur më 2 mars 2023]
- 147 Intervistë me burim anonim nga një parti politike, shkurt 2023.







MEDIET

> |> > >< <><> ><> > ><>

PËRMBLEDHJE

Në Kosovë ka 19 stacione televizive, 89 radio stacione, 41 operatorë të shpërndarjes dhe 94 ofrues të shërbimeve mediale audio-vizuale, të licencuar nga Komisioni i Pavarur për Medie (KPM).

70/100 Rezultati i përgjithshëm i shtyllës





KPM-ja është autoriteti kryesor rregullativ për mediet vizive, mbi të cilat shteti ka autoritet ligjor. Nga ana tjetër, media e shkruar është e vetërregulluar dhe e përfaqësuar nga Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës (KMSHK). Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK) është organizatë që luan rol thelbësor në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të gazetarëve si dhe edukimin e tyre joformal.

Kushtetuta garanton të drejtat dhe liritë e gazetarëve. Megjithatë, në praktikë, ato janë pjesë e ndërhyrjeve të përditshme nga shteti apo individë të ndryshëm. Transmetuesi publik ka buxhet të ndarë nga Kuvendi, ndërsa mediet e tjera kryesisht vetëfinancohen ose financohen nga aktivitetet e marketingut.

Korniza ligjore nuk ka pësuar asnjë ndryshim vitet e fundit dhe, si e tillë, mbetet e fragmentuar në mbulimin e sektorit të medieve. Ende nuk është miratuar Ligji për Media, i cili do të mundësonte zgjidhjen e çështjeve që kanë të bëjnë me funksionimin e medieve në përgjithësi.

Presioni politik në formën e padive strategjike kundër pjesëmarrjes publike (paditë SLAPP) dhe sulmet verbale ndaj medieve dhe sulmet ndaj gazetarëve janë shqetësime. Lajmet e publikuara shpesh krijojnë mosmarrëveshje brenda sektorit të biznesit dhe sektorit të medieve sa u përket sponsorizimeve. Media vazhdon të jetë zëri i spikatur për ekspozimin dhe hetimin e rasteve të korrupsionit, megjithëse rezultatet nuk janë aspak të kënaqshme. Pronësia e medieve vazhdon të mbetet një zonë që i nënshtrohet zbulimit të paqartë të informacionit. Kjo vlen veçanërisht për mediet online.

Pas pandemisë COVID-19, të gjitha gazetatat në vend kanë ndërprerë botimin. Mediet online, si portalet, nuk janë të rregulluara me ligj, gjë që krijon vështirësi në drejtim të kontrollit, veçanërisht në lidhje me lajmet e rreme.



Kapacitetet

INDIKATORI 12.1.1 BURIMET (SIPAS LIGJIT)

75/100



Korniza ligjore që ka të bëjë me ekzistencën dhe funksionimin e medieve është përgjithësisht e favorshme për medie të pavarura dhe të larmishme. Megjithatë, mungon rregullimi mbi funksionimin e portaleve online në lidhje me lajmet e rreme, gjuhën e urrejtjes dhe kërcënimet në seksionet e komenteve të medieve online.

Transmetuesit duhet të marrin licencë nga KPM-ja, ndërsa mediet e shkruara vetërregullohen përmes KMSHK-së.¹ Në vitin 2021, qeveria inicioi një grup punues për hartimin e ndryshimeve të Ligjit për Komisionin e Pavarur të Mediave për ta harmonizuar atë me Direktivat e BE-së për mediet digjitale. Megjithatë, ky proces nuk ka vazhduar.² Aktualisht, KPM-ja lëshon licenca për periudhë shtatëvjeçare për transmetuesit e radios dhe dhjetë vjet për shërbimet mediale audio-vizuale.³

KPM-ja mund të refuzojë ose të mos vazhdojë licencat për ofruesit e medieve audio-vizuale⁴ kur licencat e transmetimit kërkojnë nga akterë të caktuar, si partitë politike, komunitetet fetare, grupet ose organizatat e menaxhuara nga individë që mbajnë funksione publike.⁵ Megjithatë, këto refuzime duhet të arsyetohen me shkrim.⁶

Mediat e shkruara nuk kanë asnjë rregullim në lidhje me kufizimet e krijimit të tyre. Këto media mbikëqyren vetëm nga KMSHK-ja, i cili funksionon bazuar në një Kod Etike.⁷ KMSHK-ja punon me një bord dhe sekretariat që merret

drejtpërdrejt me ankesat për shkelje të këtij bordi por jo me licencimin e medieve. Mediet e shkruara janë thjesht pjesë e organizatës.⁸

Dispozitat ligjore promovojnë larminë e medieve në raport me konkurrencën dhe detyrimet e medieve për të ofruar shërbime mediatike duke promovuar konkurrencë të ndershme.⁹

INDIKATORI 12.1.2 BURIMET (NË PRAKTIKË)

75/100



Burime të shumta mediatike mbulojnë të gjitha çështjet politike dhe spektrin shoqëror. Megjithatë, mungesa e burimeve financiare i bën ata të pambrojtur ndaj ndikimit politik dhe atij nga bizneset.

Aktualisht, 19 stacione televizive, 89 radio stacione, 41 operatorë shpërndarjeje dhe 94 ofrues të shërbimeve mediatike audio-vizuale ofrojnë programet e tyre vetëm përmes rrjetit të operatorëve të shpërndarjes.¹⁰ Ato janë të licencuara nga KPM-ja dhe operojnë në territorin e Republikës së Kosovës.¹¹ Stacionet kryesore televizive janë të vendosura në kryeqytet, ndërsa shumë stacione televizive funksionojnë në zonat lokale. Ato veprojnë në gjuhën shqipe, serbe dhe gjuhët tjera të komuniteteve jo shumicë. Që nga viti 2020, Kosova nuk ka asnjë gazetë të shtypur si rezultat i mungesës së interesit, duke e bërë Kosovën të vetmen në rajon dhe në Evropë pa asnjë gazetë ditore të shtypur.¹² Ka edhe organizata joqeveritare që funksionojnë si gazeta online që mbulojnë tema sociale dhe politike në vend, si Kosova 2.0¹³ dhe Kallxo.com.¹⁴





Sipas drejtores ekzekutive të AGK-së, peizazhi mediatic reflekton një spektër të gjerë interesash të shoqërisë, duke pasur parasysh praninë e madhe mediatike në vend dhe mbulimin që këto media kanë në skemat e tyre programore dhe editoriale.¹⁵ Kjo u konfirmua edhe në analizën e vitit 2023 të Reporterëve pa Kufij duke vënë në dukje se Kosova ka "një treg pluralist dhe të gjallë mediatic".¹⁶

Problemi më i madh për mediet në vend është mungesa e financave, pasi ato financohen kryesisht nga aktivitetet reklamuese.¹⁷ Redaksitë e medieve private janë gjithashtu të ekspozuara ndaj ndërhyrjeve nga grupe të fuqishme politike ose bizneset nëpërmjet pronarëve të medieve (shih 12.1.4), duke shkaktuar një kërcënim për lirinë e medieve.¹⁸

Sipas redaktorit menaxhues të Kallxo.com, platformës online për raportimin e korrupsionit, shteti ka ndërprerë ndarjen e reklamave për media, dhe transmetuesi publik (RTK) po ashtu ka ndërprerë ndarjen e fondeve publike për organizatat e shoqërisë civile në vitin 2020 që kanë prodhuar programe të pavarura për RTK-në.¹⁹ RTK-ja bën përjashtim nga çështja e financimit pasi financohet nga buxheti i shtetit. Të gjitha mediet e tjera televizive tani transmetohen vetëm nëpërmjet kompanive private të transmetimit që operojnë si platforma televizive në vend.²⁰ Meqenëse kompanitë private të transmetimit janë të varura nga të ardhurat nga reklamat, kjo i ndikon pagat dhe përfitimet e punonjësve të medieve, por gjithashtu ndikon negativisht në shumëllojshmërinë e këndvështrimeve që ofrojnë mediet private.²¹

Sipas drejtores ekzekutive të AGK-së, gazetarët në përgjithësi kanë përgatitje adekuate akademike dhe profesionale, duke dhënë përvojën e tyre në fushatën që mbulojnë.²² Mungesa e vetëqëndrueshmërisë financiare i lë mediet, përfshirë transmetuesin publik, të cenueshme ndaj interesave politike dhe të biznesit (shih 12.1.4).²³

INDIKATORI 12.1.3 PAVARËSIA (SIPAS LIGJIT)

75/100



Edhe pse jo drejtpërdrejt nga një ligj specifik për medie, ekzistojnë masa mbrojtëse ligjore që parandalojnë ndërhyrjen e pajustificuar të jashtme në media. Megjithatë, Ligji Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes nuk ka pasur asnjë ndryshim që nga viti 2008 për t'iu përshtatur ndryshimeve të tjera ligjore.

Kushtetuta garanton lirinë e shprehjes dhe lirinë e medieve.²⁴ Mbrojtja juridike që parandalon ndërhyrjen në veprimtarinë e medieve është paraparë nga Ligji për KPM-në²⁵ dhe Ligji për Mbrojtjen e Burimeve të Gazetarisë.²⁶ Megjithatë, në përgjithësi mungon ligji për medie.

Dispozitat e përgjithshme sigurojnë pavarësinë editoriale, por ato kryesisht lidhen me sponsorizimin.²⁷ Ligji për KPM-në specifikon se programet e sponsorizuara nuk duhet të ndikojnë në përgjegjësinë dhe pavarësinë editoriale të medieve.²⁸ Kodi i Etikës për Mediet e Shkruara gjithashtu parashih që sponsorizimi nuk duhet të ndikojë në pavarësinë editoriale dhe përmbajtja duhet të jetë e qartë.²⁹ Kushtetuta ndalon censurën dhe specifikon se askush nuk mund të pengojë shpërndarjen e informacionit përmes medieve.³⁰

Gazetarët dhe profesionistët e tjerë të medieve kanë të drejtë të mos japin burimet e tyre të informacionit, përveç rasteve kur detyrohen nga gjykata për të parandaluar kërcënim serioz.³¹

Ligji për Qasjen në Dokumente Publike i garanton medieve të drejtën për të pasur qasje në informacion.³² Miratimi i këtij ligji në vitin 2019 ka krijuar hapësirë për mediet për pasqyrim më profesional të rasteve që janë me interes për publikun.



Ekzistenca dhe licencimi i medieve në vend janë bërë për të ofruar një hapësirë që mediet private të kenë hapësirë për të promovuar formatin e tyre.³³ Por licencimi nuk përkon me rregullimin e përmbajtjes së programeve transmetuese, pasi kjo rregullohet nga aktet nënligjore për ofruesit e shërbimeve audio dhe audio-vizuale.³⁴ Në parim, qeveria nuk kontrollon informacionin që shpërndan media, por raportet vjetore të KPM-së i dorëzohen dhe miratohen nga Kuvendi i Kosovës.³⁵

Ligji Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes, i cili daton nga viti 2008 dhe nuk është ndryshuar që atëherë³⁶ ka shkaktuar kërcënim për gazetarët që janë shënjestruar me padi SLAPP nga bizneset dhe politikanët (shih 12.1.4).

INDIKATORI 12.1.4 PAVARËSIA (NË PRAKTIKË)

50/100



Bizneset dhe politikanët ndërhyjnë herë pas here në aktivitetet mediatike. Këto raste të ndërhyrjeve zakonisht janë jo të rënda, si sulme kërcënuese verbale, pa pasoja të rëndësishme për sjelljen e medieve.

Puna e rregullatorëve të medieve është kritikuar shpesh, veçanërisht në lidhje me emërimet në borde dhe funksionimin e tyre.³⁷ Sipas Reporterëve pa Kufij, rregullatori i medieve, KPM-ja, ka qenë joefikas dhe së fundmi i përfshirë në një aferë korrupsioni.³⁸

Sipas Indeksit Botëror të Lirisë së Shtypit, Kosova ka bërë përparim në aspektin e lirisë së medieve dhe mund të konsiderohet kryesisht e lirë nga ndërhyrjet.³⁹ Megjithatë, liria e gazetarëve në vend është vënë në pikëpyetje kohët e fundit për shkak të rasteve të sulmeve dhe kërcënimeve të mëdha ndaj tyre.⁴⁰ Në raportin e fundit të vitit 2022 nga Human Rights Watch, liria e shprehjes në media u përshkrua si e minuar nga kërcënimet verbale të përdorura nga zyr-

tarët publikë.⁴¹ Raporti thekson se veprime të tilla dëmtojnë mediet dhe krijojnë një mjedis armiqësor për gazetarët. Për më tepër, raporti ka nënvizuar se interesat e qeverisë dhe të biznesit kanë ushtruar ndikim të padrejtë në linjat editoriale të medieve, përfshirë në RTK-në.⁴² Edhe pse bordi i transmetuesit publik RTK, ashtu si KPM-ja, zgjidhet drejtpërdrejt nga Parlamenti, duke e bërë atë të ndjeshëm ndaj ndikimeve politike, procedura për emërimin e anëtarëve të tij në fund të vitit 2021 u konsiderua transparente nga grupet mbrojtëse të lirisë së medieve.⁴³ Gjatë vitit 2022, AGK-ja ka regjistruar 33 raste të sulmeve, kërcënimeve dhe frikësimeve ndaj gazetarëve dhe medieve.⁴⁴

Në të kaluarën, ka pasur një tendencë të ndikimit politik në politikën editoriale të medieve.⁴⁵ Megjithatë, në këtë drejtim është shënuar një rënie që kur u zgjodh qeveria e re në vitin 2021. Megjithatë, raste të tilla janë raportuar herë pas here edhe në këtë periudhë. Për shembull, në vitin 2020, drejtori ekzekutiv i Klan Kosovës deklaroi se paraardhësi i tij kishte dhënë dorëheqjen nga posti për shkak të presionit të akterëve politik dhe pronarëve.⁴⁶ Mediumi publik prodhon lajme informative dhe edukative në një mase, por ato nuk ofrojnë mbulim të drejtë për të gjitha partitë politike siç kërkohet me Ligjin për Transmetimin Publik.⁴⁷

Për më tepër, sipas Raportit të Indeksit Botëror të Lirisë së Shtypit të Reporters Without Borders 2023, gazetarët kanë qenë gjithnjë e më shumë objektivi i padive SLAPP⁴⁸ të iniciuara nga grupet e biznesit dhe politikanët.⁴⁹

Për më tepër, ka shembuj kur gazetarët kanë kaluar nga gazetaria në pozita politike për shkak të rreshtimeve politike që kishin në të kaluarën. Po ashtu, ka raste kur disa prej këtyre individëve, pas largimit nga politika, i janë rikthyer sërish gazetarisë.⁵⁰

Ndjekjet penale për rastet e kërcënimeve ndaj medieve në vend janë ende në proces dhe nuk ka asnjë vendim për këto raste.⁵¹ Shembuj për këtë janë rastet e kërcënimit me vdekje ndaj gazetarit Vehbi Kajtazi⁵² dhe ai i rrahjes së gazetarit Valon Sylta.⁵³

Sipas përfaqësuesve të KPM-së, licencimi i medieve bëhet sipas legjisllacionit në fuqi.⁵⁴ Mirëpo, nëse ky proces është transparent mbetet në pikëpyetje pasi ky institucion shpeshherë është parë si i politizuar, siç është rasti i zgjedhjes së Luljeta Aliut për anëtare të këtij Komisioni.⁵⁵





Qeverisja

**INDIKATORI 12.2.1
TRANSPARENCA
(SIPAS LIGJIT)**

75/100



Në përgjithësi, dispozitat ligjore, rregullat e brendshme dhe kodet e organeve të mediejeve synojnë të vendosin transparencë të plotë në lidhje me aktivitetet përkatëse mediatike. Megjithatë, nuk ka ndonjë rregullim për transparencën e pronësisë së mediejeve online.


Transparenca është një nga parimet e KPM-së si mbikëqyrëse e mediejeve. Ligji për KPM-në kërkon qasje të plotë në licencat, aktet nënligjore, regjistrimet e rasteve, mbledhjet dhe vendimet e marra nga KPM-ja.⁵⁶ Rregullorja për funksionimin e KPM-së ia jep edhe përgjegjësinë KPM-së për komunikimin me media.⁵⁷ Për më tepër, Rregullorja e Punës së KPM-së përcakton transparencën e Komisionit si një nga pjesët më thelbësore të tij.⁵⁸ Kjo transparencë ka të bëjë me obligimet që KPM-ja ka ndaj komunikimit me mediet, mbajtjes së takimeve të hapura, komunikimit me media dhe bërjes publike të vendimeve.⁵⁹ Nuk ka rregullore për zbulimin e pronësisë së mediejeve online.⁶⁰

Transmetuesit që regjistrohen si kompani në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (ARBK) duhet të jenë transparentë në ofrimin e informacionit bazë për themeluesit e biznesit.⁶¹ Përveç Radio Televizionit të Kosovës,⁶² i cili operon si transmetues publik, mediat tjera janë të regjistruara si kompani dhe subjekte afariste dhe janë të detyruar të raportojnë pronësinë e tyre në KPM⁶³ përveç ARBK-së.⁶⁴

Mediet audio-vizuale, në baza vjetore, duhet të paraqesin raporte financiare në lidhje me përmbajtjen e programit të paraparë me kushtet e licencës.⁶⁵ Sa u përket mediejeve të shkruara, Kodi i Etikës kërkon që media të jetë transparente në lidhje me çështjet e pronësisë dhe menaxhimit të medias. Mediat e shkruara duhet t'u ofrojnë qytetarëve qartësi për identitetin e pronarëve dhe masën e interesit të tyre financiar në media.⁶⁶

**INDIKATORI 12.2.2
TRANSPARENCA
(NË PRAKTIKË)**

50/100



Ndërsa organet e mediejeve zakonisht zbulojnë informacione të rëndësishme për aktivitetet e tyre, ato shpesh janë të pjesshme ose të vjetëruara.

Në praktikë, shumica e kompanive mediatike nuk raportojnë pronësinë e tyre në KPM dhe ARBK. Kjo ka ngritur shqetësime sepse mund të ofrojë hapësirë për presion dhe ndërhyrje politike dhe financiare.⁶⁷

Sipas raportit të Komisionit Evropian të vitit 2022 për Kosovën, informacioni mbi pronësinë e mediejeve, veçanërisht për mediet online, mbetet i paqartë dhe shpesh fiktiv. Shumica e mediejeve nuk japin informacion mbi financat e tyre apo pronësinë reale.⁶⁸

Në vitin 2023, organizatat lokale të mediejeve me financim nga organizatat ndërkombëtare kanë filluar një projekt për të krijuar një platformë me të dhënat mbi pronësinë e mediejeve që do të publikohen në mesin e vitit 2024.⁶⁹



Radio Televizioni i Kosovës⁷⁰ publikon informacione për stafin e brendshëm, politikat e raportimit dhe politikat redaktoriale në faqen e tij të internetit. Media të tjera që funksionojnë si OJQ publikojnë gjithashtu informacionet e tilla.⁷¹ Megjithatë, mediet e tjera kombëtare publikojnë vetëm emrat e autorëve të artikujve të tyre.

**INDIKATORI 12.2.3
LLOGARIDHËNIA
(SIPAS LIGJIT)**

100/100



Ekzistojnë mekanizma gjithëpërfshirës që sigurojnë që mediet të jenë të përgjegjshme.

KPM-ja është institucion i pavarur kushtetues⁷² që funksionon sipas Ligjit për Komisionin e Pavarur të Mediejeve⁷³ dhe merret me rregullimin dhe menaxhimin e frekuencave të transmetimit. KPM-ja licencon transmetuesit privatë, drejton dhe zbaton politikën e transmetimit duke rregulluar të drejtat, kufizimet dhe përgjegjësitë e brendshme dhe ato ligjore për shërbimet e mediejeve audio dhe audio-vizuale.⁷⁴ KMSHK-ja është organ vetërregullues përgjegjës për rregullimin e mediejeve të shkruara, i përbërë nga kryeredaktorët e ndërmarrjeve mediatike. Roli i tij është të forcojë pajtueshmërinë me Kodin e Mediejeve të Shkruara në Kosovë dhe të sigurojë që gazetaria ndjek parimet e Kodit të Etikës.⁷⁵

Të gjitha mediet e licencuara duhet të dorëzojnë një raport vjetor në KPM, i cili përfshin informacion në lidhje me programin dhe funksionimin sipas kushteve të licencës, së bashku me një raport të detajuar financiar dhe informacione të tjera të parapara me ligj.⁷⁶ E drejta për të korrigjuar informacionin e transmetuar, ose për t'iu përgjigjur informacionit të transmetuar, ushtrohet në përputhje me Kodin e Etikës së Transmetuesve.⁷⁷ Kodi i Etikës parasheh që pas ankesës

eventuale ndaj ndonjë materiali transmetues, të gjitha mediet janë të detyruara të përgjigjen ose korrigjojnë informacionin e gabuar brenda shtatë ditëve në të njëjtën kohë dhe hapësirë transmetimi.

**INDIKATORI 12.2.4
LLOGARIDHËNIA
(NË PRAKTIKË)**

50/100



Ndërsa disa medie kanë mekanizma efektivë të llogaridhënies, nuk ka ndonjë sistem efektiv të llogaridhënies që mbulon të gjithë sektorët e mediejeve, sidomos në lidhje me financimin.

Efektiviteti i KPM-së si organi kryesor rregullator për mediet është vënë shpesh në pikëpyetje, kryesisht për shkak të mungesës së profesionalizmit dhe mungesës së anëtarëve.⁷⁸ Në vitin 2021, përzgjedhja e anëtarëve të KPM-së dështoi, gjë që shkaktoi reagime nga akterët politikë, shoqëria civile në Kosovë dhe organizatat ndërkombëtare të gazetarëve të cilët kritikuan se bordi nuk funksionoi për më shumë se një vit dhe se ankesat nuk u trajtuan.⁷⁹ Megjithatë, KSHMK-ja ka qenë më efektive në punën e saj, veçanërisht në luftën kundër lajmeve të rreme dhe verifikimin e fakteve që kanë të bëjnë kryesisht me artikujt në mediet online.⁸⁰

Në parim, disa medie kanë blogje përmes të cilave ndërveprojnë me publikun. Këto blogje kanë mbulim të gjerë të rrjeteve sociale dhe mijëra ndjekës.⁸¹

Sipas redaktorit menaxhues në Kallxo.com, mediet në vend nuk kanë avokatë individual.⁸² Kurse, sipas Zëvendës Kryeshëfit Ekzekutiv të KPM-së, i intervistuar për këtë raport, media e ndjek obligimin ligjor për korrigjimin e informacionit të gabuar.⁸³





**INDIKATORI 12.2.5
MEKANIZMAT E
INTEGRITETIT (SIPAS LIGJIT)**

75/100



Ka mekanizma që sigurojnë integritetin e medie, por mungojnë kodet e brendshme të medie.

Ekziston Kodi për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Kosovë i cili ka hyrë në fuqi në vitin 2016.⁸⁴ Ky kod buron nga Ligji për KPM-në dhe si i tillë mbulon vetëm mediat vizive.⁸⁵ Ekziston edhe Kodi i Etikës për mediane dhe shkruar, i nxjerrë nga Këshilli i Mediave të Shkruara.⁸⁶ Të dy kodet janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga të gjithë gazetarët, reporterët, redaktorët dhe pronarët e medie vizive dhe të shkruara që janë të licencuar.⁸⁷

Kodi i Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediatike ofron standarde etike për të garantuar integritetin e medie në llogaridhënie.⁸⁸ Këto rregullore lidhen me ndalimin e medie për nxitjen e gjuhës së urrejtjes,⁸⁹ mbulimin e paanshëm mediatik,⁹⁰ të drejtat e njeriut,⁹¹ dhe të drejtën për t'u përgjigjur.⁹² Kodi i Etikës së Medie të Shkruara shërben si bazë rregullative për etikën dhe integritetin profesional të gazetarëve.⁹³

Megjithatë, mediet nuk kanë kode të brendshme etike dhe as komisione të brendshme të organeve individuale të medias. Në shumë raste, shkeljet e Kodit të Etikës për mediet e shkruara kryhen nga vet organet vetërregulluese, nga kryeredaktorët dhe nga redaktorët e organeve mediatike anëtare të këtij organi.⁹⁴

**INDIKATORI 12.2.6
MEKANIZMAT E
INTEGRITETIT (NË PRAKTIKË)**

50/100



Ekziston një qasje e pjesshme dhe reaktive për të garantuar integritetin e punonjësve të medie, si për shembull zbatimi i rregullave ekzistuese, hetimi i sjelljes së pahijshme (të supozuara), sanksionimi i sjelljes së keqe dhe trajnimi i stafit për çështjet e integritetit.

Gazetarët respektojnë deri diku Kodin e Etikës gjatë raportimit të tyre. Në raportet e fundit vjetore, KPM-ja ka proceduar tri shkelje të Kodit nga media.⁹⁵ KMSHK-ja ka marrë dhjetëra ankesa për shkeljen e Kodit të Etikës nga gazetarët e medie të shkruara.⁹⁶ Gazetarët mund të marrin udhëzime për etikën vetëm nga trajnimet e organizuara nga organizata joqeveritare ose këshilla të caktuara mediatike, të cilat shpesh organizojnë edhe shkolla për etikën gazetareske.⁹⁷

Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës është organizatë joqeveritare që merret me mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të gazetarëve, si dhe me përmirësimin e gazetarisë në vend.⁹⁸ Si i tillë, organizon vazhdimisht trajnime dhe projekte lidhur me etikën dhe profesionalizmin në gazetari.⁹⁹ Çështja e ndjekjes së procedurave gjatë ofrimit apo pranimit të dhuratave është pak më komplekse.

Sipas Redaktorit Menaxhues të Kallxo.com, mungesa e financave mediatike dhe sponsorizimeve të padokumentuara të lajmeve krijon hapësirë që mediet të pranojnë dhurata.¹⁰⁰ Drejtorja Ekzekutive e AGK-së thekson se gazetarët janë të ekspozuar edhe ndaj dhuratave dhe nevojave për shërbime, kryesisht për shkak të pagave të ulëta.¹⁰¹



Roli

**INDIKATORI 12.3.1
HULUMTIMI DHE EKSPOZIMI
I RASTEVE TË PRAKTIKAVE
KORRUPTIVE**

75/100



Në përgjithësi, media është shumë aktive dhe e suksesshme në hulumtimin dhe ekspozimin e rasteve të korrupsionit. Por problemi qëndron tek presioni dhe ndërhyrja në raportim nga akterë të jashtëm.¹⁰²

Gazetaria hulumtuese është bërë një aspekt thelbësor i shumë medie në vend. Megjithatë, në shumë raste, puna në këtë fushë është mjaft delikate dhe përmban shumë rreziqe.¹⁰³ Mediet në vend kanë krijuar programe hulumtuese duke bërë gazetari hulumtuese. Nuk ka statistika të sakta sa i përket numrit të gazetarëve apo programeve hulumtuese, por sipas Drejtores Ekzekutive të AGK-së, numri i tyre po rritet me shpejtësi.¹⁰⁴

Ka medie specifike që merren drejtpërdrejt me gazetarinë hulumtuese çdo ditë. Kallxo.com, një platformë raportimi, pjesë e organizatës joqeveritare BIRN, është e specializuar në gazetarinë hulumtuese dhe ka projekte që kanë të bëjnë kryesisht me luftën kundër korrupsionit. Transmetuesi Klan Kosova së fundi ka nisur një emision hulumtues të quajtur KIKS Kosova.¹⁰⁵

Sa i përket raportimit për rastet e profilit të lartë të korrupsionit, ka shumë raste ku gazetarët kanë qenë burimi kryesor për zbulimin e këtyre rasteve, siç është rasti "Brezovica"¹⁰⁶. E njëjta gjë vlen edhe për rastin "2 milionë euro",¹⁰⁷ në të

cilin janë ndërmarre hapa të mëtejshëm për dokumentimin e detajeve të këtij rasti pas hulumtimeve dhe raportimeve të gazetarëve.

**INDIKATORI 12.3.2 INFORMIMI I
PUBLIKUT MBI KORRUPSIONIN
DHE NDIKIMIN E TIJ**

75/100



Në përgjithësi, media është shumë aktive dhe e suksesshme në informimin e publikut për korrupsionin dhe ndikimin e tij. Megjithatë, problem mbetet mbështetja e programeve të tilla nga sistemi gjyqësor.

Ka programe specifike si "Kallxo Pernime" dhe "Betimi për Drejtësi"¹⁰⁸ drejtuar nga media për të edukuar publikun mbi korrupsionin.¹⁰⁹

Këto organizata joqeveritare që funksionojnë si media shpesh mbajnë trajnime për gazetarët se si të trajtojnë raportet e rasteve të korrupsionit.¹¹⁰ Këto programe kanë një ndikim të konsiderueshëm dhe shpesh kanë qenë shumë të suksesshme, pasi hetimet për këto raste kanë filluar pas raportimeve nga media.¹¹¹ Për shembull, në vitin 2022 emisioni "Betimi për Drejtësi" zbuloi dokumente që tregonin se dy anëtarë të familjes së prokurorit në Departamentin e Krimeve të Rënda në Prizren ishin të përfshirë në korrupsion.¹¹²

Sipas Redaktorit Menaxhues në Kallxo.com, këto programe kryesisht janë të vetëfinancuara ose të mbështetura nga projekte nga donatorë ndërkombëtarë, por nuk kanë mbështetje të nivelit të lartë nga sistemi gjyqësor.¹¹³ Megjithatë, këto emisione





hulumtuese kanë fituar çmime të ndara nga Zyra e BE-së në Kosovë dhe organizata të tjera vendore dhe ndërkombëtare.¹¹⁴ Gazetarët e Koha Ditore, Kallxo dhe Preportr-Çohu kanë fituar çmime për hulumtimet e tyre lidhur me temat kryesisht për pastrimin e parave dhe pasojat e korrupsionit.¹¹⁵



INDIKATORI 12.3.3 INFORMIMI I PUBLIKUT PËR ÇËSHTJET E QEVERISJES

75/100



Në përgjithësi, media është aktive dhe e suksesshme në informimin e publikut për aktivitetet e rregullta të qeverisë dhe institucioneve të tjera qeverisëse. Megjithatë, ka mungesë bashkëpunimi dhe transparence nga ana e qeverisë me mediet.¹¹⁶

Sipas redaktorit menaxhues në Kallxo.com, ka raportim gjithëpërfshirës për tema të rëndësishme, siç janë pasqyrimi i ngjarjeve ditore politike, kronikat sociale dhe hulumtimi për tema politike dhe sociale. Por mungon raportimi i duhur për tema të tjera, si arsimit dhe shëndetësia. Kjo ndodh për shkak të mungesës së burimeve njerëzore që mediet të raportojnë për këto tema.¹¹⁷ Agjendat e medieve janë të mbingarkuara me ngjarje politike dhe tituj sensacionalë.¹¹⁸

Për më tepër, qasja në informacionin publik nga qeveria vazhdon të paraqesë sfida për punën e gazetarëve.¹¹⁹ Një çështje shqetësuese mbetet kërcënimet ose frikësimet e gazetarëve në lidhje me raportimin e tyre (shih 12.1.4), gjë që ndikon në cilësinë e raportimit nga media.¹²⁰ Situata me aktivitetin e raportimit të medieve për qeverinë ka ndryshuar. Ka shumë raste të gazetave, e së fundmi edhe kanaleve televizive, në pronësi të politikanëve që përdoren kryesisht si platformë për agjitacion politik.¹²¹ Në dy vitet e mëparshme që nga ndërrimi i qeverisë në vitin 2021, media ka qenë më ndërvepruese me qeverinë, me raporte të përditshme për mbledhjet e qeverisë, vendimet dhe të gjitha të rejtat që dalin

nga institucionet. Raporti i Bordit Ndërkombëtar të Kërkimeve dhe Shkëmbimeve (IREX) vlerësoi se megjithëse në Kosovë prodhohet shumëllojshmëri e përmbajtjeve, shumica e raportimeve kanë të bëjnë më shumë me politikën sesa me politikën, dhe pjesa më e madhe e përmbajtjes u përket politikanëve individualë dhe interpretimit të tyre të ngjarjeve.¹²²



INDIKATORI 12.3.4 GJINIA

50/100



Lajmet përfshijnë zërat dhe perspektivat e grave dhe burrave në një mënyrë përgjithësisht të balancuar. Media citon në mënyrë rutinore grupet e të drejtave të grave në lajme për çështje që prekin drejtpërdrejt gratë. Megjithatë, problem madhor mbetet mungesa e grave në pozita drejtuese në media në vend.

Sipas drejtores ekzekutive të AGK-së, mediet në Kosovë priren të jenë të balancuara në aspektin gjinor kur bëhet fjalë për lajmet dhe burimet e përdorura për t'i raportuar ato.¹²³ Përmbajtja e lajmeve përbëhet nga citate nga të dyja gjinitë. Ndikimi gjinor i çështjeve specifike sociale përfshihet përgjithësisht në raportet e medieve.¹²⁴ Diskriminimi i vazhdueshëm gjinor brenda industrisë së medias është shkak për shqetësim, krahas nënpërfaqësimit të dukshëm të grave në role drejtuese dhe pjesëmarrjes së tyre të kufizuara në diskutime në panel.¹²⁵ Sipas gjetjeve të hulumtimit, afërsisht 70 për qind e pjesëmarrësve në anketë kanë mendimin se gratë portretizohen në mënyrë joadekuate në medie, shpesh duke u anashkaluar tërësisht. Për më tepër, vetë media shpesh perceptohet se mban një perspektivë kryesisht patriarkale.¹²⁶

Shumë media si Kallxo.com punojnë në promovimin e të drejtave të grave dhe çështje të tjera që prekin drejtpërdrejt gratë.¹²⁷ Mungon progresi në raportimin mediatik për gratë në poste publike, ku shpesh ato bëhen objekt komentesh nga publiku që nxisin diskriminimin ndaj tyre.¹²⁸



Ndërveprimet

Media ndërvepron me shumicën e institucioneve të vendit, teksa raportojnë dhe pasqyrojnë ngjarjet e organizuara prej tyre. Media ndërvepron kryesisht me Qeverinë, Kuvendin dhe shoqërinë civile.

Ky ndërveprim ndërmjet medias dhe qeverisë karakterizohet nga mbulimi mediatik i takimeve, mbledhjeve dhe konferencave për media nga të gjitha mediet në vend. Megjithatë, ky ndërveprim është zbehur kohët e fundit, pasi organizatat që përfaqësojnë gazetarët kanë ngritur shqetësime për mungesën e konsiderueshme të qasjes të gazetarëve në shumë departamente qeveritare.¹²⁹ Po kështu, transparenca e krerëve të shtetit dhe zyrtarëve të tjerë përballë medias ka munguar në qeverinë aktuale.¹³⁰

Kuvendi i Kosovës ndërvepron ngushtë me mediat. Gazetarët mund të kenë qasje dhe të mbulojnë seancat plenare dhe mbledhjet e komisioneve në Kuvend.¹³¹

Bashkëpunimi ndërmjet medieve dhe shoqërisë civile mund të konsiderohet si më i suksesshmi, veçanërisht në avokimin e ngjarjeve me rëndësi kombëtare, përfshirë luftën kundër korrupsionit. Aktivitetet e shoqërisë civile mbulohen nga media në përgjithësi.¹³²

Rekomandimet e shtyllës

- Qeveria duhet:
 - Të miratojë një ligji organik për mediet për të rregulluar të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me medie, si pronësia e medieve, financimi i tyre, raportimi, regjistrimi dhe funksionimi i portaleve online dhe mbrojtja e gazetarëve nga paditë SLAPP.
 - Të bashkëpunojë në mënyrë më aktive me mediet duke ofruar qasje në informacion në kohën e duhur.
 - Të organizojë më shumë konferenca shtypi për tema kritike si procesi i dialogut dhe çështjet e sigurisë.
- Mediet duhet:
 - Të krijojnë një portfolio financiar më të larmishëm (që u mundëson atyre të operojnë më të pavarur nga mbështetja e bizneseve).
 - Të vijohet bashkëpunimi ndërinstitucional më aktiv me institucionet e drejtësisë në hetimin, zhvillimin dhe përfundimin më efektiv të rasteve të sulmeve ndaj gazetarëve.



REFERENCAT

- 1 Ligji për Komisionin e Pavarur të Medieve, neni 3.
- 2 Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën për 2022, tetor 2022, faqe 32.
- 3 Ligji për Komisionin e Pavarur për Media, neni 21, paragrafi 2.
- 4 Ligji për Komisionin e Pavarur të Medieve, neni 21.
- 5 Ligji për Komisionin e Pavarur të Medieve, neni 22.
- 6 Ligji për Komisionin e Pavarur të Medieve, neni 24.
- 7 Këshilli i Medieve të Shkruara të Kosovës, "Rreth nesh", <https://presscouncil-ks.org/rreth-nesh/> [qasur më 25 dhjetor 2022]
- 8 Këshilli i Medieve të Shkruara të Kosovës, "Rreth nesh", <https://presscouncil-ks.org/rreth-nesh/> [qasur më 21 dhjetor 2022]
- 9 Ligji për Komisionin e Pavarur të Medieve, neni 9.
- 10 Raporti vjetor i Komisionit të Pavarur për Media, faqe 31.
- 11 Raporti vjetor i Komisionit të Pavarur për Media, faqe 31.
- 12 Radio Evropa e Lirë, 14 mars 2021, <https://www.evropaelire.org/a/kosova-gazeta-te-stypura-/31150170.html> [qasur më 20 dhjetor 2022]
- 13 Kosova Dy Pikë Zero, <https://kosovotwopointzero.com/en/> [qasur më 15 qershor 2023]
- 14 Kallxo.com, <https://kallxo.com/> [qasur më 17 qershor 2023]
- 15 Intervistë me Getoarbë Mulliqi Boja, Drejtoreshë Ekzekutive e Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës, dhjetor 2022.
- 16 Indeksi i Reporterëve pa Kufij për Kosovën, 2023, <https://rsf.org/en/country/kosovo> [qasur më 6 qershor 2023]
- 17 Radio Evropa e Lirë, 26 dhjetor 2021, <https://www.evropaelire.org/a/mediat-sfide-pandemia/31626529.html> [qasur më 20 dhjetor 2022]
- 18 Indeksi i Reporterëve pa Kufij për Kosovën, 2022, <https://rsf.org/en/country/kosovo> [qasur më 12 janar 2023]
- 19 Intervistë me Kreshnik Gashin, kryeredaktor në Kallxo.Com, janar 2023.
- 20 Platformat më aktive të transmetimit në vend janë: Art Motion <https://artmotion.net/rreth-nesh/>; Ipko <https://www.ipko.com/>; Kujtesa <https://www.kujtesa.com/>; dhe Telkos <https://telkos.net/>
- 21 AGK, "Ndikimi i Pandemisë Covid-19 në gjendjen ekonomike të gazetarëve, kameramanëve dhe fotoreporterëve" (Prishtinë: AGK, 2020), faqe 10.
- 22 Intervistë me Getoarbë Mulliqi Boja, Drejtoreshë Ekzekutive e Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës, dhjetor 2022.
- 23 Raporti vjetor i Komisionit të Pavarur për Media, faqe 31.
- 24 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 40 dhe 41.
- 25 Ligji për Komisionin e Pavarur të Medieve, neni 1.
- 26 Ligji për Mbrojtjen e Burimeve të Gazetarisë, neni 1.
- 27 Ligji për Komisionin e Pavarur të Medieve, neni 31.
- 28 Ligji për Komisionin e Pavarur të Medieve, neni 31.
- 29 Këshilli i Medieve të Shkruara, Kodi i Medieve të Shkruara të Kosovës, neni 10.
- 30 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 42.
- 31 Ligji për Mbrojtjen e Burimeve të Gazetarisë, neni 4.
- 32 Ligji për qasje në dokumente publike, neni 1.
- 33 Ligji për Komisionin e Pavarur të Medieve, neni 23.
- 34 Rregullorja për shpërndarjen e ofruesve të shërbimeve të medieve audio dhe audio-vizuale, Neni 1.
- 35 Ligji për Komisionin e Pavarur të Medieve, neni 3.
- 36 Ligji Civil Kundër Shpijjes dhe Fyerjes, neni 1.
- 37 Gazeta Blic, mars 2022, <https://gazetablic.com/dk-qeveria-ka-lene-jashte-funksonit-tri-institucione-te-pavarura/> [qasur më 23 dhjetor 2022]
- 38 Indeksi i Reporterëve pa Kufij për Kosovën, 2023, <https://rsf.org/en/country/kosovo> [qasur më 6 qershor 2023]
- 39 Radio Evropa e Lirë, maj 2022, <https://www.evropaelire.org/a/raporti-i-reportereve-pa-kufij/31830945.html> [qasur më 10 qershor 2023]
- 40 Intervistë me Kreshnik Gashin, kryeredaktor në Kallxo.Com, janar 2023.
- 41 Raporti i Human Rights Watch për Kosovën, dhjetor 2022, faqe 362.
- 42 Raporti i Freedom House për Kosovën, 2022, <https://freedomhouse.org/country/kosovo/freedom-world/2022#CL> [qasur më 20 janar 2023]
- 43 Indeksi i Reporterëve pa Kufij për Kosovën, 2023, <https://rsf.org/en/country/kosovo> [qasur më 6 qershor 2023]
- 44 ⁴² KlanKosova, March 28, 2023, <https://klankosova.tv/agk-thote-se-sulmet-ndaj-gazetareve-u-rriten-gjate-vitit-2022-1/> [qasur më 7 gusht 2023]
- 45 Demokracia për Zhvillim, "Media dhe tenderët", (Prishtinë: D4D, 2019), faqe 8.
- 46 SEENPM, "Peizazhi mediatik në Kosovë: Ndikimi i urrejtjes dhe propagandës", (Lubjanë: SEENPM, 2020), faqe 5.
- 47 Barometri IREX për Kosovën, 2022, faqe 8.
- 48 SLAPP-të janë padi strategjike kundër pjesëmarrjes publike. Këto padi të dëmshme minojnë fjalën e lirë dhe debatin e shëndetshëm duke synuar ata që komunikojnë me qeverinë e tyre ose flasin hapur për çështje me interes publik.
- 49 Indeksi i Reporterëve pa Kufij për Kosovën, 2022, <https://rsf.org/en/country/kosovo> [qasur më 12 janar 2023]

- 50 Reporter.al, maj 2017. <https://www.reporter.al/2017/05/22/gazetaret-ne-kosove-i-futen-politikes-me-shpresen-per-ndryshim/> [qasur më 20 janar 2023]
- 51 Intervistë me Kreshnik Gashin, kryeredaktor në Kallxo.Com, janar 2023.
- 52 Kallxo.com, dhjetor 2021, <https://www.koha.net/arberi/64540/agk-reagon-kunder-frikesimit-te-familjes-se-gazetares-saranda-ramaj/> [qasur më 20 tetor 2023]
- 53 Gazeta Express, prill 2023, <https://www.gazetaexpress.com/tre-sulmuesit-e-valon-syles-u-identifikuan-nga-drejtoria-e-terrorizmit-prokuroria-speciale-i-ngarkon-me-kete-veper-penale/>, [qasur më 20 tetor 2023]
- 54 Intervistë me Zëvendës Kryeshefin Ekzekutiv të Komisionit të Pavarur për Media, Faruk Rexhaj, dhjetor 2022.
- 55 Koha.net, maj 2023, <https://www.koha.net/lajmet-e-mbremjes-ktv/378925/luljeta-aliu-krasniqi-zgjidhet-anetare-e-kpm-se-kritikohet-lvv-ja-per-politizim/> [qasur më 20 qershor 2023]
- 56 Ligji për Komisionin e Pavarur të Medieve, neni 7.
- 57 Rregullorja e Punës së Komisionit të Pavarur për Media, neni 16.
- 58 Rregullorja e Punës së Komisionit të Pavarur për Media, neni 1.
- 59 Rregullorja e Punës së Komisionit të Pavarur për Media, neni 17.
- 60 Mbrojtësit e të Drejtave Qytetare - Civil Rights Defenders (CRD), "Liria e Shprehjes, Mediave dhe Informacionit në Kosovë" faqe 5
- 61 Agjencia Kosovare për Regjistrimin e Bizneseve, Regjistrimi i Bizneseve të Reja, <https://arb.krs.gov.net/Page.aspx?id=1.33> [qasur më 22 dhjetor 2022]
- 62 Radio Televizioni i Kosovës, <https://www.rtklive.com/sq/index.php> [qasur më 22 dhjetor 2022]
- 63 Ligji për Komisionin e Pavarur të Medieve, neni 22.
- 64 Agjencia Kosovare për Regjistrimin e Bizneseve, <https://arb.krs.gov.net/> [qasur më 25 dhjetor 2022]
- 65 Ligji për Komisionin e Pavarur të Medieve, neni 28.
- 66 Këshilli i Medieve të Shkruara, Kodi i Medieve të Shkruara të Kosovës, faqe 2.
- 67 Qendra Burimore për Lirinë e Medieve në Evropë, <https://www.rcmediafreedom.eu/Wiki-for-mediafreedom/Concentration-of-media-owner-ship-and-media-pluralism-in-Kosovo> [qasur më 15 gusht 2023]
- 68 Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën, tetor 2022, faqe 34.
- 69 Intervistë me një ekspert anonim, korrik 2023.
- 70 Radio Televizioni i Kosovës, <https://www.rtklive.com/sq/page.php?ID=5> [qasur më 8 gusht 2023]
- 71 Kallxo.com, <https://kallxo.com/per-ne/> [qasur më 22 korrik 2023]
- 72 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 141.
- 73 Ligji për Komisionin e Pavarur të Medieve, neni 28.
- 74 Komisioni i Pavarur i Mediave, "Rreth nesh", <https://www.kpm-ks.org/kpm/311/per-kpm/311?page=kpm> [qasur më 25 dhjetor 2022]
- 75 Këshilli i Medieve të Shkruara të Kosovës, "Rreth nesh", <https://presscouncil-ks.org/rreth-nesh/> [qasur më 25 dhjetor 2022]
- 76 Ligji për Komisionin e Pavarur të Medieve, neni 28.
- 77 Ligji për Komisionin e Pavarur të Medieve, neni 35.
- 78 Koha.net, 6 nëntor 2022, <https://www.koha.net/arberi/351387/bordi-i-kpm-se-e-ai-i-ankesave-me-mungese-anetaresh-kerkohet-zgjedhje-e-profesionisteve/> [qasur më 15 dhjetor 2022]
- 79 Kallxo.com, 16 korrik 2021, <https://kallxo.com/lajm/akuza-per-perzgjedhjen-sekrete-te-anetareve-te-kpm-se-reagon-kryetarja-e-komisionit-parlamentar/> [qasur më 17 dhjetor 2022]
- 80 Kallxo.com, 25 nëntor 2021, <https://kallxo.com/lajm/si-te-identifikohen-lajmet-e-reme-dhe-si-te-verifikohen-faktet-ne-mediat-online/> [qasur më 10 janar 2023]
- 81 Kosova Dy Pikë Zero, Blogbox, <https://kosovotwopointzero.com/blogbox/> [qasur më 27 dhjetor 2022]
- 82 Intervistë me Kreshnik Gashin, kryeredaktor në Kallxo.Com, janar 2023.
- 83 Intervistë me Zëvendës Kryeshefin Ekzekutiv të Komisionit të Pavarur për Media, Faruk Rexhaj, dhjetor 2022.
- 84 Kodi i Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës.
- 85 Kodi i Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës, neni 1.
- 86 Kodi i Etikës i Këshillit të Mediave të Kosovës, neni 1.
- 87 Kodi i Etikës i Këshillit të Mediave të Kosovës, neni 1.
- 88 Kodi i Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës, neni 1.
- 89 Kodi i Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës, neni 5.
- 90 Kodi i Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës, neni 6.
- 91 Kodi i Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës, neni 7.
- 92 Kodi i Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës, neni 10.
- 93 Kodi i Etikës i Këshillit të Medieve të Kosovës, Preambula.
- 94 Kallxo.Com, 15 prill 2021, <https://kallxo.com/gjate/mendime/trendet-e-shkeljeve-te-etikes-ne-kosove-nga-mediat-e-skruara-mungesa-e-zbatimit-te-standardeve-international-to-journalism/> [qasur më 27 dhjetor 2022]
- 95 Raporti vjetor i Komisionit të Pavarur për Media, faqe 34.
- 96 Kallxo.com, 15 prill 2021, <https://kallxo.com/gjate/mendime/trendet-e-shkeljeve-te-etikes-ne-kosove-nga-mediat-e-shkruara-mungesa-e-zbatimit-te-standardeve-nderkombetare-te-gazetarise/> [qasur më 13 janar 2023]
- 97 Këshilli i Medieve të Shkruara të Kosovës, <https://presscouncil-ks.org/u-mbajit-moduli-i-dyte-i-shkolles-se-etikes/> [qasur më 12 janar 2023]
- 98 Këshilli i Medieve të Shkruara të Kosovës, "Rreth nesh", <https://agk-ks.org/rreth-nesh/> [qasur më 21 janar 2023]



- 99 Intervistë me Getoarbë Mulliqi Boja, Drejtoreshë Ekzekutive e Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës, dhjetor 2022.
- 100 Intervistë me Kreshnik Gashin, kryeredaktor në Kallxo.Com, janar 2023.
- 101 Intervistë me Getoarbë Mulliqi Boja, Drejtoreshë Ekzekutive e Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës, dhjetor 2022.
- 102 Barometri IREX për Kosovën, 2022, faqe 6.
- 103 Intervistë me Getoarbë Mulliqi Boja, Drejtoreshë Ekzekutive e Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës, dhjetor 2022.
- 104 Intervistë me Getoarbë Mulliqi Boja, Drejtoreshë Ekzekutive e Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës, dhjetor 2022.
- 105 Klan Kosova, KIKS Kosova, <https://klankosova.tv/katemisionet/kiks/> [qasur më 15 shkurt 2023]
- 106 Betimi për Drejtësi, 12 nëntor 2022, <https://betimiperdrejtesi.com/rasti-brezovica-ne-shenjester-tentohet-permes-ndikimeve-te-shkaterrohen-he-timet/> [qasur më 11 janar 2023]
- 107 Kallxo.com, 2 nëntor 2021, <https://kallxo.com/lajm/dosja-e-prokurorise-si-e-kreu-labinot-gruda-transferimin-e-2-1-milione-eurove-nga-thesari-i-shtetit/> [qasur më 20 tetor 2023]
- 108 Betimi për Drejtësi, <https://betimiperdrejtesi.com/emisione/> [qasur më 27 janar 2023]
- 109 Kallxo.com, <https://kallxo.com/> [qasur më 11 janar 2023]
- 110 Intervistë me Kreshnik Gashin, kryeredaktor në Kallxo.Com, janar 2023.
- 111 Koha.net, 31 maj 2022, <https://www.koha.net/arberi/328048/nisin-hetimet-per-keqperdorimet-ne-emer-te-te-semureve-rende/> [qasur më 13 janar 2023]
- 112 "Betimi për Drejtësi", qershor 2022, <https://betimiperdrejtesi.com/gjykimi-ndaj-bashkeshortit-te-prokurores-ervehe-gashi-i-akuzuari-thote-se-kishin-kerkuar-nga-ai-qe-te-ushtronte-ndikim-te-bashkeshortja-e-tij/> [qasur më 30 qershor 2023]
- 113 Intervistë me Kreshnik Gashin, kryeredaktor në Kallxo.Com, janar 2023.
- 114 Kallxo.com, 10 nëntor 2022, <https://kallxo.com/lajm/gazetaret-e-kallxo-com-fitojne-cmimin-e-pare-te-be-se-per-gazetari-hulumtuese/> [qasur më 27 janar 2023]
- 115 Kallxo.Com, nëntor 2022, <https://kallxo.com/lajm/gazetaret-e-kallxo-com-fitojne-cmimin-e-pare-te-be-se-per-gazetari-hulumtuese/> [qasur më 30 qershor 2023]
- 116 Gazeta Blic, janar 2023, <https://gazetablic.com/barrikadimi-i-qeverise-ndaj-mediave/> [qasur më 2 shkurt 2022]
- 117 Intervistë me Kreshnik Gashin, kryeredaktor në Kallxo.Com, janar 2023.
- 118 Iniciativa e Ndryshimit Paqësor, https://peacefulchange.org/wp-content/uploads/2021/06/Conclusions-MCD3_Albanian.pdf, qasur më 25 gusht 2023]
- 119 Radio Evropa e Lirë, maj 2022, <https://www.evropaelire.org/a/dita-botorore-e-lirise-se-shtypit-ne-kosove/31832141.html> [qasur më 25 korrik 2023]
- 120 BIRN, "Presion i pafund: Raportimi i medieve kosovare për krimin e organizuar dhe korrupsionin" (Prishtinë: BIRN, 2018).
- 121 Osservatorio Balcani CaucasoTranseuropa, 5 prill 2018, <https://www.balcanicaucaso.org/eng/Areas/Kosovo/Political-and-economic-interests-in-media-ownership-are-squeezing-Kosovar-journalism-179036> [qasur më 24 dhjetor 2022]
- 122 Barometri IREX për Kosovën, 2022, faqe 4.
- 123 Intervistë me Getoarbë Mulliqi Boja, Drejtoreshë Ekzekutive e Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës, dhjetor 2022.
- 124 Intervistë me Getoarbë Mulliqi Boja, Drejtoreshë Ekzekutive e Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës, dhjetor 2022.
- 125 Intervistë me një ekspert anonim, korrik 2023.
- 126 Iniciativa për Ndryshim Paqësor, "Gruaja në Media", faqe 24.
- 127 Kallxo.com 9 dhjetor 2021, <https://kallxo.com/lajm/trajtimi-i-dhunes-ne-familje-a-ka-humbur-besimi-ne-institucione/> [qasur më 24 dhjetor 2022]
- 128 Kallxo.com 29 qershor 2022 <https://kallxo.com/komuna/raportimet-e-mediave-stimulojne-diskriminimin-e-grave/> [qasur më 23 dhjetor 2022]
- 129 Radio Evropa e Lirë, 3 maj 2022, <https://www.evropaelire.org/a/dita-botorore-e-lirise-se-shtypit-ne-kosove/31832141.html> [qasur më 27 dhjetor 2022]
- 130 Telegrafi, 24 mars 2022, <https://telegrafi.com/nje-vit-ne-kryste-shtetit-gazetaret-thone-se-qeveria-kurte-eshte-jo-transparente/> [qasur më 20 dhjetor 2022].
- 131 Kuvendi i Kosovës, Roli i medieve dhe publikut në punën e Kuvendit, <https://www.kuvendikosoves.org/shq/ta-njohim-kuvendin/roli-i-mediave-dhe-i-publikut-ne-punen-e-kuve/> [qasur më 12 janar 2023]
- 132 Ekonomia Online, 26 mars 2022, <https://ekonomiaonline.com/shoqeria-civile-me-konference-lidhur-me-projektligjin-per-financimin-e-subjekteve-politike/> [qasur më 21 dhjetor 2022]




SHOQËRIA CIVILE




PËRMBLEDHJE

Organizatat e shoqërisë civile (OSHC) në Kosovë janë organizata jofitimprurëse që janë jashtë aparatit formal shtetëror.


63/100 Rezultati i përgjithshëm i shtyllës




Kapacitetet



Qeverisja



Roli





Sektori përfshin jo vetëm OJQ-të, por edhe organizatat që tradicionalisht janë quajtur grupe interesi, si sindikatat, shoqatat profesionale, odat ekonomike, klubet sportive, shoqëritë kulturore dhe grupet joformale të komunitetit. Gjithsej 11,232 organizata (shumica me bazë anëtarësie) janë regjistruar në Kosovë deri në fund të vitit 2021, ndonëse shumica e tyre janë jo-aktive. Kjo paraqet një rritje prej afro 1000 organizatash gjatë vitit të kaluar, dyfishi i rritjes në vitin paraprak. Ky numër i lartë lidhet edhe me mungesën e detyrimit për çregjistrim të organizatave jo-aktive (shih 13.1.2). Për qëllimet e këtij studimi, OSHC-të i referohen më shumë OJQ-ve dhe organizatave lokale.¹

Bazuar në legjislacionin aktual në Kosovë, OJQ-të mund të regjistrohen në tri forma: shoqata, fondacione dhe institute.² Organi më i lartë drejtues i shoqatës është asambleja e anëtarëve, e cila përbëhet nga të gjithë anëtarët.³ Organi më i lartë drejtues i një fondacioni ose instituti është bordi, i cili përbëhet nga të paktën tre (3) anëtarë.⁴ Shumica e OJQ-ve janë të regjistruara si shoqata (96 për qind), dhe vetëm një numër i vogël kanë zgjedhur të regjistrohen si fondacione (4 për qind).⁵

Me mbështetjen financiare dhe teknike të komunitetit ndërkombëtar të donatorëve, ka pasur një rritje drastike të numrit të OJQ-ve. Organizatat janë të regjistruara në Departamentin për Regjistrim të OJQ-ve në Ministrinë e përgjegjëse për administratën publike.

Shoqëria civile në Kosovë luan rol qendror në mbajtjen e qeverisë llogaridhënëse dhe informimin e publikut për dështimet e politikave, veçanërisht lidhur me korrupsionin. Shoqëria civile në përgjithësi funksionon në një mjedis miqësor ku Kushtetuta dhe ligjet përkatëse garantojnë lirinë e shprehjes dhe asociimit. Institucionet ekzekutive, legjislative dhe gjyqësore janë më të hapura për publikun për shkak të ndikimit të ushtruar mbi to nga shoqëria civile nëpërmjet aktiviteteve dhe presionit publik. Megjithatë, sa i përket organizimit dhe funksionimit të brendshëm, OSHC-të kanë probleme, veçanërisht sa i përket transparencës dhe llogaridhënies.

Pothuajse të gjitha organizatat kryesore të shoqërisë civile janë të angazhuara në luftën kundër korrupsionit. Këtu bëjnë pjesë IKD, KDI, Çohu, FOL, Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS), Instituti GAP, BIRN etj. Këto organizata kanë përvojë të gjatë pune në luftën kundër korrupsionit. Shumë organizata lokale janë aktive në kërkimin e llogaridhënies më të madhe nga autoritetet lokale, si “Ec ma Ndryshe” në Prizren, “Syri i Vizionit” në Pejë dhe “Nisma për Progres” në Ferizaj.



Kapacitetet

 **INDIKATORI 13.1.1
BURIMET (SIPAS LIGJIT)**

100/100



Në përgjithësi, korniza ligjore që ka të bëjë me ekzistencën dhe funksionimin e OSHC-ve është e favorshme sa i përket mbrojtjes themelore të lirisë së asociimit dhe procedurave të thjeshta të regjistrimit. Megjithatë, trajtimi i njëjtë i OJQ-ve me operatorët ekonomik nga shteti ngre vështirësi për OSHC-të që përfshihen në aktivitete ekonomike.⁶

Liria e asociimit mbrohet nga Kushtetuta⁷ dhe Ligji i vitit 2019 për Lirinë e Asociimit në OJQ.⁸ Gjithashtu, në fund të vitit 2022, qeveria kishte miratuar udhëzimin administrativ që përcakton procedurat e regjistrimit, funksionimit dhe çregjistrimit për OJQ-të.⁹

Të gjitha procedurat e regjistrimit ose çregjistrimit janë të drejtpërdrejta, të lehta dhe pa pagesë.¹⁰ Procesi i regjistrimit mund të kryhet online.¹¹ OSHC-të e paregjistruara nuk janë të ndaluara në Kosovë, por njihen si iniciativa joformale që mund të funksionojnë pa pengesa dhe të ushtrojnë të drejtën e lirisë së asociimit.¹² Departamenti mund të refuzojë regjistrimin vetëm për qëllime legjitime,¹³ duke iu përmbajtur parimeve të domosdoshmërisë dhe proporcionalitetit dhe duhet të japë një përkrahim të përshtatshëm të arsyeve të refuzimit dhe të arsyeve ligjore.¹⁴ Në përgjithësi, OSHC-të mund të angazhohen në avokim dhe të kritikojnë qeverinë.¹⁵ Çregjistrimi dhe ndalimi i veprimtarisë së OSHC-ve mund të bëhet me vendim gjykatë në rastet kur aktivitetet e OSHC-ve cenojnë rendin kushtetues, të drejtat dhe liritë e njeriut ose nxisin urrejtje. Të gjitha vendimet për mosregjistrim, çregjis-



trim, anulim ose mosveprim administrativ mund të apeloehen në gjykata brenda 30 ditëve.¹⁶

Me përjashtim të rasteve kur gjenerojnë të hyra dhe të ardhura, OSHC-të përjashtohen nga TVSH-ja në të gjitha rastet e donacioneve dhe fondeve që ato kanë për qëllime përfitimi publik, duke përfshirë financimin e donatorëve ndërkombëtarë, pa pasur nevojë të aplikojnë për rimbursim.¹⁷ Ky përjashtim vlen për të gjitha OSHC-të, të vogla dhe të mëdha. Një problem që mbetet është se Administrata Tatimore i trajton OSHC-të si operatorë ekonomikë, duke u kërkuar atyre të përdorin të njëjtit formularë të raportimit vjetor si bizneset dhe i trajton ato në mënyrë të barabartë sa u përket ligjeve që lidhen me tregtinë dhe konkurrencën. Kjo shkakton probleme për OSHC-të sa i përket barrës së lartë administrative me burime të kufizuara.

 **INDIKATORI 13.1.2
BURIMET (NË PRAKTIKË)**

50/100



Në përgjithësi, shumica e OSHC-ve kanë disa burime financimi (përfshirë mbështetjen ndërkombëtare dhe financimin publik).¹⁸ Megjithatë, OSHC-ve më të vogla lokale u mungon qëndrueshmëria financiare, gjë që ndikon në burimet njerëzore dhe infrastrukturore.

Megjithëse financimi shtetëror është rritur nga 2.6 milionë euro në 2021 në 4.6 milionë euro në 2021¹⁹ dhe numri i organizatave të mbështetura është më shumë se dyfishuar,²⁰ ai mbulon vetëm 27 për qind të të gjitha OSHC-ve të regjis-



truara.²¹ Ekziston një varësi e lartë nga donatorët e huaj, të cilët janë burimi kryesor i financimit për 41 për qind të OSHC-ve në Kosovë.²² Këto OShC janë kryesisht ato më të mëdha që punojnë për demokratizimin, sundimin e ligjit, çështjet gjinore dhe mjedisore dhe nuk marrin fonde shtetërore për të shmangur konfliktet e mundshme të interesit, për shembull, nëpërmjet monitorimit të një institucioni nga i cili marrin mbështetje financiare.²³

Shumica e OShC-ve kanë financim projektsh nga donatorë të ndryshëm, megjithëse ka raste të rralla kur OShC-të operojnë vetëm me një burim financiar.²⁴ OShC-të në nivel lokal janë të fokusuara kryesisht në fondet publike të dhëna nga institucionet publike, sepse e shohin më sfidues arritjen e donatorëve të huaj për shkak të mungesës së kapaciteteve njerëzore të kërkuar për të aplikuar dhe marrë donacione të tilla.²⁵

Sipas Charities Aid Foundation's World Giving Index 2022, 56 për qind e të anketuarve thanë se kishin dhuruar para në muajin paraprak.²⁶ Megjithatë kjo është e orientuar kryesisht drejt kauzave humanitare si dhe ngjarjeve sportive dhe aktiviteteve kulturore.²⁷

Mungesa e qëndrueshmërisë financiare dhe perspektiva e pagave të ulëta përtej asaj që parashihet në buxhetin e projektit e bën punën në shumicën e OShC-ve jo tërheqëse për stafin e kualifikuar. Vetëm OShC-të e mëdha që janë më të qëndrueshme financiarisht kanë aftësinë për të tërhequr staf të kualifikuar. Një faktor tjetër që ndikon në rekrutimin është fakti që OShC-të zakonisht operojnë vetëm mbi bazën e projekteve afatshkurtra.²⁸

Sipas Indeksit Botëror të Dhurimit 2022, 11 për qind e të anketuarve raportuan se kishin marrë pjesë në aktivitete vullnetare në muajin paraprak.²⁹ Megjithatë, sipas CIVIKOS, shumica e vullnetarëve janë të angazhuar në organizata rinore ose organizata që punojnë me një komunitet më specifik. Organizatat e tjera kanë sfida më të mëdha në mbledhjen e anëtarëve për shkak të natyrës së punës së tyre, e cila është më burokratike, më pak praktike dhe më pak e lidhur drejtpërdrejt me komunitetin.³⁰

**INDIKATORI 13.1.3
PAVARËSIA (SIPAS LIGJIT)**

100/100



Ekzistojnë dispozita të mjaftueshme ligjore për të mbrojtur OSHC-të nga ndërhyrjet e jashtme të papërshtatshme në aktivitetet e tyre.

Sidoqoftë, Ligji për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit i vitit 2016 vazhdon të jetë kufizues për OJQ-të e regjistruara, pasi përfshin të gjitha OJQ-të si subjekte raportuese dhe, si rrjedhojë, përmban një sërë dispozitash që nuk mund të zbatohen nga shumica e të regjistruarve. OJQ-të, si dhe disa kufizime të panevojshme për donacionet në para. Në mesin e Ballaknit Perëndimor dhe Turqisë, Kosova është i vetmi vend që i trajton OJQ-të si subjekte raportuese. Ky realitet paraqet pengesa për aksesin e OJQ-ve në shërbimet thelbësore bankare, si nga hapja dhe mirëmbajtja e llogarisë deri te aksesin në shërbime më të gjera bankare. Tejkalimi i këtyre çështjeve do të rriste gjithashtu transparencën e OJQ-ve.

Liria e tubimit dhe e organizimit në Kosovë janë të drejta kushtetuese.³¹ Nuk ka kufizime ligjore për mbajtjen e takimeve publike, të cilat do të përbënin barriera për mobilizimin e OSHC-ve. Prandaj, OSHC-të janë plotësisht të lira të veprojnë në emër të tyre ose në emër të qytetarëve dhe partnerëve që ata janë të prirur të përfaqësojnë.

Ligji për OSHC-të parasheh që çdo person ka të drejtë të themelojë një organizatë joqeveritare dhe asnjë person nuk diskriminohet në asnjë mënyrë për shkak të vendimit për t'u asociuar.³² Kufizimet dhe ndalimet janë të mundshme vetëm nëse aktivitetet e OShC-ve shkelin rendin kushtetues, shkelin lirinë ose të drejtat e njeriut, ose nxisin urrejtje racore, kombëtare, etnike ose fetare.³³ Shteti mund të ndërhyjë vetëm në interes të sigurisë kombëtare ose të sigurisë publike, për të



mbrojtur rendin dhe për të parandaluar krimin, për të ruajtur shëndetin publik ose për të mbrojtur të drejtat dhe liritë e të tjerëve.³⁴

Nuk ka rregullore që kërkojnë përfshirjen e shtetit në bordet e OSHC-ve ose pjesëmarrjen e detyrueshme të shtetit në mbledhjet e OSHC-ve. Ligji për OJQ-të thotë shprehimisht se institucionet publike nuk duhet të ndërhyjnë në të drejtat dhe liritë e OJQ-ve.³⁵ Institucionet publike janë të detyruara të mbështesin dhe nxisin veprimtarinë e OJQ-ve,³⁶ duke krijuar mjedis të përshtatshëm. Po kështu, institucionet publike mbrojnë OSHC-të nga ndërhyrja e palëve të treta.³⁷

**INDIKATORI 13.1.4
PAVARËSIA (NË PRAKTIKË)**

75/100



Në përgjithësi, OSHC-të në Kosovë operojnë lirisht dhe i nënshtrohen vetëm mbikëqyrjes së arsyeshme të lidhura me interesa të qarta dhe legjitime publike. Megjithatë, ka raste të rralla kur politikanët dhe akterët e tjerë të jashtëm sulmojnë verbalisht OSHC-të dhe bëjnë akuzat e rreme.

Ndërhyrje të tilla zakonisht përbëhen nga sulme verbale pa ndonjë pasojë të rëndësishme. OShC-të më të ekspozuara ndaj tensioneve politike janë ato që kritikojnë qeverinë. Megjithatë, ato janë më të kërcënuara nga individët sesa nga institucionet. Raste tipike të sulmeve verbale janë kur politikanët qendrorë ose lokalë bëjnë deklarata të rreme për OSHC-të.³⁸ Për shembull, në vitin 2020, gjatë hapjes së platformës për fondet publike, ish-zëvendëskryeministri Haki Abazi akuzoi sektorin e shoqërisë civile për mungesë transparence.

Në vitin 2021, profesori dhe ish-dekani i Fakultetit Filozofik, Bujar Dugolli, akuzoi Organizatën për Rritjen e Cilësisë së Arsimit (ORCA) se financohet nga fonde të dyshimta, duke qenë i paqartë në akuzën e tij, pasi OSHC-ja e kishte denoncuar publikisht për plagjiaturë.³⁹

Zakonisht, liderët politikë dënojnë publikisht rastet kur aktivistët e shoqërisë civile sulmohen verbalisht.⁴⁰

Deri më tani, nuk ka pasur raste kur shteti ka arrestuar aktivistët të shoqërisë civile për shkak të aktiviteteve të tyre, apo sulmeve fizike ndaj aktiviteteve të OSHC-ve.





Qeverisja

**INDIKATORI 13.2.1
TRANSPARENCA
(NË PRAKTIKË)**

50/100



Edhe pse OSHC-të janë transparente në lidhje me aktivitetet dhe punën e tyre, ka mungesë të konsiderueshme të transparencës financiare në mesin e OJQ-ve të vogla. Megjithatë, vlen të theksohet që kjo mungesë transparence rrjedh nga mungesa e detyrimit ligjor për të gjitha OShC-të për të raportuar.

Studimi i Indeksit Kosovar të Shoqërisë Civile 2018 tregon se vetëm 27 për qind e organizatave të anketuara kanë uebfaqe dhe 39.6 për qind përdorin faqe të medieve sociale.⁴¹ Prandaj, mungon edhe transparenca në lidhje me përbërjen e OShC-ve dhe bordeve ekzekutive, përveç atyre me nivele më të larta financimi.

Vetëm organizatat e mëdha dhe ato të etabluara publikojnë raportet e tyre vjetore financiare në faqet e tyre të internetit ose platforma të tjera online. Ligji nuk i detyron OSHC-të të publikojnë pasqyrat financiare për publikun e gjerë, dhe OSHC-të me status të përfitimit publik me mbi 100,000 € në qarkullim vjetor janë të detyruara të kryejnë një auditim të jashtëm, por ende nuk janë të detyruara ta bëjnë publike atë për qytetarët.⁴² Mbi 1,880 OShC raportojnë financiarisht në ATK. OShC-të janë transparente kryesisht për shkak të kërkesave të donatorëve për të llogaritur shpenzimet e fondeve të marra⁴³ dhe rregulloret tatimore për të raportuar shpenzimet e detajuara. Në baza vjetore që nga viti 2017,⁴⁴ Zyra e Kryeministrit publikon listën e organizatave që përfitojnë nga fondet publike dhe shumën e marrë.⁴⁵

Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) aktualisht është duke zhvilluar një propozim për një sistem të raportimit financiar për të gjitha OSHC-të përmes një rregulloreje. Në të njëjtën kohë, KCSF-ja është duke ndërtuar një platformë online për transparencë financiare të të gjitha OSHC-ve.⁴⁶

**INDIKATORI 13.2.2
LLOGARIDHËNIA
(NË PRAKTIKË)**

25/100



Vetëm disa OShC mbikëqyren efektivisht nga organe të tjera, si anëtarësia ose bordi. Disa OShC e konsiderojnë bordin ose asamblenë e anëtarëve më shumë si formalitet. Megjithatë, ka edhe shembuj pozitivë ku këto organe funksionojnë në mënyrë efektive.⁴⁷

Vetëm disa OShC mbikëqyren efektivisht nga organe të tjera, si anëtarësia ose bordi. Disa OShC e konsiderojnë bordin ose asamblenë e anëtarëve më shumë si formalitet. Megjithatë, ka edhe shembuj pozitivë ku këto organe funksionojnë në mënyrë efektive.

Sipas intervistave të bëra për këtë raport, OSHC-të në përgjithësi kanë shumë pak përgjegjësi ndaj anëtarëve të tyre ose bordit të tyre. Edhe pse 95 për qind e OSHC-ve të regjistruara janë shoqata me bazë anëtarësie, vetëm disa prej tyre mbajnë takime të anëtarëve të kërkuara me ligj.⁴⁸ Një problem tjetër është se shumica e OShC-ve kanë një strukturë organizative të ndërtuar në mënyrë jo të duhur⁴⁹ ku, për shembull, ato janë të regjistruara si shoqata, por nuk kanë një asamble anëtarësh si organi më i lartë, megjithëse ky është detyrim ligjor. Anëtarësia në OShC në përgjithësi është mjaft e ulët. Disa OSHC gjithashtu përfshijnë stafin e tyre në



anëtarësi. Kjo do të thotë që stafi i raporton menaxhmentit të organizatës si punonjës, megjithatë i njëjti menaxhment i raporton stafit të tyre çdo vit.⁵⁰ Zakonisht, anëtarët e bordit të OSHC-ve janë persona publikë që vijnë nga fusha të ndryshme. Anëtarët e bordit apo asamblenë nuk duhet të kryejnë punë që bien ndesh me qëllimin e OSHC-së në të cilën janë anëtarë, gjë që është një arsye tjetër që çon në anëtarësimin e ulët brenda OJQ-ve.

**INDIKATORI 13.2.3
INTEGRITETI (NË PRAKTIKË)**

25/100



OShC-të në përgjithësi janë joaktive në sigurimin e integritetit të stafit të tyre dhe anëtarëve të tjerë ose në sanksionimin e sjelljes së keqe. Janë ndërmarrë disa iniciativa shumë të kufizuara vetërregulluese, të tilla si hartimi i kodeve të sjelljes, por në praktikë është arritur progres minimal.

Në shumicën e rasteve, OSHC-të, veçanërisht ato të mëdha, kanë dokumentet e brendshme të nevojshme, të tilla si rregulloret e punës, rregulloret financiare, kodet e sjelljes dhe madje edhe politikat për sinjalizimin e brendshëm ose ngacmimin seksual, por nuk zbatojnë sistematikisht procedurat dhe nuk e monitorojnë zbatimin. Në një masë, këto dokumente janë hartuar për të përmbushur kërkesat e donatorëve të huaj në mënyrë që të jenë të pranueshëm për të marrë grante.⁵¹ Megjithatë, bazuar në natyrën e funksionimit, shumë OShC nuk kanë fare nevojë të kenë rregulloret të tilla. Sipas Indeksit të Shoqërisë Civile të Kosovës, rreth 38 për qind e organizatave të anketuara deklaruan se nuk kanë rregullore financiare, rregullore të punës (24 për qind) apo kod të sjelljes së punonjësve (39 për qind).⁵²

CIVIKOS, si organizatë ombrellë e rreth 300 OSHC-ve në Kosovë, ka krijuar një Kod të Etikës, por zbatimi i tij ka ngecje. Kjo ngecje është për shkak të shumë faktorëve, kryesisht mungesës së interesit në mesin e OSHC-ve për vetë-rregul-

limin dhe stimujve të pamjaftueshëm, si dhe kapaciteteve njerëzore dhe financiare.⁵³ CIVIKOS gjithashtu nuk arriti të krijojë një mekanizëm të rreptë për monitorimin e zbatimit praktik të Kodit të Etikës nga anëtarët e tij.

**INDIKATORI 13.2.4
GJINIA**

50/100



Vetëm OSHC-të më të mëdha me mbështetje financiare nga donatorë të huaj marrin parasysh konsideratat gjinore në programet e tyre dhe vetëm ndonjëherë mbledhin të dhëna të ndara sipas gjinisë.

Sipas drejtorit ekzekutiv në KCSF, kjo vlen kryesisht për disa organizata më të mëdha që marrin më shumë mbështetje financiare nga donatorët e huaj dhe për këtë arsye kanë rritur ndjeshmërinë e tyre gjinore. Në organizatat më të vogla, vetëdijesimi për çështjet gjinore është më pak i theksuar.⁵⁴

Të dhënat e ndara sipas gjinisë në lidhje me shtrirjen dhe ndikimin e ngjarjeve dhe projekteve të tyre shpesh nuk mbledhen në mënyrë konsistente, megjithëse zakonisht është kusht i raportimit për donatorët e huaj në veçanti.





Roli

INDIKATORI 13.3.1 MBAJTJA E QEVERISË LLOGARIDHËNËSE

75/100



Ndërsa OSHC-të janë aktive dhe shpesh efektive në mbajtjen e qeverisë dhe institucioneve publike llogaridhënese, kjo kryesisht drejtohet nga organizata të mëdha me burime të konsoliduara.

Shoqëria civile ka rol të zhvilluar si mbikëqyrës. Aktivitetet tipike në të cilat marrin pjesë OSHC-të përfshijnë diskutime publike, kontribute për ligje dhe rregullore specifike – si duke marrë pjesë në grupet përkatëse të punës dhe duke avokuar për ndryshime – dhe mbikëqyrjen e punës së Kuvendit dhe institucioneve të tjera publike. Për të gjetur një qëndrim të përbashkët, OSHC-të kanë krijuar rrjete ose janë bashkuar me to, siç është rasti i rrjetit të organizatave vendore të vëzhgimit të zgjedhjeve “Demokracia në Veprim”.

Në vitin 2018, KCSF, në një përpjekje të përbashkët me 300 OSHC, kundërshtoi ndryshimet në Ligjin për OJQ-të, të cilat lejuan transferimin e kapitalit të OShC-ve tek institucionet private, i mundësoi shtetit mbylljen e OShC-ve bazuar në interpretimet arbitrare të veprimtarisë së OShC-ve, duke e vështirësuar themelimin e OShC-ve të reja dhe duke shkelur statusin e tyre për përfitim publik.⁵⁵ Fushata⁵⁶ ishte e suksesshme dhe pasi Presidenti e ktheu projektligjin për shqyrtim në Kuvend, ai u miratua me amendamentet e propozuara nga OShC-të.

Në vitin 2019, mbi 100 organizata të shoqërisë civile iu bashkuan “Marshit të Refuzimit” për të kundërshtuar Projektligjin për Financimin e Subjekteve Politike, i cili vlerësohej se shkelte Kushtetutën dhe standardet ndërkombëtare (të Komisionit të Venecias) duke cenuar pavarësinë e Zyrës që ishte përgjegjëse për mbikëqyrjen financiare, duke ulur gjatë ndaj subjekteve

politike, duke rritur kufijtë e donacioneve, duke lejuar kontribute më të larta në para të gatshme, etj.⁵⁷ Menjëherë pas protestës, kryeministri i atëhershëm, Ramush Haradinaj, e tërhoqi projektligjin në përgjigje të presionit publik.⁵⁸

Një shembull tjetër që demonstroi përfshirjen e organizatave të shoqërisë civile në sigurimin e llogaridhënies ka të bëjë me emërimin e Kryeprokurorit të Shtetit. Në këtë rast, OSHC-të monitoruan në mënyrë aktive procesin e përzgjedhjes dhe identifikuan një sërë mangësish që minonin integritetin e procesit.⁵⁹ Veçanërisht, Presidentja e vendit i mori parasysht këto vlerësime dhe, kur vendosi të refuzojë emërimin e Kryeprokurorit, iu referua shprehimisht vëzhgimeve të bëra nga OShC-të.⁶⁰

OShC-të kanë qenë aktive në edukimin e institucioneve publike për t’u bërë më transparente dhe llogaridhënese. Kjo në përgjithësi përfshin vendosjen e praktikave të mira, si p.sh. pjesëmarrja në themelimin e Forumit për Transparencë të Kuvendit të Kosovës⁶¹, miratimin e planeve të Partneritetit Kombëtar të Qeverisjes së Hapur (OGP), prezantimi i sesioneve të drejtëpërdrejta të pyetjeve dhe përgjigjeve me përfaqësues politikë, etj.

INDIKATORI 13.3.2 REFORMAT NË POLITIKA

75/100



Shoqëria civile është përgjithësisht shumë aktive në angazhimin me qeverinë për politikat kundër korrupsionit. Megjithatë, suksesi është i kufizuar.

Shoqëria civile ka qenë një forcë shtytëse në luftën kundër korrupsionit.⁶² OShC-të kanë kontribuar në hartimin dhe



ndryshimin e shumë ligjeve, duke përfshirë financimin e partive politike, legjislacionit zgjedhor, deklarimin e pasurisë, konfiskimin e pasurisë, Kodin Penal, Këshillin Gjyqësor dhe Këshillin Prokurorial, Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit dhe ligje të tjera të tilla.

OJQ-të kanë dhënë kontribute të vlefshme duke ofruar ekspertizën e tyre në aktivitetet e grupeve të ndryshme të punës dhe duke ofruar rekomandime specifike në lidhje me legjislacionin. Sa për ilustrim, në kontekstin e legjislacionit të financimit politik, OSHC-të kanë luajtur rol kryesor duke organizuar vizita studimore për ligjvënësit në vendet e Bash-

kimit Evropian, gjë që i lejoji deputetët të fitonin njohuri mbi praktikat më të mira në lidhje me mekanizmat e raportimit dhe mbikëqyrjen efektive financiare për subjektet politike.⁶³ Rrjedhimisht, OJQ-të kanë qenë instrumentale në avancimin e masave që sigurojnë autonominë e Zyrës për Kontroll Financiar brenda KQZ-së dhe që rrisin transparencën e raporteve të publikuara financiare.

Sot ka shumë përfaqësues të shoqërisë civile që janë anëtarë të këshillave dhe agjencive të rëndësishme, ku janë të përfshirë drejtëpërdrejt në vendimmarrje dhe ku u jepet e drejta e votës, megjithëse nuk është dhënë shumë efekt i prekshëm.

Ndërveprimet

Organizatave të shoqërisë civile bashkëpunojnë ngushtë me pothuajse të gjitha institucionet në vend. Për shkak të kompetencave të tyre vendimmarrëse, bashkëpunimi më i theksuar shfaqet me ekzekutivin, legjislativin, gjyqësorin dhe institucionet e tjera të përfshira në luftën kundër korrupsionit. Shumica e ndërveprimeve ndërmjet OShC-ve dhe këtyre akterëve ndodhin mbi baza joformale të bashkëpunimit. Megjithatë, ka edhe raste të shpeshta të nënshkrimit të memorandumeve të mirëkuptimit.

Në kuadër të bashkëpunimit me qeverinë, ekziston një Strategji e Qeverisë për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile⁶⁴ e cila synon të përmirësojë mjedisin operativ për shoqërinë civile. Në kuadër të kësaj strategjie u krijua Këshilli për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile.⁶⁵ Në lidhje me legjislativin, janë nënshkruar memorandume të shumta mirëkuptimi nga OShC-të, të cilat kryesisht synojnë rritjen e kapaciteteve të Kuvendit të Kosovës për të ushtruar funksionet e tij dhe monitorimin efektiv të politikave.⁶⁶ OShC-të gjithashtu bashkëpunojnë zyrtarisht me institucionet financiare si Administrata Tatimore e Kosovës.⁶⁷

Nëpërmjet bashkëpunimit me institucionet, shoqëria civile ka arritur të ndikojë pozitivisht në punën e tyre në luftën kundër korrupsionit dhe të rrisë transparencën dhe llogaridhënien e tyre ndaj publikut.

Rekomandimet e shtyllës

- Qeveria duhet të ndryshojë ligjin për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftën kundër financimit të terrorizmit, pasi aktualisht paraqet kufizime ligjore për veprimtarinë e OShC-ve në aspektin financiar, duke marrë parasysht rekomandimet e shoqërisë civile.⁶⁸
- CIVIKOS duhet:
 - Të kërkojë nga OShC-të anëtarë të jenë më transparente dhe të publikojnë raporte financiare vjetore.
 - Të bashkëpunojnë me Rrjetin Ballkanik të Zhvillimit të Shoqërisë Civile për të zhvilluar masa për rritjen e llogaridhënies së OShC-ve bazuar në Standardin Global për Llogaridhënien e OShC-ve.⁶⁹



REFERENCAT

- Dy organizata të shquara joqeveritare (OJQ) që luajtën rol vendimtar në formësimin e kësaj shtylle janë KCSF dhe platforma CIVIKOS. KCSF shquhet si një nga themelet më të qëndrueshme dhe afatgjata në Kosovë, me një rezervuar të konsiderueshëm financiar, një pjesë e konsiderueshme e të cilit kanalizohet në mbështetjen e OShC-ve të tjera të ndryshme. Në anën tjetër, CIVIKOS zë vendin e saj si një nga rrjetet ndërsektoriale më të mëdha dhe më të larmishme brenda peizazhit të shoqërisë civile të Kosovës, duke përfshirë një anëtarësim prej rreth 300 OJQ-ve. Veçanërisht, CIVIKOS është shfaqur si zëri përfaqësues de facto për OJQ-të në ndërveprimet e tyre me qeverinë, kryesisht për shkak se një pjesë e konsiderueshme e OJQ-ve të mirë-formuara janë të lidhura me këtë platformë.
- Ligji Nr. 06/L –043 për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare, neni 19. Gjetendet në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=19055>
- Ligji Nr. 06/L –043 për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare, neni 31, pika 1.
- Ligji Nr. 06/L –043 për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare, neni 31, pika 2.
- Indeksi Kosovar i Shoqërisë Civile, nga "Fondacioni Kosovar i Shoqërisë Civile" (2018), faqe 18.
- USAID (2022), Indeksi i Qëndrueshmërisë së OSHC-ve 2021– Kosovë, f. 3, <https://storage.googleapis.com/cso-si-dashboard.appspot.com/Reports/CSOSI-Kosovo-2021.pdf>
- Kushtetuta e Kosovës, neni 44.
- Ligji Nr. 06/L –043 për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare, Neni 4.
- Udhëzimi Administrativ (QRK) - Nr.12/2022 për Regjistrimin, Vepimtarinë dhe Çregjistrimin e Organizatave Joqeveritare. Gjetendet në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=19055>
- OShC-të duhet të paraqesin kërkesë për regjistrim në Departamentin për Organizata Joqeveritare në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Kërkesa për regjistrim duhet të përmbajë vetëm aktin e themelimit, statutin dhe dokumentet e identifikimit të themeluesve. Shih: Ligji Nr. 06/L –043 për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare, neni 22, paragrafët 1 dhe 4. Regjistrimi bëhet brenda 30 ditëve nga paraqitja e kërkesës, Shih: Ligji Nr. 06/L –043 për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare, neni 25, paragrafi 2.
- Udhëzimi Administrativ (QRK) - Nr.12/2022 për Regjistrimin, Vepimtarinë dhe Çregjistrimin e Organizatave Joqeveritare, neni 7, paragrafi 2.
- Ligji Nr. 06/L –043 për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare, neni 22, paragrafi 2.
- Ligji parashih katër skenarë që mund të çojnë në refuzimin e kërkesës për regjistrim, duke përfshirë: dokumentet e regjistrimit janë në kundërshtim me kërkesat e ligjit; statuti i OJQ-së promovon pabarazinë mbi ndonjë bazë; organizata që kërkon regjistrim ka të njëjtin emër ose akronim si një OJQ e regjistruar më parë ose tashmë e themeluar, dhe emër dhe simbol të njëjtë ose të ngjashëm me një institucion publik në mënyrë që të shkaktojë konfuzion ose të jetë çorientues; nëse nuk respektohen afatet e përcaktuara me ligji.
- Ligji Nr. 06/L –043 për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare, Neni 26, paragrafët 1 dhe 2.
- Ligji për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare, nenet 8 dhe 9.
- Ligji për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare, neni 43; dhe Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative, neni 127, paragrafi 1.
- Vendim Shpjegues Publik Nr. 04/2016 për trajtimin e donacioneve për qëllime tatimore.
- USAID, Byroja për Demokraci, Konflikt dhe Ndihmë Humanitare (BDCHA) dhe Qendra e Ekselencës për Demokraci, të Drejtat e Njeriut dhe Qeverisje (CEDHRG), Botimi i 24 i Indeksit të Qëndrueshmërisë së OSHC-ve (CSOSI) për Evropën Qendrore dhe Lindore dhe Euroazinë 2020, fq. 118. Gjetendet në: <https://www.fhi360.org/sites/default/files/media/documents/csosi-europe-eurasia-2020-report.pdf> [qasur më 4 nëntor 2022]
- 15 milionë euro nga organizatat qendrore dhe 14 milionë euro nga komunat. Shih: <https://kk.rks-gov.net/lipjan/wp-content/uploads/sites/20/2022/05/RAPORTI-PER-FINANCIM-TE-OJQ-VE-PER-VITIN-2021.docx>
- Numri i OSHC-ve të mbështetura nga qeveria qendrore (2020: 420 & 2021: 1,073); Numri i OSHC-ve të mbështetura nga komunat (2020: 939 & 2021: 2677). Shih: <https://kk.rks-gov.net/lipjan/wp-content/uploads/sites/20/2022/05/RAPORTI-PER-FINANCIM-TE-OJQ-VE-PER-VITIN-2021.docx>
- USAID (2022), Indeksi i Qëndrueshmërisë së OSHC-ve 2021– Kosovë, f. 4, <https://storage.googleapis.com/cso-si-dashboard.appspot.com/Reports/CSOSI-Kosovo-2021.pdf>
- Matrica e monitorimit për krijimin e një mjedisi të favorshëm për zhvillimin e shoqërisë civile - Raport për Kosovën nga "Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile" (2019), faqe 22.
- Intervistë me Taulant Hoxha, Drejtor Ekzekutiv në KCSF, gusht 2022
- USAID, Byroja për Demokraci, Konflikt dhe Ndihmë Humanitare (BDCHA) dhe Qendra e Ekselencës për Demokraci, të Drejtat e Njeriut dhe Qeverisje (CEDHRG), Botimi i 24 i Indeksit të Qëndrueshmërisë së OSHC-ve (CSOSI) për Evropën Qendrore dhe Lindore dhe Euroazinë 2020, fq. 118.
- Intervistë me Dardan Kryeziun, Menaxher Programi në CIVIKOS, korrik 2022.
- Fondacioni i Ndihmës së Bamirësisë (2022), Indeksi i Dhurimit Botëror CAF 2021, f. 22, https://www.cafonline.org/docs/default-source/about-us-research/caf_world_giving_index_2022_210922-final.pdf (vizituar për herë të fundit më 6 janar 2023)
- USAID (2022), Indeksi i Qëndrueshmërisë së OSHC-ve 2021– Kosovë, f. 3, <https://storage.googleapis.com/cso-si-dashboard.appspot.com/Reports/CSOSI-Kosovo-2021.pdf>
- USAID (2022), Indeksi i Qëndrueshmërisë së OSHC-ve 2021– Kosovë, f. 5, <https://storage.googleapis.com/cso-si-dashboard.appspot.com/Reports/CSOSI-Kosovo-2021.pdf>
- Fondacioni i Ndihmës së Bamirësisë (2022), Indeksi i Dhurimit Botëror CAF 2021, f. 22, https://www.cafonline.org/docs/default-source/about-us-research/caf_world_giving_index_2022_210922-final.pdf (vizituar për herë të fundit më 6 janar 2023)
- Intervistë me Dardan Kryeziun, Menaxher Programi në CIVIKOS, korrik 2022.
- Kushtetuta e Kosovës, neni 43 dhe 44.
- Ligji Nr. 06/L –043 për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare, Neni 4, pikat 1 dhe 4.

- Ligji Nr. 06/L –043 për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare, Neni 44.
- Ligji Nr. 06/L –043 për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare, Neni 14, paragrafët 2 dhe 3.
- Ligji Nr. 06/L –043 për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare, Neni 13.6.
- Ligji Nr. 06/L –043 për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare, Neni 13.2
- Ligji Nr. 06/L –043 për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare, Neni 13.5.
- Intervistë me Dardan Kryeziun, Menaxher Programi në CIVIKOS, korrik 2022.
- <https://www.gazetaexpress.com/dugolli-i-reagon-orca-s-qe-e-akuzoi-per-plagjiature-praktikantet-nuk-duhet-te-bijne-pre-e-e-maileve-anonime/>
- Për më shumë, shihni artikujt në media: <https://telegrafi.com/lv-pajtohet-me-shoqerine-civile-per-projektligjin-per-financimin-e-partive-politike-de-non-sulmin-fizik-ndaj-aktivisteve-nga-zyrtare-te-pdk-se/>; <https://www.zeriamerikes.com/a/kosovo-journalist/2665049.html>
- Indeksi Kosovar i Shoqërisë Civile, nga "Fondacioni Kosovar i Shoqërisë Civile" (2018), faqe 21.
- Ligji Nr. 06/L –043 për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare, neni 38, paragrafi 8.
- Intervistë me Dardan Kryeziun, Menaxher Programi në CIVIKOS, korrik 2022.
- Kur ka hyrë në fuqi rregullorja për fondet publike për OSHC-të. Shih: Rregullorja nr. 04/2017 për kriteret, standardet dhe procedurat për financimin publik të OJQ-ve, neni 26, paragrafi 2.
- Për më shumë, shihni Raportin Vjetor të Zyrës së Kryeministrit për Mbështetjen Financiare Publike për OJQ-të në Republikën e Kosovës për vitin 2021. E disponueshme në: <http://ojqfinancime.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/06/Raportivjetor2021.pdf> Përveç kësaj, ekziston një bazë e të dhënave online për financimin publik të OJQ-ve. Gjetendet në: <http://ojqfinancime.rks-gov.net/lista-e-hollesishme/>
- Intervistë me Taulant Hoxha, Drejtor Ekzekutiv në KCSF, gusht 2022.
- Njëra prej tyre është Down Syndrome Kosova, e cila përfshin prindërit ose anëtarët e familjes së personave me sindromën Down në asamblenë e anëtarëve, duke qenë kështu një shembull i mirë i ndërveprimit ndërmjet menaxhmentit të organizatës dhe asamblesë së anëtarëve. Këto të dhëna janë marrë në intervistën e realizuar me Dardan Kryeziun, Menaxher Programi në CIVIKOS, korrik 2022.
- USAID (2022), Indeksi i Qëndrueshmërisë së OSHC-ve 2021– Kosovë, f. 3, <https://storage.googleapis.com/cso-si-dashboard.appspot.com/Reports/CSOSI-Kosovo-2021.pdf>
- Intervistë me Taulant Hoxha, Drejtor Ekzekutiv në KCSF, gusht 2022.
- Intervistë me Taulant Hoxha, Drejtor Ekzekutiv në KCSF, gusht 2022.
- Intervistë me Taulant Hoxha, Drejtor Ekzekutiv në KCSF, gusht 2022.
- Indeksi Kosovar i Shoqërisë Civile, nga "Fondacioni Kosovar i Shoqërisë Civile" (2018), faqe 21.
- Intervistë me Taulant Hoxha, Drejtor Ekzekutiv në KCSF, gusht 2022.
- Intervistë me Taulant Hoxha, Drejtor Ekzekutiv në KCSF, gusht 2022
- Ekonomia Online, "300 OJQ kundërshtojnë ligjin e ri për OJQ-të" (shkurt, 2019). Gjetendet në: <https://ekonomiaonline.com/300-organizata-joqeveritare-kundershtojne-ligjin-e-ri-per-ojq/> [qasur më 15 tetor 2023]
- KCSF, Komisioni Parlamentar për Administratën Publike shtyn përpara dispozitat jokushtetuese të ligjit për OJQ-të, gjendet në: <https://www.kcsfoundation.org/activity/ngolaw/> [qasur më 5 shtator 2022]
- Faqja zyrtare e KDI-së. Gjetendet në: <https://kdi-kosova.org/aktivitetet/shoqeria-civile-marshon-kunder-projektligjit-per-financimin-e-sujekteve-politike-pengohet-dhunshem-nga-pdk-ja/> [qasur më 5 shtator 2022]
- Portali Telegrafi (2019), Qeveria tërheq projektligjin për financimin e partive politike, <https://telegrafi.com/qeveria-terheq-projektligjin-per-financimin-e-partive/> [qasur më 5 shtator 2022]
- Koha.Net, "IKD, GLPS dhe FOL: Propozimi i KPK-së për emërimin e kryeprokurorit të ri të shtetit, i papranueshëm" (prill, 2022). Gjetendet në: <https://www.koha.net/arberi/319334/ikd-glps-dhe-fol-propozimi-i-kpk-se-per-emerim-te-kryeprokurorit-te-ri-te-shtetit-i-papranueshem/> [qasur më 9 nëntor 2023]
- Radio Evropa e Lirë, "Presidentja Osmani nuk e emëron Isufajn në postin e Kryeprokurorit të Shtetit." (tetor, 2023). Gjetendet në: <https://www.evropaelire.org/a/vjosa-osmani-kryeprokurori-i-shtetit-/32640852.html> [qasur më 9 nëntor 2023]
- Për më shumë, shihni seksionin e Forumit për Transparençën Parlamentare. Gjetendet në: <https://www.kuvendikosoves.org/eng/for-the-public/forum-for-parliamentary-transparency/>
- Intervistë me Taulant Hoxha, Drejtor Ekzekutiv në KCSF, gusht 2022.
- Për më shumë shihni artikullin e KDI-së lidhur me vizitën e deputetëve në Çeki, në kohën kur në Kuvend po diskutohej projektligji për financime politike. Gjetendet në: <https://shorturl.at/msR28>
- Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, Strategjia e Qeverisë për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019-2023. Gjetendet në: http://www.civikos.net/repository/docs/Strategy_Alb_815880.pdf
- Për më shumë, shihni: <https://kryeministri.rks-gov.net/zyra-e-kryeministrit/keshilli-per-bashkepunim-te-qeverise-me-shoqerine-civile/>
- Ndër të tjera, memorandumet janë si më poshtë: Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet Institutit Demokratik të Kosovës dhe Kuvendit të Kosovës. Gjetendet në: <https://kdi-kosova.org/timeline/nenshkruhet-memorandumi-i-mirekuptimit-mou-me-kuvendin-e-kosoves/>; Memorandum Bashkëpunimi ndërmjet Institutit për Politikë Sociale "Musine Kokalari" dhe Kuvendit të Kosovës. Gjetendet në: <https://kallxo.com/lajm/visar-ymeri-nenshkruan-memorandum-bashkepunimi-me-kuvendin-e-kosoves/>; Memorandum Bashkëpunimi ndërmjet Grupit për Studime Juridike dhe Politike dhe Kuvendit të Kosovës. Gjetendet në: [https://kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Files/28/2021_08_19_Memorandum_i_punes_së_përbashkët_mes_Kuvendit_të_Republikës_së_Kosovës_dhe_Grupit_për_Studime_Juridike_dhe_Politike_\(GLPS\)_UzVCGqFAUp.pdf](https://kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Files/28/2021_08_19_Memorandum_i_punes_së_përbashkët_mes_Kuvendit_të_Republikës_së_Kosovës_dhe_Grupit_për_Studime_Juridike_dhe_Politike_(GLPS)_UzVCGqFAUp.pdf)
- Për më shumë shihni njoftimin për nënshkrimin e memorandumit të bashkëpunimit ndërmjet; Administratës Tatimore të Kosovës dhe Rrjetit Ballkanik të Gazetarisë Hulumtuese si dhe organizatës Demokracia Plus. Gjetendet në: <https://ekonomia-ks.com/sq/ekonomi/atk-nenshkruan-memorandum-me-birn-dhe-demokracia-plus>
- Për më shumë, ju lutemi shikoni rekomandimet e OShC-ve lidhur me këtë çështje që janë pjesë e raportit "Ndikimi i kufizimeve bankare në OJQ-të në Kosovë", faqe 13. Gjetendet në: <https://dokumen.tips/documents/raport-ndikimi-i-kufizimeve-bankare-tek-ojq-t-n-kosov-2-ligji-nr-06l-043.htm-l?page=13>
- Për më shumë, ju lutemi shihni Standardin Global për Llogaridhënien e OShC-ve. Gjetendet në: https://www.csostandard.org/wp-content/uploads/2019/09/GlobalStandard_CoreDocument_Albanian.pdfv


BIZNESET

> |> > >< <><> ><> > ><>


PËRMBLEDHJE

Spektori i biznesit rregullohet me procedura të përcaktuara nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) dhe me kornizën ligjore të përcaktuar me Ligjin për Shoqëritë Tregtare, i ndryshuar në qershor 2018.


40/100 Overall pillar score




Capacity



Governance



Role





Legjislacioni kërkon që kompanitë të regjistrohen në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë (ARBK). Llojet e bizneseve përfshijnë bizneset individuale, ortakëritë e përgjithshme, ortakëritë e kufizuara, shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara dhe shoqëritë aksionare.

Procedurat për hapjen e bizneseve janë thjeshtuar shumë dhe hapja e një biznesi zgjat vetëm 24 deri në 72 orë. Në regjistrin qendror janë 213,739 biznese të regjistruara ku ruhen të dhënat për të gjitha kompanitë e regjistruara. Bizneset i nënshtrohen tatimit mbi të ardhurat, tatimit mbi vlerën e shtuar dhe tatimit mbi të ardhurat e korporatave. Ato gjithashtu duhet të mbajnë në burim tatimet dhe kontributet e pensioneve për punonjësit e tyre dhe çdo qira që paguajnë. Ka pasur një rritje të numrit të bizneseve të reja të regjistruara në ARBK, por pandemia e COVID-19 ka prekur shumë kompani që janë mbyllur apo kanë pushuar së funksionuari.

Ende shqetësuese është çështja e ekonomisë joformale dhe mungesa e sundimit të ligjit në raport me bizneset dhe aktivitetin ekonomik. Kjo do të thotë që pasi regjistrohet një biznes, ai nuk mbrohet mirë nga shteti. Çdo kërcënim apo ryshfet që merr apo jep një biznes ka pak të ngjarë të raportohet në gjykata, pasi ato konsiderohen të paefektshme dhe të ndikuara politikisht.

Mungojnë të dhënat specifike për pronësinë e bizneseve dhe rregullimin ligjor, si dhe mungon një organ i posaçëm për kontrollin dhe mbikëqyrjen e bursës.



Kapacitetet



**INDIKATORI 14.1.1
BURIMET (SIPAS LIGJIT)**

75/100



Ligjet që kanë të bëjnë me nisjen dhe operimin e bizneseve individuale janë të qarta, të drejtpërdrejta dhe të lehta për t'u zbatuar dhe përfshijnë vetëm kërkesa të arsyeshme për aplikantët. Megjithatë, një pjesë e legjislacionit është e vjetëruar dhe nuk është e harmonizuar me standardet ndërkombëtare.

Ligji për tregtinë është i vetmi ligj që rregullon tregtinë e brendshme; megjithatë, ai nuk është ndryshuar që nga viti 2007 dhe nuk është i harmonizuar me Direktivat e BE-së dhe dispozitat e Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA).¹ Ligji për Shoqëritë Tregtare, i miratuar në vitin 2018, rregullon regjistrimin e bizneseve, aktivitetet operacionale dhe raportimin dhe është i vetmi ligj që rregullon të gjithë sektorët e biznesit në vend.² Ligji për Falimentimin rregullon procedurat e falimentimit dhe mbylljes së bizneseve, të cilat kategorizohen sipas llojeve të subjekteve tregtare.³

Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës përcakton rregullat dhe masat për mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg.⁴ Pavarësisht ekzistencës së tij, ky ligj nuk zbatohet fare në rastet e shkeljeve të raportuara në prokurimet publike apo partneritetet publiko-private (PPP) dhe koncesionet apo investimet strategjike.

Për më tepër, ekzistojnë edhe Ligji për Investimet e Huaja⁵ dhe Ligji i Investimeve Strategjike,⁶ të cilat ndihmojnë në realizimin e investimeve dhe investimeve strategjike në Repub-

likën e Kosovës. Këto ligje mbështesin parimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit mes Kosovës dhe BE-së.

Ligji për Markat Tregtare është miratuar nga Kuvendi i Kosovës në vitin 2022 dhe përcakton kushtet dhe procedurat për regjistrimin e markave tregtare, siç janë fitimi i së drejtës, shenjat dalluese, karakteristikat që shoqërojnë markën deri në marrjen e licencës dhe marrjen e të drejtës për regjistrim.⁷ Ligji për Mbrojtjen e Sekreteve Tregtare synon të rregullojë mbrojtjen kundër blerjes, përdorimit dhe zbulimit të jashtëligjshëm të sekreteve tregtare. Mirëpo, ky ligj nuk adreson dhe nuk krijon mundësinë e një organi në kuadër të MTI-së i cili merret me sekretet tregtare, i cili vazhdon të jetë në mos pajtim me ligjin për konfliktin administrativ, i cili parasheh se çdo kontest duhet të trajtohet në shkallë të parë brenda institucionit të cilit i përket.

Ligji për Gjykatën Komerciale hodhi themelet për themelimin e Gjykatës Komerciale në vitin 2022 si mekanizëm i ri për zgjidhjen e kontesteve ekonomike.⁸

Janë pesë hapa të detajuar për informimin e qytetarëve për procedurat e hapjes për një biznes.^{9,10} E drejta e pronësisë mbrohet nga Ligji për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta.¹¹ Disa dispozita sanksionojnë shkeljen e rregullave për mbrojtjen e pronësisë intelektuale.^{12,13}


Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve rregullon formën e zbatimit të kontratave, duke përfshirë parimet bazë dhe rregullat e përgjithshme për të gjitha detyrimet. Ligji ka dispozita të mjaftueshme që garantojnë zbatimin e kontratave, si dispozita për objektet, detyrimet, format, afatet dhe vlefshmërinë e kontratave.¹⁴ Ligji për Partneritetet Publiko-Privat ofron fleksibilitet edhe në strukturimin e investimeve të këtij lloji dhe në formën e zbatimit të kontratës.¹⁵





**INDIKATORI 14.1.2
BURIMET (NË PRAKTIKË)**

50/100



Në përgjithësi, fillimi, funksionimi dhe mbyllja e një biznesi përfshin një investim të moderuar sa i përket kohës dhe parave. Megjithatë, ka probleme sa i përket procesit të falimentimit, zbatimit të mekanizmave të ankesave dhe mbrojtjes së të drejtave të pronësisë (intelektuale).

Reforma në praktikën e regjistrimit të bizneseve ka nisur në vitin 2020 dhe po vazhdon. Procedurat për të regjistruar një biznes janë përgjithësisht të thjeshta dhe zgjasin mesatarisht vetëm një deri në tri ditë, në varësi të llojit të biznesit.¹⁶ Një procedurë e tillë mund të bëhet edhe online përmes faqes zyrtare të ARBK-së dhe si proces është pa pagesë.¹⁷ Sipas drejtorit ekzekutiv të Institutit Riinvest, problemi më i madh është aplikimi i legjislacionit për falimentimin apo mbyllja e bizneseve. Procesi operacional i falimentimit dhe mbylljes së bizneseve zgjat më shumë; prandaj, shumë biznese nuk i respektojnë këto procese.¹⁸

Në vitin 2018, Ministria e Financave themeloi bordin e ankesave për të ndihmuar bizneset të shmangin burokracinë e tepër në procedurat për zhvillimin e ankesave, kryesisht në Doganë dhe Administratën Tatimore të Kosovës.¹⁹ Në të njëjtën kohë, në një nivel më të lartë, krijimi i Gjykatës Komerciale ishte një hap pozitiv drejt zgjidhjes në kohë të kontesteve ekonomike. Gjykata Komerciale ka filluar të funksionojë në gjysmën e dytë të vitit 2022. Gjatë kësaj periudhe, në këtë Gjykatë janë kaluar 7972 lëndë nga gjykata e apelit dhe janë përfunduar 2,073 lëndë të pranuar.²⁰

Mbrojtja efektive e të drejtave pronësore çalon në praktikë, ku kritikën kryesore janë mosfunksionimi i mekanizmit ankimor dhe moszbatimi i legjislacionit për Ligjin për të Drejtën e Autorit.²¹ Ka të paktën një rast të fillimit të procedurës ligjore për mbrojtjen e të drejtës së autorit. Në këtë rast, i njohur si

rasti "Stupcat", Emrush Taçi dyshohet se ka përfutur 100 mijë euro duke shkelur të drejtën e autorit të tre akterëve të humorit të njohur si "Stupcat". Taçi dyshohej se ka kryer veprën penale të shkeljes së të drejtës së autorit. Kjo lëndë nga viti 2012 deri në vitin 2022 nuk ka marrë asnjë vendim përfundimtar nga gjykata.²²

Veçanërisht bizneset e reja mbeten kryesisht të pambështetura nga shteti. Që nga maji 2023, Qeveria ka nisur një program të ri të quajtur "Super Puna", një ndërmjetës midis punëdhënësit dhe punëkërkuarit, i cili subvencionon punonjësit e rinj me 264 € për 6 muaj.²³ Megjithatë, sukcesi dhe cilësia e kësaj mbështetjeje ende nuk mund të vlerësohet.

**INDIKATORI 14.1.3
PAVARËSIA (SIPAS LIGJIT)**

75/100



Ekzistojnë garanci gjithëpërfshirëse ligjore për të parandaluar ndërhyrjet e jashtme të papërshtatshme në aktivitetet e bizneseve private. Megjithatë, nuk ka një rregullore të veçantë për kompensimin e bizneseve në rastet e ndërhyrjeve.

ARBK-ja si agjenci është përgjegjëse për regjistrimin e shoqërive tregtare.²⁴ Në çdo komunë identifikohen zyrtarët që merren me regjistrimin e bizneseve private dhe emrat e tyre bëhen publikë në faqen zyrtare të agjencisë.²⁵

Sa i përket mekanizmit të ankesës, procedurat e ankesës janë të përcaktuara me Ligjin për Shoqëritë Tregtare.²⁶ Në rast të ndonjë ankese, Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës vendos për ankesën brenda 15 ditëve nga pranimi.²⁷ Në anën tjetër, në rastet e ndërhyrjeve të papërshtatshme nga jashtë, të gjithë subjekteve juridike, përfshirë bizneset, u garantohej mbrojtja nga




mekanizmat civilë, penalë dhe administrativë; këto mekanizma janë të përshkruara në disa ligje të ndryshme.

Nëse ankesa nuk shqyrtohet, i dërgohet Komisionit të MTI-së, i cili është përgjegjës për administrimin e kërkesave.²⁸ Nëse Komisioni e aprovon ankesën, do të kërkojë nga kreu i ARBK-së që të ndër marrë masat e duhura për korrigjimin e këtyre problemeve.²⁹

Ligji përcakton të drejtat e kompensimit për shoqëritë tregtare, i cili përcakton të gjitha llojet e kompensimit që lidhen me llojet e shoqërive tregtare.³⁰ Megjithatë, nuk ka rregulla të veçanta që rregullojnë kërkimin e kompensimit nga bizneset në rast ndërhyrjeje.

**INDIKATORI 14.1.4
PAVARËSIA (NË PRAKTIKË)**

50/100



Institucionet shtetërore herë pas here ndërhyjnë në aktivitetet e sektorit të biznesit. Megjithatë, mbështetja për bizneset nga shteti ka filluar të rritet.

Ka pasur raste kur zyrtarë shtetërorë kanë abuzuar me detyrën zyrtare duke kërkuar dhe pranuar para nga bizneset. Rasti më i fundit është ai i një zyrtari të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, i cili u arrestua me dyshimin se kërkonte dhe merrte para në këmbim të subvencioneve për bizneset me vlerë mijëra euro.³¹ Në hulumtimin e kryer nga Instituti Riinvest, 91 për qind e bizneseve të anketuara deklaruan se korrupsioni në biznes ishte shkaktuar nga kërkesat dhe kushtet e vendosura nga zyrtarët publikë.³²

Shteti ka filluar të mbështesë bizneset (për shembull në formën e paketave të ndihmës financiare) për të operuar në vend, por ka ende vështirësi në krijimin e bashkëpunimit për

të çuar përpara sundimin e ligjit dhe luftën kundër korrupsionit në sektorin e biznesit.³³

Sektorit privat i mungon mbështetja nga qeveria sa u përket paketave financiare për të stimuluar ekonominë, si dhe problem shihen taksat e larta si barrë e lartë tatimore mbi importet.³⁴

Qeveria mbështet më shumë bizneset e mëdha në krahasim me ato më të vogla. Kjo u evidentua në shpërndarjen e paketave financiare për bizneset për rimëkëmbje pas pandemisë COVID-19.³⁵

Sipas drejtorit ekzekutiv të Institutit Riinvest, është e lehtë për një biznes të ankohet apo të bëjë padi kundër sjelljes së zyrtarëve të administratës publike. Edhe pse kjo është e përcaktuar me Ligjin për Shoqëritë Tregtare,³⁶ në praktikë, procesi i zgjidhjes së ankesave apo paraqitjes së padive në gjykata është i zgatur dhe është kritikuar ndër vite.³⁷





Qeverisja

**INDIKATORI 14.2.1
TRANSPARENCA
(SIPAS LIGJIT)**

75/100



Ekzistojnë rregulla gjithëpërfshirëse të publikimit për aktivitetet e biznesit, veçanërisht për të dhënat financiare. Problem mbetet mungesa e inspektimeve bankare dhe zbrazëtia ligjore në lidhje me transparencën e pronësisë përfutuese (beneficial ownership).

Legjislati i ri për kontabilitetin, raportimin financiar dhe auditimin ka hyrë në fuqi në vitin 2018. Ai parasheh që të gjitha shoqëritë tregtare duhet t'i nënshtrohen auditimit dhe raportimit financiar.³⁸ Standardet e auditimit dhe raportimit janë të specifikuar dhe të detajuara për çdo lloj biznesi, duke siguruar një mekanizëm më të rreptë zbatimi për këto standarde.³⁹ Auditimi i bizneseve kryhet duke u bazuar në kategorizimin e llojeve të shoqërive tregtare. Çdo kompani tregtare duhet të auditohet pasqyrat financiare të biznesit në baza vjetore fiskale përmes një auditori të jashtëm të kontraktuar.⁴⁰ Shoqëritë tregtare në Kosovë caktojnë një auditor ose një firmë auditimi për angazhim fillestar për të paktën një vit. Angazhime të tilla mund të vazhdohen.⁴¹ Pasqyrat financiare të audituara duhet të dorëzohen dhe publikohen në Këshillin për Raportim Financiar, dhe një kopje i dorëzohet MINT-it jo më vonë se 30 prilli i vitit vijues.⁴² Ligji kërkon që raportimi të kryhet sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.⁴³ Megjithatë, nuk ka dispozita lidhur me inspektimet vjetore bankare.

Kosova ka zbatuar masa ligjore për të rregulluar transparencën e pronësisë përfutuese. Ligji për Parandalimin e

Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit është një nga instrumentet kryesore legjislative që trajton këtë çështje. Ai detyron subjektet të mbajnë të dhëna të sakta dhe të përditësuara të pronarëve të tyre përfutues. Megjithatë Kosova nuk ka krijuar një regjistër qendror të pronësisë përfutuese. Koncepti si i tillë nuk ekziston në asnjë ligj, përveç në ligjin për Bankën Qendrore kur përcaktohen kriteret e pronarit përfutues për kreditorët.⁴⁴ Në këtë pikë, ka pasur iniciativa nga organizatat ndërkombëtare për të krijuar një hapësirë njohurish për përcaktimin e pronarëve përfutues dhe angazhimeve ligjore.⁴⁵

**INDIKATORI 14.2.2
TRANSPARENCA
(NË PRAKTIKË)**

25/100



Ndërsa bizneset publikojnë pjesërisht informacione të rëndësishme për aktivitetet e tyre, ai informacion shpesh është i vjetëruar. Si i tillë, niveli i transparencës është i kufizuar në informatat në regjistrin e ARBK-së.

Të dhënat lidhur me kompanitë e regjistruara në vend janë të qasshme në faqen zyrtare të ARBK-së, ku përfshihen emrat e menaxherëve dhe të dhëna të tjera kontaktuese.⁴⁶ Megjithatë, këto të dhëna nuk përditësohen rregullisht dhe shpesh janë të pasakta. Auditimet dhe raportimi financiar zbatohen nga shoqëritë e ndihmës financiare që janë të licencuara nga Ministria e Financave për të kryer auditime dhe raportime financiare të kompanive të tjera.⁴⁷

Të dhënat lidhur me auditimin e pasqyrave financiare mund të gjenden vetëm në ueb faqen e Këshillit për Raportim Fi-



nanciar, i cili funksionon në kuadër të MIT-së. Ky Këshill është edhe palë e tretë për verifikimin e të dhënave financiare nga bizneset. Megjithatë, ka pasur një zbrazëti të madhe në këtë shpalosje, me më pak se 1 për qind të totalit të kompanive të regjistruara që i kanë dorëzuar raportet e tyre Këshillit në vitin 2022 (shih 14.2.4).⁴⁸

Korporatat, përveç të dhënave financiare të deklaruara çdo vit, nuk paraqesin të dhëna të tjera lidhur me qëndrueshmërinë e tyre.⁴⁹

Bizneset kanë pak nisma që shpalosin luftën kundër korrupsionit për shkak të mungesës së vetëdijesimit nga ana e bizneseve për luftën kundër korrupsionit.⁵⁰

Në përgjithësi, të dhënat për strukturat e pronësisë së biznesit janë të qasshme për publikun. Identifikimi i pronarëve të vërtetë të bizneseve, veçanërisht në biznese si shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar dhe korporatat, mbetet problem.⁵¹ Nuk ka të dhëna në lidhje me pronësinë përfutuese. Të dhënat e vetme janë për drejtuesit e kompanive që gjenden në regjistrat e ARBK-së, Doganës, si dhe Administratës Tatimore të Kosovës.

**INDIKATORI 14.2.3
LLOGARIDHËNIA
(SIPAS LIGJIT)**

75/100



Ekzistojnë dispozitat ligjore për mbikëqyrjen e duhur të qeverisjes biznesore, duke përfshirë rregullat se si duhet të qeverisen kompanitë, formimi i kompanive, rolet e bordit, menaxhmenti dhe pronarët, falimentimi dhe shpërbërja. Megjithatë, problemi mbetet se Kosova nuk ka ndonjë rregullim të tregut të aksioneve.

Ligji për shoqëritë tregtare specifikon formën dhe funksionimin e korporatave dhe shoqërive aksionare. Kjo rregullore në versionin e fundit të miratuar së fundi është harmonizuar me direktivat e BE-së dhe ka trajtuar më tej problemet që


lidhen me funksionimin.⁵² Kodi i Qeverisjes së Korporatave përcakton standardet e funksionimit të korporatave.⁵³ Ligji për shoqëritë tregtare përshkruan të gjitha kompetencat e bordit të drejtorëve kundrejt aksionarëve, duke përfshirë miratimin e planeve strategjike, thirrjen e asambleve dhe angazhimin e auditorëve.⁵⁴ Bazuar në Ligjin për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, të gjitha bizneset me më shumë se 50 punonjës janë të detyruar të kenë një zyrtar sinjalizues i cili pranon sinjalizimin e brendshëm.⁵⁵

Rregullatori i vetëm financiar që mbikëqyr sektorin e biznesit nën Ministrinë e Financave dhe Transfereve është Këshilli i Kosovës për Raportim Financiar. Ky Këshill miraton dhe verifikon të gjitha pasqyrat financiare të shoqërive tregtare.⁵⁶ Stafi i këtij Këshilli përbëhet nga dhjetë anëtarë, me buxhet të përgjithshëm vjetor prej 135,550€; prej të cilave 113,260€ ndahen për paga.⁵⁷

Nuk ka asnjë organ të veçantë që mbikëqyr tregun e aksioneve. Banka Qendrore e Kosovës është institucioni i vetëm në Kosovë që emeton letra me vlerë si instrumente financiare dhe mbikëqyr tregun financiar në vend.⁵⁸ Megjithatë, pas themelimit të Fondit Sovran të Kosovës, pritet që të krijohet një bursë për hapjen e tregut të aksioneve.⁵⁹

**INDIKATORI 14.2.4
LLOGARIDHËNIA (NË PRAKTIKË)**

50/100



Në përgjithësi, investitorët dhe bordet janë vetëm pjesërisht efektivë në sigurimin e mbikëqyrjes së vendimeve të menaxhimit të bizneseve/korporatave. Shkeljet e rregullave të mbikëqyrjes nga menaxhmenti i biznesit/korporatës nuk janë të rralla.

Në praktikë, qeverisja efektive e biznesit/korporatës konsiderohet problematike. Sipas drejtorit ekzekutiv të Institutit Riinvest, organet udhëheqëse si bordet mbikëqyrëse të





kompanive janë stabile në emërimin e tyre dhe në kryerjen e funksioneve të tyre. Megjithatë, ka një mospërputhje në marrëdhëniet ndërmjet menaxherëve, drejtorëve dhe aksionarëve, veçanërisht në ndarjen proporcionale të detyrave dhe hapësirës si dhe llogaridhënien në këto detyra. Shpesh ka edhe mungesë llogaridhënieje në ndarjen e detyrave menaxheriale në nivel të lartë.⁶⁰ 319 kompani kanë dorëzuar raporte financiare në Këshillin Kosovar për Raportim Financiar gjatë vitit 2022, numër pothuajse i njëjtë me të njëjtën periudhë të viteve të kaluara. Kjo përbën më pak se 1 për qind të totalit të kompanive të regjistruara.⁶¹

Nuk ka asnjë mekanizëm shtesë që inkurajon kompanitë të zbulojnë informacione kundër korrupsionit. Bizneset theksojnë se janë angazhuar në dhënien e informacionit për luftën kundër korrupsionit, por rezultatet ende mungojnë.⁶² Gjatë vitit 2022 janë regjistruar gjithsej 11,024⁶³ kompani të reja.

**INDIKATORI 14.2.5
MEKANIZMAT E
INTEGRITETIT (SIPAS LIGJIT)**

25/100



Ndërsa ekzistojnë një sërë rregulloresh, ato nuk mbulojnë të gjitha aspektet që lidhen me integritetin e akterëve të biznesit dhe disa dispozita përmbajnë zbrazëtira. Në nivel sektori mungojnë kodet etike dhe kodet kundër korrupsionit.

Në parim, legjislacioni në Kosovë nuk i obligon bizneset që të kenë kode të sjelljes. Në hulumtimin e publikuar nga Riinvest, 62 për qind e bizneseve të anketuara kanë deklaruar se kanë një Kod të Etikës të cilit punëtorët duhet t'i përmbahen. Ndërkohë, 27 për qind e bizneseve kanë treguar se kanë një rregullore që ndalon punonjësit e biznesit të japin ryshfet.⁶⁴

Nuk ka një kod të detyrueshëm kundër korrupsionit në të gjithë sektorin. Një numër biznesesh kanë nënshkruar një Kod vullnetar Kundër Korrupsionit, ku zotohen të luftojnë korrupsionin sipas një nisme të re të udhëhequr nga odat

ekonomike.⁶⁵ Ky Kod është nënshkruar nga gjashtë shoqata biznesi dhe biznese. Ai përcakton normat dhe aktivitetet dhe nxit motivimin e subjekteve ekonomike për të përvetësuar dhe zbatuar standardet më të mira ndërkombëtare për luftimin dhe parandalimin e korrupsionit⁶⁶

Legjislacioni në Kosovë nuk parasheh që ofertuesit e kontratave publike të kenë programe etike; ekziston vetëm një "Deklaratë nën betim" që ofertuesit duhet të nënshkruajnë për të deklaruar mospërfshirjen në korrupsion.⁶⁷ Një nismë e tillë pritet të përfshihet në projektligjin e ri për prokurimin publik.

Ekziston një legjislacion efektiv që sanksionon plotësisht ryshfetin, duke përfshirë edhe sektorin privat. Kodi Penal i Kosovës përcakton përgjegjësinë penale për personat fizikë dhe juridikë, duke përfshirë bizneset dhe korporatat.⁶⁸ Në parim, korporatat kanë një kod qeverisjeje i cili si dokument ka vendosur konceptet dhe praktikatat kryesore të qeverisjes së korporatave që rrjedhin nga Ligji për Shoqëritë Tregtare.⁶⁹ Për më tepër, korporatat kanë gjithashtu kode individuale unike, veçanërisht institucionet financiare,⁷⁰ të cilat janë të qasshme në faqet e tyre të internetit.

Korporatat e mëdha zakonisht kanë një zyrtar të pajtueshmërisë. Ky lloj obligimi vjen nga rregulloret e Bankës Qendrore të Kosovës.⁷¹

**INDIKATORI 14.2.6
MEKANIZMAT E
INTEGRITETIT (NË PRAKTIKË)**

25/100



Në përgjithësi, ka mungesë të veprimeve të biznesit që synojnë të garantojnë integritetin e sektorit, duke rezultuar në mossanksionim të shkeljeve apo keqpërdorimeve nga brenda.

Kodet e brendshme të bizneseve, duke përfshirë kodet e sjelljes, zbatohen shumë rrallë në praktikë. Sipas drejtorit



ekzekutiv të Institutit Riinvest, bizneset vazhdojnë të kenë problem në krijimin e frymës së performancës së mirë në aspektin e integritetit nga ana e punonjësve të këtyre bizneseve.⁷² Bizneset kanë ngritur shqetësime për mungesën e progresit në çështjet e korrupsionit dhe integritetit në sektorin privat.⁷³

Ryshfeti është një nga format më të përhapura të korrupsionit brenda bizneseve. Në hulumtimin e publikuar nga Oda Ekonomike Amerikane, 62 për qind e të anketuarve besojnë se kjo formë po dëmton frymën e të bërit biznes në vend. Në të njëjtën kohë, kjo po shkakton edhe mungesën e investimeve strategjike nga jashtë.⁷⁴

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka një listë të zezë⁷⁵ të kompanive që nuk i kanë përmbushur më parë detyrimet kontraktuale ndaj shtetit kur janë dhënë kontratat. Megjithatë, pavarësisht se janë në këtë listë, disa kompani vazhdojnë të marrin kontrata nga shteti.⁷⁶ Për shembull, në vitin 2022, Organi Shqyrtues i Prokurimit kishte futur në listën e zezë 16 kompani, duke përfshirë edhe një kompani për shkak të për falsifikimit të dokumenteve, por ajo ishte shpallur sërish fituese e tenderit për furnizimin e Policisë së Kosovës.⁷⁷ Gjithashtu, odat ekonomike kanë krijuar lista të zeza për kompanitë që nuk kanë përmbushur detyrimet kontraktuale dhe janë të përfshira në raste korrupsioni.⁷⁸

Politikat e sinjalizimit nuk zbatohen në mënyrë efektive dhe shumë kompani nuk kanë as informacione për detyrimin për të pasur një zyrtar sinjalizues. Si rezultat, ka pasur pak raste të sinjalizimit në praktikë.⁷⁹ Kompanitë nuk kanë mekanizma specifikë për t'u marrë me rastet e ryshfetit; kryesisht çështjet zgjidhen brenda menaxhmentit dhe shpeshherë përfundojnë pa u trajtuar në gjykatë.⁸⁰ Nuk ka pakte integriteti ndërmjet kompanive dhe gjithashtu mungon trajnimi për punonjësit e sektorit privat për çështjet e integritetit.⁸¹

Legjislacioni në Kosovë duket se zbatohet në mënyrë efektive në rastet e ryshfetit nga jashtë, ku rasti më i spikatur është rasti i ashtuquajtur "Stenta 3", ku disa shtetas të huaj janë akuzuar për ryshfet. Ky rast nuk ka ende një përfundim edhe pse aktakuza është ngritur në vitin 2021 kundër disa mjekëve dhe drejtorëve të spitaleve për ryshfet, "trajtim të pandërgjegjshëm mjekësor", "ushtrim të jashtëligjshëm të veprimtarisë mjekësore dhe farmaceutike" dhe "shmangie nga taksat". Në mesin e këtyre personave ka shtetas maqedonas dhe turq.⁸²

**INDIKATORI 14.2.7
PËRFAQËSIMI GJINOR**

25/100



Qeveria publikon vetëm të dhëna të kufizuara gjinore. Të dhënat që publikohen tregojnë për një disbalancë të theksuar ndërmjet pranisë së grave dhe burrave në pozitat drejtuese të bordeve të kompanive/korporatave në sektorin e biznesit.

Në përgjithësi, ka mbështetje për gratë në fushën e biznesit, konkretisht në krijimin e bizneseve të vogla.⁸³ Megjithatë, pjesëmarrja e grave në sektorin e biznesit është ende e ulët.⁸⁴ Edhe pse gratë përfaqësojnë gjysmën e popullsisë së Kosovës, angazhimi i tyre në aktivitetin ekonomik mbetet i ulët në krahasim me burrat.⁸⁵ Me gratë që përfaqësojnë vetëm 11.42 për qind të ndërmarrësve, Kosova përballet me një nga normat më të ulëta të grave ndërmarrëse në mbarë botën.⁸⁶ Përfaqësimi i grave në shoqatat e biznesit apo odat ekonomike është gjithashtu i ulët.⁸⁷ Megjithatë, ekziston një odë e grave për ekonomi e quajtur Oda Ekonomike e Grave të Kosovës e cila funksionon si organizatë joqeveritare.⁸⁸

Vlerësohet se bordet e korporatave dhe ndërmarrjeve të tjera udhëhiqen kryesisht nga burra.⁸⁹ Të dhënat e publikuara nga qeveria tregojnë një çekuilibrë në shkallën e përfaqësimit të grave. Sipas të dhënave të ARBK-së, në tre muajt e fundit të vitit 2022, nga 2,641 biznese të regjistruara, 19 për qind janë udhëhequr nga gra që janë në ortakëri apo aksionare.⁹⁰





Roli



**INDIKATORI 14.3.1
ANGAZHIMI NË POLITIKAT
KUNDËR KORRUPSIONIT**

25/100



Çështja e anti-korrupsionit pothuajse mungon në agjendën e angazhimit të sektorit të biznesit me qeverinë, pavarësisht se është një nga sektorët më të prekur nga korrupsioni.⁹¹ Edhe bizneset kanë pak angazhim në luftën kundër korrupsionit.

Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë ka kryer disa lloje të hulumtimeve në lidhje me korrupsionin në mesin e bizneseve.⁹² Ka disa iniciativa, kryesisht nga Oda Ekonomike Amerikane dhe Oda Ekonomike e Kosovës, për të mbështetur luftën kundër korrupsionit, por ato kryhen kryesisht në periudha specifike, si gjatë javës kundër korrupsionit, e jo vazhdimisht gjatë gjithë vitit.⁹³

Sipas kryetarit të Aleancës Kosovare të Bizneseve, çështjet që lidhen me luftën kundër korrupsionit dhe planifikimin e strategjive të mundshme përfshihen deri diku në agjendat e takimeve të shoqatave të mëdha të biznesit dhe odave ekonomike në takimet me qeverinë.⁹⁴

Pesë kompani lokale janë anëtare të UN Global Compact.⁹⁵ Edhe pse kanë qenë anëtarë prej disa vitesh, katër nga këto kompani janë përjashtuar nga nisma për shkak të dështimit për të treguar progres.⁹⁶



**INDIKATORI 14.3.2
MBËSHTETJA/ANGAZHIMI
ME SHOQËRINË CIVILE**

0/100



Në përgjithësi, sektori i biznesit nuk angazhohet dhe nuk ofron mbështetje për shoqërinë civile në detyrën e saj për të luftuar korrupsionin.

Sipas Drejtorit Ekzekutiv në Institutin Riinvest, bizneset hezitojnë të mbështesin aktivitetet e OSHC-ve kundër korrupsionit financiarisht.⁹⁷

Me sa mund të konstatohet, sektori i biznesit nuk bashkëpunon apo angazhohet në ndonjë program specifik me shoqërinë civile dhe nuk ofron mbështetje për luftën kundër korrupsionit. Gjithashtu, ky sektor nuk ka zhvilluar asnjë projekt në këtë drejtim dhe këto janë realizuar vetëm nga shoqëria civile.



Ndërveprimet

Bizneset ndërveprojnë kryesisht me Qeverinë, Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit dhe partitë politike, kryesisht në një kapacitet reagues ose në përgjigje të detyrimeve ligjore. Për shembull, bizneset punojnë ngushtë me MINT-in për të regjistruar operacionet e biznesit.⁹⁸ Ato veprojnë edhe si ofertuesit kryesorë për kontratat publike në vend, të cilat i shpallin institucionet publike.⁹⁹ Nga ana tjetër, bizneset janë financuesit kryesorë të partive politike, veçanërisht në fushatat elektorale (shih 11.3.1).¹⁰⁰ Gjatë zgjedhjeve të fundit u identifikuan 68 biznese që potencialisht mund të kenë financuar partitë politike.¹⁰¹ Kjo krijon ndikimin potencial të panevojshëm të interesave të biznesit në politikë.

Ekziston mungesë e theksuar e bashkëpunimit ndërmjet bizneseve dhe shtyllave të tjera në luftimin e korrupsionit, si prokuroria dhe gjyqësori. Ekziston gjithashtu mungesë e theksuar e bashkëpunimit ndërmjet bizneseve dhe shoqërisë civile.

Rekomandimet e shtyllës

- Bizneset duhet të krijojnë kode të brendshme të integritetit dhe të sigurojnë zbatimin e tyre.
- Shoqatat e biznesit duhet të ofrojnë mbështetje financiare për OSHC-të në luftën kundër korrupsionit dhe organizojnë ngjarje për të diskutuar sfidat kundër korrupsionit në sektorin e tyre dhe si t'i trajtojnë ato.
- Qeveria duhet të krijojë rregullore për publikimin e të dhënave në lidhje me pronësinë përfituese të kompanive, veçanërisht në bazën e të dhënave të prokurimit elektronik dhe dosjet e tenderëve.
- Agjencia Kundër Korrupsionit duhet të kontrollojë dhe të ofrojë statistika nëse bizneset me mbi 50 të punësuar zbatojnë ligjin për sinjalizuesit dhe nëse kanë një zyrtar sinjalizues. Inspektorati i Punës duhet të krijojë një mekanizëm për sinjalizimin e zbatueshëm për bizneset më të vogla.





REFERENCAT

- 1 Ligji për Tregtinë e Brendshme, neni 1.
- 2 Ligji për Shoqëritë Tregtare, neni 1.
- 3 Ligji për Falimentim, neni 1.
- 4 Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës, neni 1.
- 5 Ligji për Investime të Huaja, neni 1.
- 6 Ligji për Investime Strategjike, neni 1.
- 7 Ligji për Markat tregtare, neni 1. Ky ligj është pjesërisht në përputhje me Direktivën (EU) 2015/2436 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 16 dhjetor 2015 për përafrimin e ligjeve të shteteve anëtare në lidhje me markat tregtare dhe me Direktivën 2004/48/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 29 prillit 2004 mbi Zbatimin e të Drejtave të Pronësisë Intelektuale.
- 8 Ligji për Gjykatën Komerciale, neni 1. Gjykata Komerciale e Kosovës gjykon të gjitha kontestet tregtare dhe konfliktet administrative, të përcaktuara me ligj, dhe vepron si gjykatë e shkallës së parë dhe gjykatë e shkallës së dytë.
- 9 Agjencia e Regjistrimit të Biznesit, Regjistrimi i Biznesit të Ri <https://arbk.rks-gov.net/Page.aspx?id=1.33> <https://arbk.rks-gov.net/page.aspx?id=2.33> [qasur më 10 shkurt 2023] Për të filluar regjistrimin, një aplikant duhet të plotësojë formularin e aplikimit. Pas plotësimit të formularit të aplikimit, parashtruesi i kërkesës (ose personi i autorizuar për regjistrim) e dorëzon formularin e aplikimit personalisht, në çdo qendër shërbimi të ARBK-së, së bashku me dokumentet e tjera të nevojshme. Zyrtari për pranim verifikon që aplikacioni dhe dokumentet shoqëruese janë të plota dhe të pranueshme për Agjencinë Kosovare për Regjistrimin e Bizneseve (ARBK). Kur një formular aplikimi i plotësuar pranohet, ai duhet të nënshkruhet nga aplikanti ose përfaqësuesi i autorizuar. Taksa për regjistrimin e biznesit fillestar nuk paguhet.
- 10 Agjencia Kosovare për Regjistrimin e Bizneseve, Regjistrimi i Bizneseve të Reja, <https://arbk.rks-gov.net/Page.aspx?id=1.33> <https://arbk.rks-gov.net/page.aspx?id=2.33> [qasur më 10 shkurt 2023]
- 11 Ligji për pronën dhe të drejtat e tjera sendore, neni 1. Ky është ligji për të drejtat e autorit që në bazë të pronësisë intelektuale u takojnë autorëve në lidhje me veprat e tyre.
- 12 Ligji për pronën dhe të drejtat e tjera sendore, neni 191,192,193,194,195. Kodi Penal, nenet 278 - 311.
- 13 Ligji për Administratën Tatimore dhe Procedurat, neni 78. Ekziston një Bord i Pavarur Shqyrtues që merrret me ankesat e tatimpaguesve. I cili funksionon si organ i pavarur me anëtarë të propozuar nga qeveria.
- 14 Ligji për Marrëdhëniet Detyrimore, neni 1.
- 15 Ligji për Partneritet Publik-Privat, neni 1. Direktiva e BE-së për prokurimin parashë PPP-të dhe investimet strategjike ose koncesionet si pjesë e prokurimit dhe këto blerje ose prokurime rregullohen nga Direktiva e Shërbimeve. Në Kosovë, këto tri lloje të kontratave publike (prokurimi publik, PPP dhe koncesionet) janë të ndara. Ligji për Prokurimin Publik trajton vetëm prokurimet, ndërsa Ligji për PPP parashë investime strategjike në fushën e shërbimeve komunale. Asnjë ligj nuk trajton se cilat rregulla duhet të ndiqen nga ndërmarrjet publike që blejnë p.sh. energjinë elektrike apo shërbime të tjera gjatë këtyre procedurave, apo cilat rregulla duhet të ndiqen. Ligji për PPP trajton fushat dhe kërkesat për investime, por jo për blerjet siç parashihet me Direktivën e Shërbimeve Komunale, ndërsa blerjet kategorizohen si investime strategjike në nivel qendror që nuk rregullohen me ligj, por me akt nënligjor si lloj grantesh strategjike, dhe nuk kanë dispozita të kontabilitetit dhe transparencës për investime apo financime.
- 16 Agjencia Kosovare për Regjistrimin e Bizneseve, Regjistrimi i Bizneseve të Reja, <https://arbk.rks-gov.net/Page.aspx?id=1.33> <https://arbk.rks-gov.net/page.aspx?id=2.33> [qasur më 10 shkurt 2023]
- 17 Agjencia Kosovare për Regjistrimin e Bizneseve, Regjistrimi i Bizneseve të Reja <https://arbk.rks-gov.net/Page.aspx?id=1.33> <https://arbk.rks-gov.net/page.aspx?id=2.33> [qasur më 10 shkurt 2023]
- 18 Intervistë me Alban Hashani, Drejtor Ekzekutiv në Institutin Riinvest, shkurt 2023.
- 19 Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, <https://mf.rks-gov.net/page.aspx?id=1.2.738> [qasur më 8 shkurt 2023]
- 20 Gjykata Komerciale, 30 janar 2023, <https://www.facebook.com/gjykatakomerciale/posts/pfbid0Wspn2dZdRZAKLi4dQhKQk9zGgWJkTxAzknQ-4Qui3ePbDuAxs3g2SvkvNrDmuYPI> [qasur më 8 shkurt 2023]
- 21 Intervistë me Alban Hashani, Drejtor Ekzekutiv në Institutin Riinvest, shkurt 2023.
- 22 Insajderi, 20 tetor 2022, <https://insajderi.org/emrush-thaci-qe-hodhi-akuza-kunder-vedat-bajramit-ishte-arrestuar-me-2013-dysoheje-per-mashtrim/> [qasur më 9 shkurt 2023]
- 23 Dukagjini, 3 gusht 2023, <https://www.dukagjini.com/cka-ofron-super-puna-dhe-praktika-ne-qeveri/> [qasur më 9 shkurt 2023]
- 24 Ligji për Shoqëritë Tregtare, Kapitulli 2, neni 9.
- 25 Agjencia e Regjistrimit të Biznesit, Qendrat Komunale, <https://arbk.rks-gov.net/page.aspx?id=1.14> [qasur më 27 janar 2023]
- 26 Ligji për Shoqëritë Tregtare, neni 47.
- 27 Ligji për Shoqëritë Tregtare, neni 47, pika 1.
- 28 Ligji për Shoqëritë Tregtare, neni 47, pika 2.
- 29 Ligji për Shoqëritë Tregtare, neni 47, pika 3.
- 30 Ligji për Shoqëritë Tregtare
- 31 Kallxo.Com, 11 janar 2022 <https://kallxo.com/lajm/arrestohet-zyrtari-i-ministrise-dyshohet-se-kerkoi-dhe-pranoi-ryshfet-nga-bizneset-apli-kuese-per-subvencione/> [qasur më 27 janar 2023]
- 32 Institutit Riinvest, "Perspektiva e Biznesit e Korrupsionit në anën e ofertës" (Prishtinë: Institutit Riinvest, 2019), faqe 35.
- 33 Intervistë me Alban Hashani, Drejtor Ekzekutiv në Institutin Riinvest, shkurt 2023.



- 34 Radio Evropa e Lirë, 1 shkurt 2023 <https://www.evropaelire.org/a/sektori-privat-i-diskriminuar-nga-shteti-pa-ndihme/32245797.html> [qasur më 6 shkurt 2023]
- 35 Radio Evropa e Lirë, 1 shkurt 2023 <https://www.evropaelire.org/a/sektori-privat-i-diskriminuar-nga-shteti-pa-ndihme/32245797.html> [qasur më 6 shkurt 2023]
- 36 Ligji për Shoqëritë Tregtare, neni 47.
- 37 Intervistë me Alban Hashani, Drejtor Ekzekutiv në Institutin Riinvest, shkurt 2023.
- 38 Ligji për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, neni 1.
- 39 Ligji për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, Kapitulli 2.
- 40 Ligji për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, neni 10.
- 41 Ligji për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, neni 10, pika 2.
- 42 Ligji për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, neni 18.
- 43 Ligji për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, neni 3.
- 44 Udhëzime për identifikimin e pronarëve përfitues, neni 1
- 45 UNDP, "Kuptimi i Pronësisë Përfituese dhe Marrëveshjet Ligjore për Luftimin e Pastrimit të Parave", (Prishtinë: gusht 2021), faqe 6.
- 46 Agjencia Kosovare për Regjistrimin e Bizneseve, Regjistrimi i Bizneseve të Reja, <https://arbk.rks-gov.net/Page.aspx?id=1.33> <https://arbk.rks-gov.net/page.aspx?id=2.33> [qasur më 10 shkurt 2023]
- 47 Intervistë me Alban Hashani, Drejtor Ekzekutiv në Institutin Riinvest, shkurt 2023.
- 48 Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Divizioni i Këshillit Kosovar për Raportim Financiar, <https://mf.rks-gov.net/page.aspx?id=2.91> [qasur më 9 shkurt 2023]
- 49 Intervistë me Alban Hashani, Drejtor Ekzekutiv në Institutin Riinvest, shkurt 2023.
- 50 Institutit Riinvest, "Perspektiva e Biznesit e Korrupsionit në anën e ofertës" (Prishtinë: Institutit Riinvest, 2019), faqe 22.
- 51 Intervistë me Alban Hashani, Drejtor Ekzekutiv në Institutin Riinvest, shkurt 2023.
- 52 Ligji për Shoqëritë Tregtare, pjesa 3.
- 53 Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Kodi i Qeverisjes së Korporatave.
- 54 Ligji për Shoqëritë Tregtare, pjesa 6, neni 162.
- 55 Ligji për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, neni 17.
- 56 Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Divizioni i Këshillit Kosovar për Raportim Financiar, <https://mf.rks-gov.net/page.aspx?id=2.91> [qasur më 9 shkurt 2023]
- 57 Ligji për ndarjet buxhetore për buxhetin e vitit 2023, faqe 6.
- 58 Ligji për Banka Qendrore, neni 22.
- 59 Intervistë me një ekspert të ekonomisë, shkurt 2023.
- 60 Intervistë me Alban Hashani, Drejtor Ekzekutiv në Institutin Riinvest, shkurt 2023.
- 61 Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Divizioni i Këshillit Kosovar për Raportim Financiar, Pasqyrat Financiare të Raportuara – 2022, <https://mf.rks-gov.net/page.aspx?id=1.209> [qasur më 9 shkurt 2023]
- 62 Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë, "Studimi i Perceptimit të Korrupsionit 2021" (Prishtinë: OEAK, 2021), faqe 10.
- 63 Agjencia e Statistikave të Kosovës <https://ask.rks-gov.net/media/7478/repertori-statistikor-mbi-nd%C3%ABrmarrjet-ekonomike-n%C3%AB-kosov%C3%AB-tm1-2023.pdf> faqe 8.
- 64 Institutit Riinvest, "Perspektiva e Biznesit e Korrupsionit në anën e ofertës" (Prishtinë: Institutit Riinvest, 2019), faqe 35.
- 65 Kosoalive, 6 nëntor 2019, <https://kosoalive.net/bizneset-nenshkruajne-kodin-kunder-korrupsionit-zotohen-per-luftimin-e-kesaj-dukurie/> [qasur më 7 shkurt 2023]
- 66 Institutit Riinvest, "Kodi i Biznesit Kundër Korrupsionit" (Prishtinë: Institutit Riinvest, 2019), faqe 4. Nëpërmjet këtij Kodi, nënshkruesit e tij zotohen se do të zbatojnë standardet më të avancuara të etikës, transparencës dhe integritetit në aktivitetet e tyre të biznesit, të cilat do të shmangin me vendosmëri çdo formë përfshirjeje në rastet e korrupsionit, ofrimit të dhuratave apo favoreve ndaj të tjerëve, ndaj zyrtarëve publikë ose personave të tjerë zyrtarë ose privatë me qëllim sigurimin e privilegjeve ose përfitimeve të jashtëligjshme në favor të shoqërisë.
- 67 E-Prokurimi, Deklarata nën Betim.
- 68 Kodi Penal i Republikës së Kosovës, nenet 309 dhe 310. Cilido që punon në këtë sektor, i cili kërkon, pranon ose jep ryshfet në formë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që përfshin dhurata të pamerituara, shpërdorim të pozitës ose premtime nga dikush ose pranimin e një oferte ose premtimi për një dhuratë ose shpërbllim të tillë, dënohet me gjobë dhe burgim nga gjashtë muaj deri në pesë vjet.
- 69 Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Kodi i Qeverisjes së Korporatave.
- 70 Banka për Biznes, Kodi i Etikës.
- 71 Banka Qendrore e Kosovës, Rregullorja për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, neni 3.
- 72 Intervistë me Alban Hashani, Drejtor Ekzekutiv në Institutin Riinvest, shkurt 2023.
- 73 Zëri i Amerikës, 9 dhjetor 2019, <https://www.zeriamerikes.com/a/kosovo-corruption/5198425.html> [qasur më 2 shkurt 2023]
- 74 Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë, "Studimi i Perceptimit të Korrupsionit 2021" (Prishtinë: OEAK, 2021), faqe 13.
- 75 Lista e zezë është një proces që i ndalon kompanitë të marrin pjesë në tenderë kur konstatohet se ato janë përfshirë në keqpërdorime ose abuzime gjatë procesit të tenderimit.
- 76 Kallxo.com, 13 mars 2022, <https://kallxo.com/gjate/hulumtim-si-i-fitoi-5-tendere-nga-unops-kompania-ne-liste-te-zeze-te-oshp-se/> [qasur më 1 shkurt 2023]
- 77 IndeksOnline, nëntor 2022, <https://indeksonline.net/16-kompani-ne-listen-e-zeze-te-oshp-se-tre-kompani-tantuan-ta-mashtrojne-policine-1236/> [qasur më 21 tetor 2023]



|||||

- 78 Intervistë me Agim Shahinin, President i Aleancës së Bizneseve Kosovare, shkurt 2023.
- 79 Lëvizja FOL, 19 mars 2021, <https://levizjafol.org/ligji-per-mbrojtjen-e-sinjalizuesve-ligj-per-te-cilin-shume-pak-dihet-ne-sektorin-privat/> [qasur më 2 shkurt 2023]
- 80 Intervistë me Alban Hashani, Drejtor Ekzekutiv në Institutin Riinvest, shkurt 2023.
- 81 Intervistë me Alban Hashani, Drejtor Ekzekutiv në Institutin Riinvest, shkurt 2023.
- 82 "Betimi për Drejtësi", 8 tetor 2021 https://betimiperdrejtesi.com/ne-nentor-prietet-nis-gjykimi-ndaj-drejtoresve-te-spitaleve-private-ne-rastin-stenta-3/?fbclid=IwAR3Rd41KRBanvwHwK79OnwIj1a-81CWjP_Z-Mo19fQ_j6BllCyRHLt2kLf4 [qasur më 2 shkurt 2023]
- 83 Koha.net, 8 mars 2021 <https://www.koha.net/arberi/261543/grate-qe-udheheqin-biznese-te-vogla-perfitojne-nga-programi-i-rimekembjes/> [qasur më 29 maj 2023]
- 84 Institut Riinvest, "Ndërmarrja e Grave, Analiza e të Bërit Biznes në Kosovë" (Prishtinë: Institut Riinvest, 2017), faqe 35.
- 85 Institut Riinvest, "Ndërmarrja e Grave, Analiza e të Bërit Biznes në Kosovë" (Prishtinë: Institut Riinvest, 2017), faqe 9.
- 86 Sbunker, 1 tetor 2021 <https://sbunker.net/op-ed/91117/grate-si-ndermarrese/> [qasur më 1 shkurt 2023]
- 87 Intervistë me Agim Shahinin, President i Aleancës së Bizneseve Kosovare, shkurt 2023.
- 88 Oda Ekonomike e Grave të Kosovës – G7, <https://www.facebook.com/profile.php?id=100064336075753> [qasur më 1 shkurt 2023]
- 89 Kallxo.com, 15 nëntor 2021 <https://kallxo.com/lajm/bordet-e-ndermarrjeve-publike-te-rezervuara-per-burra/> [qasur më 3 shkurt 2023]
- 90 Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve, "Raporti i Treguesve Bazë të Performancës për Regjistrimin e Shoqërive Tregtare në Kosovë për periudhën: tetor - dhjetor 2022" (Prishtinë: ARBK, 2022), faqe 9.
- 91 Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë, "Studimi i Perceptimit të Korrupsionit 2021" (Prishtinë: OEAK, 2021), faqe 9.
- 92 Kallxo.com, 9 dhjetor 2019 <https://kallxo.com/lajm/oda-ekonomike-amerikane-72-e-bizneseve-e-shohin-korrupsionin-si-ceshtje-kritike/> [qasur më 3 shkurt 2023]
- 93 Ekonomia Online, 8 dhjetor 2022, <https://www.ekonomia-ks.com/sq/ekonomi/oda-amerikane-therret-per-perpjekje-gjitheperfshirese-per-ccrenjosjen-e-korrupsionit> [qasur më 10 shkurt 2023]
- 94 Intervistë me Agim Shahinin, President i Aleancës së Bizneseve Kosovare, shkurt 2023.
- 95 Pakti Global i Kombeve të Bashkuara, [https://www.unglobalcompact.org/search?keywords=kosovo&page=1&search\[document_type\]=Pjesemarrës](https://www.unglobalcompact.org/search?keywords=kosovo&page=1&search[document_type]=Pjesemarrës) [qasur më 9 shkurt 2023]
- 96 Pakti Global i Kombeve të Bashkuara, pjesëmarrës, <https://www.unglobalcompact.org/what-is-gc/participants/994> [qasur më 9 shkurt 2023]
- 97 Intervistë me Alban Hashani, Drejtor Ekzekutiv në Institutin Riinvest, shkurt 2023.
- 98 Agjencia Kosovare për Regjistrimin e Bizneseve, Regjistrimi i Bizneseve të Reja, <https://arbk.rks-gov.net/Page.aspx?id=1,33> <https://arbk.rks-gov.net/page.aspx?id=2,33> [qasur më 10 shkurt 2023]
- 99 Ligji për Prokurimi publikë, neni 1.
- 100 Radio Evropa e Lirë, 8 nëntor 2020, <https://www.evropaelire.org/a/30930142.html> [qasur më 10 shkurt 2023]
- 101 Kallxo.com, dhjetor 2020, <https://kallxo.com/lajm/kozhani-shumica-e-bizneseve-te-identifikuara-qe-financojne-partite-politike-jane-ndeshkuar-nga-atk/> [qasur më 22 tetor 2023]



|||||

NDËRMARRJET PUBLIKE

> |> > >< <><> ><> > ><>

PËRMBLEDHJE

Ndërmarrjet publike (NP-të) në Republikën e Kosovës ndahen në ndërmarrje publike qendrore dhe lokale. Këto ndërmarrje funksionojnë në bazë të Ligjit për Ndërmarrjet Publike dhe Ligjit për Shoqëritë Tregtare.¹



Kapacitetet

50

Pavarësia (sipas ligjit)

75

Pavarësia (në praktikë)

25

Qeverisja

50

Transparenca (sipas ligjit)

75

Transparenca (në praktikë)

25

Llogaridhënia (sipas ligjit)

75

Llogaridhënia (në praktikë)

25

Mekanizmat e integritetit (sipas ligjit)

75

Mekanizmat e integritetit (në praktikë)

25



Qeveria e Kosovës ose komunat kanë pronësinë e plotë të shumicës, ose një pakicë të konsiderueshme, të aksioneve në ndërmarrjet publike qendrore apo lokale.

Në Kosovë operojnë gjithsej 72 ndërmarrje publike, nga të cilat 52 janë ndërmarrje publike lokale, 11 ndërmarrje publike kombëtare dhe nëntë ndërmarrje rajonale.² Ligji për Ndërmarrjet Publike gjithashtu liston të gjitha ndërmarrjet publike qendrore, ndërmarrjet publike rajonale dhe ndërmarrjet publike lokale.³

Ndërmarrjet publike qendrore përfshijnë 1) Korporatën Energjetike të Kosovës; 2) Postën e Kosovës; 3) Telekomin e Kosovës; 4) TRAINKOS; 5) Ibër-Lepenci; 6) Kompaninë për menaxhimin e mbeturinave; 7) Infrakos; 8) Aeroporti (kontrolli ajror); 9) Trepça sh.a; 10) Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut (KOSTT); dhe 11) Radio Televizioni i Kosovës (RTK).⁴

Ligji për Ndërmarrjet Publike ka dispozita gjithëpërfshirëse për funksionimin e ndërmarrjeve publike, por nuk garanton pavarësinë dhe funksionimin e pavarur të këtyre ndërmarrjeve nga ndërhyrjet politike. Emërimi dhe shkarkimi i anëtarëve të bordit bëhen sipas preferencave të partive politike, gjë që ndikon në performancën e këtyre kompanive. Kjo pasi ligji përcakton që shumica e anëtarëve të bordit të drejtorëve do të emërohen nga Qeveria.⁵

Ekziston një njësi koordinuese – Njësia e Monitorimit dhe Politikave të NP-ve⁶ – por ajo nuk mbikëqyr në mënyrë efektive punën dhe performancën e ndërmarrjeve publike. Kjo për shkak se nuk ka staf të mjaftueshëm për të monitoruar siç duhet ndërmarrjet publike. Aktualisht nuk ka monitorim të duhur të ndërmarrjeve publike.⁷ Njësia nuk ka publikuar raporte të performancës në lidhje me ndërmarrjet publike që nga viti 2021.⁸ Që nga viti 2014 nuk ka asnjë përditësim të publikuar për aktivitetet e këtij institucioni.⁹ Gjithashtu, nuk ka raporte se si zbatohen kodet e qeverisjes, as nuk ka dëshmi të ndonjë memorandumit apo planit të përbashkët të integritetit.¹⁰

Ndërmarrjet publike auditohen në dy mënyra: me auditim të përgjithshëm, të kryer nga Zyra Kombëtare e Auditimit dhe me auditim të brendshëm. Megjithatë, auditorët e brendshëm nuk janë shumë efektivë. Raportet e tyre shpesh nuk janë të plota dhe nuk kanë informacion të detajuar.



Kapacitetet



**INDIKATORI 15.1.1
PAVARËSIA (SIPAS LIGJIT)**

75/100



Ekzistojnë disa ligje dhe dispozita që ofrojnë kornizën ligjore për pronësinë dhe qeverisjen e ndërmarrjeve publike në Kosovë.¹¹ Megjithatë, legjislacioni ka zbrazëtira të vogla sa i përket ndalimit që anëtarët e partive të jenë anëtarë të bordeve (gjë që paraqet problem në praktikë).¹²

Sipas legjislacionit në Kosovë, të gjitha ndërmarrjet publike janë të organizuara si shoqëri aksionare në bazë të Ligjit për Shoqëritë Tregtare. Këto shoqëri aksionare janë në pronësi të Qeverisë së Kosovës, e cila ushtron të drejtën e aksionerit përmes bordeve të zgjedhura.¹³

Detyrimet dhe përgjegjësitë e NP-së sa i përket shërbimit publik janë të përcaktuara qartë me ligje dhe rregullore. NP-ja është e detyruar të hartojë një plan biznesi për vitin pasardhës, i cili përfshin detyrimet e saj ndaj konsumatorëve dhe publikut.¹⁴ NP-ja duhet të testojë rregullisht kënaqshmërinë e klientit me shërbimet e ofruara.¹⁵

Ndërmarrjet publike nuk janë të përjashtuara nga asnjë ligj ose rregullore e përgjithshme që zbatohet për kompanitë e sektorit privat.¹⁶ Çdo NP, duke përfshirë zyrtarët dhe drejtorët e tyre, pa asnjë përjashtim, i nënshtrohet ligjeve, rregulloreve dhe akteve nënligjore që rregullojnë kompanitë tregtare në pronësi private.¹⁷

Ligji për Ndërmarrjet Publike nuk i mundëson drejtpërdrejt qeverisë që të ndërhyjë në menaxhimin e përditshëm të

një NP-je, me përjashtim të rasteve kur ajo mbikëqyr veprimtarinë e bordit drejtues të një NP-je. Ligji parasheh gjithashtu se në rastet kur një NP nuk arrin të përmbushë objektivat e saj të performancës për dy vite financiare radhazi, zyrtarët qeveritarë përgjegjës për ushtrimin e të drejtave përkatëse të aksionerit janë të detyruar të marrin në konsideratë shkarkimin dhe zëvendësimin e bordit drejtues ose të shumicës nga anëtarët e saj.¹⁸

Ligji parashikon gjithashtu që detyra për të mbikëqyrur nuk duhet të ushtrohet në një mënyrë që ndërhyt ose synon të ndërhyjë në veprimtarinë ose pavarësinë e bordit të drejtorëve ose komitetit të auditimit të një ndërmarrje publike.¹⁹

Sipas Ligjit për Ndërmarrjet Publike, Qeveria ka kompetencë të emërojë dhe shkarkojë anëtarët e bordeve të ndërmarrjeve publike qendrore, ndërsa kuvendet e komunave janë në gjendje të emërojnë dhe shkarkojnë anëtarët e ndërmarrjeve publike lokale. Ligji specifikon 20 kritere për t'u emëruar si anëtar i bordit drejtues në një NP.²⁰ Megjithatë, ligji nuk ka kritere specifike dhe të qarta që mund të përcaktojnë kushtet për shkarkimin e një anëtari të bordit drejtues ose të anëtarëve të bordit në tërësi. Ligji thotë vetëm se sa herë që ka informacione të besueshme se bordi i drejtorëve ose një drejtor individual i NP-së ka vepruar në kundërshtim me detyrat e tyre fiduciare, aksioneri(ët), d.m.th. Qeveria kur bëhet fjalë për ndërmarrjet publike qendrore, do të kryejë një hetim në detaje dhe pa vonesë. Nëse Qeveria konstaton se shkelja ka ndodhur në të vërtetë, ajo do të shkarkojë dhe zëvendësojë menjëherë drejtorin ose drejtorët përgjegjës të bordit të shoqërisë publike.²¹

Ligji kërkon që anëtarët e bordit të mos jenë ose nuk kanë qenë të zgjedhur, të emëruar apo vendimmarrës në asnjë parti politike në 36 muajt e fundit përpara datës së aplikimit të tyre; por megjithatë, nuk përjashtohen individët që janë anëtarë të ndonjë partie politike,²² gjë që mund të cenojnë seriozisht pavarësinë e NP-së në fjalë për shkak të zbrazëtirave ligjore për procedurat e emërimit profesional dhe të bazuar në merita. Ligji nuk ndalon qartë emërimet partiake në këto borde, por përcakton vetëm se një person nuk mund të zgjidhet si drejtor i një bordi nëse ai ka mbajtur poste drejtuese në një parti politike gjatë 36 muajve të fundit.²³ Do të ishte ideale që personi të mos ketë qenë anëtar i një partie politike të paktën në 5 vitet e fundit.





**INDIKATORI 15.1.2
PAVARËSIA (NË PRAKTIKË)**

25/100



Ekziston një trend i dukshëm i ndërhyrjes së gjerë të qeverisë në procesin e emërimit të ndërmarrjeve publike, siç dëshmohet nga emërimet e fundit të anëtarëve të bordit dhe drejtuesve të tjerë me lidhje të ngushta me partinë në pushtet. Preferencat politike të bordeve reflektohen edhe në punësimin e stafit në funksione të tjera.²⁴

Sipas Udhëzimeve të OECD-së për Qeverisjen Korporative të Ndërmarrjeve Shtetërore, "personat e lidhur drejtpërdrejt me pushtetin ekzekutiv – d.m.th. krerët e shteteve, krerët e qeverive dhe ministrat – nuk duhet të shërbejnë në borde pasi kjo do të hidhte dyshime serioze mbi pavarësinë e gjykimin të tyre."²⁵

Udhëzimet e OECD-së për NSH-të rekomandojnë që procesi i rekrutimit duhet të bazohet në rregullat e përshtatshme dhe mekanizmat e duhur të verifikimit (p.sh. komisionet e emërimit) përpara vendimit përfundimtar të ministrave. Aty ku NSH-të kanë investitorë të pakicës jashtetërore, duhet të sigurohet gjithashtu përfaqësimi i tyre adekuat në bord.²⁶ Vendimi për emërimin e bordit duhet të lehtësohet nga një kornizë e qëndrueshme e politikave që i mundëson bordit të luajë një rol në identifikimin e anëtarëve të mundshëm me ekspertizë dhe njohuri të përshtatshme. Korniza e politikave përfshin përcaktimin e kriterëve të qarta minimale të kualifikimit për emërimet e bordit; mekanizmat e verifikimit për emërimet e bordit ministror; krijimin e komiteteve të nominimit ose marrjen e një qasjeje të përshtatur nominimi; dhe sigurimin e të drejtës së aksionarëve për të zgjedhur anëtarët e bordit.²⁷

Megjithatë, përbërja e bordeve të ndërmarrjeve publike ndikohet nga partitë politike dhe interesat e tyre. Në fakt, përzgjedhja e anëtarëve të bordit dhe drejtorëve të këtyre ndërmarrjeve shpesh duket se nuk bazohet kryesisht në kriteret

objektive që rrjedhin nga përvoja apo ekspertiza e tyre, por sipas përkatësive politike.²⁸ Rast konkret është emërimi në vitin 2022 i Bujar Bilallit, ish-kandidat i Lëvizjes Vetëvendosje për asamblenë komunale në Mitrovicë, në bordin e drejtorëve të kompanisë Trepça. Në të njëjtin vit kryetar i bordit të Postës së Kosovës bëhet Fadil Bejta, donator i Lëvizjes Vetëvendosje dhe Feim Fetoshi kryetar i Bordit të Drejtorëve të Ujësllësit Rajonal "Hidroregjioni Jugor" në Prizren.²⁹ Emërim i anëtarit të Lëvizjes Vetëvendosje është bërë edhe në ndërmarrjet publike vendore, konkretisht në kompaninë "Ujësllësi Hidroregjioni Jugor" në qytetin e Prizrenit.³⁰

Një rast tjetër është emërimi i Burbuqe Hanës si Kryeshefe Ekzekutive e Telekomit nga bordi i drejtorëve në vitin 2022. Ish-shëf i Bedri Istrefi tha se vendimi ishte "politik". Këtë e mbështet edhe fakti se kandidati tjetër Kreshnik Domi ka marrë më shumë pikë në të dhënat e monitorimit të publikuara nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar. Duhet theksuar se ky proces monitorimi mbështetet nga Ambasada Britanike për t'i ofruar asistencë teknike Qeverisë dhe Kuvendit të Kosovës në proceset e rekrutimit për pozitat e larta në shërbimin civil dhe institucionet e pavarura, për të forcuar transparencën, meritokracinë dhe qeverisjen e mirë.³¹ Mirëpo, edhe nga zyra e shtypit e Ambasadës Britanike theksuar se nuk kanë kundërshtime për këtë proces pasi ka qenë i mirëorganizuar dhe vendimin përfundimtar e merr institucioni. KQZ-ja gjithashtu nuk e identifikoi Hanën si anëtare të ndonjë partie politike. Gjithsesi, rreth këtij emërimi ka pikëpyetje pasi raportimet në media kanë treguar lidhjen e Hanës me Lëvizjen Vetëvendosje duke marrë pjesë në protestën e tyre.³²

Një rast tjetër nga viti 2023 është emërimi i ish-aktivistit të Lëvizjes Vetëvendosje, Genc Hundozi, anëtar bordi i operatorit shtetëror të rrjetit hekurudhor të Kosovës INFRAKOS.³³

Si emërimet ashtu edhe shkarkimet në NP kontrollohen nga partitë politike në pushtet. Sipas një raporti analitik të publikuar nga Instituti Demokratik i Kosovës, e gjithë procedura e përzgjedhjes së anëtarëve të bordit fillon dhe përfundon me qeverinë. Pra, përgjegjësia më e madhe për përzgjedhjen e bordeve i takon komisionit të rekomandimit. Kjo situatë krijon hapësirë për keqpërdorim të procedurës së përzgjedhjes dhe ndërhyrje politike në Komisionin Rekomandues në favor të partive qeverisëse.³⁴

Si rezultat i emërimeve politike në borde dhe në postet e drejtorëve ekzekutivë, ndërmarrjet publike mund të mos veprojnë me gjykim objektiv dhe të pavarur.

Nuk është raportuar se ndonjë NP ka fituar pa të drejtë qasje në asetet ose burimet private.



Qeverisja

**INDIKATORI 15.2.1
TRANSPARENCA
(SIPAS LIGJIT)**

75/100



Ekzistojnë rregulla dhe dispozita që parashohin publikimin e informacioneve të caktuara për veprimtarinë dhe përbërjen e ndërmarrjeve publike dhe raportimin për të dhënat financiare. Megjithatë, legjislacioni nuk i detyron ndërmarrjet publike që të kenë programe kundër korrupsionit dhe t'i publikojnë ato.

Ligji për ndërmarrjet publike kërkon që NP-të, përkatësisht Njësia e Monitorimit dhe Politikave të NP-ve, të bëjnë publike një sërë informacionesh për të gjitha NP-të në faqen e tyre të internetit. Kjo përfshin pasqyrat financiare, vlerësimet e performancës, planet e punës, vendimet dhe aktet nënligjore, pagat e drejtorëve dhe zyrtarëve, numrin dhe kategorizimin e punonjësve, të dhënat materiale për çdo transaksion me palët e lidhura, kontratat e prokurimit, detyrimet e shërbimit publik, interesat financiare të deklaruara nga drejtorët dhe zyrtarët, dhe një listë me dhjetë furnizuesit kryesorë.³⁵

Gjithashtu, sipas Ligjit për Ndërmarrjet Publike, Njësia për Monitorim dhe Politika të NP-ve kërkohet të publikojë të gjitha informacionet, raportet, pasqyrat financiare dhe vlerësimet e kërkuara me ligj për të gjithë bordet dhe anëtarët e NP-ve.³⁶ Njësia duhet të paraqesë gjithashtu një raport mbikëqyrës pranë ministrisë përkatëse, duke propozuar procedurën për mbikëqyrjen e NP-së dhe të gjitha vendimet ose veprimet e ndërmarrja nga qeveria, ministri ose Komisionin Komunal i Aksionarëve në lidhje me NP-në ose bordin e saj.³⁷

Legjislacioni për ndërmarrjet publike nuk i detyron ato në mënyrë specifike të zbatojnë standardet ndërkombëtare të transparencës financiare, siç janë Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit. Ligji thotë vetëm se pasqyrat financiare vjetore të çdo ndërmarrje publike i nënshtrohen një auditimi të jashtëm të paraparë me ligj në përputhje me standardet e pranura ndërkombëtare të auditimit.³⁸ Gjithashtu, nuk ka asnjë dispozitë ligjore që kërkon që NP-të të raportojnë për programin e tyre kundër korrupsionit, apo edhe të kenë një program të tillë. Ligji në fjalë vetëm e detyron NP-në të publikojë të gjitha konfliktet e interesit të deklaruara nga drejtorët dhe zyrtarët e ndërmarrjeve publike.³⁹

**INDIKATORI 15.2.2
TRANSPARENCA
(NË PRAKTIKË)**

25/100



Ndërmarrjet publike në Kosovë kanë përgjithësisht mangësi serioze në transparencë. Shumica e ndërmarrjeve nuk kanë zyrtarë përgjegjës për komunikimin me palët e jashtme, duke përfshirë komunikimin me mediat, dhe gjithashtu nuk ka zyrtarë të caktuar për t'u mundësuar palëve të jashtme qasje në të dhënat publike. Për më tepër, shumë dokumente që duhet të jenë publike në faqen e tyre zyrtare mungojnë.⁴⁰

Të gjitha të dhënat mbi pronësinë përfutuese të aksioneve të NP-së janë të regjistruara në ARBK.⁴¹

Megjithatë, ekziston një mungesë e theksuar e transparencës në Njësinë e Monitorimit dhe Politikës së NP-ve. Sipas Institutit GAP, Njësia tash e disa vite nuk ka publikuar raportin





e performancës për ndërmarrjet publike me arsyetimin se ato nuk janë miratuar nga Kuvendi.⁴²

Ndërmarrjet publike kanë faqet e tyre të internetit, por jo të gjitha publikojnë të dhëna për detyrimet e shërbimit publik dhe kompensime të tjera financiare ose informacione rreth strukturës së tyre të menaxhimit.⁴³ Në disa prej këtyre ndërmarrjeve publikohen emrat e anëtarëve të bordit dhe drejtorëve ekzekutivë, por nuk ka asnjë raport që shpjegon marrëdhëniet e qeverisjes dhe pronësisë së NP-ve me subjektet e tjera shtetërore.⁴⁴ Megjithatë, ka edhe disa ndërmarrje publike që e publikojnë këtë informacion në faqen e tyre të internetit, siç është kompania Posta dhe Telekom i Kosovës.⁴⁵

Disa ndërmarrje publike nuk i publikojnë raportet vjetore të performancës së bordeve. Gjithashtu mungon publikimi i të dhënave për procedurat e prokurimit dhe raportet e auditimit financiar. Për shembull, Korporata Energjetike e Kosovës publikoi raportin e fundit vjetor të pasqyrave financiare të audituara në vitin 2020 në vitin 2021.⁴⁶

Po ashtu, në Kosovë nuk ekziston asnjë faqe interneti që publikon në mënyrë të përgjithshme të gjitha informatat për aktivitetet e ndërmarrjeve publike qendrore dhe lokale, të cilat do t'i mundësonin publikut të dijë më shumë për këto ndërmarrje.

Për më tepër, asnjë informacion financiar dhe operativ në bazë të vendit nuk publikohet për ndonjë ndërmarrje publike nëse ajo operon edhe jashtë Kosovës.

**INDIKATORI 15.2.3
LLOGARIDHËNIA
(SIPAS LIGJIT)**

75/100



Ekzistojnë dispozita që sigurojnë dhe garantojnë mbikëqyrjen e ndërmarrjeve publike, por Njësia për Monitorim dhe Politika të NP-ve nuk i raporton drejtpërdrejt Kuvendit të Kosovës, por Qeverisë.

Ligji për Ndërmarrjet Publike rregullon se si duhet të qeverisen NP-të dhe kujt i përgjigjen ato. Çdo NP raporton ligjërisht në Ministrinë e Ekonomisë dhe në Njësinë e Monitorimit dhe Politikës së NP-ve, të cilën qeveria e Kosovës e ka themeluar si organ të centralizuar.⁴⁷ Aksionarët e NP-ve gjithashtu kanë të drejtë të ushtrojnë mbikëqyrje të vazhdueshme të punës së bordit të drejtorëve dhe komisioneve të auditimit. Në fakt, sipas Ligjit për NP-të, brenda 30 ditëve nga përfundimi i çdo tremujori kalendarik, zyrtarët e NP-së duhet të përgatisin dhe t'i dorëzojnë bordit të drejtorëve një raport tre mujor për veprimet dhe veprimtarinë e ndërmarrjes.⁴⁸

Përveç raportit tre mujor, ligji kërkon që brenda 45 ditëve pas përfundimit të çdo viti kalendarik, zyrtarët e NP-së duhet të përgatisin dhe t'i dorëzojnë Bordit të Drejtorëve të NP-së një raport vjetor ku përshkruhen veprimet e ndërmarra, rezultatet financiare të arritura dhe efikasiteti i përgjithshëm në arritjen e objektivave të vendosura në planin e biznesit.⁴⁹



Njësia e Monitorimit dhe Politikës së NP-ve, e krijuar nga Ministria e Ekonomisë, i paraqet ministrit raporte analitike dhe propozon procedurat për mbikëqyrjen e NP-ve.⁵⁰ Ajo mbledh informacion dhe i ofron ndihmë Departamentit të Buxhetit për çdo NP dhe çështje të lidhura me të.⁵¹ Mirëpo, Njësia e Monitorimit dhe Politikës së NP-ve nuk i përgjigjet drejtpërdrejt Kuvendit të Kosovës, por Qeverisë, dhe kjo e fundit më pas raporton në baza vjetore në Kuvend lidhur me mënyrën se si ky mekanizëm i ushtron detyrat dhe përgjegjësitë e tij.⁵² Ligji gjithashtu nuk parasheh që Njësia në fjalë duhet të ketë raporte apo marrëdhënie me institucionet qendrore të auditimit si Zyra Kombëtare e Auditimit.

Përveç që i nënshtrohet mbikëqyrjes nga Njësia e Monitorimit dhe Politikës së NP-ve, çdo NP i nënshtrohet gjithashtu auditimit të jashtëm të pavarur nga një institucion kompetent, i pavarur dhe i kualifikuar.⁵³

Ligji parashikon që pasqyrat financiare vjetore të çdo NP-je i nënshtrohen një auditimi të jashtëm të paraparë me ligj në përputhje me standardet e pranuar ndërkombëtare të auditimit.⁵⁴

**INDIKATORI 15.2.4
LLOGARIDHËNIA
(NË PRAKTIKË)**

25/100



Në praktikë, nuk ka shumë mbikëqyrje efektive të ndërmarrjeve publike. Shkaku i problemit është se bordet, që janë shkalla e parë e mbikëqyrjes, emërohen politikisht nga qeveritë që janë në pushtet. Është bërë praktikë në Kosovë që qeveritë e reja të veprojnë menjëherë dhe të shkarkojnë bordet e kompanive publike që janë emëruar nga qeveritë e mëparshme.⁵⁵

Bordet në përgjithësi kryejnë një vlerësim vjetor të performancës së tyre dhe të ndërmarrjes publike, madje hartojnë një raport vjetor⁵⁶ për të paraqitur arritjet dhe sfidat e përjetuara

në punën e tyre dhe të kompanisë.⁵⁷ Në anën tjetër, sa herë që bordet mbajnë mbledhje për të shqyrtuar raportet vjetore apo performancën e një NP-je, marrin pjesë edhe aksionarët të cilët janë të deleguar nga qeveria e Kosovës.

Për më tepër, çdo NP i nënshtrohet një auditimi vjetor nga Zyra Kombëtare e Auditimit,⁵⁸ por ato mbeten prapa në auditimet e brendshme sepse këtyre të fundit u mungon ekspertiza profesionale dhe informacioni i hollësishëm (shih 9.1.1).⁵⁹ Sipas Visar Prebrazës nga BIRN, i cili mbulon fushën e zhvillimit ekonomik në Kosovë me theks të veçantë në zhvillimet në lidhje me ndërmarrjet publike në Kosovë, si raportet e brendshme ashtu edhe auditimet e jashtme të kontraktuara nga kompanitë publike⁶⁰ me një kompani të pavarur nuk kanë detaje të nevojshme dhe kanë një efekt të kufizuar. Kështu, NP-të vazhdojnë të operojnë me humbje financiare, kanë performancë të dobët të qeverisjes dhe nuk kanë përgjegjësi efektive.⁶¹

Me një fjalë, emërimet politike krijojnë hapësirë që bordet të mos ushtrojnë funksionet e tyre në përputhje me objektivat e kompanisë, por të veprojnë bazuar në pëlqimin dhe interesat e partive politike përgjegjëse për emërimet e tyre (shih 15.1.2).⁶²

Nuk ka asnjë politikë apo strategji të publikuar apo draft për komunikim dhe konsultim me të gjithë aksionarët. Megjithatë, aksionarët kanë hapësirë dhe mund të marrin pjesë në vendimet bazë të bordit qoftë përmes zgjedhjes së kryeshefit ekzekutiv ose vendimeve të tjera operacionale.⁶³

Konkurrentët gjithashtu mund të kenë qasje në mekanizmat e kompensimit nëse konsiderojnë se të drejtat e tyre janë shkelur duke përdorur mjetet e ankesës në sistemin gjyqësor të Kosovës.⁶⁴





**INDIKATORI 15.2.5
MEKANIZMAT E
INTEGRITETIT (SIPAS LIGJIT)**

75/100



Ekzistojnë dispozita ligjore për të siguruar dhe garantuar integritetin e ndërmarrjeve publike dhe anëtarëve të tyre, me përjashtim të legjislacionit në lidhje me aktivitetet lobuese, i cili mungon.

Ndërmarrjet publike u nënshtrohen rregullave dhe akteve nënligjore të cilat përmbajnë dispozita për çështjet e integritetit, monitorimit dhe kontrollit të konfliktit të interesit, si dhe çështjet e vlerësimit të drejtë të performancës së anëtarëve të NP-së.

Çdo NP kërkohet të ketë një kod të etikës dhe qeverisjes së korporatës, dhe kjo përfshin standardet më të larta të sjelljes së korporatës.⁶⁵ Kodi përmban dispozita konkrete kundër korrupsionit, konfliktit të interesit dhe mospranimit të dhuratave dhe ryshfetit.⁶⁶ Të gjitha ndërmarrjet publike u ndalohet të mbështesin financiarisht partitë politike.⁶⁷

Ligji i prokurimit dhe rregullat e prokurimit publik zbatohen për të gjitha NP-të dhe ndërmarrjet e sektorit privat kur punojnë me njësitë qeveritare.⁶⁸ Ekzistojnë gjithashtu ligje të tilla si Kodi Penal⁶⁹ dhe Ligji për Përgjegjësinë e Personave Juridik për Veprat Penale të cilat kanë dispozita që sanksionojnë dhënien e ryshfetit si vepër penale dhe e bëjnë të dënueshme përgjegjësinë personale dhe korporative.⁷⁰

Nuk ka dispozita ligjore që rregullojnë lobimin në tërësi në Republikën e Kosovës. Megjithatë, ekzistojnë dispozita ligjore që i kufizojnë anëtarët, drejtorët dhe zyrtarët e NP-së që të llobojnë gjatë aktiviteteve të NP-së. Ligji i kufizimit ata që të marrin pjesë në çdo veprim ose të përpiqen të ndikojnë në çdo takim, diskutim, negociim ose vendim për çështje që lidhen me interesin e tyre personal.⁷¹ Megjithatë, nuk ka

dispozita ligjore që lejojnë ose ndalojnë NP-të si korporata të kryejnë aktivitete lobimi.

Për të parandaluar korrupsionin në ndërmarrjet publike, kryetarët dhe anëtarët e bordeve dhe drejtorët e përgjithshëm të ndërmarrjeve publike janë të detyruar të deklarojnë pasurinë, të ardhurat dhe çdo dhuratë të marrë në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit.⁷²

Sa herë që zbulohet një rast korrupsioni, ekzistojnë mekanizma të pavarur si policia, Prokurori i Shtetit dhe Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ku mund të raportohet një ngjarje e tillë. Të gjithë personat që raportojnë praktika të jashtëligjshme ose të parregullta mbrohen sipas Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve. Ky ligj ka dispozita gjithëpërfshirëse për të mbrojtur personat që raportojnë veprimtari të jashtëligjshme.⁷³

**INDIKATORI 15.2.6
MEKANIZMAT E
INTEGRITETIT (NË PRAKTIKË)**

25/100



Në përgjithësi, ekziston një qasje e pjesshme dhe reaktive për sigurimin e integritetit të ndërmarrjeve publike. Kodi i Etikës dhe Qeverisjes së Ndërmarrjeve Publike nuk monitorohet mjaftueshëm nga Njësia e Monitorimit dhe Politikave të NP-së. Që nga viti 2018, kjo Njësi nuk ka raportuar asnjë të dhënë për zbatimin e Kodit.⁷⁴ Për më tepër, asnjë NP nuk raportohet të ketë nënshkruar një pakt integriteti.

Ndërmarrjet publike janë larg situatës së rekomanduar nga OECD-ja, d.m.th. që shteti duhet të luajë një rol pozitiv në përmirësimin e qeverisjes së korporatave dhe performancës së NP-ve.⁷⁵

Rastet kur anëtarët e bordit kanë hasur në konflikt interesi zakonisht raportohen nga media. Në vitin 2021, mediat



raportuan për një konflikt të mundshëm interesi në lidhje me një anëtar të bordit të ndërmarrjes publike banesore në Prishtinë.⁷⁶ Personi i emëruar si anëtar i bordit raportohet se ka qenë më parë zyrtar i kësaj kompanie i angazhuar si konsulent.⁷⁷ Ky rast është raportuar edhe në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, e cila është e mandatuar të hetojë dhe vlerësojë nëse ka ekzistuar një konflikt i tillë i interesit, por nuk ka raportime për ndonjë vendim të Agjencisë. Sipas Ligjit për Ndërmarrjet Publike, thuhet se një person nuk është i pavarur dhe nuk mund të emërohet anëtar i bordit nëse gjatë 5 viteve të fundit ka mbajtur pozitë zyrtare në atë kompani.⁷⁸

Nuk është raportuar asnjë rast që përfshin dikë nga një NP, apo që punon në emër të saj, duke ofruar ryshfet brenda apo jashtë vendit për realizimin e ndonjë përfitimi.

Sipas raportit vjetor të vitit 2022 të publikuar nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, 432 zyrtarë të ndërmarrjeve publike janë të detyruar të deklarojnë pasurinë dhe deri më tani nuk ka pasur asnjë rast që asnjëri prej tyre të mos deklarojë një deklaratë të tillë.⁷⁹

Nëse ka ndonjë rast të mundshëm ku një zyrtar dyshohet se ka marrë ryshfet, ai mund t'i raportohet zyrtarit informues të emëruar nga NP, ose organeve shtetërore, si Policia dhe Prokuroria. Megjithatë, deri më tani, asnjë rast i tillë nuk është raportuar.

Në vitin 2018, Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) ka anuluar një aktivitet të prokurimit për Ministrinë e Integritetit Evropian për shkak se nuk ka përzgjedhur një kompani publike në vend të asaj private.⁸⁰ Në këtë rast, kompania publike, Telekom i Kosovës pretendoi se Ministria e Integritetit Evropian kishte bërë shkelje të ligjit për prokurimin publik me dhënien e tenderit për shërbimet e telefonisë mobile një kompanie private për 77 mijë euro. Megjithatë, nuk ka asnjë informacion të disponueshëm publikisht nëse kjo ishte vërtet e saktë.⁸¹

Nuk ka raste të raportuara që NP-të të kenë ofruar donacione për subjektet politike apo të jenë angazhuar në ndonjë aktivitet lobues në organet publike vendimmarrëse.

Sipas një gazetari të ekonomisë nga BIRN që punon në disa çështje rreth prokurimeve dhe keqmenaxhimit në ndërmarrjet publike, ndërmarrjet publike janë të detyruara të emërojnë zyrtarë sinjalizues, por në praktikë këta zyrtarë janë të lidhur kryesisht me drejtorët ekzekutivë të këtyre ndërmarrjeve.⁸² Sipas gazetarit, shumë raste që mund të jenë rapor-

tuar tek zyrtarët e sinjalizimit të NP-ve janë mbyllur, ose nuk raportohen fare, për shkak të ndikimit të drejtorit ekzekutiv.⁸³ Prandaj, ky mekanizëm nuk konsiderohet i sigurt ose i besueshëm për sinjalizuesit brenda NP-së.⁸⁴

Disa NP nuk kanë kod të etikës dhe qeverisjes së korporatës. Nga shqyrtimi i faqeve të internetit të 18 ndërmarrjeve publike në Kosovë, rezultoi se dhjetë⁸⁵ prej tyre kanë publikuar kodet e tyre të etikës, ndërsa tetë nuk i kanë publikuar në faqet e tyre të internetit.⁸⁶

Së fundi, nuk ka raporte për ndonjë NP që ka nënshkruar ndonjë pakt për integritet, i cili sipas Transparency International përfaqëson "një mjet për parandalimin e korrupsionit në kontraktimet publike". Ky mjet kërkon që autoriteti kontraktues qeveritar dhe kompania të bien dakord të përmbahen nga ryshfeti, marrëveshjet e fshehta dhe praktikatat tjera korruptive.⁸⁷





Ndërveprimet

Ndërveprimet me ekzekutivin janë kryesisht në kuadër të detyrimeve ligjore lidhur me emërimin dhe shkarkimin e bordeve të NP-ve. Ndërveprimi me mediet dhe shoqërinë civile lidhet me monitorimin dhe përcjelljen e aktiviteteve të NP-ve.

Po kështu, ndërveprimi me mediet dhe shoqërinë civile lidhet me dhënien e informacionit për procesin e rekrutimit në ndërmarrjet publike dhe bashkëpunimin për monitorimin e aktiviteteve dhe punës së ndërmarrjeve publike. Ndërveprimi me mediet dhe shoqërinë civile është kryesisht pozitiv në raportimin e rasteve të korrupsionit. Mediet dhe shoqëria civile shpesh kanë raportuar raste kur zyrtarët e NP-ve janë identifikuar në konflikt të mundshëm interesi ose shkelje të tjera ligjore. Megjithatë, kjo marrëdhënie duhet të përmirësohet dhe forcohet më tej, veçanërisht nga ana e NP-ve. Aktualisht, ndërmarrjet publike nuk kanë zyrtarë për marrëdhënie me publikun për të lehtësuar qasjen e medieve në informacion dhe komunikim më të mirë.

Rekomandimet e shtyllës

- Qeveria dhe Kuvendi duhet të forcojnë mekanizmat mbikëqyrës të Njesisë së Politikave dhe Monitorimit për ndërmarrjet publike duke rritur buxhetin e tyre dhe numrin e stafit për të siguruar qeverisje cilësore të këtyre ndërmarrjeve.
- Qeveria duhet të ndalojë emërimet partiake në bordet e ndërmarrjeve publike në Kosovë, duke respektuar kriteret e përcaktuara në ligjin për ndërmarrjet publike, të cilat kërkojnë që në këto pozita të emërohen profesionistë sipas meritave të tyre.
- Qeveria duhet të propozojë një ndryshim të ligjit për ndërmarrjet publike për të përcaktuar qartë kriteret për shkarkimin e anëtarëve të bordeve të ndërmarrjeve publike.
- Njësia e Monitorimit dhe Politikave të NP-ve duhet të publikojë raporte vjetore mbi zbatueshmërinë e kodit të qeverisjes së korporatës nga ndërmarrjet publike.
- Ndërmarrjet publike duhet të caktojnë zyrtarë për medie dhe marrëdhënie me publikun për të trajtuar kërkesat nga media dhe shoqëria civile në kohën e duhur dhe të tregojnë përkushtimin e tyre për zhvillimin e transparencës.
- Ndërmarrjet publike duhet të përditësojnë faqet e tyre elektronike të internetit duke i bërë publike dhe të qasshme të gjitha dokumentet e tyre strategjike, kornizën ligjore, statutet dhe kodin e qeverisjes së korporatës, si dhe duke publikuar të dhëna për raportet e auditimit dhe raportet vjetore të punës.



REFERENCAT

- 1 Ligji Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, neni 1 dhe 4. Ky ligj është duke ndryshuar dhe plotësuar Ligjin Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 në maj 2015.
- 2 Shih portalin Koha.Net, dhjetor 2022, <https://www.koha.net/veshtrime/358131/a-ka-nevoje-kosova-per-ndermarrje-te-reja-publike/> [qasur më 27 korrik 2023]
- 3 Kompanitë rajonale janë kompani publike që ofrojnë shërbime publike në disa komuna, ndërsa kompanitë vendore janë kompani që menaxhohen nga një komunë dhe ofrojnë shërbime vetëm brenda territorit të komunës përkatëse.
- 4 Ligji Nr. 03/L-087 Për Ndërmarrjet Publike, faqe 24.
- 5 Shih Ligjin Nr. 03/L-087 Për Ndërmarrjet Publike, neni 15 paragrafi 1, i cili thotë se: Të gjithë drejtorët përveç njërit do të zgjidhen nga qeveria; dhe secili drejtor i zgjedhur do të ketë mandat prej 3 vjetësh. Drejtori tjetër është kryeshefi ekzekutiv i ndërmarrjes shtetërore, i cili zgjidhet nga bordi i drejtorëve të ndërmarrjes shtetërore në pajtim me nenin 21 të këtij ligji. Me rastin e zgjedhjes së drejtorëve në bordin e drejtorëve të një ndërmarrjeje shtetërore qendrore, qeveria mund të zgjedhë vetëm persona të cilët i janë rekomanduar qeverisë nga Komisioni përkatës i Rekomandimit i krijuar në paragrafin 2 të këtij neni.
- 6 Njësia e Politikave dhe Monitorimit të Ndërmarrjeve Publike është një mekanizëm që funksionon në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë, e cila ka këto detyra dhe përgjegjësi: të mbështesë Ministrin e Ekonomisë dhe qeverinë në ushtrimin e përgjegjësisë të tyre lidhur me ndërmarrjet publike; të përgatisë dhe t'i dorëzojë ministrin analiza dhe rekomandime në lidhje me ndërmarrjet publike qendrore; të përgatisë dhe t'i dorëzojë ministrin propozime për mbikëqyrjen e ndërmarrjeve publike qendrore, si dhe të monitorojë pajtueshmërinë e tyre me Ligjin për Ndërmarrjet Publike dhe legjislacionin tjetër në fuqi; mblehin të dhënat përkatëse për ndërmarrjet publike dhe ofrojnë mbështetje, sipas nevojës, për Divizionin e Buxhetit dhe Financave në lidhje me të gjitha aspektet e Buxhetit të Kosovës që kanë të bëjnë me ndërmarrjet publike; merr pjesë në mbledhjet e bordeve të ndërmarrjeve publike, si vëzhgues që përfaqëson aksionarin; dhe kryen detyra dhe përgjegjësi të tjera të përcaktuara në Ligjin për Ndërmarrjet Publike, Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike dhe legjislacionin tjetër përkatës në fuqi.
- 7 Intervistë me Visar Prebreza, kryeredaktor në BIRN, 19 janar 2023.
- 8 Shih lidhjen në Njesisë e Politikave dhe Monitorimit të Ndërmarrjeve Publike, <https://me.rks-gov.net/njpmnp/raportet-e-performances-per-np/> [qasur më 2 gusht 2023]
- 9 Shihni edhe: Njoftim nga lidhja në Njesisë e Politikave dhe Monitorimit të Ndërmarrjeve Publike: <https://me.rks-gov.net/njpmnp/njoftime/> [qasur më 2 gusht 2023]
- 10 Shih faqen e internetit të Njesisë së Monitorimit dhe Politikave të NP-ve: <https://me.rks-gov.net/njpmnp/njoftime/> [qasur më 2 tetor 2023]
- 11 Ligji Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, qershor 2008, i plotësuar dhe ndryshuar në 2012 dhe 2015.
- 12 Ligji Nr.06/L-016 për Shoqëritë Tregtare, maj 2018.
- 13 Shih Ligjin për Ndërmarrjet Publike, qershor 2008, i plotësuar dhe ndryshuar në vitin 2012 dhe 2015, neni 3, paragrafi 2. Përveç ndërmarrjeve publike qendrore, në Kosovë ekzistojnë edhe ndërmarrje publike lokale të cilat administrohen nga komunat përmes komisioneve komunale si aksionarë.
- 14 Ligji Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, qershor 2008, i plotësuar dhe ndryshuar në vitin 2012 dhe 2015, neni 30, paragrafi 1.e.
- 15 Ligji Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, qershor 2008, i plotësuar dhe ndryshuar në 2012 dhe 2015, neni 29.
- 16 Sipas nenit 1 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, theksohet se, përveç rasteve kur shprehimisht theksohet ndryshe në këtë ligj, dispozitat e ligjeve të tjera të Kosovës (duke përfshirë, por pa u kufizuar në, Ligjin për Shoqëritë Tregtare) të cilat rregullojnë shoqëritë aksionare si dhe drejtorët, menaxhmentin, aksionarët, si dhe të drejtat dhe detyrimet e secilit prej sipërpërmendurve, do të zbatohen në tërësi për NP-të, drejtorët, menaxhmentin dhe aksionarët.
- 17 Ligji Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, neni 13 paragrafi 1.
- 18 Shih Ligjin Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, neni 7.
- 19 Ligji Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, neni 7 paragrafi 6.
- 20 Ligji Nr. 03/L-087 Për Ndërmarrjet Publike, neni 17.
- 21 Ligji Nr. 03/L-087 Për Ndërmarrjet Publike, neni 19.
- 22 Ligji për Ndërmarrjet Publike, neni 17 paragrafi 2.k.
- 23 Ligji për Ndërmarrjet Publike, neni 17 paragrafi 1 pika k, vetëm përfshin ndalimin për personat që mbajnë poste drejtuese ose vendimmarrëse në një parti politike, por nuk ndalon emërimin e të gjithë personave që mbajnë poste partiake.
- 24 Portali Telegrafi, maj 2018, <https://telegrafi.com/politizimi-bordeve-con-ndermarrjet-dreit-falimentimit/> [qasur më 3 shkurt 2022]
- 25 Udhëzimet e OECD-së mbi qeverisjen korporative të ndërmarrjeve shtetërore, f. 71, <https://www.oecd-ilibrary.org/docserver/9789264244160-en.pdf?expires=1695636155&id=id&accname=quest&checksum=766B6EF15A6E65B4BC4C6E>
- 26 Shih Udhëzimet e OECD-së mbi qeverisjen korporative të ndërmarrjeve shtetërore, faqe 71.
- 27 Ligji Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, qershor 2008, i plotësuar dhe ndryshuar në 2012 dhe 2015, neni 15, 16, 17.
- 28 Portali Kallxo.Com, mars 2018, <https://kallxo.com/gjate/hurumtim/bordi-i-politizuar-i-telekomit/> [qasur më 23 janar 2023]
- 29 Shih portalin Sinjali.com, shkurt 2022, <https://sinjali.com/ish-kandidati-i-vv-se-per-kuvend-te-mitrovices-emerohet-anetar-ne-bordin-e-trepces/> [qasur më 7 gusht 2023]
- 30 Shih portalin Dukagjini.Com, gusht 2022, <https://www.dukagjini.com/anetari-i-vv-se-emerohet-ne-bordin-e-ndermarrjes-publike/> [qasur më 8 gusht 2023]
- 31 Për më shumë, shihni "Memorandumin e Mirëkuptimit" të nënshkruar ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar dhe Irlandës së Veriut, e përfaqësuar nga Ambasada Britanike. Qëllimi i këtij memorandum mirëkuptimi është të mbështesë përpjekjet e përbashkëta për të siguruar që drejtues të fortë, të pavarur dhe profesional të institucioneve dhe organeve publike të emërohen përmes një procesi të drejtë dhe transparent të rekrutimit. Ky projekt synon të ndihmojë institucionet e Kosovës në rekrutimin e një liste të dakorduar të pozitave të larta. Botuar në <https://www.kosovoselection.org/overview> [qasur më 3 tetor 2023]
- 32 Gazeta Express, <https://www.gazetaexpress.com/kryeshefja-e-re-e-telekomit-burbaqe-hana-zyrtare-qe-zbaton-urdhrat-e-vvse/> [qasur më 25 shtator 2023]
- 33 Për më shumë shihni portalin Gazeta10.com, mars 2023, <https://gazeta10.com/kurti-emeron-aktivistin-e-vv-se-si-anetar-bordi-ne-infrakos/> [qasur më 3 gusht 2023]
- 34 Analiza e Institutit Demokratik të Kosovës: 'Bordet Politike', (KDI: Prishtinë, qershor 2021), faqe 13. [qasur më 25 shtator 2023]
- 35 Ligji Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, neni 37 paragrafi 4.
- 36 Ligji Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, neni 37 paragrafi 3.
- 37 Ligji Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, neni 37 paragrafi 4 pika 1 deri në i.
- 38 Ligji Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, qershor 2008, i plotësuar dhe ndryshuar në 2012 dhe 2015, neni 33, paragrafi 1.
- 39 Ligji Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, neni 37 paragrafi 4 pika J.
- 40 Instituti GAP, raport tematik: 'Menaxhimi financiar dhe transparenca në Ndërmarrjet Publike' (GAP: Prishtinë, dhjetor 2022), faqe 24.
- 41 Ekziston një faqe interneti e Agjencisë Qendrore për Bizneset ku ekziston edhe një listë e bizneseve të regjistruara. Shihni linkun: <https://arbk.rks-gov.net/page.aspx?id=2>
- 42 Instituti GAP, raport tematik: 'Menaxhimi financiar dhe transparenca në ndërmarrjet publike', faqe 24.



- 43 Posta dhe Telekom i Kosovës (PTK) publikuan raportin vjetor të auditimit financiar në ueb faqen e tyre vetëm në vitin 2019. Pas këtij viti nuk ka asnjë publikim të këtij raporti apo ndonjë dokumenti tjetër që flet për obligimet dhe kompensimin financiar të PTK-së.
- 44 Korporata Energjetike e Kosovës, në ueb faqen e saj, ka publikuar emrat e bordit dhe drejtorit të kësaj kompanie, por nuk ka asnjë raport që shpjegon këto marrëdhënie. Raporti vjetor i auditimit të fundit financiar është publikuar në vitin 2021 dhe flet për performancën e Korporatës në vitin 2020.
- 45 Në faqen e Telekomit të Kosovës nuk ka të dhëna apo informacione që tregojnë identitetin e ekipit menaxhues. Shih për më shumë në linkun: <https://kosovotelecom.com/publikime/> [qasur më 23 janar 2023]
- 46 Shih faqen e internetit të Korporatës Energjetike të Kosovës, "Raporti Financiar" <http://kek-energy.com/kek/raportet-audituaara-financiare/> [qasur më 23 janar 2023]
- 47 Ligji Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet publike, neni 37, paragrafi 1.
- 48 Shih Ligjin Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, neni 31.
- 49 Ligji Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, neni 31, paragrafët 1 deri 5.
- 50 Ligji Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, neni 37 paragrafi 2 pika b.
- 51 Ligji Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, neni 37 paragrafi 2 pika c.
- 52 Ligji Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, neni 37.
- 53 Ligji Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, neni 33 paragrafi 1.
- 54 Ligji Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, qershor 2008, i plotësuar dhe ndryshuar në 2012 dhe 2015, neni 33, paragrafi 1. Për këtë çështje, Ligji për Ndërmarrjet Publike në nenin 41 paragrafi 1 dhe 2 përcakton vetëm se NP-ja duhet të veprojë në përputhje të plotë me të gjitha kushtet për raportim financiar dhe parimet e kontabilitetit për shoqëritë aksionare të përcaktuara në Ligjin për shoqëritë tregtare. Sipas Ligjit, NP-ja duhet gjithashtu të veprojë në përputhje të plotë me udhëzimet administrative të nxjerra nga Thesari për përgatitjen e raporteve financiare të cilat kërkohen me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.
- 55 Intervistë me Visar Prebrezën, 'Redaktor Menaxhues në organizatën BIRN, 19 janar 2023.
- 56 Shih: Posta e Kosovës, Raporti Vjetor i Punës për 2021', (PK, Prishtinë: mars 2022), faqe 11.
- 57 Shih: Korporata Energjetike e Kosovës, 'Raporti vjetor 2021', (KEK: Prishtinë: prill 2022), faqe 7.
- 58 Shih: Zyra Kombëtare e Auditimit, Raporti i Auditimit: "Performanca financiare dhe operative e NP-së Trepça Sh.a", (ZKA: Prishtinë, dhjetor 2022), faqe 10-11.
- 59 Intervistë me Visar Prebrezën, 'Redaktor Menaxhues në organizatën BIRN, 19 janar 2023.
- 60 Shih artikullin e shkruar nga Visar Prebreza në shtator 2019, <https://kallxo.com/gjate/analize/divorci-i-qeverise-nga-asfalti/> [qasur më 8 gusht 2023] është shpërblyer Visar Prebreza në vitin 2020 nga Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK) në bashkëpunim me Misionin e OSBE-së në Kosovë dhe Entitetin e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Barazi Gjinore dhe Fuqizimin e Grave Çmimin e Gazetarisë për Ekonomi "Ibrahim Rexhepi". Për më shumë shihni linkun <https://ekonomiaonline.com/agk-ja-ndan-kater-cmime-shperblehen-gazetaret-qe-raportuan-gjate-pandemise/>.
- 61 Intervistë me Visar Prebrezën, Redaktor Menaxhues në organizatën BIRN, 19 janar 2023.
- 62 Instituti Demokratik i Kosovës, 'Bordet Politike', (KDI: Prishtinë, qershor 2021), faqe 13.
- 63 Intervistë me Visar Prebrezën, Redaktor Menaxhues në organizatën BIRN, 19 janar 2023.
- 64 Më 1 gusht 2022 u funksionalizua Gjykata Ekonomike, e cila ka juridiksionin për të trajtuar të gjitha rastet e konflikteve ndërmjet shoqërive publike dhe private në çështjet tregtare. Përveç mosmarrëveshjeve ndërmjet autoriteteve publike dhe ndërmarrjeve publike, ekzistojnë mekanizma gjyqësorë siç janë gjykatat e rregullta që pranojnë dhe shqyrtojnë rastet e kësaj natyre.
- 65 Ligji Nr.03/L-87 për Ndërmarrjet Publike, qershor 2008, i plotësuar dhe ndryshuar në 2012 dhe 2015, neni 35.
- 66 Kodi i Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike, (prill 2010), faqe 21.
- 67 Ligji Nr.03/L-174 për Financimin e Partive Politike, neni 11 paragrafi 2.
- 68 Shih ligjin nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Kosovë, neni 2 paragrafi 2.
- 69 Kodi Penal 06/L-074 i Republikës së Kosovës, neni 422, rryshfeten e konsideron veprë penale të dënueshme me burgim nga 6 muaj deri në 8 vjet.
- 70 Neni 5 i Ligjit Nr.04/L-030 për Përgjegjësinë e Personave Juridikë për Veprat Penale përcakton se personi juridik është përgjegjës për veprën penale të personit përgjegjës i cili duke vepruar në emër të personit juridik në kuadër të autorizimit të tij, ka kryer veprë penale me qëllim që ai person juridik të përfitojë ose ka shkaktuar dëm. Përgjegjësia e personit juridik ekziston edhe kur veprimi i atij personi juridik është në kundërshtim me politikën ose urdhrat e biznesit të personit juridik.
- 71 Ligji për Ndërmarrjet Publike, neni 36.
- 72 Ligji Nr. 08/L-108 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurive dhe Dhuratave, neni 4, paragrafi 1 pika 15, (korrik 2022).
- 73 Ligji Nr. 06/L-85 për Mbrojtjen e sinjalizuesve, neni 5 dhe 7.
- 74 Uebfaqja e Njësisë së Monitorimit dhe Politikës së Ndërmarrjeve Publike, 'Publikime' <https://me.rks-gov.net/npmnp/?page=1,3&date=2020-00-00> [qasur më 27 janar 2023] Në pjesën e publikimeve është vërejtur vetëm një raport për vlerësimin e performancës së bordit drejtues të NP-së dhe nuk ka të dhëna të tjera.
- 75 OECD, 'Udhëzime për qeverisjen korporative të ndërmarrjeve shtetërore, faqe 10.
- 76 Portali Kallxo.Com, nëntor 2021, <https://kallxo.com/gjate/anetari-i-bordit-te-ndermarrjes-publike-banesore-ne-konflikt-te-mundshem-te-interesit/> [qasur më 27 janar 2023]
- 77 Po aty, portali Kallxo.Com, nëntor 2021, <https://kallxo.com/gjate/anetari-i-bordit-te-ndermarrjes-publike-banesore-ne-konflikt-te-mundshem-te-interesit/> [qasur më 3 tetor 2023]
- 78 Ligji Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet publike, neni 17, paragrafi 2.
- 79 Shih Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, 'Raporti Vjetor për 2022', (Prishtinë: APK, mars 2023), faqe 27.
- 80 Portali Ekonomia Online, gusht 2018, <https://ekonomiaonline.com/oshp-favorizon-ndermarrjeet-publike-ne-procurim-praktike-e-cila-esthe-ne-kundershtim-msa-ne/> [qasur më 3 shkurt 2023] Në këtë rast, Telekom i Kosovës ka dorëzuar ankesë në OSHP, duke pretenduar se Ministria e Integritetit Evropian kishte shkelur Ligjin për prokurimin publik me dhënien e tenderit për shërbimet e telefonisë mobile në vlerë prej 77,000 €.
- 81 Portali Koha.Net, gusht 2018 <https://www.koha.net/arberi/108463/oshp-favorizon-ndermarrjet-publike-ne-prokurim-praktike-e-cila-eshte-ne-kundershtim-me-msa-ne/> [qasur më 3 tetor 2023]
- 82 Intervistë me Visar Prebrezën, Redaktor Menaxhues në organizatën BIRN, 19 janar 2023.
- 83 Intervistë me Visar Prebrezën, Redaktor Menaxhues në organizatën BIRN, 19 janar 2023.
- 84 Shih Instituti i Kosovës për Drejtësi, 'Analiza e zbatimit të ligjit për sinjalizuesit nga institucionet publike', (Prishtinë: IKD, prill 2020), faqe 45.
- 85 Shih NSH-të të cilat kanë publikuar kodin e etikës dhe qeverisjes korporative: Korporata Energjetike e Kosovës, <http://kek-energy.com/kek/legjislacioni/>; Iber-Lepenc K.R.U., <https://iber-lepenc.org/publikimet/>; KOSTT https://www.kostt.com/Content/ViewFiles/CorporateLegislation/PO_KO_001_Kodi_i_etikes_DHE_Qeverisjes_Korporative_per_NPQ_KOSTT.pdf; Posta: <https://postakosoves.com/publikime/legjislacioni/statusi-dhe-rregulloret/>; Drini i Bardhe: <https://hidrodrini.com/wp-content/uploads/2021/04/KODI-I-ETIKES-SHQIP-2014.pdf>; Trepça, sh.a <https://trepcasha.com/index.php?page=regulations>; KRU Pristina <https://trepcasha.com/index.php?page=regulations>; Hidro Drini-Peja: <https://hidrodrini.com/kodi-i-etikes-shqip-2014/>.
- 86 Shih NSH-të të cilat nuk kanë publikuar kodin e etikës dhe qeverisjes korporative: Telekom i Kosovës: <https://kosovotelecom.com/publikime/>; TrainKos: <https://www.trainkos.com/publikimet/rreg-aktet-tjera-te-brendshme/>; Kompania për Menaxhimin e Deponive: <https://www.kmdk-ks.org/?page=1,14&offset=20>; Infra-Kos: <https://infrakos.com/publikimet/rregulloret/>; Agjencia për Shërbimet e Navigacionit Ajror: <https://www.ashna-ks.org/publikimet/financa/>; K.R.U. Gjakova: <https://www.kru-gjakova.com/rregulloret/>; Hidromorava-Gjilan, <https://kru-hidromorava.com/rregulloret/>; Radoniqi-Peje <https://kruradoniqi-dukagjini.com/rregulloret/> [qasur më 8 gusht 2023]
- 87 Shih Transparency International, <https://www.transparency.org/en/tool-integrity-pacts3> [qasur më 3 shkurt 2023]

PËRFUNDIME / REKOMANDIME POLITIKASH

Duke u mbështetur nga gjetjet kryesore të vlerësimit të NIS-it për shtylla specifike dhe një ekzaminim i plotë i shqetësimeve gjithëpërfshirëse dhe çështjeve ndërsektoriale, KDI paraqet rekomandimet e mëposhtme. Kjo listë nuk është shteruese dhe është përshtatur për institucionin apo shtyllën përkatëse të cilës i drejtohet secili rekomandim. Këto rekomandime synojnë të ofrojnë udhëzime dhe përmirësime të synuara bazuar në sfidat dhe konsideratat e identifikuara brenda secilit kontekst specifik.

Nevojitet legjislacioni i ri/i ndryshuar:

- Miratimi i ndryshimeve ligjore që obligojnë qeverinë të ndajë buxhetin për Kuvendin në përputhje me kërkesat e saj, bazuar në një përqindje minimale të buxhetit të caktuar.
- Të ndryshohet korniza ligjore për raportimin e agjencive të pavarura në Kuvend duke përcaktuar sanksione për drejtuesit apo bordet e institucioneve të pavarura në rast të mosmiratimit të raporteve të tyre vjetore nga Kuvendi. Ndryshimi duhet t'i përcaktojë afatet për dorëzimin e raporteve vjetore nga secili institucion.
- Miratimi i një ligji për lobimin që detyron deputetët të dokumentojnë dhe zbulojnë ndërveprimet në lidhje me proceset legjislative.
- Ndryshimi i ligjit për KPK-në në lidhje me përbërjen dhe emërimin e tij për ta bërë atë vërtet pluralist sipas rekomandimeve të Komisionit të Venecias: zgjedhja me shumicë të thjeshtë duhet të zëvendësohet me sistemin proporcional të zgjedhjes dhe emërimi i disa anëtarëve joprokurorënga institucione të jashtme të pavarura ose të shoqërisë civile.
- Të ndryshohet ligji për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve për të përfshirë mundësinë e shkarkimit të prokurorëve për performancë të dobët.
- Ndryshimi i legjislacionit për të paraparë kufizimet pas punësimit për zyrtarët e lartë policorë të Policisë së Kosovës.
- Të rishikohet legjislacioni mbi financimin politik për t'u kërkuar kandidatëve të subjekteve politike të raportojnë financat dhe shpenzimet e tyre.
- Ndryshimi i Ligjit për Avokatin e Popullit në mënyrë që të përcaktohet se kandidatët për këtë pozitë të mos kenë qenë pjesë e partive politike, ekzekutivit ose në poste të tjera politike për një periudhë të paktën pesë vjet përpara konkurimit për t'u zgjedhur Avokati i Popullit, duke garantuar një nivel edhe më të lartë të pavarësisë së Avokatit të Popullit.
- Të bëhen përshtatjet e nevojshme ligjore, në bashkëpunim me qeverinë për krijimin e mekanizmave, përfshirë organin administrativ, rolet dhe procedurat, që do të trajtonin sanksionet dhe masat ndëshkuese për çështjet sistematike të identifikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit dhe rekomandimet e pa adresuara.
- Të bëhen përshtatjet e nevojshme ligjore, në bashkëpunim me qeverinë për krijimin e mekanizmave, përfshirë organin administrativ, rolet dhe procedurat, ku palët e audituara mund të apelojnë gjetjet e raportuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.
- Të ndryshohet Ligji për Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm për të kufizuar diskrecionin e Presidentit për të emëruar më shumë se një komision për përzgjedhjen e kandidatit për Auditor të Përgjithshëm, duke krijuar kështu mundësi për të zgjedhur nga kandidatët e ndryshëm dhe për të përcaktuar qartë procedurat për rekrutim të bazuar në merita Auditorin e Përgjithshëm dhe llogaridhënie për anulimin e kriterëve të përcaktuara.
- Të kodifikohen të gjitha rregulloret për partitë politike në një ligj të vetëm për partitë politike. Ligji i ri duhet të përcaktojë qartë prerogativat, detyrimet dhe kushtet e tjera që u mundësojnë partive politike të përmbushin funksionet e tyre në shoqëri.



- Të miratohet një ligji organik për mediet për të rregulluar të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me medie, si pronësia e medieve, financimi i tyre, raportimi, regjistrimi dhe funksionimi i portaleve online dhe mbrojtja e gazetarëve nga paditë SLAPP.
- Të ndryshohet ligji për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftën kundër financimit të terrorizmit, pasi aktualisht paraqet kufizime ligjore për veprimtarinë e OShC-ve në aspektin financiar.
- Krijimi i rregulloreve të reja në lidhje me publikimin e të dhënave që lidhen me "pronësinë përfituese" të kompanive, veçanërisht në bazën e të dhënave të prokurimit elektronik dhe dosjet e tenderëve.

Për Kuvendin:

- Rritja e ndjeshme e numrit të konsultimeve dhe dëgjimeve publike duke futur mekanizma të detyrueshëm për të pasur dëgjime publike për çdo projektligj që shqyrtohet nga Kuvendi.
- Të sigurohet transparenca më e madhe duke publikuar votat e deputetëve si në mbledhjet plenare ashtu edhe në komisione në faqen e internetit dhe në platforma të tjera online.
- Miratimi i plotë, së bashku me qeverinë, i kërkesave buxhetore të KPK-së në mënyrë që ata të rrisin rekrutimin e prokurorëve dhe stafit profesional për të përmbushur rolin e tyre të ndjekjes penale të korrupsionit.
- Të përfundojë procesi i nevojshëm i reformës zgjedhore, duke përfshirë aspektet thelbësore dhe politike të sistemit zgjedhor, duke përfshirë ngritjen e standardeve për të drejtën ligjore të kandidatëve; kufizimi i votimit preferencial në tre kandidatë; prezantimi i modelit "zebra" të përfaqësimit të barabartë; dhe ndryshimi i përbërjes së KQZ-së duke rritur numrin e gjyqtarëve.

Për Qeverinë:

- Të miratohet një Kod Etike dhe Sjelljeje për anëtarët e kabinetit qeveritar që përcakton rregullat për parimet e punës dhe sjelljes së anëtarëve të kabinetit qeveritar si dhe rregullat disiplinore dhe sanksionimin e këtyre anëtarëve në rastet kur ata kryejnë veprime të pahijshme dhe jo të duhura e të jashtëligjshme gjatë ose pas orarit të punës.
- Ndryshimi i Rregullores së Qeverisë, përkatësisht nenit 23, ku procesverballi i mbledhjes së qeverisë nuk duhet të konsiderohet konfidencial siç është aktualisht. Qeveria duhet ta harmonizojë këtë rregullore me ligjin për qeverinë, ligjin për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar dhe ligjin për qasje në dokumente publike. Nëpërmjet rregullores, duhet të përcaktohen qartë kriteret specifike se çfarë përbën një dokument konfidencial për punën e qeverisë.
- Shmangia e ndërhyrjeve në punën e institucioneve të pavarura kushtetuese, veçanërisht në sistemin gjyqësor dhe prokurorial, përmes nismave ligjore për uljen e pagave të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Qeveria gjithashtu duhet të ndalojë praktikën e mos miratimit të plotë të kërkesave buxhetore të KGJK-së dhe KPK-së, por të respektojë legjislacionin për menaxhimin e financave publike që kërkon që kërkesat buxhetore të institucioneve të pavarura gjyqësore të respektohen dhe miratohen kur ato të dorëzohen brenda afati ligjor.
- Zbatim i një mekanizmi transparence në Ministrinë e Punëve të Brendshme për rekrutimin dhe emërimin e drejtuesve të lartë të policisë, duke siguruar që këto procese të jenë profesionale dhe të mos ndikohen politikisht. Ky mekanizëm duhet ta bëjë të detyrueshëm publikimin e të gjitha dokumenteve të brendshme që mund të jenë me interes për publikun, duke përfshirë fletët e notimit të kandidatëve dhe përmbledhjet dhe arsyetimin e vlerësimit të rekrutimit.
- Rritja e buxhetit të Agjencisë në përputhje me kompetencat e saj të zgjeruara të lidhura me amendamentin e fundit të vitit 2022 të ligjit të Agjencisë dhe të lejohet që ajo të rekrutojë staf të ri. Gjithashtu nevojitet një buxhet më i madh që Agjencia të zbatojë plotësisht planet e saj për aktivitetet dhe fushatat për parandalimin e korrupsionit.
- Të bashkëpunojë në mënyrë më aktive me mediet duke ofruar qasje në informacion në kohën e duhur. Qeveria gjithashtu duhet të organizojë më shumë konferenca shtypi për tema kritike si procesi i dialogut dhe çështjet e sigurisë.
- Të fuqizohet Njësia e Politikave dhe Monitorimit për ndërmarrjet publike duke rritur buxhetin e tyre dhe numrin e stafit për të siguruar qeverisje cilësore të këtyre ndërmarrjeve.
- Të ndalojë emërimet partiake në bordet e ndërmarrjeve publike në Kosovë, duke respektuar kriteret e përcaktuara në ligjin për ndërmarrjet publike, të cilat kërkojnë që në këto pozita të emërohen profesionistë sipas meritave të tyre.
- Njësia e Monitorimit dhe Politikave të NP-ve: Duhet të publikohen raporte vjetore mbi zbatueshmërinë e kodit të qeverisjes së korporatës nga ndërmarrjet publike.



Për institucionet e sistemit të drejtësisë:

- Këshilli Gjyqësor i Kosovës: Rekrutimi i më shumë stafi të kualifikuar mbështetës, përfshirë bashkëpunëtorë dhe zyrtarë ligjorë në mënyrë që rastet të trajtohen më shpejt dhe me efikasitet.
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës: Të ndryshohet rregullorja për vlerësimin e performancës së gjyqtarëve dhe të parashihet shqiptimi i masave disiplinore si ato të përcaktuara me Ligjin për përgjegjësinë disiplinore për gjyqtarët dhe prokurorët (vërejtje publike me shkrim, ulje në detyrë dhe transferim apo ulje të përkohshme të pagës) ndaj gjyqtarëve që nuk shkruajnë vendime të arsyetuara, ose që shkruajnë vendime gjyqësore të arsyetuara në mënyrë të pamjaftueshme.
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës: Të krijohet një bazë të dhënash ku të dhënat për efikasitetin e gjyqësorit në trajtimin e lëndëve gjyqësore të korrupsionit dhe pastrimit të parave regjistrohen, përditësohen dhe publikohen sipas veprave të veçanta penale dhe llojit të dënimit të shqiptuar.
- Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Akademia e Drejtësisë: Organizimi i trajnimeve shtesë të specializuara për korrupsionin dhe krimet ekonomike. Kjo duhet të përfshijë një listë të trajnimeve të detyrueshme në lidhje me procesin e hetimit dhe hartimin e aktakuzave me cilësore për veprat penale të korrupsionit zyrtar dhe pastrimit të parave. Trajnimi i veçantë është i nevojshëm edhe për prokurorët për zhvillimin e aftësive në hetimin dhe mbledhjen e provave në rastet e konfiskimit të pasurive të fituara në mënyrë të jashtëligjshme.

Për institucionet mbikëqyrëse dhe të pavarura:

- KQZ: Zhvillimi dhe kryerja e programeve për ngritjen e kapaciteteve me mbështetjen e OSBE-së dhe organizatave të tjera ndërkombëtare ose vendase për të forcuar kapacitetet e Sekretariatit dhe stafit të Zyrës, brenda Komisionit Qendror Zgjedhor, veçanërisht në lidhje me shkrimin ligjor, aftësitë financiare dhe prezantimin publik.
- KQZ: Zgjerimi i dispozitave të transparencës dhe llogaridhënies së KQZ-së në nivelet lokale të trupave menaxhuese të zgjedhjeve.
- Avokati i Popullit: Miratimi i një Kod të ri të Etikës i cili përcakton qartë subjektet për të cilat zbatohet; përcakton llojet e informacionit që duhet të jetë konfidencial; ndalon angazhimet dhe kontributet ndaj subjekteve politike; përcakton politikën e sinjalizimit; dhe specifikon mbikëqyrjen e zbatimit dhe shqiptimin e masave disiplinore. Ndryshimet duhet gjithashtu të parashohin obligimin e IAP-së për të zhvilluar trajnime specifike për punëtorët lidhur me çështjet e integritetit.
- Avokati i Popullit: Fokusimi, në bashkëpunim me Kuvendin e Kosovës, në gjetjen e mënyrave për rritjen e nivelit të zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit nga institucionet publike. Duhet të merret parasysh kushtëzimi i ndarjes së mjeteve për institucionet publike në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit.
- Zyra Kombëtare e Auditimit: Të vlerësojë çështjet sistematike në nivel lokal dhe kombëtar, me synimin për të identifikuar shkakun rrënjësor të problemit dhe për të kontribuar në përmirësimin e proceseve dhe praktikave publike në menaxhimin e financave publike.
- Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit: Të bëhet më aktive në angazhimin e saj informues në fushatat e vetëdijesimit dhe edukimit të publikut mbi rëndësinë e raportimit të rasteve të konfliktit të interesit, mosdeklarimit të pasurisë dhe korrupsionit.
- Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit: Të adaptojë Planin e Veprimit Kundër Korrupsionit dhe ta harmonizojë atë me detyrat dhe kompetencat e tij sipas situatës aktuale.
- Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit: Të shtojë më shumë burimet njerëzore për të zbatuar plotësisht aktivitetin e saj në çështjet e mbikëqyrjes së legjislacionit anti-korrupsion, hartimit të planeve të integritetit dhe mbrojtjes së sinjalizuesve. Ekziston gjithashtu nevoja për të rekrutuar staf profesional administrativ në fushën teknologjike.
- Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit: Të kontrollojë dhe të ofrojë statistika nëse bizneset me mbi 50 të punësuar zbatojnë ligjin për sinjalizuesit dhe nëse kanë një zyrtar sinjalizues. Inspektorati i Punës duhet të krijojë një mekanizëm për sinjalizimin e zbatueshëm për bizneset më të vogla.





Për Sektorin Publik dhe Agjencitë e Zbatimit të Ligjit:

- Sektori publik: Angazhimi më i lartë me agjencitë e tjera shtetërore, OSHC-të dhe bizneset që lidhen drejtpërdrejt me luftën kundër korrupsionit. Kjo duhet të jetë në formën e memorandumëve të mirëkuptimit që parashohin trajnime për çështjet e integritetit, sinjalizimin, etj.
- Policia e Kosovës: Organizimi i trajnimeve shpesh të specializuara mbi integritetin dhe kryerja e testeve të vazhdueshme të integritetit për policët.

Për partitë politike:

- Të miratojnë politika të brendshme për të rritur pjesëmarrjen e grave në vendimmarrje duke promovuar modelin e përfaqësimit “zebra” – me çdo listë zgjedhore të partive politike që përfshin 50 për qind të grave. Vëmendje e veçantë duhet t’i kushtohet buxhetimit të barabartë gjinor, pra përgatitjes së buxhetit të partisë duke marrë parasysh perspektivat gjinore.

Për bizneset:

- Të krijojnë kode të brendshme të integritetit dhe të sigurojnë zbatimin e tyre
- Shoqatat e biznesit: Duhet të ofrojnë mbështetje financiare për OShC-të në luftën kundër korrupsionit dhe të organizojnë ngjarje për të diskutuar sfidat kundër korrupsionit në sektorin e tyre dhe si t’i trajtojnë ato.

Për entitetet mbikëqyrëse:

- Mediet: Të krijojnë një portfolio financiar më të larmishëm që u mundëson medieve të operojnë më të pavarur nga mbështetja e bizneseve.
- Mediet: Të vijohet bashkëpunimi ndërinstucional më aktiv me institucionet e drejtësisë në hetimin, zhvillimin dhe përfundimin më efektiv të rasteve të sulmeve ndaj gazetarëve.
- OSHC-të: Rritja e transparencës dhe publikimi i raporteve financiare vjetore.
- CIVIKOS: Të bashkëpunojnë me Rrjetin Ballkanik të Zhvillimit të Shoqërisë Civile për të zhvilluar masa për rritjen e llogaridhënies së OShC-ve bazuar në Standardin Global për Llogaridhënien e OShC-ve.

Për Ndërmarrjet shtetërore:

- Të përparojnë në përmirësimin e efikasitetit të punës së tyre, zhvillimin e sistemeve të shërbimit elektronik dhe zhvillimin e aplikacioneve për pranimin dhe ofrimin e shërbimeve të pagesave dhe faturave online.
- Duhet të përditësojnë faqet e tyre elektronike të internetit duke i bërë publike dhe të qasshme të gjitha dokumentet e tyre strategjike, kornizën ligjore, statutet dhe kodin e qeverisjes së korporatës, si dhe duke publikuar të dhëna për raportet e auditimit dhe raportet vjetore të punës.
- Duhet të caktojnë zyrtarë për medie dhe marrëdhënie me publikun për të trajtuar kërkesat nga media dhe shoqëria civile në kohën e duhur dhe të tregojnë përkushtimin e tyre për zhvillimin e transparencës.



